REVISTA STUDIME JURIDIKE

NR. 1, 2024

Fontespic – si koopertina

(Faqja pas Kopertinës)

Botim i parë: shtator 2001
Revista "Studime Juridike", botim i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
Adresa: Rruga 'Milto Tutulani', 1001, Tiranë
www.fdut.edu.al

ISSN: 2220-3990

© Të drejtat e autorit i përkasin Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Drejtori i revistës
Prof. Asoc. Dr. Ela Kerka

Bordi Editorial

Prof. Dr. Artan Hoxha
Prof. Dr. Dorina Hoxha
Prof. Dr. Skënder Kaçupi
Prof. Dr. Altin Shegani
Prof. Dr. Aurela Anastasi
Prof. Dr. Eralda (Methasani) Çani
Prof. Dr. Ardian Nuni
Prof. Dr. Argita Malltezi
Prof. Dr. Nada Dollani
Prof. Dr. Eriona Katro
Prof. Dr. Iva Zajmi
Prof. Asoc. Dr. Kristinka Jançe
Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Olldashi
Prof. Asoc. Dr. Flutura Tafaj
Prof. Asoc. Dr. Lirime Çukaj

Sekretariati teknik
Dr. Eniana Qarri
Elida Qershori

Shtypur në shtypshkronjën e Shtëpisë
Botuese.....
Tiranë, 2024

Pasyra e lëndës

Prof. Dr. Aurela ANASTASI
Garancitë kushtetuese përgjatë situatave të jashtëzakonshme në një vështrim të krahasuar 1

Prof. Dr. Artan HOXHA, Dr. Valbona NDREPEPAJ, Dr. Dorina SAJA
Vlerësimi i rolit të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.....15

Doc. Dr. Erind MERKURI
Interpretimi i kushtetutës midis shkollës "tekstualiste" dhe asaj "evolutive".....26

Assoc. Prof. Dr.sc. Blerton SINANI
Disa aspekte juridike mbi të drejtën komparative 61

Prof. Asoc. Dr. Anjeza LIÇENJI, Doktorant Saimir MUÇMATAJ
Aspekte doktrinale mbi llojet e veçanta të kontratës së dhurimit.....83

Dr. Eniana QARRI
Mbrojtja e kreditorëve të bashkëshortëve në regjimet pasurore me kontratë: efektet ligjore të regjistrimit të kontratës martesore.....92

Dr. Ilda MUÇMATAJ
Standardi i origjinalitetit si një prej kërkesave themelore për mbrojtjen e veprave nga e drejta e autorit. *Aspekte teorike të legjislacionit dhe jurisprudencë*.....106

Doktorante Sonila KAMAMI
Nga diversiteti në uniformitet: e drejta kontraktore në Bashkimin Evropian 119

Doktorante Lira SPIRO
Pronësia industriale, rëndësia e saj dhe Bashkimi Evropian.....128

Doktorante Inesa ADHAMI (LL.M.)
COVID-19 dhe zhvillimet e ndihmës shtetërore në Bashkimin Evropian dhe në Shqipëri 138

Doktorante Erida SKËNDAJ, Prof. Asoc. Dr. Skerdian KURTI
Analizë krahasimore e legjislacionit shqiptar dhe atij italian mbi regjimin e posaçëm të ushtrimit të të drejtave në institucionet penitenciare 14649

Dr. Bledar MUSTAFARAJ, Msc. Kristina PUCI
Efikasiteti i trajtimit juridiko-penal të veprës penale "shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" në Shqipëri si dhe problematikat e hasura.....1625

Msc. Maend KULLAJ
Krimet seksuale sipas të drejtës penale kosovare: vështrim krahasimor 1760

Doktorant Ismail SHEHU, Prof. Asoc. Dr. Saimir SHATKU
Standardet dhe të drejtat e të miturve gjatë procesit penal 1882

Msc. Erina SHIRA
Garancitë ligjore që gëzojnë të miturit nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit.....1960

GARANCITË KUSHTETUESE PËRGJATË SITUATAVE TË JASHTËZAKONSHME NË NJË VËSHTRIM TË KRAHASUAR

Prof. Dr. Aurela ANASTASI*

THE CONSTITUTIONAL PRINCIPLES DURING THE EXTRAORDINARY MEASURES

Abstract

The constitutional principles during the extraordinary measures are the basic guarantees for the protection of the Rule of Law. During these periods, the priorities and balances of governance are shifted, due to the specific needs for managing the situation and avoiding the created consequences. Therefore, the attention of this paper is focused on the respect for the rule of law, as the basic guarantee for the functioning of constitutional democracy in these situations. Through the empirical and comparative methods, the study analyze the Albanian institutional experience during this period to the standards that originate from international acts, as well as to the experiences of other countries. Not being able to analyse all aspects of the rule of law, the paper focuses on the issues of the application of the constitutional guarantees during the emergencies.

Keywords: *constitutionalization of extraordinary measures; extraordinary measures; principle of proportionality, principle of periodicity, principle of renewal, direct application of acts.*

1. Hyrje

Sidomos gjatë periudhës Covid 19, është shprehur gjerësisht mendimi se përgjatë situatave të jashtëzakonshme Shteti i së Drejtës futet në një periudhë të fortë stresi. Kjo mund të shpjerë në cenime të marrëdhënieve institucionale, krahas cenimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Për shembull, "*Komisioni Evropian e konsideroi pandeminë Covid-19 si një test stresi për qëndrueshmërinë e sundimit të ligjit.*"[1] Ky shqetësim ngrihet në të gjitha vendet, përfshirë edhe demokracitë më të konsoliduara, por veçanërisht në demokracitë të reja, sikurse janë vendet e Ballkanit Perëndimor, ku përfshihet edhe Shqipëria.

Gjatë pandemisë Covid -19, "*Përjashtimisht, funksionimi i institucioneve të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe i gjyqësorit ose u ndërpre ose u kufizua për disa javë dhe në disa raste edhe më gjatë. Kjo ishte veçanërisht e dukshme në vendet e Ballkanit Perëndimor*".[2]

Ky punim ka qëllim të trajtojë garancitë kushtetuese për përballimin e stresit që kalon Shteti i së Drejtës përgjatë periudhave të jashtëzakonshme. Studimi bazohet kryesisht, në përvojën e Shqipërisë gjatë dy fatkeqësive natyrore të njëpasnjëshme: tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia Covid-19 (2020-2021). Ai synon që përmes analizës së zbatimit të parimeve të Kushtetutës në këto situata të nxjerrë mësime për të ardhmen. Është shumë e nevojshme të analizohet se si masat e ndërmarra për të minimizuar pasojat e fatkeqësisë natyrore ndikojnë në mbarëvajtjen e Shtetit të së Drejtës. Kjo është një nga pyetjet kryesore në të cilat është përqendruar kërkimi dhe analiza e këtij punimi. Përpos të tjerave, studimi kërkon të gjejë dhe të argumentojë se si ndikon në përballimin e

* Aurela Anastasi, Profesore/Pegagoge pranë Departamentit të së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
[1] "The Protection of Human Rights during Times of Emergency. An analysis of the relevant jurisprudence of the European Court of Human Rights through the lens of the Covid-19 pandemic", AIRE Center, 2022, f. 218.
[2] Po aty, f. 21.

stresit të Shtetit të së Drejtës në këto situata, zbatimi i drejtpërdrejtë i Kushtetutës dhe i parimeve që ajo sanksionon, si dhe zbatimi i drejtpërdrejtë i standardeve ndërkombëtare.

Rasti i Shqipërisë, e cila kaloi në dy kriza të njëpasnjëshme për shkak të tërmetit të Nëntorit 2019 dhe të pandemisë globale Covid 19, tregoi nevojën e kësaj analize. Për më tepër, pandemia e gjeti Shqipërinë në një situatë mjaft të brishtë politike për shkak se si kurrë më parë, opozita kishte lënë mandatet dhe Parlamenti kishte humbur një numër të konsiderueshëm deputetësh[3]. Nga ana tjetër gjyqësori po vuante stres për shkak të mungesave të krijuara nga reforma në drejtësi që kishte filluar në vitin 2016. Madje, mund të themi se vetë drejtësia ishte në një proces tjetër emergjent, pasi po zhvillohej *vetting*-u i gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili rezultonte me largime nga puna.[4] Në këtë periudhë, gjyqësori e uli dukshëm volumin e çështjeve të gjykuara. Kjo evidentohet nga vjetari statistikor i vendimeve të dhëna gjatë vitit 2020, i cili qartazi është më i ulët sesa ai i viteve paraardhëse ose pasardhëse.[5] Kështu, u shumëfishuan problemet e krijuara për funksionimin e pushtetit gjyqësor.

Në këtë kuadër, përpos të tjerave, punimi rreket të argumentojë nëse kontrolli gjyqësor është një nga kontributet më të rëndësishme për respektimin e parimit të Shtetit të së Drejtës përgjatë emergjencave dhe përballimin e stresit të tij.

2. Kushtetuta dhe masat e jashtëzakonshme

2.1 Kushtetutëzimi i masave të jashtëzakonshme: një vështrim i krahasuar

Parashikimi në Kushtetutë i rregullimeve themelore për masat e jashtëzakonshme ofron garancitë për mbrojtjen e Shtetit të së Drejtës. Masat e jashtëzakonshme ndërmerren nga shtetet kryesisht, për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së rrezikut për rendin e brendshëm kushtetues, si dhe gjendjes së fatkeqësisë. Kushtetuta e Shqipërisë (1998) ka parashikuar masat e jashtëzakonshme për të tria rastet e sipërpërmendura. Ajo rregullon regjimet juridike përkatësisht për "*gjendjen e luftës"*, "*gjendjen e jashtëzakonshme"* dhe "*gjendjen e fatkeqësisë natyrore"* (nenet 170-176). "Gjendja e jashtëzakonshme" *per se*, vendoset në rastin e rrezikut për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike. "Gjendja e luftës" vendoset në rast agresioni të armatosur, kurse, "Gjendja e fatkeqësisë natyrore" vendoset për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore a aksidenti teknologjik. Kushtetuta e Shqipërisë (neni 170.1) sanksionon shprehimisht:

"*Masat e jashtëzakonshme mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe zgjatin për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje.*"

Një regjim të ngjashëm me Shqipërinë ka ndjekur Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila ka parashikuar vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme në të tria rastet e sipërpërmendura (neni 131). Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka parashikuar gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme. E para shpallet kur paraqitet rreziku i sulmit ndaj Republikës, kurse e dyta shpallet kur ndodhin fatkeqësi të mëdha natyrore ose epidemi (nenet 122-128). Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi ka parashikuar "gjendjen e luftës" dhe "gjendjen e jashtëzakonshme". Kjo e fundit shpallet për shkaqe të rrezikut të paqes së brendshme dhe të rendit kushtetues, si dhe për shkaqe të fatkeqësisë natyrore dhe aksidenteve teknologjike (nenet 132-133). Sipas Kushtetutës së Serbisë, përgjithshëm sanksionohet se gjendja e emergjencës shpallet në rastin kur ekzistenca e shtetit dhe jeta e qytetarëve ndodhen përpara një "rreziku publik" (nenet 122-128). Për sa më sipër konstatojmë se të gjitha kushtetutat e vendeve të Ballkanit perëndimor kanë konstitucionalizuar masat e jashtëzakonshme dhe kanë parashikuar rregullime për përballimin e situatave të jashtëzakonshme. Midis tyre ka disa diferenca përsa i

[3] Shih: Cukani, Entela. *Albania e Covid-19: dallo stato di calamità naturale alla calamità dello Stato di diritto?* Saggi- DPCE online, 2020/2, f. 2006 available at: Albania_e_Covid_19_dallo_stato_di_calami (2).pdf

[4] Anastasi, Aurela. *Reforming the Justice System in the Western Balkans.* Constitutional Concerns and Guarantees (June 19, 2018). Workshop No. 18, of the 10th World Congress of Constitutional Law (IACL-AIDC); 2018 SEOUL 18-22 June 2018, Available at SSRN: https://ssrn.com/abstract=3198787 or http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.3198787.

[5] Shih:Vjetari statistikor 2020: https://www.drejtesia.gov.al/statistika/.

përket detajimit të rregullimeve në Kushtetutë. Rezulton se Kushtetuta e Shqipërisë spikat për një rregullim më të detajuar. Kjo e fundit u miratua pasi Shqipëria kishte dalë nga periudha e gjendjes së jashtëzakonshme e vitit 1997. Ndoshta, kështu shpjegohen dispozitat mjaft të hollësishme të Kushtetutës për masat e jashtëzakonshme.

Gjetje rezultojnë edhe nga krahasimi i kushtetutave të reja me kushtetutat e demokracive të konsoliduara, të cilat kanë miratuar kushtetuta më hershëm, sidomos ato të hartuara pas Luftës II Botërore. Këto të fundit kanë më pak dispozita të shprehura në Kushtetutë. Në mungesë të tyre vepron tradita kushtetuese dhe ligjet e posaçme. Nga një vëzhgim i këtyre të fundit, konstatohet se sidomos dispozitat kushtetuese që rregullojnë gjendjet e fatkeqësisë natyrore, ose janë shumë të pakta, ose mungojnë krejt. P.sh., Kushtetuta e Italisë (1948) parashikon vetëm masat e jashtëzakonshme për shkak të luftës (neni 78). Ndërsa kushtetutat e periudhës post rënies së regjimit komunist kanë parashikime të detajuara në Kushtetutë, duke vendosur parime e kufizime të posaçme gjatë këtyre periudhave. Të tilla mund të përmenden p.sh., Kushtetuta e Republikës së Polonisë 1997, (nenet 228-234)[6], ose Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë (nenet 57/3, 64/2, 84/12, 100/5, 162/2)[7].

Çfarë rëndësie ka konstitucionalizimi/kushtetutëzimi i rregullimit të situatave të emergjencës? Kjo pyetje u ngrit përgjatë pandemisë Covid -19, duke ringjallur debatin Hans Kelzen me Carl Shmidt.[8] Në doktrinë është shprehur mendimi se rregullat emergjente të parashikuara në Kushtetutë zakonisht nuk janë përdorur:

> "…*modelet e emergjencës nuk duhet të shihen thjesht si elementë statikë të një rendi kushtetues, pavarësisht nga fakti se rregullat emergjente të përcaktuara në kushtetutë zakonisht nuk janë përdorur*."[9]

Mospërdorimi i tyre lidhet me faktorë të ndryshëm. Mund të jetë rasti i kushtetutave që nuk kanë rregulla të detajuara e për rrjedhojë gjithçka rregullohet nga ligji. Por, sidomos pas situatës së Covid 19, rezultoi se kushtetutëzimi i dispozitave të posaçme për situatat e jashtëzakonshme, ka rëndësi për veprimin shtetëror, për mbrojtjen e Shtetit të së Drejtës. Nga ky krahasim *prima facia*, më së paku, kuptojmë nevojën e konstitucionalizimit të masave të jashtëzakonshme, veçanërisht në demokracitë e reja. Ai ofron garanci përmes sanksionimit të parimeve dhe kritereve të posaçme për periudhat e emergjencave, ndalesave ndaj ndërprerjes së të drejtave të njeriut, garantimit të parimit të sigurisë juridike dhe të drejtës për kompensim, etj. Garanci të tjera burojnë edhe nga bashkëveprimi i dispozitave të posaçme për masat e jashtëzakonshme, me sistemin e përgjithshëm të parimeve kushtetuese. Nëse këto nuk do të sanksionoheshin shprehimisht, rregullimi do të zbriste në nivelet e mbrojtjes ligjore nga gjykatat e zakonshme. Prandaj, konstitucionalizimi i masave të jashtëzakonshme mbështet gjykimin kushtetues, krahas atij administrativ, të cilat përbëjnë garancitë procedurale më të rëndësishme përgjatë emergjencave. Përvoja e pandemisë tregoi veçanërisht, se zhvillimi i mendimit kushtetues mbetet shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e Shtetit të së Drejtës. Ky zhvillohet edhe më shumë në raportet shumëplanëshe të rregullimit të gjendjes së jashtëzakonshme, pra, edhe nga Kushtetuta, edhe nga aktet ndërkombëtare, edhe nga ligjet. Zbatimi i tyre i drejtpërdrejtë përbën në vetvete një garanci për mbrojtjen e Shtetit të së Drejtës.

2.2 Zbatimi i drejtpërdrejtë i Kushtetutës

Zbatimi i drejtpërdrejtë i Kushtetutës është një garanci që do të rriste sigurinë juridike dhe do të mbronte Shtetin e së Drejtës nga deformimet gjatë dhe pas përfundimit të masave të jashtëzakonshme. Kushtetuta e Shqipërisë ka sanksionuar shprehimisht zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të Kushtetutës. "*Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe*." (neni 4/3). Kjo është

---

[6] Shih: Kushtetuta e Republikës së Polonisë: THE_CONSTITUTION_OF_THE_REPUBLIC_OF_POLAND.pdf (kul.pl).

[7] Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë: https://www.parliament.bg/en/const.

[8] Selimi, Behar, Rexhaj, Albatros. *Trajtimi kushtetues i të drejtave dhe lirive themelore gjatë menaxhimit të pandemisë së covid-19 në Kosovë*, Centrum 15, 2021.

[9] Tímea, Drinóczi. *Central and Eastern European constitutional formulas: the abuse and observance of constitutions in times of emergency*. THE 10TH IACL-AIDC World Congress 2018 Workshop Abuse of the Constitution in Times of Emergency, available at: (99+) Central and Eastern European constitutional formulas: the abuse and observance of constitutions in times of emergency | Timea Drinoczi - Academia.edu

një qasje që e kanë edhe mjaft Kushtetuta të tjera, veçanërisht ato të hartuara pas rënies së regjimit komunist në vendet e Evropës Lindore.[10] Në disa vende kjo është afirmuar edhe nga organet e kontrollit kushtetues, sikurse ka interpretuar Këshilli Kushtetues Francez.[11]Megjithatë, për ta realizuar këtë, është po aq e rëndësishme që përmbajtja e dispozitës të jetë e zbatueshme drejtpërdrejt. Ky është një element thelbësor i kushtetutëzimit të masave të jashtëzakonshme. Në përgjithësi, zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e kushtetutës që vendosin shkaqet dhe kushtet për masat e jashtëzakonshme, institucionet kompetente që i ndërmarrin këto masa, procedurat përkatëse, si dhe dispozitat që vendosin ndalimin e veprimtarive ose kufizimin e të drejtave kushtetuese. P.sh., ekzistenca e dispozitave ndaluese të shprehura në Kushtetutën e Shqipërisë për zhvillimin e zgjedhjeve përgjatë masave të jashtëzakonshme, ka parazgjidhur një konflikt të mundshëm. Një konflikt i tillë ndodhi në Poloni gjatë periudhës së emergjencës Covid-19, kur shpalli ligjin për mbajtjen e zgjedhjeve presidenciale përgjatë pandemisë.[12] Shqipëria e kaloi një situatë të tillë në krye të krizës së vitit 1997,[13] kur Kuvendi i kohës kishte shpallur gjendjen e jashtëzakonshme për shkak të rrezikut ndaj sigurisë publike dhe zhvilloi zgjedhjet për Presidentin e ri të Republikës. Aktualisht, kjo çështje është rregulluar shprehimisht në Kushtetutën e Shqipërisë, e cila thekson:

"*Gjatë periudhës së zbatimit të masave të jashtëzakonshme nuk mund të zhvillohen zgjedhje vendore, nuk mund të zhvillohet referendum, si dhe nuk mund të zgjidhet një President i ri i Republikës.* …." (neni 170/6).

Gjatë masave të jashtëzakonshme Kushtetuta ndalon edhe ndryshimin e kushtetutës, e ligjeve për zgjedhjet e Kuvendit dhe për organet e pushtetit vendor, si dhe e ligjeve për masat e jashtëzakonshme (neni 170/5). Në fakt, një ligj për gjendjen e jashtëzakonshme në bazë të referencës që bën Kushtetuta (neni 81/2 dh) nuk është miratuar ndonjëherë. Ky ligj do të shërbente për rregullime të përgjithshme garantuese. Kështu do të zinin vend standardet ndërkombëtare si fjala vjen kushtet që Komisioni i Venecies ka renditur në listë,[14] për përcaktimin e kritereve për shpalljen e masave të jashtëzakonshme[15].

2.3 Zbatimi i drejtpërdrejtë i akteve ndërkombëtare

Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon zbatimin e drejtpërdrejtë të akteve ndërkombëtare, të cilat pas ratifikimit të tyre bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm. Përvoja tregon se në rastin e emergjencave dhe gjendjeve të jashtëzakonshme një rol të veçantë përbëjnë vendimet e gjykatave ndërkombëtare, sidomos të GJEDNJ-së. Gjithashtu, e rëndësishme paraqitet edhe e drejta e butë e organizatave ndërkombëtare, e cila është mjaft ndihmuese për të mbrojtur standardet themelore të shtetit të së drejtës.[16] Ky fakt, u evidentua përgjatë pandemisë Covid 19, me masat e rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Disa autorë diskutuan mundësinë për detyrueshmërinë e akteve të nxjerra nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.[17] E drejta e Butë ndërkombëtare ka përpunuar edhe kushtet bazë që duhet të përmbushen nga shtetet përgjatë emergjencave, me qëllim që Shteti i së Drejtës të kalojë testin e "stresit".[18]

Në këtë kuadër, janë mjaft të rëndësishme opinionet që vijnë nga Komisioni i Venecies. Sipas tyre, Qeveria teston paraprakisht situatën dhe shpall gjendjen e jashtëzakonshme kur përmbushen kriteret që vijojnë:

[10] Omari, Luan, Anastasi, Aurela. *E drejta Kushtetuese*, Tiranë, 2017, f. 98.
[11] Favoreaux, Luis.et al. 1999. *Droit Constitutionnel*. Paris: Dalloz, f. 803-804.
[12] Selimi, Rexhaj. cituar.
[13] Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr.14, viti 1997.
[14] *Venice Comision, Rule of Law check List*, CDL-AD (2016)007*11-12 mars 2016, available at:* default.aspx (coe.int)
[15] CDL-PI (2020)003; C*ompilation of Venice commission opinions and reports on states of emergency*; Strasbourg, 16 Prill 2020.
[16] Asambleja Parlamentare e Keshillit të Europës 1713(2005); dhe (CDL-PI(2020)003; cituar.
[17] Villarreal Pedro A, Covid-19 and Police Powers Beyond the State, 30 Septembre 2021, në: COVID-19 and Police Powers Beyond the State — IACL-IADC Blog (blog-iacl-aidc.org)
[18] CDL-PI (2020)003; cituar.

Rreziku/kriza ka natyrë të jashtëzakonshme është real, pra, të jetë duke ndodhur ose së paku të jetë i pashmangshëm; Pasojat e rrezikut/krizës duhet të përfshijnë të gjithë kombin dhe rreziku/kriza kërcënon vazhdimësinë e jetës së organizuar në komunitet; Kriza ose rreziku duhet të jenë të jashtëzakonshme, deri në atë shkallë që masat normale ose kufizimet të jenë plotësisht të papërshtatshme; Shpallja e situatës së jashtëzakonshme të kryhet mbi bazën e dispozitave që ekzistojnë më parë në vend; Masat e jashtëzakonshme mund të vendosen vetëm përkohësisht, për aq kohë sa situata e rrezikut/krizës e dikton këtë.[19]

Legjislacioni i Bashkimit Evropian është gjithashtu një burim mjaft i rëndësishëm në këto periudha. Përqasja e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, është një garanci jo vetëm për efektivitetin e masave të jashtëzakonshme, por edhe për mbrojtjen e Shtetit të së Drejtës. Në Shqipëri, vitet e fundit ka ndodhur intensivisht përqasja e legjislacionit të brendshëm me acquis-në e BE-së. Edhe legjislacioni për menaxhimin e emergjencave civile, rezulton një legjislacion i ri, i përqasur, së paku pjesërisht. Kështu, ligji "Për mbrojtjen civile"[20] është përqasur pjesërisht me katër direktiva të BE-së, si dhe me vendime të Parlamentit Evropian dhe të Komisionit.

2.4 Zbatimi i drejtpërdrejtë i ligjeve

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon që ligji për gjendjen e jashtëzakonshme të miratohet me shumicë të cilësuar, prej 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 81/2 dh). Megjithatë, që nga viti 1998 kur kjo kushtetutë hyri në fuqi, deri më sot, Shqipëria nuk ka miratuar një ligj të tillë dhe nuk ka pasur ndonjë propozim për një ligj të tillë. Heshtja për këtë nismë ligjore sjell paqartësi se, cilat janë aspektet e gjendjes së jashtëzakonshme që duhet të rregullonte ky ligj. Nga konteksti, ai i referohet vetëm situatës së rrezikut për rendin kushtetues dhe për sigurinë publike. Situatat e emergjencës për shkak të fatkeqësisë natyrore, kanë një bazë ligjore të vendosur paraprakisht, përmes ligjeve të posaçme, sipas fushave. Megjithatë, pavarësisht nga ky pluralitet ligjesh të posaçme për emergjencat natyrore, një rregullim i përgjithshëm i organizimit dhe funksionimit të institucioneve është parashikuar në ligjin "Për mbrojtjen civile". Ky i fundit, ka një natyrë më të përgjithshme dhe aktualisht mund të konsiderohet si një rregullator i kodifikuar për të gjitha emergjencat në kuptimin administrativ të fjalës. Por, për shkak të veçorive specifike, ka edhe një sërë ligjesh që parashikojnë masa të posaçme. Të tilla janë ato për mbrojtjen nga përhapja e sëmundjeve dhe infeksioneve që rregullojnë marrëdhëniet e krijuara në varësi të situatës së emergjencës. Të tilla janë ligjet "*Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive*", si dhe ligji "*Për shëndetin Publik*". Ka edhe ligje të tjera që mund të lidhen me këto situata sikurse ligji "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin",* etj.[21] Në kushtet e këtij pluraliteti, mungon jo vetëm një ligj kuadër, por edhe një inkorporim i dispozitave që zbatohen përgjatë gjendjes së jashtëzakonshme, të cilat janë të shpërndara në ligje të ndryshme.

Çështja e shtruar është kufiri midis zbatimit të drejtpërdrejtë të Kushtetutës dhe zbatimit të ligjeve të posaçme. Kështu, masat që u morën për përballimin e pasojave të tërmetit, shfaqën dilemën nëse duhet të vepronte "gjendja e fatkeqësisë natyrore", si një regjim juridiko-kushtetues apo "emergjenca civile" si një regjim juridiko-administrativ. Të dyja këto situata trajtohen në mënyrë të pavarur në aktet përkatëse. Një konkurrencë e tillë ndodh edhe midis Kushtetutës dhe ligjeve për mbrojtjen nga sëmundjet infektive. P.sh., disa masa kufizuese në rastin e pandemisë së Covid -19 u morën nga Qeveria shqiptare përpara shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Kjo e fundit u shpall më 24 Mars 2020, ndërsa urdhri i parë që shpalli gjendjen e epidemisë daton më 11 Mars 2020. Akti normativ i Këshillit të Ministrave që parashikoi masa të veçanta përgjatë periudhës së epidemisë Covid 19,

[19] Venice Comision, Rule of Law check List, cituar dhe CDL-PI (2020)003; cituar.
[20] Ligj nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile".
[21] Shih: Ligj nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"; & Ligj nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin Publik", & Ligj nr. 152/2015 datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".

hyri në fuqi që në datën 15 Mars 2020[22]. Për këtë u ngritën disa pikëpyetje,[23] të cilat mbetën në trajtën e debatit, ndërkohë që në Republikën e Kosovës u bënë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.[24]

Gjykata Kushtetuese ka pasur një rol të dukshëm për respektimin e ligjit përgjatë masave të jashtëzakonshme. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë në çështjen me objekt shfuqizimin si antikushtetues të amendamenteve të Kodit Penal që sanksiononin përgjegjësinë penale për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, ka theksuar se cilësia e ligjit duhet të përmbushet, pavarësisht se vendi po kalon masa të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë Covid 19.[25] Gjykata ka vënë theksin tek zbatimi i ligjit, duke nënvizuar se ai duhet të jetë mjaftueshëm i aksesueshëm, i saktë dhe i parashikueshëm për zbatim (parag.32). Ajo ka ngritur shqetësime që lidhen me "*cilësinë e ligjit*" dhe rithekson se, kur kontrollohen aktet e pushtetit publik, sa herë që vihet në diskutim një e drejtë kushtetuese ose liri themelore, është me rëndësi të verifikohen parimet që lidhen me cilësinë e ligjit, parashikueshmërinë, sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit. Kjo, sepse janë pikërisht ato parime që mbrojnë individin nga arbitrariteti, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet tij dhe shtetit (parag. 29.) Në këtë rast, vlen të theksohet edhe fakti se, Gjykata nuk i mori në konsideratë pretendimet e palëve për shkelje të procedurave për miratimin e ndryshimeve të Kodit Penal. Madje, nuk e konsideroi rastin në gjykim, të lidhur me pretendimin e palës se ky aktivitet legjislativ nuk duhet të ndodhte. Sipas kësaj Gjykate:

"*Këshilli i Evropës ka udhëzuar se gjatë krizës së COVID-19 shtetet duhet të minimizojnë aktivitetin legjislativ në masën e domosdoshme për të adresuar gjendjen në të cilën ndodhet shteti*" (parag 58).

Sidoqoftë, këtu është fjala për një aktivitet legjislativ të lidhur me situatën e jashtëzakonshme. Por, parë që ndryshimi kryhej mbi kodin Penal për vepra të reja penale përgjatë situatës së pandemisë, mund të ngrihej çështja standardit se legjislacioni duhet të ketë parashikuar më parë kufizimet e lirive përgjatë situatave të jashtëzakonshme e sidomos në të drejtën penale në kuadrin e parimit "Nuk ka dënim pa ligj".

3. Parimet kushtetuese përgjatë periudhës së masave të jashtëzakonshme

3.1 Parimet e posaçme

Një interpretim tekstual i dispozitave të Kushtetutës së Shqipërisë evidenton parime të së drejtës që janë sanksionuar në mënyrë të posaçme për situatat e jashtëzakonshme. Ajo vendos dy parime themelore mjaft të rëndësishme atë të proporcionalitetit dhe rimëkëmbjes kur sanksionon:

"*Të gjitha aktet që ndërmerren si pasojë e masave të jashtëzakonshme duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e rrezikut, dhe duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për funksionimin normal të shtetit*." (neni 170/4).

Ndërsa më tej Kushtetuta afirmon parimin e përkohshmërisë së tyre kur thekson se këto masa:

"*...zgjatin për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje*" (neni 170/1).

Sa më sipër, evidentohen tri parime themelore që përshkojnë masat e jashtëzakonshme. I quajmë parime dhe jo thjesht kritere, për shkak të prioritetit që marrin në lidhje me Shtetin e së Drejtës në situatat e jashtëzakonshme.

- parimi i rimëkëmbjes/ripërtëritjes
- parimi i proporcionalitetit

[22]Këto dhe aktet e tjera normative për gjendjen e epidemisë janë të gjindshme në faqen zyrtare: https://shendetesia.gov.al/masat-e-reja-per-te-parandaluar-perhapjen-e-covid-19/.
[23]Shih: ***Albania's response to the coronavirus pandemic,*** Andi Hoxhaj, University of Warwick, e gjindshme në: https://www.cambridge.org/core/blog/2020/05/19/albanias-response-to-the-coronavirus-pandemic/.
[24] Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nr. KO54/20.
[25] Shih: Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr. 39, viti 2022.

- parimi i përkohshmërisë dhe i periodicitetit të masave të jashtëzakonshme.

Këtyre parimeve iu shtohet dhe parimi i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore në kushtet e masave të jashtëzakonshme, nga neni 175 i Kushtetutës.

Midis tyre, parimi i proporcionalitetit, është një parim i përgjithshëm në çdo kohë, i sanksionuar shprehimisht në Kushtetutën e Shqipërisë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore nga kufizimet arbitrare (neni 17/1). Kushtetuta kujdeset për epërsinë e tij përgjatë masave të jashtëzakonshme. Dy parimet e tjera janë karakteristikë vetëm për periudhat e emergjencave. Sidoqoftë, të tria parimet lidhen ngushtë me njëri-tjetrin dhe zbatohen si një sistem. Ato veprojnë të gërshetuara me parimet e tjera kushtetuese të Shtetit të së Drejtës dhe nuk presupozojnë një shmangie prej tyre. Sidoqoftë, Kushtetuta e Shqipërisë referon në ligj përcaktimin e parimeve të veprimtarisë së organeve publike dhe të shkallës së kufizimit të të drejtave dhe lirive të Njeriut gjatë gjithë periudhës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme (neni 170/2). Referenca në ligj lidhet ngushtë me garancinë kushtetuese për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme mbi bazën e dispozitave të miratuara më parë.[26] Madje, ka mendime që edhe detyrimi për të shpallur formalisht gjendjen e jashtëzakonshme kur është e nevojshme, përbën gjithashtu një parim kushtetues[27]. Këtyre parimeve iu nënshtrohen të gjitha aktet që ndërmerren në këto periudha. Kur Kushtetuta e Shqipërisë thekson "aktet që ndërmerren", ka pasur parasysh jo vetëm aktet e së drejtës, por edhe të gjitha veprimtaritë që kryhen nga institucionet.

Për sa më sipër, një rol të domosdoshëm merr interpretimi i parimeve nga Gjykata Kushtetuese. Në literaturë është shprehur opinioni se:

"*Megjithëse në pjesën më të madhe të tekstit të kushtetutës përfshihen parimet e përgjithshme, kuptimi i tyre është kryesisht rezultat i procesit interpretues të gjykatës*."[28]

Për të siguruar që dispozitat e Kushtetutës të zbatohen drejtpërsëdrejti, është e domosdoshme jurisprudenca kushtetuese. Ajo i shtjellon këto parime në aktualitetin e tyre, duke nxitur zbatimin e tyre të drejtpërdrejtë, edhe pse janë parime dhe kanë karakter përgjithësues.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka një qasje të ngjashme në lidhje me parimet, por i ka mëshuar në mënyrë të veçantë parimit të fuqisë së Kushtetutës edhe përgjatë masave të jashtëzakonshme. "Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk suspendohet. Kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Kushtetutë, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me këtë Kushtetutë. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të Komunave nuk mund të ndryshohet. Parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme rregullohen me ligj, por ato nuk duhet të jenë në shpërputhje me këtë nen" (neni 131.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës").[29]

3.2 Parimi i proporcionalitetit si një parim metodik

Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së proporcionaliteti kërkon që:

"*...Shteti të marrë vetëm masa që kërkohen strikt nga situata emergjente*."[30]

Për këtë është e nevojshme që proporcionaliteti të shndërrohet në një parim metodik në punën e përditshme të administratës publike. Edhe në situatat e zakonshme janë shtuar zërat që e lidhin parimin e proporcionalitetit jo vetëm me nivelin gjyqësor, por edhe me metodat që duhet të përshkojnë veprimtarinë e administratës publike. Ka

[26] CDL-PI (2020)003; cituar.
[27] Shih: Bajrami, Arsim. *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*, Shtëpia Botuese "Artini", Prishtinë (2012).
[28] Vorpsi, Arta (2022). The Role of Constitutional Justice in Preserving the Rule of Law in Albania. In: Cremades, J., Hermida, C. (eds) Encyclopedia of Contemporary Constitutionalism. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-319-31739-7_18-1
[29] Shih më gjerë: Hasani, Enver.*Komentar, Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Botimi I, Prishtinë, 2013, f. 652.
[30] The Protection of Human Rights during Times of Emergency, cituar f. 227.

një vështrim të proporcionalitetit jashtë gjykatave në këndvështrimin e konstitucionalizmit popullor dhe politik[31], pra në veprimtaritë e tjera jashtëgjyqësore, si legjislativi dhe ekzekutivi. Këto organe, në masat që marrin, duhet të testojnë zbatimin e proporcionalitetit. P.sh., në mënyrë të arsyeshme, ligjvënësi duhet të marrë në konsideratë:

"*...nëse legjislacioni shtrëngues ndërhyn sa më pak të jetë e mundur në sferat e dobishme të lirisë private*."[32]

Për më tepër, përgjatë periudhës së emergjencës kjo kërkesë bëhet më strikte dhe institucionet duhet të kryejnë analizën e proporcionalitetit kur marrin masa të jashtëzakonshme. Testi i proporcionalitetit i zhvilluar nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut, si dhe jurisprudenca e gjykatave kushtetuese të shteteve, ndihmon për të vlerësuar masat kufizuese të ndërmarra në periudhën e emergjencës. E ilustrojmë këtë me një vendim të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë. Kjo e fundit, shqyrtoi kërkesën me objekt, shfuqizimin si antikushtetues të urdhrit të Ministrit të shëndetësisë dhe çështjeve sociale që ndalonte:

"*...grumbullimet me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore, deri në një urdhër të dytë....*"[33]

Në arsyetimin e saj, Gjykata theksoi:

"*Për përmbushjen e kërkesave të këtij parimi, përgjatë emergjencës institucionet duhet të parashikojnë vetëm masat e domosdoshme, të lidhura vetëm me tejkalimin e pasojave si dhe të specifikojnë sa më qartë qëllimin dhe fushën e veprimit të akteve që miratojnë."*

Në përfundim të gjykimit ajo vendosi:

"*…termi 'deri në një urdhër të dytë'...., nuk i përgjigjet standardit të proporcionalitetit".*[34]

Në një situatë të zakonshme vështirë se mund të vendoste kështu. Urdhrat me një tekst të tillë në administratën publike janë të shumtë dhe jo medoemos janë antikushtetues. Një aspekt mjaft i rëndësishëm për Shtetin e së Drejtës mbetet shtrirja në kohë e masave kufizuese për shkak të situatave të jashtëzakonshme. Prandaj, për situatën e jashtëzakonshme ky formulim i urdhrit është vlerësuar antikushtetues. Pra përkohshmëria, shtrirja në kohë *strikt* në përputhje me nevojat që dikton situata, është një standard kryesor për të përmbushur kërkesat e parimit të proporcionalitetit në periudhat e jashtëzakonshme.

Edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës në një rast të ngjashëm, nuk ka lejuar që kufizimet të shtrihen në të gjithë vendin ose komunitetin, nëse nuk shpallen masat e jashtëzakonshme në përputhje me Kushtetutën.[35]

Në Shqipëri, përpos izolimit dhe karantinës pati edhe masa të tjera të kufizimit të lirisë së lëvizjes si mbyllja në shtëpi, mbyllja në hotele dhe vende të caktuara për strehimin e përkohshëm të personave të riatdhesuar[36] etj. Kur këto masa vijuan edhe përgjatë vitit 2021, disa prej tyre ngjallën mjaft debate. P.sh., Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë në prag të zgjedhjeve të reja, për karantinimin e të riatdhesuarve që mbërrinin nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia,[37] u kritikua ashpër dhe u dërgua për pakushtetutshmëri në Gjykatën Kushtetuese nga organizata të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit. Por, Gjykata Kushtetuese nuk e shqyrtoi këtë masë. Ajo e pushoi gjykimin,

---

[31] Frank I, Michelman. *Proportionality outside the courts with special reference to popular and political constitutionalism*, "Proportionality…" Proportionality. New Frontiers, new challenges", Edited by Vicky C. Jackson and Mark Tushnet, Cambridge University Press, 2017, f. 30.

[32] See: Vicky C, Jackson. *"Proportionality and equality"*, in "Proportionality…", cituar, f. 173.

[33] Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr. 11 dt. 09.3.2021.

[34] Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, No. 11/2021, parag.69.

[35] Aktgjykim i Gjykatës Kushtetues të Kosovës nr. KO61/2021.

[36] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 15.4.2020 "*Për organizimin e strehimit të përkohshëm të personave të riatdhesuar si pasojë e situatës së shkaktuar nga Covid-19*".

[37] Urdhër nr. 219, datë 19.04.2021 i ministrit së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "*Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia*".

për shkak se urdhri nuk ishte më në fuqi dhe i kishte përfunduar efektet e tij.[38] Në fakt, kishte një interes publik të rëndësishëm të gjykohej një urdhër i tillë, gjë që lejohej proceduralisht edhe nga ligji organik i Gjykatës Kushtetuese, në rastet e heqjes dorë nga kërkesa.[39] Megjithatë, Gjykata gjeti se nuk ndodhemi përpara një interesi të tillë. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese nuk mbajti parasysh se për periudhat e emergjencës, interpretimet kushtetuese janë mjaft të dobishme. Këto interpretime mund të referohen dhe të ndikojnë në mbrojtjen e Shtetit të së Drejtës edhe pas zhdukjes së shkakut të jashtëzakonshëm, përpos faktit se mund të shërbejnë në raste të tjera emergjente që mund të vijnë në të ardhmen.

Nga studiuesit ka pasur këndvështrime të ndryshme ndaj masave kufizuese. Mjaft prej tyre kanë qenë kritike. P.sh., qysh në fillim, masa e mbylljes në Britaninë e Madhe u pa si problematike në lidhje me proporcionalitetin:

> "*Problemi i dukshëm këtu është se përcaktimi sipas të cilit do të shpëtohen më shumë jetë nga mbyllja, është shumë spekulativ....Nuk ka asnjë tregues që qeveria të ketë thirrur ndonjë hulumtim apo të ketë kryer ndonjë vlerësim të rrezikut, duke krahasuar numrin e jetëve që do të humbiste*."[40]

Ka autorë që shqetësohen për shkak të abuzimeve të mundshme me pushtetin gjatë masave të jashtëzakonshme. Kështu, autori Max Steuer shpreh shqetësimin se:
"*Sllovakia ndërmori masa më shtrënguese në raport me vende të tjera demokratike.... …disa vende janë duke shkuar drejt masave të një regjimi autoritar*".[41]

Ky rrezik qëndron veçanërisht për shtetet gjysmë autokratike, sikurse janë vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky mendim është shprehur pikërisht edhe për Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Disa autorë mendojnë se në Shqipëri pati edhe masa të papajtueshme me Kushtetutën:

> "*... një nga shqetësimet kryesore lidhur me shtetin e së drejtës dhe demokracinë në Shqipëri është se, qeveria miratoi masa ligjore që nuk ishin në përputhje me kuadrin kushtetues*."[42]

Në një vështrim të krahasuar me Kosovën, paraqet interes të veçantë interpretimi që Gjykata Kushtetuese e Kosovës i ka bërë kuptimit të karantinës. Ajo ka marrë në shqyrtim Vendimin [nr. 214/IV/2020], datë 12 prill 2020, të Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës, për shpalljen e komunës së Prizrenit "zonë karantinë" dhe ka konstatuar se ky vendim nuk është në përputhshmëri me parimin e proporcionalitetit. Gjykata thekson se Ministria e Shëndetësisë ka tejkaluar kompetencat e përcaktuara përmes Ligjit "*Për luftimin dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse*",[43] pasi "ndërhyrjet" në të drejtën e lirisë së lëvizjes, përmes karantinimit të të gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit, nuk janë "të përcaktuara në ligj". Gjithashtu, ajo qartësoi se "karantina" mund të urdhërohet nga Ministria e Shëndetësisë, pas rekomandimit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, vetëm për persona fizikë për të cilët vërtetohet ose dyshohet se kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me personat e sëmurë me sëmundje ngjitëse ose të dyshuar si të tillë. Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka quajtur joproporcionale masën e karantinës mbi të gjithë qytetin vetëm për faktin se banorë të tij janë identifikuar të infektuar. Sa më sipër, vendimi për shpalljen e komunës së Prizrenit "zonë karantinë", u shpall jokushtetues. Sipas kësaj gjykate, justifikohen masa më strikte vetëm ndaj individëve që janë në kontakt me virusin. Në këtë rast do të vlente kontakti në një vend më i ngushtë, si shtëpia apo vendi i punës (Aktgjykimi nr. 61_2020).

---

[38] Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr. 38, viti 2022, parag. 28.
[39] Ligj nr. 8577, dt. 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar, neni 31/b.2
[40]See: Yossi, Nehushtan. "The British Lockdown is Disproportionate" IACL-IADC Blog (9 April 2020) https://blog-iacl-aidc.org/2020-posts/2020/4/9/the-british-lockdown-is-disproportionate
[41]Max, Steuer. "Slovak Constitutionalism and the COVID-19 Pandemic: The Implications of State Panic" IACL-AIDC Blog (9 April 2020) https://blog-iacl-aidc.org/2020-posts/2020/4/9/slovak-constitutionalism-and-the-covid-19-pandemic-the-implications-of-state-panic
[42]Hoxhaj, Andi, Zhilla, Fabian. (2021). *The Impact of covid-19 Measures on the Rule of Law in the Western Balkans and the Increase of Authoritarianism.* European Journal of Comparative Law, and Governance 8 (2021) 271-303, f. 286.
[43] Ligj nr. 02/L-109 "Për luftimin dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse".

Duket se pyetjes doktrinore, nëse gjatë periudhave emergjente do të përdorim një interpretim të gjerë apo të ngushtë në testin e proporcionalitetit, të dyja gjykatat kushtetuese janë përgjigjur për një interpretim strikt. Veçanërisht, Gjykata Kushtetuese e Kosovës thekson:

"*Përfundimisht, emergjenca nuk mund të shërbejë si shkak për një prerje më të gjerë të masave në kuadrin e proporcionalitetit si të tillë.*"[44]

3.3 Parimi i rimëkëmbjes dhe masat pozitive

Aktet që miratohen në situatat e emergjencave i nënshtrohen parimit të ripërtëritjes, rimëkëmbjes ose riaftësimit, i cili ka kërkesë kryesore rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për funksionimin normal të shtetit. Ky parim përfaqëson një nga qëllimet kryesore të veprimtarisë shtetërore përgjatë emergjencës. Përmbushja e tij kërkon që institucionet të marrin masa të veçanta pozitive dhe të menjëhershme. Në rastet e emergjencës masat pozitive janë të domosdoshme jo vetëm për përmbushjen me efektivitet të të drejtave kushtetuese sociale dhe ekonomike, por edhe për respektimin e të drejtave dhe lirive vetjake, pavarësisht se këto të fundit karakterizohen si të drejta negative.[45] Të tilla janë veçanërisht, masat e ndihmës financiare, ushqimore, shëndetësore, të sigurimeve, etj.

Në Shqipëri u miratuan akte për ndihmën financiare për të riparuar pasojat e tërmetit 2019, si dhe pwr kompensimin e humbjeve gjatë pandemisë.[46] Edhe Gjykata Kushtetuese e ka evidentuar nevojën për marrjen e masave nga ana e institucioneve shtetërore përgjatë këtyre periudhave. P.sh., gjatë periudhës së pandemisë, Gjykata ka evidentuar "nevojën urgjente shoqërore":

"*Prandaj dhe masat e marra, ..., janë të lidhura me këtë objektiv, në kuadër të detyrimeve dhe përgjegjësive që kanë autoritetet shtetërore për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse*".[47]

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka përcaktuar raportin midis masave pozitive dhe atyre kufizuese, kur thekson se në këto raste gjatë:

"*…gjendjeve emergjente të drejtat e qytetarëve të përcaktuara me ligje, do të garantohen deri në masën që nuk e rrezikon efikasitetin e masave të ndërmarra për tejkalimin e tyre*."[48]

Në rastin e mësipërm, Presidenti i Republikës së Kosovës paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për të verifikuar masat shtrënguese të Qeverisë, të cilat u ndërmorën pa u shpallur më parë gjendja e jashtëzakonshme, sipas Kushtetutës. Ndërsa Qeveria këmbëngulte se këtë e lejonte legjislacioni i posaçëm kundër sëmundjeve infektive, Presidenti i Republikës i konsideronte disa prej masave jokushtetuese, pasi duhet të ndërmerreshin vetëm pasi të ishte shpallur gjendja e jashtëzakonshme. Gjykata Kushtetuese e Kosovës shqyrtoi këtë çështje duke bërë një analizë të bazuar në testin e proporcionalitetit të të drejtave të kufizuara. Në përfundim të gjykimit ajo konkludoi se:

[44] Anastasi, Aurela. *Rishikimi kushtetues i kufizimeve të lirisë përgjatë pandemisë së Covid-19 dhe roli i institucioneve kërkimore. Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë.* ASHSH, Tiranë, 2023, f. 445-454.
[45] Mbrojtja e të drejtave të Njeriut në kohë emergjencash, cituar f. 227.
[46] Shih p.sh: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 856, datë 04.11.2020, "Për ndihmën financiare të disa prej kategorive kryesore të ndërmarrjeve, të cilat zbatojnë protokollet e sigurisë, në kuadër të parandalimit e të kontrollit të pandemisë COVID-19.
[47] Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr.11, Viti 2021, parag. 61.
[48] Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nr. 54-20, parag. 284.

"*Qeveria ka vepruar përtej autorizimit të dhënë me pikat b) të nenit 41 të Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke ndaluar qarkullimin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës në të gjithë territorin e saj*"[49].

Me këtë arsyetim, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, ka vendosur një standard që mund të shërbejë edhe për të ardhmen. Ky standard është në përputhje më standardet ndërkombëtare, sipas të cilit gjendja e jashtëzakonshme shpallet kur pasojat e rrezikut/krizës përfshijnë të gjithë kombin dhe rrezikojnë jetën në komunitet. Në këtë mënyrë, gjykata kushtetuese e Kosovës ka konsideruar se masat parandaluese dhe kufizuese të parashikuara nga ligjet e zakonshme, nuk mund të kenë karakter të përgjithshëm në të gjithë territorin e Republikës, pa u shpallur më parë gjendja e jashtëzakonshme sipas Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata ka evidentuar lidhjet midis parimit të rimëkëmbjes me parimin e proporcionalitetit, duke i vendosur në një balancë të drejtë masat e ndërmarra për rimëkëmbjen dhe kufizimet e të drejtave të Njeriut.

Parimi i rimëkëmbjes është një nga parimet bazë edhe për përcaktimin e mënyrës dhe masës së kompensimit të dëmeve përgjatë gjendjes së emergjencave. Në lidhje me këtë Kushtetuta e Shqipërisë ka sanksionuar rezervën ligjore:

"....*ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve..."* (art. 170/3).

Ligji shqiptar "Për mbrojtjen civile" e ka ritheksuar këtë të drejtë. Ai përcakton mënyrën e kompensimit të dëmeve, kur thekson se ky kompensim kryhet rast pas rasti, me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave (neni 41/5). Nga ana e tij, Këshilli i Ministrave përcakton me vendim masën e kompensimit të dëmeve, procedurat, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen (neni 41/6). Ka pasur edhe sugjerime që të ketë një vendim kuadër të Këshillit të Ministrave për të përcaktuar paraprakisht, për sa është e mundur, disa kritere dhe procedura.[50] Por, në mungesë, do të zbatohen parimet e përgjithshme kushtetuese sidomos, barazia dhe proporcionaliteti. Kompensimi është një rregull universal, i cili është analizuar nga mjaft autorë, sidomos në periudhën e masave kundër Covid 19[51]. Qytetari ka akses në gjykatë për të kërkuar masën e kompensimit. Ai mund të kërkojë shpërblimin e dëmit bazuar në legjislacionin përkatës, edhe pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme. Një përvojë domethënëse në këtë drejtim lidhet me ndihmën për ripërtëritjen nga pasojat e tërmetit, nëntor 2019.[52]

3.4 Përkohshmëria dhe periodiciteti i masave të jashtëzakonshme

Për periudhat e emergjencave, përkohshmëria dhe periodiciteti i masave ngrihet në nivelin e një parimi kushtetues. Mund të trajtohej si një kusht apo kriter, por nuk do të ishte e mjaftueshme. Rëndësia që ka përkohshmëria e masave të jashtëzakonshme në dispozitat e Kushtetutës, i jep atij karakterin e një parimi. I njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga studiuesit e Kushtetutës së Kosovës, në respekt të kësaj të fundit.[53] Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon se:

"*Masat e jashtëzakonshme... zgjatin për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje*" (neni170/1).

Njëkohësisht, Kushtetuta kujdeset për të vendosur afate fikse dhe një kontroll parlamentar mbi kohëzgjatjen

---

[49] Shih: Prishtinë, më 6 prill 2020 Nr. ref.: AGJ 1543/20; AKTGJYKIM në rastin nr. KO54/20 parashtrues Presidenti i Republikës së Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020; i gjindshëm në: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/04/ko_54_20_agj_shq.pdf

[50] Anastasi, Aurela (2023). *Rule of Law in Times of Emergency*. In: Cremades, J., Hermida, C. (eds.) Encyclopedia of Contemporary Constitutionalism. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-319-31739-7_223-1

[51] Pierre De Vos, *"Why the Management of the Covid-19 Lockdown Threatens Respect for the Rule of Law''* IACL-AIDC Blog (23 April 2020) https://blog-iacl-aidc.org/2020-posts/2020/4/23/why-the-management-of-the-covid-19-lockdown-threatens-respect-for-the-rule-of-law.

[52] Hazbiu, Aulona (2022). Legislative: *Law and Institutions*. In: Cremades, J., Hermida, C. (eds.) Encyclopedia of Contemporary Constitutionalism. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-319-31739-7_24-1

[53] Selimi, Rexhaj. cituar.

e masave të jashtëzakonshme. Ajo ka saktësuar afatin e gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të rrezikut ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike, duke vendosur:

"…*Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, mund të vendosë në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit gjendjen e jashtëzakonshme, e cila zgjat për aq kohë sa vazhdon rreziku, por jo më shumë se 60 ditë."* (neni173/1).

Gjithashtu, Kushtetuta ka vendosur mundësinë për zgjatjen e afatit, i cili:

"*...mund të bëhet vetëm me pëlqim të Kuvendit çdo 30 ditë, për një periudhë jo më shumë se 90 ditë*" (neni 173/3).

Në rastin e masave të jashtëzakonshme për shkak të fatkeqësisë natyrore kushtetutëbërësi ka ndjekur një qasje të ndryshme. Duke mos vendosur afate fikse për zgjatjen e saj, e ka lënë këtë në diskrecion të Qeverisë, përmes dhënies së pëlqimit nga Kuvendi. Kjo është e arsyeshme, pasi për këtë situatë faktorët objektivë që ndikojnë mund të jenë të paparashikueshëm. Prandaj, rishikimi periodik dhe kontrolli parlamentar periodik janë shumë të rëndësishëm. Zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të bëhet vetëm me pëlqimin e Kuvendit (neni 174/2), por nuk ka ndonjë afat se sa mund të shtyhet kjo gjendje. Prandaj, çështja e zgjatjes së afateve ka ngjallur debate jo vetëm në nivel politik, por edhe juridik. Debate të tilla janë zhvilluar midis forcave politike, si në rastin e fatkeqësisë së ardhur prej tërmetit (2019), ashtu edhe në rastin e fatkeqësisë Covid 19. Në prill të vitit 2020, pas përfundimit të afatit prej 30 ditësh për shkak të pandemisë, propozimi i Këshillit të Ministrave në Kuvend për të zgjatur situatën e emergjencës edhe 60 ditë të tjera, u konsiderua nga opozita si antikushtetues. Përfaqësuesi i opozitës në Kuvend, theksoi se:

"*Afati fillestar që parashikon Kushtetuta është 30 ditë dhe shtesa nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar…."*[54]

Sidoqoftë nuk pati një rishikim kushtetues për këtë çështje. Megjithatë, periodiciteti i masave të jashtëzakonshme dhe rishikimi i tyre në periudha që përcaktohen qartë me ditë kalendarike, është theksuar nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. Në vendimin e saj në lidhje me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë për ndalimin e grumbullimeve me më shumë se 10 persona, Gjykata arsyeton se:

"*.... raportimi periodik përpara legjislativit i autoriteteve publike që marrin këto masa kufizuese është një praktikë tjetër e mirë, që i shërben shtetit të së drejtës, në të cilin pushteti legjislativ, ndër të tjera, kontrollon dhe garanton përgjegjshmërinë e organeve të ekzekutivit*".[55]

Në përfundim të gjykimit Ajo konstatoi:

"…*termi "deri në një urdhër të dytë" krijon problematikë në dy drejtime: së pari, nuk detyron autoritetet përgjegjëse të bëjnë vlerësim periodik për masat kufizuese të përcaktuara me urdhrin në fjalë dhe, së dyti, nuk i përgjigjet standardit të proporcionalitetit."*[56]

Për këtë arsye, gjykata vendosi shfuqizimin si antikushtetues të shprehjes "deri në një urdhër të dytë" dhe detyrimin e organit kompetent të rishikojë kohëzgjatjen e kufizimeve brenda një jave nga shpallja e këtij vendimi (parag. 69). Në këtë rast, gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka arsyetuar përmes parimit të proporcionalitetit. Por, edhe nëse do të arsyetonte përmes parimit të periodicitetit, ajo do të kishte arritur në të njëjtin përfundim. Madje, arsyetimi i lidhur me periodicitetin është më i drejtpërdrejtë, kurse përmes proporcionalitetit duket një arsyetim më i tërthortë. Madje do të ishte mirë argumentimi i pakushtetutshmërisë së masës përmes të dyja parimeve: proporcionalitetit dhe periodicitetit.

[54] Bylykbashi O, ATA, dt. 21.4.2020.
[55] Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë Nr. 11, viti 2021, parag 49.
[56] Po aty.

4. Konkluzione

Për sa më sipër mund të arrijmë në disa përfundime e sugjerime:

- Studimi dëshmoi se Kushtetuta e Shqipërisë është shtëpia e parimeve themelore përgjatë masave të jashtëzakonshme. Në këtë kuadër, konstitucionalizimi/kushtetutëzimi i masave të jashtëzakonshme përbën një garanci të fortë për mbrojtjen e parimit të Shtetit të së Drejtës gjatë këtyre situatave. Garancitë kushtetuese realizohen përmes zbatimit të kërkesave që burojnë nga parimet, sipas të cilave masat e jashtëzakonshme ndërmerren në mënyrë strikt proporcionale në raport me situatën, mbi bazën e përkohshmërisë dhe periodicitetit të zbatimit të tyre, si dhe duke i mështuar rimëkëmbjes përmes masave pozitive. Sugjerohet që institucionet të parapërgatiten mbi kërkesat që burojnë nga këto parime kushtetuese, me qëllim marrjen e masave për zbatimin e tyre përgjatë situatave të jashtëzakonshme.
- Vendosja në Kushtetutë e procedurave themelore për shpalljen e masave të jashtëzakonshme përbën një garanci të rëndësishme për mbrojtjen e Shtetit të së Drejtës. Ajo siguron një zbatim të drejtpërdrejtë të saj, një kontroll parlamentar dhe një kontroll gjyqësor aktiv. Nga ana tjetër, Kushtetuta është strumbullari ku bazohet legjislacioni i posaçëm për rastet e jashtëzakonshme dhe të emergjencave. Standardet kërkojnë që ky legjislacion të jetë hartuar më parë, sesa emergjenca të ketë ardhur. Përgatitjet për përballimin e situatave të tilla duhet të jenë të vazhdueshme, duke koordinuar vazhdimisht punën parapërgatitore.
- Kur shpallen masat e jashtëzakonshme, çështja e respektimit të Shtetit të së drejtës mbetet sfida kryesore. Kjo sfidë shtrihet në dy plane: në mënjanimin e masave me përmbajtje autoritariste dhe mënjanimin e abuzimeve me masat e marra. Megjithatë, shpallja e masave të jashtëzakonshme në bazë të Kushtetutës nuk është një qëllim në vetvete, por një garanci e zbatimit të të gjithë rregullimeve shumëplanëshe. Kjo bëhet më e dukshme në republika të reja parlamentare si Shqipëria, ku zakonisht, ka shumë pak dallime midis pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv. Prandaj, është e nevojshme që institucionet kushtetuese të dallojnë qartë periudhat e jashtëzakonshme nga periudhat e emergjencës kur ndërmerren masa administrative emergjente. Punimi sugjeron që të mbahet në vëmendje vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për këtë çështje, i cili është analizuar në punim.
- Gjykimi kushtetues në këto situata ka një rol kyç. Punimi dëshmon interesin publik që kontrolli kushtetues të ushtrohet edhe pasi situata emergjente të ketë përfunduar. Nëse gjykatat kushtetuese do t'i pushojnë vazhdimisht këto gjykime për shkak se situata e emergjencës është shuar, do të na pakësoheshin burimet kushtetuese që japin zgjidhje për të ardhmen. Prandaj një nga sugjerimet kryesore i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, e cila duhet të vlerësojë interesin publik në legjitimimin e çështjes që shtrohet për shqyrtim.
- Studimi provoi se, ka një konfuzion të ligjeve përgjatë masave të jashtëzakonshme. Rregullimet ligjore përgjatë këtyre masave janë të shpërndara në ligje të ndryshme. Ka nevojë të qartësohet veprimtaria e institucioneve, situatat kur ato duhet të veprojnë në kuadrin e regjimit kushtetues, apo atij ligjor. Është detyrë të hartohet Ligji organik për gjendjen e jashtëzakonshme, sikurse parashikon neni 81.2/dh e Kushtetutës. Ligji "Për mbrojtjen civile", duhet të ndajë më qartë veprimin në kuadrin e masave të jashtëzakonshme si regjim kushtetues, nga veprimi në kuadrin e masave të emergjencës si regjim juridik administrativ. Një inkorporim në një trup të vetëm i të gjitha dispozitave ligjore që rregullojnë këto situata, është i mirëpritur sa më parë.
- Në këtë kuadër, ndërgjegjja juridike e qytetarëve mbetet gjithashtu shumë e rëndësishme për t'i bërë ata subjekte aktive. Kjo kërkon edukim e ndihmë ligjore të posaçme jo vetëm gjatë këtyre periudhave, por gjatë gjithë kohës, me qëllim përgatitjen për përballimin e situatave të tilla.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Anastasi, Aurela (2023). *Rule of Law in Times of Emergency*. In: Cremades, J., Hermida, C. (eds) Encyclopedia of Contemporary Constitutionalism. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-319-31739-7_223-1.
2. Anastasi, Aurela. *"Shteti i së drejtës përgjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore"*, "Avokatia" review, Nr.35, Year 2020.
3. Anastasi, Aurela, Gjini, Andri. *Les enjeux de l'état de droit pendant la pandémie covid-19 : le cas de l'Albanie*, Conference: Journées juridiques francophones 2021 - Conférence "Les réincarnation de l'État de droit en Europe", Sofia 2021, available at: Anastasi Aurela, Reforming the Justice System in the Western Balkans. Constitutional Concerns and Guarantees (June 19, 2018). Available at SSRN: https://ssrn.com/abstract=3198787 or http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.3198787.
4. Bajrami, Arsim. *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*, "Artini'', Prishtina, 2012.
5. CDL-PI (2020)003; C*ompilation of Venice commission opinions and reports on states of emergency*; Strasbourg, 16 Prill 2020, available at: CDL-PI (2020)003 (coe.int).
6. Cukani, Entela. Albania e Covid-19: *dallo stato di calamità naturale alla calamità dello Stato di diritto*? Saggi -DPCE online, 2020/2, available at: Albania_e_Covid_19_dallo_stato_di_calami (2).pdf.
7. Hasani, Enver, Cukalovic, Ivan.Komentar. Kushtetuta e Republikws së Kosovës, Prishtina, 2013, available at: Komentar Kushtetuta e Republikës së Kosovës - E-Library of the Kosovo Judicial Institute (rks-gov.net).
8. Hazbiu, Aulona (2022). Legislative: *Law and Institutions*. In: Cremades, J., Hermida, C. (eds) Encyclopedia of Contemporary Constitutionalism. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-319-31739-7_24-1.
9. Hoxhaj, Andi. *Albania's response to the coronavirus pandemic*, University of Warwick, e gjindshme në: https:/www.cambridge.org/core/blog/2020/05/19/albanias-response-to-the-coronavirus-pandemic/.
10. Hoxhaj, Andi, Zhilla Fabian. *The Impact of covid-19 Measures on the Rule of Law in the Western Balkans and the Increase of Authoritarianism*, European Journal of Comparative Law and Governance 8 (2021) f.271-303.
11. Jackson, Vicky C. *Proportionality and equality* at "Proportionality. New Frontiers, new challenges", Edited by Vicky C. Jackson and Mark Tushnet, Cambridge University Press, 2017.
12. Michelman, Frank I., Proportionality outside the courts with special reference to popular and political constitutionalism, at: *Proportionality. New Frontiers, new challenges,* Edited by Vicky C. Jackson and Mark, Tushnet. Cambridge University Press, 2017.

Legjislacion

1. Kushtetuta e Republikës së Bullgarisë, 1991.
2. Kushtetuta e Republikës së Greqisë, 1975.
3. Kushtetuta e Republikës së Italisë, 1948.
4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.
5. Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi, 2007.
6. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 1991.
7. Kushtetuta e Republikës së Polonisë, 1997.
8. Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 2006.
9. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998.
10. Ligj nr. 10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin Publik"
11. Ligj nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive".
12. Ligj nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile".

13. Urdhër nr.219, datë 19.04.2021 "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" të ministrit së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
14. Urdhër nr.53, datë 31.01.2020 i ministrit të Shëndetësisë "Për krijimin e Komitetit të Përkohshëm Teknik për Infeksionin e Përhapur nga Covid-19".
15. Vendim nr. 10, datë 15.4.2020 "Për organizimin e strehimit të përkohshëm të personave të riatdhesuar si pasojë e situatës së shkaktuar nga Covid-19", Botuar në Fletoren zyrtare, nr. 68, datë 18.04.2020.

Jurisprudencë

1. Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nr. KO54/2020.
2. Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nr. KO61/2020.
3. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr.4/1997.
4. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Spanjës, datë 14 korrik 2021.
5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr. 11/2021.
6. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr. 38/2022.
7. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr. 39/2022.

Web faqe

1. Max Steuer, 'Slovak Constitutionalism and the COVID-19 Pandemic: The Implications of State Panic' IACL-AIDC Blog (9 April 2020) https://blog-iacl-aidc.org/2020-posts/2020/4/9/slovak-constitutionalism-and-the-covid-19-pandemic-the-implications-of-state-panic.
2. Pedro A. Villarreal, Covid-19 and Police Powers Beyond the State, 30 Septembre 2021, available at: COVID-19 and Police Powers Beyond the State — IACL-IADC Blog (blog-iacl-aidc.org).
3. Pierre De Vos, "Why the Management of the Covid-19 Lockdown Threatens Respect for the Rule of Law'' IACL-AIDC Blog (23 April 2020) https://blog-iacl-aidc.org/2020-posts/2020/4/23/why-the-management-of-the-covid-19-lockdown-threatens-respect-for-the-rule-of-law.
4. Selimi Behar, Rexhaj Albatros, *Trajtimi kushtetues i të drejtave dhe lirive themelore gjatë menaxhimit të pandemisë së covid-19 në Kosovë*, Centrum 15, 2021, available at: TRAJTIMIKUSHTETUESITDREJTAVEDHELIRIVE (1).pdf.
5. Steuer, M. (2023). Rule of Law – The Concept. In: Cremades, J., Hermida, C. (eds) Encyclopedia of Contemporary Constitutionalism. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-319-31739-7_51-1
6. The Protection of Human Rights during Times of Emergency. An analysis of the relevant jurisprudence of the European Court of Human Rights through the lens of the Covid-19 pandemic, AIRE Center, 2022.
7. Tímea Drinóczi, "Central and Eastern European constitutional formulas: the abuse and observance of constitutions in times of emergency THE 10TH IACL-AIDC World Congress 2018 Workshop Abuse of the Constitution in Times of Emergency, available at: (99+) Central and Eastern European constitutional formulas: the abuse and observance of constitutions in times of emergency | Timea Drinoczi - Academia.edu
8. Venice Commission, Rule of Law check List, CDL-AD (2016)00711-12 mars 2016, available at: default.aspx (coe.int).
9. Vorpsi, A. (2022). The Role of Constitutional Justice in Preserving the Rule of Law in Albania. In: Cremades, J., Hermida, C. (eds.) Encyclopedia of Contemporary Constitutionalism. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-319-31739-7_18-1 Yossi Nehushtan, 'The British Lockdown is Disproportionate' IACL-IADC Blog (9 April 2020): https://blog-iacl-aidc.org/2020-posts/2020/4/9/the-british-lockdown-is-disproportionate.
10. Vjetari statistikor 2020: https://www.drejtesia.gov.al/statistika/.

VLERËSIMI I ROLIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË RRITJEN E TRANSPARENCËS DHE BESIMIT TË PUBLIKUT NË SISTEMIN E DREJTËSISË*

Prof. Dr. Artan HOXHA**
Dr. Valbona NDREPEPAJ***
Dr. Dorina SAJA****

EVALUATION OF THE ROLE OF THE OFFICE OF HIGH INSPECTORATE OF JUSTICE IN ENCREASING TRANSPARENCY AND PUBLIC TRUST IN JUSTICE SYSTEM

Abstract

In Albania, for years, there has been a public perception that the judicial system is affected by corruption. This negative perception, resulting from the lack of transparent practices, the prolongation of judicial processes, or the lack of trust in the judiciary, prompted the beginning of the reform of the judiciary in the country, which culminated in the creation of new bodies of governance of the judiciary. Among them, the Office of the High Inspector of Justice (ILD) was created, which, according to the organic law, aims to increase transparency and efficiency in the judicial system. It also affects the increase of the public's trust and access to the judiciary. Even though more than two years have passed since the constitution of this office, there is still discussion about the low level of transparency in the judicial system and the public's low trust in the reform of the judiciary. After all, it is perceived that there are still corrupt judges or prosecutors in the system.

There is a lack of monitoring, studies, or continuous scientific research for the new judiciary bodies. It means that we cannot say whether the ILD, as a new constitutional body has played its role - increasing transparency and public trust in Justice.

At the same time, the lack of objective, reliable data has highlighted the need to evaluate, mainly, the work of the Office of the High Inspector of Justice. This evaluation process aims to provide the public with objective information on the work of ILD but also to identify why ILD, two years after its creation, has a moderate role in increasing transparency and public confidence in the justice system.

Keywords: *ILD, assessment, role, transparency, trust, public.*

1. Hyrje

Në Shqipëri, në vite, ka pasur një perceptim të publikut se, sistemi gjyqësor është i prekur nga fenomeni i korrupsionit. Ky perceptim negativ, i ardhur nga mungesa e praktikave transparente, tejzgjatja e proceseve gjyqësore, apo mungesa e besimit te gjyqësori, nxiti fillimin e reformës më të madhe të drejtësisë në vend, e cila

* Ky artikull, është produkt i nxjerrë nga Projekti me të njëjtin titull, i cili është kryer me financimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

** Prof. Dr. Artan Hoxha, Rektor i Universitetit të Tiranës/ Profesor i së Drejtës së Procedurës Penale në Fakultetin e Drejtësisë UT.

*** Dr. Valbona Ndrepepaj, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme në Universitetin e Tiranës/Lektor i lëndës Kriminilogji-Penologji në Fakultetin e Drejtësisë UT (Njëkohësisht drejtues i këtij projekti të financuar nga AKKSHI).

**** Dr. Dorina Saja, Lektor i së Drejtës së Procedurës Penale në Fakultetin e Drejtësisë UT.

kulmoi me krijimin e organeve të reja të qeverisjes së drejtësisë. Ndër to, u krijua edhe Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), etj, që është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore dhe fillimit të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Më konkretisht, ky institucion, sipas ligjit organik, ka si qëllim rritjen e transparences dhe eficencës në sistemin gjyqësor. Por, edhe pse kanë kaluar më shumë se dy vjet nga konstituimi i kësaj zyre, ende diskutohet mbi nivelin e ulët të transparencës në sistemin gjyqësor dhe besimin e pakët të publikut në reformën në drejtësi. Pasi perceptohet se, në sistem ka përsëri gjyqtarë apo prokurorë të korruptuar. Në të njëjtën kohë, prej disa aktorëve të tjerë, deklarohet se është rikthyer besimi i publikut në drejtësi, pasi sistemi është pastruar nga këta gjyqtarë apo prokurorë të korruptuar.

Në të vërtetë, mungon kryerja e monitorimeve, kërkimeve shkencore apo e vlerësimeve të vazhdueshme për organet e reja të drejtësisë. Kjo do të thotë se, pa studime apo monitorime të tilla, nuk mund të themi me siguri nëse ILD, si një organ i ri kushtetues dhe i rëndësishëm për mirëqeverisjen e sistemit të drejtësisë, e ka luajtur rolin e tij, - rritjen e transparences dhe besimit të publikut në drejtësi. Njëkohësisht, mungesa e të dhënave objektive, të besueshme dhe të paanshme, ka evidentuar nevojën për të vlerësuar, kryesisht, punën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ndaj ky artikull, ka si qëllim të ofrojë një informacion të vërtetë mbi punën e kësaj zyre, si edhe të identifikojë shkaqet se *përse* ILD, dy vite pas krijimit, ka një rol të moderuar në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Për kryerjen e këtij artikulli, është përdorur një metodë e përzier tre fazëshe. *Së pari*, është evidentuar dhe analizuar kuadri i plotë ligjor mbi organizimin dhe funksionimin e ILD-së. *Së dyti*, është monitoruar periodikisht online faqja e web-it të ILD-së, si dhe është shqyrtuar vendimmarrja e ILD-së, mbi ankesat e paraqitura. *Së treti*, është vlerësuar aktiviteti i ILD-së, - konkretisht shqyrtimi dhe vendimmarja mbi ankesat e paraqitura, më qëllimin përfundimtar evidentimin e ndikimi të ILD-së në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

2. Roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në sistemin e organeve të qeverisjes së drejtësisë: Kuadri Ligjor

ILD, i krijuar, në vitin 2016, në kuadër të reformës në drejtësi, është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe zyrave të Prokurorisë[1].

Më konkretisht, sipas nenit 147/d dhe në vijim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 198 dhe në vijim, të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", si edhe kuadrit tjeter ligjor sektorial, ILD ka tre lloj funksionesh (rolesh):

- kontrolluese … *është përgjegjës për verifikimin*…;
- hetimore … *hetimin e shkeljeve disiplinore* …;
- inspektuese …. *inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë* ...

Për të kuptuar rolin e vërtetë të ILD-së, në sistemin e organeve të qeverisjes së drejtësisë, *së pari*, duhet analizuar më kujdes procedura e përcaktuar në ligj mbi mënyrën e ushtrimit të funksioneve të tij, psh., shqyrtimi i ankesave prej ILD-së, si: afatet e parashkrimit, afatet e procedimit, subjektet e ankimit, kriteret për pranueshmërinë e kërkesës, shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës[2]. *Së dyti*, duhet analizuar, marrëdhënieja e ILD-së me institucionet e tjera të rëndësishme të sistemit të qeverisjes së gjyqësorit[3].

[1] Neni 147/d, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
[2] I referohemi ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
[3] I referohemi ligjit nr. 115/2016 'Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Sipas ligjit nr. 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, ILD vendos të arkivojë ankesën ose të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar, *brenda tre muajve nga marrja e ankesës.* Ndërsa, brenda *gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit,* fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Këshillit kompetent raportin e hetimit ose merr vendimin për mbylljen e hetimit. Në raste të caktuara, ILD mund të zgjasë afatin e hetimit, edhe për tre muaj të tjerë në raste komplekse, për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, ose në rast sëmundjeje apo pamundësisë së magjistratit.[4]

Ligji, *prima facie*, parashikon afate të gjata në dispozicion të ILD-së, si për marrjen e vendimit për fillimin e hetimit ose jo, ashtu edhe për fillimin e hetimit disiplinor dhe përcjelljen e tij te këshillat përkatës. Në të vërtetë, dispozita e cituar më lart, kryesisht pika 2 e saj, është e paqartë nëse, ILD e kryen hetimin brenda 6 muajve, apo pret të kalojnë 6 muaj dhe më pas e fillon hetimin, të cilin mund ta shtyjë, në raste të veçanta, dhe për tre muaj të tjerë. Konkretisht, duke bërë një interpretim literal të saj, shikojmë disa problematika, që e vështirësojnë veprimtarinë e ILD-së në drejtim të eficiences, efikasitetit dhe produktivitetit të punës, si afatet e gjata; një kolizion dhe paqartësi në normë, - pika 2 me pikën 3 dhe së treti, cili është afati brenda së cilit duhet të mbarojë hetimi. Por, me anë të një interpretimi sistematik të normës, shikojmë se në fakt, kjo nuk është e vërtetë, pasi gjatë kësaj kohë ILD, kryen një sërë veprimesh, si pranon ankesën, e verifikon atë formalisht dhe më pas në përmbajtje, si edhe shprehet me një sërë vendimesh *infra*, duke e treguar seriozitetin e këtij institucioni dhe rëndsinë që ai ka.

Në nenin 118, të ligjit, parashikohet se, ILD duhet t'i konfirmojë ankuesit administrimin e ankesës brënda pesë ditëve nga marrja e saj. Po ashtu, brënda këtij afati, duhet t'i njoftojë ankuesit vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin e hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë vendimet për arkivimin dhe mbylljen e hetimit. Këto detyrime të ILD-së, apo në anën tjetër të drejta të subjektit ankues, pavarësisht llojit të tij, - *çdo person fizik ose juridik, apo Ministri i Drejtësisë; një anëtar i vetëm i Këshillit; kryetari i gjykatës ose i prokurorisë*, janë elementë të një procesi të rregullt ligjor, që ndikojnë pozitivisht në transperencen, përgjegjësinë dhe llogaridhënien e punës së ILD-së, pasi e bëjnë atë një institucion të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, për pasojë të besueshëm. Po ashtu, këtë të fundit e ndihmon edhe mënyra e paraqitjes së ankesës, - *personalisht, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks*, pasi tregon për proces të deburokratizuar. Po ashtu, tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës, nëse ILD vlerëson se pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij. Këto do të thonë se, ky institucion është i interesuar për mirëmbajtjen e trupës së gjyqtarëve, duke ruajtur edhe interesin individual të ankuesit, edhe interesin e personit ndaj të cilit është bërë ankimi, por edhe interesin publik.

Për këtë arsye, - mirëmbajtjen e trupës së gjyqtarëve dhe ruajtjen e interesit publik, ankesa pranohet vetëm nëse përmbush kriteret e mëposhtme:

a) paraqitet në formën e përcaktuar ;
b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;
c) nuk përmban elementë abuzivë, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues.
ç) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
d) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
dh) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.[5]

Më pas, ILD shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme dhe vendos:

a) të arkivojë ankesën, pasi nuk përmbush një ose më shumë kritere formale të parashikuara;
b) të verifikojë ankesën;

[4] Neni 117, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[5] Neni 120, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

c) të fillojë hetimin. [6]

Me anë të instrumentit të verifikimit, për ankesën që nuk ka informacion të qartë, ILD verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme, që justifikojnë fillimin e hetimit. Për këtë, mund t'i kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente apo informacion shtesë, të japë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar.

Vetëm, në rast se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet. Vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill, brënda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.[7]

ILD fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. Vendimi i arsyetuar për fillimin e hetimit i njoftohet palëve në proces dhe përmban:

a) emrin e inspektorëve të ngarkuar me hetimin;
b) objektin e hetimit, duke treguar shkeljen e dyshuar;
c) parashtrimin e rrethanave të faktit të pretenduara;
ç) provat e mbledhura;
d) periudhën kohore përkatëse për hetimin;
dh) parashtrimin e të drejtave të magjistratit në lidhje me hetimin disiplinor, si dhe të drejtën e magjistratit dhe të ankuesit për të dorëzuar parashtresë dhe dokumente mbështetëse, brenda tre javëve nga marrja e vendimit.[8]

Por, ILD mund të fillojë hetimin edhe me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. [9]

Në të gjitha rastet, për një proces të rregullt dhe proporcional hetimi, ligji i ka lënë ILD-së një sërë instrumentash në dispozicion, si: verifikimi i pasurisë dhe figurës së magjistratit[10] (brenda një jave nga vendimi për fillimin e hetimeve); pezullimi i hetimit; pezullimi i magjistratit; thirrja e dëshmitarëve dhe mbledhja të dhënave, dokumentevë[11]; drejtimi i pyetjeve[12]; njoftimi i palëve dhe dëgjimi i tyre[13]; dokumentimi i hetimit, - dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal dhe harton raportin e hetimit.[14]

Po ashtu, ligji në nenin 137 të tij parashikon se, ILD administron një sistem menaxhimi të çështjeve për procedurën hetimore. Sistemi duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm: a) gjeneralitetet dhe adresën e magjistratit nën hetim; b) emrin dhe adresën e ankuesit, nëse është e mundur; c) objektin e hetimit; ç) të dhënat përkatëse mbi zhvillimin e hetimit; d) informacion për arkivimin e ankesës, mbi mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor; dh) informacion për vendimin e formës së prerë për masën disiplinore; e) informacione të tjera, sipas rastit.

Gjithashtu, për një proces të rregullt dhe ekonomik hetimi, ligji i ka lënë ILD-së një sërë instrumentash në dispozicion, si: bashkimi i procedimeve disiplinore; shtyrja e seancës dëgjimore; ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor[15].

Bazuar në *procedurën për kryerjen e procedimit disiplinor të magjistratëve prej ILD-së*, rezulton se, është një proces që përmbush karakteristikat e procesit të rregullt ligjor, si: *zyrtar*, - ka rregulla, procedura dhe metoda

[6] Neni 121, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[7] Neni 122, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[8] Neni 123, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[9] Neni 124, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[10] Neni 125, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[11] Neni 130, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[12] Neni 130, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[13] Neni 138, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[14] Neni 133, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[15] Neni 126, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

të paracaktuara në ligj dhe çdo institucion shtetëror, person juridik privat ose individ duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë formale nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që i ka ndodhur një shkelje; *individual*, - kryhet për një magjistrat të caktuar; *i gjithanshëm*, - kryhet një hetim i plotë dhe merret në konsideratë çdo element i nevojshëm; *i hapur dhe transparent*, - palët informohen në proces që nga momenti i fillimit të hetimit, dhe ju garantohet aksesi në dosjen e hetimit në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit; *i moderuar eficient, efikas dhe produktiv*, - marrja e një vendimi deri diku brenda një afati të arsyeshëm; *i ligjshëm dhe i besueshëm*, - organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si edhe ngrihet mbi parimin e prezumimit të pafajësisë dhe mosdënimit pa ligj; *i barabartë*; parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor; *proporcional; i pavaruar*; *konfidencial*, - respektohet jeta private dhe mbrohen të dhënat personale; *i kujdesshëm dhe i balancuar*. Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, të drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ILD merr parasysh faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e magjistratit nga akuzat e pabaza dhe rëndësinë që ka informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.[16]

Krahas funksionit të hetimit, ILD ka edhe kompetenca për inspektim, të parashikuara në nenin 147/d, të Kushtetutës, në nenin 194 dhe 204 të Ligjit nr. 116/ 2016. Këto kompetenca kanë të bëjnë më përcaktimin e metodologjisë për inspektimin dhe planifikimin e kryerjes së tyre. Në raportet vjetore[17] të paraqitura para kuvendit prej ILD-së, vërehet se, është fokusuar në inspektimin tematik dhe ka kryer 3 (tre) inspektime të tilla, konkretisht: Inspektimi tematik i gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt "Lirimin me Kusht"; Inspektimi tematik mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" i ndryshuar dhe "Inspektimi tematik mbi respektimin e kushteve dhe kritereve për caktimin e masave të sigurimit personal" për veprën penale "Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyese dhe municionit". [18]

ILD gjatë inspektimeve synon të kontrollojë si është gjendja, apo si zbatohen rregullat në lidhje me etikën profesionale të magjistratëve; profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrës, veprimtarinë e kryetarëve të gjykatave dhe drejtuesve të zyrave të prokurorive; efektivitetin e zgjidhjes së çështjeve gjyqësore; efektivitetin e nisjes së hetimeve penale, veprimtarinë e administratës gjyqësore dhe zyrës së prokurorisë, etj.[19]

Kryerja e inspektimeve prej ILD-së, mbështetet në zbatimin e parimeve, si: parimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor; ligjshmërisë; barazisë para ligjit; prezumimit të pafajësisë dhe dyshimit në favor të magjistratit; proporcionalitetit; pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimit të pavarësisë së magjistratit; drejtësisë së hapur; konfidencialitetit, të drejtës së jetës private, mbrojtjes së të dhënave personale dhe informimit të publikut.

Edhe *procedura për kryerjen e inspektimeve të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë prej ILD-së*, është një proces që përmbush karakteristikat e procesit të rregullt ligjor, si: *zyrtar*, - ka rregulla, procedura dhe metoda të paracaktuara në ligj dhe manualin e miratuar, *i gjithanshëm*, - një hetim i plotë dhe merret në konsideratë çdo element i nevojshëm; *i hapur dhe transparent*, - palët informohen në proces që nga momenti i fillimit të inspektimit, *i pavaruar*; *i kujdesshëm dhe i balancuar*, etj.

Në anën tjetër, siç e kemi cekur, duhet analizuar edhe marrëdhënia e ILD-së me institucionet e tjera të rëndësishmë të qeverisjes së gjyqësorit, për të vërtetuar rolin e vërtetë të këtij institucioni në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Më konkretisht,

[16] Neni 100, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

[17] Përshembull, shiko faqen nr.29, të Raportit Vjetor, të vitit 2022.

[18]https://ild.al/sq/2021/05/21/inspektimet-tematike-prioriteti-i-ri-i-inspektorit-te-larte-te-drejtesise/.(shkarkuar maj- qershor, 2023).

[19] Neni 101 – 104, ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

ILD - Këshilli i Lartë Gjyqësor / i Prokurorisë

Në sistemin e qeverisjes së drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, si dhe Shkolla e Magjistraturës janë një grup institucionesh që kryejnë detyra të ndryshme për të arritur një qëllim të përbashkët, - pavarësinë, llogaridhënien, transparencën dhe efiçencën e sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Këto institucione, ndryshojnë në rol dhe përgjegjësi.

Përshembull, Këshillat kanë të drejtë të pranojnë ose jo kërkesat e lëshuara nga ILD-ja për procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve[20]. Kur Këshillat çmojnë se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, kanë të drejtë:

a) të urdhërojnë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me ligjin, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit 1-mujor;

b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim. [21]

Pavarësisht sa më sipër, ILD ka një rol qendror dhe të rëndësishëm. Ndaj edhe kompetenca e mësipërme e Këshillave është një formulë kryesisht bashkëpunimi dhe më pas monitorimi. Kjo do të thotë se, marrëdhënia e tyre institucionale kryesisht konsiston në vendosjen e standardeve më të mira të procedimit disiplinor[22], për edukimin e magjistratëve për të qenë në lartësinë e detyrës që kryejnë. Po ashtu, mund të ndodhë, që gjatë këtij bashkëpunimi, të adresohen problematika me interes të përbashkët[23].

Në të vërtetë, roli qendror dhe i rëndësishëm i ILD-së ndërmjet organeve të tjera të sistemit të qeverisjes së gjyqësorit, tregohet edhe nga fakti se shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Prokurorisë hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*[24]. Ndërkohë që është Gjykata Kushtetuese ajo që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor[25].

ILD - Pushteti Gjyqesor

Në marrëdhënien ILD - pushtet gjyqësor, rolin e ILD-së, përveç sa më sipër, e shohim edhe përsa i përket ndarjes së çështjeve gjyqsore, e cila bëhet me short në rrugë elekronike. Më konkretisht, ILD kryen të gjitha inspektimet e ndarjes së çështjeve me short dhe gjithashtu çdo vit kontrollon raportet e sistemit elektronik[26]. Aktet e tij të kontrollit dhe inspektimit përfshihen në diskutimt periodike që bëhen në kuadër të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve.

ILD - Prokurori i Përgjithshëm

[20] Nenin 147/a pika 1, shkronja "b" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të ligjit nr.115/2016, "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar, në nenin 138, pika 2 të Ligjit nr.96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në nenin 31, pika 1 dhe 2 të Rregullores, "Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor".

[21] Neni 144, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

[22] Neni 104, ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

[23] Neni 106, ligji Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

[24] Neni 6, pika 1, ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

[25] Neni 6, pika 2, ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

[26] Neni 25, pika 4, e ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Në marrëdhënien ILD - Prokurori i Përgjithshëm, rolin e rëndësishëm të ILD-së e shohim edhe në rastin e paraqitjes së shprehjes së interesit për pozicionin e punës Prokuror i Përgjithshëm. Në këtë rast, Komisioni përkatës, që shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, kërkon raportim[27] nga institucionet kompetente si, ILD, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, Shërbimet Shtetërore Informative, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit, etj.

Po ashtu, në vijim të kësaj marrëdhënie bashkëpunimi, Prokurori i Përgjithshëm i kërkon ILD-së të kryejë inspektime tematike ose hetime për shkeljet individuale. Ndërkohë vetë ILD kryen rregullisht, të paktën çdo vit, një inspektim tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve[28], apo mbi caktimin e çështjeve. Apo, si Prokurori i Përgjithshëm ashtu edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme për çështjet që janë në juridiksdionin e tyre kanë për detyrim të bashkëpunojnë me ILD-në dhe ta informojnë atë në lidhje me çfarëdolloj shkeljeje disiplinore apo problematikë që mund të hasin në ushtrimin e aktivitetit të tyre të përditshëm[29].

ILD - Këshilli për Emërimet në Drejtësi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është organ i pavarur që verifikon përmbushjen e kushteve ligjore dhe vlerëson kriteret profesionalë e moralë të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli për Emërimet në Drejtësi rendit dhe përcakton rradhën e individëve që do të përzgjidhen më pas nga Kuvendi për detyrën e Inspektorit të lartë të Drejtësisë.

ILD - Gjykata Kushtetuese

Një ndër detyrat kryesore të Gjykatës Kushtetuese është edhe shkarkimi nga detyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në rastin e shkeljeve disiplinore të kryera[30].

Në përfundim, mund të themi se, ligji me formulën e zgjedhur mbi organizimin dhe funksionimin e ILD-së, kompetencat e tij ligjore dhe mënyrën e ushtrimit të tyre, vendin qendror në sistemin e organeve të drejtësisë, i ka dhënë ILD-së, një rol të rëndësishëm në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në vend. Pavarësisht, konfliktit në dukje ndërmjet parimeve të eficiences, efikasitetit, produktivitetit dhe atyre të transperences, përgjegjësisë dhe llogaridhënies, përsëri kemi garancinë që ky institucion të ketë një rol në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

3. Monitorimi dhe vlerësimi i punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

3.1 Monitorimi

E theksuam se, ligji me formulën e zgjedhur mbi organizimin dhe funksionimin, kompetencat ligjore dhe mënyrën e ushtrimit të tyre, vendin qendror në sistemin e organeve të drejtësisë, i ka një dhënë ILD rol të rëndësishëm në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në vend.

[27] Neni 31, pika 2, ligji Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[28] Neni 49, pika 6, ligji Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[29] Neni, 110, pika 1, ligji Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[30] Neni 207, ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Mirëpo, për të parë më siguri, nëse ligji, me krijimin e ILD-së, ka sjellë apo jo pasojën e dëshiruar, - rritjen e transparences dhe besimit të publikut në Drejtësi, janë monitoruar online dhe analizuar, prej 12 janarit 2022- korrik 2023[31], ankesat e paraqitura në ILD dhe vendimmarrjen e tij në kuadër të tyre[32]. [33]

Më konkretisht, për vitin 2022, periudha janar - nëntor, janë parë dhe shqyrtuar 90 ankesa. Ku rezulton se, 88 ankesa janë paraqitur nga individë, ku një prej të cilëve me statusin avokat, ndërkohë 2 ankesat e tjera janë paraqitur nga persona juridikë private. Pjesa më e madhe e këtyre ankesave, rezulton se, kanë si objekt të tyre problematika, si: ankesa ndaj vendimmarrjeve të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve; pretendime për zvarritje të gjykimit nga ana e magjistratëve dhe shkelje procedurale nga ana e magjistratëve. Nga këto ankesa të shqyrtuara, ILD ka vendosur që 85 prej tyre ti arkivojë, ndërsa për 5 ankesa ka vendosur fillimin dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të ankesës. Pas hetimit të arsyeve të arkivimit të pjesës më të madhe të ankesave, rezulton se, në këto raste, ankesa nuk përmbush një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesave. Kryesisht, ankuesi nuk ka fakte dhe prova të mjaftueshme për të bazuar ankesën e tij. Pra, mungesa e provave, do ta bënte ILD-në më pak objektive në vendimarrjen dhe shqyrtimin e ankesës.

Po ashtu, vërehet një numer i lehtë rastesh, - vetëm 4, kur në ILD ka pasur individë që kanë paraqitur raste të përsëritur ankesash.

Edhe në këto raste, ILD ka vendosur të arkivojë ankesën, pasi nuk përmbush një ose më shumë nga kriteret që duhet të përmbushë ankesa, si: nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit.

Për vitin 2023 - janar- korrik, janë parë dhe shyrtuar 61 ankesa. Nga këto 61 ankesa, 10 prej tyre janë paraqitur nga institucione të ndryshme publikë dhe privatë. Pjesa më e madhe e këtyre ankesave kanë, si objekt të tyre, problematika, si: ankesa ndaj vendimmarrjeve të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve; pretendime për zvarritje të gjykimit nga ana e magjistratëve dhe shkelje procedurale nga ana e magjistratëve. ILD ka vendosur që nga 61 ankesa të paraqitura, 60 ankesa ti arkivojë, ndërsa për 1 ankesë ka vendosur përfundimin dhe mbylljen e hetimit disiplinor. Arsyeja pse, ILD ka vendosur më së shumti arkivimin e çështjeve është pasi ankesa nuk përmbush një ose më shumë kritere të parashikuar si të domosdoshme për pranimin e saj. Kryesisht, mosparaqitje e ankesës në formën e përcaktuar, mungesa e provave dhe pamjaftueshmëria e faktve për fillimin e hetimit dhe kalimi i afateve.

Në ndryshim nga viti 2022, në vitin 2023, nuk rezulton të kemi raste kur, në ILD të ketë pasur individë që kanë riparaqitur ankesën.

Për të arritur në një përfundim të saktë, kemi marrë në konsideratë edhe disa elementë të tjerë, si:

a) *publikimi dhe komunikimi i informacionit,* ankesat që publikohen, kanë rrjedhshmëri publikimi, pra çdo ankesë e re që i paraqitet institucionit të ILD, publikohet dhe bëhet transparente për publikun, në formën e një njoftimi me shpallje për ankesën. Gjithashtu, një kërkesë apo ankesë, përveç publikimit fillestar, është në përditësim dhe ndryshim të vazhdueshëm. Kjo do të thotë se, publiku njoftohet për administrimin e kërkesës/ankesës; përcjelljen e saj pranë organeve kompetente; përgjigjen e tyre, etj;
b) *numri i ankesave të paraqitura dhe trajtimi i tyre*, sipas raportimit të ILD-së, vërëjme se, në vitin 2023 janë mbartur për shqyrtim 1072 ankesa, të depozituara nga viti 2022. Që do të thotë, janë trajtuar jashtë afatit ligjor;
c) *vendbanimin apo vendqendrimin e ankuesve*, ankuesit të cilët i drejtohen ILD-së banojnë në të gjithë Shqipërinë, por numrin më të lartë të ankuesve e zë Qarku i Tiranës, që ndiqet më pas nga Qarku i Durrësit, etj. Duke pasur në vëmendje numrin e popullsisë në këto qarqe, kjo tregon një përfshirje të gjërë të qytetarëve që e kanë zgjedhur ILD-në, si një institucion ku mund të gjëjnë zgjidhje. Po ashtu, tregon edhe

[31] Në muajin Qershor, 2023 nuk rezulton të ketë vendimmarrje (https://ild.al/sq/njoftim-publik-per-shpallje-vendimi/).

[32] Për këtë, jemi bazuar të informacioni i publikuar në faqen zyrtare të ILD-së. Më konkretisht, në seksionin e emërtuar "*njoftime*", - nënseksioni "*njoftim publike për shpallje vendimi*", ku gjenden të pasqyruara të gjitha njoftimet me shpallje për ankesa të depozituara nga persona fizikë/juridikë.

[33] Pas marrjes së informacionit të nevojshëm, kemi ndërtuar, për secilin vit, një tabelë më indikatorët, vendimi, ankuesi, i padituri, vendimarrja e ILD, arsyeja e vendimmarrjes, KLP/GJ, vendimmarrja KLP/GJ.

një rritje të ndërgjegjes qytetare që për çfarëdolloj shkeljeje, pavarësisht se kush mund të jetë shkelësi i të drejtës së tyre (gjyqtarë apo prokurorë), përveçse kanë të drejtë ti drejtohen institucioneve përkatëse, mundet edhe të marrin shërbimin e duhur;

d) *objekti i ankesave*, problematikat apo pretendimet e ngritura më së shumti nga ankuesit janë, vendimmarrje të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve; zvarritje të gjykimit nga ana e magjistratëve; shkelje procedurale nga ana e magjistratëve;
e) *shkaqet e arkivimit të ankesave të depozituara nga ILD*, janë mungesa e provave, shkeljet e pretenduara nuk parashikoheshin si shkelje disiplinore në ligjin në fuqi, apo në kohën e shqyrtimit të ankesës, magjistrati nuk ushtronte funksionin e tij;
f) *numri i kërkesave të përcjella në KLP/ KLGJ dhe rezultati i tyre*, gjatë vitit 2022, ILD ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 6 magjistratë, për 3 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për 3 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ndërsa, deri në gusht 2023[34], vërejme se, janë paraqitur 3 kërkesa në KLP[35], nga të cilat 2 janë pranuar dhe 1 është pezulluar dhe përafërsisht kërkesa në KLGJ, ku për 8 prej tyre është vendosur pezullim; për 10 prej tyre ka filluar procedimi; për 8 prej tyre është caktuar masë; 2 prej tyre është vendosur mbyllja e procedimit dhe në dy raste KLGJ ka pranuar kërkesën e ILD-së;
g) *natyra e çështjeve të cilat i janë drejtuar ILD*, janë çështje të cilat i përkasin fushës civile, penale ose administrative;
h) *inspektimet me iniciative/ hetime të nisura kryesisht*, numri i tyrë është i vogël, duke passjellë një rol jo aktiv të ILD-së në këtë drejtim;
i) *aktivitetit të përditshëm të ILD-së*, shyqrtimi i ankesave është kryer në mënyrë publike, përtej afatit ligjor dhe duke pasur në fokus rritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimin e publikut, pasi, në vazhdimësi, kryhen takime me qytetarët për dhënie informacioni apo sqarime të nevojshme për ankesat dhe rolin e ILD-së; publikohen rezultatet e veprimtarisë; dalje publike në masmedia (media tradicionale dhe online), etj. Po ashtu, në faqen zyrtare të ILD-së, kemi seksionin *Si pranohen ankesat*, ku shpjegohet rrugëtimi i një ankesë në ILD dhe ju jepet përgjigje disa pyetjeve, të cilat qartësojnë qytetarin apo të interesuarin, mbi përdorimin me efektivitet të këtij instrumenti.[36]

3.2. Vlerësimi

Duke pasur në konsideratë kohën kur ILD, ka filluar të veprojë efektivisht, si edhe informacionin e mësipërm, kemi zgjedhur një kohë të ndërmjetme vlerësimi dhe si metodë kemi përdorur OECD-DAC (2015) Vlerësimi i Kritereve[37], e përdorur gjerësisht në vlerësimin e ndikimit të politikave ligjore. Kjo metodë mbështet në disa indikatorë, si: relevanca, efektivieti, efikasiteti, ndikimi, qëndrueshmëria dhe koherenca.

Por, ne kemi marrë në konsideratë ato indikatorë, që në opinionin tonë, tregojnë se, një politikë ka një ndikim pozitiv apo negativ mbi rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në qeverisjen në përgjithësi dhe në veçanti në atë të gjyqësorit. Më konkretisht, *rëndësinë*[38], *efektivitetin dhe efikasitetin*[39], *qëndrueshmërinë*[40] dhe *koherencën*.

[34] https://klgj.al/akte-administrative-individuale-2/ (parë së fundmi në gusht, 2023).
[35] https://klp.al/category/vendime-akte-administrative/ (parë së fundmi në gusht, 2023).
[36] https://ild.al/sq/pyetje-te-shpeshta/ (parë së fundmi në korrik, 2023).
[37] https://www.oecd.org/dac/evaluation/daccriteriaforevaluatingdevelopmentassistance.htm (parë së fundmi në korrik, 2023).
[38] Shkalla në të cilën objektivat e një ndërhyrjeje janë në përputhje me kërkesat e qytetarëve, nevojat e vendit, etj.
[39] Shkalla në të cilën objektivat e ndërhyrjes janë arritur ose pritet të arrihen.
[40] Vazhdimësia e përfitimeve nga ndërhyrja.

Pas kryqëzimit të informacionit të marrë dhe përballjes me këta indikatorë, rezulton se, *duke marrë si indikator kohën/ koherencën*, ILD ka kryer një procedim administrativ *deri diku*[41]*efikas dhe efektiv të hetimit dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*, të kryera nga ana e magjistratëve, kjo jo sepse nuk ka vullnetin e duhur, por pasi nuk ka pasur/ nuk ka në dispozicion burimet e nevojshme njerëzore, deri në gusht 2023, janë 9 pozicione inspektor vakante[42], si edhe nuk ka infrastrukturën e duhur teknike, - nuk rezulton të jetë ndërtuar ende sistemi i menaxhimit të ankesave, detyrim që buron prej ligjit. Pra, më siguri mund të themi se, ILD ka trashëguar dhe administruar një numër të madh ankesash; pjesa më e madhe e tyre janë trajtuar jashtë afatit *supra*, edhe se *përse* ligji parashikon afate relativisht të gjata; pjesa më e madhe e ankesave, për mungesë provash, janë arkivuar, - edhe *përse* nga ana e tij është bërë një punë e mirë në drejtim të edukimit të publikut për kthimin e ILD-së në një instrument efektiv; një pjesë e vogël rastesh është përcjellë në KLP/ KLGJ dhe në të shumtën e rasteve prej tyre është konfirmuar vendimmarrja e ILD-së.

Ndërsa, *duke marrë si indikator transparencen*, ILD ka kryer një *procedim administrativ deri diku efikas të hetimit dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*, të kryera nga ana e magjistratëve, pasi ka krijuar një infrasrukturë që publiku të njoftohet për administrimin e kërkesës/ankesës; përcjelljes së saj pranë organeve kompetente, përgjigjen e tyre, etj. Por, nuk rezulton të jetë ndërtuar ende sistemi i menaxhimit të ankesave, detyrim që buron prej ligjit.

Pra, jo për mungesen e vullnetit, por për shkak se është një institucion i ri, disa problemeve të ligjit, mungesës së infrastrukturës, ILD, ka një rol pozitivisht të moderuar në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Ky rol do të rritet në të ardhmen, pasi vërehet, *së pari*, nga viti në vit rritja e numrit të qytetarëve që e zgjedhin si një instrument juridik dhe *së dyti*, zvogëlimi i kohës së trajtimit të një ankesë.

Edhe, Kuvendi i Shqipërisë, në rezolutën e tij drejtuar ILD-së[43], e ka vlerësuar punën e saj, por i ka rekomanduar: …

6. Vijimin me ritme të shpejta të trajtimit të ankesave të dorëzuara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare, si dhe trajtimin me përparësi të ankesave, të cilat për shkak të parashikimeve të nenit 117 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokuroreve në Republiken e Shqipërisë" mund të parashkruhen, duke shmangur kështu arkivimin e tyre pa bërë të mundur verifikimin dhe hetimin nga institucioni.

4. Konkluzione

Në përfundim të procesit të vlerësimit të rolit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, *rezulton se*, ligji, me formulën e zgjedhur mbi organizimin dhe funksionimin e ILD-së, kompetencat e tij ligjore dhe mënyrën e ushtrimit të tyre, vendin qendror në sistemin e organeve të drejtësisë, i ka dhënë një rol të rëndësishëm në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në vend. Pavarësisht se, në dukje kemi një konflikt ndërmjet parimeve të eficiences, efikasitetit dhe produktivitetit dhe atyre të transperences, përgjegjësisë dhe llogaridhënies, përsëri kemi garanci që ky institucion të këtë një rol në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Pasi, në të vërtetë, edhe pas kryerjes së procesit të monitorimit dhe kryqëzimit të informacionit të marrë, rezulton se, ILD, ka luajtur një rol pozitivisht të moderuar në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Pozitivisht të moderuar, jo për mungesën e vullnetit, por për shkak se është një institucion i ri dhe ka disa probleme të ligjit, mungesës së infrastrukturës. Mirëpo, ky rol do të rritet në të ardhmen, pasi vërehet, *së pari*, nga viti në vit rritja e numrit të qytetarëve që e zgjedhin si një instrument juridik dhe *së dyti*, zvogëlimi i kohës së trajtimit të një ankesë. Po ashtu, ligji ka parshikuar se, ILD është kompetent dhe ka tre lloj funksionesh, si: kontrollues, hetimor dhe inspektues, në rastin e procedimit disiplinor të magjistratëve dhe kryerjen e inspektimeve

[41] Për shkak të numrit të ulët të intervistave, përgjigjet e tyre nuk janë zbardhur, por kanë shërbyer si instrument për të provuar gjetjet tona nga monitorimi.
[42] https://ild.al/sq/zyra-e-inspektorit-te-larte-te-drejtesise/stafi-yne/ (parë në gusht, 2023).
[43] https://ild.al/wp-content/uploads/2022/09/Rezolute-e-Kuvendit-per-vitin-2021.pdf (parë në gusht, 2023).

të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë si dhe ka parashikuar mekanizmin për ushtrimin e këtyre funksioneve në përputhje me procesin e rregullt ligjor.

Ndaj, për të rritur rolin e ILD-së në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, do të rekomandonim edhe:

1. Rritjen e bashkëpunimit mes institucioneve (shkëmbimit të eksperiencave; unifikimit të metodave dhe praktikave më të mira në përputhje me standardet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës).
2. Hartimin e një plani veprimi nga secili insitucion në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet organeve të drejtësisë (bazuar te kërkesa e ILD drejtuar Kuvendit për krijimin e një mekanizmin mbikëqyrës, i nevojshëm për matjen e performancës së institucioneve të drejtësisë).
3. Përmirësimin e infrastrukturës IT.
4. Nxitjen e edukimit ligjor.

BIBLIOGRAFI

Legjislacion

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Ligji i Republikës së Shqipërisë nr. 115/2016 ‘Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
3. Ligji i Republikës së Shqipërisë nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
4. Ligji i Republikës së Shqipërisë nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
5. Metodologjia e inspektimit, miratuar me urdhërin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nr. 121, datë 30.12.2022.
6. Rregullorja e Republikës së Rumanisë “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektimit Gjyqësor”.

Web faqe

1. https://ild.al/sq/2021/05/21/inspektimet-tematike-prioriteti-i-ri-i-inspektorit-te-larte-te-drejtesise/.
2. https://ild.al/sq/2023/05/05/raporti-i-punes-per-vitin-2022/.
3. https://ild.al/sq/njoftim-publik-per-shpallje-vendimi/.
4. https://ild.al/wp-content/uploads/2022/09/Rezolute-e-Kuvendit-per-vitin-2021.pdf.
5. https://klgj.al/akte-administrative-individuale-2/.
6. https://klp.al/category/vendime-akte-administrative/.
7. https://www.normattiva.it/.
8. https://www.oecd.org/dac/evaluation/daccriteriaforevaluatingdevelopmentassistance.html.

INTERPRETIMI I KUSHTETUTËS MIDIS SHKOLLËS "TEKSTUALISTE" DHE ASAJ "EVOLUTIVE"*

Doc. Dr. Erind MERKURI**

THE INTERPRETATION OF THE CONSTITUTION BETWEEN THE "TEXTUALISM" AND THE "EVOLUTIONARY" SCHOOL

Abstract

The Constitution and any other legal act, which is presented in written form, necessarily requires the realization of an interpretation process on it. In the legal world, the two main currents of interpretation are "textualism" and "evolutionary/pragmatist interpretation". The debate between these two schools is quite extensive, but in Albania, it has been addressed very little, although our courts, the Constitutional Courts and the Supreme Courts, have shown that they have applied both of these approaches. Through the paper, it is intended to open a discussion at the doctrinal level as to which methods are closer to the constitutional principles and respect a democratic form of government.

Keywords: *Interpretation, textualism, evolution, judgment, democracy.*

1. Hyrje

Historia e zhvillimit të shoqërisë nga bashkësitë primitive deri në shoqërinë moderne është një rrugë e gjatë dhe e ndërlikuar që ka përfshirë ndryshime thelbësore në organizimin shoqëror, sistemin juridik dhe stukturën shtetërore. Fillimisht në periudhën primitive, shoqëritë karakterizoheshin nga mungesa e strukturave të avancuara shoqërore dhe juridike. Normat shoqërore kishin një karakter spontan dhe bazoheshin kryesisht në instinktet njerëzore dhe marrëdhëniet e vogla sociale. Me zhvillimin e shoqërisë në periudhën e antikitetit, siç ka ndodhur në Greqi dhe Romë, shfaqet një krijimtari e re në fushën e së drejtes, e cila zhvillohet me krijimin e qytetërimeve dhe formimin e shteteve të hershme. Në periudhën e mesjetës, shumica e shoqërive evoluojnë drejt një organizimi shtetëror që karakterizohet nga monarkia absolute, ku rregullat juridike shërbenin kryesisht për të mbështetur pushtetin mbretëror, të elitës fetare dhe të aristokracisë. Gjatë përiudhës së rilindjes fillojnë të dalin ide të reja për organizimin shtetëror, bazuar edhe në nocionin e ndarjes së pushteteve midis legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, me qëllim për të parandaluar abuzimet. Këto ide shërbyen si mbështetje për revolucionet që ndodhën në shek e XVIII që sollën ide të reja për organizimin shoqëror. Krijohet kështu një kuptim i ri i sovranitetit, duke kaluar nga monarkia absolute tek një formë e re organizimi që përfshin pjesëmarrjen e popullit në pushtetin politik. Kjo periudhë shënon një tranzicion drejt demokracisë dhe shteteve moderne.

Kalimi i sovranitetit tek popullit dhe krijimi i rregullave juridike kanë formuar themelet e shoqërisë moderne dhe sistemit hierarkik të normave juridike. Këto zhvillime kanë ndikuar drejtpërdrejt në ndryshimin e strukturave shtetërore dhe në përcaktimin e drejtësisë dhe ligjit në shoqërinë e sotme.

Prodhimi gjithmonë e më i madh i normave juridike që rregullojnë aspekte të ndryshme të sjelljeve dhe jetës së njerëzve ka sjellë edhe debatin se si duhet të kuptohen ato. Pavarësisht përpjekjeve që mund të bëjë organi

* Ky punim, është një përmirësim i referimeve të bëra në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, me 20.11.2023 dhe në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, më 22.11.2023 me rastin e aktiviteteve për 25 vjetorin e Kushtetutës së Shqipërisë.

** Doc. Dr. Erind Merkuri, Lektor i së Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

legjislativ, ai e ka të pamundur të rregullojë në detaje çdo lloj marrëdhënie shoqërore apo situatat që mund të krijohet në realitet. Për këtë arsye, në përgjithësi, normat juridike, formulohen në mënyrë të përgjithshme, për t'iu lënë më pas organeve ekzekutive dhe atyre gjyqësore mundësinë që t'i zbatojnë ato në raste konkrete.

Pikërisht, mënyra e kuptimit të këtyre normave dhe përcaktimi nëse një rast apo çështje e caktuar bie në fushëveprimin e një norme konkrete juridike, ka sjellë si pasojë përpunimin e disa metodave interpretuese, metoda këto që kryesisht ndahen në dy rryma kryesore atë "tekstualiste" dhe të "evolutive/normë-krijuese/pragmatiste".[1]

Debati midis këtyre dy metodave, u bë edhe më i fortë mbas vendimit të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara, e cila në çështjen *"Dobbs v. Jackson Women's Health Organization, 597 U.S. 215 (2022)"*, përcaktoi që e drejta e grave për abort, nuk është e drejtë kushtetuese, por duhet që të rregullohet nga ana e ligjvënësit e secilit shtet, pjesë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nëpërmjet kësaj vendimmarrje, Gjykata e Lartë e SHBA, rrëzoi dy precedentët e saj të mëparshëm dhe konkretisht vendimet në çështjet *"Roe v. Wade, 410 U.S. 113 (1973)"* dhe *"Planned Parenthood v. Casey, 505 U.S. 833 (1992)".* Sipas kritikëve të këtij vendimi, e drejta kushtetuese për abort e njohur nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj të vitit 1973, mbas 50 vjetesh, nuk ishte më e drejtë kushtetuese. Ata që e mbrojnë këtë vendimmarrje kritikojnë pikërisht faktin se vendimi i vitit 1973 i Gjykatës së Lartë, krijoi nga "hiçi" një të drejtë kushtetuese, e cila prej 187 vitesh nuk ishte konsideruar si e tillë.

Shqipëria, në vitin 1998, hartoi dhe miratoi aktin e tetë kushtetues në historinë e tij si shtet.[2] Tashmë, mbi ligjin themelor të vendit është krijuar një jurisprudencë e pasur nga Gjykata Kushtetuese dhe nga Gjykata e Lartë. Nga analiza e kësaj praktike gjyqësore, del se qasja që kanë pasur këto dy institucione ndaj tekstit kushtetues, nuk ka qenë e njëjtë dhe këto gjykata janë treguar si "tekstualiste", ashtu edhe "evolutive" në interpretimin e ligjit themelor të vendit dhe të drejtës në përgjithësi.

Kjo situatë mund të ilustrohet mjaft mirë duke marrë si shembull dy raste nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr.20, datë 1.6.2011, ka mbajtur qendrimin se *"Për shkak te vetë formës ekstremisht konçize që kanë dispozitat kushtetuese, nëpërmjet vendimeve, pra interpretimit që bën Gjykata, bëhet e mundur që Kushtetuta të jetë "e gjallë", që do të thotë se Gjykata i përshtatet evolucionit që bëjnë vlerat në vendin tonë, duke garantuar që vlera të reja, të cilat ndoshta nuk ishin në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës, të marrin dinjitet, njohje dhe, mbi të gjitha, mbrojtje kushtetuese."* Siç mund të shihet, në këtë rast, Gjykata Kushtetuese, dukshëm anohet në favor të doktrinës së interpretimit "evolutiv", duke i njohura vetes të drejtën që edhe të krijojë të drejtat ë reja kushtetuese, që nuk parashikohen nga ligji themelore i vendit. Por, vetëm 8 ditë më vonë, Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.24, datë 9.6.2011, u shpreh se *"Gjykata vëren se funksioni më i rëndësishëm i pushtetit ligjvënës, në një shtet të së drejtës, është nxjerrja e ligjeve dhe është në kompetencë vetëm të Kuvendit që, nëse vlerëson se dispozita të ndryshme kanë nevojë për ndryshime ose plotësime, të ushtrojë funksionin e tij për miratimin e rregullimeve përkatëse. Në kushtet kur në Kushtetutë, ose edhe në ligjet e tjera, elementet e mësipërme,*

[1] Në varësi të autorëve të ndryshëm, këto dy rryma mund të marrin dhe emërtesa të ndryshme. Në përgjithësi, për rrymën e dytë interpretuese, gjenden emërtesat "evolutive" dhe "normë-krijuese". Ndërkohë ish gjyqtari i Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Stephen Breyer, përdor termin "pragmatist". Në ndonjë rast, përdoret edhe termi "gjyqësori ligjbërës". Të gjitha këto terma në thelb i referohen të njëjtës qasje interpretuese dhe përdorimi i këtyre termave në këtë kuptim është i njëjtë.

[2] Nga viti 1912 deri më sot, aktet kushtetuese në Shqipëri kanë qenë 1) Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë, 1920 (Statuti i Lushnjes); 2) Zgjanimi i Statutit të Lushnjes, 1922; 3) Statuti Themeltar i Republikës, 1925; 4) Statuti Themeltar i Mbretërisë (1928); 5) Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë, 1946; 6) Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1976; 7) Ligji nr.7941, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", së bashku me ligjet e tjera plotësuese; 8) Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Shqipërisë" e amenduar.

Janë edhe dy akte të tjera por të cilat nuk janë llogaritur në numërim për këto arsye:

a) Statuti Organik i Shqipërisë i viti 1914, që njihet si kushtetuta e parë e vendit, mbeti në fazën e një projekti, por nuk hyri në fuqi. Shih Merkuri, Erind. *Analizimi dhe vlerësimi i (projekt) Statutit Organik të Shqipërisë të vitit 1914.*, botuar në revistën "Studime juridike", botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia botuese "Flesh", nr.2, të vitit 2023, Tiranë 2024, f.19-55.

b) Statuti Themeltar i Mbretërisë, i viti 1939, dhënë nga Mbreti Viktor Emanueli III, ka qenë akti kushtetues i vendit gjatë pushtimit Italian të Shqipërisë (1939-1943). Ky akt (bashkë më të tjerë) është shpallur dy herë i pavlefshëm, së pari nga Asambleja Kushtetuese e muajit tetor 1943 dhe së dyti nga Kongresi i Përmetit, i muajit maj 1944.

të parashtruara nga kërkuesit, nuk gjejnë rregullim të hollësishëm, këto elemente nuk mund të plotësohen nëpërmjet vendimit interpretues të Gjykatës. Interpretimi ka për qëllim t`i japë normës kushtetuese kuptimin e drejtë të saj dhe nuk ka për qëllim plotësimin e boshllëqeve kushtetuese/ligjore, sepse përndryshe Gjykata do të vihej në pozicionin e gabuar të krijuesit të normës juridike". Pra, në dukje, shumë shpejt, Gjykata Kushtetuese, menjëherë iu kthye shkollës "tekstualiste" të interpretimit të së drejtës, pa dhënë asnjë arsye për këtë zgjedhje.

Ajo që e bën më problematike këtë qasje të dyfishtë të Gjykatës Kushtetuese është se këto çështje janë gjykuar në të njëjtën periudhë në këtë institucion.[3] Me logjikë këto dy vendime janë arsyetuar paralelisht me njeri – tjetrin. Kjo do të thotë që e njëjta trupë gjyqësore, na paraqitet "evolutive" dhe "tekstualiste" në të njëjtën kohë.

Duke qenë se punimet për qasjen e këtyre dy teorive janë të pakta,[4] ky punim ka si qëllim që të japë një pasqyrim të mënyrës së zbatimit të këtyre dy metodave interpretuese mbi të drejtën në Shqipëri, si edhe të bëjë një analizë të të përputhshmërisë së tyre me rendin kushtetues dhe sistemin demokratik në vend. Është e kuptueshme që në kuadër të këtij punimi, i kufizuar për nga natyra, kjo analizë nuk mundet që të jetë shteruese, por ka si qëllim që nëpërmjet shembujve të dhënë të nxisë më tej debatin mbi këto dy shkolla të interpretimit.

Autori dëshiron të theksojë, se qëllimi i këtij punimi është nxitja e debatit doktrinor dhe diskutimi i ideve të ndryshme mbi mënyrën e interpretimit të së drejtës dhe qendrimi i tij mbi vendime të caktuara gjyqësore, nuk ka të bëjë me vlerësimin personal për gjyqtarët që kanë marrë ato vendime, të cilët duke pasur një integritet të lartë moral dhe profesional i shërbejnë këtij vendi në më të mirën e aftësive të tyre.

2. Shkolla "tekstualiste" e interpretimit të së drejtës

Sipas doktrinës "tekstualiste" të interpretimit, normat juridike interpretohen bazuar në strukturën e ligjit dhe në kuptimin e zakonshëm të fjalëve të përdora në të. Kjo qasje bazohet në idenë se ligji duhet të lexohet dhe kuptohet nga të gjithë subjektet që i drejtohet dhe sjelljen e të cilëve kërkon që të rregullojë. Për këtë arsye, fjalët që përdoren në tekstin ligjor, shihen në kuptimin e tyre normal dhe të zakonshëm,[5]me përjashtim të rasteve kur ligjvënësi ka vendosur t'u japë vetë një kuptim tjetër këtyre fjalëve.[6] Por edhe në këtë rast të fundit, përsëri, subjektet i referohen përkufizimeve që ndodhen në vetë tekstin e ligjit.

Pra, bazuar në këtë qasje, gjyqtarët do të duhet që të interpretojnë fjalët e një teksti ligjor, siç do t'i kuptonte një njëri i arsyeshëm. Qëllimi i ligjvënësit, duhet të dalë dhe të kuptohet vetëm nga fjalët që ai ka përdorur në ligjin e miratuar prej tij dhe jo në materiale të tjera "ekstraligjore".

Për këtë arsye, në interpretimin e ligjit, nuk duhet që të merren në konsideratë e ashtuquajtura "historia legjislative" *(legislative history)*, e cila përfshin shqyrtimin dhe analizimin e relacionit që shoqërojnë projektligjin, raportet e komisioneve apo diskutimet parlamentare. Këto janë akte që nuk diskutohen, ndryshohen/amendohen, votohen apo miratohen në Kuvend. Duke qenë të tilla, këtyre akteve nuk mund t'u jepet vlerë e barabartë apo vlerë më të lartë se vetë tekstit ligjor të votuar dhe miratuar nga organi ligjvënës, siç me të drejtë Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kanë mbajtur qendrimin se *"Ne nuk do të marrim drejtimin e kundërt që të lejojmë që historia e dyshimtë legjislative të ngatërrojë gjuhën e qartë të tekstit ligjor"*.[7]

Përsa i përket diskutimeve të deputetëve në komisionet parlamentare apo në diskutimet në seancë plenare, ato përbëjnë qendrimin e një personi dhe jo domosdoshmërisht deputetët e tjerë që votojnë ligjin, ndajnë të njëjtin

---

[3] Në rastin e parë, seanca në Gjykatën Kushtetuese, është zhvilluar me datë 23.2.2011, ndërsa vendimi i shpallur mban datën 1.6.2011, ndërsa në rastin e dytë, seanca në Gjykatën Kushtetuese, është zhvilluar me datë 21.12.2010, ndërsa vendimi i shpallur mban datën 9.6.2011.

[4] Anastasi, Aurela. *E drejta Kushtetuese e Krahasuar*.Shtëpia Botuese "Dajti 2000", Tiranë, 2009. Berberi, Sokol. *Ligjvënësi dhe interpretimi gjyqësor i ligjit.* Botuar në revistën "Jeta juridike", botim i Shkollës së Magjistraturës, Shtëpia botuese "Morava", nr.3, viti 2014, f. 9-18.

[5] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts*, Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 74.

[6] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts*. Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 187.

[7] Milner v. Department of Navy, 562 U. S. 562, 572 (2011).

mendim.[8] Të pretendosh që diskutimi i një apo disa deputetëve, përbën edhe qëllimin e të gjithë trupës legjislative, do të thotë të mohosh individualitetin e çdo deputeti, bazuar vetëm në faktin se si ka votuar më pas ai. Për të ilustruar më tej, këtë qendrim, po i referohemi dhe dy rasteve gjyqësore. Kështu, Gjykata Kushtetuese e Mbretërisë së Spanjës, ka mbajtur qendrimin se *"Deklaratat e bëra nga përfaqësuesit politikë në asnjë mënyrë nuk përbëjnë metodë për interpretimin e ligjit dhe nuk mund të përdoren për të shtrembëruar përmbajtjen e tij. ... Thelbi objektiv i atij ligji nuk mund të shtrembërohej nga deklarata apo iniciativa që hynin në sferën e debatit politik apo strategjisë politike dhe në asnjë mënyrë nuk përbëjnë metodë për interpretimin e ligjit në shqyrtim"*.[9] Në një shembull tjetër, Gjykata e Lartë e SHBA-së është shprehur se *"Kjo Gjykatë prej kohësh ka kundërshtuar argumentet e bazuara në qëllimet e pretenduara legjislative. Gjykata ka pranuar se hetimet për qëllimet e ligjvënësit "janë një çështje e rrezikshme". Edhe kur një pretendim për qëllimin e ligjvënësit mbështetet nga deklaratat e bëra nga ligjvënësit që votuan për një ligj, ne kemi hezituar t'ia atribuojmë ato qëllime organit legjislativ në tërësi. "Ajo që motivon një ligjvënës të mbajë një fjalim për një ligj nuk është domosdoshmërisht ajo që motivon shumë të tjerë për ta miratuar atë"*.[10]

Gjykatat tona në këtë rast janë kontradiktore, ku nga njëra anë kanë pranuar si materiale interpretuese dhe kanë përdorur relacionet, projektligjet, diskutimet apo materiale të tjera të historisë legjislative të aktit, por nga ana tjetër, ka përsëri shembuj ku ato janë injoruar dhe nuk janë përdorur prej tyre. Kështu, në rastin e diskutimeve të kushtetutshmërisë së dënimit me vdekje, Gjykata Kushtetuese injoroi totalisht dhe nuk mori në konsideratë diskutimet e zhvilluara në Komisionin parlamentar për hartimin e projektkushtetutës, nga të cilat del që formulimi kushtetues që ato kishin bërë, e lejonte dënimin me vdekje dhe heqja apo mbajtja e tij i lihej në të ardhmen pushtetit legjislativ.[11] Të njëjtën qasje mori Gjykata Kushtetuese edhe në mënyrën e interpretimit të nenit 70, pika 4 e Kushtetutës, ku përcaktoi se Kuvendi nuk kishte të drejtë të vlerësonte vetë nëse do ja çonte apo jo Gjykatës Kushtetuese, kërkesën e paraqitur nga jo më pak se një e dhjeta e deputetëve për të vlerësuar papajtueshmërinë e një deputeti në ushtrimin e detyrës së tij.[12] Një tjetër rast i tillë, ishte edhe shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Protokollit lidhur ndërmjet Qeverisë së Italisë dhe Këshillit të Ministrave të Shqipërisë "Për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit", ku në interpretimin e Traktatit të Miqësisë, lidhur midis Shqipërisë dhe Italisë në vitin 1995, Gjykata Kushtetuese nuk iu referua relacionit që kishte shoqëruar ratifikimin e kësaj marrëveshje në vitin 1995, por e zgjidhi çështjen duke i dhënë kuptimin e zakonshëm fjalëve të përdorura në këtë marrëveshje.[13]

E ndryshme nga "historia legjislative", është metoda tjetër e interpretimit që njihet si "interpretimi historik" *(statutory history)* dhe që kërkon që gjykata të analizojë të gjitha aktet juridike që rregullojnë këtë fushë, përfshirë aktet e mëparshme dhe të shfuqizuara, si edhe ndryshimet që ato kanë pësuar.[14] Logjika e kësaj mënyre interpretimi është që ligjvënësi prezumohet se ka dijeni për të gjitha aktet që ka nxjerrë për të rregulluar një fushë të caktuar dhe për rrjedhojë, është shumë i kujdesshëm kur zgjedh gjuhën që përdor në normat e reja që krijon. Një shembull i përdorimit të kësaj teknike është edhe rasti i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese e çështjes së dënimit me vdekje,

[8] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts.* Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 282.

[9] Vendimi nr. 73/2000, date 14.3.2000 (ESP-2000-1-011) i Gjykatës Kushtetuese të Mbretërisë së Spanjës, marrë nga adresa http://www.codices.coe.int/NXT/gateëay.dll/CODICES/precis/eng/eur/esp/esp-2000-1-011?f=templates$fn=document-frameset.htm$q=%5Bfield,IDEcross%3A%5Borderedprox,0%3Aconst-eng-esp-a-009%5D%5D%20$x=server$3.0#LPHit1

[10] *Dobbs v. Jackson Women's Health Organization*, 597 U.S. 215 (2022).

[11] *"Debati kushtetues",* Vëllimi I, botim i OSBE, Tiranë 2006, f.50, 57-63, 70-76.

[12] Vendimi nr.7, datë 24.2.2016 i Gjykatës Kushtetuese. Shih veçanërisht mendimin në pakicë të gjyqtarit Sokol Berberi që terheq vëmëndjen se "shumica", nuk ka marrë në konsideratë diskutimet e Komisionit për hartimin e projektkushtetutës.

[13] Vendimi nr.2, datë 29.1.2024 i Gjykatës Kushtetuese. Shih veçanërisht mendimin në pakicë të gjyqtarëve Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja dhe Ilir Toska që terheqin vëmëndjen se "shumica", nuk ka marrë në konsideratë relacionin që ka shoqëruar ratfikimin e Traktatit të Miqësisë së vitit 1995, në lidhje me kuptimin e termit "fluks emigrantësh".

[14] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts*. Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 333.

ku në analizën e saj bazohet në krahasimin e përmbajtjes midis një normë te shfuqizuar (neni 1 i ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 "Për të drejtat dhe liritë themelore të njëriut"), dhe normës së re në fuqi (neni 21 i Kushtetutës).[15]

Shpesh herë, "tekstualizmi", ngatërrohet me interpretimin strik dhe mekanik të normave juridike, por kjo nuk është e vërtetë. Kjo doktrinë bazën e saj e ka në leximin e arsyeshëm të normave, siç del nga përmbajtja e tekstit të shkruar.[16] Nëse doktrina tekstualiste do të kuptohej drejtë, atëherë fjalëve të ligjit, u duhet dhënë kuptimi i tyre më i gjërë, i mundshëm,[17] me përjashtim kur vetë ligjvënësi e ka përkufizuar ndryshe.

Në librin e tyre *"Leximi i së drejtës: Interpretimi i teksteve ligjore" (Reading Law: The interpretation of legal text),* autorët Antonin Scalia[18] dhe Bryan A. Garner[19] analizojnë 57 rregulla interpretimi dhe 13 "falsitete", pra metoda të gabuara interpretimi. Me disa përjashtime, që lidhen me sistemin ligjor federal të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, këto rregulla dhe parime kanë gjetur zbatim dhe në Shqipëri dhe mund të përdoren nga gjyqtarët për të zgjidhur mosmarrëveshjet e paraqitura pranë tyre. Përdorimi i këtyre rregullave, respektojnë disa parime të rëndësishme kushtetuese, si formën e qeverisjes, duke qenë se Shqipëria është republikë parlamentare (neni 1, pika 1 e Kushtetutës), sovranitetin popullor (neni 2, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës), shtetin e së drejtës (neni 4, pika 1 e Kushtetutës), si edhe parimin e ndarjes dhe të balancimit midis pushteteve (neni 7 i Kushtetutës).

3. Doktrina e "interpretimit evolutiv/normë-krijues/pragmatist"

Megjithëse pretendohet si një teori moderne, fillesat e kësaj teorie janë antike dhe duket se i kanë rrënjët e saj në teorinë e Platonit për shtetin ideal, ku mundësia për të krijuar norma ligjore nuk duhej të ishte e centralizuar në një organ legjislativ, por e përhapur dhe për rrjedhojë edhe gjykatat mund të krijonin norma.[20] Në aspektin modern, fillesat e kësaj doktrine, e gjejmë në autorin, që më pas do të bëhej President i SHBA-së, Woodrow Wilson, i cili në librin e tij, të vitit 1908, "Qeverisja kushtetuese në Shtetet e Bashkuara" *(Constitutional Government in the United States),* ndër të tjera mban qendrimin se *"Kushtetutat e gjalla politike duhet të jenë darviniane në strukturë dhe në praktikë".*[21] Më pas kjo teori u përpunua nga autori Horward Lee McBain, në librin

---

[15] Vendimi nr.65, datë 10.12.1999 i Gjykatës Kushtetuese.

[16] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts*. Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 274.

[17] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts*. Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 95.

[18] Antonin Gregory Scalia (11 mars 1936 – 13 shkurt 2016) ka qenë diplomuar për drejtësi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Harvardit dhe fillimisht ka punuar si avokat pranë studios ligjore "Jones Day" përpara se të bëhej lektor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Virxhinias. Në fillim të viteve 1970, ai shërbeu në administratat e presidentëve Richard Nixon dhe Gerald Ford, duke u emëruar prej këtij të fundit si Ndihmës Prokuror i Përgjithshëm. Më pas ka qenë lektor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Çikagos. Në vitin 1982, Presidenti Ronald Reagan e emëroi si gjyqtar të Gjykatës së Apelit të SHBA-së për Qarkun e Distriktit të Kolumbisë. Katër vjet më vonë, në vitin 1986, u emërua si gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, detyrë që e ushtroi deri në fund të jetës së tij.

[19] Bryan Andrew Garner (lindur më 17 nëntor 1958) është një studiues i së drejtës dhe leksikograf amerikan. Ai ndoqi Universitetin e Teksasit në Austin, për gjuhësi. Pas marrjes së diplomës Bachelor të Arteve, Garner hyri në Fakultetin Juridik të Universitetit të Teksasit, ku u diplomua në vitin 1984. Më pas punoi si këshilltar për gjyqtarin Thomas M. Reavley të Gjykatës së Apelit të SHBA për Qarkun e Pestë përpara se të bashkohej me studion ligjore "Carrington, Coleman, Sloman & Blumenthal" në Dallas, Teksas. Më pas ai u kthye në Fakultetin Juridik të Universitetit të Teksasit dhe u emërua drejtor i Qendrës së Teksasit/Oksfordit për Leksikografinë Ligjore. Në vitin 1990, ai u largua nga universiteti për të themeluar LawProse Inc., e cila ofron seminare mbi shkrimin e qartë, informimin dhe redaktimin për avokatët dhe gjyqtarët. Garner ka dhënë mësim në Fakultetin Juridik të Universitetit të Teksasit, Fakultetin Juridik të UC Berkeley, Fakultetin Juridik të Universitetit Teknik të Teksasit dhe në Fakultetin Juridik të Universitetit A&M të Teksasit. Që nga viti 1995, është kryeredaktori i "Black's Law Dictionary". Ai ka shkruar shumë libra, në fushën e gjuhës angleze dhe ligjore.

[20] Kelsen, Hans. *Pure theory of law.* përkthyer nga gjermanishtja nga Max Knight, The Lawbook exchange LTD, Clark, New Jersey, 2009, f. 252.

[21] Wilson, Woodrow. *Constitutional Government in the United States.*Botuar në vitin 1908, ribotuar në vitin 2011, Shtëpia Botuese "Quid Pro, LLC", f. 57.

e tij të vitit 1927, "Kushtetuta e gjallë, një shqyrtim i realiteteve dhe legjendave të ligjit tonë themelor"[22] dhe filloi të përkrahej dhe nga disa gjyqtarë të Gjykatës së Lartë të SHBA-së në atë kohë, si Oliver Wendell Holmes Jr. dhe Louis D. Brandeis.

Përsa i përket jurisprudencës gjyqësore, rezulton se rasti i parë i përdorimit të kësaj metode është vendimi i Komitetit Gjyqësor të Këshillit Privat të Kurorës[23] në çështjen *"Edwards v Canada (AG) [1930] AC 124, [1929] UKPC 86"*. Në këtë vendim, të datës 18 tetor 1929, ky organ gjyqësor, mbajti qendrimin se *"Ligji Britanik i Amerikës së Veriut mbolli në Kanada një pemë të gjallë të aftë për t'u rritur dhe zgjeruar brenda kufijve të saj natyrorë. Objekti i ligjit ishte t'i jepte një Kushtetutë Kanadasë. "Ashtu si të gjitha kushtetutat e shkruara, ajo ka qenë objekt i zhvillimit përmes përdorimit dhe sjelljeve." (Studime Kushtetuese Kanadeze, Sir Robert Borden (1922), f. 55)". Lordët nuk e konceptojnë si detyrë të këtij Bordi - sigurisht që nuk është dëshira e tyre - të shkurtojnë dispozitat e këtij Ligji me një interpretim të ngushtë dhe teknik, por përkundrazi t'i japë atij një interpretim të gjerë dhe liberal në mënyrë që dominioni në një masë të madhe, por brenda kufijve të caktuar, mund të jetë zonjë në shtëpinë e vet, pasi krahinat në një masë të madhe, por brenda disa kufijve të caktuar, janë zonjë në shtëpinë e tyre".*[24] Pikërisht përdorimi i termit "pemë e gjallë" në këtë vendim, janë fillesat e përdorimit të në praktikën gjyqësore të kësaj shkolle. Sipas kësaj qasjeje, gjykatat nëpërmjet jurisprudencës së tyre, mund të zhvillonin degët e kësaj "peme".

Në sistemin amerikan, situata në Gjykatën e Lartë, filloi të ndryshojë në favor të kësaj doktrine, me emërimin si Kryetar të kësaj Gjykate të Earl Warren, i cili në çështjen "*Trop v. Dulles*, 356 U.S. 86 (1958)", duke shkruar në emër të shumicës, u shpreh se *"Fjalët e Amendamentit të Tetë nuk janë të strikte dhe se qëllimi i tyre nuk është statik. Amendamenti duhet të nxjerrë kuptimin e tij nga standardet e evoluimit të dinjitetit dhe që specifikojnë përparimin e një shoqërie të maturuar".* Pikërisht togfjalëshi i fundit, shërben si baza kryesore e kësaj shkolle. Shoqëria ndryshon, evoluon dhe për rrjedhojë edhe vlerat e saj. Në këtë drejtim, gjykatat do të duhet të interpretojnë normat ligjore jo sipas kuptimit që ato kanë pasur në momentin e miratimit të tyre, apo kuptimin që japin fjalët që përmban teksti ligjor, por sipas vlerave që shoqëria ka në momentin e zbatimit të asaj norme ligjore mbi një mosmarrëveshje konkrete.

Ky model u përqafua shpejt edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e cila u krijua nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e vitit 1950 dhe filloi funksionimin e saj në vitin 1959. Për herë të parë, zbatimin e shprehur të kësaj metode e gjemë në çështjen *"Tyrer v. The United Kingdom"*, aplikimi nr.5856/72, datë 25 prill 1978, ku GJEDNJ, mbajti qendrimin se *"Gjykata duhet gjithashtu të kujtojë se Konventa është një instrument i gjallë i cili, siç theksoi me të drejtë Komisioni, duhet të interpretohet në dritën e kushteve të sotme".* Në këtë rast terminologjia e përdorur nga GJEDNJ për këtë metodë është ajo e "Instrumentit të gjallë" ose "Konventa e gjallë".

Në thelb të kësaj metode qëndron ideja që kuptimi tekstual dhe fillestar i normave juridike është i tillë që sjell rezultate të papranueshme për një shoqëri e cila është gjithmonë në zhvillim dhe ideja se hartuesit e kushtetutës apo akteve të tjera, në mënyrë të qëllimtë i shkruajnë normat juridike në mënyrë sa më të gjërë, për të qenë sa më fleksibël dhe për të pasur një dokument dinamik.[25] Interesante është se kjo doktrinë në Shqipëri, ka gjetur zbatim që në kohën e regjimit komunist, ku edhe normat e regjimit komunist ndryshoheshin për t'iu përshtatur "vlerave" të reja të asaj shoqërie. Më këtë qasje në fakt kuptohej sjellja e gjykatave për t'iu përshtatur dhe dënuar çdo person që nuk ishte dakort me këtë regjim.[26]

---

[22] McBain, Howard Lee. *The Living constitution, a consideration of the realities and legends of our fundamental law*. The Workers education bureau press, 1927.

[23] Emri në anglisht i këtij institucioni është *"Judicial Committee of the Privy Council"* dhe është gjykata më e lartë e apelit dhe përfundimtare për territoret jashtë Mbretërisë së Bashkuar së Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut, si edhe për territoreve që janë nën varësinë e kurorës.Ky institucion shërben me këto funksione edhe për ato vende të Commonwealth që megjithëse kanë shpallur pavarësinë kanë ruajtur të drejtën për t'u ankuar tek ky institucion. https://www.jcpc.uk/.

[24] https://www.bailii.org/uk/cases/UKPC/1929/1929_86(image1).pdf

[25] Chawawa, Morgan. *The United States Constitution and the Bible, Conflict or Compromise.* WestBow Press, Bloomfield. 2019.

[26] Elezi, Ismet. *Zhvillimi i legjislacionit penal në Shqipëri.* Tiranë 1997, f. 96, 98.

4. Raporti i shkollës së interpretimit "evolutiv/normë-krijues/pragmatist" me parimet kushtetuese

Justifikimi i përdorimit të shkollës së "interpretimit evolutiv/normë-krijues/pragmatist", paraqet probleme në raport me parimet dhe standardet kushtetuese. Shqipëria, me hartimin dhe miratimin e Kushtetutës së vitit 1998, zgjodhi formën parlamentare të qeverisjes, siç del qartë nga formulimi i nenit 1, pika 1 e Kushtetutës.[27] Bazuar në këtë qasje, është prerogativë kushtetuese e Kuvendit, si organ ligjvënës, që duke zbatuar nenet 81 – 85 dhe 177 të Kushtetutës, të bëjë ndryshime kushtetuese dhe ligjore në vend. Qartazi në këto parashikime, si Gjykata Kushtetuese ashtu edhe pushteti gjyqësor, nuk gjejnë vend.

Nëse për Gjykatën Kushtetuese, nuk gjendet asnjë normë, e cila do të mund të justifikonte ndonjë veprimtari normë krijuese prej saj, për Gjykatën e Lartë, dikush edhe mund të argumentojë se kjo bazohet në nenin 141, pika 1 e Kushtetutës, sipas të cilit *"Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit".* Ndërkohë që termi "njëhsim" është i kuptueshëm pasi lidhet me njehsimin e praktikave të ndryshme gjyqësore me qëllim garantimin e parimit të barazisë dhe sigurisë juridike në vend, për termin tjetër, "zhvillimin" e praktikës gjyqësore, mund të pretendohet se mbi këtë bazë Gjykata e Lartë, mund të realizojë edhe "interpretim evolutiv". Por në fakt deri më sot, në asnjë vendim të Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës së Lartë, nuk jepet një kuptim i tillë i këtij parashikimi kushtetues. Për më tepër termi "zhvillim" ka kuptime të ndryshme, siç mund të jetë edhe zhvillimi i një ore mësimore, apo zhvillimi i një funksioni.[28] Nga ana tjetër Gjykata Kushtetuese, në interpretimin e normave kushtetuese, ka mbajtur qëndrimin se *"Gjykata rithekson se çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo, për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik. Natyra e Kushtetutës, koncepti i kushtetutshmërisë, nënkupton që Kushtetuta nuk mund të ketë kontradikta të brendshme. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete".*[29] Për rrjedhojë, ky term nuk mundet që të shihet i shkëputur nga neni 1, pika 1 e Kushtetutës dhe dispozitat e tjera që do të trajtohen në vijim. Siç e kemi përmendur më sipër, shkolla "tekstualiste" përfshin dhjetra rregulla për interpretimin e normave juridike në përputhje me atë se çfarë është shkruar në një tekst ligjor. Për këtë arsye, termi "zhvillim" duhet kuptuar në përpunimin dhe zbatimin e këtyre rregullave mbi mosmarrëveshjet konkrete. Madje siç do të përmendet më poshtë, vetë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e kanë përjashtuar mundësinë që nëpërmjet zhvillimit të së drejtës të krijohen norma.

Forma e qeverisjes parlamentare është e lidhur edhe në mënyrë të natyrshme edhe me nenin 2, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës. Ligji themelor i vendit përcakton qartësisht se *"Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit"* dhe se *"Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti"*. Këto parashikime kushtetuese, janë mjaft domethënëse, pasi tregon që sovran mbetet populli i cili ka dy rrugë për ta ushtruar këtë sovranitet. Përsa i përket rastit të parë, ushtrimit nëpërmjet përfaqësuesve, ky është plotësim i formës së qeverisjes parlementare që parashikon Kushtetuta, në nenin 1, pika 1 të sajin. Për të plotësuar këtë formë ushtrimi të sovranitetit, vlen edhe parashikimi i nenit 70, pika 1 e Kushtetutës, sipas të cilit *"Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues".* Pra, është e qartë që përfaqësues i sovranit, është deputeti dhe jo funksionarë të tjerë, përfshirë edhe gjyqtarët. Zgjedhësit, nëse nuk janë dakort me mënyrën e sjelljes, votimit apo të veprimit të një deputeti, mund të votojnë kundër tij në zgjedhjet e ardhshme. Këtu përfshihet mundësia për të votuar kundër, nëse zgjedhësit nuk janë dakort me një ligj të miratuar nga deputetët që i përfaqësojnë. Zgjedhësit, duke votuar kundër një deputeti në zgjedhjet parlamentare, nuk kanë nevojë që të justifikojnë asnjë mungesë performance apo shkelje disiplinore nga ana e deputetit që ata nuk duan më të zgjidhet. Kjo mundësi veprimi, është edhe thelbi i demokracisë.

Në këtë kundërt, zgjedhësit, jo vetëm që nuk kanë asnjë mundësi të zgjedhin gjyqtarët e tyre, të cilët emërohen sipas një procedure kushtetuese, por nga ana tjetër, nëse këta gjyqtarë krijojnë norma të reja, zgjedhësit nuk mund

[27] Kushtetuta, neni 1, pika 1: *Shqipëria është republikë parlamentare*.
[28] *"Fjalori i Gjuhës Shqipe"*, botim Akademisë së Shkencave - Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 2006.
[29] Vendimi nr.2, datë 19.1.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

të votojnë për t'i hequr ato. Kjo sepse Kushtetuta u garanton gjyqtarëve imunitetin,[30] pagën dhe privilegjet,[31] raste e mbarimit të mandatit,[32] rastet e përgjegjësisë disiplinore,[33] si dhe pavarësinë e tyre.[34] Pra, duke qenë se gjyqtarët janë të pa zgjedhur në mënyrë demokratike, duke qenë se nuk mbajnë përgjegjësi politike dhe duke qenë se zgjedhësit nuk kanë asnjë të drejtë që t'i largojnë gjyqtarët, qartazi rezulton që nuk është demokratike që gjyqtarët të vendosin norma të reja detyruese për popullsinë.

Përsa i përket, rrugës së dytë të ushtrimit të sovranitetit popullor, atë drejtëpërsëdrejti, rezulton se kjo mundësi nuk është e pakufizuar dhe ushtrohet sipas kushteve dhe mënyrës së parashikuara nga nenet 150 – 152 dhe 177, pikat 4 dhe 5 të Kushtetutës. Madje vetë Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qendrimin se *"Gjykata thekson se në një shtet kushtetues, ideja e një pushteti, i cili nuk përballet me detyrime dhe kufizime që burojnë nga Kushtetuta, nuk mund të pranohet. Sovraniteti i popullit, i vendosur në kuadrin e një sistemi kushtetues e ligjor, nuk mund të ngatërrohet me pushtetin themelor dhe kërkesa për të ndjekur disa procedura të veçanta gjatë ushtrimit të tij është tërësisht në përputhje me sovranitetin popullor. Kushtetuta e Shqipërisë në mënyrë të qartë e ka lidhur ushtrimin e sovranitetit popullor me rregulla të veçanta. Është e vërtetë se në përputhje me nenin 2, pika 1 e Kushtetutës "sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i takon popullit"."* Pra, në këtë kontekst, kur vetë pushteti popullor, është i kufizuar, është e pakuptimtë që të pretendohet se gjyqtarët nuk kanë asnjë kufizim në krijimin e normave, përveç bindjes së tyre te brendshme.

Me tej në Kushtetutë, neni 4, pika 1, parashikon se *"E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit"*. Ky formulim i rëndësishëm, i cili na jep kuptimin e shtetit të së drejtës, tregon që organet kushtetuese dhe publike veprojnë vetëm mbi bazën e një autorizimi kushtetues dhe/apo ligjor të cilat përbëjnë edhe bazën e kufizimit të tyre të veprimtarisë së tyre. Ky parim mëshiron gjithashtu edhe parimin e rëndësishëm demokratik të qeverisjes së një shoqërie nga ligjet dhe jo nga vullneti personal i njeriut.

Bazuar nga sa më sipër, është e nevojshme të analizojmë nëse doktrina e "interpretimit evolutiv", përmbush këto kërkesa. Nëse i referohemi rasteve të Komitetit Gjyqësor të Këshillit Privat të Kurorës, cituar më sipër, rezulton se pranohet që doktrina e "pemës së gjallë" ka disa kufizime, por si ky vendim, ashtu edhe të tjerë, nuk na tregojnë nëse ka kritere objektive për ushtrimin e metodës evolutive të së drejtës, apo nëse ka kufizime për ushtrimin e kësaj metode dhe cilat janë konkretisht. Përsa i përket Gjykatës së Lartë të SHBA-së (kur ka përdorur metodën evolutive të interpretimit) dhe GJEDNJ-së, në jurisprudencën e tyre nuk trajtohen kritere objektive apo kufizime në përdorimin e kësaj metode.

Në Shqipëri, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, është shprehur se *"Gjyqtari nuk mund të shmanget nga roli krijues gjatë interpretimit të ligjit, pasi, në rrethana të caktuara, e drejta mund të ekzistojë tej normave pozitive që nxjerr shteti, e drejtë që e ka burimin e saj në rendin juridik kushtetues si një tërësi logjike dhe që funksionon si një korrigjuese e normave të shkruara. Gjykatat kanë detyrimin ta gjejnë këtë të drejtë dhe ta bëjnë atë realitet në çështjet që kanë për shqyrtim. Kushtetuta nuk e kufizon gjyqtarin në zbatimin strikt të vullnetit legjislativ në çështjen që i është paraqitur. Funksioni gjyqësor presupozon se nuk ekziston asnjë boshllëk në rendin juridik pozitiv, një kusht që mund të jetë i dëshirueshëm në interes të sigurisë juridike, por që në praktikë është i paarritshëm. Detyra e gjyqtarit nuk kufizohet në interpretimin dhe zbatimin e vendimeve legjislative. Ai mund të jetë i detyruar të marrë një vendim në pajtim me vlerat kushtetuese, pra të ndriçojë dhe të zbatojë në vendimet e tij ato koncepte të vlerave që janë pjesë e pandarë e rendit juridik kushtetues, por që në tekstet e ligjeve të shkruara nuk janë shprehur qartë apo në mënyrë të plotë. Në kryerjen e kësaj detyre, gjyqtari duhet të ruhet nga arbitrariteti. Vendimi i tij duhet të bazohet në një arsyetim racional. Ai duhet të bëjë të qartë që ligji i shkruar nuk arrin ta përmbushë qëllimin e vet për të ofruar një zgjidhje të drejtë për problemin ligjor në shqyrtim. Është*

[30] Kushtetuta, neni 137.
[31] Kushtetuta, neni 138.
[32] Kushtetuta, neni 139.
[33] Kushtetuta, neni 140.
[34] Kushtetuta, neni 145.

pikërisht vendimi i gjyqtarit ai që e mbush këtë hapësirë boshe, duke përdorur arsyen e shëndoshë dhe konceptet e përgjithshme të komunitetit mbi drejtësinë".[35]

Nga ky pasazh, rezulton se arsyet që Gjykata e Lartë, justifikon pushtetin e saj për të krijuar norma, bazohet në disa nocione jo objektive, si tek një e drejtë që nuk është e shkruar por që buron nga rendi kushtetues. Kjo e drejtë mund të zbulohet vetëm nga gjyqtarët, të cilët mund ta përdorin për të korigjuar normat e shkuara, pasi funksioni i gjyqtarit nuk kufizohet vetëm në interpretimin e normave juridike. Megjithë këtë deklarim, pasazhi i mësipërm, por edhe pjesë të tjera të arsyetimit të Gjykatës së Lartë, nuk tregojnë apo argumentojnë se kush e ka hartuar, votuar dhe miratuar, këtë të drejtë të pashkruar, tej normave pozitive që nxjerr shteti? Pra, ky sistem që ekziston jashtë së drejtës pozitive, nga e ka legjitimitetin e saj demokratik? Këto pyetje, nuk marrin asnjë përgjigje, si në këtë vendim, apo në vendime të tjera. Duke analizuar këto shkaqe justifikuese për t'i dhënë gjykatave një pushtet për të krijuar norma, rezulton se ato janë fjalë me natyrë të përgjithshme dhe nuk tregojnë asgjë konkrete. Kjo do të thotë që individualizimi i këtyre rasteve mbetet në gjykimin personal të gjyqtarit, ku vetëm ai ka aftësinë për të zbuluar vlera dhe norma të pashkruara, por që "gjenden" në rendin kushtetues.

Qasja e mësipërme e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mesa duket nuk është pranuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili në një tjetër rast, ndër të tjera, ka arsyetuar se *"87. Sikurse mund të konkludohet, edhe pse reminishencë e kodeve të mëparshme, neni 168 i KC, përmban një ometim të qartë legjislativ, për shkak se legjislatori nuk ka parashikuar të gjithë rrethin e fakteve juridike të cilët mund të qëndrojnë në themel të parashkrimit fitues me titull. Kjo dispozitë ka përjashtuar apriori të gjitha format e tjera të kalimit të pronësisë me ligj të veçantë. Mëtimi është i tillë që nuk mund të shërohet me interpretim të zgjeruar nga ana e gjyqtarit të juridiksionit të zakonshëm, në të kundërt ai do të bënte një normë të re juridike, duke e zgjeruar tej parashikimit të ligjit kategorinë e titujve të pronësisë, të cilat ky i fundit shprehimisht i ka përjashtuar. Kjo do të vinte në kundërshtim me nenin 145/1 të Kushtetutës sipas të cilit gjykata ka detyrimin të japë drejtësi dhe të zgjidhë në përputhje me ligjin çështjet e shtruara para tij".*[36]

Përsa i përket kufizimeve në ushtrimin e këtij pushteti "evolutiv/normë-krijues", Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë përmend vetëm faktin që gjyqtari nuk duhet të jetë a) arbitrar; b) vendimi të bazohet në arsyetim racional duke treguar që ligji nuk përmbush qëllimin për një zgjidhje të drejtë; c) përdorimi i arsyeve të shëndosha dhe ç) përdorimi i koncepteve të komunitetit mbi drejtësinë. Këto kritere apo kërkesa janë përsëri me terma të përgjithshme, pasi duke qenë se gjyqtari vendos vetë për çështjen, atij në çdo rast vendimi nuk do t'i duket arbitrar. Gjithashtu edhe termat arsyetim racional dhe i shëndoshë, janë terma shumë të përgjithshëm. Këto dy kritere duket sikur bazohen në aftësinë e gjyqtarëve për të shkruar vendimin e tyre sa më "bukur", por një arsyetim i mirë nuk do të thotë që vendimi është i bazuar dhe i drejtë.

Për më tëpër në këtë rast Gjykata e Lartë, nuk ka marrë në konsideratë dhe jurisprudencën e saj, e cila ka mbajtur qëndrimin e qartë se "*...Kolegji Penal sjell në vëmendje të gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimuar faktin se, subjekteve të procedimit pa përjashtuar edhe Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, nuk u njihet e drejta e vlerësimit të operativitetit apo jo dhe, aq më pak, e drejta e oportunitetit të zbatimit ose jo të normave procedurale në pergjithesi,..."*[37] Thelbi i këtij arsyetimi në këtë rast është që gjykatat, nuk kanë mundësi dhe të drejtë që të vlerësojnë racionalitetin dhe oportunitetin e ligjeve, apo siç thotë Kolegji Administrativ, të tregojë që ligji nuk përmbush qëllimin për një zgjidhje të drejtë. Ato janë thjesht të detyruara që t'i zbatojnë.

Kriteri i fundit që përmendet, konceptet e përgjithshme të komunitetit mbi drejtësinë, është jashtëzakonisht i paqartë. Gjyqtarët në formimin e tyre, nuk marrin formim filozofik, sociologjik, psikologjik, statistikor apo empirik, të cilëvë do t'u japin aftësinë që të vlerësojnë "konceptet e komunitetit". Kjo do të thotë që ato bazohen në gjykimin e tyre personal se çfarë është apo jo e "drejtë" Për rrjedhojë dukshëm, shkolla e "interpretimit evolutiv/normë-krijues/pragmatist", nuk bazohet në nocionin e qeverisjes së shoqërisë nga ligjet, por bazohet në nocionin e qeverisjes së shoqërisë nga vullneti personal i njerëzve. Qartazi kjo qasje nuk bazohet në rendin kushtetues dhe në demokracinë.

---

[35] Vendimi nr.00-2022-1513 (186), datë 12.5.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
[36] Vendimi njëhsues nr.00-2022-4596 (393), datë 26.10.2022 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
[37] Vendimi nr.61, datë 6.2.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Një tjetër argument që mund të jepet në "favor" të metodës "evolutive" të së drejtës, është edhe mënyra se si është formuluar, neni 1, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, dispozitë e cila parashikon se "Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë". Kjo mënyrë e formuluari, mund të interpretohet sikur, gjykatat në mungesë të një norme ligjore, duhet ta "krijojnë" vetë atë. Është e kuptueshme që kjo qasje nuk ka një bazë kushtetuese, pasi autorizimi për të prodhuar, krijuar apo miratuar norma, jepet nga Kushtetuta dhe jo nga ligji. Gjithashtu, mungesa e një norme juridike, nuk do të thotë që gjykatat duhet ta "gjejnë" apo "krijojnë" këtë normë. Gjykatat shumë mirë mund të vendosin rrëzimin e kërkesës apo kërkesëpadisë, pasi e drejta e pretenduar nuk mbështetet në një normë të së drejtës pozitive, siç me të drejtë është shprehur Gjykata e Lartë, në një rast, ku ka mbajtur qëndrimin se *"38. Kolegji vlerëson se në rastin kur e drejta e pretenduar të mbrohet nëpërmjet procesit gjyqësor nuk është parashikuar në një normë pozitive të së drejtës, me pasojë pushimin e gjykimit, duhet të dallohet nga rasti kur një pretendim nuk gjen mbështetje ligjore me pasojë rrëzimin e kërkesëpadisë. 39. Në rastin e një ometimi absolut të ligjit, atëherë kur pretendimi nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore të rendit juridik, pra nuk ekziston e drejta pozitive e pretenduar që mbështet kërkimet e kërkesëpadisë, gjykata do të duhet të vendosë pushimin e gjykimit, ndodhur para një padie që nuk mund të ngrihet"*.[38] Siç mund të konstatohet me lehtësi, gjykatat në zbatim të nenit 1, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile janë të autorizuara të disponojnë me pushimin e apo rrëzimin e kërkesëpadisë dhe kjo mundësi vendimmarrje nuk do të thotë që në këtë rast gjykata ka refuzuar të shqyrtojë dhe të japë vendim. Përkundrazi në këtë rast vendimi është dhënë dhe çështja merr zgjidhje, megjithëse jo në favor të kërkuesit apo kërkesëpadisë.

Referenca që mund të bëhet ne veprimtarinë e GJEDNJ-së e cila përmend të ashtuquajturën ligjbërje gjyqësore,[39] një tjetër term ky për doktrinën e "interpretimit evolutiv", jam i mendimit që nuk duhet të merret për bazë. Duke qenë se hapësira e këtij punimi nuk lejon vlerësimin edhe të jurisprudencës së GJEDNJ në këtë aspekt, po kufizohemi në disa konstatime.

Së pari, GJEDNJ interpreton dhe zbaton KEDNJ, por kjo nuk duhet të pengojë gjykatat kombëtare që të interpretojnë dhe zbatojnë të drejtën e brendshme në përputhje me parimet kushtetuese dhe duke respektuar demokracinë.

Së dyti, shumë individë që e mbështesin GJEDNJ, për shkak të natyrës së ndryshueshme jurisprudencës së saj, zhgënjehen shpesh prej saj. Kështu mund të përmendim, qendrimin në lidhje me çështjen kthimit dhe të kompensimit të pronave, ku një autor, për çështjen "Agim Beshiri dhe 11 të tjerë kundër Shqipërisë",[40] përmend deri në shtatë zhgënjime.[41] Një tjetër zhgënjim duket se është pësuar edhe për mënyrën se si GJEDNJ, vendosi në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku pretendohet se në këto raste GJENDJ ka vendosur kundër të gjithë precedentëve të saj të mëparshëm.[42] Një tjetër autore është shprehur në lidhje me mënyrën e gjykimit të çështjeve për detyrime ushqimore nga ana e GJENDJ-së.[43] Nëse kalojmë në Mbretërinë e Bashkuar, kryetarja e parë grua e Gjykatës së Lartë të këtij vendi, Baronesha Brenda Hale e Richmond, e cila ka pasur gjithmonë një prirje pozitive ndaj GJEDNJ dhe doktrinës së saj, në një moment të caktuar u shpreh se *"Si një mbështetës i Konventës dhe i punës së Gjykatës, lutja ime për ta është të pranojnë se ka disa kufij natyrorë për*

[38] Vendimi nr.00-2023-1937 (136), datë 15.3.2023 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

[39] Kalaja, Florjan. *Refleksione mbi veprën penale të fshehjes dhe asgjesimit të kufomës.* Botuar në revistën "Studime juridike", nr.1, viti 2023, botim i Fakultetit të Drejtësisë të Univeristetit të Tiranës, f. 45-51.

[40] GJEDNJ, Dhoma e dytë, "Agim Beshiri dhe 11 të tjerë kundër Shqipërisë", aplikimi nr.29026/06, datë 17.3.2020.

[41] Kalaja, Florjan. *Strasburg disappointments,* marrë nga adresa e internetit. https://www.academia.edu/44597149/STRASBURG_DISAPPOINTMENTS

[42] Bianku, Ledi. *Kramer kundër Kramer. A është reforma në drejtësi në përputhje me standardet evropiane?* Botuar në "Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë – Vështrime të studiuesve të së drejtës në diasporë", botuar nën kujdesin e Prof.Dr. Aurela Anastasi (Akad) dhe Prof.Dr. Shaban Sinani (Akad), nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2023, f. 143-180.

[43] Anastasi, Aurela.*Çështje të ekzekutimit te vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve. Përgjegjësitë institucionale dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.* Botuar në Revistën "Jeta juridike", botim i Shkollës së Magjistraturës, nr.1, viti 2016.

rritjen dhe zhvillimin e pemës së gjallë. ... Përndryshe, kam frikë se vendimet e tyre dhe ato të gjykatave kombëtare që i pasojnë ato, do të sfidohen gjithnjë e më shumë nga qeveritë dhe parlamentet tona. Ky është një fenomen shumë i rrallë për momentin dhe mund të mbetet i tillë për shumë kohë. ... Ata "duhet të kërkojnë të arrijnë një ekuilibër të drejtë, midis vlerave universale të lirisë dhe barazisë të mishëruara në Konventë, dhe zgjedhjeve të veçanta të bëra nga parlamentet e shteteve anëtare të zgjedhura në mënyrë demokratike".[44] Kjo "profeci", duket se u realizua nga refuzimi që bëri Parlamenti i Zvicrës, ndaj vendimit të GJEDNJ,[45] në çështje mjedisore.[46]

Një tjetër problem për GJEDNJ, mbeten dhe disa shqetësime të ngritura nga një organizatë jofitimprurëse e cila duke analizuar veprimtarinë e saj, ka konstatuar lidhje midis gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe OJF të ndryshme, të shtrira në kohë, të cilat paraqiten rregullisht para GJEDNJ për çështje të ndryshme.[47]

Këto "zhgënjime", të cilat me të drejtë kritikohen, në fakt janë pasojë e mënyrës si vepron doktrina e "interpretimit evolutiv/normë-krijues/pragmatist", e cila bazohet në bindjen e brendshme të gjyqtarëve se si kanë evoluar parimet, vlerat dhe standardet e një shoqërie. Gjyqtarët ndërkombëtarë dhe kombëtarë, që bazuar në këto doktrinë, ndryshojnë apo miratojnë norma të reja ligjore, pretendojnë se vendimet e tyre duhet të respektohen nga vetë gjykata në të ardhmen. Megjithëse në përgjithësi kjo ndodh, nuk mbetet një rregull i fortë. Asgjë nuk e pengon apo detyron gjyqtarët e tjerë që në të ardhmen të pretendojnë se përsëri parimet, vlerat dhe standardet e një shoqërie, kanë ndryshuar përsëri dhe të injorojnë precedentët e mëparshëm. Jemi të mendimit që me këtë qasje duhet të shihen edhe ndryshimet e jurisprudencës së GJEDNJ por edhe të gjykatave kombëtare.

Pikërisht, bazuar në këtë dobësi të doktrinës së "interpretimit evolutiv", Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë së fundmi duket sikur e kanë mbyllur këtë debat për gjykatat e zakonshme në Shqipëri, kur kanë konkluduar se *"Pikërisht, krijimi dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore, nëpërmjet zgjidhjes së çështjeve gjyqësore e dallon Gjykatën e Lartë nga pushteti normativ i ligjvënësit, i cili sa herë vlerëson mospërshtatjen e tij me situatën apo rrethanat e krijuara, ia nënshtron ligjin procedurës parlamentare për ndryshim. Detyrë e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është të respektojë kufijtë kushtetues të interpretimit gjyqësor të normës juridike, duke mos marrë kompetencat e ligjvënësit, por duke kryer një zhvillim gjyqësor të së drejtës".*[48]

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, janë autoriteti më i lartë gjyqësor në vend dhe qartazi janë poziconuar në favor të doktrinës "tekstualiste" të së drejtës. Në këtë aspekt, të gjitha vendimet e kolegjeve të thjeshta të Gjykatës së Lartë që kanë ngritur pretendime për të bërë interpretim evolutiv dhe krijuar norma, nuk do të duhet që të merren në konsideratë, mbas këtij vendimi të Kolegjeve të Bashkuara të këtij institucioni.

5. "Problematikat" me doktrinën e "interpretimit evolutiv" në Shqipëri dhe pasojat e saj

Përgjithësisht tentohet, që metodën e "interpretimit evolutiv" ta paraqesin si më të duhurën dhe më të mirën për shoqërinë, por zbatimi i kësaj doktrine, mund të sjellë edhe kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore, si edhe të sjellë probleme edhe për vetë rendin kushtetues në vend. Siç e përmendëm edhe më sipër, zbatimi i kësaj doktrine, në vendin tonë fillon që në kohën e regjimit komunist dhe për rrjedhojë, jemi të mendimit që ai regjim vetëm "pozitiv" nuk mund të konsiderohet.

Gjithashtu, siç do të ilustrohet me disa shembuj, rezulton që përdorimi i metodave të kësaj shkolle, ka qenë cënues për të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Në këtë rast nuk mundet që të nxirret si justifikim që kur rezultati është "pozitiv" për të drejtat dhe liritë themelore, vetëm atëherë mund të konsiderohet se janë përdorur

---

[44] https://www.telegraph.co.uk/news/uknews/Law-and-order/8580795/Ëe-need-to-control-the-spread-of-human-rights-Supreme-Court-judge-says.html

[45] GJEDNJ, Dhoma e Madhe, çështja "Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerë kundër Zvicrës", aplikimi nr.53600/20, datë 9.4.2024.

[46] https://www.bbc.com/news/articles/cl55ggjqvx7o#:~:text=However%20Switzerland's%20parliament%20voted%20on,an%20effective%20climate%20change%20strategy

[47] Raporti "NGOs and the Judges of the ECHR", studim i "European Center for Law and Justice", 2020, marrë nga adresa: https://eclj.org/ngos-and-the-judges-of-the-echr Raporti "The Impartiality of the ECHR – Concerns and Recommendations", studim i "European Center for Law and Justice", 2023, marrë nga adresa: https://eclj.org/echr-impartiality-concerns-and-recommendations

[48] Vendimi nr.1, datë 28.10.2022 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

rregullat interpretuese të kësaj shkolle dhe kur kemi rezultate "negative", atëherë jemi përpara keqinterpretimit të normave juridike apo zbatimit të gabuar të tyre. Në fakt, në të dyja këto raste, zbatohet i njëjti parim, largimi nga teksti i shkruar i normës juridike. Për rrjedhojë si shkolla "evolutive/normë-krijuese/pragmatiste", apo "keqinterpretimi/zbatimi i gabuar i normës", janë në thelb dhe substancialisht e njëjta gjë.

Lidhur me problematikat që paraqiten me zbatimin e kësaj praktike në Shqipëri, në vijim të kësaj nënçështjeje do të trajtojmë disa raste praktike të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Si rast të parë, të cenimit të të drejtave kushtetuese, do të trajtojmë rastin e së drejtës për ankim të personave që gjykohen në proceset penale. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke ndryshuar praktikën e tyre gjyqësore,[49] vendosën që avokatët e caktuar kryesisht, ose nga familjarët, e personave që po gjykohen në mungesë, nuk legjitimohen që të paraqesin ankim, kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë.[50] Ky konkluzion bazohej në parashikimet e neneve 48[51] dhe 410[52] të Kodit të Procedurës Penale, nga të cilat dilte që ankimi mund të bëhej nga vetë i pandehurit ose nga mbrojtësi i caktuar prej tij me akt përfaqësimi. Përjashtimisht dispozita parashikonte që mbrojtësi mund të caktohej nga të afërm kur personi ishte i *"ndaluar, i arrestuar ose i dënuar me burgim* dhe vetëm *derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjidhjen".* Siç mund të konstatohet këto dispozita nuk bëjne fjalë për personat që ndodhen në arrati dhe që gjykohen në mungesë. Pavarësisht kësaj, Gjykata Kushtetuese, këtë qasje "tekstuale" të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, e konsideroi si të papajtueshme me Kushtetutën, pasi cënonte të drejtën për akses dhe ankim.[53] Ajo në thelb shtoi mundësinë që të afërmit të mund të lëshojnë prokurë edhe për personat që gjykohen në mungesë për shkak se ndodhen në arrati, mundësi kjo që nuk parashikohej nga Kodi i Procedurës Penale. Pra, në thelb Gjykata Kushtetuese bëri një interpretim evolutiv, duke krijuar një normë të re ligjore.

Në rigjykim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, inistuan në qendrimin e tyre,[54] por vendimmarrja e tyre u shfuqizua përsëri nga Gjykata Kushtetuese.[55] Më vonë, në favor të qasjes së Gjykatës së Lartë, ndërhyn edhe ligjvënësi, i cili, nëpërmjet ndryshimeve ligjore, përcaktoi që "*Në nenin 410, në pikën 2 pas fjalës "lëshuar" shtohen fjalët "nga i pandehuri"."*[56] Por, edhe ky vullnet i ligjvënësit u konsiderua si antikushtetues nga ana e Gjykatës Kushtetuese.[57]

Kjo qasje e Gjykatës Kushtetuese krijoi probleme, pasi avokatët e caktuar kryesisht ose nga familjarët për personat që gjykoheshin në mungesë, pasi ndodheshin në arrati, mund të realizonin dhe një mbrojtje fiktive dhe formale, e cila nëpërmjet ankimit dhe rekursit shteronte të gjitha mjetet gjyqësore në Shqipëri. Kjo situatë duhet të jetë shfaqur si realisht problematike, që e detyroi Gjykatën e Lartë të insistonte përsëri në qendrimin e saj të hershëm dhe të sfidonte vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, por kësaj here në një formë tjetër, duke kërkuar shfuqizimin e këtyre dispozitave si antikushtetuese, pasi cënonin të drejtën për ankim dhe të mbrojtjes së të

[49] Vendimi nr.47, datë 28.1.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
[50] Vendimi nr.386, datë 29.7.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
[51] Kodi i Procedurës Penale, neni 48 (siç ishte miratuar në vitin 1995): *1. I pandehuri ka të drejtë të zgjedhë jo më shumë se dy mbrojtës. 2. Zgjedhja bëhet me deklarim të bërë para organit procedues ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomande. 3. Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2.*
[52] Kodi i Procedurës Penale, neni 410 (siç ishte miratuar në vitin 1995): *1. I pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Kujdestari i të pandehurit mund të bëjë çdo ankim që i takon të pandehurit. 2. Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji. 3. I pandehuri mund ta tërheqë ankimin e bërë nga mbrojtësi i tij, por kur ai nuk ka zotësinë juridike për të vepruar duhet të merret edhe pëlqimi i kujdestarit. 4. Ankimi i të pandehurit kundër dënimit penal ose pafajësisë i shtrin efektet e veta edhe në pjesën e vendimit që cakton detyrimin për kthimin e pasurisë, shpërblimin e dëmit dhe pagimin e shpenzimeve procedurale.*
[53] Vendimi nr.17, datë 17.4.2000 i Gjykatës Kushtetuese.
[54] Vendimi nr.371, datë 27.10.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
[55] Vendimi nr.5, datë 7.2.2001 i Gjykatës Kushtetuese.
[56] Ligj nr.8813, datë 13.6.2002 Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", neni 50.
[57] Vendimi nr.15, datë 17.4.2003 i Gjykatës Kushtetuese.

gjykuarve.

Gjykata Kushtetuese, duke kuptuar situatën që kishte krijuar, vendosi të ndryshojë qendrimin e saj, por këtë e bëri në një formë tjetër. Kështu, në fillim Gjykata Kushtetuese, pranoi se po ndryshonte jurisprudencën e saj, por për shkak të jurisprudencës së GJEDNJ-së. Më pas, mbas një analize të gjatë Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se të afërmit mund të caktojnë mbrojtës, vetëm nëse kanë kontakte dhe kanë komunikuar me të pandehurin dhe janë duke vepruar për të përmbushur vullnetin e të pandehurit. E njëjta llogjikë ndiqej edhe për ushtrimin e së drejtës së ankimit.[58]

Siç mund të konstatohet, precedenti i vendosur në vitin 2000, u konsiderua si jo i drejtë dhe u ndryshuar në vitin 2010, por kjo shtrirje e gjatë kohore prej 10 vjetësh mund të ketë cënuar të drejtën për t'u mbrojtur dhe për ankim të një numri të konsiderueshëm subjektësh të cilët ishin gjykuar në mungesë. Kjo edhe për shkak se Gjykata Kushtetuese, mbajti qendrimin se ndryshimi i jurisprudencës së saj, nuk prekte vendimet e marra nga gjykatat e zakonshme, që ishin bazuar në jurisprudencën e vjetër të kësaj gjykate.[59]

Në një tjetër rast, që ka të bëjë me veprën penale të falsifikimit, një person u dënua, sepse në jetëshkrimin e tij, kërkesën për aplikim dhe në përgjigjet e dhëna përpara organeve publike, që kishin vlerësuar kandidaturën e tij, kishte fshehur faktin që nga sistemi gjyqësor ishte larguar për shkak se ishte shkarkuar dhe nuk ishte larguar me dorëheqje. Ky person më pas u emërua si gjyqtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Më vonë, një nga subjektet që u shkarkua nga ky Kolegj, bëri kallzim penal, në lidhje me këtë fakt.

Vepra penale për të cilën prokuroria ngriti akuzën në gjykatë, bazohej në nenin 186 i Kodit Penal, titulluar "Falsifikimi i dokumentave". Në këtë rast, një debat shtrohej rreth pyetjes, nëse jetëshkrimi dhe kërkesa për aplikim, si edhe fshehja e të vërtetës gjatë intervistimit të këtij personi, përbënin apo jo "dokument" sipas kësaj dispozite.

Gjykata e Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar[60] si edhe Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar,[61] mbajtën qendrimin se në këtë rast jemi përpara falsifikimit intelektual dhe për rrjedhojë personi mban përgjegjësi penale. E investuar mbi rekursin e të pandehurit, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit, duke u mbështetur në një tjetër vendim të saj të mëparshëm,[62] por Gjykata Kushtetuese, u shpreh se në këtë rast ishte cënuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe Gjykata e Lartë duhej të mbante qendrim të shprehur në lidhje me pretendimin e dënimit të personit pa ligj, pra për një vepër penale që nuk parashikohej nga ligji.[63]

Në rigjykim, Gjykata e Lartë vendosi përsëri lënien në fuqi të vendimeve të gjykatave më të ulta, por duke arsyetuar gjerësisht përse në këtë rast ndodheshim përballë një "falsifikimi intelektual".[64]

Jam i mendimit që në këtë rast individi nuk është dënuar në bazë të një norme konkrete ligjore dhe gjykatat, mesa duket, kanë zbatuar një interpretim të nenit 186 të Kodit Penal, i cili nuk mbështetet në tekstin ligjor të kësaj dispozite. Kjo ka sjellë që i individi të dënohet për veprime që nuk ishin të parashikueshme si vepër penale, në kohën e kryerjes së saj. Përkundrazi, gjykatat kanë bërë një interpretim të zgjeruar të normës deri në ekstrem duke realizuar në thelb zbatimin e ligjit penal me analogji.

---

[58] Vendimi nr. 30, datë 17.6.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

[59] Vendimi nr.84, datë 12.7.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Kërkesa konkrete drejtuar Gjykatës me pretendimin, midis të tjerash, për cenimin e të drejtës së mbrojtjes, si një nga komponentët e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, është paraqitur pas datës 30.06.2010, e cila është data e hyrjes në fuqi të vendimit të ri interpretues, mbi bazën e të cilit janë përcaktuar standardet e reja dhe i është dhënë një kuptim i ndryshëm nenit 410/2 të KPP-së. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, me të drejtë, kanë pranuar mbrojtjen e interesave të kërkuesit, të deklaruar në mungesë, nga mbrojtësi i caktuar nga familjarët. Vendimet e këtyre gjykatave kanë qenë në përputhje me interpretimin që Gjykata i ka bërë përmbajtjes së nenit 410/2 të KPP-së, në lidhje me mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët, përmes vendimeve të saj interpretuese përpara vitit 2010, ndaj mbi bazën e këtij arsyetimi, Kolegji e vlerëson këtë pretendim të kërkuesit haptazi të pambështetur.*

[60] Vendimi nr.32, datë 1.12.2020 i Gjykatës Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

[61] Vendimi nr.5, datë 8.3.2021 i Gjykatë së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

[62] Vendimi nr.00-2021-670 (63), datë 26.10.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[63] Vendimi nr.21, datë 26.9.2022 i Gjykatës Kushtetuese.

[64] Vendimi nr.00-2023-406 (76), datë 21.3.2023 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Në vendimin e saj, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i është referuar, Fjalorit të Gjuhës Shqipe, dhe për të nxjerrë kuptimin e termit "falsifikim", por ky citim i Fjalorit, është i cunguar pasi nuk nxjerr nga "Fjalori" edhe kuptimin e termit "dokument",[65] nga ku del se përdorimi i zakonshëm i fjalës "dokument" siç e ka përkufizuar gjuha shqipe, ka të bëjë me akte zyrtare, procesverbale, apo dokumente historike. Aktet e hartuara nga personat privatë, nuk klasifikohen si "dokumenta" sipas gjuhës shqipe. Për rrjedhojë bazuar vetëm në kuptimin gjuhësor të kësaj fjale, individi rezulton që të jetë dënuar në bazë të një vepër penale që nuk parashikohet nga ligji.
Edhe referimi që më pas ka bërë Gjykata e Lartë në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, nëpërmjet të cilave synohet që të justifikohet qendrimi, nuk më duket i drejtë. Përderisa Gjykata e Lartë ka tentuar të justifikojë qendrimin e saj duke përdorur terminologjinë juridike, pra duke luajtur me "termat", atëherë duhet të kishin zbatuar rregullat e "metodës tekstualiste" në mënyrë korrekte. Kështu sipas "rregullit të përdorimit të qendrueshëm" *(Presumption of Consistent Usage)* rezulton se një fjalë ose frazë supozohet se ka të njëjtin kuptim në të gjithë tekstin ndërsa një ndryshim material në terma apo frazë sugjeron një ndryshim në kuptim.[66] Mbi këtë bazë, Kodi Penal, përdor termin "dokument", në nenin 186 të tij, ndërsa Kodi i Procedurës Civile, përdor termin "shkresë", që i ndan në akte zyrtare, shkresa të thjeshta dhe shkresa private. Për secilën prej këtyre "shkresave", përcaktohet vlera dhe mënyra e kundërshtimit në një proces civil, të cilat janë të ndryshme.[67] Për rrjedhojë, termi "shkresë", nuk mundet kurrsesi të barazohet me termin "dokument".

Nëse i referohemi më pas praktikës së Gjykatës së Lartë, rezulton se në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qendrimin se "falsifikimi intelektual", lidhet me akte/dokumenta zyrtare të lëshuara nga organet shtetërore dhe jo për akte private. Ky qendrim, përveç dokumentave të pronësisë,[68] është mbajtur edhe më tej për pashaportat,[69] aktet e kolaudimit,[70] paraqitja e të dhënave të rreme në zbatimin e një kontrate administrative,[71] rezultatin e provimeve në universitet,[72] leje meremetimesh,[73] apo vendime të komisioneve të kthimit të pronave.[74] Në të gjitha këto raste, jemi akte apo dokumenta të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe që cilësohen si dokumenta zyrtare për institucionet. Ndodhur në këto kushte, është mëse e qartë që praktika gjyqësore në asnjë moment nuk ka njohur si pjesë të veprës penale të falsifikimit, qoftë dhe në formën "intelektuale", akte private, hartuar nga persona privatë.

Si argument i fundit, jam i mendimit që shërbejnë edhe rastet e tjera të parashikuara nga ligje të posaçme të cilat rregullojnë përgjegjësinë penale për personat që nuk plotësojnë deklarimet apo formularë të ndryshëm. Si shembuj mund t'i referohemi legjislacionit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike,[75] legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike,[76] si edhe legjislacioni për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike,[77] të cilat parashikojnë pikërisht përgjegjësinë penale të personave që hartojnë

[65] *"Fjalori i Gjuhës Shqipe"*, botim Akademisë së Shkencave - Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 2006, f. 205.
[66] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts.* Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 170.
[67] Kodi i Procedurës Civile, nenet 258-263.
[68] Vendimi nr.00-2011-931 (137), datë 26.10.2011 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[69] Vendimi nr.00-2013-1741 (315), datë 22.11.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[70] Vendimi nr.00-2014-674 (78), datë 12.3.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[71] Vendimi nr.00-2015-3041 (199), datë 9.12.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[72] Vendimi nr.00-2016-353 (37), datë 9.3.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[73] Vendimi nr.00-2017-659 (116), datë 19.7.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[74] Vendimi nr.00-2017-581 (111), datë 12.7.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[75] Ligj nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike", i ndryshuar, neni 5.
[76] Ligj nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, neni 43/1.
[77] Ligj nr.138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar, neni 5, pika 3, si edhe neni 8, pika 11.

deklarata të ndryshme bazuar në të dhenat e tyre personale. Ky parashikim, mungonte në rastin e legjislacionit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Për rrjedhojë edhe në këtë rast, këto shembuj tregojnë që ndodhemi, në rastin ekstrem të një krijimi të një norme të re penale nga gjyqësori dhe në rastin më pak të keq, në zbatimin e ligjit penal me analogji.

Një tjetër shembulli që lidhet me veprimtarinë "normë-krijuese" të gjykatave në fushën penale dhe që ka rënduar pozitën e të pandehurit, ka të bëjë me veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Kështu, individi ishte akuzuar nga prokuroria se kishte dhënë një leje legalizimi, në zonën historike të qytetit të Tiranës. Por në këtë rast, individ mbrohej me pretendimin se vendimi i Këshillit të Ministrave, që përcaktonte zonën historike, kishte rënë nga fuqia, për shkak se ligji ku ky akt bazohej dhe në zbatimit të të cilit kishte dalë, ishte shfuqizuar nga Kuvendi, nëpërmjet miratimit të një ligji të ri, i cili në dispozitat e tij tranzitore nuk parashikonte mbajtjen në fuqi të akteve të "vjetra" nënligjore. Gjykata e Lartë në atë rast, mbajti qendrimin se një akt normativ nënligjor nuk bie nga fuqia, nëse shfuqizohet ligji në bazë të të cilit ky akt ka dalë, por duhet të shfuqizohet në mënyrë të shprehur.[78] Kjo qasje e Gjykatës së Lartë nuk më duket e drejtë, pasi sipas nenit 118 të Kushtetutës, rezulton se *"1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, ..."* dhe për rrjedhojë aktet nënligjore normative duhet të bazohen në një ligj dhe të autorizohen prej tij. Këto akte nuk kanë një "jetë" të pavarur nga ligji në bazë dhe për zbatim të të cilit kanë dalë. Referimi që bën Gjykata e Lartë, në disa dispozita të Kodit të Procedurave Administrative nuk na duket i drejtë, pasi ato parashikime kanë të bëjnë me aktin administrativ individual dhe jo më aktin nënligjor normativ. Kjo qasje rezulton edhe nga doktrina, e cila qartësisht e ka cilësuar këtë situatë si "pushimi faktik të fuqisë së aktit juridik".[79]

Si një argument i fundit në këtë rast, është edhe fakti që nga krjimi i Shtetit Shqiptar, në vitin 1912 deri më sot, ka plot akte nënligjore normative që nuk janë shfuqizuar shprehimisht me akte të tjera. Këto mund të jenë qindra, por edhe mijëra. Duke qenë se e drejta ndërkombëtare njeh vazhdimësinë e shtetit, atëherë sipas llogjikës së Gjykatës së Lartë edhe këto akte vijojnë të jenë ende në fuqi dhe cilido prej zyrtarëve që vepron, shkel një akt nënligjor normativ të nxjerrë dikur më parë dhe për rrjedhojë mban përgjegjësi penale. Qartazi, një konkluzion i tillë përbën një *non sens* juridik. Duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i ka dhënë vlerë juridike një akti të shfuqizuar, duke e risjellë atë në fuqi. Qartazi jemi përpara një veprimtarie "normë-krijuese" të Gjykatës së Lartë, e cila ka sjellë edhe denimin e një personi, dënim ky i cili nuk do të duhej të kishte ndodhur.

Si një shembull i fundit i veprimtarisë normë krijuese të gjykatave, me pasojë dënimin e personave, lidhet me mënyrën si është formuluar neni 303 i Kodit Penal, dispozitë e cila parashikon dënimin e personave që ndihmojnë autorin për të fshehur apo asgjësuar kufomën. Rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar[80] si edhe Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar[81] kanë refuzuar rregullat e interpretimit tekstual të dispozitës dhe kanë realizuar një interpretim "qartësues dhe të zgjeruar të normës penale". Duke qenë se nuk kemi pasur akses në vendimet gjyqësore, po i referohemi një artikulli të botuar nga një prej gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këtë punim, pranohet që kjo lloj metode sjell si rezultat një interpretim "in pejus", pra rendues, për të pandehurit. Duke iu referuar argumentave të dhëna, rezulton se interpretimi literal, konsiderohet i papranueshëm, bazuar në nenet 15, 16 dhe 17 të Kushtetutës, si edhe në nenin 1/b të Kodit Penal, pasi një person dhe bashkëpunëtorët e tij, që kanë shkaktuar vdekjen e një personi tjetër nëse kryejnë veprime për fshehjen apo asgjesimin e kufomës, duhet të mbajnë përgjegjësi edhe për këtë vepër penale. Interpretimi literal në këtë rast do të cënonte pikërisht vlerat kushtetuese dhe nuk do të luftonte "kriminalitetin". Gjithashtu, vijon argumentimi, në këto raste cënohej dhe koncepti kushtetues, konventor dhe social i familjes, pasi nuk i mundëson familjarët që të realizojnë një ceremoni mortore për të afërmin e tyre, duke cënuar nenin 8 të KEDNJ dhe nenin 53 të Kushtetutës.[82]

Jam i mendimit që këto argumenta, nuk gjejnë bazë në rendin kushtetues. Kështu nenet që citohen të

[78] Vendimi nr.00-2023-2187 (352), datë 19.12.2023 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
[79] Sadushi, Sokol. *E drejta administrative 2 -Teoria e aktit administrative.* Shtëpia botuese "Ora", Tiranë 2005, f. 164.
[80] Vendimi nr.53, datë 29.9.2022 i Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
[81] Vendimi nr.16, datë 20.3.2023 i Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
[82] Kalaja, Florjan. *Refleksione mbi veprën penale të fshehjes dhe asgjesimit të kufomës.* Botuar në revistën "Studime juridike", botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, nr.1, viti 2023, f. 47.

Kushtetutës, të KEDNJ dhe të Kodit Penal, nuk i japin të drejtë gjykatave që të kriminalizojnë sjellje apo veprime të caktuara. Ato janë norma të përgjithshme dhe që nga mënyra si janë formuluar, dukshëm nuk kanë të bëjnë me rastin e nenit 303 të Kodit Penal. Në fakt është në natyrën e gjyqtarëve "liberalë/normë-krijues/pragmatistë", që të justifikojnë veprimet e tyre bazuar në disa "vlera të përgjithshme", por që në fakt bazohen vetëm në bindjen e tyre të brendshme se si ligji do të duhej të ishte, por jo si realisht është. Në rastin konkret, gjykata është mbështetur në argumenta morali, për të cilat dhe unë jam personalisht dakort, por duhet që kjo sjellje të kriminalizohet nga ligjvënësi dhe jo nëpërmjet veprimtarisë gjyqësore. Është interesante, që në justifikimin e kësaj veprimtarie normë-krijuese, nuk gjejnë vend dhe nuk trajtohen aspak neni 1, pika 1; neni 2, pika 1 dhe 2; neni 4, pika 1; neni 70, pika 1, si edhe neni 145, pika 1 të Kushtetutës, të cilat trajtojnë formën e qeverisjes, sovranitetin popullor, mënyrën e ushtrimit të tij, si edhe detyrimin e gjykatave që t'i binden Kushtetutës dhe ligjit.

Edhe argumenat e tjera që jepen, në lidhje me interpretimin e zgjeruar të kësaj norme penale, jam i mendimit që nuk qendrojnë. Për më tepër rastet që përmenden nga GJEDNJ, për moszbatimin e urdhërit të gjykatës nga një anëtar jurie[83] dhe falsifikimi i dokumentave bankare dhe vjedhje në bankë,[84] nuk mendoj se kanë të bëjnë me rastin e veprimtarisë "normë-krijuese" të gjykatave në fushën penale. Në këto raste, shumë mirë mund të gjejnë zbatim rregullat e interpretimit të shkollës "tekstualiste" të së drejtës, si rregulli i përdorimit të termave të përgjithshëm *(General-Terms Canon)*, sipas së cilit termave të përgjithshme u duhen dhënë kuptimi i përgjithshëm,[85] si edhe fjalët në një tekst ligjor nuk duhet të lexohen/interpretohen në mënyrë të ngushtë.[86] Në këtë aspekt termat në legjislacionet respektive ishin formuluar në mënyrë të mjaftueshme që parashikon dënimin e atyre personave.

Përsa i përket justifikimit për të përdorur një interpretim të zgjeruar në fushën penale, që lidhet me qëllimin e ligjvënësit, kjo mendoj se është e ekzagjeruar. Kështu pretendohet se "Zbatimi interpretimi qartësues dhe i zgjeruar i normës penale kërkohet në rastin lex minus dicit quam voluit, pra kur vetë ligji përcakton literalisht më pak nga çfarë ka dashur të thotë legjislatori dhe se interpretimi i gjykatës ka për qëllim dhënien e drejtësisë sipas këtij orientimi kushtetues".[87] Një analizë e shkurtër e kësaj qasjeje të bën të kuptosh që ky konkluzion nuk është i drejtë.

Qëllimi që ka pasur ligjvënësi në miratimin e një legjislacioni apo normave të caktuara, mund të nxirret vetëm duke zbatuar rregullat e interpretimit tekstual mbi fjalët e tekstit ligjor siç ai është shkruar. Përkundrazi, nxjerrja e një kuptimi tjetër të qëllimit të ligjvënësit nga ajo që është shkruar, votuar dhe miratuar prej tij, nuk ka një bazë kushtetuese. Përdorimi i nocioneve të tilla si interpretimi "teleogjik" i normës (kur del jashtë kuptimit të fjalëve) apo i "frymës" së ligjit, të jep pershtypjen se ndodhemi përballë "qellimeve te fshehta" te legjislatorit, te cilat ky i fundit nuk i ka shprehur nëpërmjet fjalëve që ka votuar dhe miratuar, por përkundrazi, ka pasur qëllime të tjera "sekrete", të cilat vetëm gjykata është e aftë t'i zbulojë nëpërmjet veprimtarisë së saj. Siç me të drejtë është shprehur edhe gjyqtari i Gjykatës së Lartë të SHBA-së, Neil Gorsuch *"Dhe nëse shteti i së drejtës do të thotë diçka, kjo do të thotë se ne udhëhiqemi nga kuptimi publik i fjalëve që gjenden në ligje dhe rregullore, dhe jo nga qëllimet private të hartuesve të tyre. Kjo është një pjesë jetike e asaj që do të thotë të kesh "një qeverisje nga ligjet dhe jo nga njerëzit"".*[88] Është e kuptueshme që përdorimi i termave të tillë, si "fryma", e ligjit apo qëllimi i

[83] Kalaja, Florjan. *Refleksione mbi veprën penale të fshehjes dhe asgjesimit të kufomës.* Botuar në revistën "Studime juridike", botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, nr.1, viti 2023, fq. 49. GJEDNJ, Seksioni i parë, çështja *"Dallas v. The United Kingdom",* aplikimi nr.38395/12, datë 11.2.2016.

[84] Kalaja, Florjan. *Refleksione mbi veprën penale të fshehjes dhe asgjesimit të kufomës.* Botuar në revistën "Studime juridike", botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, nr.1, viti 2023, fq. 50-51. GJEDNJ, Seksioni i tretë, çështja *"Martrosyan v. Armenia",* aplikimi nr.23341/06, datë 5.2.2013.

[85] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts.* Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 101.

[86] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A *Reading law: The interpretation of legal texts.* Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 355.

[87] Kalaja, Florjan. *Refleksione mbi veprën penale të fshehjes dhe asgjesimit të kufomës.* Botuar në revistën "Studime juridike", botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, nr.1, viti 2023, f. 48.

[88] Kisor v. Wilkie 588 U. S. 558 (2019).

ligjvënësit, përdoren nga gjykatat "evolutive/normë-krijuese", për të fshehur veprimtarinë e tyre reale, pra që të mos zbatojnë ligjin si ai është shkruar, por përkundrazi si gjyqtari mendon se duhej të ishte.

Kjo mënyrë e të vepruarit, duke mëse qartë në mënyrën e interpretimit të nenit 303 të Kodit Penal, normë e cila është miratuar, në vitin 1995 dhe nuk ka pësuar ndryshime që nga ajo kohë. Në atë kohë Kuvendi përbëhej nga 140 deputetë. Sot një pjesë e këtyre deputetëve mund të vijojnë të jenë në politikë, një pjesë janë tërhequr dhe një pjesë edhe nuk jeton më. Ndërkohë në vitin 2023, pra 28 vite më vonë, trupat gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si edhe të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, janë në gjendje të kuptojnë shumë qartë se çfarë kanë dashur të thonë të 140 deputetët e viti 1995, kur kanë shkruar atë normë dhe kanë kuptuar se këta deputetë, të gjithë sëbashku, kanë pasur një tjetër qëllim, nga ajo që kanë shkruar. Pra, ata kanë pasur një qëllim tjetër "sekret", që u arrit të zbulohej nga ana e gjykatave rreth tre dekada më vonë. Qartazi një argument i tillë nuk mundet që të qendrojë dhe për më tepër të justifikojë veprimtarinë "normë-krijuese" të gjykatave.

Ky veprim gjyqësor, bie ndesh me disa rregulla të tjera të metodës tekstualiste të interpretimit dhe konkretisht të rregullit të ndalimit të plotësimit të normave *(Omitted-Case Canon)*, sipas të cilit asgjë nuk mundet që t'i shtohet asaj që ligji tregon apo në mënyrë të arsyeshme nënkupton,[89] si edhe të rregullit më të favorshëm *(Rule of Lenity)*, sipas të cilit paqartësia që mund të ketë një ligj që përcakton një vepër penale apo vendos një sanksion duhet t'i jepet kuptimi që është në favor të të akuzuarit.[90]

Duhet sjellë në vëmëndje se këto dy gjykata në këtë rast, përveç largimit nga rregullat e interpretimit nuk kanë marrë në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës së Lartë,[91] por edhe vetë jurisprudencën e GJEDNJ, e cila shprehet kundër interpretimit të zgjeruar të normave penale.[92]

Për ta përfunduar analizën në lidhje me këtë vendimmarrje mund të citojmë jurisprudencën e Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila ka mbajtur qendrimin se *"Vetëm përfaqësuesit e zgjedhur të popullit në Kongres kanë fuqinë për të shkruar ligje të reja penale federale. Dhe kur Kongresi ushtron këtë pushtet, ai duhet të shkruajë ligje që u japin njerëzve të zakonshëm paralajmërim të drejtë për atë që ligji kërkon prej tyre. Ligjet e paqarta i shkelin të dyja këto kërkesa kushtetuese. Ata ua dorëzojnë përgjegjësinë e legjislativit për përcaktimin e sjelljes kriminale prokurorëve dhe gjyqtarëve të pazgjedhur dhe i lënë njerëzit pa asnjë mënyrë të sigurt për të ditur se çfarë pasojash do të ketë sjellja e tyre"*.[93]

Nga sa më sipër, qartazi rezulton se veprimtaria e gjykatave, duke u fshehur mbas teknikave "normë-krijuese", kanë cënuar garancinë kushtetuese të nenit 29 të Kushtetutës, sipas së cilës, veprat penale duhet të parashikohen vetëm me ligj.

Veprimtaria normë-krijuese e gjykatave shqiptare, është konsideruar shkelje edhe nga vetë GJEDNJ, ku për ta ilustruar, mund ta përmendim dy raste. Në rastin e parë, në çështjen "Alimuçaj kundër Shqipërisë", nga sna e GJEDNJ u arrit konkluzioni se aplikanti nuk do të kishte mundësi që të parashikonte, edhe sikur të merrte konsulencë juridike, se e njëjta vepër e kryer prej tij më shumë se një herë, do të mblidhej po aq herë sa ishte kryer vepra, në mungesë të një dispozite ligjore që në mënyrë të shprehur ta parashikonte diçka të tillë. Më konkretisht GJEDNJ në këtë vendim u shpreh se *"Duke marrë në konsideratë interpretimin doktrinor dhe zbatimin efektiv të nenit 55 nga Gjykata e Lartë në atë kohë, Gjykata çmon se ankuesi nuk mund të parashikonte se neni 55 do të zbatohej në caktimin e një bashkimi dënimesh për kryerjen e mashtrimit si vepër e përsëritur, në mungesë të një akuze tjetër dhe dënimi për një akuzë tjetër, edhe nëse ai duhet të merrte konsulencë juridike.* [94] Pra, qartazi në

---

[89] Scalia, Antonin, Garner. Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts*. Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 93.

[90] Scalia, Antonin dhe Garner. Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts.* Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 180.

[91] Vendimi nr. 00-2012-1402 (254), datë 10.10.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[92] GJEDNJ, Dhoma e Madhe, Mendim këshillimor, kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Armenisë, nr. P16-2019-001, 29.5.2020: *Ndërsa ndalon në veçanti zgjerimin e fushëveprimit të veprave ekzistuese në veprime të cilat më parë nuk ishin vepra penale, ai gjithashtu parashtron parimin që ligji penal nuk duhet të interpretohet gjerësisht në dëm të një të akuzuari, për shembull me analogji*

[93] *United States v. Davis*, 588 U.S. ___ (2019).

[94] GJEDNJ, Seksioni i katërt, çështja *"Alimuçaj kundër Shqipërisë",* aplikimi nr. 20134/05, datë 7.2.2012.

këtë rast, interpretimi që kishte bërë Gjykata e Lartë, që e shpalli fajtor aq herë sa kishte kryer veprën penale, u konsiderua si cënuese e të drejtave të tij nga ana e GJEDNJ.

Në rastin e dytë, në çështjen "Grori kundër Shqipërisë",[95] GJEDNJ, konkludoi se ndaj aplikantit kishte pasur kufizim të lirisë personale pa ligj dhe se ai nuk ishte në gjendje që të parashikonte në mënyrë të arsyeshme rrethanat e procedimit ndaj tij. Në këtë rast rezultonte se gjykatat kombëtare kishin "huazuar" marrëveshje ndërkombëtare të pa ratifikuara nga Shqipëria dhe i kishin aplikuar ato për të kufizuar lirinë personale të aplikantit, pasi asnjë normë e Kodit të Procedurës Penale dhe/ose ndonje ligji tjetër në atë kohë nuk e sillte qëllimin e kërkuar nga ana e tyre.

Shembuj tjetër, të kufizimit të të drejtave, mund të përmendim edhe mundësinë që ka debitori që të kundërshtojë veprimet përmbarimore, sipas nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo norme që është ndryshuar disa herë[96] parashikon një ankim të veçantë, 5 ditor, kundër veprimeve përmbarimore në gjykatën e shkallës së parë dhe një ankim të veçantë, 5 ditor, kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë në gjykatën e apelit. Dispozita nuk trajton rekursin në Gjykatën e Lartë dhe afatin për ta ushtruar këtë të drejtë. Në këtë situatë, kjo do të thotë që për rekursin dhe kushtet e tij do të duhet të zbatohen rregullimet e përgjithshme të neneve 427 – 476 të Kodit të Procedurës Civile. Këto rregullime vlejnë edhe për sa i përket afatit për të ushtruar të drejtën për rekurs. Duke mos pasur asnjë parashikim të veçantë në nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile, doktrina "tekstualiste" të çon në konkluzion llogjik që në këtë rast zbatohet afati i përgjithshëm 30 ditor që parashikohet në nenin 476 i Kodit të Procedurës Civile.

Pavarësisht këtyre rregullimeve ligjore, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në një vendim të sajin njehsues, përcaktoi se *"Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se ankimi i veçantë i parashikuar në nenin 610, me ndryshimet që ka pësuar KPC në vitin 2021, do të duhet të ndjekë të njëjtin regjim juridik të posaçëm, si në gjykimin në apel, ashtu edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Në nenin 443 të ndryshuar me ligjin nr.44/2021, është parashikuar instituti i rekurseve të veçanta, si mjet për goditjen e vendimeve të gjykatës së apelit, të vënë në lëvizje nga një ankim i veçantë, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ligjvënësi ka patur si qëllim që të ofrojë ankime të veçanta ndaj çështjeve për të cilat duhet adresuar gjyqësisht nga juridiksioni rishikues një zgjidhje e shpejtë, qoftë nga gjykata e apelit, qoftë nga Gjykata e Lartë. Ndaj njëjtësimi i rregullave të gjykimit rishikues në Gjykatën e Lartë, si ndaj ankimeve të zakonshme ashtu edhe ndaj ankimeve të veçanta nuk do të ishte as në frymën e ligjit dhe as zbatim kushtetues i tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ndaj vendimeve të gjykatës së apelit që disponojnë mbi ankimet e veçanta kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, sipas nenit 610 të KPC, ligji lejon rekurs të veçantë në Gjykatën e Lartë, që do të thotë rekurs brenda 5 ditëve."*[97] Në këtë rast, Kolegji Civil ka pretenduar se ka interpretuar "frymën" e ligjit për të siguruar dhe kushtetutshmërinë e zbatimit të tij. Logjika e Kolegjit Civil është se përderisa në Kodin e Procedurës Civile, janë parashikuar rekurset e veçanta dhe kjo është një procedurë e që kërkon të gjykohet me shpejtësi, atëherë dhe rekursi për në Gjykatën e Lartë do të duhet të ushtrohet brenda 5 ditëve.

Interesant është fakti që, megjithëse me ndryshimet e vitit 2017, ligjvënësi përfshiu nocionin e rekursit të veçantë, u kujdes që të parashikonte rastet se kur mund të ushtrohej ky rekurs. Më konkretisht, rekursi i veçantë parashikohet shprehimisht në nenet 59, 466, 467 dhe 476 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo do të thotë që përderisa nuk ka një parashikim të drejtëpërdrejtë që në rastin e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore, ushtrohet rekurs i veçantë, atëherë qëllimi i ligjvënësit ka qenë që në këtë rast të zbatohet rregulli i përgjithshëm për rekurset. Duke vepruar në këtë mënyrë, për këtë lloj mosmarrëveshje, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet krijimit të një norme të re, ka kufizuar të drejtën për akses dhe ankim në Gjykatën e Lartë nga 30 ditë që e ka parashikuar ligjvënësi, në 5 ditë.

Një tjetër rast, që tregon që përdorimi i interpretimit "evolutiv" nga ana e gjykatave të zakonshme që nuk ka bazë kushtetuese, është tendenca e disa gjykatave që të ushtrojnë vetë kontroll kushtetues. Kushtetuta jonë ka

[95] GJENDJ, Seksioni i katërt, çështja "Grori kundër Shqipërisë", aplikimi nr.25336/04, datë 7.7.2009.

[96] Ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.5.2001; nr. 10 052, datë 29.12.2008; nr. 122/2013, datë 18.4.2013; nr. 114/2016, datë 3.11.2016; shtuar paragrafi i tretë pas paragrafit të dytë me ligjin nr. 44/2021, datë 23.3.2021.

[97] Vendimi njëhsues nr. 00-2022-4586 (392), datë 26.10.2022 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

përzgjedhur kontrollin e centralizuar i cili ushtrohet vetëm nga Gjykata Kushtetuese. Gjykatat e zakonshme, mund të paraqiten si subjekte që mund të vendosin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese,[98] por jo që ta ushtrojnë vetë atë, siç e ka bërë të qartë dhe vetë jurisprudenca kushtetuese.[99] Por pavarësisht parashikimeve të ligjit themelor të vendit, si edhe mënyrës së interpretimit të tyre nga vetë Gjykata Kushtetuese, rezulton se gjykatat e zakonshme po pretendojnë krijimin e një norme të re, që u jep atyre të drejtë që të vlerësojnë kushtetutshmërinë e normave.

Kështu Gjykata e Posaçme e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me vendimin e saj nr. 32, datë 22.08.2022, ka vendosur deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit Durrës, duke arsyetuar se *"... ligjvënësi ka tejkaluar parashikimet e Kushtetutës lidhur me kompetencën e gjykatave të posaçme lidhur me gjykimin e disa veprave penale, ndër të cilat edhe vepra penale "Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste",...".."...Gjykata konstaton se nga përqasja e nenit 75/a të KPP me nenin 135/2 të Kushtetutës rezulton se ka një kundërshti lidhur me parashikimin e disa prej veprave penale të cilat akti themelor nuk ia ka atribuuar kompetencës lëndore të gjykatave të posaçme. Për këtë shkak, neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale vjen në kundërshtim me nenin 135/2 të Kushtetutës për sa parashikon në kompetencën e gjykatave të posaçme veprën penale "Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste", parashikuar nga neni 232/a i Kodit Penal."* Qartazi një arsyetim i tillë edhe sikur të jetë i vërtetë, mund të shërbejë si argument për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, por jo që gjykata e zakonshme të deklarojë vetë antikushtetutshmërinë e normës ligjore. Pra, praktikisht u ndryshua vetë Kushtetuta, nëpërmjet një vendimi gjyqësor, duke marrë gjykatat e zakonshme atributet dhe kompetencat që i njihen ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese.[100]

6. Metoda e interpretimit evolutiv, si shkak për krijimin e mosmarrëveshjeve

Metoda e interpretimit evolutiv, mund të shkaktojë dhe mosmarrëveshje midis gjykatave të llojëve dhe shkallëve të ndryshme, por edhe me organizata ndërkombëtare.

Historikisht në Shqipëri, Gjykata e Lartë (pavarësisht emërtesës që ka pasur në kohë të ndryshme), ka qenë shkalla më e lartë e pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Kjo mendësi e krijuar në disa dhjetëvjeçarë, normalisht që nuk mundej që të pranonte që vendimet e kësaj gjykate të shqyrtoheshin nga Gjykata Kushtetuese. Kjo herë pas herë krijoi një lloj konflikti midis këtyre dy gjykatave në vend, duke e detyruar Gjykatën Kushtetuese që të mbante qëndrimin se vendimet e saj ishin detyruese për Gjykatën e Lartë.[101] Detyrueshmëria e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të dhëna në seancë plenare, u shtri më vonë edhe për vendimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese në Mbledhjen e Gjyqtarëve.[102]

---

[98] Kushtetuta, neni 134, pika, 1, gërma "dh" dhe neni 145, pika 2.

[99] Vendimi nr.97, datë 27.7.2001 i Gjykatës Kushtetuese: *Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese duke iu rikthyer edhe një herë analizës që përbën thelbin e çështjes lidhur me qëndrimin e gjykatave ndaj ligjit nr.355, datë 21.11.1946, thekson se ky qëndrim është antikushtetues, sepse gjykata nuk ka të drejtë të mos e zbatojë një ligj që sipas saj ka karakter të theksuar politik. Në rast se gjykata çmon se ligji nuk pajtohet me Kushtetutën, ajo është e detyruar të pezullojë gjykimin dhe t'ia dërgojë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Çdo qëndrim tjetër e bën procesin gjyqësor të parregullt.*

[100] Vendimi i Gjykatës së Posaçme e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar u prish nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin nr.00-2023-499, datë 23.3.2023, arsyetoi se *"15. ... Kolegji vlerëson se në rastin konkret, Gjykata e Posaçme e Apelit në kushtet kur ka çmuar se këto ndryshime ligjore janë në kundërshtim me Kushtetutën, në thelb ka vënë në diskutim kushtetutshmërinë e neni 7 të ligjit nr. 41/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodit i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Një situatë e tillë ligjore është rregulluar nga neni 145 i Kushtetutës, që në funksion të garantimit të pavarësisë së gjyqtarëve, ka parashikuar se kur ato çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato. Por, në të njëjtën kohë, kjo dispozitë parashikon edhe detyrimin e gjyqtarëve që në një rast të tillë, të pezullojnë gjykimin dhe të dërgojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese....19. Kolegji thekson se veprat penale me qëllime terroriste për shkak të rëndësisë dhe natyrës së tyre, janë krime serioze që lidhen me faktin se terrorizmi paraqet një kërcënim të madh për paqen, sigurinë dhe stabilitetin kombëtar e ndërkombëtar.*

[101] Vendimi nr.5 datë 7.2.2001 i Gjykatës Kushtetuese

[102] Vendimi nr.20, datë 1.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

Por pavarësisht këtij qëndrimi të prerë të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë përsëri do insistonte në një "pushtet" të sajin për të shmangur jo vetëm konkluzionet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese, por edhe nga një organizatë ndërkombëtare.

Ky rast e ka fillesën në çështjen "Dauti kundër Shqipërisë",[103] ku Shqipëria, u konsiderua në shkelje, pasi legjislacioni i saj, ndalonte ankimet kundër KMCAP Epror[104] në gjykatë. Kjo strukturë administrative u vlerësua se nuk përmbushte kriteret për t'u konsideruar si e pavarur dhe heqja e garancive të shqyrtimit gjyqësor, përbënte shkelje të së drejtës konventore për akses në gjykatë. Në vitin 2011, ligjvënësi bëri disa ndërhyje në legjislacionin përkatës,[105] të shoqëruara më pas me miratimin e disa akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave. Masat e reja ligjore dhe nënligjore, u morën në shqyrtim nga Komiteti i Ministrave, organ ky i parashikuar nga Konventa Evropiane e Drejtave të Njeriut, në nenin 46 të saj, dispozitë e cila parashikon se *"1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë. 2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij. 3. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit të një vendimi të formës së prerë pengohet nga një problem i interpretimit të vendimit, ai mund t'ia referojë çështjen Gjykatës për t'u shprehur me vendim për çështjen e interpretimit. Një vendim i tillë kërkon një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet. 4. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon të respektojë një vendim të formës së prerë të Gjykatës në një çështje ku ajo është palë, pasi t'i ketë dërguar një njoftim formal asaj Pale dhe me vendim që merret me një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që marrin pjesë në Komitet, ai mund t'ia referojë Gjykatës çështjen nëse Pala e ka përmbushur detyrimin e saj në bazë të paragrafit 1. 5. Nëse Gjykata gjen një shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhen marrë. Nëse Gjykata nuk gjen asnjë shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave, i cili e mbyll shqyrtimin e çështjes"*. Siç rezulton nga ky formulim, organi i ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të GJEDNJ-së, është Komiteti i Ministrave dhe jo vetë GJEDNJ.

Ky organ, ndërkombëtar, i parashikuar në një marrëveshje ndërkombëtare, pasi shqyrtoi masat e marra nga Shqipëria, miratoi një rezolutë, në të cilën mbajti qëndrimin se *"Pasi ka ftuar qeverinë e shtetit përgjegjës për të informuar Komitetin për masat e marra për të përmbushur detyrimin e sipërpërmendur; Duke ekzaminuar raportin e veprimit të ofruar nga qeveria që tregon masat e miratuara për t'i dhënë efekt vendimit, duke përfshirë informacionin e dhënë në lidhje me pagesën e shpërblimit të drejtë të dhënë nga Gjykata (shih dokumentin DH-DD(2016)684); Duke qenë i bindur se të gjitha masat e kërkuara nga neni 46, paragrafi 1, janë miratuar, SHPALL se ka ushtruar funksionet e saj sipas nenit 46, paragrafi 2, i Konventës në këtë rast dhe VENDOS të mbyllë shqyrtimin e tij".*[106] Siç rezulton nga gjuha e qartë e kësaj rezulute, vendimi i GJEDNJ-së, do të konsiderohet i ekzekutuar plotësisht dhe Shqipëria nuk ka më asnjë detyrim në lidhje me këtë çështje.

Nga ndërhyrjet legjislative dhe të pranuara nga Komiteti i Ministrave, ishte edhe neni 39/1, pika 3, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore" e cila parashikonte se "*Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë".*

Gjykata e Lartë, duke e konsideruar si antikushtetues formulimin e mësipërm, pasi sipas saj ndalonte ankimimin në gjykatë të vendimeve të KMCAP Epror, organ i cili përsëri nuk ofronte garanci të mjaftueshme pavarësie në shqyrtimin e ankesave të individëve të ndryshëm, pezulloi çështjen dhe iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kësaj norme. Gjykata Kushtetuese, e shqyrtoi paraprakisht këtë çështje në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe konkludoi se nuk plotësoheshin kërkesat për shqyrtimin e saj. Për sa i përket, mundësisë së ankimit gjyqësor apo jo ndaj vendimeve të KMACP Epror, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, u shpreh se *"Duke iu referuar këtyre pretendimeve, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se*

[103] GJEDNJ, Dhoma e katërt, çështja *"Dauti kundër Shqipërisë"*, aplikimi nr.19206/05, datë 3.2.2009.
[104] Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë.
[105] Ligj nr. 10 447, datë 14.07.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore", të ndryshuar.
[106] Rezoluta CM/ResDH(2016)210, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 14 shtator 2016 në mbledhjen e 1264 të Zëvendës Ministrave, marrë nga adresa e internetit https://hudoc.echr.coe.int/#{%22tabvieë%22:[%22document%22ç,%22itemid%22:[%22001-167203%22ç}

shprehja e vënë në dyshim prej gjykatës referuese "vendim i formës së prerë" jo vetëm që është përdorur nga legjislacioni procedural edhe në raste të tjera pa penguar kontrollin gjyqësor gjer në Gjykatën e Lartë (shih ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar; ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në RSH", të ndryshuar; ligjin nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave"), por i është nënshtruar edhe unifikimit nga vetë Gjykata e Lartë në procedura të tjera gjyqësore në raport me konceptin e vendimit përfundimtar (shih vendimin unifikues nr. 2, datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë). Po ashtu, duhet evidentuar se ligji nr. 7703/1993, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar në kohë, në nenin 86 parashikonte dhe vazhdon të parashikojë të drejtën e ankimit gjyqësor të individëve kundër vendimeve administrative që përcaktojnë përfitime të pafavorshme. Në këtë mënyrë, ky ligj garanton aksesin në gjykatë të procesit kryesor që përcakton të drejtat e ligjshme të individit dhe për efekte të të cilit zhvillohet procesi administrativ i caktimit të shkallës së aftësisë për punë nga Komisioni Epror. Nën këtë analizë, gjykata referuese duhet të ushtrojë funksionin e saj, pra për ta shqyrtuar çështjen lidhur me kuptimin dhe zbatimin e tekstit të ligjit "vendim i formës së prerë" i Komisionit Epror, në raport me aksesin në gjykatë, duke vlerësuar brenda kufijve kushtetues, nëse është vendi për njësimin, zhvillimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore".[107]

Nga ky pasazh kuptohet qartë se për Gjykatën Kushtetuese, nuk kishte problem kushtetutshmërie të normës, e cila mund të zgjidhej duke aplikuar metodat tradicionale të interpretimit. Por, siç e analizuam më sipër, megjithëse konkluzionet e Mbledhjes së Gjyqtarëve, janë detyruese për Gjykatën e Lartë, kjo e fundit mori komplet një tjetër qasje, fillimisht kundër konkluzioneve të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe më pas kundër vetë Gjykatës Kushtetuese.

Përsa i përket konkluzioneve të Komitetit të Ministrave, të cituara më sipër, Gjykata e Lartë u shpreh se *"42. Në këtë pikë të analizës, për Kolegjin u shtrua për zgjidhje çështja se çfarë fuqie juridike kanë konkluzionet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës që konstatojnë përmbushjen e masave të përgjithshme që GJEDNJ ka lënë si detyrë ndaj shtetit në një nga vendimet e saj që ka marrë formë të prerë, në rast se pas rezolutës konstatohet se, në të vërtetë, masat ligjore të marra nga shteti nuk e kanë zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke lejuar vijimin e shkeljeve të dispozitave të KEDNJ-së. ... 46. Pavarësisht rolit të rëndësishëm që i jepet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës në mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave të përgjithshme që rrjedhin nga vendimet e formës së prerë të GJEDNJ-së, nuk mundet që këtij institucioni t'i njihet edhe autoriteti gjyqësor i vetë GJEDNJ-së, i gjykatave kushtetuese apo edhe i gjykatave vendase të pushtetit gjyqësor. Kjo do të thotë se, pavarësisht konkluzioneve të arritura, rast pas rasti, nga ana e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, mbi ekzekutimin e masave të përgjithshme të vendimeve të formës së prerë të GJEDNJ-së prej shteteve anëtare, konkluzioni nëse këto masa përmbushin cilësisht standardet kushtetuese dhe konventore mbeten në pushtetin e natyrshëm dhe sovran të pushtetit gjyqësor, gjykatave kushtetuese dhe vetë GJEDNJ-së. Në këtë këndvështrim, konkludohet se nuk mund t'i njihet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës një pushtet i tillë juridik që të zëvendësojë dhe njëkohësisht t'i imponohet gjykatave të zakonshme, gjykatave kushtetuese dhe vetë GJEDNJ-së"*.

Vënia në diskutim, e konkluzioneve të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në këtë rast, është një veprim tepër i guximshëm i Gjykatës së Lartë. Nga hulumtimet e bëra, nuk më rezulton që KEDNJ të ketë ndonjë parashikim, që vetë shtetet të refuzojnë konkluzionet e Komitetit të Ministrave, për më tepër kur ky Komitet ka vendosur që shteti e ka ekzekutuar vendimin e GJEDNJ-së. Gjithashtu, nuk rezulton që ndonjë shtet tjetër, në më shumë se shtatë dekada të ekzistencës së KEDNJ të këtë vendosur të mos pranojë konkluzionet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në rastin kur ka konkluduar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga një vendim i GJEDNJ-së.

Lidhja e fuqisë detyruese të një akti të një organizate ndërkombëtare me përbërjen e saj, siç bën Gjykata e Lartë, paraqet një qasje jo të drejtë, kjo për shkak se shumica e organizatave ndërkombëtare kanë përbërje jo gjyqësore, por politike. Bazuar në logjikën e Gjykatës së Lartë, vendet anëtarë të Bashkimit Evropian, edhe mund të refuzojnë konkluzionet e Këshillit Evropian apo të Komisionit Evropian, vetëm me argumentin se në këtë rast, këto struktura nuk janë trupa gjyqësore, por kanë përbërje politike. I njëjti argument do të vlente për rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombëve të Bashkuara, e kështu me rradhë.

[107] Vendimi nr.55, datë 31.3.2021 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Nga ana tjetër edhe vetë GJEDNJ, nuk e ka pretenduar ndonjëherë pushtetin që të mos marrë në konsideratë konkluzionet e Komitetit të Ministrave. Përkundrazi jurisprudenca e kësaj Gjykate, tregon një respekt të jashtëzakonshëm për veprimtarinë e Komitetit të Ministrave dhe nuk është arritur të identifikohet ndonjë rast, ku GJEDNj të jetë shprehur se nuk merr në konsideratë konkluzionet e këtij organizmi. Përkundrazi në jurisprudencën e GJENDJ-së, gjejmë edhe deklarime të tilla se *"Për më tepër, Gjykata rithekson se duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e mjeteve në dispozicion për të arritur restitutio in integrum dhe natyrën e çështjeve të përfshira, në ushtrimin e kompetencës së saj sipas nenit 46 § 2 të Konventës, Komiteti i Ministrave është në një pozicion më të mirë se sa Gjykata për të vlerësuar masat specifike që duhen marrë. Prandaj, duhet t'i lihet Komitetit të Ministrave të mbikëqyrë, në bazë të informacionit të dhënë nga shteti përgjegjës dhe duke pasur parasysh situatën në zhvillim të aplikantit, miratimin e masave të tilla që janë të realizueshme, në kohë, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të siguruar dëmshpërblimin maksimal të mundshëm për shkeljet e konstatuara nga Gjykata"*.[108]

Duke iu rikthyer vendimit të Gjykatës së Lartë, rezulton se përsa i përket Gjykatës Kushtetuese, ajo mbajti qëndrimin vijues: *"125. Kolegji risjell në vëmendje se Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 55, datë 31.03.2021 ka orientuar Gjykatën e Lartë për të bërë interpretim pajtues të kësaj dispozite, duke theksuar se koncepti "formë e prerë" mund të marrë kuptime të ndryshme sipas legjislacionit në fuqi dhe jo në çdo rast është i barazvlefshëm me konceptin e vendimit final. Gjykata Kushtetuese ka sjellë si shembull, për analogji, Vendimin unifikues nr. 2, datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku është diferencuar fuqia ekzekutive e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, nga cilësia gjë e gjykuar.*

126. Kolegji ndan një qëndrim të ndryshëm nga ky orientim i Gjykatës Kushtetuese, mbi interpretimin e këtij ligji, për arsyet që do të parashtrohen në vijim.

127. Së pari, Ligji nuk ka dhënë përkufizime për të sqaruar kuptimin e frazës "vendim gjyqësor i formës së prerë". Megjithatë konceptin "formë e prerë", si cilësi dhe status ligjor të një vendimi, ligji e përmend edhe në dy dispozita të tjera. Njërin formulim e gjen në nenin 39/4, ku parashikohet se anëtari i KMCAP Epror shkarkohet nga detyra, nëse dënohet me një vendim gjyqësor penal të formës së prerë. Për të përcaktuar vendimin gjyqësor të formës së prerë, sipas këtij rregullimi, do t'i referohemi parashikimit që jepet në nenin 462 të Kodit të Procedurës Penale. Formulimin tjetër e gjen në shkronjën d) të së njëjtës dispozitë ligjore, ku parashikohet se mandati i anëtarit të KMCAP Epror përfundon kur vërtetohet paaftësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Edhe për këtë formulim do të duhet t'i referohemi parashikimit që bën neni 451 i Kodit të Procedurës Civile.

128. E përbashkëta e këtyre dy parashikimeve normative mbi konceptin "formë e prerë e një vendimi", për llogari të zbatimit të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, qëndron te situata juridike e prekluzivitetit të ankimeve dhe njëherazi te finaliteti i një zgjidhje ligjore administrative apo gjyqësore.

129. Ligji nr. 7703/1993 përmban edhe një tjetër formulim mbi formën e prerë të vendimit, në nenin 86, pika 3, ku parashikohet se ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme (duke iu referuar Komisionit të Ankimit pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore apo Komisionit të Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore), bëhen në gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar. Pra, cilësisë së vendimit të formës së prerë, sipas këtij ligji, i shtohet edhe cilësia e vendimit përfundimtar, duke konkluduar se kjo zgjidhje administrative është finale dhe e pamundur të kontestohet gjyqësisht.

130. Krahas interpretimit literal dhe sistematik, Kolegji çmon të ndalet edhe tek interpretimi teleologjik dhe se cili ka qenë qëllimi i ligjvënësit në përdorimin e togfjalëshit "formë e prerë", kur përcakton efektet e vendimeve të KMCAP Epror. Në këtë kuadër, Kolegji risjell në vëmendje Raportin e Veprimit, datë 03.05.2013 të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, ku janë marrë në analizë, ndër të tjera, edhe masat e përgjithshme të Republikës së Shqipërisë për të adresuar zgjidhje në sistemin e brendshëm ligjor për zbatimin e vendimit të GJEDNJ-së në çështjen "Dauti kundër Shqipërisë". Në raport pasqyrohet se në Kuvend u hodh poshtë propozimi për të lejuar ankim gjyqësor kundër vendimeve të KMCAP Epror, të pafavorshme për llogari të

[108] GJEDNJ, Dhoma e Madhe, çështja "Ilgar Mammadov v. Azerbaijan", procedim sipas nenit 46, pika 4 e KEDNJ, aplikimi nr.15172/13, datë 29.5.2019, paragrafi 155.

subjekteve kërkues, duke u miratuar norma ligjore në variantin se vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë, të paankimueshme dhe të detyrueshme.

131. Nisur nga këto tre forma të interpretimit të ligjit, Kolegji vlerëson se koncepti "formë e prerë", i përdorur nga ligjvënësi në nenin 39/1, pika 3 të ligjit nr. 7703/1993, pa ekuivok dhe pa dyshim është i njëjtë me konceptin e vendimit përfundimtar dhe të paankimueshëm gjyqësisht. Me këtë zgjidhje ligjvënësi ka konkluduar se çështja konsiderohet e përfunduar në procedurën administrative, pa asnjë mundësi ankimi në gjykatë

132. Së dyti, nëse ligjvënësi do të kishte pasur të konsoliduar si qëllim të këtij ligji se cilësia "formë e prerë" e vendimeve të KMCAP Epror, nuk është e njëjtë me cilësinë e "vendimit përfundimtar, të paankimueshëm gjyqësisht", nuk do të ishte e nevojshme angazhimi i Kuvendit, në vitin 2011, që nëpërmjet ndryshimeve të ligjit nr. 7703/1993, të kërkonte përmbushjen e standardeve të GJEDNJ-së, për ta konturuar KMCAP Epror si quazi gjykatë. Kolegji vlerëson se synimi i ligjvënësit, pavarësisht se nuk e ka përmbushur tërësisht këtë detyrim të GJEDNJ-së, për ta formatuar KMCAP Epror si një organ quazi gjyqësor, përputhet me konceptin për të mos lejuar kundërshtimin në gjykatë të këtyre vendimeve.

133. Në kushtet ku neni 39/1, pika 3, ka ndaluar shprehimisht kontrollin gjyqësor të vendimeve të KMCAP Epror, përpara Kolegjit shtrohet për zgjidhje çështja nëse i lejohet gjykatës, në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, të refuzojë apo të shmang zbatimin e ligjit, kur vlerëson se ky i fundit vjen në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, në veçanti me KEDNJ, duke kërkuar zbatimin e drejtpërdrejtë të kësaj të fundit. Kjo është një nga çështjet që Gjykata e Lartë i'a shtroi për zgjidhje Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet kontrollit incidental, me qëllim shfuqizimin e nenit 39/1, pika 3 të Ligjit nr. 7703/1993".[109]

Arsyetimi i mësipërm, duket se nuk përputhet me rregullat e shkollës tekstualiste të interpretimit dhe konkretisht të rregullit të përdorimit të qendrueshëm të termave *(Presumption of Consistent Usage)*, ku sipas këtij rregulli një term ka të njëjtin kuptim në çdo pjesë të tekstit ligjor apo të ligjeve të ndryshme ku ai përdoret. Ndërsa një ndryshim në përmbajtjen e termit, tregon edhe një ndryshim në kuptimin e tij.[110] E parë në këtë aspekt, termi "vendim i formës së prerë", është përdorur nga legjislacioni procedural civil, penal por edhe akte të tjera, kryesisht ato për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, organet e drejtësisë etj (që citohen nga Gjykata Kushtetuese), në kuptimin e ekzekutueshmërisë, por jo se këto akte bëheshin të paankimueshëm.

Për këtë arsye, përdorimi i termit "vendim i formës së prerë", nga neni 39/1, pika 3 e këtij ligji, nuk do të thotë që ky vendim është përfundimtar. Përkundrazi, kur ligjvënësi ka dashur që të jetë i qartë në paankimueshmërinë e vendimit, këtë e ka bërë në mënyrë të qartë, duke vendosur edhe termin "përfundimtar". Në këtë rast, Gjykata e Lartë, duke iu përpjekur që t'i japë përgjigje arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese, citon pjesërisht shembujt e dhënë nga kjo e fundit. Kështu, Gjykata e Lartë, nuk trajton rastet e parashikuara nga ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar; ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në RSH", i ndryshuar si edhe ligji nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", por citon vetëm vendimin njësues penal nr.2, datë 3.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, edhe citimi i dispozitave të tjera të ligjit nr.7703/1993 duket sikur nuk ndihmon në këtë drejtim. Referimi në dy dispozita që kanë të bëjnë me mbarimin e mandatit të anëtarit të KMCAP, për shkak një vendimi fajësie, apo konstatimi paaftësie me vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk do të thotë që këto vendime janë përfundimtare. Këto vendime janë të ekzekutueshme dhe sjell humbjen e mandatit të tij, pavarësisht se personi mund të vijojë të ankohet në Gjykatën e Lartë (nuk ka asnjë kufizim për këtë). Për rrjedhojë vendimi gjyqësor në atë rast është i ankimueshëm, pavarësisht pasojave që sjell vendimi i marrë nga gjykatat e apelit. Edhe referimi që bëhet në nenin 86 të ligjit nr.7703/1993, ka dallim, pasi kjo dispozitë, përmban termin "përfundimtar", ndërkohë që neni 39/1, pika 3, nuk e përmban një term të tillë. Kjo duket qartë edhe nga fakti që Gjykata e Lartë ka konsideruar të pazbatueshëm nenin 39/1, pika 3, por jo edhe nenin 86 të këtij ligji.

[109] Vendimi njëhsues nr.00–2021–1317 (113), datë 22.7.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

[110] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts*. Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 170.

Përsa i përket referimit në relacione dhe dokumenta të tjerë, këto duke qenë akte që hartohen nga administrata e Këshillit të Ministrave dhe nuk diskutohen, amendohen, votohen apo miratohen në Kuvend, nuk mund të jenë akte mbi të cilat të bazohemi për të ndryshuar kuptimin e fjalëve të një teksti ligjor.[111]

Bazuar në këto arsye, Gjykata e Lartë, duke zbatuar metodat tekstualiste të interpretimit, mundej që të t'i jepte zgjidhje çështjes, duke mos dalë kundër Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, si edhe kundër Gjykatës Kushtetuese.

Për më tëpër, Gjykata e Lartë, konklzuionet e mësipërme, duket se nuk i gjeti të zbatueshme në raste të tjera. Më konkretisht në një çështje të mëvonshme, Gjykata e Lartë, ka mbajtur qëndrimin se "*18. Neni 32 i ligjit nr. 96/2016 "Verifikimi i pasurisë dhe figurës", parashikon procedurën që ndjek KLGJ dhe të drejtën e ankimi ndaj vendimmarrje së saj. Me ligjin nr. 50/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.05.2021, neni 32 ka ndryshuar në pikën 6 të tij me formulimin se "Kandidatët, të cilët nuk pranohen në Shkollën e Magjistraturës, kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për shfuqizimin e vendimit të Këshillit ose rrëzimin e padisë brenda dy javëve nga paraqitja e tij. Vendimi i gjykatës kompetente është përfundimtar dhe i formës së prerë." Me ndryshimet e ligjit nr 50/2021 u shtua në mënyrë eksplicite parashikimi se "Vendimi i gjykatës kompetente është përfundimtar dhe i formës së prerë." Rezulton se vendimi objekt gjykimi është marrë nga pala e paditur më datë 09.06.2021, pra pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve me ligjin nr. 50/2021 ... 22.Kolegji në vështrim të këtyre dispozitave ligjore konstaton se një vendim gjyqësor i formës së prerë, në çdo rast, është një vendim gjyqësor me fuqi ekzekutive, por jo domosdoshmërisht konsiderohet si një vendim përfundimtar, sepse ligji ka parashikuar formën e prerë të vendimeve të gjykatave të apelit, pavarësisht se ato mund të rekursohen në rrugë të zakonshme ankimi pranë Gjykatës së Lartë, e cila brenda juridiksionit të saj ligjor eventualisht edhe mund të ndryshojë vendimmarrjen, ndonëse tashmë të ekzekutuar. Kjo do të thotë që në këto raste, vendimi përfundimtar (final) është vendimi i kolegjeve përkatëse të Gjykatës së Lartë (në rastet kur ushtrohet ankim) dhe jo vendimi i gjykatës së apelit, i cili është bërë i ekzekutueshëm. 23. ... Paqartësitë konceptuale mes vendimit të gjyqësor të formës së prerë, për efekt ekzekutueshmërie dhe vendimit gjyqësor të formës së prerë, për efekt të gjësë së gjykuar, janë hasur edhe më parë, në parashikimet tashmë të shfuqizuara të Kodit të Procedurës Penale, të cilat gjeneruan vendimin unifikues nr. 2, datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, në vijim të tij, edhe disa ndryshime legjislative. ... 26. Kolegji vlerëson se në praktikën gjyqësore është konsoliduar qëndrimi, referuar edhe praktikës njësuese të Kolegjeve të Bashkuara, se një vendim gjyqësor i formës së prerë është menjëherë i ekzekuteshëm, por jo domosdoshmërisht ka efektet e gjësë së gjykuar (res judicata). Përkundrazi, në rastet kur një vendim gjyqësor është "i formës së prerë" dhe i shtohet gjithashtu edhe termi "përfundimtar", kjo do të thotë se ky vendim, jo vetëm është menjëherë i ekzekutueshëm, por se ndaj tij nuk ka asnjë mjet të zakonshëm ankimi, për arsye se natyra e tij finale/përfundimtare pengon gjykimin nga një gjykatë më e lartë, përveç rishikimit të vendimit. 27. Teknika legjislative e përdorur nga ligjvënësi, duke i shtuar frazës "vendim i formës së prerë" edhe termin "përfundimtar", nuk është e paqëllimtë. Duke qenë se fraza "formë e prerë" konfondohet dhe, për më tepër, nuk barazohet me efektet res judicata, Kolegji vlerëson se përforcimi i kësaj fraze me një tjetër term, pra termin "përfundimtar", i jep soliditet dhe me efekte res judicata vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, si në aspektin formal, ashtu edhe substancial. Ndryshimet e konstatuara në hartimin e dispozitave ligjore si: "vendim i formës së prerë dhe përfundimtar", "vendim i formës së prerë dhe ndaj të cilit nuk lejohet ankim", "vendim i formës së prerë ndaj të cilit nuk lejohet rekurs", duket se nuk kanë uniformitet nga pikëpamja e teknikës legjislative. Në të vërtetë formulime të tilla nuk synojnë të çekuilibrojnë të drejtën e ankimit dhe as të krijojnë ndonjë paqartësi, por veçse, për shkak të marrëdhënies specifike që rregullojnë, të japin garanci në aspektin e parimit të sigurisë juridike, duke konkluduar për pakundërshtueshmërinë e tyre. Pikërisht, natyra tepër e veçantë*

[111] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *"Reading law: The interpretation of legal texts"*, Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 369-390.

e çështjeve apo rasteve, për të cilat ligjvënësi ka parashikuar se "vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë", është në funksion të shmangies së gjendjes së pasigurisë, e cila nuk mund të vijojë pafundësisht".[112]

Siç rezulton nga arsyetimi i mësipërm, Gjykata e Lartë, iu rikthye përsëri dallimit midis termave "vendim gjyqësor i formës së prerë" dhe "vendim gjyqësor i formës së prerë dhe përfundimtar", duke bërë dallimin midis ankimueshmërisë ose jo të këtyre vendimeve. Në këtë rast, Gjykata e Lartë e bëri të qartë se vetëm në rastet kur vendimi cilësohet nga norma ligjore si "përfundimtar", vetëm atëherë ai bëhet i paankimueshëm.

Si për ta përfocuar më tej këtë qëndrim, megjithëse nuk e konsideroi të drejtë vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, më vonë, është përsëri Gjykata e Lartë, që e citon dhe e përdor në mbështetje të arsyetimit të saj. Kështu, në jurisprudencën e mëvonshme të vetë Gjykatës së Lartë, arsyetohet se *"43. Në mbështetje të argumentave të parashtruara më sipër, Kolegji sjell në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin nr. 55, datë 31.03.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve ka vlerësuar se shprehja e vënë në dyshim nga gjykata referuese (Gjykata e Lartë) "formë e prerë" është përdorur nga legjislacioni procedural edhe në raste të tjera, pa penguar kontrollin gjyqësor deri në Gjykatën e Lartë (shih ligjin nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar; ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH", të ndryshuar; ligjin 133/2015 "Për Trajtimin e Pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave"). Pra konstatohet se edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese orienton kuptimin e togfjalëshit "formë e prerë" në drejtim të mospengimit të të drejtës së ankimit"*.[113]

Kjo qasje e fundit, tregon sikur Gjykata e Lartë, është tërhequr nga qëndrimi i saj i mëparshëm dhe i është rikthyer metodave tradicionale të interpretimit. Ky shembull tregon që metodat "evolutive" të interpretimit nuk prodhojnë një jurisprudencë të qëndrueshme, por përkundrazi krijojnë një jurisprudencë të paqartë dhe mosmarrëveshje në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar.

7. Përdorimi jo i drejtë i së drejtës së krahasuar

Një nga metodat që përdorin gjyqtarët evolutistë është edhe e drejta e krahasuar, por nga analiza e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë rezulton se nuk ka kritere të qarta në përdorimin e kësaj metode. Më shumë duket se përdorimi i kësaj metode, ushtrohet vetëm kur i shërben rezultatit që gjyqtarët kërkojnë të arrijnë, por ndërkohë injorohet në rastet e tjera. Ky konkluzion mund të ilustrohet nëpërmjet këtyre shembujve vijues.

Në vitin 2022, Gjykata Kushtetuese dha vendimin e saj për rastin e shkarkimit të Presidentit, procedurë kjo e iniciuar nga ana e Kuvendit. Në atë rast, një nga pretendimet e ngritura nga ana e Kuvendit, ishte edhe shkelja e betimit prej Kryetarit të Shtetit, qasje kjo që bazohej dhe në Kushtetutën e Lituanisë. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, e rrëzoi këtë pretendim, ndër të tjera duke u arsyetuar se *"Gjykata vëren se Kushtetuta nuk e përcakton shkeljen e betimit si shkak të veçantë për shkarkimin e Presidentit nga detyra, në ndryshim nga sisteme të tjera kushtetuese, siç është ai i Lituanisë, që referohet nga Kuvendi në vendimin e shkarkimit"*. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese, i është referuar vetëm tekstit të Kushtetutës së Lituanisë, por jo jurisprudencës të Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë (megjithëse Kuvendi bazohej tek kjo jurisprudencë), që në këtë rast, kishte përcaktuar se "*Gjykata Kushtetuese gjithashtu deklaroi se një shkelje e betimit është gjithashtu një shkelje e rëndë e Kushtetutës, ndërsa një shkelje e rëndë e Kushtetutës është gjithashtu një shkelje e betimit"*.[114] Siç rezulton nga ky pasazh, për Gjykatën Kushtetuese të Lituanisë, teksti i Kushtetutës së Lituanisë, nuk kishte asnjë dallim midis shkeljes së Kushtetutës dhe shkeljes së betimit, duke vlerësuar si shkeljen e njërës ashtu edhe të tjetrës si rast të njëjtë. Ndërkohë Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, indirekt na çon në konkluzionin se Gjykata Kushtetuese e Lituanisë e ka interpretuar gabim Kushtetutën e vendit të vetë dhe Gjykata Kushtetuese e jonë ka bërë interpretimin më të saktë të Kushtetutës së atij vendit.

---

[112] Vendimi nr. 00-2022-656, datë 11.4.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Shih edhe Vendimin nr. 00-2022-1717 (265), datë 7.7.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

[113] Vendimi nr.00-2022-1717 (265), datë 7.7.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Shih edhe vendimin nr. 00-2022-2178, datë 6.10.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

[114] Vendimi nr.14/04, datë 31 mars 2004 i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë.

Qartazi një konkluzion i tillë nuk mundet që të qëndrojë, por Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, nuk jep asnjë arsye në vendimin e saj, përse në këtë rast, vendosi të mos e marrë në konsideratë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, kur në raste të tjera ka mbajtur qëndrim pozitiv, duke cituar disa herë legjislacionin si edhe vendime të Gjykatës Kushtetuese të atij vendi.[115] Në këtë aspekt është e pakuptimtë se përse për nëntë here referimi në Kushtetutën, legjislacionin dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, ishte i drejtë dhe herën e dhjetë nuk ishte.

Një tjetër shembull, nga vjen nga Gjykata e Lartë, e cila në një rast vendosi që normat administrative që janë favorizuese për palën, kanë fuqi prapavepruese. Në këtë rast, Gjykata e Lartë shmang totalisht në pjesën e saj arsyetuese, legjislacionin shqiptar të zbatueshëm, kur arsyeton se *"40. Pikërisht, zbatimi i ligjit me efekt favorizues edhe ndaj situatave që kanë lindur më parë, pavarësisht nëse ligjvënësi nuk e ka parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë efektin prapaveprues (një lloj paralelizmi me një nga rastet kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese "për çështje ende të paezauruara"- neni 76, pika 7, shkronja c) të ligjit 99/2016), vlerësohet si një zgjidhje e pranueshme nga pikëpamja kushtetuese. Zbatimi i efekteve prapavepruese të ligjeve favorizuese, i pranuar si përjashtim në ligjet penale favorizuese, nuk ndalohet në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm dhe as në rastet kur paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme"*.[116]

Nga ky pasazh del se Gjykata e Lartë, pretendon se nga ana e ligjvënësit nuk ka ndonjë rregullim në lidhje me efektin prapaveprues të normave legjislative që miratohen, por duke thënë këtë, nuk merr në konsideratë parashikimin e nenit 37, pika 1 të Ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, sipas të cilit "Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët *dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ*". Gjykata e Lartë në të gjithë arsyetimin e saj, nuk ndalet për asnjë moment të arsyetojë se përse ky parashikim ligjor, që ndodhet për më tepër në legjislacionin e saj procedural, që është i zbatueshëm për gjykimet që zhvillohen pranë saj, nuk është i zbatueshëm në rastin konkret. Mesa duket Gjykata e Lartë, kërkonte krijimin e një norme të re, të cilën e gjen në të drejtën e krahasuar, duke qenë se i referohet një vendimi të GJEDNJ-së, disa vendime të Gjykatës Kushtetuese të Italisë të viteve 2010, 2011 dhe 2012,[117] si edhe një vendim të Gjykatës së Kasacionit të Italisë të vitit 2019.[118] Përdorimi i këtyre vendimeve duket se është bërë jashtë kontekstit të tyre, pasi në vitin 2016, rezulton që Gjykata Kushtetuese e Italisë ka mbajtur qëndrimin se *"3.6.– Në fund të fundit, nuk ekziston, brenda kuadrit të garancive të dhëna nga KEDNJ, siç interpretohet nga Gjykata e Strasburgut, pranimi i një detyrimi konventor në lidhje me ndonjë parim të përgjithshëm, që në sistemet e brendshme ligjore të shteteve anëtare individuale, të pranohet parimit i prapaveprueshmërisë të ligjit më të favorshëm, për t'u transpozuar në sistemin e sanksioneve administrative. ... 4.2.– Duke iu referuar nenit. 3 të Kushtetutës, jurisprudencës së vazhdueshme e kësaj gjykate, të cilës i referohet edhe vetë gjykata referuese, pohohet se në çështjen e sanksioneve administrative nuk është e mundur të gjendet një kufizim kushtetues në kuptimin e zbatimit në çdo rast të ligjit favorizues, pasi është në diskrecionin e ligjvënësit – në përputhje me kufirin e arsyeshmërisë – që të përshtasë vendimet e tij sipas kritereve të ashpërsisë më të madhe ose më të vogël në bazë të çështjeve që mbulon disiplina (vendimet nr. 245, 2003, nr. 501 dhe nr.140 i vitit 2002)".*[119]

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese të Italisë, është mjaft i qartë ku tregon që nuk buron ndonjë detyrim nga KEDNJ dhe nga jurisprudenca e GJEDNJ, që ligjet administrative më të favorshme duhet që të kenë fuqi prapavepruese, qasje kjo që është pranuar dhe nga Gjykata e Lartë e Kasacionit të Italisë.[120]

---

[115] Vendimet nr.9, datë 23.3.2010; nr.21, datë 29.4.2010; nr.30, datë 17.6.2010; nr.44, datë 7.10.2011; nr.22, datë 24.4.2015; nr.71, datë 27.11.2015; nr.33, datë 8.6.2016; nr.20, datë 20.4.2021 dhe nr.27, datë 29.6.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

[116] Vendimi nr.00-2022-751, datë 25.3.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

[117] Vendimet nr.209, i vitit 2010; nr.64 i vitit 2011; nr.93, i vitit 2011 dhe nr.78 i vitit 2012 të Gjykatës Kushtetuese së Italisë.

[118] Vendimi nr.11 750/2019, i Gjykatës së Lartë të Kasacionit të Italisë.

[119] Vendimi nr.193, i vitit 2016 i Gjykatës Kushtetuese të Italisë.

[120] Vendimi nr.30 499, datë 18.10.2022 i Seksionit II Civil të Gjykatës së Lartë të Kasacionit të Italisë.

Bazuar nga sa më sipër, shohim një shmangie të paarsyetuar të Gjykatës së Lartë nga legjislacioni i brendshëm dhe një referim akoma më të paqartë në jurisprudencën gjyqësore të Italisë, ku nuk kuptohet se perse janë zgjedhur disa vendime dhe janë shmangur disa të tjera. Pra, nuk ka një kriter objektiv, për të përcaktuar se si përzgjidhen materialet nga e drejta e krahasuar.

Qasjet e mësipërme, të marra si shembuj, tregon se përdorimi i metodës krahasimore, përdoret në varësi të rezultatit që kërkohet të arrihet nëpërmjet vendimit gjyqësor dhe jo për zbatimin korrekt të normës së shkruar. Për rrjedhojë deri më sot, si Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë, nuk kanë përpunuar asnjë test objektiv se kur e drejta e krahasuar mund të përdoret, ose jo, në jurisprudencën e gjykatave shqiptare. Kjo mungesë ka krijuar mundësinë e përdorimit të saj, pa ndonjë kriter dhe për më tepër në mënyrë kaotike.

Personalisht jam i mendimit që e drejta e krahasuar mund të përdoret në dy raste, ku së pari, kemi të bëjmë me situatën ku norma juridike që do të zbatohet në zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete është marrë si model nga një akt i ndonjë shtetit të caktuar dhe për rrjedhojë jurisprudenca e gjykatave të atij shteti mund të përdoren. Së dyti e drejta e krahasuar, mund të përdoret edhe në rastin kur normat juridike, të vendit tonë, janë të njëjta ose substancialisht të njëjta me të drejtën e huaj. Në këtë rast mund të lejohet përdorimi i tyre, nëse nuk bien në kundërshtim me rregullat e tjera të interpretimit tekstual të cilat tregojnë qartë qëllimin që ka legjislacioni shqiptar.

Dëshiroj ta mbyll këtë nënçështje me shprehjen e një gjyqtari të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në lidhje me përdorimin e së drejtës së krahasuar dhe më konkretisht "Të përdorësh të drejtën e huaj kur ai përputhet me mendimin e dikujt dhe ta shpërfillësh atë kur nuk përputhet, nuk është vendimmarrje e arsyetuar, por dinakëri."[121]

8. Metoda "evolutive" e interpretimit si atribut vetëm i pushtetit gjyqësor

Bazuar në doktrinën e "interpretimit evolutiv/normë-krijues/pragmatist", gjykatat justifikojnë veten në krijimin e normave juridike, por kjo qasje e tyre, përveç se nuk ka bazë kushtetuese dhe ligjore, krijon edhe një qasje të gabuar në raport me pushtetin legjislativ dhe pushtetin ekzekutiv.

Pushteti ligjvënës, për nga natyra e tij, kryesisht shprehet me ligje. Në ushtrimin e funksioneve të tij, pushteti ligjvënës, mund të ndodhet në situata të cilat nuk kanë asnjë rregullim kushtetues, ose për të cilën ligji themelor ka parashikime të tjera. Pavarësisht kësaj, a mundet ligjvënësi, që të miratojë ligje të cilat bien ndesh me këto parashikime? A mundet ligjvënësi që të bëjë vetë një "interpretim evolutiv" të normave kushtetuese dhe për rrjedhojë të miratojë një legjislacion i cili në kuptimin "tekstual" nuk ka bazë kushtetuese, por që ligjvënësi, mendon se tashmë kushtet shoqërore, ekonomike dhe përceptimi i shoqërisë ka evoluar?

Përgjigja në këto raste, mesa duket është "JO". Kështu Gjykata Kushtetuese, ka mbajtur qendrimin se *"Pa hyrë në vlerësimin e hollësishëm të qëllimit të ligjit, Gjykata Kushtetuese çmon se mjetet e përdorura për arritjen e këtij qëllimi nuk janë kushtetuese. Dispozitat që kundërshtohen prekin mjaft dispozita kushtetuese dhe dispozita të tjera të ligjeve organike, që garantojnë pavarësinë e organeve dhe institucioneve kushtetuese të lartpërmendura",*[122] qendrim ky i mbajtur edhe më tej se *"Siç është shprehur edhe më lart, Gjykata vëren se fakti që normat ligjore renditen sipas një sistemi të shkallëzuar sipas vlerës që mbartin, shkakton një përgjegjësi të veçantë për hartuesit dhe procesin legjislativ, në drejtim të respektimit të hierarkisë, statusit dhe efektit të këtyre normave. Kjo do të thotë që dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën".*[123] Pra, në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk ka pranuar që me një ligj të zakonshëm të rregullohen marrëdhënie që duhet të rregullohen me ligje që miratohen me shumicë të cilësuar. Madje tërheq vëmendjen shprehja që përdoret në këtë rast, që mjeti i zgjedhur nga ligjvënësi, nuk është i duhuri, duke u mjaftuar në thelb, vetëm me këtë konstatim. Gjykata në këtë rast nuk e ka parë të arsyeshme të analizojë nëse Kuvendi ka bërë apo jo një "interpretim evolutiv", të normave kushtetuese dhe për rrjedhojë më ligj të zakonshëm të ndryshojë kuptimin e tyre. Është e dukshme që një mundësi e tillë për Kuvendin, si organ ligjvënës, është totalisht e palejueshme (dhe me të drejtë).

---

[121] Mendimi i gjyqtarit Antonin Scalia në çështjen "Roper v. Simmons 543 U. S. 551, 627 (2005)".

[122] Vendimi nr.19, datë 3.5.2007 i Gjykatës Kushtetuese.

[123] Vendimi nr.10, datë 6.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

Një tjetër pushtet kushtetues është edhe pushteti ekzekutiv, i cili ushtrohet nga disa organe kushtetuese dhe ligjore, por më të rëndësishmit janë Këshilli i Ministrave, si edhe ministrat. Në ndryshim nga Kuvendi, këto organe kushtetuese, si edhe organet e tyre të varësisë apo strukturat e tyre, janë të ngarkuara me zbatimin e ligjeve në raste konkrete dhe të përditshme. Kjo do të thotë që mangësitë ligjore, për zgjidhjen e çështjeve të caktuara, konstatohen më shpejt nga këto organe kushtetuese/administrative, madje volumi i marrëdhënie juridike që shqyrtohen prej tyre, mund të jetë edhe më i lartë se atyre gjyqësore.

Ndodhur përballë kësaj situate, a mundet që edhe Këshilli i Ministrave, ministrat dhe/apo organet e tjera kushtetuese/administrative, duke pretenduar se legjislacioni ka boshllëqe apo se nuk i përgjigjet më kohës, të krijojë norma të reja duke zbatuar doktrinën e "interpretimit evolutiv". Edhe në këtë rast, nga praktika gjyqësore, rezulton se përgjigja është përsëri "JO". Nuk rezulton asnjë vendim gjyqësor që të ketë konfirmuar dhe lënë në fuqi, akte të pushtetit ekzekutiv me argumentin e "interpretimit evolutiv", pra, që legjislacioni nuk autorizon nxjerrjen e këtyre akteve nënligjore, por duke qenë se kushtet ekonomike, shoqërore dhe përceptimi social kanë ndryshuara, atëherë këto akte të ekzekutivit do të ishin të justifikueshme nën këtë doktrinë. Përkundrazi dhe me të drejtë, sa herë është tejkaluar kompetenca për të nxjerrë akte nënligjore, ato janë shfuqizuar nga organet gjyqësore.

Për ta ilustruar më saktë, këtë problematikë, po i referohemi edhe dy rasteve praktike, njëri nga Gjykata e Lartë e Shqipërisë dhe tjetri nga GJEDNJ që kanë të bëjnë me të drejtat mejdisore. Kështu në Shqipëri, ka rezultuar se Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ka miratuar Vendimin nr.467, datë 26.7.2018 "Për zgjerimin e sipërfaqes së Parkut Kombëtar Mali i Tomorit", akt i cili u kundërshtua në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila vendosi shfuqizimin e tij. Mbi rekursin e paraqitur nga palët gjyqhumbëse, Gjykata e Lartë vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës më të ulët duke arsyetuar se *"17. Në interpretim të dispozitës së sipërcituar dhe ashtu sikurse i ka rezultuar nga hetimi Gjykatës Administrative të Apelit, ministri i Turizmit dhe Mjedisit ka vepruar në kundërshtim me nenin 36 të ligjit të sipërcituar, pasi i ka dërguar Këshillit të Ministrave propozimin për zgjerimin e sipërfaqes së Parkut Kombëtar të Malit të Tomorit në mungesë të dokumentacionit ligjor, e konkretisht në mungesë të vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit për ndryshimin e sipërfaqes së zonës konkrete. Ky fakt ka rezultuar i provuar dhe është vlerësuar nga gjykata e faktit, pasi me shkresën me nr. 120/1 prot., datë 01.02.2019 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit theksohet se: "Nga shtatori i vitit 2015 (periudhë në të cilën AZHT ka filluar të ushtrojë funksionet e Sekretariatit Teknik të KKT), e deri në momentin e lëshimit të kësaj shkrese, Këshilli Kombëtar i Territorit nuk ka miratuar ndonjë vendim lidhur me ndryshimin e sipërfaqes së zonës së mbrojtur mjedisore, Parku Kombëtar Mali i Tomorit". Gjithashtu ky propozim duhet të konsultohet paraprakisht edhe me subjektet e tjera privatë të prekura apo të interesuara, duke qenë se këto subjekte kanë të drejtën e kundërshtimeve me shkrim ndaj propozimit për përfshirjen e pronësisë private në zonat e mbrojtura dhe ministri i Mjedisit, pasi të njihet me kundërshtimet ia dërgon ato KKT për t'i shqyrtuar dhe kundër vendimit të KKT, subjektet e interesuara kanë të drejtën e ankimit në gjykatën administrative, në referim të nenit 53 të ligjit nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura". ... 20. Në interpretim të parashikimeve të sipërcituara, Kolegji vlerëson të theksojë se ligji nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", në shpalljen e zonave të mbrojtura, jo pa qëllim ka parashikuar një procedurë specifike dhe të detajuar, pasi paraqet rëndësi të veçantë dhe ka si qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, të peizazhit, të trashëgimisë natyrore e kulturore, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore, sipas njërës prej kategorive të caktuara në këtë ligj (neni 10, pika 5). Pra, përcaktimi dhe vlerësimi i kritereve sipas këtij ligji për shpalljen e një zone të mbrojtur, nuk bëhet nga zyrat e institucioneve publike, por ato kanë nevojë për njohuri të posaçme dhe specifike nga ekspertë të fushës, të institucioneve akademike dhe shkencore, të institucioneve vendore apo të komunitetit të zonës brenda territorit administrativ të së cilës ndodhet zona, pasi janë këto subjekte të cilët kanë njohuritë specifike të zonës përkatëse, të biodiversitetit të saj, të faunës dhe florës dhe se mund të përcaktojnë nëse ka rrezikshmëri të shkatërrohet nga ndërhyrjet e veprimtarisë njerëzore. Në këtë kuptim, organi publik i ngarkuar nga ligji për përcaktimin e një zone të mbrojtur, pasi merr mendimin e ekspertëve të fushës dhe pasi merr në vlerësim dhe analizon masën e cenimin e të drejtave të komunitetit të zonës, pronarëve privatë apo biznese që ushtrojnë veprimtari në këtë zone, si dhe me qëllim për të ruajtur një raport të barazpeshuar dhe të drejtë midis interesit publik dhe atij privat, vendos se sa do të jetë sipërfaqja që do të shpallet zonë e mbrojtur. Si konkluzion Kolegji thekson se në këtë linjë interpretimi të sipërcituar zbatohet dhe nuk cenohet parimi i proporcionalitetit. Tashmë praktika është konsoliduar në lidhje me*

këtë parim, sipas së cilit veprimtaria administrative e kryer nga organet publike është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës, b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj dhe c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë. Pala paditëse ishte në gjendje të argumentonte që akti objekt gjykimi nuk e ka respektuar këtë parim, që nuk është një akt i nevojshëm dhe se nuk është respektuar procedura ligjore për nxjerrjen e aktit duke mos u mbajtur në konsideratë nga pala e paditur kriteret ligjore për përcaktimin e zonës së mbrojtur".[124]

Siç mund të konstatohet nga arsyetimi i mësipërm, Gjykata e Lartë e Shqipërisë, ka konstatuar që Këshilli i Ministrave dhe institucionet e tjera shtetërorë, nuk kanë ndjekur dhe zbatuar procedurat ligjore, në zgjerimin e sipërfaqës së mbrojtur të Parkut Kombëtar të Malit të Tomorrit. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë tërheq më shumë vëmëndjen për pjesën tjetër, ku konkludohet se institucionet shtetërore nuk kanë përvojën dhe ekspertizën e duhur për të vlerësuar këtë gjendje apo situatë dhe duhet të thërrasin aktorë të tjerë. Pra, në këtë rast, Gjykata e Lartë i ka qendruar besnik mënyrës së formulimit të normave ligjore, duke mos ndjekur frymën, qëllimin e mirë, apo synimin që ka dashur të realizojë Këshilli i Ministrave dhe konkretisht mbrojtjen e mjedisit.

Nga ana tjetër, pothuaj i gjithë komuniteti juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, ka vlerësuar, duke e quajtur historike madje, evoluimin e konceptit "jetë private" që parashikohet në nenin 8 të KEDNJ, ku tashmë, sipas një vendim të fundit të GJEDNJ, ky koncept përfshin dhe të drejtën për të pasur një mjedis të pastër.[125]

Pra, rezulton qartësisht se organet ekzekutive nuk mund të kryejnë një veprimtari të tillë sa do pozitiv që të jetë qëllimi i tyre. Kjo është e kuptueshme se po t'i japësh liri veprimi të tillë organeve ekzekutive, atëherë kjo mundësi mund të përdoret dhe në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nga ana tjetër, është e pakuptimtë se përse gjykatat qenkan të afta ta kryejnë këtë veprimtari, dhe të ndryshojnë shtojnë apo shfuqizojnë normat ligjore.

Parë në këtë këndvështrim, është e pakonceptueshme se përse pushteti gjyqësor, e paska këtë mundësi, që të mos marrë në konsiderate norma kushtetuese apo ligje, të deklarojë ligje si të pazbatueshme, apo të krijojë norma të reja, ndërsa pushtetit e tjera duhet t'i "binden" normave tekstualisht.

9. A është metoda tekstualiste e interpretimit pengesë për zhvillimin e shoqërisë?

Një nga kritikat më të forta që i bëhet shkollës "tekstualiste" të interpretimit, është ngurtësia e saj ndaj normës së shkruar, dhe për rrjedhojë mos përshtatja e normave me realitetet e reja politike, shoqërore, ekonomike etj. Kjo mund të sjellë si pasojë që legjislacioni të bëhet pengesë për zhvillimin e përgjithshëm.

Kjo kritikë, që mbetet edhe më e forta ndaj shkollës "tekstualiste" të interpretimit, megjithëse në dukje duket shumë bindëse, nuk merr në konsideratë nocionin e qeverisjes demokratike. Kështu, personat që ngrenë këtë pretendim, apo bëjne këtë kritikë, në rradhë të parë do të duhet të japin përgjigje se përse në një vend demokratik, ekziston ndarja e pushteteve.

Ndarja e pushteteve, midis atyre tre tradicionaleve, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, i shërben demokracisë por jo efektivitetit të qeverisjes. Për ta bërë më bindes këtë argument, po i referohem autorit Rex. E. Lee, i cili në librin e tij "Vështrime të një juristi për Kushtetutën, ndër të tjera arsyeton se *"... çdo sistem qeverisjeje – në çdo vend, në çdo kohë – i duhet të zgjedhë në mënyrë të domosdoshme ndërmjet dy vlerave konkurruese. Këto janë efiçenca, në njërën anë, dhe kontrolli kundër ushtrimit arbitrar të pushtetit shtetëror, në anën tjetër. Është e pamundur t'i kesh të dyja këto vlera. ... Kohët e fundit unë pyeta një nga shokët e mi historianë të më jepte disa shembuj monarkësh, nën mbretërinë e të cilëve populli përparoi për shkak të efiçencës së një pushteti të tillë që i ishte veshur një individi të vetëm. Përgjigja e tij ishte: Napoleoni, Frederiku i Madh, Luigji XIV, Pjetri i Madh dhe Katerina e Madhe. Pastaj unë i kërkova të më jepte disa shëmbujsh monarkësh, të cilët e vunë popullin e tyre nën vuajtje të mëdha sepse ata gëzonin pushtet absolut e të pakontrolluar. Ai u mendua për një moment, buzëqeshi, dhe u përgjigj: Napoleoni, Frederiku i Madh, Luigji XIV, Pjetri i Madh dhe Katerina e Madhe. Në secilin rast, në*

[124] Vendimi nr.00-2023-499 (15), datë 20.1.2023 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

[125] GJEDNJ, Dhoma e Madhe, çështja *"Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerë kundër Zvicrës"*, aplikimi nr.53600/20, datë 9.4.2024.

periudha të ndryshme të regjimeve të monarkëve individualë ekzistonin rrethana të ndryshme. Në asnjë rast mbreti nuk ishte në gjendje që ta përdorte pushtetin e tij absolut vetëm për të mirë, dhe t'i rezistonte joshjes për shpërdorime. Një çështje e rëndësishme është se inefiçenca është një kosto e domosdoshme për të shmangur regjimin tiranik. E parë në këtë aspekt, produkti ja vlen për çmimin që ka".[126]

Pra, e parë tashmë me këtë këndvështrim, me Kushtetutën e vitit 1998, Shqipëria ka zgjedhur sistemin qeverisës bazuar në ndarjen e pushteteve (neni 7 i Kushtetutës), duke zgjedhur qëllimisht një sistem i cili, ka probleme me efektivitetin e tij. Kjo vjen si rezultat i përplasjes dhe debatit midis aktorëve të ndryshëm politikë, të cilët duhet të arrijnë një kompromis të caktuar ose të marrin një shumicë të caktuar. Por të paktën, në këtë mënyrë zhvillohet një debat i gjërë publik dhe nëse elektorati nuk është dakord me zgjidhjen e përfaqësuesve të tij, ka të drejtë në zgjedhjet më të afërta të votojë kundër tyre pa dhënë asnjë arsye. Kurse një vendimmarrje që krijon norma, e realizuar nga gjykatat, i heq elektoratit mundësinë e debatit dhe të ballafaqimit të ideve të ndryshme. Për më tepër, nëse elektorati nuk është dakord me këtë lloj zgjidhjeje të bërë nga gjykatat, nuk ka mundësi të votojë kundër tyre, por vetëm të bindet. Është e qartë që kjo zgjidhje e dytë nuk përputhet me vlerat e demokracisë.

Normat që kanë të bëjnë me ndarjen e pushteteve zënë vend thelbësor në një Kushtetutë, duke përbërë parakusht për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kjo sepse ekzistenca e normave që garantojnë ndarjen dhe balancimin e pushteteve krijon më pak premisa për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. E kundërta, një pushtet i përqendruar, pavarësisht parashikimeve lidhur me garantimin e të drejtave dhe liritë themelore te njeriut, ka premisa që t'i shkelë ato.

Kjo duket qartë edhe në hartimin e Kushtetutës së SHBA-së, i pari vend në botë që aplikoi parimin e ndarjes së pushteteve, ku në fillim, ky ligj themelor, trajtonte vetëm pushtetet e ndryshme dhe ndarjen e tyre. Të drejtat dhe liritë themelore u vendosën më vonë, nëpërmjet amendamenteve kushtetuese.

Për ta bërë më konkrete si rast, po i referohemi edhe Kushtetutës së Shqipërisë së vitit 1976, e cila në kreun II, nenet 38–65 trajtonte të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, ku përfshiheshin liria e shprehjes, e votimit, e organizimit, e punës, e familjes etj. Por nga ana tjetër kjo Kushtetutë vendoste varësinë e të gjitha institucioneve nën drejtimin e Partisë së Punës. Kështu mund të përmendim, nenin 2: *Republika Populllore Socialiste e Shqipërisë mbështetet në unitetin e popullit rreth Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ka në themel aleancën e klasës puntore me fshatarësinë kooperativiste nën udhëheqjen e klasës punëtore;* nenin 3: *Partia e Punës e Shqipërisë, pararoja e klasës punëtore, është forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë;* nenin 10: *Klasa punëtore, si klasa udhëheqëse e shoqërisë, fashatarësia kooperativiste si edhe punonjësit e tjerë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, ushtrojnë kontroll të drejtëpërdrejtë dhe të organizuara mbi veprimtarinë e organeve shtetërore, të organizatave ekonomike e shoqërore dhe të punonjësve të tyre për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit dhe për forcimin e rendit socialist;* nenin 67: *Kuvendi Populllor ka këto kompetenca kryesore: Përcakton, në përputhje me vijën e përgjithshme dhe direktivat e Partisë së Punës të Shqipërisë, drejtimet kryesore të politikës së brendshme e të jashtme të shtetit;* nenin 88: *Forcat e Armatosura udhëhiqen nga Partia e Punës e Shqipërisë* dhe nenin 89; *Sekretari i parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Kryetar i Këshillit të Mbrojtjes.*

Nga këto dispozita kuptohet që Partisë së Punës i jepej rol kryesor në organizimin e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit. Gjithashtu edhe ai që cilësohej si organi më i lartë i pushtetit shtetëror, Kuvendi Populllor, vepronte *në përputhje me vijën e përgjithshme dhe direktivat e Partisë së Punës të Shqipërisë.* Praktikisht, me këtë akt kushtetues, Shteti vendosej kushtetutshmërisht si një strukturë varësie e Partisë së Punës.[127] Duhet të kemi në konsideratë, gjithashtu, se kjo është edhe periudha ku në Shqipëri, të drejtat e njeriut janë shkelur në mënyrën më të keqe të mundshme dhe për këtë arsye, parimi i ndarjes së pushteteve merr rol thelbësor.

---

[126] Lee, Rex E. *Vështrime të një juristi për Kushtetutën*, përkthyer nga Petrit Plloçi, Shtëpia botuese "Nënë Tereza", Tiranë 2000, f. 52-53.

[127]Merkuri, Erind. *Një vështrim mbi ndryshimet kushtetuese në Shqipëri gjatë regjimit komunist - Përse ishin të nevojshme.* Botuar në aktet e konferencës shkencore kombëtare "Historia dhe historiografia: Refleksione mbi Shqipërinë e viteve 1945-1990", organizuar me datë 9.6.2022, nga Instituti i Historisë – Akademia e Studimeve Albanologjike, Editor Afrim Krasniqi, Tiranë 2023, f. 216.

Në zbatimin e teorisë "evolustiste", gjykatat, nuk kanë asnjë problem që të përfshihen në fushën kushtetuese të pushtetit legjislativ, por nga ana tjetër kur kjo lloj vendimmarrje kritikohet, gjykatat tentojnë me shpejtësi të mbrohen pas parimit të ndarjes së pushteteve dhe kërkojnë respektimin e vendimeve të tyre. Është e kuptueshme që një logjike e tillë me dy standarde nuk mundet që të qendrojë.

Në përfundim të trajtimit të kësaj nënçështjeje, përgjegjsia për përditësimin dhe zhvillimin e legjislacionit në përputhje me kushtet e reja ekonomike, politike dhe shoqërore, nuk është përgjegjësi e gjykatave, por e pushtetit legjislativ, i cili përbëhet nga aktorë të ndryshëm politikë dhe ku normalisht procesi i diskutimeve dhe i miratimit të legjislacionit kërkon kohën e tij. Kjo "inefiçencë" është bërë e qëllimshme dhe është një nga vlerat kryesore të një shteti demokratik.

10. Konkluzione

Debati midis këtyre dy shkollave të interpretimit të së drejtës, vijon të jetë aktual. Doktrina "tekstualiste" bazohet në nocionet e ndarjes së pushteteve, dhe respektimin e vullnetit ligjvënës. Sipas kësaj doktrine, populli dhe ligjvënësit janë plotësisht të aftë që të t'i përballen me sfidat që sjell jeta dhe të përshtasin legjislacionin në lidhje me këto ndryshime.

Nga ana tjetër, ka një tendencë për të përdorur gjithmonë e më shumë metodën e "interpretimit evolutiv". Ndikimi i GJEDNJ-së, e cila për nga natyra e saj është shumë pak e kontrollueshme, bën që ajo të ketë peshë me ndikim të lartë edhe në mënyrën se si shtetet do të duhet që të interpretojnë normat e tyre të brendshme. Gjithashtu dhe gjykatat kombëtare, duke u bazuar në GJEDNJ kanë gjetur justifikimin e tyre për të përdorur gjithmonë e më shumë metodën e "interpretimit evolutiv".

Kjo qasje gjithmonë e më e theksuar po na çon drejt disa "super elitave" të përbërë nga gjyqtarë, të cilët janë të vetmit që kanë aftësinë për të vlerësuar qëllimet e fshehta të ligjvënësit kushtetues, frymën e ligjit, ndryshimet dhe nevojat e shoqërisë.

Në thelb përdorimi i kësaj teknike, nuk sjell vetëm "përfitime" siç paraqitet. Duke iu referuar shembujve të cituar në këtë punim, ka edhe raste kur nëpërmjet kësaj doktrine janë kufizuar të drejtat dhe liritë themelore. Kjo doktrinë nuk gjen mbështetje në asnjë prej parashikimeve kushtetuese dhe për më tepër, nuk kuptohet pse është vetëm atribut i pushtetit gjyqësor, kurse pushteti ligjvënës dhe ai ekzekutiv duhet detyrimisht që të qendrojnë brenda kornizave të vendosura nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi.

Doktrina e "interpretimit evolutiv" apo e "Kushtetutës së gjallë", mohon zhvillimin normal të shoqërisë dhe proceset demokratike. Në fakt duke vendosur shumë gjera nëpërmjet vendimmarrjes gjyqësore, shoqëria privohet nga debati demokratik në lidhje me këto çështje, fenomene apo ngjarje dhe për rrjedhojë privohet edhe nga e drejta për të votuar në lidhje me to. Kjo mesa duket promovohet pasi është më e e lehtë të bindësh një trupë gjyqësore, se sa shumicën e cilësuar të trupës legjislative.

Bazuar në këto konsiderate dëshiroj ta mbyll me një shprehje të gjyqtarit amerikan Antonin Scalia, sipas të cilit *"Në praktikë, Kushtetuta e Gjallë do të ishte më mirë të quhej Demokracia e Vdekur"*.[128]

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Anastasi, Aurela *"E drejta Kushtetuese e Krahasuar"*, Shtëpia Botuese "Dajti 2000", Tiranë, 2009.
2. Anastasi, Aurela *"Çështje të ekzekutimit te vendimeve gjyqësore për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve. Përgjegjësitë institucionale dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese"*, botuar në Revistën "Jeta juridike", botim i Shkollës së Magjistraturës, nr.1, viti 2016.

[128] Scalia, Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts*, Shtëpia botuese "Thomson/West", Chigaco 2012, f. 311.

3. Berberi. Sokol. *Ligjvënësi dhe interpretimi gjyqësor i ligjit.* Botuar në revistën "Jeta juridike", botim i Shkollës së Magjistraturës, Shtëpia botuese "Morava", nr.3, viti 2014.
4. Bianku, Ledi. *Kramer kundër Kramer.A është reforma në drejtësi në përputhje me standardet evropiane.* Botuar në "Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë - Vështrime të studiuesve të së drejtës në diasporë", botuar nën kujdesin e Prof.Dr. Aurela Anastasi (Akad) dhe Prof.Dr. Shaban Sinani (Akad), nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 2023.
5. Chawawa, Morgan. *The United States Constitution and the Bible, Conflict or Compromise.* WestBow Press, Bloomfield. 2019.
6. *"Debati kushtetues",* Vëllimi I, botim i OSBE, Tiranë 2006.
7. Elezi, Ismet*"Zhvillimi i legjislacionit penal në Shqipëri",* Tiranë 1997.
8. *"Fjalori i Gjuhës Shqipe",* botim Akademisë së Shkencave – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 2006.
9. Kalaja, Florjan. *Strasburg disappointments.*Marrë nga adresa e internetit https://www.academia.edu/44597149/STRASBURG_DISAPPOINTMENTS.
10. Kalaja, Florjan *"Refleksione mbi veprën penale të fshehjes dhe asgjesimit të kufomës",* botuar në revistën "Studime juridike", nr.1, viti 2023, botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.
11. Lee, Rex E. *Vështrime të një juristi për Kushtetutën.* Përkthyer nga Petrit Plloçi, Shtëpia botuese "Nënë Tereza", Tiranë 2000.
12. Merkuri, Erind. *Një vështrim mbi ndryshimet kushtetuese në Shqipëri gjatë regjimit komunist - Përse ishin të nevojshme.*Botuar në aktet e konferencës shkencore kombëtare "Historia dhe historiografia: Refleksione mbi Shqipërinë e viteve 1945-1990", organizuar me datë 9.6.2022, nga Instituti i Historisë -Akademia e Studimeve Albanologjike, Editor Afrim Krasniqi, Tiranë 2023.
13. Merkuri, Erind. *Analizimi dhe vlerësimi i (projekt) Statutit Organik të Shqipërisë të vitit 1914.* Botuar në revistën "Studime juridike", Shtëpia botuese "Flesh", nr.2, të vitit 2023, Tiranë 2024.
14. Omari, Luan Aurela Anastasi, *"E drejta kushtetuese"*, Shtëpia botuese "Djati 2000", Tiranë 2017.
15. Sadushi, Sokol. *E drejta administrative 2 – Teoria e aktit administrativ*, Shtëpia botuese "Ora", Tiranë 2005.
16. Scalia Antonin dhe Garner, Bryan A. *Reading law: The interpretation of legal texts*. Shtëpia botuese "Thomson/West.Chigaco 2012.
17. Woodrow, Wilson. *Constitutional Government in the United States,* botuar në vitin 1908, ribotuar në vitin 2011, Shtëpia Botuese "Quid Pro, LLC".
18. McBain, Howard Lee. *The Living constitution, a consideration of the realities and legends of our fundamental law.* The Workers education bureau press, 1927.

Legjislacion

1. Kushtetuta e Shqipërisë e vitit 1976.
2. Kushtetuta e Shqipërisë.
3. Kodi Penal i Shqipërisë.
4. Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë.
5. Kodi i Procedurës Civile i Shqipërisë.
6. Ligj nr.8813, datë 13.6.2002 Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Shqipërisë".
7. Ligji nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike".
8. Ligj nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
9. Ligj nr. 10 447, datë 14.07.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore", të ndryshuar.

10. Ligj nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.
11. Ligj nr.138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar.
12. Rezoluta CM/ResDH(2016)210, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 14 shtator 2016 në mbledhjen e 1264 të Zëvendës Ministrave.

Jurisprudencë

1. GJEDNJ, çështja *"Tyrer v. The United Kingdom"*, aplikimi nr.5856/72, datë 25 prill 1978.
2. GJEDNJ, Dhoma e katërt, çështja *"Dauti kundër Shqipërisë"*, aplikimi nr.19206/05, datë 3.2.2009.
3. GJEDNJ, Dhoma e Madhe, çështja *"Ilgar Mammadov v. Azerbaijan"*, procedim sipas nenit 46, pika 4 e KEDNJ, aplikimi nr.15172/13, datë 29.5.2019.
4. GJEDNJ, Seksioni i Dytë, *"Agim Beshiri and 11 others v. Albania"*, aplikimi nr.29026/06, datë 17.3.2020.
5. GJEDNJ, Dhoma e Madhe, *"Mendim këshillimor, kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Armenisë",* nr. P16-2019-001, datë 29.5.2020.
6. Vendimi nr.65, datë 10.12.1999 i Gjykatës Kushtetuese.
7. Vendimi nr.17, datë 17.4.2000 i Gjykatës Kushtetuese.
8. Vendimi nr.5, datë 7.2.2001 i Gjykatës Kushtetuese.
9. Vendimi nr.97, datë 27.7.2001 i Gjykatës Kushtetuese.
10. Vendimi nr.15, datë 17.4.2003 i Gjykatës Kushtetuese.
11. Vendimi nr.2, datë 19.1.2005 i Gjykatës Kushtetuese.
12. Vendimi nr.19, datë 3.5.2007 i Gjykatës Kushtetuese.
13. Vendimi nr.9, datë 23.3.2010 i Gjykatës Kushtetuese.
14. Vendimi nr.21, datë 29.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese.
15. Vendimi nr.30, datë 17.6.2010 i Gjykatës Kushtetuese.
16. Vendimi nr.20, datë 1.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese.
17. Vendimi nr.24, datë 9.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese.
18. Vendimi nr.44, datë 7.10.2011 i Gjykatës Kushtetuese.
19. Vendimi nr.84, datë 12.7.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.
20. Vendimi nr.10, datë 6.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese.
21. Vendimi nr.22, datë 24.4.2015 i Gjykatës Kushtetuese.
22. Vendimi nr.71, datë 27.11.2015 i Gjykatës Kushtetuese.
23. Vendimi nr.7, datë 24.2.2016 i Gjykatës Kushtetuese.
24. Vendimi nr.33, datë 8.6.2016 i Gjykatës Kushtetuese.
25. Vendimi nr.55, datë 31.3.2021 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.
26. Vendimi nr.20, datë 20.4.2021 i Gjykatës Kushtetuese.
27. Vendimi nr.27, datë 29.6.2021 i Gjykatës Kushtetuese.
28. Vendimi nr.21, datë 26.9.2022 i Gjykatës Kushtetuese.
29. Vendimi nr.2, datë 29.1.2024 i Gjykatës Kushtetuese.
30. Vendimi nr.47, datë 28.1.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
31. Vendimi nr.386, datë 29.7.1999 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
32. Vendimi nr.371, datë 27.10.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
33. Vendimi nr.61, datë 6.2.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
34. Vendimi nr.00-2011-931 (137), datë 26.10.2011 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
35. Vendimi nr.00–2012–1402 (254), datë 10.10.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
36. Vendimi nr.00-2013-1741 (315), datë 22.11.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
37. Vendimi nr.00-2014-674 (78), datë 12.3.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
38. Vendimi nr.00-2015-3041 (199), datë 9.12.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
39. Vendimi nr.00-2016-353 (37), datë 9.3.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

40. Vendimi nr.00-2017-581 (111), datë 12.7.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
41. Vendimi nr.00-2017-659 (116), datë 19.7.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
42. Vendimi nr.00-2021-670 (63), datë 26.10.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
43. Vendimi njëhsues nr. 00–2021–1317 (113), 22.7.2021 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
44. Vendimi nr.00-2022-751, datë 25.3.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
45. Vendimi nr. 00–2022–656, datë 11.4.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
46. Vendimi nr.00–2022–1513 (186), datë 12.5.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
47. Vendimi nr.00–2022–1717 (265), datë 7.7.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
48. Vendimi nr.00-2022-2178, datë 6.10.2022 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
49. Vendimi njëhsues nr. 00–2022–4586 (392), datë 26.10.2022 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
50. Vendimi nr.1, datë 28.10.2022 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
51. Vendimi nr.00-2023-406 (76), datë 21.3.2023 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
52. Vendimi nr.00–2023–499, datë 23.3.2023 i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë.
53. Vendimi nr.00-2023-1937 (136), datë 15.3.2023 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
54. Vendimi nr.00-2023-2187 (352), datë 19.12.2023 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
55. Vendimi nr.5, datë 8.3.2021 i Gjykatë së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
56. Vendimi nr.32, datë 22.08.2022 e Gjykatës së Posaçme e Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
57. Vendimi i Gjykatës së Lartë të SHBA-së në çështjen *Trop v. Dulles*, 356 U.S. 86 (1958).
58. Vendimi i Gjykatës së Lartë të SHBA-së në çështjen *Roper v. Simmons* 543 U. S. 551 (2005).
59. Vendimi i Gjykatës së Lartë të SHBA-së në çështjen *Milner v. Department of Navy,* 562 U. S. 562, 572 (2011).
60. Vendimi i Gjykatës së Lartë të SHBA-së në çështjen *Dobbs v. Jackson Women's Health Organization*, 597 U.S. 215 (2022).
61. Vendimi i Gjykatës së Lartë të SHBA-së në çështjen *United States v. Davis*, 588 U.S. ___ (2019).
62. Vendimi i Gjykatës së Lartë të SHBA-së në çështjen *Kisor v. Wilkie 588 U. S. 558 (2019)*.
63. Vendimi i Komitetit Gjyqësor të Këshillit Privat të Kurorës në çështjen *"Edwards v Canada (AG)* [1930] AC 124, [1929] UKPC 86".
64. Vendimi i Gjykatës së Lartë të Mbretërisë së Bashkuar në çështjen *"In the matter of an application by Lorraine Gallagher for Judicial Review (Northern Ireland)"*, datë 30.1.2019, [2019] UKSC 3, Case ID, UKSC 2016/0195.
65. Vendimi nr. 73/2000, date 14.3.2000 (ESP-2000-1-011) i Gjykatës Kushtetuese të Mbretërisë së Spanjës.
66. Vendimi nr.209, i vitit 2010 i Gjykatës Kushtetuese së Italisë.
67. Vendimi nr.64 i vitit 2011 i Gjykatës Kushtetuese së Italisë.
68. Vendimi nr.93, i vitit 2011 i Gjykatës Kushtetuese së Italisë.
69. Vendimi nr.78 i vitit 2012 i Gjykatës Kushtetuese së Italisë.
70. Vendimi nr.193, i vitit 2016 i Gjykatës Kushtetuese të Italisë.
71. Vendimi nr.11 750/2019, i Gjykatës së Lartë të Kasacionit të Italisë.
72. Vendimi nr.30 499, datë 18.10.2022 i Seksionit II Civil të Gjykatës së Lartë të Kasacionit të Italisë.
73. Vendimi nr.14/04, datë 31 mars 2004 i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë.

Web faqe

1. Raporti *"NGOs and the Judges of the ECHR"*, studim i "European Center for Law and Justice", 2020, marrë nga adresa: https://eclj.org/ngos-and-the-judges-of-the-echr.
2. Raporti *"The Impartiality of the ECHR – Concerns and Recommendations"*, studim i "European Center for Law and Justice", 2023, marrë nga adresa: https://eclj.org/echr-impartiality-concerns-and-recommendations.
3. https://www.jcpc.uk/

4. https://www.bailii.org/uk/cases/UKPC/1929/1929_86(image1).pdf
5. https://www.telegraph.co.uk/news/uknews/Law-and-order/8580795/We-need-to-control-the-spread-of-human-rights-Supreme-Court-judge-says.html
6. https://www.bbc.com/news/articles/cl55ggjqvx7o#:~:text=However%20Switzerland's%20parliament%20voted%20on,an%20effective%20climate%20change%20strategy
7. https://hudoc.echr.coe.int/#{%22tabvieë%22:[%22document%22ç,%22itemid%22:[%22001-167203%22ç}
8. www.supremecourt.gov
9. www.gjk.gov.al
10. www.gjykataelarte.gov.al
11. www.cortecostituzionale.it
12. https://lrkt.lt/en

DISA ASPEKTE JURIDIKE MBI TË DREJTËN KOMPARATIVE

Asoc. Prof. Dr.sc. Blerton SINANI[*]

SOME LEGAL ASPECTS ON COMPARATIVE LAW

Abstract

This paper explores key legal aspects within the field of comparative law, focusing on the methodologies and frameworks used to analyse and compare different legal systems. It examines both micro-comparative and macro-comparative approaches, detailing their respective strengths and challenges. The study delves into the historical development of comparative law, its impact on legal harmonization, and the role it plays in understanding global legal diversity. By highlighting case studies and practical applications, the paper demonstrates how comparative law facilitates cross-jurisdictional learning and legal reform. Ultimately, this research underscores the importance of comparative law in promoting legal harmonization as well as fostering legal reforms, and enhancing the development of a more cohesive international legal community.

Keywords: *comparative law, legal comparison, differences and similarities between the legal systems, typology of legal systems, reformation and modernization of legal systems.*

1. Hyrje

Marrëdhëniet shoqërore të gjithmbarshme janë të karakterit të ndryshëm, prandaj çdonjëra nga degët e veçanta të së drejtës është një tërësi normash juridike, me të cilat rregullohen marrëdhënie shoqërore të një karakteri të caktuar brënda kornizave të sistemit juridik të një shteti të caktuar. Ndërkaq, të gjithë degët e të drejtës, ndërtojnë sistemin juridik të gjithmbarshëm të një shteti të caktuar. Kjo do të thotë se sistemi juridik në një shtet të caktuar konstitutohet nga një spektër i degëve të së drejtës, të cilat me ndihmën e normave të veta juridike rregullojnë fusha të veçanta të caktuara të marrëdhënieve (raporteve) shoqërore. Në lidhje me këtë, duhet të theksohet se të gjithë degët e së drejtës nga pikëpamja ontologjike (përmbajtësore) kanë si "emërues të përbashkët" normat juridike si përbërës së përmbajtjes së brendshme të tyre që sigurojnë apo mundësojnë rregullimin e marrëdhënieve dhe të çështjeve të caktuara shoqërore në sistemin juridik të një shteti konkret. Nga ana tjetër, degët e të drejtës dallohen midis tyre nga aspekti i objektit rregullativ normativ-juridik, pra nga sfera e marrëdhënieve shoqërore që rregullojnë normat juridike që i përkasin një dege të caktuar të së drejtës pozitive nacionale. Me këtë rast lind natyrshëm pyetja: "*A është e drejta komparative një degë e të drejtës ose është vetëm një disiplinë shkencore juridike*"?

Vështruar objektivisht, e drejta komparative (*ius comparatum*)[1] nuk është një degë e të drejtës, por ajo është një disiplinë aplikative shkencore juridike. Ky qëndrim mbështetet shkencërisht dhe argumentohet juridikisht se e

[*] Asoc. Prof. Dr.sc. Blerton Sinani, Profesor i Asociuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, adresa e emailit: blerton.sinani@seeu.edu.mk.

[1] Termi "*E drejta komparative*" u përgjigjet termave: *Droit comparé* (fr.), *Comparative law* (ang.), *Diritto comparatorio* (it.), *Derecho comparado* (spa.), *Sporedbeno pravo* (maq.), *Poredbeno pravo* (kro.), ndërsa është interesante të theksohet se vetëm në gjuhën gjermane emërtohet *Rechtsvergleichung - krahasimi i ligjeve* dhe jo e drejta komparative. Në gjuhën shqipe për të shënuar të drejtën komparative si sinonime përdoren edhe këto terma juridike alternative: "*E drejta krahasimore*", "*E drejta krahasimtare*", "*E drejta krahasuese*" dhe "*E drejta e krahasuar*".

drejta komparative nuk ka një substancë normative në vetvete (nuk ngërthen apo përmban në vetvete norma juridike), sikurse ka e drejta kushtetuese, e drejta administrative, përfshirë dhe degë të tjera të së drejtës. Për rrjedhojë, e drejta komparative nuk ka për objekt rregullimi normativo-juridik ndonjë fushë të caktuar të marrëdhënieve shoqërore. Kur flasim, për shembull, për të drejtën administrative komparative,[23] nuk i referohemi një tërësie normash juridike që determinojnë dhe rregullojnë marrëdhëniet shoqërore në lidhje me organizimin, veprimtarinë dhe kontrollin juridik mbi organet e administratës shtetërore; por thjesht i referohemi faktit që aktet ligjore mbi organizimin dhe punën e administratës shtetërore si burime formale-juridike të paktën të dy ose më shumë shteteve i janë nënshtruar një procesi krahasimi juridik me synimin për të eksploruar dhe zbuluar apo konstatuar dallimet dhe ngjashmëritë përkatëse ndërmjet tyre nga aspekti organizativ, struktural, funksional, përfshirë avantazhet/përparësitë dhe disavantazhet/mangësitë midis tyre.

Shprehur në mënyrën më të thjeshtë të mundur, e drejta komparative, në kuptimin më të përgjithshëm të saj është, "krahasimi juridik i sistemeve juridike të ndryshme të shteteve respektive të botës".[4] Procesi i krahasimit juridik si një operacion logjik-juridik nuk krijon vetvetiu akte normative juridike, por ai kontribuon vetëm në krijimin e akteve normative juridike në kuadër të një sistemi juridik ose më shumë prej tyre.[5]

Në lidhje me krahasimin juridik duhet theksuar se në literaturën juridiko-komparative identifikohet ekzistenca e krahasimit juridik horizontal dhe e krahasimit juridik vertikal. Nga njëra anë, krahasimi juridik horizontal ka të bëjë me krahasimin juridik të sistemeve juridike (p.sh. në nivel nacional SHBA–Finlandë–Francë) që janë në të njëjtin nivel për sa i përket kualitetit (cilësisë). Bëhet fjalë për krahasim juridik midis sistemeve juridike të shteteve konkrete. Nga ana tjetër, krahasimi juridik vertikal, bëhet midis sistemeve juridike që janë në nivele kualitativisht (cilësisht) të ndryshme, kështu që krahasimi juridik mund të ketë të bëjë, le të themi, me modalitetet e garantimit dhe mbrojtjes juridike të lirive dhe të drejtave të individëve në të drejtën ndërkombëtare, në të drejtën supranacionale të Unionit Evropian, ose në sistemin juridik të Mbretërisë së Bashkuar.[6]

Vështruar nga prizmi gjeografik, krahasimi juridik si një proces objektiv, mund të aplikohet në sistemet juridike diverse/të ndryshme sipas përkatësisë territoriale. Pra, krahasimi juridik mund të ketë për objekt sistemet juridike (*systems of law*) partikulare të njësive konstitutive federale si shtete individuale që ekzistojnë dhe funksionojnë në kuadrin e një bashkësie shtetërore komplekse – federative, si p.sh., SHBA, Gjermania, Zvicra, Austria, Australia, Bosnja dhe Hercegovina, India, Brazili, Meksika etj.,[7] ose edhe sistemet juridike transnacionale – të shteteve të ndryshme të botës (*transnational legal comparisons*).[8]

2. Përkufizimi i nocionit së të drejtës komparative

Në doktrinën juridiko-komparative ekzistojnë disa përpjekje për të përkufizuar nocionin e të drejtës komparative nga autorë të ndryshëm. Kështu, Konrad Zweigert dhe Hein Kötz, autorët e një teksti mësimor klasik

---

[2] Ackerman, Susan Rose, Lindseth, Peter L., Emerson, Blake. *Comparative Administrative Law*, Edward Elgar Publishing 2019; Peter Cane, Herwig C H Hofmann, Eric C Ip, Peter L Lindseth, *The Oxford Handbook of Comparative Administrative Law*, Oxford University Press 2021; René Seerden, *Comparative Administrative Law*: *Administrative Law of the European Union, Its Member States and the United States*, Intersentia 2018; Frank Johnson Goodnow, *Comparative Administrative Law*: *An Analysis of the Administrative Systems, National and Local, of the United States, England, France and Germany*, Forgotten Books 2018.

[3] Rritja e interesit për të drejtën komparative manifestohet edhe me theksimin në rritje të së drejtës komparative si një lëndë mësimore në edukimin/arsimin juridik akademik universitar. Kështu, e drejta administrative komparative është përcaktuar dhe parashikuar si një lëndë mësimore e veçantë në kuadër të programit studimor juridik pasuniversitar *Master E Drejta Kushtetuese dhe Administrative*, por njëkohësisht edhe në kuadër të programit studimor juridik pasuniversitar *PhD E Drejta Kushtetuese dhe Administrative* në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë.

[4] Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford, 1998, f. 2.

[5] *Pravni Leksikon*, Zagreb, 2007, f. 1128.

[6] Adams, Maurice, Heirbaut, Dirk. *The Method and Culture of Comparative Law*, Hart Publishing 2014, f. 59.

[7] Halberstam, Daniel, Reimann, Mathias. *Federalism and Legal Unification: A Comparative Empirical Investigation of Twenty Systems*, Springer 2013.

[8] Mousourakis, George. *Comparative Law and Legal Traditions*, Springer 2019, f. 3.

mbi të drejtën komparative, e përshkruajnë të drejtën komparative si "një aktivitet intelektual që ka si objekt të drejtën dhe krahasimin juridik si një proces të tij".[9] Nga ana tjetër, autori Peter de Cruz afirmon pikëpamjen se "e drejta komparative" përshkruan studimin sistematik të traditave juridike specifike dhe normave juridike mbi baza komparativo-juridike. Për më tepër, Peter de Cruz shprehet se, kur flitet për të drejtën komparative duhet spikatet fakti se ajo bazohet në një sërë disiplinash, por është eklektike në përzgjedhjen e saj. Si e tillë, e drejta komparative njeh (pranon) marrëdhëniet e rëndësishme midis të drejtës, historisë dhe kulturës dhe vepron mbi bazën se çdo sistem juridik është një amalgam e veçantë e frymës së popullit të tij dhe është produkt i disa ngjarjeve historike të ndërthurura dhe ndërvepruese të faktorëve historik e socio-kultural, të cilat kanë prodhuar një karakter dhe ambient distinktiv nacional.[10] Sipas profesorit të njohur Radomir Llukiq, e drejta komparative merret me studimin sinkronik (të njëkohshëm) të së paku dy të drejtave pozitive të shteteve të caktuara, qoftë në tërësinë e tyre, qoftë në ndonjë segment (pjesë) juridik partikular (të posaçëm) të tyre.[11]

Sidoqoftë, në doktrinën juridiko-komparative (*comparative law scholarship*) prevalon pikëpamja se shprehja "*e drejta komparative*" rëndom përdoret në dy kuptime: *e para*, si një degë e veçantë e shkencave juridike, d.m.th. si një disiplinë e veçantë shkencore juridike dhe, *e dyta*, si një disiplinë e veçantë mësimore-akademike në kuadër të kurrikulave apo plan-programeve studimore juridike universitare.

Si një disiplinë e veçantë shkencore juridike, e drejta komparative merret me studimin, hulumtimin dhe krahasimin juridik të së paku dy e më tepër instituteve juridike, sistemeve juridike të shteteve të caktuara mbi baza komparativo-juridike për të identifikuar dhe interpretuar (sqaruar) ngjashmëritë dhe dallimet reciproke midis tyre, qoftë për synime hulumtuese teorike-shkencore, apo për synime pragmatike-empirike. Pra, e drejta komparative përfshin tërësinë e njohurive sistematike shkencore me përmbajtje tematike komparativo-juridike që u referohen fenomeneve juridike, apo instituteve juridike partikulare nga fusha të ndryshme të së drejtës, si dhe sistemeve juridike kontemporane më të mëdha në mbarë botën[12] (*contemporary major legal systems around the world*). Kështu, e drejta komparative është zhvilluar si një bransh/degë e shkencave juridike, madje për nga natyra juridike është interdisiplinare dhe subsidiare. Kjo do të thotë se e drejta komparative ndahet në disa disiplina aplikative shkencore juridike, konform degëve të së drejtës, sikurse janë e drejta kushtetuese komparative, e drejta administrative komparative, e drejta penale komparative, e drejta civile komparative, e drejta tregtare komparative etj.,[13] duke pasur një rol subsidiar (ndihmës) *vis-à-vis* tyre, sepse ato shfrytëzojnë arritjet epistemologike të së drejtës komparative, përkatësisht shërbehen me njohuritë juridike të së drejtës komparative.

Si një disiplinë e veçantë mësimore-akademike, e drejta komparative përfshin tërësinë e njësive tematike mësimore të caktuara që mësohen nga studentët e drejtësisë gjatë studimeve të tyre juridike universitare.

E drejta komparative ka të bëjë me të drejtën pozitive të huaj (*foreign positive law*), pra me sistemin juridik aplikativ të një shteti të caktuar. Megjithëse aspekti kognitiv (njohja) e një të drejte të huaj të caktuar është *par excellence* - një hap preliminar inherent për çdo studim analitiko-komparativ juridik dhe njëherazi përfaqëson substratin (themelin) mbi të cilin është etabluar *per se* (vetë) e drejta komparative.[14] Nga ana tjetër, studimi i një të drejte të huaj presupozon jo vetëm njohjen e një gjuhe të huaj, por edhe njohjen me zhargonin (terminologjinë) juridik të asaj të drejte të huaj konkrete që studiohet.[15] Mirëpo, ajo që do të duhej të përfillet është se "vetë studimi i të drejtës së huaj nuk mund të jetë e drejtë komparative". Për të drejtën komparative aplikative ("*comparative*

[9] Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford, 1998, f. 2.
[10] Peter de Cruz, *Comparative law in a Changing World*, Routledge-Cavendish, 1999, f. 3, 6.
[11] Радомир Лукић, *Методологија Права*, Београд, 1979, f. 152.
[12] Sistemet e mëdha juridike nënkuptojnë një tërësi sistemesh juridike nacionale të shumë shteteve që formësojnë një familje juridike konkrete. Sistemi i madh juridik mund të jetë vetëm ai sistem juridik, i cili e ka tejkaluar hapësirën e origjinës së vetë dhe që ka ushtruar një impakt sinjifikant mbi sistemet juridike nacionale të ndryshme të mbarë botës. – Драгољуб Поповић, *Увод у Упредно Право,* Београд, 2008, f. 51.
[13] Reimann, Mathias, Zimmermann, Reinhard. *The Oxford Handbook of Comparative Law*, Oxford University Press 2008, f. 900-2209.
[14] Glendon, Mary Ann, Carozza, Paolo, Picker, Colin. *Comparative Legal Traditions*, West Academic Publishing 2008, f. 10-11.
[15] Mousourakis, George, Nicolini, Matteo. *Comparative Law and Legal Traditions*, Springer 2019, f. 110.

law in action") mund të flitet vetëm atëherë "kur ka pasqyrime krahasuese juridike për fenomenin juridik të caktuar të cilit i kushtohet puna e bërë". Prandaj, "përvoja ka treguar se kjo bëhet më mirë kur autori parashtron pikat thelbësore të së drejtës së huaj, për secilin shtet të caktuar veç e veç dhe pastaj e përdor këtë material si një bazë për krahasimin kritik juridik", duke nxjerrë konkluzionet lidhur me politikën juridike (*legal policy*) oportune (e përshtatshme) që do të miratohet e që mund të përfshijë një rishqyrtim të vetë sistemit juridik të tij.[16]

E drejta komparative, siç praktikohet sot, mund të trajtohet konceptualisht nga dy qasje të dallueshme: *një*, "e drejta komparative legjislative (*legislative comparative law*)", kur të drejtat e huaja eksplorohen për të krijuar akte ligjore nacionale kualitative", por edhe për të bërë kodifikimin juridik në ndonjë fushë të caktuar të së drejtës pozitive nacionale, ashtu sikurse është përdorur me sukses, p.sh., në kodifikimet moderne, siç janë ato të Francës, Austrisë e më vonë edhe të Gjermanisë, Zvicrës etj),[17] dhe; *dy*, "e drejta komparative teorike ose shkencore (*scholarly comparative law*)" kur ndërmerret studimi analitiko-komparativ juridik i sistemeve juridike të ndryshme të botës për të përmirësuar dhe zgjeruar horizontin epistemologjik (njohuritë) profesionale-shkencore juridike mbi tipologjinë e sistemeve juridike ekzistuese nga një perspektivë transnacionale dhe në këtë mënyrë për të krijuar një kuptim më të mirë dhe të integruar të tipologjisë, strukturës dhe funksionimit të sistemeve juridike ekzituese në botë.[1819] Veç kësaj, e drejta komparative teorike ose shkencore shpjegohet me idenë se studimi i të drejtave të huaja konsiston mbi nevojën objektive "përmes krahasimit juridik drejt harmonizimit/unifikimit juridik" (*through legal comparison towards legal harmonization/unification*) të sistemeve juridike nacionale, sidomos të zgjidhjeve juridike në lëmin juridik të së drejtës private (*ius privatum*), në mënyrë që të evitohen barrierat juridike të shkëmbimit ndërkombëtar të mallrave dhe të shërbimeve në tregun e përbashkët rajonal e global.

Kjo është kryesisht rezultat i zhvillimit të interaksionit apo bashkëpunimit reciprok midis shteteve në arenën e marrëdhënieve ndërkombëtare, por edhe të ekspansionit të aktiviteteve ekonomike, si dhe nevoja në rritje për zhvillimin e rregullave për të lehtësuar transaksionet juridike tregtare në rrafshin transnacional.[20]

Rritja e interesit për të drejtën komparative shkencore gjatë shekullit XIX është reflektuar në krijimin e instituteve të ndryshme shkencore të dedikuara për studimin komparativo-juridik të fenomeneve juridike përgjithësisht, siç janë: Instituti Britanik i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Komparative (*British Institute of International and Comparative Law*) i themeluar në vitin 1894, Instituti Maks Plank për të Drejtën Komparative dhe të Drejtën Ndërkombëtare Private (*Max Planck Institute for Comparative and International Private Law*) i formuar në vitin 1926, Instituti për të Drejtën Komparative në Paris (*Institut de Droit Comparé de Paris*) i krijuar në vitin 1931. Në këtë kontekst, vlen për të nxjerrë në pah faktin se në Republikën Popullore Federative të Jugosllavisë (RPFJ) u themelua *Instituti për të Drejtën Komparative* (*Institut za Uporedno Pravo*) me një dekret të Këshillit Ekzekutiv Federativ në vitin 1955, të nënshkruar nga Presidenti i atëhershëm i RPFJ-së, Josip Broz Tito. Instituti për të Drejtën Komparative në RPFJ filloi punën më 1 janar 1956, si një nga institucionet e para të këtij lloji në botë. Sipas të njëjtit model, institutet për të drejtën komparative u themeluan në Japoni (*The Institute of Comparative Law in Japan*) në vitin 1948 dhe në Zvicër (*Swiss Institute for Comparative Law*) në vitin 1978.[21]

---

[16] De Cruz, Peter. *Comparative Law in a Changing World*, GB Gardners Books, 1999, f. 8.

[17] Ragone, Sabrina, Smorto, Guido.*Comparative Law*, Oxford University Press 2024, f. 2-3.

[18] Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford, 1998, f. 51.

[19]Zweigert, Konrad, Drobnig, Ulrich. *International Encyclopedia of Comparative Law*, Brill 2006. *Enciklopedia Ndërkombëtare e të Drejtës Komparative*, e botuar në 17 vëllime, është shkruar nga specialistë kryesorë të njohur në mbarë botën të së drejtës komparative. Është padyshim një vepër masive me një vrojtim sa ekstenziv aq dhe inkluziv i të drejtës komparative në nivel ndërkombëtar i publikuar ndonjëherë, dhe si e tillë, përfshin përshkrime të detajuara dhe analiza komparative juridike të sistemeve juridike të më shumë se 150 shteteve të botës.

[20] Mousourakis, George, Nicolini, Matteo.*Comparative Law and Legal Traditions*, Springer 2019, f. 72.

[21] https://iup.rs/en/about/background/

Sot, e drejta e krahasuar ka bërë të mundur një komunikim ndërkombëtar opinionesh e doktrinash, kushtetutash e ligjesh, etj.[22]Kështu, për shembull, e drejta kushtetuese komparative[2324]është një disiplinë autonome shkencore juridiko-politike, që merret me studimin e të drejtave kushtetuese nacionale të shteteve të ndryshme në rrafshin komparativo-juridik[25], duke i pajisur studentët e drejtësisë me njohuri mbi përmbajtjen fondamentale juridiko-politike të sistemeve kushtetuese të shteteve të caktuara të botës të cilat kanë të të zhvilluar dhe të avancuar të drejtën kushtetuese si një degë të së drejtës, siç janë: Franca, SHBA, Gjermania, Zvicra, Italia, Spanja, Anglia, etj.[26] Për më tepër, interesi për të drejtën kushtetuese të krahasuar ka ardhur duke u rritur vazhdimisht, veçanërisht në dekadat e fundit. Kjo ka ndodhur për shkak të zhvillimeve që ka njohur kjo fushë dhe përhapjes që kanë pasur kushtetutat e reja në kuadër të tranzicionit për demokracinë konstitucionale, në pjesë të ndryshme të botës, si, në Evropën lindore, në Afrikë dhe në Amerikën Latine. Ky interes i dedikohet gjithashtu, edhe internacionalizimit të të drejtave kushtetuese, duke filluar që pas Luftës së Dytë Botërore. Me zgjerimin e internacionalizimit të të drejtave të njeriut, u hartuan mjaft karta rajonale për mbrojtjen e tyre. Të tilla ishin Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe ekuivalentet e saj për Afrikën dhe kontinentin amerikan.[27]

Kohët e fundit, kontaktet midis gjyqtarëve nga vende të ndryshme janë rritur ndjeshëm dhe vendimet gjyqësore të huaja janë bërë transparente e mjaft të lexueshme, duke i publikuar ato përmes Teknologjisë Informative Elektronike – *Internetit*. Në një analizë të rreth 1500 aktgjykimeve të Gjykatës Federative të Zvicrës ka treguar se në rreth 10 % të rasteve gjykata përkatëse u është referuar një ose më shumë sistemeve juridike të huaja për qëllime të krahasimit juridik, përkatësisht u është referuar vendimeve të gjykatave të huaja për të mbështetur argumentimin juridik gjatë vendimmarrjes së vet.[28] Ndërkohë, studimet komparativo-juridike që lidhen me shqyrtimin dhe me marrjen e vendimeve gjyqësore të çështjeve të caktuara kontestimore juridike, duhet të shoqërohen me qasjen analitiko-juridike, por dhe të tregojnë gjithmonë një interes në vendosjen e lidhjeve kauzale (shkak-pasojë) dhe të mbajë parasysh nevojën për të zbuluar ngjashmëritë. Për juristët-komparatistë është shumë e rëndësishme kjo analizë sepse mund të ofrojnë interpretime të normave juridike me analogji, por edhe për gjykatat kur bëjnë interpretime krahasimore juridike kur u referohen vendimeve të gjykatave ndërkombëtare ose të shteteve të tjera demokratike me rastin e marrjes së vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e ndonjë çështje kontestimore juridike, apo

[22] Anastasi, Aurela. *E Drejta Kushtetuese e Krahasuar*, Tiranë, 2009, f. 7.

[23] Ginsburg, Tom, Dixon, Rosalind.*Comparative Constitutional Law*, Edward Elgar Publishing 2013; Rosenfeld, Michel, Sajo, Andras. *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*, Oxford University Press 2013; Masterman, Roger, Schütze, Robert. *The Cambridge Companion to Comparative Constitutional Law*, Cambridge University Press 2019; Tushnet, Mark. *Advanced Introduction to Comparative Constitutional Law*, Elgar, Edward Publishing 2018.

[24] E Drejta Kushtetuese Komparative është përcaktuar dhe parashikuar si një lëndë mësimore e veçantë në kuadër të programit studimor juridik pasuniversitar *Master E Drejta Kushtetuese dhe Administrative*, por njëkohësisht edhe në kuadër të programit studimor juridik pasuniversitar *PhD E Drejta Kushtetuese dhe Administrative* në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë.

[25] Szabó, Zsolt. *Constitution and Government at the Western Balkans*, Berliner Wissenschafts-Verlag 2023.
Autori Zsolt Szabó në këtë libër ka aplikuar një qasje komparativo-juridike e analitike-kritike duke përshkruar dhe vlerësuar statusin dhe funksionimin e sistemeve të qeverisjes kushtetuese dhe sundimit të së drejtës të shteteve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi), në lidhje me anëtarësimin e tyre në Unionin Evropian. Libri mbulon sistematikisht të gjitha fushat kryesore institucionale të së drejtës kushtetuese dhe administrative: sistemi zgjedhor, çështjet etnike, organizimi i shtetit, ndarja e pushteteve (legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor), procedura administrative, sistemi i nëpunësve administrativ dhe gjyqësori kushtetues.

[26] Shih: Rosenfeld, Michel, Sajo, Andras. *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*, Oxford University Press, 2013; Masterman, Roger, Schütze, Robert.*The Cambridge Companion to Comparative Constitutional Law*, Cambridge University Press, 2019; Aalt Willem Heringa, *Constitutions Compared: An Introduction to Comparative Constitutional Law*, Eleven International Publishing, 2021.

[27] Anastasi, Aurela. *E Drejta Kushtetuese e Krahasuar*, Tiranë, 2009, f. 7-23.

[28] Andenas, Mads, Fairgrieve, Duncan.*Courts and Comparative Law*, Oxford University Press 2015, f. 40.

vendosjen e ndonjë rasti të veçantë.[29] Kështu, fjala vjen, Gjykata e Tiranës në vendimin e pafajësisë për ish-Komandantin e Gardës Ndrea Prendin dhe gardistin Agim Llupon të akuzuar për vrasje në rrethana cilësuese në ngjarjet protestuese të 21 janarit 2011, thekson se "gjatë hetimeve nuk është provuar që dy të pandehurit kanë realizuar këtë vepër penale me dashje, por kanë qenë në zbatim të ligjit për të mbrojtur godinën e institucionit të Kryeministrisë si objekt me vlerë dhe rëndësi të veçantë shtetërore dhe zyrtarëve të lartë shtetëror që ndodheshin brenda saj mesditën e 21 janarit 2011. Sipas gjykatës, në asnjë rast Prendi e Llupo nuk kanë qenë në vendngjarje si persona civil dhe të motivuar nga shkaqe personale, por për shkak të detyrës zyrtare të ngarkuar nga ligji, si drejtues dhe përfaqësues të Gardës së Republikës. Për më tepër, edhe vendimi i marrë ishte bazuar në një vendim të mëparshëm të Gjykatës së Strasburgut për një rast të ngjashëm në Itali, përkatësisht është bazuar në Vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 25 gusht 2009 Ankimi nr. 23458/02 – *Giuliani e Gaggio kundër Italisë*.[30]

Gjykata, ne vendimin e saj, deklaron se ky vendim është i detyrueshëm të zbatohet nga gjykatat shqiptare. Për sa i përket fuqisë juridike detyruese të këtij Vendimi dhe Jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, gjykata sqaron se bazuar në nenet 17 dhe 116/1a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dispozitat e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, janë të detyrueshme të zbatohen nga gjykatat shqiptare. Por, për të kuptuar më mirë se për çfarë bën fjalë vendimi i Gjykatës së Strasburgut paraqitet një përmbledhje të historisë dhe arsyetimit të gjykatës. Në korrik të vitit 2001 në Xhenova të Italisë një protestues u vra nga një karabinier gjatë takimit të G8. Tre karabinierë ishin bllokuar në xhipin e tij dhe ishin bërë preh e sulmit të demonstruesve të armatosur me gurë, shkopa dhe shula hekuri, të cilët godisnin me forcë makinën. Një prej karabinierëve, sipas gjykatës i mbledhur kruspull në pjesën e pasme të xhipit, i plagosur, pre e panikut, duke u mbrojtur nga njëra anë me një mburojë (sipas deklarimit të demonstruesit Predonzani), duke u bërtitur demonstruesve që të iknin, "se përndryshe do t'i vriste", Mario Placanica nxori Berettën e tij 9 mm, e drejtoi drejt xhamit të pasëm të mjetit të thyer copash dhe shtiu dy herë. Plumbi i parë kapi protestuesin Carlo Giuliani-n në fytyrë, poshtë syrit të majtë dhe e plagosi rëndë. Carlo Giuliani u plagos përtokë pranë rrotës së pasme të majtë të mjetit. Pak më pas, Filippo Cavataio drejtuesi i mjetit, arriti të rinisej, e për t'u çliruar, eci me marshin indietro, duke kaluar kështu mbi trupin e Carlo Giuliani-t. Futi marshin e parë dhe kaloi për herë të dytë mbi trupin e Carlo Giuliani-t, duke u larguar. Sipas Gjykatës karabinierët ishin efektivisht të ekspozuar ndaj një rreziku imediat dhe serioz për humbjen e jetës, apo për marrjen e plagëve të rënda. Aq më pak, ata mund të mendonin të justifikuar, që ta merrnin në sy këtë rrezik. Për këtë, Gjykata kujton se përdorimi i forcës nga ana e përfaqësuesve të shtetit, për arritjen e njërit prej objektivave të shpallur në paragrafin 2 të nenit 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, mund të justifikohet në raport me këtë dispozitë, nëse bazohet në një bindje të sinqertë, nisur nga motive të mira, e vlefshme në kohën e ngjarjes, por që më pas del e gabuar. Të pohosh të kundërtën, do të thotë t'i ngarkosh shtetit dhe përfaqësuesve të tij të ngarkuar me zbatimin e ligjit, një detyrë joreale, që do të rrezikonte të ushtrohej, duke i kushtuar jetën atyre dhe të tjerëve. Sa më lart, Gjykata pohon, se nuk është vërtetuar, që autoritetet italiane, nuk i janë përmbajtur detyrimit, për mbrojtjen e jetës së Carlo Giuliani-t. Gjykata deklaron, unanimisht, se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës në planin material, për sa i përket përdorimit të tepruar të forcës. Me datë 25 gusht 2009 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg ka shpallur të pafajshëm karabinierin Mario Placanica.[3132]

---

[29] Shih: Örücü, Esin.*The Enigma of Comparative Law: Variations on a Theme for the Twenty-first Century*, Springer, 2004, fq. 38; *The use of comparative law by courts*: *XIVth International Congress of Comparative Law*, Athens, The Hague; Boston: Kluwer Law International, 1999.

[30] European Court of Human Rights, *CASE OF GIULIANI AND GAGGIO versus ITALY*; (Application no. 23458/02); http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-104098 – në këtë adresë të linkut është i përmbajtur versioni autentik dhe *en bloc* i Vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 25 gusht 2009 Ankimi nr. 23458/02 – *Giuliani e Gaggio kundër Italisë*.

[31] Shih: http://www.tiranaobserver.al/2013/02/08/21-janari-4-te-vrare-0-te-denuar/

[32] Në vendimin për shpalljen të pafajshëm të ish-Komandantit të Gardës së Republikës, Ndrea Prendi, dhe ish-gardistit Agim Llupo, Gjykata e Tiranës, seksioni i Krimeve të Rënda, u mbështet dhe në një vendim të mëparshëm të Gjykatës së Strasburgut për një rast të ngjashëm në Itali. Gjykata, pafajësinë e të pandehurve e bazoi edhe në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, ku është deklaruar i pafajshëm një efektiv policie, i cili kishte vrarë shtetasin Carlo Giuliani

3. Origjina dhe zhvillimi historik i të drejtës komparative

E drejta komparative, si një disiplinë e veçantë shkencore juridike, u shfaq në shekullin e XIX. Disa faktorë e nxitën këtë zhvillim. Rëndësi të veçantë kishte konsolidimi i idesë së shtetit-komb (*nation-state*) dhe përhapja e legjislacionit nacional; zgjerimi i marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare, gjë që solli në kontakt palët ndërgjyqëse dhe praktikuesit e ligjit me sistemet juridike të huaja; dhe interesi në rritje për studimin shkencor të fenomeneve juridike në një kontekst më të gjerë historik dhe komparativo-juridik.[33]

Vështruar historikisht, fillet (shkëndijat) e para të së drejtës komparative hasen qysh në Greqinë antike. Në botën antike greke shumë dijetarë ishin të interesuar për të drejtat e huaja. I tillë është qëndrimi i Likurgut në Spartë dhe i Solonit në Athinë, të cilët bënin "ekskursion", pra udhëtonin në vendet e Mesdheut për të njohur më nga afër legjislacionin e këtyre vendeve përpara se të nxirrnin ligje në vendet e tyre. Në veprën e tij Ligjet, Platoni bën një krahasim të të drejtave të poliseve (qyteteve-shtete) greke; ai jo vetëm që i deskripton ato, por edhe i ekzaminon dhe analizon përkundrejt "kushtetutës ideale" që ai konstrukton duke u bazuar në to. Para se të shkruante veprën e tij Politika, Aristoteli gjithashtu shqyrtoi kushtetutat e jo më pak se 153 poliseve (qyteteve-shtete), megjithëse vetëm një pjesë kushtuar Athinës ka arritur deri tek ne. Kjo punë mund të konsiderohet si një spekulim filozofik duke u mbështetur tek e drejta komparative.[34]

Një shembull i mirënjohur i një ndikimi të huaj të pretenduar (supozuar) në hartimin e legjislacionit nga periudha e hershme romake ka të bëjë me *Lex XII (Duodecim) Tabularum* – Ligjin e Dymbëdhjetë Tabelave, përmbledhja më e vjetër e të drejtës romake e miratuar në mesin e shekullit të pestë para Krishtit. Si shkrimet e oratorit dhe filozofit Ciceroni (106-43 p.e.s.) dhe juristi Gaius (shekulli i dytë pas Krishtit) duket se sugjerojnë se

---

gjatë një proteste të dhunshme kundër takimit të G8 në Xhenova në 2001 në Itali. Bazuar në këtë precedent, trupa e gjyqtarëve të Gjykatës së Tiranës që gjykoi në themel aktakuzën për 21 janarin dëshmoi pavarësinë dhe integritetin e saj si një institucion bazë i dhënies së drejtësisë shtetërore në Republikën e Shqipërisë. Kjo edhe për faktin se precedenti gjyqësor në rendin juridik të Republikës së Shqipërisë, gëzon rank kushtetues. Ka një sërë dispozitash kushtetuese që përcaktojnë zbatimin e së drejtës ndërkombëtare të detyrueshme dhe mbi të gjitha përparësinë e normës ndërkombëtare ndaj ligjit. Pa asnjë mëdyshje, treshja e gjyqtarëve që vendosi shpalljen të pafajshëm të ish-Komandantit të Gardës së Republikës, Ndrea Prendi, dhe ish-gardistit Agim Llupo, dëshmoi se njeh mirë doktrinën e precedentit gjyqësor në kontinentin evropian, nga e cila nuk ka bërë përjashtim as sistemi i së drejtës në Shqipëri. Rasti i "21 janarit" është i ngjashëm me rastin e Xhenovas, në Itali, të zhvilluar në vitin 2001, ku si pasojë e përplasjes me karabinierët dhe demonstruesve antiglobalistë u vra njëri prej tyre. Procesi u mbyll me shpalljen të pafajshëm të karabinierit nën akuzë jo vetëm nga drejtësia italiane, por edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Një precedent ky që legjitimon tërësisht vendimin e Gjykatës së Tiranës në rastin e gjykimit të 21 janarit. Kjo edhe për faktin se ekzistenca dhe aplikimi i precedentit gjyqësor (si burim i së drejtës) në rendin juridik të Republikës së Shqipërisë, nënkupton detyrimin e gjykatave më të ulëta ndaj precedentit (në rastin konkret vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg për pafajësinë efektivit të policisë, i cili kishte vrarë shtetasin Carlo Giuliani gjatë një proteste të dhunshme kundër takimit të G8 në Xhenova në 2001-in). Gjatë procesit gjyqësor ndaj ish funksionarëve të lartë të gardës së Republikës së Shqipërisë avokati Gjokutaj ka përforcuar analogjinë mes dy rasteve, duke theksuar se ngjarja në Shqipëri ishte edhe më e rëndë nga pikëpamja e vendi ku ajo u zhvillua. Ndërkohë, trupi gjykues është mbështetur fort në faktin se vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg luajnë rolin e precedentit detyrues për gjykatat më të ulëta në zgjidhjen e çështjeve analoge. Kjo përkthehet në forcimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, barazinë e individit përpara ligjit (precedentit), sigurinë juridike dhe eliminimin e çdo forme të ndërhyrjeve ndaj pushtetit gjyqësor si dhe rritje të profesionalizmit të gjyqtarëve, elementë këto bazal për shtetin e së drejtës. Sistemi juridik në Republikën e Shqipërisë, duke qenë pjesë e formacionit të së drejtës së Evropës kontinentale, e cila karakterizohet nga kodifikimi i së drejtës dhe gjyqtari si zbulues e deklarues i saj, tradicionalisht i ka kushtuar një vend modest jurisprudencës në hierarkinë e burimeve të së drejtës. Tashmë, është fakt se roli i jurisprudencës në përgjithësi dhe i precedentit në veçanti, është rritur aq shumë, sa mund të thuhet pa hezitim dhe me argumente shkencorë se, është koha dhe epoka e precedentëve. Kjo u provua më së miri edhe në këtë rast ku vendimi i dhënë nga gjyqtari Besnik Hoxha, për shpalljen të pafajshëm të ish-Komandantit të Gardës së Republikës, Ndrea Prendi dhe ish-gardistit Agim Llupo është sinjal i qartë i mosndikimit të drejtësisë nga politika e kriminalizuar. – cituar sipas Halil Rama, *Precedenti gjyqësor, si burim i së drejtës*; http://www.gazetarepublika.al/?p=42709.

[33] Mousourakis, George, Nicolini, Matteo. *Comparative Law and Legal Traditions*, Springer, 2019, f. 71-75.

[34] Smits, Jan M. *Elgar Encyclopedia of Comparative Law*, Edward Elgar Pub, 2014, f.57; René David, John E. C. Brierley, *Major Legal Systems in the World Today*, Free Press, 1978, f. 1-2.

ata besonin legjendën e dukshme se, përpara se të fillonte puna për kodin ligjor, një komision prej tre anëtarësh u dërgua në Greqi për të mësuar nga ligjet e ligjvënësit të famshëm athinas Solon dhe ato të qyteteve-shteteve të tjera greke. Historianët bashkëkohorë tani pranojnë se nuk ka gjasa që një delegacion të jetë dërguar në Greqi. Kjo pikëpamje mbështetet nga fakti se fragmentet e ruajtura të Ligjit të Dymbëdhjetë Tabelave zbulojnë shumë pak që mund të gjurmohen drejtpërdrejtë në një ndikim grek, ndonëse vërehen disa paralele me ligjet e shoqërive të tjera të hershme. Sidoqoftë, siç tregon historia e Ligjit të Dymbëdhjetë Tabelave, ndikimi i civilisimit greko-antik në kulturën romake është i pamohueshëm, sado që tendenca që mbizotëronte në mesin e juristëve romakë ishte përqëndrimi ekskluzivisht në të drejtën e brendshme të Romës.[35] Në fakt, te juristët romak, identifikohet dhe evidentohet një subjektivizëm dhe egoizëm juridik, ngaqë ato asnjë të drejtë (bile edhe të drejtën e zhvilluar greke) nuk e kanë konsideruar dhe pranuar si të barabartë me të drejtën romake. Kjo do të thotë se juristët romak kanë pasur një qasje negatore (mohuese) dhe pezhorative kundrejt të drejtave të popujve tjerë që më së miri pasqyrohet, në veprën e Ciceronit: *"De oratove"*. Ciceroni, duke e krahasuar të drejtën romake me ligjet e Likurgut, Drakonit dhe Solonit thotë:*"Incredible est enim quam sit omne jus civile præter hoc nostrum, inconditum et poene ridiculum"* – "*E pabesueshme është se çdo e drejtë civile, përveç të drejtës sonë, sa është disharmonike aq është edhe komike*".[36] Superioriteti politiko-ekonomik i shtetit dhe i sistemit juridik romak ndaj shteteve dhe sistemeve juridike të tjera presumohet që ka qenë arsye parimore për një qëndrim të tillë të juristëve romak, për të mos treguar fare vëmendje dhe interesim për të drejtat e huaja. Po kështu, edhe në Angli, mbase edhe në shumicën e vendeve të *Commonwealth* (Bashkësia e shteteve të Perandorisë së dikurshme të Britanisë së Madhe), prevalonte botëkuptimi se e drejta e *common law* është një e drejtë e perfeksionuar dhe për rrjedhojë nuk ka nevojë për trajtimin dhe studimin e të drejtave të huaja, pra për të drejtat e shteteve të tjera.[37]

Kontribut të çmuar në zhvillimin dhe avancimin e të drejtës komparative kanë dhënë filozofët Bejkoni dhe Laibnici. Në esenë e tij *"De dignitate et augmentis scientiarium"* (1623) Bejkoni theksonte se juristi duhet ta çlirojë veten "nga ai egoizëm dhe narcizëm juridik", nga ajo lidhje me sistemin juridik nacional të tij përpara se ai të vlerësojë rëndësinë e vërtet: objekt i gjykimit (e drejta nacionale) nuk mund të jetë standard i gjykimit (*the object of judgement – national law cannot be the standard of judgement*). Ky perceptim, që është tani po aq i vlefshëm sa ka qenë gjithnjë, justifikon të gjitha eksplorimet (kërkimet) juridike e gjera dhe intensive krahasuese juridike. Nga ana e tij, Laibnic e vrojton të drejtën komparative nga prizmi i historisë universale: plan i tij për një *"Theatrum Legale"* përfshinte një portretizim krahasimtar të të drejtave të të gjithë popujve, vendeve dhe kohëve.[38]

E drejta komparative është një disiplinë relativisht e re shkencore juridike. Kongresi i Parë Ndërkombëtar i të Drejtës Komparative i organizuar nga Shoqëria Franceze e Legjislacionit Komparativ (*Société française de législation comparée*) mbajtur në Paris në vitin 1900, gjatë Panairit Botëror të Parisit dhe Kongresit Ndërkombëtar të Arsimit të Lartë ishte një ngjarje kruciale për zhvillimin e teorisë dhe praktikës të së drejtës komparative. Në fakt, Kongresi Ndërkombëtar i Parisit mbi të drejtën komparative në vitin 1900 shënoi një moment historik dhe decisiv për inaugurimin – themelimin dhe elaborimin e aspekteve teoriko-juridike konceptuale e metodologjike të së drejtës komparative moderne si një disiplinë autonome shkencore juridike. Studiuesit francezë Édouard Lambert dhe Raymond Saleilles, të drejtën komparative e konsideronin si "aseti/thesari i përbashkët i zgjidhjeve juridike nga të gjitha sistemet juridike të avancuara të botës ("*common stock of legal solutions*" *from amongst all the advanced legal systems of the world*).[39]

Për më tepër, Lambert dhe Saleilles ekspozuan dhe afirmuan idenë mbi të drejtën komparative në emër të motiveve dhe vizioneve universaliste, kozmopolitane, internacionaliste, humaniste dhe progresive shoqërore, që

---

[35] Mousourakis, George, Nicolini, Matteo.*Comparative Law and Legal Traditions*, Springer, 2019, f. 52.

[36] James H. Richardson, Federico, Santangelo. *The Roman Historical Tradition: Regal and Republican Rome*, Oxford University Press 2014, f. 262.

[37] Reimann, Mathias, Zimmermann, Reinhard. *The Oxford Handbook of Comparative Law*, Oxford University Press 2008, f. 24-61.

[38] Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford University Press 1998, f. 50.

[39] Mousourakis, George, Nicolini, Matteo. *Comparative Law and Legal Traditions*, Springer, 2019, f.4, 94; Mathias Siems, *Comparative Law*, Cambridge University Press 2018, f. 37; Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford, 1998, f. 2-4.

shtetet në mbarë botën të bëjnë përpjekje maksimale dhe të zhvillojnë një strategji sistematike e afatgjate në planin e harmonizimit juridik dhe unifikimit juridik të konceptit përmbajtësor të normave juridike dhe instituteve juridike në kuadër të sistemeve juridike nacionale të tyre, duke pasur si një intencë ultimative (qëllim të fundit) që në perspektivë të krijohet "një sistem juridik unik në mbarë botën". Me fjalë të tjera, mund dhe duhet të krijohet nga e drejta komparative "një e drejtë e vetme dhe e përbashkët e njerëzimit në mbarë rruzullin e tokësor", pra, "një e drejtë mondiale/botërore"; "*ius commune universale*"; "*common law of civilized mankind*"; "*droit commun de l'humanite civilisee*".[40] Një përfundim që do të mund të nxirrej në lidhje me këtë, i drejtë, logjik dhe i qëndrueshëm, është se esenca e idesë të eksponentëve apo protagonistëve kryesorë Lambert dhe Saleilles konsiston në faktin që të akceptohet dhe aplikohet një qasje propulsive juridike unike dhe universale brenda përbrenda suazave të sistemeve juridike të ndryshme të shteteve të botës, në mënyrë që normat juridike, parimet juridike, nocionet (konceptet) juridike, kategoritë juridike apo institutet juridike të kenë një kuptim (domethënie) të njëjtë nga aspekti juridik (*unitary sense of justice*) në sistemet juridike të shteteve të botës. Aspirata e këtillë e "kreatorëve ideor" të sipërtheksuar që të krijohet një e drejtë e vetme aplikative uniforme në planin transnacional apo global, e cila mund dhe duhet të vlejë për të gjithë shtetet, për të gjithë popujt dhe për të gjithë njerëzimin, është e parealizueshme në praktikë. Pra, "projekti i tyre ideor mund të kualifikohet si një mision i pamundur, përkatësisht utopik, dhe si i tillë, mund të shtjellohet vetëm si një diskurs juridik në rrafshin teoriko-akademik".

Sidoqoftë, procesi dinamik i kooperacionit ndërkombëtar në gjysmën e dytë të shekullit XX i cili zhvillohet paralelisht me progresin intensiv shkencor e teknologjik dhe ndryshimet në jetën politike, ekonomike dhe kulturore në shumicën e shteteve dhe të shoqërive të tyre, integrimi i shteteve evropiane në Unionin Evropian, zhvillimi shkencës juridike mbi të drejtën e Unionit Evropian dhe ideja mbi rendin juridik evropian, kanë rezultuar me përfshirjen e të drejtës komparative në programet studimore akademike në shumë universitete të Evropës dhe të SHBA.[41] Ndryshe, interdependenca (ndërvarësia) globale gjithnjë e më e madhe e shteteve në përmasa planetare ka ndikuar në studimin e tipologjisë të sistemeve juridike, madje e drejta pozitive nacionale nuk mund të kuptohet, nëse ajo vrojtohet ekskluzivisht brënda kornizave juridike rigjide (të ngurta) nacionale.[42] Kjo sikur e vërteton tezën se, e drejta komparative i kundërvihet dhe e lufton parokializmin/lokalizmin, apo provincializmin, pozitivizmin, dogmatizmin dhe nacionalizmin restriktiv (ngushtë) të observacionit të fenomeneve juridike brënda kufijve shtetëror dhe kështu inkurajon ligjvënësin të zhvilloj aktivisht një sens vigjilence dhe përgjegjësie për reformimin dhe përmirësimin e të drejtës nacionale. Veç kësaj, e drejta komparative e bën më modest juristin e një shteti të caktuar, lidhur me standartet e drejtësisë së shtetit të tij, dhe për pasojë e relativizon një lloj shovinizmi që çdo jurist lokal (vendas) e mban në vete.[43]

Për më tepër, në botën bashkëkohëse është shumë vështirë të mendohet miratimi i ligjeve në çdo sferë juridike pa mbështetje në të drejtën komparative.[44] Kështu, fjala vjen, të drejtës komparative i kushtohet rëndësi e madhe nga ligjvënësit, me rastin e hartimit dhe miratimit të akteve ligjore, ose ndryshimeve dhe plotësimeve të tyre, shfrytëzohen edhe praktikat më të mira nga përvojat juridike të shteteve të tjera. Gjithashtu, gjatë procesit të draftimit të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, që është miratuar më 17 nëntor të vitit 1991 nga kushtetutvënësi – Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë konsultuar dhe konsumuar zgjidhjet juridike që ofron e drejta kushtetuese komparative si një udhërrëfyes lidhur me çështjet apo problematikat nga fusha e materies juridiko-kushtetuese në përgjithësi.

Nuk ka asnjë dyshim se e drejta komparative sikur shtron nevojën që legjislatorët e shteteve të Evropës kontinentale, t'i hartojnë aktet ligjore mbi bazën e standarteve universale juridiko ndërkombëtare dhe të Unionit Evropian, përkatësisht nën optikën e të drejtës komparative. Ç'është e vërteta, e drejta komparative aludon dhe insiston në faktin që ligjvënësi modern gjithnjë e më tepër duhet t'i konsultoj apo t'iu referohet sistematikisht dhe

[40] Будимир Кошутић, *Увод у Велике Правне Системе Данашњице*, Београд, 2002, f.13.
[41] *Pravni Leksikon*, Zagreb, 2007, f. 1128.
[42] Shehu, Natasha. *E Drejta e Krahasuar Publike*, Tiranë, 2004, f. 15.
[43] Siems, Mathias. *Comparative Law*, Cambridge University Press 2018, fq. 1; Konrad Zweigert, Hein Kötz, *An introduction to Comparative Law*, Oxford, 1998, f. 15, 23.
[44] Драгољуб Поповић, *Увод у Упоредно Право*, Београд, 2008, f. 21.

t'i marrë në konsideratë zgjidhjet normative që ofron e drejta komparative në një perspektiv më të gjerë ndërkombëtare, pra, zgjidhjet juridike që ofrojnë sistemet juridike nacionale të shteteve të ndryshme lidhur me ndonjë çështje juridike të veçantë që paraqet objekt interesi, shqyrtimi dhe rregullimi nga ligjvënësi (parlamenti) i një shteti të caktuar. Në këtë drejtim, ligjvënësi duke analizuar dhe vlerësuar me një qasje kritike-juridike të gjithë zgjidhjet juridike të mundshme, më në fund dhe përfundimisht, të selektojë (përzgjedh) dhe të bëj transplantimin dhe recipimin juridik (*legal transplants and receptions*)[45] e asaj zgjidhjeje juridike konkrete në sistemin juridik nacional që konsiderohet më racionale e optimale (e përshtatshme) nga perspektiva pragmatike, d.m.th., që korrespondon më mirë me rrethanat dhe me kushtet konkrete e specifike socio-ekonomike dhe politike të shoqërisë dhe shtetit të tij.

4. Objekti dhe metodat e së drejtës komparative

Çdo disiplinë shkencore juridike përmban dy elemente të ndërlidhura midis veti në mënyrë dialektike: objektin dhe metodën. Në këtë drejtim, objekti dhe metoda janë *conditio sine qua non* (kusht i domosdoshëm) për konstitutimin dhe ekzistencën e një dege të së drejtës, përkatësisht për konstitutimin dhe ekzistencën e një disipline shkencore juridike. Për më tepër, në shkencën juridike të zhvilluar një objekt mund të studiohet nga aspekte të veçanta dhe duke përdorur metoda të ndryshme. Ndonëse, edhe aspekti i një objekti është objekt po qe se të studiuarit e tij është adekuat (i arsyeshëm) nga pikëpamje metodologjike dhe nëse zbulon esencën më të plotë e më të gjithanshme, të vërtetën mbi objektin.[46] Së këndejmi, e drejta komparative si një disiplinë specifike shkencore juridike, në radhë të parë, dhe kryesisht, ka për objekt të studimit, sistemet juridike të së paku dy ose më shumë shteteve të caktuara në aspektin juridiko-komparativ. Është me shumë interes dhe rëndësi të vihet në dukje fakti se në të drejtën komparative në pikëpamje të objektit të saj të studimit, mbizotëron një tipar i rëndësishëm, ai i volumit global apo dimensionit transnacional.[47] Kjo lejon mundësinë të kuptohet se objekti i të drejtës komparative nga prizmi i studimit të sistemeve juridike nuk është i limituar në aspektin e shtrirjes hapësirore gjeografike, d.m.th., ajo studion, kundron dhe trajton sistemet juridike ekzistuese gjithandej në mbarë botën.

Metoda e një disipline shkencore juridike është rruga apo mënyra e hulumtimit që ajo zbaton që ta studioj dhe ta njoh objektin e vet. Ndryshe, metoda përfshin veprimet dhe mjetet me ndihmën e të cilave studiohet objekti i një disipline shkencore juridike të caktuar. Metoda dhe objekti janë në lidhje të ngushtë dhe në varësi reciproke me njëri-tjetrin. Kjo nënkupton se "metoda duhet të jetë konform me objektin e studimit, ndonëse objekti determinon metodën duke e absorbuar në vete, ndërsa metoda duket vetëm si shprehje e jashtme e objektit në vetëdijen e atij i cili e zbaton atë".[48] Shumica dërmuese, ose pjesa më e madhe disiplinave shkencore juridike i shfrytëzojnë disa metoda shkencore të përgjithshme të hulumtimit. I tillë është rasti edhe me të drejtën komparative. Pra, e drejta komparative nuk disponon me ndonjë metodë autonome dhe ekskluzive me të cilën do të identifikohej vetëm ajo. Në këtë rast, duhet të theksohet se, metodat e të drejtës komparative, janë të kondicionuara nga qasja studimore e fenomeneve juridike, përkatësisht nga objekti i të drejtës komparative.

E drejta komparative si disiplinë shkencore juridike, në studimin e objektit të vet, në radhë të parë, dhe kryesisht, zbaton: metodën komparativo-juridike, metodën historiko-juridike, si dhe metodën e logjikës juridike (analiza, sinteza, abstraksioni, deduksioni, induksioni). Në fakt, e drejta komparative në parim mund të përdorë çdo metodë që mund të përdoret për të gjetur përgjigje për pyetjet që u interesojnë komparatistëve.[49]

Metodën komparativo-juridike e drejta komparative e zbaton, sepse gjatë studimit dhe hulumtimit të fenomeneve juridike interesohet ekskluzivisht vetëm për dimensionin juridiko-komparativ të tyre. Në fakt, e drejta

---

[45] Shih: Reimann, Mathias, Zimmermann, Reinhard. *The Oxford Handbook of Comparative Law*, Oxford University Press 2008, f. 478-510.
Transplantimi juridik është një formë e huazimit juridik, dhe si i tillë, përfshin procesin ku një shtet i caktuar inkorporon dhe implementon ndonjë normë juridike të caktuar në legjislacionin e vet nacional nga legjislacioni i një shteti tjetër.

[46] Jovan Đorđević.*Ustavno Pravo*, Beograd, 1982, f. 20.

[47] Shegani, Altin. *E Drejta Penale e Krahasuar*, Tiranë, 2002, f. 13.

[48] Радомир Лукић. *Увод у Право*, Београд, 1975, f. 12.

[49] Adams, Maurice, Heirbaut, Dirk. *The Method and Culture of Comparative Law*, Hart Publishing 2014, f. 56.

komparative metodën komparativo-juridike e aplikon me rastin e studimit dhe shqyrtimit të fenomeneve të ndryshme juridike (akteve normative juridike, instituteve juridike, sistemeve juridike) në përmasa komparativo-juridike. Në përputhje me këtë, metoda komparativo-juridike nuk është tjetër, veçse një metodë shkencore që shërben për studimin dhe njohjen e të drejtave nacionale apo interne të shteteve të tjera. Pikërisht për këtë arsye, në disa raste flitet për studime krahasimtare-juridike të sistemeve juridike (p.sh., studimi i të drejtës franceze dhe i të drejtës gjermane), sesa për të drejtë komparative. Ndryshe, metoda komparativo-juridike në të drejtën, është e përshtatshme për observimin sinkronik të normave juridike, si dhe të formave të zgjidhjeve të çështjeve juridike identike apo analoge në raste dhe në vende, si dhe në kohë të ndryshme. Për më tepër, tendenca e harmonizimit juridik të sistemeve juridike nacionale të ndryshme në shkallë evropiane, për të arritur në perspektivë tek një sistem juridik i përbashkët dhe unik panevropian bën imanente (të domosdoshme) zhvillimin dhe kultivimin e metodës komparativo-juridike si një metodë aplikative shkencore juridike.[50] Kjo lejon mundësinë të kuptohet se, metoda komparativo-juridike me aktualitet të mprehtë veçanërisht vjen në shprehje në kushtet dhe rrethanat e zhvillimit të procesit të harmonizimit të sistemeve juridike të shteteve aspirante për anëtarësim në Unionin Evropian, përfshirë, ndër të tjera, edhe sistemin juridik pozitiv të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të Republikës së Shqipërisë, dhe të Republikës së Kosovës. Kjo aq më tepër që është në korelacion me kriterin juridik të Kopenhagës, si një nga kriteret kyçe të Unionit Evropian që duhet të plotësojnë shtetet pretendente për anëtarësim në Unionin Evropian, në mënyrë që të evitohen divergjencat juridike esenciale midis sistemeve juridike të shteteve evropiane, dhe rrjedhimisht sistemet juridike të tyre të jenë sa aproksimative aq edhe analoge me njëri-tjetrin, duke aplikuar metodën komparativo-juridike. Megjithëse, sot në Evropë shtetet kanë tendencë t'i harmonizojnë (përafrojnë) të drejtat e tyre pa dashur t'i unifikojnë (bashkojnë) ato në një të drejtë të vetme.

Së fundmi, është e rekomandueshme që "të gjithë pedagogët e të drejtës" të aplikojnë "metodën komparativo-juridike me qëllim që të zgjerojnë diapazonin e dijeve apo begatojnë fondin e njohurive profesionale-shkencore juridike". Roskoe Paund, qysh në vitin e largët 1934, kishte sugjeruar "që pedagogu i të drejtës i së ardhmes duhet të mbështesë veten në të drejtën komparative, me qëllimin e vetëm që ai të bëhet i aftë të kuptojë dhe të zotërojë më mirë materien juridike që lidhet me lëndën e vetë mësimore përkatëse..."[51]

Metodën historiko-juridike e drejta komparative e përdorë, në sensin e kërkimit për të zbuluar origjinat e hershme të zhvillimit të traditave juridike dhe për të studiuar evoluimin kronologjik të sistemeve juridike që nga antikiteti deri në ditët tona.[52] Me fjalë të tjera, metoda historiko-juridike, i hyjnë në shërbim të drejtës komparative, për shkak se nëpërmjet saj akumulon (grumbullon) njohuri rreth sistemeve juridike që kanë lindur dhe janë zhvilluar në një kuadër historik dhe në një formacion shoqëror–ekonomik të caktuar.

5. Parimi i funksionalitetit si parim bazë i së drejtës komparative

Parimi i funksionalitetit (*principle of functionality*) është pikënisja dhe baza për çdo krahasim juridik të fenomeneve juridike, dhe si e tillë, e të gjithë të drejtës komparative. Në fakt, parimi i funksionalitetit është parimi bazë metodologjik i të gjithë të drejtës komparative. Parimi i funksionalitetit niset nga prezumimi juridik i ngjashmërisë – *praesumptio similitudinis*/*presumption of similarity*, me ç'rast krahasimi juridik mund të bëhet vetëm ndërmjet instituteve juridike komparibile (që janë të krahasueshme/që mund të krahasohen), d.m.th. midis atyre instituteve juridike që janë ekuivalente nga prizmi funksional, pra, që përmbushin të njëjtat detyra apo kanë

[50] Shih: Adams, Maurice, Heirbaut, Dirk. *The Method and Culture of Comparative Law*, Hart Publishing 2014, f. 38-57; Pier Monateri, *Advanced Introduction to Comparative Legal Methods*, Edward Elgar Publishing 2021.
[51] Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford, 1998, f. 23-24.
[52] Shegani, Altin. *E Drejta Penale e Krahasuar*, Tiranë, 2002, f. 15.

të njëjtat funksione.[53] Sipas autorit Ernst Rabel parimi i funksionalitetit përbëhet nga dy elemente bosht: *një*, "funksioni" dhe *dy*, "konteksti".[54]

Funksioni do të thotë se institutet juridike të sistemeve juridike nacionale të ndryshme mund të krahasohen nga aspekti juridik vetëm në qoftë se ato kryejnë të njëjtën detyrë, apo i shërbejnë të njëjtit funksion, që, në esencë, përbën një emërues të përbashkët (*common comparative denominator, tertium comparationis*), që siguron dhe bën të mundur krahasimin juridik. Kështu, ngjan (duket) bizar, paradoksal dhe tejet absurde, sikundër është edhe "jashtë sensit të çdo logjike juridike" të krahasohen dy institute juridike[55] heterogjene (të ndryshme) që kryejnë funksione të ndryshme në aspektin juridik, si p.sh., Gjyqësori Administrativ dhe Gjyqësori Kushtetues. Kjo ilustrohet më së miri nëpërmjet aksiomës angleze "*incomparables can not be compared";* ose *"only comparables can be compared"*, që do të thotë "të pakrahasueshmet nuk mund të krahasohen", ose "vetëm të krahasueshmet mund të krahasohen". Ndërkohë, është krejtësisht e natyrshme nga "aspekti i logjikës juridike" të bëhet krahasimi juridik për motive të punës studimore e kërkimore-shkencore, apo praktike-empirike instituti juridik identik, si p.sh., Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Gjermanisë, duke hulumtuar, analizuar, dhe eksplikuar tiparet e qenësishme të përbashkëta dhe tiparet e veçanta dalluese, përfshirë avantazhet e disavantazhet ndërmjet tyre në planin juridiko-komparativ.

Konteksti do të thotë se gjatë procesit të krahasimit juridik të një instituti juridik të caktuar duhet të kihen parasysh sfondi i përgjithshëm historik e socio-ekonomik, por edhe faktorët e gjithmbarshëm kulturor, ideologjik, psikologjia sociale, tradicional e religjioz, që kondicionojnë (kushtëzojnë) dhe ndikojnë në formësimin e përmbajtjes normative semantike të një instituti juridik të caktuar në momentin e dhënë kohor në një mjedis shoqëror të dhënë në praktikë.

6. Mikro-komparacioni juridik dhe makro-komparacioni juridik

Juristët që merren me të drejtën komparative quhen jurist-komparatist (*comparative lawyers*). Me fjalë të tjera, juristët-komparatist janë shkencëtarët që studiojnë dhe hulumtojnë fenomene të ndryshme juridike në planin juridiko-krahasimtar. Juristët-komparatist janë të destinuar dhe të inklinuar t'i krahasojnë, shkoqisin dhe shpjegojnë dukuritë juridike, përkatësisht konceptet juridike, aktet normative juridike, institutet juridike sikundër edhe sistemet juridike të shteteve të ndryshme, qoftë për synime hulumtuese teorike-shkencore juridike, qoftë për synime pragmatike-empirike.

Në lidhje me metodat e komparacionit juridik duhet theksuar se dy qasje kryesore në të drejtën komparative janë: mikro-komparacioni (*micro-comparison*) juridik dhe makro-komparacioni (*macro-comparison*) juridik. Zakonisht mikro-krahasimi juridik merret me krahasimin juridik të akteve normative juridike, rasteve studimore juridike, çështjeve tematike juridike dhe instituteve juridike specifike në suaza më të ngushta (shkallë më të vogël) në dy ose më shumë sisteme juridike të shteteve të caktuara. Për shembull, konflikti administrativ si një institut juridik specifik në sistemet juridike të shteteve të Ballkanit Perëndimor.[56] Makro-krahasimi juridik ka të bëjë me krahasimin juridik në suaza më të gjëra (shkallë më të madhe) kryesisht të frymës dhe stilit gjeneral të sistemeve juridike të shteteve të ndryshme. Në të vërtetë, sistematizimi, grupimi dhe klasifikimi i sistemeve juridike të botës në disa entitete të mëdha, d.m.th. në familje juridike qëndron në zemër të makro-krahasimit juridik: ai merret me

---

[53] Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford, 1998, f.34; Natasha Shehu, *E Drejta e Krahasuar Publike*, Tiranë, 2004, f.16.

[54] Shih: Glendon, Mary Ann, Carozza, Paolo G., Picker, Colin B. *Comparative Legal Traditions*, West Academic, 2007, fq. 10-17; Siems, Mathias. *Comparative Law*, Cambridge University Press 2018, f. 31-49; Adams, Maurice, Bomhoff, Jacco. *Practice and Theory in Comparative Law*, Cambridge University Press, 2012, f. 263-264.

[55] Tërësia e normave juridike që rregullojnë dhe përcaktojnë statusin - organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në sistemin juridik të një shteti të caktuar formojnë një institut juridik specifik që i përket të drejtës kushtetuese si një degë themelore e të drejtës. Ose, tërësia e normave juridike që rregullojnë dhe përcaktojnë statusin – organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative në sistemin juridik të një shteti të caktuar formojnë një institut juridik specifik që i përket të drejtës administrative si një degë e veçantë e të drejtës.

[56] Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford, 1998, f.5-6; Geoffrey Samuel, *An Introduction to Comparative Law Theory and Method*, Hart Publishing 2014, f. 50-53.

krahasimin juridik të sistemeve juridike nacionale *en bloc*, të grupeve apo familjeve juridike të sistemeve juridike si tërësi dhe jo me çështje tematike specifike të shkallës së vogël të natyrës juridike.[57] Kështu, lidhur me makro-krahasimin juridik paraqitet në formë koncize një shembull konkret: nëse vështrohet në planin komparativo-juridik sistemi juridik kontinental evropian dhe sistemi juridik anglo-sakson (anglo-amerikan), do të vërehet se ekzistojnë diferenca evidente mes tyre.

Sistemi juridik kontinental evropian (*civil law legal system*) kryesisht bazohet në të drejtën e shkruar (*ius scriptum*) dhe të kodifikuar, i cili origjinën e ka nga e drejta romake. Tradita e të drejtës kontinentale evropiane është tradita juridike[58] më e vjetër dhe më e përhapur sot në botë, duke përfshirë sistemet juridike të Evropës Kontinentale, Amerikës Latine dhe ato të shumë vendeve afrikane dhe aziatike. Këto të drejta, të influencuara jashtëzakonisht nga mësimdhënia universitare e të drejtës romake që në Mesjetë, më pas nga shkolla e të drejtës natyrore dhe, më vonë, nga kodifikimi, karakterizohen nga përdorimi i koncepteve juridike abstrakte dhe nga formulimi i normave juridike të përgjithshme, përparësia e burimeve juridike të shkruara dhe ndarja e normave juridiko-materiale nga normat juridiko-formale (procedurale). Mënyra kryesore e rezonimit/arsyetimit logjik-juridik të juristëve të Evropës kontinentale është silogjizmi (deduksioni), proces i cili konsiston në nxjerrjen e një norme juridike të veçantë (konkrete/individuale) në bazë dhe për zbatim të një normë juridike abstrakte e të përgjithshme në ndonjë rast konkret individual në praktikë (arsyetimi juridik deduktiv). Në lidhje me këtë, vlen të theksohet maksima juridike latine: "*iudicis est ius dicere, non dare*", që do të thotë se roli i gjyqtarit nuk është të krijoj të drejtën, por është vetëm të interpretoj dhe të zbatoj të drejtën (aktet e përgjithshme normative juridike) nëpërmjet nxjerrjes së akteve juridike individuale konkrete në raste partikulare në praktikë.[59]

Nga ana tjetër, sistemi juridik anglo-sakson/anglo-amerikan (*common law legal system*)[60] paraqitet si rezultat i zgjerimit, konsolidimit dhe centralizimit të pushtetit të fuqishëm monarkist dhe njëherësh të veprimtarisë dhe punës së gjykatave monarkiste të cilat kanë qenë tërësisht të varura dhe të ndërlidhura për pushtetin monarkist dhe që kanë funksionuar në bazë të sistemit së të drejtës së përgjithshme-*common law*, që ka qenë aplikativ në gjithë territorin e Anglisë. Bëhet fjalë për një sistem juridik origjinal, meqë është zhvilluar në mënyrë spontane, graduale dhe autonome pa ndonjë influencë nga e drejta romake dhe Evropa kontinentale, së pari në Angli e më vonë është përhapur edhe në vendet tjera të cilat e kanë si një mjet komunikimi gjuhën angleze. Juristët anglezë me krenari të veçantë e nënvizojnë individualitetin e vetëqenies historike kombëtare dhe trashëgiminë e të drejtës së vetë nacionale autentike dhe autoktone. Sot, pothuajse 1/3 nga popullsia në rruzullin tokësor jeton sipas parimeve juridike fondamenti i të cilëve është krijuar në kuadër së të drejtës anglo-saksone. Sistemi juridik anglo-sakson përmbledh kryesisht të drejtën e Britanisë së Madhe, Irlandës, SHBA, Kanadasë, Australisë dhe Zelandës së Re. Fillimisht e drejta zakonore/dokësore e quajtur *common law* ka shërbyer për gjykime të çështjeve gjyqësore, kështu që çështjet e gjykuara juridike me *common law*, rrjedhimisht janë shndërruar në *case law*, që, në thelb, paraqesin shembëllesë të praktikës gjyqësore, që më vonë i obligojnë gjykatat t'i aplikojnë me analogji juridike në rastet e ngjashme në praktikë nga gjykatat. Pra, *common law*, është substrati embrional i burimit juridik, duke u aplikuar nëpërmjet të *case law* e përpunuar nëpërmjet rasteve specifike në praktikë. Në përputhje me këtë, nuk ka asnjë dyshim se e drejta anglo-saksone është një e drejtë jurisprudenciale (gjyqësore), pra e krijuar dhe e përpunuar nga gjykatat, përkatësisht gjyqtarëve me vendimet e tyre gjatë shekujve të shkuar, karakterizohet nga përdorimi i

[57] Smits, Jan M. *Elgar Encyclopedia of Comparative Law*, Edward Elgar Publishing 2014, f. 382-383.

[58] Tradita juridike nuk është një tërësi normash juridike, përkundrazi, është një grup qëndrimesh të rrënjosura thellë, të kushtëzuara historikisht për natyrën e të drejtës, rolin e të drejtës në shoqëri dhe në shtet, organizimin dhe funksionimin e duhur të një sistemi juridik, dhe si e drejta duhet të bëhet, zbatohet, studiohet, perfeksionohet dhe mësohet. – John Henry Merryman, Rogelio Pérez-Perdomo, *The Civil Law Tradition*, Stanford University Press 2018, f. 2.

[59] Shih më gjerë: Siems, Mathias. *Comparative Law*, Cambridge University Press 2018, f. 50-68; David, René, Brierley, John E. C. *Major Legal Systems in the World Today: An Introduction to the Comparative Study of Law*, Free Press 1978, f.21-22; Glendon, Mary Ann, Carozza, Paolo, Picker, Colin. *Comparative Legal Traditions*, West Academic Publishing 2008, f. 16-150; Marryman, John Henry.*The Civil Law Tradition An Introduction to the Legal Systems of Western Europe and Latin America*, Stanford University Press, 2007, f. 1-67.

[60] Ndërsa termi "sistemi juridik anglo-sakson„ "predominon" në "literaturën juridike britanike", termi "sistemi juirdik anglo-amerikan" "mbizotëron" në "literaturën juridike amerikane".

koncepteve juridike më pak abstrakte, nga përparësia e rregullave kazuistike (që trajtojnë raste të veçanta) dhe nga ndërthurja e normave juridike substanciale/materiale me normat juridike formale/procedurale. Vendimi gjyqësor i mëparshëm argumentet juridike e të cilit shfrytëzohen që të vendoset rasti i ri quhet precedent gjyqësor, ndërsa e drejta e krijuar në bazë të precedentëve gjyqësor (*judicial precedents*) quhet e drejta e precedentore (*case law*) ose e drejta jurisprudenciale/gjyqësore (*judge – made case law*). Për pasojë, qasja juridiko-induktive ndaj të drejtës reflektohet edhe në rrafshin e doktrinës juridike anglo-amerikane, ku e drejta përkufizohet si një tërësi rregullash që krijojnë apo vendosin gjykatat. Përveç kësaj, ekziston edhe një e drejtë ligjore (*statutory law*/*statute law*) si një tërësi normash juridike që miraton parlamenti në formë të akteve ligjore për të rregulluar marrëdhënie me përmbajtje të ndryshme tematike shoqërore në sistemin juridik. Mënyra kryesore e rezonimit/arsyetimit logjik-juridik të juristëve anglo-amerikanë është racionalo-pragmatike, më saktësisht analogjia juridike, proces i cili konsiston në zbatimin e një norme juridike konkrete ekzistuese në rastet aproksimative (e përafërta) apo analoge që do lindin/shpërfaqen në praktikë duke e vendosur në korelacion me rastet e mëhershme që veçmë kanë marrë epilog juridik konkret në praktikë (arsyetimi juridik induktiv). Në lidhje me këtë, vlen të theksohet maksima juridike anglo-amerikane: "*judges follow previously decided cases where the facts are of sufficient similarity*", që do të thotë se gjyqtarët ndjekin rastet e vendosura më parë kur faktet kanë ngjashmëri të mjaftueshme.[61]

7. Funksionet (synimet) e të drejtës komparative

[61] E drejta e precedentore pikënisje ka parimin juridik që mban emërtimin *stare decisis* – që përkthyer *ad litteram* do të thotë "*t'i përmbahemi vendimit të marrë"*, i cili origjinën e ka nga maksima juridike latine: "*stare decisis et non quieta movere*"; "*To stand by decisions and not disturb the undisturbed*" – që do të thotë "*T'i përmbahemi vendimeve veçmë të marra dhe të mos i deformojmë (shkelim) çështjet tashmë të vendosura*". Pra, gjyqtari është i obliguar të interesohet dhe të kujdeset se në një rast që shtrohet për shqyrtim gjyqësor para tij a ekziston ndonjë vendim gjyqësor (precedent gjyqësor) dhe nëse ekziston duhet të konsiderohet i detyrueshëm për gjyqtarët e të njëjtit rank ose të një ranku më të ulët. Kjo siguron dhe bën të mundur qëndrueshmërinë, konsekuencën dhe parashikueshmërinë nga pikëpamja e zbatimit së të drejtës në praktikë. Në këtë kontekst, gjyqtarët në sistemin juridik anglo-sakson, nuk janë vetëm "makinë aplikative ose goja që prononcon/shqipton fjalët e akteve normative juridike, por, përkundrazi, ato janë edhe kreatorë të tyre, ngase i zhvillojnë ato nëpërmjet marrjes së vendimeve gjyqësore, duke u dhënë epilog juridik rasteve partikulare në praktikë që palët i shtrojnë përpara tyre (*judge - made case law*). Së këndejmi, gjyqtarët e gjykatave të Anglisë, e ndjekin zhvillimin e praktikës gjatë vendosjes së rasteve konkrete, kështu që, me rastin e marrjes së vendimit gjyqësor mbi një rast të veçantë, gjyqtarët i përfillin ato, madje edhe thirren në rastet preliminare (e mëhershme) analoge tashmë të gjykuara, pra i marrin në konsideratë vendimet gjyqësore të mëparshme në të gjitha rastet analoge të ardhshme kur të shtrohen për shqyrtim gjyqësor, gjë e cila ka çuar në krijimin e praktikës gjyqësore në zgjidhjen e rasteve të ngjashme nga organet gjyqësore shtetërore të Anglisë. Praktika gjyqësore nënkupton mënyrën në të cilën një normë juridike zbatohet njëjtë në më shumë raste apo situata analoge. Në lidhje me praktikën gjyqësore, në të drejtën romake ka ekzistuar maksima juridike: *"Cursus curiae est lex curiae"* – praktika gjyqësore është ligj për gjykatën. Vendimi gjyqësor me të cilin është vendosur në praktikë një rast konkret, konsiderohet i detyrueshëm për të gjithë rastet e ardhshme analoge të cilat vendosen në mënyrë identike. Kjo do të thotë se një vendim gjyqësor si një akt juridik konkret individual shndërrohet në normë të përgjithshme juridike si rezultat i përsëritjeve të shpeshta të rasteve analoge në praktikën gjyqësore dhe ajo quhet precedent gjyqësor, ndërsa vetë sistemi juridik, sistem i të drejtës precedentore. Në kuptimin më të përgjithshëm, precedenti gjyqësor nënkupton rastin e veçantë që është vendosur më parë nga gjykata, e që më pas mund të ndiqet nga gjykatat në situatat e mëvonshme analoge si pikë-referenciale për të justifikuar raste të tjera analoge në kontekste të caktuara. Shprehur në mënyrën më të thjeshtë të mundshme, precedenti gjyqësor është vendosja e njëhershme e një rasti konkret në praktikë nga gjykata, e cila shërben si model për vendosjen e mëvonshme të rasteve analoge në praktikë nga gjykatat. – shih: Endicott, Timothy, Kristjánsson, Hafsteinn Dan, Lewis, Sebastian, Philosophical Foundations of Precedent, Oxford University Press 2023; Brand, Paul. The Making of the Common Law, Hambledon Press 1992; Glenn, H Patrick. On Common Laws, Oxford University Press 2007; David, René, Brierley, John E. C. Major Legal Systems in the World Today: An Introduction to the Comparative Study of Law, Free Press 1978, f. 23-26; Caenegem, R. C. Van.The Birth of the English Common Law, Cambridge University Press 1988, f.1-28; Pound, Roscoe. The Spirit of the Common Law, Routledge 1998; W. W. Buckland, McNair, Arnold D. Roman Law and Common Law: A Comparison in Outline, Cambridge University Press 2008; Collin, Peter. Dictionary of Law, Bloomsbury Pub Ltd, 2004, f. 41, 55; Glenn, H Patrick. On Common Laws, Oxford University Press, 2007; Herbert Lionel Adolphus Hart, The Concept of Law, Oxford University Press 2012.

Sikurse çdo disiplinë shkencore juridike, ashtu edhe e drejta komparative ka funksionet (synimet) e saj, të cilat do të mund të përmblidheshin apo sistemoheshin në disa më kryesore. Në këtë rast, do të jepet një shpjegim i përkorë për këto funksione kryesore të mëposhtme:

E para, njohuri – intenca qendrore e studimit të së drejtës komparative në fakultetet juridike të universiteteve të ndryshme të botës, në radhë të parë, dhe kryesisht, reduktohet në faktin që studentët e drejtësisë të pajisen me një kulturë universale juridike dhe të fitojnë njohuri fondamentale teoriko-juridike në fushën e sistemeve juridike që u përkasin familjeve të ndryshme juridike në rrafshin mondial (botëror).[62] Megjithëse "të gjitha format e njohurive më të larta profesionale-shkencore juridike konsistojnë nga aspektet komparativo-juridike" (*comparativa est omnis investigatio; all forms of higher knowledge consist of comparison*).[63]

E dyta, si një ndihmë për legjislatorin – legjislatorët, në mbarë botën "kanë parë se në shumë çështje ligjet e mira nuk mund të dalin pa ndihmën e të drejtës komparative", prandaj ato bëjnë transplantimin/huazimin juridik (*legal borrowing*) sipas nevojës specifike të ndonjë zgjidhje juridike nga legjislacionet e shteteve të tjera në legjislacionin e vetë nacional.[64] Mirëpo, me të drejtë tërhiqet vërejtja për faktin se duhet treguar kujdes të madh me rastin e "akceptimit të një zgjidhje juridike të huaj", sepse, sipas, dy autorëve gjerman Zweigert dhe Kotz, "kurdoherë që propozohet të akceptohet" një zgjidhje juridike e huaj, që thuhet se është më "superiore", duhet të bëhen dy pyetje: *e para*, "nëse ajo ka provuar se ka qenë e dobishme në vendin e saj të origjinës", dhe, *e dyta*, "nëse do të funksionojë në mënyrë efektive në vendin ku është akceptuar". Ndryshe, mund të dalë, jo rallë, "që një zgjidhje juridike e provuar në një vend tjetër mund të mos jetë e pranueshme (përshtatshme) dhe efektive për një vend tjetër për shkak të sfondit dhe kontekstit lokal divers social, ekonomik, kulturor e religjioz, si dhe rezistencës ose reaksioneve nga komunitetet shoqërore të caktuara, të cilët mund të sfidojnë pranimin apo zbatimin në praktikë të ndonjë zgjidhje juridike të huaj që bie ndesh, bie fjala, me vlerat lokale përkatëse të shoqërisë dhe shtetit konkret. Prandaj, suksesi dhe sfida e transplantimit juridik kushtëzohet dhe varet nga kompatibiliteti (përshtatshmëria) me kontekstin lokal – kushtet dhe rrethanat konkrete e specifike të mjedisit shoqëror përkatës.[65]

Tre, edukimin juridik – është konsideruar me "shumë interes" funksioni i rëndësishëm i të drejtës komparative, për edukimin juridik, që kontribuon në zhvillimin akademik dhe profesional të juristëve, duke pasur parasysh faktin se "në edukimin juridik, si dhe në shkencën juridike në përgjithësi, është shumë kufizuese të studiosh vetëm një të drejtë nacionale". Studimi i të drejtave të shteteve të ndryshme ndihmon në rritjen e tolerancës dhe nxitjen e dialogut ndërmjet kulturave juridike të ndryshme, duke njohur dhe respektuar pluralizmin e traditave juridike. Pra, e drejta komparative u ofron studentëve të drejtësisë "një dimension krejt të ri, që ata të mund të mësojnë dhe të fitojnë shprehi t'i respektojnë kulturat juridike të posaçme të popujve të tjerë, mandej "të kuptojë të tijën më mirë", të zhvilloj standartet kritike që mund të çojnë në përmirësimin, zhvillimin dhe përkryerjen (përsosjen) e kulturës juridike të vendit të tij" dhe, natyrisht, "të mësojë se si kushtëzohen normat juridike nga faktorët socialë dhe se çfarë përmbajtje të ndryshme mund të marrin ato". Me një fjalë, vetëm prej atij "që mëson të respektojë kulturat juridike të popujve të tjerë", mund të pritet që "do të kuptojë të tijën më mirë";[66]

E katërta, unifikimi (njësimi)[67] – unifikimi i të drejtës nënkupton krijimin e një të drejte singulare (të vetme) dhe një sistemi juridik unik në territorin e një ose më shumë shteteve në të cilën ka mbisunduar partikularizmi juridik.[68] Në fakt, unifikimi i të drejtës ka të bëjë me nxjerrjen e normave juridike unike të së drejtës materiale dhe procedurale, me vlefshmëri në territorin e një shteti ose më shumë shteteve.[69]

Nuk ka asnjë dyshim, se e drejta komparative synon përherë të ushtrojë impakt në sensin unifikues mbi legjislacionet nacionale, përkatësisht mbi sistemet juridike të shteteve të ndryshme. Ndryshe, e drejta komparative

[62] Shih: Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford, 1998, f. 15-16.
[63] Andenas, Mads, Fairgrieve, Duncan. *Courts and Comparative Law*, Oxford University Press 2019, f. 28.
[64] Shih: Watson, Alan. *Legal Transplants*: *An Approach to Comparative Law*, University of Georgia Press, 1974.
[65] Shih: Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford, 1998, f. 16-21.
[66] Ibidem., f. 21-24.
[67] Ibidem., f. 24-26.
[68] Mukić, Marta Vidaković.*Opći Pravni Rječnik*, Zagreb, 2006, f. 1224.
[69] *Pravni Leksikon*, Zagreb, 2007, f. 1679.

kontribuon sistematikisht në procesin e unifikimit (njësimit) të së drejtës, mbi të gjitha, dhe para së gjithash, në fushën juridiko-private (*ius privatum*), pra në marrëdhëniet juridiko-private, ndonëse në "kuantume dhe proporcione" limitative.

Unifikimi i të drejtës bëhet në plan të dyfisht: *një*, si unifikim i të drejtës në planin intern/nacional që realizohet nëpërmjet kodifikimit juridik – nxjerrjes së kodeve voluminoze ligjore nga secili shtet veç e veç) dhe *dy*, si unifikim i të drejtës në planin ndërkombëtar (që bëhet me traktate/marrëveshje ndërkombëtare midis një numri shtetesh në konferencat diplomatike ndërkombëtare). Unifikimi i të drejtës në planin nacional paraqet përmbledhje të sistemuar të normave juridike në një tërësi koherente juridike (zakonisht kod ligjor, si p.sh., Kodi Elektoral i Republikës së Maqedonisë së Veriut i vitit 2006, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë i vitit 2015, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë i vitit 1994, Uniform Commercial Code (UCC) – Kodi i Njësuar i Tregtisë i SHBA i vitit 1952, etj) nga ligjvënësi (parlamenti) i një shteti të caktuar, në bazë të disa parimeve juridike. Unifikimi i të drejtës në planin ndërkombëtar paraqet përmbledhje të sistemuar të normave juridike në një tërësi kompakte juridike (zakonisht traktat/konventë ndërkombëtare, si p.sh., Konventa e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve, e vitit 1969, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e vitit 1950, etj) nga ndonjë organizatë ndërkombëtare të shteteve, në bazë të disa parimeve juridike. Unifikimi i të drejtës në planin ndërkombëtar, si rregull, realizohet nëpërmjet traktateve ndërkombëtare[70] multilaterale (shumëpalëshe), miratimi i të cilëve bëhet në konferenca diplomatike ndërkombëtare.[71] Kësisoj, deri te unifikimi i të drejtës në planin ndërkombëtar në ndonjë fushë juridike konkrete mund të vijë nëse në traktatet ndërkombëtare multilaterale që lidhin (nënshkruajnë) shtetet midis tyre miratojnë qëndrime juridike unanime lidhur me kuptimin (domethënien) përmbajtësor të normave juridike ose instituteve juridike të caktuara me të cilat rregullohen marrëdhënie juridike nga ndonjë domen konkret i të drejtës. Në këtë mënyrë, normat juridike uniforme të përmbajtura në një traktat ndërkombëtar multilateral me aktin e ratifikimit të tyre me ligj nga parlamenti i secilit shtet kontraktual veç e veç bëhen pjesë integrale (përbërëse) të rendit juridik intern të atyre shteteve kontraktuale, me çka arrihet unifikimi i të drejtës në sferën juridike respektive, dhe për pasojë, detyrohen që t'i aplikojnë në praktikë (*pacta sunt servanda*).[72] Në lidhje me këtë, duhet theksuar se në të gjithë konferencat ndërkombëtare diplomatike që janë mbajtur e deri më sot, nuk është arritur të bëhet unifikimi juridik inkluziv (gjithpërfshirës) i të drejtës në planin ndërkombëtar, por është arritur të bëhet unifikimi juridik parcial, pra fragmentar (i pjesshëm) i të drejtës, në fusha konkrete të caktuara të marrëdhënieve juridike. Shembull ilustrativ është unifikimi i dispozitave juridike në fushën e marrëdhënieve juridiko-private me element të huaj nga çështjet statusore, e drejta e autorit, pronësia industriale, nga lëmia e së drejtës kambiale dhe çekore etj,[73] (Konventa mbi zgjidhjen e konfliktit të ligjeve në çështjet e martesës, e vitit 1902 në Hagë, Konventa mbi kujdestarinë ndaj personave të mitur, e vitit 1902 në Hagë); (Konventa mbi mbrojtjen e të drejtës së autorit, e vitit 1886 në Bern); (Konventa mbi mbrojtjen e pronësisë industriale, e vitit 1883 në Paris); (Konventat e Gjenevës mbi çekun dhe kambialin, e vitit 1930 dhe 1931).

---

[70] Traktatet (marrëveshjet) ndërkombëtare janë akte juridike, me anë të së cilave subjektet e të drejtës ndërkombëtare (shtetet, organizatat ndërkombëtare), marrin të drejta dhe detyrime reciproke për rregullimin e marrëdhënieve midis tyre, qoftë të natyrës juridiko-publike, ose të natyrës juridiko-private. – Juraj Andrassy, *Međunarodno Pravo*, Zagreb, 1984, f. 18. Ndryshe, traktati ndërkombëtar konsiston në akordimin e vullnetit të dy ose më shumë subjekteve së të drejtës ndërkombëtare me qëllim, që, të arrihet efekt juridik i caktuar sipas së drejtës ndërkombëtare, duke krijuar raportin e të drejtave dhe detyrimeve midis palëve të saja. – Vladimir Đuro Degan, *Međunarodno Pravo*, Zagreb, 2011, f. 113.

[71] Varësisht nga numri i palëve që i kanë nënshkruar, traktatet mund të jenë dypalëshe (bilaterale) dhe shumëpalëshe (multilaterale). Miratimi i traktateve ndërkombëtare bilaterale (dypalëshe), por edhe kur janë disa palë, bëhet me nënshkrimin formal të dokumenteve nga përfaqësuesit zyrtar të autorizuar të shteteve përkatëse. Ndërkaq, miratimi i traktateve ndërkombëtare multilaterale (shumëpalëshe) në një konferencë ndërkombëtare, si rregull, bëhet me votën e dy të tretave të shteteve të pranishme dhe që votojnë, përveç rasteve kur me të njëjtën shumicë, ato vendosin të zbatojnë një rregull tjetër (neni 9, paragrafi 2 i Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve i vitit 1969). – Vesna Crnić-Grotić, *Pravo Međunarodnih Ugovora*, Rijeka, 2002, f. 311.

[72] *Pravna Enciklopedija* 2, Beograd, 1989, f. 1772 – 1773.

[73] Katičić, Natko. *Međunarodno Privatno Pravo*, Zagreb, 1976, f. 25.

Vështruar nga perspektiva zhvillimore futuriste, e drejta në planin global planetar në përgjithësi shoqërohet me "tendenca konvergjente" dhe jo me "tendenca divergjente".[74] Në këtë drejtim, ndihmesë të madhe në unifikimin e të drejtës ofrojnë organizatat dhe asociacionet ndërkombëtare të caktuara, siç janë: p.sh., Akademia për të Drejtën Ndërkombëtare, Komisioni i OKB-së për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (*UNICITRAL*), Instituti Ndërkombëtar për Unifikimin e të Drejtës Private në Romë (*UNIDROIT*), Konferenca e Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, Organizata Botërore për Pronësinë Intelektuale.[75] Kështu, fjala vjen, Konferenca e Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private, ka si mision kryesor të saj, unifikimin progresiv të dispozitave juridike të së drejtës ndërkombëtare private. Veprimtaria e Konferencës konsiston në përgatitjen e teksteve të konventave multilaterale të dedikuara për nënshkrim dhe ratifikim nga shtetet-anëtare të saj. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se deri më sot janë miratuar 34 konventa: Konventa e zgjidhjes së kolizionit mes të drejtës së shtetësisë dhe të drejtës së vendbanimit, e vitit 1955; Konventa mbi njohjen e subjektivitetit juridik të ndërmarrjeve të huaja, shoqatave dhe institucioneve, e vitit 1956, etj.[76] Ose, Komisioni i OKB-së për të drejtën ndërkombëtare tregtare (*UNICITRAL*) është themeluar 17.XII.1966 me qëllim të avancimit, harmonizimit dhe unifikimit progresiv të dispozitave të së drejtës ndërkombëtare tregtare, duke pasur parasysh interesat e të gjithë popujve dhe shteteve në përgjithësi dhe popujve dhe shteteve në zhvillim në veçanti. Arritja e tij më e madhe deri tani është Konventa mbi Kontratat për Shitblerjen Ndërkombëtare të Mallrave (*Convention on Contracts for the International Sale of Goods – CISG*) e lidhur në Vjenë në vitin 1980.[77]

8. Nocioni familja juridike dhe klasifikimi i sistemeve juridike në familje juridike

Diversiteti i të drejtave nacionale ka qenë po aq i madh sa dhe ajo e gjuhëve, kulturave dhe shoqërive. Në botën kontemporane, të bazuar mbi sovranitetin e shteteve, ka të paktën po aq sisteme juridike sa ka edhe shtete, madje ka edhe më shumë përderisa disa shtete nuk e kanë unifikuar krejtësisht të drejtën që zbatohet në territorin e tyre (rasti i të drejtës skoceze në Mbretërinë e Bashkuar, i Luizianës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj).[78] "Panorama e sistemeve juridike të botës" përfshin pluralitetin (shumësinë) e sistemeve juridike nacionale me ç'rast, në secilin nga ato veç e veç është integruar aktiviteti dhe resurset e gjithmbarshme të shtetit përkatës, siç janë: shkenca juridike, kultura juridike[79] e tradita juridike.

Sintagma "familja juridike**"** përdoret thjesht si një metaforë, pra në kuptimin figurativ, për qëllime shpjeguese, dhe si e tillë, ka shërbyer si një shtyllë organizative për analizën e sistemeve juridike të botës. Në fakt, togfjalëshi "familja juridike" përdoret për të treguar tipet (llojet) e sistemeve juridike, në përputhje me stilin e orientimin gjeneral –karakteristikat juridike themelore të përbashkëta që ekzistojnë midis shumicës dominante të sistemeve juridike nacionale, dhe në sajë të kësaj, bëhet grupimi dhe klasifikimi i sistemeve juridike nacionale nëpër familje juridike.[80] Klasifikimi i sistemeve juridike në familje juridike është kryesisht një instrument pedagogjik-didaktik, i cili është krijuar për të lehtësuar përshkrimin dhe kuptimin e sistemeve juridike të huaja duke u ofruar studiuesve një pasqyrë inkluzive të diversitetit kompleks të tipologjisë së sistemeve juridike të botës.[81]

Ndërlidhja e sistemeve juridike nacionale në familje juridike më të mëdha është rezultat i zhvillimit konkret-historik dhe logjik përgjithësisht dhe i shkencës juridike, në mënyrë të veçantë. Prandaj, ka shumë të vërtetë në thënien se "*shkenca juridike nuk njeh kufij, ajo është një urë lidhëse midis shteteve*". Kësisoj, duke i falënderuar

[74] Varadi, Tibor. *Međunarodno Privatno Pravo*, Novi Sad, 2001, f. 36.
[75] *Pravna Enciklopedija* 2, Beograd, 1989, f. 1764.
[76] Bilalli, Asllan, Kuçi, Hajredin. *E Drejta Ndërkombëtare Private*, Tetovë, f. 75-82.
[77] *Pravna Enciklopedija 2*, Beograd, 1989, f. 1764.
[78] Fromont, Michel. *Sistemet e Huaja Më të Mëdha të të Drejtës*, Tiranë, 2009, f. 7.
[79] Kultura juridike i referohet qëndrimeve (pikëpamjeve), vlerave dhe përfytyrimeve që mban shoqëria për sa i përket të drejtës dhe sistemit juridik të një shteti të caktuar. – Lawrence Meir Friedman, *Law and Society*, Pearson College Div 1977, f. 76.
[80] Mousourakis, George. *Comparative Law and Legal Traditions*, Springer 2019, f. 26.
[81] Ibidem. f. 142.

shkencës juridike, institute juridike të shumta të sistemeve juridike të periudhës kohore të kaluar janë transmetuar gjatë historisë si trashëgimi për brezat e rinj dhe për rregullimet shtetërore juridiko-politike në etapat kohore që kanë pasuar. Në këtë kontekst, veçanërisht është karakteristik shembulli me të drejtën romake. Impakti i të drejtës romake në sistemet juridike të mëvonshme, dhe natyrisht në sistemet juridike moderne evropiane është i madh dhe i ndjeshëm. Kështu, edhe sot, në shtete të ndryshme me rregullim të ndryshëm shtetëror, ekzistojnë institute juridike të numërta nga sfera e të drejtës private që janë shfaqur qysh në kohën e të drejtës romake të cilat, të plotësuara, të pasuruara dhe të zgjeruara në pikëpamje përmbajtësore, janë akoma të pranishme në çdo sistem juridik bashkëkohor, madje edhe kanë rol të pazëvendësueshëm.[82]

Në doktrinën juridiko-komparative nuk ekziston një *communis opinio doctorum* – botëkuptim juridik të përbashkët unanim për sa i përket klasifikimit të sistemeve juridike nacionale në familje juridike. Për këtë arsye, do shpërfaqet një shtjellim koncis i disa sistemeve juridike grandioze (më të mëdha) bashkëkohore në aspektin global planetar.

(1) Sistemi juridik romano-gjermanik (Evropës kontinentale) përfshin vende (Franca, Belgjia, Luksemburgu, Holanda, Italia, Portugalia, Spanja, Gjermania, Austria, Zvicra etj) në të cilat e drejta dhe shkenca juridike "u formuan mbi bazën e të drejtës romake". Ky sistem juridik lindi në kontinentin evropian dhe u emërtua si "romano-gjermanik", sepse u përpunua nga studiues latino-gjermanë.[83]

(2) Sistemi juridik anglo-sakson (anglo-amerikan) përfshin të drejtën e Anglisë dhe të vendeve që kanë "akceptuar modelin e të drejtës angleze". Sfera e zbatimit të së drejtës angleze kufizohet në Angli dhe në Uells, ndërsa vendet e tjera ku zbatohet *common law* janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanadaja madje, pjesërisht, edhe India.[84]

(3) Sistemet juridike religjioze/fetare (si p.sh., e drejta islamike, e drejta kanonike, e drejta hindu, e drejta hebraike dhe e drejta konfuçiane) nuk përbëjnë një "sistem juridik më vete", sepse janë të pavarura nga njëri-tjetri. Ndër këto sisteme juridike më i rëndësishmi është sistemi juridik mysliman (sheriati). E drejta islamike myslimane nuk është e drejtë e ndonjë "shteti mysliman (islamik) të veçantë". Ajo njësoj, si e drejta kanonike e krishterë ose judaizmi, konsiderohet si e "drejtë e bashkësisë së besimtarëve". Ajo, më tepër se sa e drejtë, "është një tërësi normash, që ndiqen nga anëtarët e komunitetit fetar islam dhe që sundohen nga një doktrinë fetare – islami, objekt i të cilave janë marrëdhëniet midis njerëzve të bazuara në fenë".[85]

(4) Sistemet juridike mikse (hibride ose të përziera) janë ato sisteme juridike që kanë një strukturë dualiste: burojnë nga më shumë se një traditë juridike (familje juridike).[86] Kështu, p.sh., në sistemin juridik të Kuebekut, e drejta private (*ius privatum*) rrjedh parcialisht (pjesërisht) nga tradita juridike kontinentale evropiane dhe pjesërisht nga tradita juridike anglo-saksone. Shembull tjetër është sistemi juridik i Egjiptit, në të cilin e drejta private buron pjesërisht nga tradita juridike kontinentale evropiane dhe pjesërisht nga tradita juridike religjioze myslimane. Si përfundim mund të nxirret se, sistemet juridike mikse (hibride) janë ato sisteme juridike të cilat në natyrën e vet përmbajtësore karakterizohen me "kryqëzimin" e veçorive kryesisht të dy traditave juridik më të mëdha (*two major legal traditions*): *një*, traditës juridike kontinentale evropiane dhe, *dy*, traditës juridike anglo-amerikane. Kjo do të thotë se brenda përbrenda kornizave të një sistemi juridik unik të një shteti konkret identifikohet simbioza (koekzistenca) juridike ndërmjet dy traditave juridike të mëdha: traditës juridike kontinentale evropiane dhe traditës juridike anglo-saksone duke u ndërthurur dhe ndikuar mbi njëra-tjetrën në

---

[82] Димитар Бајалциев, *Воѕед во Правото*, Shkup, 1999, f. 413.

[83] Marryman, John Henry. *The Civil Law Tradition An Introduction to the Legal Systems of Western Europe and Latin America, Stanford University Press*, 2007, f. 1-67; H. Patrick Glenn, Legal Traditions of the World Sustainable Diversity in Law, Oxford University Press 2007; Mary Ann Glendon, Comparative Legal Traditions, West Publishing Co., 2008.

[84] Shih: Glenn, H Patrick. On Common Laws, Oxford University Press, 2007.

[85] Shih më gjerë: Karačić, Fikret, Karić, Enes. *Šerijatsko Pravo u Savremenim Društvima*, Sarajevo, 1998; Sahiti, Ejup.*Disa Njohuri Themelore për të Drejtën e Sheriatit*, Revista E Drejta, nr.2/1985, Prishtinë, f. 159-175.

[86] Mousourakis, George. *Comparative Law and Legal Traditions*, f. 152; Vernon Valentine Palmer, *Mixed Jurisdictions Worldwide*, Cambridge University Press 2007, f. 1-76.

mënyrë të ndërsjellë. Së këndejmi, shtete me sisteme juridike mikse (hibride) janë: Skocia, Israeli, Malta, Kuebeku, Luiziana, Egjipti, Afrika Jugore, Porto Riko, Filipinet etj.[87]

Kurdoherë që shtrohet çështja e kualifikimit juridik të sistemeve juridike në familje juridike duhet mbajtur parasysh dy çështje kyçe: *e para*, fusha e të drejtës që merret parasysh, dhe *e dyta*, periudha e kohës për të cilën flitet. *E para*, fusha e të drejtës që merret parasysh, konsiston në atë se në varësi nga fakti se për cilën fushë të së drejtës kemi të bëjmë, një fushë e caktuar e të drejtës së një sistemi juridik mund të vendoset në një familje juridike të caktuar, për qëllimet e asaj fushe konkrete të së drejtës, dhe për qëllimet e një fushe tjetër konkrete të së drejtës mund të vendoset në një familje tjetër juridike. Kështu, p.sh., vendet arabe pa dyshim se i përkasin familjes juridike islamike për sa i përket të drejtës familjare dhe të drejtës trashëgimore, ndërsa sa i takon të drejtës ekonomike i përkasin të drejtës franceze si rezultat i influencës së mendimit juridik të Francës si fuqi koloniale në rastin e shumicës së vendeve arabe ose, India bën pjesë në familjen juridike hindu për sa i përket të drejtës familjare dhe të drejtës trashëgimore, por e drejta ekonomike e saj i përket të drejtës anglo-saksone si rezultat i ndikimit të opinionit juridik të Anglisë si fuqi koloniale në rastin e Indisë. *E dyta*, periudha e kohës për të cilën flitet është, shumë sinjifikative dhe e vlefshme në teorinë e familjeve juridike.[88] Në këtë drejtim, duhet theksuar se ndarja e botës juridike në familje juridike dhe përfshirja e një sistemi juridik nacional në një familje juridike të caktuar, nuk është vendosur dhe dhënë njëherë e gjithmonë, ngaqë sistemi juridik nuk ekziston dhe vepron në vakum, por ekziston dhe operon brenda shoqërisë (*ubi homo, ibi societas*/aty ku ka njeri, ka shoqëri; *ubi societas, ibi jus*/aty ku ka shoqëri, ekziston e drejta), dhe si i tillë, është një fenomen zhvillimor e dinamik nga pikëpamja temporale. Kjo lejon mundësinë të kuptohet se, një sistem juridik i caktuar mund të evoluoj, apo të ndryshoj lehtë nga zhvillimet e ndryshme historike e socio-politike, pra, mund të transformohet apo tranzitoj nga një familje juridike në një familje tjetër juridike. Kështu, po qe se shqyrtohet sistemi juridik i Republikës së Maqedonisë së Veriut si një njësi konstitutive federale e ish RSFJ-së në periudhën kohore 1974 – 1990 del përfundimi i thjeshtë dhe i qartë se "sistemi juridik i Republikës Socialiste të Maqedonisë gjatë asaj periudhe kohore i ka takuar familjes juridike socialiste,[89] ndërsa nga viti 1991 (me konstituimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me 8 shtator 1991 si një shtet sovran, i mëvetësishëm, demokratik dhe social, si dhe me miratimin e Kushtetutës së RMV-së më 17 nëntor të vitit 1991 nga Kuvendi i RMV-së e në periudhën kohore në vijim sistemi juridik pozitiv intern i Republikës së Maqedonisë së Veriut pa asnjë ekuivok se i përket familjes juridike të Evropës kontinentale".

9. Konkluzione

Vështruar objektivisht, e drejta komparative (*ius comparatum*) nuk është një degë e së drejtës, por ajo është një disiplinë aplikative shkencore juridike. Ky qëndrim mbështetet shkencërisht dhe argumentohet juridikisht se e drejta komparative nuk ka një substancë normative në vetvete (nuk ngërthen apo përmban në vetvete norma juridike), sikurse ka e drejta kushtetuese, e drejta administrative, përfshirë dhe degë të tjera të së drejtës. Për rrjedhojë, e drejta komparative nuk ka për objekt rregullimi normativo-juridik ndonjë fushë të caktuar të marrëdhënieve shoqërore;

Si një disiplinë e veçantë shkencore juridike, e drejta komparative merret me studimin, hulumtimin dhe krahasimin juridik të së paku dy e më tepër instituteve juridike, sistemeve juridike të shteteve të caktuara mbi baza komparativo-juridike për të identifikuar dhe interpretuar (sqaruar) ngjashmëritë dhe dallimet reciproke midis tyre, qoftë për synime hulumtuese teorike-shkencore, apo për synime pragmatike-empirike. Pra, e drejta komparative përfshin tërësinë e njohurive sistematike shkencore me përmbajtje tematike komparativo-juridike që u referohen

[87] Palmer, Vernon Valentine. *Mixed Jurisdictions Worldwide*, Cambridge University Press 2007, f. 81-469; Reimann, Mathias, Zimmermann, Reinhard. *The Oxford Handbook of Comparative Law*, Oxford University Press 2008, f. 478-486.

[88] Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative* Law, Oxford, 1998, f. 65-66.

[89] Edhe pse e drejta socialiste veçmë nuk është sistem i madh juridik nuk do të thotë që është shuar apo se ka pushuar së ekzistuari, ngaqë vështruar nga perspektiva aktuale përveç që është aplikative në Kinë, ajo ekziston në nuanca të ndryshme në Vietnam, në Kubë dhe në disa shtete të tjera aziatike dhe afrikane. – Будимир Кошутић, *Увод у Велике Правне Системе Данашњице*, Београд, 2002, f. 13.

fenomeneve juridike, apo instituteve juridike partikulare nga fusha të ndryshme të së drejtës, si dhe sistemeve juridike kontemporane më të mëdha në mbarë botën;

E drejta komparative është zhvilluar si një bransh/degë e shkencave juridike, madje për nga natyra juridike është interdisiplinare dhe subsidiare. Kjo do të thotë se e drejta komparative ndahet në disa disiplina aplikative shkencore juridike, konform degëve të së drejtës, sikurse janë e drejta kushtetuese komparative, e drejta administrative komparative, e drejta penale komparative, e drejta civile komparative, e drejta tregtare komparative etj., duke pasur një rol subsidiar (ndihmës) *vis-à-vis* tyre, sepse ato shfrytëzojnë arritjet epistemologike të së drejtës komparative, përkatësisht shërbehen me njohuritë juridike të së drejtës komparative;

Në cilindo qoftë shtet të botës zakonisht ndërmerren studime të shumta komparativo-juridike përpara nxjerrjes së akteve ligjore, me qëllim që të sigurojnë "zgjidhjeje juridike adekuate" për "çështjet juridike lokale", sikurse edhe të inkurajohen për të zhvilluar dhe avancuar politikat publike duke propozuar dhe ndërmarrë ndonjë reformë juridike në ndonjë fushë të caktuar të legjislacionit nacional në mbështetje e në përputhje me arsenalin e zgjidhjeve juridike pragmatike dhe progresive që ofron e drejta komparative;

Studimi komparativo-juridik mund të kontribuoj dhe ndikojë në përmirësimin, reformimin dhe modernizimin e legjislacionit nacional dhe politikave publike të shteteve në përgjithësi, përfshirë ndikimin në zhvillimin e doktrinës juridike dhe praktikës gjyqësore në veprimtarinë dhe punën e gjyqësorit nacional;

E drejta komparative mund të nxisë konvergjencën e sistemeve juridike duke reduktuar në një masë të caktuar divergjencat në të drejtat nacionale që kanë arritur një shkallë të caktuar të zhvillimit social-ekonomik e kulturalpolitik;

E drejta komparative mund të ndihmojë në procesin e aproksimacionit dhe harmonizimit të sistemeve juridike, sidomos në kontekste rajonale ose ndërkombëtare, siç është Unioni Evropian;

Studimi i së drejtës komparative kontribuon në përhapjen e standarteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe avancimin e tyre, duke mundësuar një kuptim më të mirë të zbatimit të tyre në kontekste të ndryshme juridike dhe kulturore. Duke krahasuar dhe analizuar sistemet juridike të shteteve të ndryshme, mund të identifikohen praktikat më të mira për mbrojtjen juridike dhe promovimin e të drejtave të njeriut;

Studimi i së drejtës komparative në aspektin global ndihmon në lehtësimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet harmonizimit dhe unifikimit të legjislacionit në fusha të caktuara të së drejtës, veçanërisht në fusha si tregtia ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e mjedisit jetësor;

Krahasimi juridik ndihmon në kuptimin e diversitetit të sistemeve juridike nacionale dhe në zbulimin e zgjidhjeve juridike alternative për nevoja specifike të rregullimit të marrëdhënieve dhe çështjeve juridike përkatëse në kontekstin lokal;

Globalizimi ka rritur rëndësinë e së drejtës komparative, duke kërkuar që juristët të jenë të njohur me sisteme juridike të ndryshme dhe të jenë në gjendje të operojnë në një mjedis juridik ndërkombëtar, gjithnjë e më të ndërlidhur;

Ekzistojnë dy tradita juridike me shumë ndikim në botën bashkëkohore: e drejta kontinentale-evropiane dhe e drejta anglo-amerikane. Tradita juridike e së drejtës kontinentale evropiane është sot tradita juridike mbizotëruese në Evropë, në të gjithë Amerikën Latine, në shumë pjesë të Azisë dhe Afrikës, madje edhe në disa provinca në botën juridike anglo-amerikane;

Dominimi i dy traditave juridike të sipërtheksuara është rezultati i drejtpërdrejtë i imperializmit evropian në shekujt e mëparshëm, ashtu si dominimi i të drejtës romake në një epokë më të hershme ishte produkt i imperializmit romak. E drejta kontinentale evropiane dhe e drejta anglo-amerikane nuk kanë qenë të izoluara nga njëra-tjetra. Si komponent të një historie dhe kulture juridike të përbashkët oksidentale (perëndimore), ato kanë pasur kontakte të shumta dhe ndikime reciproke, duke u reflektuar edhe në ekzistencën e sistemeve juridike mikse/hibride të shteteve të caktuara të botës që përfshijnë më vete një gërshetim të tipareve juridike kumulative, d.m.th., përfshijnë tipare apo veçori juridike përkatëse që i takojnë edhe sistemit juridik kontinental evropian, edhe sistemit juridik anglo-sakson.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Anastasi, Aurela. *E Drejta Kushtetuese e Krahasuar*, Tiranë, 2009.
2. Adams, Maurice, Heirbaut, Dirk. *The Method and Culture of Comparative Law*, Hart Publishing 2014.
3. Adams, Maurice, Bomhoff, Jacco. *Practice and Theory in Comparative Law*, Cambridge University Press, 2012.
4. Andenas, Mads, Fairgrieve, Duncan. *Courts and Comparative Law*, Oxford University Press 2015.
5. Brand, Paul. *The Making of the Common Law*, Hambledon Press 1992.
6. Buckland, W.W., McNair, Arnold D. *Roman Law and Common Law: A Comparison in Outline*, Cambridge University Press 2008.
7. Caenegem, R. C. Van. *The Birth of the English Common Law*, Cambridge University Press 1988.
8. Collin, Peter. *Dictionary of Law*, Bloomsbury Pub Ltd, 2004.
9. David, René, Brierley, John E. C. *Major Legal Systems in the World Today*, Free Press, 1978.
10. Đorđević, Jovan.*Ustavno Pravo*, Beograd, 1982.
11. Endicott, Timothy, Kristjánsson, Hafsteinn Dan, Lewis, Sebastian. *Philosophical Foundations of Precedent*, Oxford University Press 2023.
12. Fromont, Michel, *Sistemet e Huaja Më të Mëdha të të Drejtës*, Tiranë, 2009.
13. Friedman, Lawrence Meir.*Law and Society*, Pearson College Div 1977.
14. Glendon, Mary Ann, Carozza, Paolo, Picker, Colin.*Comparative Legal Traditions*, West Academic Publishing 2008.
15. Glenn, H Patrick. *On Common Laws*, Oxford University Press 2007.
16. Halberstam, Daniel, Reimann, Mathias. *Federalism and Legal Unification: A Comparative Empirical Investigation of Twenty System*s, Springer 2013;
17. Herbert Lionel Adolphus Hart, *The Concept of Law*, Oxford University Press 2012.
18. James H. Richardson, Federico Santangelo, *The Roman Historical Tradition: Regal and Republican Rome*, Oxford University Press 2014.
19. Mousourakis, George.*Comparative Law and Legal Traditions*, Springer 2019.
20. Merryman, John Henry, Pérez-Perdomo, Rogelio.*The Civil Law Tradition*, Stanford University Press 2018.
21. Marta Vidaković-Mukić, *Opći Pravni Rječnik*, Zagreb, 2006.
22. Masterman, Roger, Schütze, Robert. *The Cambridge Companion to Comparative Constitutional Law*, Cambridge University Press 2019.
23. Örücü, Esin.*The Enigma of Comparative Law: Variations on a Theme for the Twenty-first Century*, Springer, 2004.
24. Peter de Cruz, *Comparative law in a Changing World*, Routledge-Cavendish, 1999.
25. Palmer, Vernon Valentine. *Mixed Jurisdictions Worldwide*, Cambridge University Press 2007.
26. *Pravni Leksikon*, Zagreb, 2007.
27. Радомир Лукић, *Увод у Право*, Београд, 1975.
28. Pound, Roscoe. *The Spirit of the Common Law*, Routledge 1998.
29. Ragone, Sabrina, Smorto, Guido.*Comparative Law*, Oxford University Press, 2024.
30. Reimann, Mathias, Zimmermann, Reinhard.*The Oxford Handbook of Comparative Law*, Oxford University Press 2008.
31. Samuel, Geoffrey. *An Introduction to Comparative Law Theory and Method*, Hart Publishing 2014.
32. Shegani, Altin. *E Drejta Penale e Krahasuar*, Tiranë, 2002.
33. Smits, Jan M. *Elgar Encyclopedia of Comparative Law*, Edward Elgar Pub, 2014.
34. Siems, Mathias. *Comparative Law*, Cambridge University Press 2018.
35. Будимир Кошутић, *Увод у Велике Правне Системе Данашњице*, Београд, 2002.
36. Shehu, Natasha. *E Drejta e Krahasuar Publike*, Tiranë, 2004.
37. Szabó, Zsolt.*Constitution and Government at the Western Balkans*, Berliner Wissenschafts-Verlag 2023.

38. Димитар Бајалџиев. *Вовед во Правото*, Shkup, 1999.
39. Zweigert, Konrad, Kötz, Hein. *An introduction to Comparative Law*, Oxford University Press, 1998.
40. Zweigert, Konrad, Drobnig, Ulrich.*International Encyclopedia of Comparative Law*, Brill 2006.
41. Watson, Alan. *Legal Transplants: An Approach to Comparative Law*, University of Georgia Press, 1974.

ASPEKTE DOKTRINALE MBI LLOJET E VEÇANTA TË KONTRATËS SË DHURIMIT

Prof. Asoc. Dr. Anjeza LIÇENJI[*]
Doktorant Saimir MUÇMATAJ[**]

DOCTRINAL ASPECTS ON THE SPECIAL TYPES OF DONATION CONTRACT

Abstract

The donation contract, explicitly provided for in the Civil Code, embodies principles of generosity and humanism. The reason that motivates the parties to enter into this legal relationship by making the donation is precisely altruism, humanism, and generosity that characterize the donor, who always, based on this generous spirit, relinquishes ownership or right over the item ultimately in favor of the recipient, who must express his consent.

Regarding the issues encountered by the parties in the donation contract, Albanian doctrine has often attempted to provide them with the most appropriate solution, considering it necessary that the updating and changing of social relationships be accompanied from time to time by the updating of legal provisions.

Given that we encounter the donation contract in various forms and manners in our daily lives, which are not reflected in legal provisions, our desire to delve into this topic has been spurred to reflect on some of the legal shortcomings regarding this contract.

Given the diverse forms of donation contracts encountered in daily life, not fully reflected in legal provisions, there is a pressing need to explore and address legal deficiencies in this area. Therefore, our focus is directed towards elucidating doctrinal aspects, particularly concerning specific types of donation contracts such as the donation contract due to marriage, donation of small-value items, indirect donation, donation as a reward, and donation in favor of the newborn child, these are frequently encountered donations in practice and integral to human relationships. The analysis aims to clarify the complexity and nuances of various forms of donation contracts, providing insights into their legal implications and doctrinal foundations.

Furthermore, doctrinal perspectives aim to address contemporary issues and emerging trends related to different types of donation contracts, reflecting on their importance in modern legal practice and their alignment with societal values and norms.

Keywords: *donation, doctrine, marriage, reward, indirect donation.*

1. Hyrje

Kontrata e dhurimit mund të cilësohet si marrëdhënie juridike detyrimi, një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat ajo i pranon.

Dhurimi është një veprim i vullnetshëm, me anë të së cilit dhuruesi duke u nisur nga shpirti i mirësisë dhe bujarisë, zhvishet nga pronësia e një sendi ose e një të drejte reale në favor të përfituesit, pa kërkuar asgjë si kundërshpërblim. Me anë të këtij veprimi, dhuruesi synon të shtojë pasurinë e përfituesit dhe të pakësojë pasurinë e tij, me anë të një veprimi të vullnetshëm dhe si rregull të parevokueshëm.[1]

[*] Prof. Asoc. Dr. Anjeza Liçenji, pedagoge në Departamentin e të Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.
[**] Doktorant Saimir Muçmataj, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore dhe të Përputhshmërisë në Ministrinë e Financave.

[1] Semini-Tutulani, Mariana. *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave*, (Pjesa e Posaçme, Tiranë, Skanderbegbooks, 2016), f. 257.

Arsyet që e shtyjnë dhuruesin mund të jenë nga më të ndryshmet por ajo që është e rëndësishme dhe që duhet të jetë gjithmonë prezent, në momentin në të cilin kryhet një akt i vullnetshëm dhurimi, është mungesa e forcës apo shtrëngimit për të kryer këtë dhurim.
Qëllimi konstant i dhuruesit për t'i kaluar një pasuri përfituesit, pa shpërblim, duhet të përkrahet dhe të ndahet edhe nga përfituesi, duke u paraqitur në këtë mënyrë si qëllimi i përbashkët i të dyja palëve.

Përveç kontratës së dhurimit të njohur nga të parashikuar nga Kodi Civil, doktrina juridike njeh edhe disa kontrata të veçanta dhurimi të cilat kanë një status të ndryshëm nga ai i kontratës së dhurimit në përgjithësi. E veçanta e këtyre kontratave ka të bëjë pikërisht me faktin që përfituesit e këtyre dhurimeve janë më të privilegjuar në të drejta. Kështu, me përjashtim të rasteve kur kontrata e dhurimit ka për objekte sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat legjislatori shqiptar i ka parashikur shprehimisht, ekzistojnë dhe disa lloje të tjera dhurimesh për të cilat në mënyrë të veçantë nuk kërkohet forma noteriale. Vetë fakti që këto dhurime ndeshen në praktikë dhe në përditshmërinë e gjithsecilit kanë qenë motivi për t'i trajtuar dhe sjellë në një këndvështrim teorik dhe praktik.

2. Dhurimi për shpërblim

Dhurimi për shpërblim është ajo kontratë në të cilën qëllimi i dhuruesit nuk është plotësisht i vullnetshëm, duke qenë se e kryen dhurimin në shenjë mirënjohjeje, si shpërblim ose duke konsideruar meritat e përfituesit.[2]
Në dispozitat mbi dhurimin, ndonëse përmendet shkarazi në nënin 771 të Kodit, dhurimit të bërë për shpërblim i njihet një rëndësi e veçantë duke qenë se ai përbën një rast përjashtimor në të cilin dhurimi nuk mund të revokohet në asnjë rast.[3]
Por çfarë nënkupton "dhurimi për shpërblim" ligji nuk e trajton, duke lënë vend për keqkuptime në raport me nocionin e dhurimit që ligji përcakton.

Teorikisht, dhurimi për shpërblim ekziston atëherë kur dhuruesi dëshiron "t'i kthejë favorin" një shërbimi që atij i kishte bërë përfituesi i dhurimit, p.sh.: shpëtimi nga rreziku, realizimi i një ndërhyrjeje të vështirë, fitimi i një çështjeje gjyqësore, etj. Pra, shkaku për të cilin kryhet veprimi juridik i pasurimit të palës tjetër i referohet një sjelljeje në të shkuarën të përfituesit ose premtimit për një veprim të ardhshëm, kundrejt të cilit akti i liberalitetit kryhet si mirënjohje, si vlerësim i meritave ose si shpërblim i shërbimit të kryer.[4] Në këtë rast shkaku i dhurimit është një ndër elementët thelbësorë të këtij veprimi juridik.

Në momentin në të cilin shkaku ose motivi nuk ekziston, dhurimi nuk mund të konsiderohet si dhurim për shpërblim.[5]

Sipas jurisprudencës së huaj, dhurimi për shpërblim konsiston në pasurimin pa kundërshpërblim të kryer në mënyrë të vullnetshme dhe me bindjen e mospërmbushjes së ndonjë detyrimi juridik, moral, shoqëror, por për të kompensuar shërbimet e kryera nga përfituesi i dhurimit.[6]
Doktrina thekson se shërbimi që do të "shpërblehet" nuk duhet të jetë ekonomikisht i prekshëm; nuk duhet të përcaktohet nga përfitimi ekonomik.

---

[2] Gjykata e Lartë italiane, në vendimin nr. 12769, datë 17.11.1999 ka konstatuar se: "Dhurimi për shpërblim karakterizohet nga rëndësia juridike që luan motivi i dhurimit, i pasurimit të palës tjetër, motiv i cili lidhet në mënyrë të ngushtë me një sjellje të mëparshme të përfituesit, ndaj të cilit akti i liberalitetit paraqitet si falënderim, mirënjohje, vlerësim ose si shpërblim i veçantë për shërbimin e kryer".

[3] Neni 771/1 i Kodit Civil parashikon se: "Dhuruesi, për dhurimet që nuk janë të zakonshme ose që nuk janë bërë për shpërblim, mund të kërkojë revokimin e dhurimit kur ai që ka marrë dhurimin:
a) me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë dhuruesin, bashkëshortin ose fëmijët, ose prindërit e tij;
b) pa të drejtë nuk i jep dhuruesit ushqim kur është i detyruar sipas ligjit."

[4] Baldassari, Augusto, Cendon, Paolo.*Codice civile annotato con la giurisprudenza*, (Torino, Utet Giuridica, 2007), f. 794.

[5] Pietro, Perlingieri.*Codice Civile annotato con la dottrina e la giurisprudenza*, (Bologna, Zanichelli Editore, 1991), f. 659.

[6] Vendimi nr. 5119, datë 03.03.2009, Gjykata e Lartë italiane, Seksioni Civil. Në bazë të rrethanave të çështjes, një zonjë kishte njohur detyrimin për të paguar një shumë të hollash në drejtim të mbesës së saj, në shenjë mirënjohjeje dhe shpërblimi për asistencën, trajtimin dhe kujdesin e marrë për një periudhë kohore të konsiderueshme.

Përsa i përket natyrës juridike të dhurimit për shpërblim ai është një dhurim i vërtetë, shkaku i të cilit përbëhet nga elementi objektiv, shpirti i bujarisë *(animus donandi)* dhe elementi subjekt, pasurimi i palës tjetër pa kundërshpërblim.[7]

Shpirti i bujarisë është gjithmonë i pranishëm edhe pse pasurimi, apo kalimi i të drejtës së pronësisë, mund të jetë kryer:

a) Në shenjë mirënjohjeje, p.sh. dhurimi reciprok, i kryer nga ai i cili ka përfituar në të shkuarën dhe tashmë i kalon një të mirë pasurore, dhuron nga ana e tij në favor të dhuruesit. Në këtë rast mirënjohja mund të lindë si rezultat i një përfitimi të marrë më parë. Një rast tipik është dhurimi që dhuruesi bën në favor të përfituesit pasi ka marrë nga ana e këtij të fundit një dhurim. Ose, një person i cili na shpëtoi nga një rrezik, ose që na dha një avantazh të veçantë duke na ndihmuar (në mënyrë të ligjshme) në ndonjë aktivitet.

b) Ose është bërë në bazë të meritave të përfituesit kundrejt kolektivit ose një individi të caktuar të ndryshëm nga dhuruesi, si pasojë e një ndjenjë admirimi ose për një zbulim shkencor, për një vepër letrare, etj., edhe nëse meritat nuk duhet t'i kenë sjellë dhuruesit asnjë lloj avantazhi të drejtpërdrejtë. Në këtë rast *animus donandi* është i frymëzuar nga ndenja e admirimit për cilësitë personale të përfituesit ose për aktivitetin e veçantë që ai zhvillon.[8] Ky është rasti i dhurimeve në favor të individëve që veprojnë në fushën shoqërore ose që janë shquar në fushën shkencore, duke bërë zbulime të rëndësishme, ose në fushën humaniste-letrare, duke prodhuar vepra të dukshme, apo edhe në fushën fetare, etj.

c) Ose është kryer si shpërblim për shërbimet e kryera nga përfituesi të cilat janë vlerësuar në mënyrë të veçantë nga dhuruesi, edhe pse shërbimet mund të jenë kryer kundrejt shpërblimit. Si raste të kësaj kontrate ne përmendëm dhurimin e kryer në favor të mjekut apo të avokatit, të cilëve, krahas shpërblimit për punën e kryer, ju dhurohet një send në shenjë mirënjohjeje për shërbimin e kryer. Në këtë rast elementi psikologjik përbëhet nga qëllimi i dhuruesit për të shpërblyer një shërbim të kryer nga përfituesi.

Dhurimi për shpërblim, në ndryshim me dhurimin e zakonshëm, nuk mund të revokohet për shkak të mosmirënjohjes dhe nuk detyron përfituesin për të përmbushur detyrimin për ushqim ndaj dhuruesit. Ndërsa në lidhje me formën e kontratës, ajo duhet të bëhet me akt noterial, ashtu sikurse dhe kontrata e dhurimit e parashikuar shprehimisht nga Kodi Civil, me përjashtim të rasteve kur kontrata e dhurimit ka për objekt sendet me vlerë të vogël.

3. Dhurimi i sendeve me vlerë të vogël

Ndryshe nga dhurimi i zakonshëm, në rastin e dhurimit të sendeve të luajtshme me vlerë të vogël nuk mjafton vetëm dhënia e pëlqimit nga ana e përfituesit, por për vlefshmërinë e dhurimit kërkohet në të njëjtën kohë edhe dorëzimi i sendit objekt i kontratës. Nëpërmjet marrjes në dorëzim të sendit nga ana e përfituesit, nënkuptohet dhënia e pëlqimit të tij.

Madhësia e kësaj vlere duhet parë rast pas rasti dhe përbëhet jo vetëm nga elementi objektiv (vlera e tregut e sendit të dhuruar), por dhe nga elementi subjektiv (krahasimi i kësaj vlere me kushtet ekonomike të dhuruesit) të cilat duhet të merren në konsideratë në momentin në të cilin është kryer dhurimi, duke vlerësuar gjithashtu edhe ndikimin që do të ketë ky dhurim në pasurinë e përfituesit.[9]

Doktrina dhe jurisprudenca italiane në këtë drejtim kanë shfaqur tendencën për të përjashtuar dhurimet me vlerë modeste nga forma solemne, pra dhurimet të cilat në vend që të jenë manifestim i një shpirti liberal, janë më tepër një manifestim i një vullneti që dëshiron të përputhet me zakonet ose detyrimet e natyrës familjare ose shoqërore sikurse mund të jenë dhuratat që bëhen me rastin e ditëlindjeve, përvjetorëve, apo mes çifteve të fejuar.

Përsa i përket këtij lloji të kontratës së dhurimit, legjislacioni ynë nuk e ka parashikuar shprehimisht dhurimin e sendeve të cilat kanë një vlerë të vogël, por vetëm dhurimin me objekt sendet e luajtshme. Kështu, nëse bazohemi tek Kodi Civil italian, dhe konkretisht në nenin 782, të këtij Kodi, parashikohet se: "Dhurimi me vlerë të vogël,

[7] Gjykata e Lartë Italiane, Seksioni II, vendimi nr. 41480, datë 24 dhjetor 2021.
[8] Capozzi, Guido. *Successioni e Donazioni*, (Milano, Giuffre Editore, 2003), f. 1604.
[9] Cataudella, Antonino.*Sucessioni e donazioni*, Trattato di diritto privato, (Torino, Giappichelli Editore, 2005), f. 93.

që ka për objekt sende të luajtshme, është i vlefshëm, edhe pse mungon akti publik, me kusht që të bëhet dorëzimi i sendit. Vlera e vogël do të vlerësohet edhe në raport me gjendjen ekonomike të dhuruesit."

Dorëzimi i sendit, si kusht për perfeksionimin e kësaj kontrate, mund të kryhet edhe nëpërmjet dorëzimit simbolik të tij, pasi i rëndësishëm është manifestimi i vullnetit për të dhuruar, pavarësisht nga fakti nëse sendi objekt i dhurimit ndodhet ose jo në posedimi të përfituesit së bashku me sendet e tjera të tij.[10]

Vlera e vogël e sendit të luajtshëm vlerësohet në raport me kushtet ekonomike dhe sociale të dhuruesit pasi nuk duhet të ndikojë në mënyrë të ndjeshme në pasurinë e dhuruesit.[11] Doktrina italiane e përjashton mundësinë që një send i paluajtshëm të konsiderohet send me vlerë të vogël, ndërsa përsa ju përket sendeve të luajtshme të cilat kanë nevojë të regjistrohen në këtë rast çështja duhet të zgjidhet rast pas rasti duke marrë në konsideratë vlerën e sendit të dhuruar. [12]

4. Dhurimi në favor të fëmijëve të sapokonceptuar, ende të palindur

Dhurimi mund të kryhet edhe në favor të fëmijës të sapokonceptuar apo në favor të fëmijëve të një personi të caktuar të cilët në kohën e dhurimit nuk kishin lindur ende.[13] Fëmija i sapokonceptuar[14] apo i ngjizur, është i aftë dhe mund të përfitojë sende dhe të drejta si rezultat i një kontrate dhurimi. Edhe nëse bëhet fjalë për një dhurim të kryer për shkak të martesës, ky person mund të trashëgojë dhe të njihet si fëmijë natyral, gjë e cila e bën këtë subjekt të pajisur më zotësi juridike.

Në këto raste bëhet fjalë për një zotësi juridike të përkohshme e cila fshihet me efekt prapaveprues në rast se nuk ndodh lindja e tij dhe që bëhet përfundimtare në qoftë se fëmija i ngjizur lind dhe ekziston.[15] Në të tilla raste, dhënia e pëlqimit për perfeksionimin e kontratës so të jepet pikërisht nga ata persona të cilët kanë të drejtën për të përfaqësuar në të gjitha aktet juridike fëmijët qofshin këta të palindur ende.

Lindja, me kusht që fëmija të jetojë sadopak pas lindjes edhe pse më ajo pasohet nga vdekja apo edhe nëse fëmija është i lindur me anomali të rënda dhe sëmundje, shënon në sistemin ligjor aktual, momentin kohor nga i cili një qenie e gjallë bëhet mbajtës i zotësisë juridike, dhe si rrjedhojë, është i aftë për tu bërë bartës i të drejtave dhe detyrimeve. Fëmija i sapokonceptuar në këtë rast ndodhet në një situatë pritjeje për të fituar të drejtat që i rrjedhin nga kontrata e dhurimit, situatë e cila bëhet përfundimtare në momentin në të cilin fëmija do të lindë gjallë.

Në thelb, fëmija i palindur ekziston dhe barazohet me atë "të lindur", për vetë faktin se mund të trashëgojë *mortis causa,* madje mund edhe të përfitojë si rezultat i një dhurimi.

Para se të ketë ndodhur lindja e personit, dhuruesi ruan pronësinë mbi sendet e dhuruara, për vetë faktin që të drejtat e personit të palindur ende i nënshtrohen kushtit pezullues të lindjes gjallë. Është dhuruesi ose trashëgimtarët e tij, personat që administrojnë sendet e dhuruara, duke përjashtuar mundësinë e prindërve të fëmijës së sapokonceptuar për t'i tjetërsuar këto sende[16].

Nëse sendi, objekt i kontratës së dhurimit nxjerr fruta para lindjes të sapokonceptuarit, këto fruta nuk i takojnë dhuruesit por përfituesit të dhurimit, duke qenë se lindja vepron *ex tunc*, ka efekt prapaveprues.

5. Dhurimi për shkak të martesës

---

[10] Baldassari, Augusto, Cendon, Paolo. *Codice civile annotato con la giurisprudenza,* (Utet Giuridica, 2007), f. 802.

[11] "Nga kjo rrjedh se akti i bujarisë, për t'u konsideruar me vlerë modeste, nuk duhet të ketë kurrë një ndikim të dukshëm në pasurinë e dhuruesit." (Gjykata e Lartë Civile, Seksioni II, vendimi nr. 3858, datë 17 shkurt 2020).

[12] Biondi Biondo, *La donazione*, Trattato di diritto civile italiano, (Torino, Trattatto Vassalli, 1961), f. 882.

[13] Neni 784 Kodi Civil Italian.

[14] Legjislatori në momentin në të cilin flet për fëmijë të sapokonceptuar, të ngjizur, i referohet embrionit, por embrionit në kuptimin më të gjerë të fjalës, e cila i referohej gjendjes që nga fekondimi i vezës. Gianluca Familietti, Filiazione e procreazione, (Pisa, Convegno annuale dell'Associazione "Gruppo di Pisa", 2013), f. 41.

[15] Palazzo.Antonio. *I contratti di donazione,* (Utet Giuridica, 2009), f. 159.

[16] Në këtë mënyrë, ashtu sikurse zotësia e fëmijës të palindur është e pjesshme, e pjesshme do të jetë edhe pushteti i përfaqësimit nga ana e prindërve të tij, duke qenë se efektet juridike mund të lindin mbi të përfaqësuarin vetëm në rast se ky është i zoti të bëhet titullar i saj. Pietro Rescigno, Trattato di diritto privato, Succesioni, (Utet Giuridica, 2006), f. 513.

Dhurimi i lidhur me një martese është një lloj i veçantë dhurimi, pasi del nga skema e zakonshme e kësaj kontrate**.** Martesa është arsyeja e vetme e këtij akti liberaliteti, shfaqjeje vullneti dhe kushti i vlefshmërisë së kontratës. Në këtë rast, dhurimi bëhet në favor të nuses ose të dhëndrit, ose në favor të fëmijës së lindur prej tyre dhe martesa është motivi i kryerjes së këtij dhurimit.[17]

Ky lloj dhurimi përmendet shprehimisht nga Kodi i Familjes dhe nuk është një koncept i ri për të drejtën Shqiptare, duke qenë se një dhurim i tillë ekzistonte dhe njihej edhe në Kodin Civil të 1929, dhe akoma më tej, në të drejtën zakonore.

Për vetë natyrën e familjes dhe rëndësisë që zë ajo në të drejtën tonë, mbetet i pashpjegueshëm fakti se përse ligjvënësi nuk e ka trajtuar këtë lloj të veçantë dhurimi. Kodi Civil e trajton këtë lloj dhurimi në një dispozitë shumë të shkurtër, por, gjithsesi, i njeh përfituesit të dhurimit një pozitë të privilegjuar, duke e përjashtuar atë nga detyrimi i dhënies së ushqimit.

Dhurimi lidhur me një martesë nuk duhet të ngatërrohet me dhurimin me kusht martesën, pasi i dyti martesën e ka si kusht që duhet të plotësojë përfituesi që kontrata të sjellë pasoja, kusht ky që në vetvete është i paligjshëm dhe që vjen në kundërshtim me parimet e rendit publik, ndërkohë që dhurimi i parë bën fjalë për një martesë të caktuar, e cila shërben si shkak për realizimin e dhurimit.

Për t'i dhënë një trajtim më të detajuar dhurimit të lidhur me një martesë, si një kontratë e veçantë dhurimi, mund ti referohemi Kodit Civil Italian, i cili i bën një trajtim më të detajuar kësaj kontrate. Pikërisht në nenin 785, paragrafi i parë, e përkufizon atë si: "Dhurim të bërë në këndvështrim të një martese të caktuar dhe të ardhshme, si nga bashkëshortët kundrejt njeri-tjetrit, si nga të tjerë në favor të njërit apo të dyve apo të fëmijëve të lindur prej tyre, e cila perfeksionohet (quhet e lidhur) pa qenë nevoja që të pranohet, por nuk prodhon efekt derisa të realizohet martesa".

Legjislacioni civil italian përcakton se ky dhurim mund të realizohet vetëm në favor të një martese të përcaktuar dhe të ardhshme duke përjashtuar fejesën, ngjarje kjo që nuk ka gjetur mbështetje dhe njohje juridike as në Kodin tonë të Familjes.

Sipas jurisprudencës italiane, bëhet një përjashtim në lidhje me formën,[18] duke qenë se në këtë rast nuk është e nevojshme që dhurimi të bëhet në formën e një akti noterial dhe në të njëjtën kohë nuk kërkohet as pranimi nga ana e përfituesit, por mjafton shfaqja e vullnetit nga ana e dhuruesit.

Ky dhurim do të konsiderohet i plotë ose perfekt pa qenë nevoja e dhënies së pranimit nga përfituesi, por me kusht që dhurime të tilla do t'i sjellin efektet juridike vetëm në rast se lidhet martesa.[19]

Gjykata e Lartë e Kasacionit italiane, në lidhje me momentin e perfeksionimit të kontratës së dhurimit për shkak të martesës është shprehur se: "Dhurimi për shkak të martesës kualifikohet si veprim i njëanshëm, i cili perfeksionohet me deklaratën e njëanshme të dhuruesit, pa qenë e nevojshme dhënia e pëlqimit dhe as mungesa e refuzimit nga ana e përfituesit".[20]

Pra, kjo kontratë nuk kërkon pranimin e përfituesit, si kusht për vlefshmërinë e dhurimit, por është e mjaftueshme vetëm vullneti i dhuruesit. Në këtë mënyrë, dhurimi formon kështu një veprim juridik të njëanshëm, i cili merr jetë nga momenti që vullneti i shprehur i dhuruesit mbërrin te përfituesi dhe paraqet në të njëjtën kohë një përjashtim nga natyra kontraktuale e dhurimit.

Megjithatë, pavarësisht se kontrata e dhurimit konsiderohet e lidhur që në momentin që deklarohet nga dhuruesi (kuptohet kur ky deklarim është serioz dhe u kundrejtohet palëve konkrete me qëllim sjelljen e pasojave të synuara), ajo realizohet vetëm në momentin e përmbushjes së veprimit juridik, në rastin konkret martesës me të cilën ajo është lidhur.

---

[17] Neni 785 Kodi Civil italian.

[18] Rescigno, Pietro.*Codice civile - Le fonti del diritto italiano*, (Milano, Giuffre Editore, 1994), f. 860.

[19] Një pjesë tjetër e doktrinës pranon që mënyra e lidhjes së kontratës për shkak të martesës përbëhet nga deklarata e dhuruesit dhe nga mungesa e refuzimit të përfituesit. Rodolfo Sacco, Giorgio de Nova, Il Contratto, I, Trattato Sacco, (Vol. 3, Torino, 2004), f. 255.

[20] Vendimi nr. 945, datë 04.04.1973, Gjykata e Lartë italiane.

Në rast se martesa e përcaktuar për t'u celebruar në një datë të ardhshme nuk bëhet, atëherë sendet e dhuruara në favor të çiftit duhet të kthehen. Ky është një detyrim personal i tyre,[21] çka do të thotë që në këtë rast nuk është e nevojshme të ngrihet padia e rivendikimit ku paditësi duhet të vërtetojë fillimisht aktin që është pronar dhe më pas të kërkojë kthimin e sendit i cili ndodhet në posedimin e paligjshëm të të paditurit.

Dhurimi për shkak të martesës, në ndryshim nga dhurimi i zakonshëm i parashikuar nga Kodi ynë Civil, nuk mund të revokohet për shkak të mosmirënjohjes së përfituesve.[22] Pavarësisht këtij përjashtimi, palët mund të parashikojnë kushtin e revokimit të dhurimit në rast se përfituesi është i padenjë për gëzim.

Për vetë faktin se kjo kontratë nuk kërkon pëlqimin e përfituesit për pranimin e dhurimit, vlen të saktësohet çfarë ndodh në rast se përfituesi nuk dëshiron të pranojë dhuratën.
Përfituesi mundet në çdo kohë të refuzojë pranimin e dhurimit, pasi asnjëherë ai nuk mund të detyrohet të pranojë një dhurim të cilin nuk e dëshiron, por "mungesa e efikasitetit në këtë rast nuk vjen për shkak të mungesës së pranimit të palës tjetër, pasi kjo nuk është e nevojshme, por për shkak të vullnetit të kundërt të përfituesit".

Çfarë ndodh në rastin e anulimit të martesës apo në rastin e zgjidhjes së saj të mëvonshme?
Shumica e juristëve[23] janë të mendimit që vetëm në rastin e anulimit të martesës, pra moscelebrimit të saj, duhet të aplikohet detyrimi i kthimit të sendeve të dhuruara nga përfituesi tek dhuruesi, njësoj sikur kjo martesë të mos ishte kryer ndonjëherë.[24] Kurse në rastin e zgjidhjes së martesës, kur kjo martesë është celebruar në përputhje me ligjin, por për shkaqe të ndryshme nuk mbijetoi, dhurimi i sjell efektet e saj.

Kodi Civil italian, në të njëjtën dispozitë, përcaktohet se: "Anulimi i martesës sjell anulimin e dhurimit. Mbeten megjithatë të pacenuara të drejtat e fituara nga të tretët me mirëbesim midis ditës së martesës dhe ditëve të gjykimit të nulitetit të martesës". Në qoftë se sendi i dhuruar është tjetërsuar në favor të një personi të tretë, pavarësisht se martesa u anulua, të drejtat e tij nuk do të preken nëse ai ka qenë me mirëbesim në momentin në të cilin i fitoi këto të drejta. Në këtë rast, mbi përfituesin rëndon detyrimi që t'i kthejë dhuruesit vlerën e sendit të dhuruar, përderisa ai nuk mund ta kthejë dot sendin në natyrë. Ndërsa mbi personin e tretë do të rëndojë barra e provës për të provuar mirëbesimin e tij, padijeninë e tij në lidhje me anulimin e martesës. Pasoja anulimit të martesës do të jetë ndërprerja *ex tunc* i efekteve të kësaj kontrate dhe kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme.

Sipas rregullave të përgjithshme, në qoftë se dhurimi është nul, sendet e dhuruara duhet t'i kthehen dhuruesit nga përfituesit ose nga personat e tretë të cilëve ju është tjetërsuar ky send nga përfituesi. Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se legjislatori përcakton anulimin automatik të dhurimit në rastet e anulimit të martesës, si fakt juridik të lidhur më dhurimin, por nuk bën të njëjtën gjë për rastet e zgjidhjes së martesës, të cilën nuk e konsideron shkak për anulimin e dhurimit.

Në rastin kur martesa e ardhshme anulohet, dhurimi i lidhur me këtë martesë bie, sepse martesa nuk ndodh. Në këtë rast kemi një martesë të pavlefshme, inekzistente që në momentin e lidhjes së saj, duke sjellë verifikimin e kushtit zgjidhës të kërkuar nga dispozita në fjalë. Ndërsa në rastin e divorcit, i cili tregon pamundësinë e mbijetesës së një martese që ka qenë ligjërisht e vlefshme që nga momenti i lidhjes së saj, kushti që lidhte dhurimin me martesën ekzistoi, ndryshe nga rasti i anulimit tek i cili ky kusht nuk u përmbush fare.

6. Dhurimi i tërthortë (indirekt)

Ndryshe nga dhurimi direkt, ku njëra palë, dhuruesi me vullnet të plotë dhe të lirë, kalon në pronësi të palës tjetër një të mirë, të cilën kjo e fundit e pranon, në dhurimin indirekt ky veprim bëhet për një motiv të ndryshëm

---

[21] Giannattasio, Carlo. *Delle successioni, divisione-donazione*, (Torino, Unione Tipografico-Editrice Torinese, 1980), f. 268.
[22] Qëllimi i parashikimit të këtij përjashtimi duhet të shihet në lidhje me politikën e shtetit për të cilën një rol të rëndësishëm dhe thelbësor luan krijimi i një familjeje të re, i cili konsiderohet mbizotërues në krahasim me sjelljen e përfituesit të padenjë dhe interesit të vetë familjes së dhuruesit. Antonio Palazzo, I contratti di donazione, (Utet Giuridica, 2009), f. 336.
[23] Giannattasio, Carlo. *Delle successioni*, divisione - donazione, (Torino, Unione Tipografico - Editrice Torinese, 1980), f. 268.
[24] Në këtë rast dhuruesi mund të kërkojë kthimin mbrapsht të sendit, objekt i kontratës së dhurimit, nëpërmjet një padie rivendikimi, nëpërmjet restitucionit ose nëpërmjet një padie njohjeje. Vendimi nr. 945, datë 04.04.1973, Gjykata e Lartë italiane.

nga ai që del në pamje të parë. Kontrata e dhurimit të tërthortë ose indirekt është ajo kontratë tek të cilat palët mund të arrijnë të njëjtin rezultat praktik me dhurimin por duke "i shpëtuar" formës së ngurtë të aktit publik.

Pra, qëllimi i pasurimit të një person mund të arrihet në mënyrë të tërthortë, duke përdorur veprime juridike të cilat kanë një shkak të ndryshëm nga ai i dhurimit.

Dhurimi indirekt është një formë e veçantë dhurimi, e cila, pavarësisht se zbatohet me forma të ndryshme nga ato tipike të dhurimit, prodhon efektet e një akti bujarie, pra varfërimin e dhuruesit dhe pasurimin e të dhuruarit. Falja e borxhit, heqja dorë nga trashëgimia e pastër dhe e thjeshtë, kontrata në dobi të një personi të treti etj., konsiderohen si shembuj të dhurimit indirekt, ku ka shpirt mirësie dhe bujarie. Por edhe rasti i pagimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes, edukimit dhe sëmundjes, si dhe shpenzimet e zakonshme të veshjeve apo dasmës që paguhen në favor të fëmijëve konsiderohen si dhurime indirekte.

Rast tipik i këtij dhurimi është rasti kur një send që ka vlerë tepër të madhe shitet me një çmim shumë të ulët.[25] Në këtë rast kemi një disproporcion ndërmjet vlerës së vërtetë të sendit dhe çmimit të shitjes, dhe pikërisht diçka e tillë është dashur nga vetë dhuruesi, i cili me vullnet të plotë ka dashur të shtojë pasurinë e personit tjetër. Për vlefshmërinë e dhurimit indirekt nuk kërkohet rigorozisht forma e aktit noterial, e cila kërkohet shprehimisht nga legjislatori në rastin e kontratës së dhurimit. Si rezultat, veprimi juridik që kryhet do i nënshtrohet rregullimit të parashikuar për atë veprim dhe jo për kontratën e dhurimit, përfshirë këtu dhe parashikimet në lidhje me formën.

Duke u bazuar përsëri tek praktika e huaj[26], është konfirmuar se: "Në rastin e blerjes së një sendi të paluajtshëm me të ardhurat e blerësit, por duke i kaluar të drejtën e pronësisë një subjekti tjetër, të cilin ai vetë dëshiron ta pasurojë, kontrata e shitjes shndërrohet në një mjet formal për transferimin e sendit dhe shtimin e pasurisë së përfituesit dhe si rrjedhojë sjell një dhurim të tërthortë ose indirekt me objekt sendin e paluajtshëm dhe jo të ardhurat të cilat janë përdorur për ta blerë atë". Gjykata e Lartë italiane në vendimin[27] e saj ka konfimuar se: "Ekziston një dhurim indirekt i një sendi (të paluajtshëm) edhe kur dhuruesi paguan vetëm një pjesë të çmimit të shitjes që i takon përfituesit, ku tregohet lidhja specifike midis dhurimit dhe përdorimit të mëvonshëm të shumave nga përfituesi, duke pasur, në këtë rast, një kontratë shitje të përzier me dhurim.

Konsiderohet dhurim indirekt edhe rasti i pagesës së borxhit të dikujt tjetër (prindi i cili paguan një borxh të fëmijës së tij), falja e borxhit (kreditori i fal detyrimin debitorit të tij), blerja e një sendi për llogari të një pale të tretë, ndërhyrja në kohën e blerjes së sendit për të paguar çmimin e tij, ose duke i dhënë palës së tretë paratë e nevojshme për blerjen e sendit, ose duke vendosur në kontratën e shitjes kushtin që parashikon kalimin e sendit në favor të një personi të tretë, si përfitues të kontratës.

Dhurimi i tërthortë nuk ju nënshtrohet të gjitha rregullave të cilat zbatohen për dhurimin, por vetëm disa prej tyre, mbi të gjitha nuk kërkon formën e aktit publik, formë e cila kërkohet në rastin e dhurimit të sendeve të paluajtshme, pasi do të respektohet forma e cila kërkohet nga dispozitat e veçanta të kontratës që është zgjedhur për të kryer këtë akt liberaliteti.

Dhurimi indirekt karakterizohet nga rezultati që synohet të arrihet dhe jo nga mjeti me anë të së cilit kërkohet të arrihet ky qëllim, i cili mund të jetë nga më të ndryshmit, brenda kufizimeve të vendosura nga legjislatori në fuqi.[28]

---

[25] Në të njëjtin përfundim ka arritur dhe Gjykata e Lartë italiane, në vendimin nr. 1685, datë 22.06.1963. Sipas saj: "Një dhurim indirekt mund të rezultojë nga akte ose veprime juridike me shpërblim, tek të cilat detyrimi i njërës palës e kalon në vlerë shumë më të madhe detyrimin e palës tjetër. Për vlefshmërinë e këtij dhurimi është e mjaftueshme respektimi i formës së kërkuar nga ligji për këtë veprim".

[26] Vendimi nr. 13619, datë 30 maj 2017, Gjykata e Lartë italiane.

[27] Vendimi nr. 10759, datë 17 prill 2019, Gjykata e Lartë italiane.

[28] Dhurimi indirekt përbëhet nga akte ose veprime juridike, kombinimi i të cilave prodhon efektin e një pasurimi pa shpërblim, si në rastin e shlyerjes së borxhit të tjetrit me heqje dorë nga e drejta e rekursit. Vendimi nr. 23260, datë 18 shtator 2019, Gjykata e Lartë italiane.

Një vendim i Gjykatës së Lartë italiane,[29] në lidhje me dhurimin direkt, është shprehur se: "Dhurimi indirekt identifikohet me çdo veprim juridik, i cili, edhe pse nuk është në formën e një dhurimi, ka lindur nga një akt bamirësie dhe ka efektin e pasurimit pa shpërblim të përfituesit, në mënyrë që qëllimi për të dhuruar të dalë vetëm në mënyrë indirekte nga vlerësimi me kujdes i të gjithëve rrethanat e çështjes konkrete, në masën që ato konkludohen dhe provohen menjëherë dhe në mënyrë rituale në gjykatë."

Si përfundim mund të themi se tek dhurimi indirekt vullneti i palëve nuk shprehet në të njëjtën formë me dhurimin direkt, megjithëse synon të arrijë të njëjtin qëllim si dhurimi direkt, pasurimin e palës tjetër.Gjithashtu, për dhurimin indirekt nuk kërkohet forma e aktit noterial, por ligji kënaqet me formën që kërkon veprimi juridik i kryer. Pra, në varësi të llojit të pasurisë që tjetërsohet, veprimi do jetë i vlefshëm duke respektuar formën që kërkohet për atë veprim sipas rastit.

7. Konkluzione

Si përfundim vlerësojmë se shumë nga çështjet dhe rastet e diskutuara në këtë analizë tregojnë disa mangësi në legjislacionin shqiptar përsa ju përket rasteve të ndryshme nëpërmjet të cilave mund të perfeksionohet kontrata e dhurimit në praktikë, të cilat nuk gjejnë reflektim dhe pasqyrim në dispozitat e Kodit Civil.

Mungesa e parashikimeve për kontratën e dhurimit për shkak të martesës, një formë e njohur dhe e përhapur e dhurimit në shoqërinë tonë, paraqet një ndër mangësitë e legjislacionit aktual. Ky është një aspekt veçanërisht i rëndësishëm për të drejtën familjare dhe natyrën e institucionit të martesës në shoqërinë tonë. Është e vështirë të shpjegohet pse ligjvënësi nuk e ka trajtuar këtë lloj të veçantë dhurimi, i cili është i zakonshëm dhe përdoret shpesh në praktikën ligjore dhe në jetën e përditshme të njerëzve. E njëjta gjë mund të thuhet edhe përsa i përket dhurimit për shpërblim, dhurim ky i kryer në shenjë mirënjohjeje ose duke konsideruar meritat e përfituesit dhe konsideratave që dhuruesi ka për të.

Ndryshe nga Kodi Civil aktual, Kodi Civil i vitit 1929 parashikon shprehimisht të ashtuquajturin dhurim "për shpërblim", koncept ky i cili përmendet nga Kodi aktual pikërisht në nenin 771 të tij në rastin e revokimit të kontratës së dhurimit, por nuk trajtohet shprehimisht si lloj i veçantë dhurimi, madje edhe vetë Kodi Civil në dispozitat e tij nuk jep përkufizimin e kësaj kontrate. Trajtimi dhe parashikimi shprehimisht i kësaj kontrate do të luante një rol të rëndësishëm, pasi do të mënjanonte abuzimet të cilat mund të bëhen me revokimin e kësaj kontrate. Duke u referuar tek doktrina e huaj, pikërisht ajo italiane, në lidhje me dhurimin indirekt si një ndër format e veçanta të kontratës së dhurimit themi me bindje se ka ardhur koha që edhe jurisprudenca shqiptare të shprehet në lidhje me këtë formë kontratë duke unifikuar qëndrimin e saj, për të qenë gjithashtu koherent edhe me parashikimin nga dispozitat ligjore të kontratës së dhurimit si kontratë reale. Në këto raste lehtësisht lind diskutimi nëse do të jemi para një kontratë shitjeje të pavlefshme për mungesë të një çmimi të drejtë, apo do ndodhemi para një kontrate dhurimi ku përfituesi është i detyruar të paguajë një kundërshpërblim sado i vogël qoftë ai.

Në përfundim të kësaj analize, është evidente se kontrata e dhurimit, siç parashikohet në legjislacionin shqiptar, paraqet një kontratë që kërkon një rishikim të plotë të kuadrit ligjor. Pavarësisht parashikimeve dhe parashikimeve ekzistuese në Kodin Civil, shumë aspekte të kësaj kontrate mbeten të paqarta ose jashtë trajtimit, duke krijuar kështu nevojën e përmirësimit të këtij segmenti ligjor në të ardhmen.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Baldassari, Augusto. Cendon, Paolo. *Codice civile annotato con la giurisprudenza*. Utet Giuridica, 2007.
2. Biondi, Biondo. *La donazione, Trattato di diritto civile italiano*. Trattatto Vassalli. Torino, 1961.

[29]Vendimi nr. 9379, datë 21 maj 2020, Gjykata e Lartë italiane. Në rastin në fjalë gjykata përjashtoi që dhurimi indirekt të ishte demonstruar nga dhënia e parave të bëra me qëllimin e vetëm të blerjes së një prone nga marrësi, pasi konfirmimi i "animus donandi" nuk mund të vinte nga deklarata e vetme e bërë nga marrësi "përfitues".

3. Cataudella, Antonino. Sucessioni e donazioni. Trattato di diritto privato. Torino: Giappichelli Editore, 2005.
4. Capozzi, *Guido. Successioni e Donazioni*. Milano: Giuffre Editore, 2003.
5. Giannattasio, Carlo. *Delle successioni, divisione-donazione.* Torino: Unione Tipografico-Editrice Torinese, 1980.
6. Familietti, Gianluca. Filiazione e procreazione. Convegno annuale dell'Associazione "Gruppo di Pisa". Pisa, 2013.
7. Semini-Tutulani, Mariana. *E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave.* Pjesa e Posaçme. Tiranë: Skanderbegbooks, 2016.
8. Palazzo, Antonio. *I contratti di donazione*. Utet Giuridica, 2009.
9. Perlingieri, Pietro. *Codice Civile annotato con la dottrina e la giurisprudenza*, Bologna: Zanichelli Editore, 1991.
10. Rescigno, Pietro. *Codice civile - Le fonti del diritto italiano*. Milano: Giuffre Editore, 1994.
11. Sacco, Rodolfo. de Nova, Giorgio. *Il Contratto*. I. Trattato Sacco. Vol. 3 Torino, 2004.

Legjislacion

1. Kodi Civil shqiptar.
2. Kod Civil italian.

Jurisprudencë

1. Vendimi nr. 1685, datë 22.06.1963, Gjykata e Lartë italiane.
2. Vendimi nr. 945, datë 04.04.1973, Gjykata e Lartë italiane.
3. Vendimi nr. 12769, datë 17.11.1999, Gjykata e Lartë italiane.
4. Vendimi nr. 5119, datë 03.03.2009, Gjykata e Lartë italiane, Seksioni Civil.
5. Vendimi nr. 13619, datë 30 maj 2017, Gjykata e Lartë italiane.
6. Vendimi nr. 23260, datë 18 shtator 2019, Gjykata e Lartë italiane.
7. Vendimi nr. 10759, datë 17 prill 2019, Gjykata e Lartë italiane.
8. Vendimi nr. 9379, datë 21 maj 2020, Gjykata e Lartë italiane.
9. Vendimi nr. 3858, datë 17 shkurt 2020, Gjykata e Lartë italiane.
10. Vendimi nr. 41480, datë 24 dhjetor 2021, Gjykata e Lartë italiane.

MBROJTJA E KREDITORËVE TË BASHKËSHORTËVE NË REGJIMET PASURORE ME KONTRATË: EFEKTET LIGJORE TË REGJISTRIMIT TË KONTRATËS MARTESORE

Dr. Eniana QARRI*

THE PROTECTION OF THE SPOUSES' CREDITORS IN CONTRACTUAL PROPERTY REGIMES: LEGAL EFFECTS OF THE REGISTRATION OF THE MARRIAGE CONTRACT

Abstract

This article aims to analyze the mechanisms provided by the Family Code for the protection of third parties, creditors of each spouse, and creditors of the community in contractual property regimes. The contractual property regimes regulated by the Family Code are the contractual community regime and the separation of properties regime. In addition to the specific mechanisms for the protection of the creditors of the spouses, which the Family Code provides for each contractual regime, it also foresees the general mechanism of registering the marriage contract. The registration of the marriage contract has the legal function of a public notification, which serves to make the marriage contract enforceable against third parties. These third parties are presumed to be aware of the existence of the contract due to its registration.

The research methodology used for this paper includes legal analysis, a review of doctrinal positions, and existing studies on the marriage contract, as well as an analysis of the Albanian jurisprudence. The jurisprudence of Albanian courts has been used to enrich the analysis and to explore the practical applications of legal principles. Finally, the paper draws several important conclusions about some issues related to the registration of the marriage contract and the mechanisms for the protection of the creditors of the spouses for each contractual property regime, as well as about the problems in the implementation of these legal regulations in judicial practice.

Keywords: *matrimonial property regime, marriage contract, registration of the marriage contract, contractual community regime, separation of properties regime.*

1. Hyrje në regjimet pasurore me kontratë

Martesa sjell si pasojë për bashkëshortët jo vetëm ndryshimin e statusit të tyre personal, por edhe ndryshimin e regjimit juridik që do t'i zbatohet pasurisë së fituar nga secili prej tyre gjatë martesës, nëpërmjet zbatimit të të ashtuquajturit regjim pasuror martesor. Me regjim pasuror kuptohet tërësia e normave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve dhe marrëdhëniet pasurore të tyre me të tretët, gjatë martesës[1].

Si rregull i përgjithshëm, sipas nenit 66 të Kodit të Familjes (KF), marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, në mungesë të kontratës martesore, rregullohen nga regjimi i bashkësisë ligjore. Nga kjo dispozitë mund të nxjerrim dy përfundime: a) regjimi ligjor është subsidiar në raport me regjimin kontraktor, në kuptimin që regjimi ligjor bëhet i zbatueshëm vetëm në mungesë të regjimit kontraktor; dhe b) për rrjedhojë legjislacioni i jep prioritet kontratës martesore si instrumenti më i përshtatshëm për rregullimin e aspektit ekonomik të marrëdhënieve familjare[2].

Instrumenti tipik, nëpërmjet së cilit gjen shprehje shfaqja e autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore, është "kontrata martesore". Justifikimin e tij, parimi i autonomisë së

* Dr. Eniana Qarri, lektore e të drejtës familjare në Departamentin e të Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

[1] Omari, Sonila. E drejta familjare. Botim i parë. Tiranë: Botimet Morava, 2010, f. 67.

[2] Ragazzini, Luigi. *La revocatoria delle convenzioni matrimoniali*. Rimini: Maggioli Editore, 1987, f. 7.

vullnetit të bashkëshortëve, e gjen në domosdoshmërinë që, në kuadrin e marrëdhënieve të reja ekonomike, në ditët e sotme, të arrihet përshtatja e regjimit pasuror me interesat pasurorë jo vetëm të familjes si entitet social, por edhe të individëve të veçantë që e përbëjnë atë (bashkëshortëve), brenda kufijve të përcaktuara nga ligji[3].

Për të lehtësuar punën e bashkëshortëve, në zgjedhjen e regjimit pasuror që më mirë u përshtatet interesave të tyre dhe për të orientuar lirinë e tyre kontraktore, KF parashikon një numër modelesh të regjimeve pasurore, të cilat nuk kanë për qëllim të kufizojnë lirinë e zgjidhjes së regjimit pasuror, por kanë për qëllim vetëm ta orientojnë atë. Në çdo rast, kufijtë e autonomisë private duhen analizuar mbi bazën e vlerësimit dhe ruajtjes së ekuilibrit ndërmjet interesave të bashkëshortëve, interesave të anëtarëve të familjes dhe mbrojtjes së të tretëve[4]. KF, përveç regjimit pasuror ligjor (bashkësia ligjore), rregullon në mënyrë të detajuar dy regjime pasurore kontraktore:

a) Regjimi i bashkësisë me kontratë;
b) Regjimi i pasurive të ndara.

Për shkak të interesit publik që ka familja dhe martesa për shoqërinë, autonomia e vullnetit të bashkëshortëve kufizohet nga normat urdhëruese të Kodit Civil (KC) dhe ato të KF, çka sjell një ndrydhje më të madhe të autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e marrëdhënieve martesore, në raport me autonominë e gjerë që gëzojnë palët në rregullimin e marrëdhënieve pasurore jomartesore. Epërsia e interesave të familjes mbi interesat e individëve që e përbejnë atë, ka sjellë si pasojë praninë në KF të normave urdhëruese, që i shërbejnë mbrojtjes së këtij interesi, norma të cilat nuk e përjashtojnë vullnetin e individëve, por vetëm e kufizojnë atë[5].

KF parashikon një tërësi të drejtash dhe detyrimesh, si të karakterit pasuror ashtu edhe të atij personal jopasuror, të cilat nuk mund të shmangen nga bashkëshortët. Konsiderohen të pavlefshme të gjitha ato klauzola kontraktore, nëpërmjet të cilave bashkëshortët ndryshojnë mënyrën e rregullimit ose shmangin zbatim e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga martesa[6], rregullat e përgjegjësisë prindërore, rregullat ligjore të administrimit të bashkësisë dhe ato të kujdestarisë. Përjashtim këtu bëjnë ato të drejta dhe detyrime për të cilat KF i ka lënë bashkëshortëve një liri vetërregullimi. Mund të përmendim këtu të drejtën e bashkëshortëve për të rregulluar me marrëveshje vendbanimin e përbashkët, mbiemrin që ata dhe fëmijët e tyre do të mbajnë gjatë martesës dhe modalitetet e përmbushjes së kontributit material për nevojat e familjes[7].

Në lëmin e të drejtave pasurore, është e pavlefshme çdo klauzolë kontraktore, e cila parashikon shmangien e njërit apo e të dy bashkëshortëve nga detyrimi i kontributit material, por nga ana tjetër bashkëshortët kanë liri të plotë në rregullimin e modaliteteve të përmbushjes së këtij detyrimi, si mënyrën, sasinë, kohëzgjatjen. Të dy bashkëshortët, pavarësisht nga lloji i regjimit pasuror, kanë detyrimin për të kontribuar materialisht për nevojat e familjes, sipas marrëveshjes së tyre. Në mungesë të marrëveshjes bashkëshortët e përmbushin kontributin në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre. Parimi i përmbushjes së kontributit në përputhje me "kushtet dhe aftësitë" e secilit bashkëshort është quajtur ndryshe nga doktrina si "parimi i barazisë së ponderuar"[8] të detyrimeve materiale, parim i cili vlerëson në mënyrë të barabartë të gjitha format e kontributit material të secilit bashkëshort

[3] Për këtë mendim shih: Terré, François. dhe Simler, Philippe. *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*. Paris: Éd. Dalloz, 2008, f. 117-118.
[4] Cubeddu, Maria G. "Autonomia privata e regimi patrimoniali." në I rapport patrimoniali tra coniugi III, T. Auletta (Ed.) në Trattati di diritto private, M. Bessone (Ed.), Torino: Giappichelli Ed., 2000, f. 5.
[5] Oberto, Giacomo. I contratti della crisi coniugale I. Amissibilita e fattispecie. Milano: Giuffré Editore, 1999, f. 136-137.
[6] Për më tepër, në nenin 65 të KF është parashikuar që, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve të cilat janë të parashikuara nga Kreu I, i Titullit të II të këtij kodi, do të zbatohen pavarësisht nga regjimi pasuror që kanë zgjedhur bashkëshortët.
[7] Diskutime në literaturën juridike ka edhe në drejtim të detyrimit të besnikërisë bashkëshortore. Ka një qëndrim sot të doktrinës, sipas së cilit, bashkëshortët janë të lirë të rregullojnë me marrëveshje midis tyre edhe detyrimin e besnikërisë bashkëshortore, madje mund të shmangen nga zbatimi i këtij detyrimi. Nëse lexojmë të kombinuara ndërmjet tyre nenin 50, paragrafi 2 dhe nenin 65, besnikëria bashkëshortore shfaqet si një element i detyrueshëm ligjor, zbatimi i të cilit rrjedh *ex lege* që me lidhjen e martesës, pa qenë i nevojshëm rregullimi i palëve, si dhe një detyrim i pashmangshëm.
[8] Ose parimi i "barazisë proporcionale".

në familje[9], duke vlerësuar si të barabartë si aktivitetin profesional ashtu dhe atë shtëpiak. Parashikimi i këtij detyrimi si të pashmangshëm është në funksion të parimit të unitetit të familjes dhe solidaritetit bashkëshortor.

Autonomia e vullnetit të bashkëshortëve në rregullimin e përmbajtjes së marrëdhënies martesore gjen kufizimin e saj në nenet 65 dhe 67 të KF. Nga interpretimi i tyre rezulton që, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve që parashikohen në nenet 60-64 të KF rrjedhin *ex lege* nga martesa, pra për shkak të parashikimit nga ligji[10], bashkëshortët nuk është e nevojshme t'i rregullojnë këto të drejta dhe detyrime me marrëveshje midis tyre, por nga ana tjetër ata nuk mund të përjashtojnë zbatimin e tyre apo të ndryshojnë përmbajtjen, me përjashtim të rasteve kur vetë normat ligjore u japin atyre një liri të tillë.

Në mungesë të kontratës martesore zbatohet *ex lege* që nga data e lidhjes së martesës regjimi i bashkësië ligjore. Regjimi i bashkësisë ligjore, është konsideruar nga ligjvënësi shqiptar, si regjimi më i përshtatshëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, sepse është parë si regjimi pasuror, që më mirë garanton barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve gjatë martesës, jo vetëm duke vendosur sistemin e bashkëpronësisë mbi pasurinë e fituar nga secili bashkëshort gjatë martesës[11], por edhe nëpërmjet vendosjes së barazisë në administrimin e kësaj pasurie, nëpërmjet sistemit të administrimit konkurrent[12], të parashikuar nga neni 90 i KF. Regjimi i bashkësisë ligjore, gjithashtu, garanton një njohje dhe vlerësim të barabartë jo vetëm të kontributit monetar të bashkëshortëve në fitimin e pasurisë gjatë martesës, por edhe të kontributit në natyrë, në drejtim të aktivitetit shtëpiak dhe rritjes dhe edukimit të fëmijëve, duke prezumuar në mënyrë absolute se ky kontribut ka bërë të mundur fitimin e pasurisë ndërmjet bashkëshortëve, gjatë martesës[13]. Gjithashtu, regjimi i bashkësisë ligjore rregullon edhe marrëdhëniet juridike ndërmjet bashkëshortëve dhe personave të tretë dhe kreditorëve të tyre.

Mbrojtja e kreditorëve të bashkëshortëve dhe në përgjithësi të personave të tretë që hyjnë në marrëdhënie juridike me bashkëshortët gjatë martesës shfaqet veçanërisht e rëndësishme në regjimet pasurore me kontratë. Kjo nevojë vjen me qëllim shmangien e rasteve kur kontrata martesore përdoret si një mekanizëm për të pakësuar pasurinë e bashkësisë ose pasurinë vetjake të secilit bashkëshort në dëm të interesave të kreditorëve. Për mbrotjen e interesave të tyre, KF ka parashikuar regjistrimin e kontratës martesore, si edhe disa mekanizma për mbrojtjen e interesave të kreditorëve për secilin nga regjimet pasurore me kontratë.

2. Regjistrimi i kontratës martesore

Në praktikë, kontrata martesore mund të përdoret nga bashkëshortët, jo për të ndryshuar realisht regjimin e tyre pasuror, por si një mjet për të pakësuar pasurinë e secilit prej tyre ose pasurinë e bashkësisë, për të shmangur përmbushjen e detyrimeve të tyre ndaj kreditorëve personalë ose kreditorëve të bashkësisë. Me qëllim mbrojtjen e kreditorëve dhe personave të tretë, që mund të përfshihen në marrëdhënie juridike me bashkëshortët gjatë martesës, KF parashikon regjistrimin e kontratës martesore. Regjistrimi nuk është pjesë e formës së kontratës martesore. KF nuk ka krijuar një regjistër të posaçëm për regjistrimin e kontratës martesore, por parashikon një sistem të shumëfishtë të regjistrimit të saj në regjistrat publikë ekzistues, si akti i martesës dhe regjistri tregtar.

2.1 Sistemi i regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë

Kontrata martesore regjistrohet në regjistrat publikë ekzistues. KF nuk ka parashikuar një regjistër të posaçëm për regjistrimin e kontratës martesore. Regjistrimi i kontratës martesore rregullohet nga leximi i kombinuar i nene 69, 71 dhe 72 të KF, si edhe neneve 83 dhe 193 të KC. Nga leximi i kombinuar i këtyre normave rezulton që në çdo rast kontrata martesore duhet të regjistrohet në Aktin e Martesës. Kontrata martesore duhet të regjistrohet në

[9] Patti, Salvatore. dhe Cubeddu, Maria G. Diritto della famiglia. Milano: Giuffré Editore, 2011, f. 170-171.
[10] Kujtojmë këtu që, momenti i lidhjes së martesës është momenti kur nëpunësi i gjendjes civile i shpall bashkëshortët të martuar në emër të ligjit.
[11] Pasuria prezumohet nga ligji e fituar me kontributin e përbashkët të të dy bashkshortëve.
[12] Flour, Jacques dhe Champenois, Gérard. Le régimes matrimoniaux. Paris: Armand Colin Ed., 1995, f. 136.
[13] Omari, *E drejtë familjare*, f. 108-109.

Regjistrin Tregtar vetëm kur parashikon ndryshimin e regjimit juridik të veprimtarive tregtare, si edhe në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, vetëm në rastet kur parashikon ndryshim e regjimit juridik të sendeve të paluajtshme.

Së pari, KF parashikon regjistrimin e kontratës martesore në Aktin e Martesës. Sipas nenit 69, para. 2 të KF noteri ka detyrimin të depozitojë një kopje të kontratës martesore në zyrën e gjendjes civile para lidhjes së martesës.

Së dyti, në bazë të nenit 71 të KF, nëse njëri nga bashkëshortët ushtron veprimtari tregtare, ndryshimet në kontratën e martesës lidhur me veprimtarinë tregtare duhet të depozitohen edhe në regjistrin tregtar"[14]. Kështu për shembull, kontrata martesore duhet të regjistrohet edhe në Regjistrin Tregtar, në ato raste kur ajo parashikon përfshirjen ose përjashtimin nga bashkësia të një veprimtarie tregtare të bashkëshortëve. Kjo nënkupton që regjistrimi i kontratës martesore në regjistrin tregtar nuk bëhet për çdo kontratë martesore. Nëse para lidhjes së martesës bashkëshortët e ardhshëm lidhin kontratë martesore me të cilën zgjedhin të zbatojnë regjimin e pasurive të ndara ose regjimin e bashkësisë universale dhe asnjëri nga të dy nuk ushtron veprimtari tregtare, atëherë është e kuptueshme që nuk ekziston detyrimi i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

Së treti, kontrata martesore duhet regjistruar edhe në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme[15], në rastin kur ajo parashikon ndryshimin e gjendjes juridike të sendeve të paluajtshme, në pronësi të njërit apo të të dy bashkëshortëve, duke parashikuar kalimin e pasurisë së paluajtshme nga pronësia vetjake e njërit bashkëshort në pronësi të bashkësisë ose e anasjella. Kjo zgjidhje nuk parashikohet nga KF, por rezulton nga interpretimi i normave të KC që rregullojnë regjistrimin e veprimeve juridike që sjellin ndryshimin e gjendjes juridike të sendeve të paluajtshme. Sipas nenit 193 të KC, "duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sende të paluajtshme, të drejta uzufrukti, përdorimi e bujtje, enfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale". Leximi i kësaj dispozite duhet bërë nën dritën e interpretimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas së cilës, sistemi i regjistrimit, i parashikuar nga kjo dispozitë, është një sistem transkriptimi, i cili ka vlerë deklaruese dhe jo krijuese[16].

Regjistrimit në regjistrat e sipërpërmendur i nënshtrohet jo vetëm kontrata martesore e lidhur para lidhjes së martesës, por edhe çdo kontratë martesore e lidhur gjatë martesës, e cila ka për objekt ndryshimin e regjimit pasuror martesor. Parashikimi i sistemit të trefishtë të regjistrimit të kontratës martesore krijon jo pak probleme në praktikë, probleme të cilat lindin për shkak të vështirësisë së koordinimit të këtyre tre regjistrave.

Në Europë, lidhur me sistemin e përdorur për regjistrimin e kontratës martesore, dallojmë dy modele ligjore:

a) Sistemet ligjore të cilat kanë krijuar një regjistër të posaçëm për regjistrimin e kontratave martesore, si: Gjermania, Holanda, Lituania dhe Letonia;
b) Sistemet ligjore, të cilat parashikojnë regjistrimin e kontratës martesore në regjistrat publikë ekzistues: regjistri i gjendjes civile, regjistri tregtar dhe ai i regjistrimit të sendeve të paluajtshme. Këtu mund të përmendim sistemin Italian, Francez dhe atë Spanjoll.

Legjislacioni shqiptar, nën ndikimin e modelit Francez dhe atij Italian, parashikon sistemin e trefishtë të regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë ekzistues.

[14] Duhet sqaruar se çfarë kuptojmë me veprimtari tregtare të bashkëshortëve, term i cili gjen përdorim edhe në nenin 74 dhe 75 të KF.

[15] Omari, *E drejta familjare*, f. 56.

[16] Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 1, datë 06.01.2009. Në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se *"Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërise së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë tek të tretët. Kontrata e cila nuk është e regjistruar është e perfeksionuar dhe e vlefshme dhe ka efektet thelbësore. Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, përfituesi i të drejtave bëhet pronar i pasurisë së paluajtshme dhe ky legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundrejt të tretëve, përveç tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në favor të të tretëve"*.

2.2 Funksionet ligjore të regjistrimit të kontratës martesore

Në analizë të përgjithshme, regjistrimi i një veprimi juridik parashikohet nga ligji për disa arsye: a) për efekt vlefshmërie, pra regjistrim me efekt "konstitutiv" (rasti i kontratës së hipotekës[17], regjistrimi i së cilës kërkohet nga ligji si kusht për vlefshmërinë e kontratës); b) për t'ia bërë atë të njohur të tretëve (për t'ia kundërdrejtuar të tretëve), regjistrimi me efektin e një "publikimi njoftues", ku në mungesë të regjistrimit kontrata është e vlefshme, por nuk sjell efekte ndaj të tretëve[18].

Bazuar në nenet 69, 71 dhe 72 të KF rezulton që, funksioni i regjistrimit të kontratës martesore është ai i publikimit njoftues. Kjo nënkupton që regjistrimi shërben për t'ia bërë të njohur dhe për t'ia kundërdrejtuar të tretëve regjimit pasuror kontraktor të zgjedhur nga bashkëshortët. Regjistrimi i kontratës në aktin e martesës, në regjistrin tregtar dhe në atë të pasurive të paluajtshme nuk ndikon në vlefshmërinë e kontratës martesore, pra nuk ka efekt konstitutiv. Nëse kontrata martesore plotëson të gjitha kushtet thelbësore të vlefshmërisë, së parashikuara në KF dhe KC, por mungon regjistrimi në regjistrin e martesave ose/dhe në atë tregtar, ajo është e vlefshme për bashkëshortët, por nuk nuk mund t'i kundërdrejtohet të tretëve. Mungesa e regjistrimit nuk sjell asnjë pasojë për bashkëshortët, në marrëdhëniet midis tyre ato do të konsiderohen nga ligji të martuar nën regjimin kontraktor të zgjedhur prej tyre. Mungesa e regjistrimit të kontratës sjell pasoja vetëm në marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve dhe personave të tretë, për të cilët bashkëshortët do të konsiderohen të martuar nën regjimin pasuror të mëparshëm, i cili mund të jetë regjimi i bashkësisë ligjore ose një regjim kontraktor i mëparshëm që i fundit figuron i regjistruar[19]. Në mungesë të regjistrimit, kontrata martesore është e vlefshme, por ajo nuk mund t'i kundërdrejtohet të tretëve (nuk sjellë pasoja për të tretët).

Kontrata martesore e lidhur para lidhjes së martesës i sjell efektet që në momentin e lidhjes së martesës si për bashkëshortët (për këta nuk ka rëndësi regjistrimi), ashtu dhe për të tretët nëse është e regjistruar. Ndërsa kontrata martesore e lidhur gjatë martesës, sjell pasoja për bashkëshortët që në momentin e lidhjes së saj (pavarësisht regjistrimit), ndërsa për të tretët sjell pasoja 3 muaj pas regjistrimit të saj në aktin e martesës. Megjithatë, edhe në mungesë të regjistrimit, kontrata martesore i kundërdrejtohet të tretëve, nëse në veprimet juridike të kryera me të tretët, bashkëshortët i kanë vënë ata në dijeni të ndryshimit të regjimit pasuror. Nga sa më sipër rezulton që, sipas neneve 69 dhe 72 të KF, regjimi pasuror i ndryshuar gjatë martesës mund t'i kundërdrejtohet të tretëve në dy raste: a) nëse kontrata është e regjistruar; ose b) nëse bashkëshortët kanë vënë në dijeni të tretin për ekzistencën e kontratës. Duke qenë se mirëbesimi i të tretëve prezumohet nga ligji, barra e provës për të provuar që të tretët janë vënë në dijeni nga bashkëshortët për ndryshimin e regjimit pasuror martesor, u takon këtyre të fundit. Dilema që lind në këtë rast, është nëse kontrata martesore e paregjistruar në aktin e martesës mund t'i kundërdrejtohet të tretit, i cili megjithëse nuk është informuar nga bashkëshortët për ekzistencën e kontratës ka marrë dijeni për lidhjen e saj[20]? Pavarësisht se kjo pyetje nuk gjen zgjidhje të posaçme në KF, mund t'i drejtohemi për zgjidhje parimeve të përgjithshme të së drejtës civile, sipas së cilave ligji nuk i ofron mbrojtje kontraktuesit në keqbesim.

Një nga problemet që rezulton nga sistemi i regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë ekzistues është mungesa e koordinimit të tyre. Natyrshëm shtrohet pyetja nëse një kontratë martesore e cila parashikon ndryshimin e regjimit juridik të pasurive të paluajtshme dhe/ose veprimtarive tregtare, a mund t'i kundërdrejtohet të tretëve nëse është regjistruar vetëm në Aktin e Martesës dhe jo në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe/ose atë tregtar. Problemi qëndron në moskoordinimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme dhe atij tregtar me regjistrat e gjendjes civile[21].

---

[17] Neni 562 i KC: "Hipoteka vihet në bazë të kontratës ose të ligjit dhe me regjistrimin e saj. Kontrata duhet të bëhet me akt noterial". Bazuar në dispozitën e mësipërme, kontrata e hipotekës duhet të lidhet me akt noterial dhe të regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, për efekt vlefshmërie.

[18] Zaccaria, Alessio. "La publicita del regime patrimoniale della famiglia: le posizioni della dottrina." në *Rivista di diritto civile*, 1980, Vol. II, Padova: CEDAM, 1980, f. 435.

[19] Zaccaria, "La publicita del regime patrimoniale della famiglia: le posizioni della dottrina." f. 416.

[20] Carnevali, Ugo. "Le convenzioni matrimoniali." në Il regime patrimoniale della famiglia në Il diritto di famiglia, G. Bonilini, G. Cattaneo (Eds.), Torino: UTET, 1997, f. 36.

[21] Cian, Giorgio. "Sulla pubblicita del regime patrimoniale della famiglia. Una revisione che si impone." *Rivista di diritto civile I*, Padova: CEDAM, 1976, f. 37 .

Regjistrimi i kontratës martesore në regjistrin e pasurive të paluajtshme nuk është gjë tjetër veçse një mjet i nevojshëm për t'i dhënë publicitetin kontratës, për të bërë të njohur ekzistencën e saj të tretët[22] të cilët do të kryejnë në të ardhmen veprime juridike me bashkëshortët. Regjistrimi ka funksionin e publikimit deklarativ. Regjistrimi është shërbim publik, që i lejon kujtdo të marrë të dhëna mbi aktet që transkriptohen. Pikërisht, marrja e saktë e informacionit nëpërmjet publikimit krijon siguri në qarkullimin civil të sendeve duke mundësuar që përfituesi i të drejtave mbi këto sende të jetë i garantuar për sendin që blen dhe të drejtat reale përkatëse. E njejta analizë është e vlefshme edhe lidhur me regjistrimin e kontratës martesore në regjistrin tregtar.

Problemi që lind në këtë rast, për të tretët që hyjnë në marrëdhënie juridiko-civile me bashkëshortët, të cilët pasi kanë konsultuar regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe/ose atë tregtar, nga ku nuk figuron asnjë ndryshim i gjendjes juridike të sendit objekt i marrëdhënies juridiko-civile ose veprimtarisë tregatre, duhet të jenë të vëmendshëm, në çdo rast të konsultojnë edhe regjistrin e martesave për të verifikuar ekzistencën e një kontrate të mundshme martesore. Jemi të mendimit që, kontrata martesore (e cila sjell si pasojë ndryshimin e gjendjes juridike të pasurisë së paluajtshme të bashkëshortëve ose veprimtarive të tyre tregtare) e pa regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme apo atë Tregtar, por e regjistruar në aktin e martesës, nuk mund t'i kundërdrejtohet të tretëve.

Një tjetër çështje që diskutohet nga doktrina franceze është nëse sistemi i regjistrimit të kontratës martesore dhe ndryshimeve që i bëhen kontratës gjatë martesës, është realisht i efektshëm. A përmbush sistemi i regjistrimit, qëllimin që ka pasur ligjvënësi, pra mbrojtjen e të tretëve dhe konkretisht të kreditorëve të bashkëshortëve? Për këtë qëllim Kodi Civil Francez, përveç sistemit të regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë, parashikon edhe detyrimin e bashkëshortëve, në eventualitetin e ndryshimit të regjimit pasuror martesor, për të njoftuar paraprakisht për këtë ndryshim fëmijët e tyre madhorë dhe kreditorët e tyre (të bashkëshortëve), nëpërmjet një njoftimi në gazetë[23]. Nëpërmjet publikimit në gazetë, të ndryshimit të regjimit pasuror martesor, garantohet më mirë mbrojtja e kreditorëve të bashkëshortëve nga kontratat martesore fiktive, të lidhura për pakësimin e pasurisë së bashkëshortit debitor me qëllim shmangien e përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të tij.

Nga analiza e praktikës së pakët gjyqësore të gjykatave shqiptare, mbi mosmarrëveshjet e bashkëshortëve në lidhje me regjimet pasurore dhe kontratën martesore, janë evidentuar probleme në lidhje me zbatimin e dispozitave të KF mbi funksionet dhe pasojat ligjore të regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë. Interpretimi i gabuar i normave të KF mbi regjistrimin e kontratës martesore nga gjykatat shqiptare ka rezultuar në dëmtimin e interesave ekonomikë të kreditorëve të bashkëshortëve, interesa të cilat ligjvënësi ka pasur qëllim të mbrojë. Këtu mund të përmendim Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3403, datë 10.04.2012; Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 2712, datë 16.11.2012 dhe Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 6139, datë 14.06.2012[24], të cilat janë vendime të marra plotësisht në interpretim të gabuar të normave të KF mbi regjistrimin e kontratës martesore. Sipas arsyetimit të gjykatave në këto vendime, kontrata e lidhur ndërmjet

[22] Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 1, datë 06.01.2009.

[23] Pintens, Walter. "Marital agreements and private autonomy in France and Belgium." në Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, 68-88, f.79.

[24] Paditësja dhe bashkëshorti i saj kanë lidhur martesë në vitin 1990. Bashkëshorti i paditëses ka ushtruar aktivitete tregtare si ortak dhe administrator i disa shoqërive tregtare, si *"EUROIL sha"*, *"EDSONY shpk"*, *"LAJTHIZA INVEST sha"*. Në cilësinë e administratorit të shoqërisë EUROIL sha., bashkëshorti i paditëses ka nënshkruar me Raiffeisen Bank sha disa kontrata kredish bankare, nga viti 2009 e në vazhdim. Për garantimin e kthimit të kredive, kredimarrësi ka dalë garant si dorëzanës, apo duke nënshkruar kontrata hipotekimi mes bankës dhe dorëzanësit *"Petrol Impenks sha"*. Pesëmbëdhjetë (15) ditë para marrjes së kredisë, në datë 26.12.2008, bashkëshortët kanë lidhur një marrëveshje, me anë të së cilës, kanë zgjedhur regjimin e pasurive të ndara. Bashkëshorti i paditëses, në kohë të ndryshme, ka tjetërsuar pasurinë e tij në favor të bashkëshortes. Nga ana tjetër, ai nuk ka likuiduar detyrimet ndaj *"Raiffeisen Bank"*. Me kërkesë të bankës ka hyrë në veprim shoqëria përmbarimore *EPSA shpk*, e cila ka kërkuar në gjykatë lëshimin e urdhërave të ekzekutimit, për të mundësuar ekzekutimin e detyrueshëm të këtyre titujve. Paditësja, bashkëshorte e debitorit, ka kërkuar në gjykatë pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë mbi pasurinë e saj. Njëkohësisht, shoqëria përmbarimore, ka depozituar në gjykatë një tjetër padi me objekt veçimin e pjesës së debitorit nga pasuria në bashkëpronësi, me arsyetimin që, kontrata e regjimit të pasurive të ndara nuk mund t'i kundërdrejtohet kreditorit, sepse nuk është regjistruar në zyrën e gjendjes civile.

bashkëshortëve i kundërdrejtohet plotësisht të tretëve, megjithëse kontrata nuk është e regjistruar në zyrën e gjendjes civile. Detyrimin e regjistrimit, vazhdojnë arsyetimin e tyre gjykatat, në bazë të nenit 69 para. 3 të KF, *ligji ia ngarkon noterit dhe mosregjistrimin e saj, ligjvënësi nuk e ka lidhur me asnjë përgjegjësi ligjore, për sa kohë që personi i detyruar është nëpunësi publik*. Ky interpretim dhe zbatim i gabuar i nenit 69 para. 3 i KF është ndrequr nga Vendimi nr. 1048, datë 30.4.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas këtij vendimi, mungesa e regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë (regjistri i martesave dhe regjistri tregtar) nuk cenon vlefshmërinë e kontratës (kontrata është e vlefshme nëse është lidhur në formën e aktit noterial), por sjell si pasojë faktin që, kontrata martesore nuk mund t'i kundërdrejtohet të tretëve. Në mungesë të regjistrimit, bashkëshortët do të konsiderohen kundrejt të tretëve të martuar nën regjimin e bashkësisë ligjore (neni 69 para. 4 i KF). Është pikërisht ky funksioni i regjistrimit të kontratës martesore, ai i mbrojtjes së të tretëve që hyjnë në marrëdhënie juridike me bashkëshortët gjatë martesës si dhe i mbrojtjes së kreditorëve të secilit bashkëshort dhe kreditorëve të bashkësisë.

Në një tjetër vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë[25], në lidhje me pretendimet e paditëses për pavlefshmërinë e kontratës martesore për shkak të mosregjistrimit të saj në gjendjen civile dhe regjistrin tregtar, Gjykata, në përputhje me qëllimin e ligjit lidhur me regjistrimin e kontratës për ndryshimin e regjimit pasuror martesor, vlerëson se mosregjistrimi i saj, nuk e cilëson kontratën si të pavlefshme, pasi mes palëve ajo sjell të gjitha efektet juridike, por regjistrimi përbën garanci për të tretët, në raport me marrëdhëniet juridike, që ata mund të kenë me bashkëshortët.

2.3 Disa probleme mbi regjistrimin e kontratës martesore

Nga leximi i para.1 dhe 2 të nenit 69 të KF, rezulton që noteri është subjekti i cili ka detyrimin ligjor për regjistrimin e kontratës martesore në zyrën e gjendjes civile, duke dorëzuar atje një kopje të saj. Gjithashtu, ligji parashikon detyrimin e noterit për t'i dorëzuar bashkëshortëve në çastin e lidhjes së kontratës martesore një certifikatë, që duhet të ketë në përmbajtje elementëve të tillë si: identiteti i plotë i palëve, adresa e tyre dhe vendi i lidhjes së kontratës. Mbetet i paqartë funksioni i certifikatës që noteri i dorëzon bashkëshortëve dhe pasojat ligjore të moslëshimit të saj nga noteri. *Ratio legis* i kësaj kërkese ligjore mund të jetë dorëzimi i certifikatës nga bashkëshortët te nëpunësi i gjendjes civile në momentin e lidhjes së martesës, me qëllim regjistrimin e kontratës martesore nga ky i fundit. Ky interpretim kërkon që detyrimin e regjistrimit të kontratës martesore ta kenë bashkëshortët. Por, kjo zgjidhje nuk gjen mbështetje në dispozitat e KF, për dy arsye: 1) së pari, KF ka ngarkuar noterin me detyrimin e regjistrimit të kontratës martesore, nëpërmjet dorëzimit prej tij të kontratës martesore në zyrën e gjendjes civile, çka e bën dorëzimin e certifikatës nga ana e bashkëshortëve të panevojshëm, madje një veprim të tepërt; dhe 2) së dyti, në asnjë dispozitë të KF nuk gjejmë të parashikuar detyrimin e bashkëshortëve për të regjistruar personalisht kontratën martesore në ose për t'i dorëzuar nëpunësit të gjendjes civile certifikatën e lëshuar nga noteri. Nga sa më sipër, rezulton që certifikata që noteri i dorëzon bashkëshortëve, nuk luan asnjë rol në gjithë procesin e regjistrimit të kontratës martesore dhe mbetet e paqartë arsyeja pse ligji ka parashikuar një detyrim të tillë. Për të kuptuar më mirë këtë parashikim ligjor mund të referojmë në KC Francez, i cili parashikohen detyrimin e noterit për t'i pajisur bashkëshortët me një certifikatë të tillë, nëpërmjet së cilës bashkëshortët, si subjekte të detyruar nga ligji, bëjnë regjistrimin e kontratës në zyrën e gjendjes civile. Në KC Francez, certifikata i shërben bashkëshortëve për të realizuar regjistrimin e kontratës martesore në zyrën e gjendjes civile, sepse sipas KC Francez subjekti i detyruar për regjistrimin e saj janë bashkëshortët dhe jo noteri. Duke qenë se KF është bazuar në KC Francez për rregullimin e kontratës martesore dhe regjimeve pasurore me kontratë, ka ruajtur të njejtin rregullim, duke harruar që ndryshe nga KC Francez, në KF detyrimin e regjistrimit të kontratës martesore e ka noteri.

Sipas nenit 69 para. 2 të KF regjistrimi i kontratës bëhet në zyrën e gjendjes civile, para lidhjes së martesës. Në rastin e kontratës martesore të lidhur para lidhjes së martesës, mbetet e paqartë se cila është zyra e gjendjes civile ku noteri duhet të dorëzojë noteri kopjen e kontratës martesore për efekt regjistrimi. Zgjidhja e këtij problemi varet nga fakti nëse bashkëshortët kanë bërë ose jo kërkesë për shpallje martese. Nëse bashkëshortët kanë bërë

[25] Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 2423, datë 16.10.2012.

kërkesë për shpallje martese, noteri duhet të dorëzojë kopjen e kontratës martesore, në zyrën e gjendjes civile ku është bërë kërkesa për shpallje martese. Nga ana tjetër, nëse bashkëshortët e ardhshëm akoma nuk kanë bërë kërkesë për shpalljen e martesës, shtrohet problemi se si do të përmbushë noteri detyrimin e tij ligjor të regjistrimit të kontratës martesore. A ka detyrimin ligjor nëpunësi i gjendjes civile, të marrë në dorëzim një kontratë martesore të lidhur nga dy personave, të cilët akoma nuk kanë paraqitur në zyrën e gjendjes civile kërkesën për shpallje martese. Nëse, nëpunësi i gjendjes civile pranon të marrë në dorëzim kontratën, në cilin regjistër do të bëhet regjistrimi i saj. Një problematike tjetër shtrohet në rastin kur bashkëshortët e ardhshëm akoma nuk kanë bërë kërkesën për shpallje martese dhe kanë vendbanimin e tyre në njësi të ndryshme territoriale. Në këtë hipotezë mbetet e paqartë se në cilën zyrë të gjendjes civile duhet të dorëzojë noteri kontratën martesore. Vihet re se pozita e noterit është mjaft delikate, përderisa atij i kërkohet nga ligji detyrimi i regjistrimit të një kontrate martesore, para se të jetë lidhur martesa, lidhje martese për të cilën ai mund të mos marrë dijeni në kohën e duhur[26] ose mund të lidhet në një tjetër qyetet nga ai në të cilin noteri zhvillon veprimtarinë e tij[27]. Janë palët ato që duhet të informojnë noterin pranë të cilit kanë lidhur kontratën martesore për vendin dhe datën e lidhjes së martesës, në mënyrë që noteri të përmbushë detyrimin e tij ligjor për regjistrimin e kontratës.

Në rastin e kontratës së lidhur gjatë martesës, për ndryshimin e regjimit pasuror martesor, ligji ka lënë pa rregulluar afatet ligjore brenda të cilave noteri duhet të kërkojë regjistrimin e kontratës në regjistrin ku figuron i regjistruar akti i martesës. Neni 72 para. 3 i KF parashikon vetëm detyrimin për regjistrimin e kontratës martesore, në mënyrë që kontrata t'i kundërdrejtohet të tretëve, por nuk e vë noterin para afateve brenda të cilave duhet të veprojë për regjistrimin e saj.

Neni 98 i KF parashikon një tjetër rast të regjistrimit të regjimit të pasurive të ndara. Sipas nenit 98 të KF, në rastin e pjesëtimit gjyqësor të pasurisë gjatë martesës, vendimi i gjykatës për pjesëtim duhet regjistruar në regjistrin e gjendjes civile dhe në origjinalin e kontratës së martesës, sepse ky pjesëtim i vendos bashkëshortët në regjimin e pasurive të ndara. Me të drejtë ligjvënësi ka parashikuar regjistrimin e vendimit gjyqësor të pjesëtimit të pasurisë, sepse ky vendim sjell dy pasoja të rëndësishme: përfundimin e regjimit të bashkësisë nga njëra anë, dhe njëkohësisht i vendos bashkëshortët në regjimin e pasurive të ndara, nga ana tjetër. Kjo logjikë nuk është ndjekur nga ligjvënësi për vendimet gjyqësore që konstatojnë apo shpallin kontratën martesore të pavlefshme. Duke pasur parasysh që, vendimi i gjykatës për pavlefshmërinë e kontratës martesore sjell si pasojë ndryshimin e regjimit pasuror sepse i rivendos bashkëshortët në regjimin pasuror që kishin para lidhjes së kontratës së pavlefshme, shtrohet problemi i regjistrimit të këtij vendimi[28]. Me qëllim mbrojtjen e të tretëve dhe të kreditorëve të bashkëshortëve, edhe vendimi gjyqësor që shpall kontratën martesore të pavlefshme duhet regjistruar në regjistrin e martesës, pasi sjell si pasojë ndryshimin e regjimit pasuror martesor. Duhet parashikuar në KF detyrimi i gjykatës për t'i dërguar një kopje të vendimit gjyqësor, që konstaton apo shpall pavlefshmërinë e kontratës martesore, zyrës së gjendjes civile ku është regjistruar kontrata martesore[29]. Në vazhdim të këtij arsyetimi, nëpunësi i gjendjes civile duhet të bëjë shënimin përkatës të pavlefshmërisë së kontratës, në aktin e martesës, ku është regjistruar kontrata martesore. Të paqarta mbeten modalitetet e këtij regjistrimi. Dilema është nëse duhet fshirë regjistrimi i kontratës së pavlefshme nga akti i martesës, apo përkrah regjistrimit të kontratës martesore duhet regjistruar edhe vendimi i gjykatës që konstaton apo shpall pavlefshmërinë e kësaj të fundit.

Lidhur me regjistrimin e kontratës martesore në regjistrin tregtar disa probleme shtrohen për diskutim për shak të paqartësisë së nenit 71 të KF. Nuk është e qartë se cili subjekt ka detyrimin e regjistrimit të kontratës martesore në regjistrin tregtar, noteri apo bashkëshortët, sepse neni 71 i KF nuk shprehet në këtë drejtim. Zgjidhja gjendet në interpretimin e nenit 71 të KF të marrë së bashku me nenin 69 të KF. Nga leximi i kombinuar i tyre, mund të

[26] Për analizën e kësaj problematike në doktrinën italiane shih: Zaccaria, "La publicita del regime patrimoniale della famiglia: le posizioni della dottrina." f. 432.

[27] Finocchiaro, Alfio. dhe Finocchiaro Mario. Diritto di famiglia, Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151. Volume I, Milano: Giuffré Editore, 1984. f. 761.

[28] Carnevali, "Le convenzioni matrimoniali." f. 45.

[29] Këtë qëndrim mban edhe doktrina juridike italiane. Për më shumë shih: Finocchiaro dhe Finocchiaro, *Diritto di famiglia. Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151*, f.758; Carnevali, "Le convenzioni matrimoniali." f. 45.

arsyetojmë që detyrimin e regjistrimit të kontratës martesore në regjistrin tregtar ashtu si edhe në atë të gjendjes civile e ka noteri.

Nga sa më sipër mund të pohohet që regjistrimi i kontratës martesore nuk është rregulluar në mënyrën më të kënaqshme të mundshme. Problemet e përmendura më sipër nuk gjejnë rregullim as në KF dhe as në ligjin "Për gjendjen civile"[30], si dhe mungojnë aktet nënligjore për rregullimin e detajuar të regjistrimit të kontratës martesore në aktin e martesës. Nxjerrja e akteve nënligjore për rregullimin në mënyrë të detajuar të mënyrës së regjistrimit të kontratës martesore dhe të afateve të regjistrimit është një domosdoshmëri. Nëpërmjet akteve nënligjore duhet rregulluar edhe procedura që duhet të ndiqet për konsultimin e kontratave martesore të regjistruara nga të tretët, përfshirë këtu edhe kreditorët e bashkëshortëve.

3. Mbrojtja e kreditorëve të bashkëshortëve në regjimin e bashkësisë me kontratë

Bashkëshortët kanë të drejtë të modifikojnë regjimin e bashkësisë ligjore duke e përshtatur atë me interesat e tyre pasurore dhe nevojat e familjes. Në këtë drejtim, nenet 108-114 të KF parashikojnë ato aspekte të bashkësisë ligjore që bashkëshortët kanë të drejtë të ndryshojnë, norma të cilat mund t'i ndajmë në tre kategori:

a) Norma që modifikojnë objektin e bashkësisë, në këtë drejtim bashkëshortët mund të realizojnë zgjerimin ose reduktimin e objektit të bashkësisë ligjore, si në drejtim të kategorive të caktuara të sendeve ose në drejtim të sendeve të veçanta;
b) Norma që rregullojnë administrimin e bashkësisë;
c) Norma që rregullojnë pjesët takuese dhe likuidimin e bashkësisë[31].

Nenet 108 (a), nenit 109 dhe 114 të KF parashikojnë mundësinë e bashkëshortëve për të zgjeruar objektin e bashkësisë ligjore, duke ofruar dy modele të regjimit të bashkësisë me kontratë: (a) modeli i bashkësisë së sendeve të luajtshme dhe fitimeve (neni 109 i KF); dhe (b) modeli i bashkësisë universale (neni 114 i KF).

Zgjerimi i objektit të bashkësisë ligjore mund të realizohet nëpërmjet kontratave martesore me natyrë programatike, me anë të të cilave bashkëshortët përfshijnë në bashkësi kategori sendesh të cilat do të fitohen në të ardhmen nga secili prej tyre, ose nëpërmjet kontratave me natyrë dispozitive, nëpërmjet të cilave bashkëshortët vendosin të përfshijnë në bashkësi sende të veçanta (të individualizuara)[32]. Ky zgjerim i objektit të bashkësisë mund të sjellë dëmtimin e interesave të kreditorëve vetjakë të bashkëshortëve, për shkak të zvogëlimit të masës së pasurisë vetjake të bashkëshortit debitor duke zvogëluar në këtë mënyrë mundësitë e kreditorit për të realizuar të drejtën e tij, nëpërmjet ekzekutimit të pasurisë së bashkëshortit debitor. Për këtë arsye, neni 110 i KF ka parashikuar disa rregulla për mbrojtjen e pozitës së kreditorëve personalë të bashkëshortëve[33].

Ratio e nenit 110 është evitimi i përdorimit të kontratës martesore nga ana e bashkëshortëve, si një instrument për të zvogëluar pasurinë e tyre personale, me qëllim shmangien e përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të tyre personalë[34]. Formulimi i nenit 110 nuk është shumë i kënaqshëm. Duhej të ishte zgjedhur një formulim më i qartë, i cili do të ndihmonte si studiuesit e KF ashtu dhe zbatuesit e tij, për një kuptim dhe përdorim më të qartë të kësaj dispozite, në të ardhmen.

Vihet re një lapsus i përsëritur shpesh nga ligjvënësi në dispozitat që rregullojnë kontratën martesore, lapsus, i cili i referohet përdorimit të termit "…për detyrimet e tyre para lidhjes së martesës". Termi më i saktë do të ishte: "për detyrimet para lidhjes së kontratës martesore"[35]. Kujtojmë këtu që, ligjvënësi ka pranuar mundësinë e zjedhjes/ndryshimit të regjimi pasuror kontraktor, jo vetëm *ante nuptias*, por edhe *constante matrimonii*. Ky

---

[30] Ligji "Për gjendjen civile", nr. 10 129, datë 11.05.2009.

[31] Colomer, André. Droit civil, Régimes Matrimoniaux. dixième édition. Paris: Litec, 2000, f. 502. Shih edhe: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, f.563.

[32] De Paola, Vincenzo. Il regime patrimoniale della famiglia II. Milano: Giuffré Editore, 1995, f. 721.

[33] Neni 110 i KF: "Bashkëshortët, për detyrimet e tyre para martesës, përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi, deri në kufirin e vlerës së pasurisë së tyre, e cila, në bazë të kontratës së lidhur, sipas këtij Kodi, është pjesë përbërëse e bashkësisë".

[34] Lo Sardo, Giuseppe. "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." në Rivista del Notariato, Milano: Giuffré Editore, 1991, 1211-1391, f.1376.

[35] Në mënyrë të përmbledhur, rekomandohet zëvendësimi i frazë "ante nuptias" me frazën "ante coventionem".

interpretimi i nenit 110 të KF i përshtatet edhe *ratio legis*, pra mbrojtjes së kreditorëve personalë të bashkëshortëve. Një interpretim i kundërt do të çonte në përfundimin e gabuar që, kjo dispozitë nuk ofron mbrojtje për kreditorët personalë të bashkëshortëve, për detyrimet që kanë lindur para lidhjes së kontratës martesore, kur kjo e fundit lidhet gjatë martesës[36].

Për një interpretim më të mirë të nenit 110 të KF, gjykojmë të nevojshme t'i referohem nenit 1501 të KC Francez dhe interpretimeve të doktrinës franceze, duke qenë se neni 110 i KF është hartuar sipas modelit të nenit 1501 të KC Francez. Sipas doktrinës franceze[37], neni 110 (neni 1501 i KC Francez) nënkupton që, kreditori personal i njërit bashkëshort ka të drejtë të ndjekë të gjitha sendet që debitori i tij kishte në pronësi vetjake ditën e lidhjes së martesës (ose lidhjes së kontratës martesore), pavarësisht nga fakti nëse nëpërmjet kontratës martesore, këto sende janë përfshirë në bashkësi ose kanë mbetur vetjake[38]. Përfshirja në bashkësi e sendeve të luajtshme në pronësi të bashkëshortëve ose e fitimeve të pasurisë vetjake, do të sjellë efekte vetëm për bashkëshortët dhe jo për kreditorët e tyre, të cilët për detyrimet e lindura para lidhjes së martesës (kontratës martesore) do të sillen ndaj këtyre sendeve njëlloj sikur këto sende të vazhdonin të ishin në pronësi vetjake të bashkëshortit debitor.

Në praktikë, mund të shfaqen probleme në identifikimin e pasurive të luajtshme të përfshira nga bashkëshortët në bashkësinë me kontratë, nëse gjatë martesës ato janë bashkuar me aktivin ekzistues të bashkësisë ligjore, aq sa nuk mund të identifikohen. KF nuk jep zgjidhje për këtë problem. Nëse i referohemi nenit 1501 të KC Francez, në hipotezën e konfondimit të sendeve, të përfshira nga bashkëshortët rishtazi në bashkësi, me sendet e luajtshme ekzistuese të bashkësisë ligjore, i ka dhënë të drejtë kreditorit të ndjekë të gjitha sendet e luajtshme të bashkësisë, me përjashtim të të ardhurave që vijë nga veprimtaria profesionale e bashkëshortëve[39].

Bazuar në interpretimin e koordinuar të nenit 110 të KF me dispozitat që rregullojnë përmbushjen e detyrimeve të bashkësisë ligjore, nxjerrim përfundimin që, skema e përmbushjes së detyrimeve vetjake të bashkëshortëve, në regjimin e bashkësisë me kontratë, paraqitet si më poshtë:

Për detyrimet vetjake të marra përsipër para lidhjes së martesës ose para lidhjes së kontratës martesore:

a) Fillimisht, kreditori personal ka të drejtë të realizojë kredinë e tij mbi sendet vetjake të bashkëshortit kreditor që nuk janë përfshirë në bashkësinë me kontratë;
b) Nëse kjo pasuria nuk është e mjaftueshme, për përmbushjen e detyrimit, atëherë kreditori ka të drejtë të realizojë kredinë e tij mbi sendet e përfshira në bashkësinë me kontratë, sense që para lidhjes së kontratës ishin në pronësi të këtij bashkëshorti kreditor;
c) Nëse sërish pasuria nuk është e mjaftueshme, atëherë ky kreditor do të barazohet me kreditorët e tjerë personalë të bashkëshortit debitor dhe për rrjedhojë do të zbatohen dispozitat e KF, që rregullojnë përmbushjen e detyrimeve të bashkësisë ligjore. Kreditori ka të drejtë të realizojë kredinë e tij mbi ½ pjesë të pasurisë së bashkësisë ligjore, që është në pronësi të bashkëshortit debitor.

Ndërsa, për detyrimet e marra përsipër pas lidhjes së kontratës martesore, qofshin këto detyrime vetjake apo detyrime të bashkësisë, do të gjejnë zbatim dispozitat e KF që rregullojnë përmbushjen e detyrimeve të regjimit të bashkësisë ligjore (nenet 81-89 të KF).

Nga interpretimi i mësipërm rezulton që, pozita e kreditorëve personalë të bashkëshortëve për detyrimet e mara përsipër para lidhjes së kontratës martesore është më e favorshme se sa pozita e kreditorëve personalë për detyrimet *"post nuptial/conventionem"*[40].

---

[36] I vetmi shpjegim për këtë lapsus të përsëritur të ligjvënësit është trashëgimi i këtij gabimi nga dispozitat e Kodit Civil Italian, që janë marrë si model në hartimin e regjimit pasuror martesor në Kodin tonë të Familjes. Kodi Civil Italian mbart këtë lapsus, sepse fillimisht me hartimin e tij, ndryshimi kontraktor i regjimit pasuror martesor gjatë martesës ishte i ndaluar dhe ndiqej parimi i "pamodifikueshmërisë së kontratave martesore". Më pas me reformën e vitit 1975 Kodi Civil Italian lejoi ndryshimin e regjimit pasuror martesor edhe gjatë martesës.

[37] Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, f. 568.

[38] Të njetin interpretim të nenit 110 të KF e gjejmë edhe në doktrinën shqiptare. Për më shumë shiko: Omari, *E drejtë Familjare*, f. 57.

[39] Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, f. 569.

[40] Lo Sardo, "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." f. 1380.

Në doktrinë është shtruar diskutimi mbi mundësinë e modifikimit, nga bashkëshortët, të regjimit juridik të përmbushjes së detyrimeve vetjake të bashkëshortëve dhe detyrimeve të bashkësisë, të rregulluar në nenet 81-89 të KF[41]. Pjesa më e madhe e doktrinës kanë dhënë përgjigje negative, duke argumentuar që, këto dispozita janë të parashikuara me norma urdhëruese dhe për pasojë modifikimi i tyre nuk mund t'i lihet vullnetit të bashkëshortëve. Qëllimi i këtyre dispozitave është, në radhë të parë, mbrojtja e interesave të kreditorëve personalë të bashkëshortëve, duke bërë të mundur maksimalisht realizimin e të drejtës së tyre të kredisë, si dhe mbrojtja e pasurisë së bashkësisë nga kreditorët personalë të bashkëshortëve apo anasjellas mbrojtja e pasurisë vetjake të bashkëshortëve nga kreditorët e bashkësisë[42].

Bashkësia universale, si formë e posaçme e bashkësisë me kontratë parashikohet nga neni 114 i KF. Për bashkësinë universale zbatohet parimi i lidhjes së drejtpërdrejtë të aktivit të pasurisë së bashkësisë me pasivin e saj[43]. Në këtë kuptim zgjerimi i aktivit të pasurisë do të sjellë automatikisht zgjerimin e pasivit të saj, me qëllim mosdëmtimin e interesave të kreditorëve personalë të bashkëshortëve.

Neni 114 i KF parashikon shprehimisht që, bashkësia universale përballon të gjitha detyrimet e bashkëshortëve:

a) Detyrimet e përbashkëta dhe detyrimet vetjake që, ekzistonin para lidhjes së kontratës martesore;
b) Detyrimet që do të marrin përsipër bashkëshortët së bashku ose veç e veç, në të ardhmen.

Pozita e kreditorëve personale të bashkëshortëve është e mbrotjur, duke qenë se kreditorët personalë shndërrohen në kreditorë të bashkësisë.

4. Mbrojtja e kreditorëve të bashkëshortëve në regjimin e pasurive të ndara

Në Kreun IV të Titullit të III të KF, i sistemuar menjëherë pas regjimit të bashkësisë me kontratë, gjen rregullim regjimi i pasurive të ndara. Në doktrinë, regjimi i pasurive të ndara përkufizohet si regjimi pasuror martesor, në të cilin pasuritë e fituara nga secili bashkëshort gjatë martesës janë vetjake të bashkëshortit titullar dhe administrohen nga bashkëshortët në pavarësi të plotë nga njëri-tjetri (neni 115, para. 1 i KF). Gjithashtu, janë vetjake edhe detyrimet që secili bashkëshort merr përsipër gjatë martesës (neni 115, para. 2 i KF). Regjimi i pasurive të ndara përmbush kërkesat e lirisë së disponibilitetit, të shpejtësisë dhe sigurisë të qarkullimit të të mirave materiale të bashkëshortëve.

Regjimi i pasurive të ndara është një regjimi i mirëfilltë pasuror, i cili përbëhet nga një grup sistematik rregullash, të cilat parashikojnë: përkatësinë e pasurisë së fituar gjatë martesës, administrimin e pasurisë së secilit bashkëshort, provën e pronësisë së sendeve, pamundësisë së shmangies nga kontributi material, mbrojtjen e banesës familjare, karakterin solidar të detyrimeve në interes të familjes.

Megjithëse gjatë regjimit të pasurive të ndara vepron parimi i pavarësisë së aktivit dhe pasivit të pasurisë së bashkëshortëve, për shkak të jetesës së përbashkët dhe solidaritetit në familje, mund të ndodhë që pasuria e bashkëshortëve (sidomos sendet e luajtshme) të konfondohet, duke bërë të vështirë përcaktimin e titullarit të pronësisë. Ky konfondim mund të sjellë dëmtimin e interesave ekonomikë të kreditorëve të secilit bashkëshort.

Për këtë arsye ligjvënësi ka parashikuar disa prezumime ligjore, si në marrëdhëniet ndërmjet vetë bashkëshortëve ashtu dhe në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe kreditorëve të tyre.

Prezumimet e pronësisë në regjimin e pasurive të ndara, të rregulluara nga neni 119 i KF paraqiten më të ndërlikuara në raport me prezumimin e sendeve vetjake në regjimin e bashkësisë ligjore[44].

Zakonisht, në praktikë problemi i përcaktimit të bashkëshortit pronar të sendeve të luajtshme, në marrëdhëniet ndërmjet vetë bashkëshortëve shtrohet në momentin e përfundimit të martesës, ndërsa në raport me kreditorët, problemi mund të shtrohet gjatë martesës, kur detyrimi bëhet i kërkueshëm, sepse kreditorët mund të ndjekin vetëm pasurinë vetjake të bashkëshortit debitor, pa pasur asnjë të drejtë mbi pasurinë e bashkëshortit tjetër.

---

[41] Për këtë opinion shih: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, f. 570.
[42] Lo Sardo, "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." f. 1246.
[43] Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, f. 570.
[44] Sipas nenit 105 të KF në mungesë të provave të kundërta, prezumohet që pasuria e luajtshme bën pjesë në bashkësi.

Neni 119 i KF parashikon tre prezumime ligjore, të cilët shfaqin disa karakteristika të përbashkëta[45]. *Së pari*, prezumimet e parashikuara në nenin 119 të KF vlejnë vetëm për sendet e luajtshme, ndërkohë që nuk mund të zbatohen në asnjë rast për sendet e paluajtshme, pronësia e të cilave do të përcaktohet, në çdo rast, mbi bazën e titullit të fitimit të pronësisë. *Së dyti*, terminologjia e përdorur nga ligjvënësi nuk është plotësisht e saktë. Në të tre paragrafët e nenit 119 ligjvënësi ka përdorur termin *"pasuri të luajtshme"* dhe jo termin *"sende të luajtshme"*. Duke qenë se termat *"pasuri"* dhe *"sende"* nuk janë sinonime të njëri-tjetrit, por termi *"pasuri"* mbart një kuptim më të gjerë në raport me termin *"send"*, gjykojmë që, ligjvënësi duhej të kishte përdorur termin send. *Së treti*, megjithëse nuk del qartë nga teksti i nenit 119, prezumimet e parashikuara nga neni 119 i KF janë prezumime relative, që do të thotë që bashkëshorti, i cili pretendon pronësinë e një sendi të caktuar ka të drejtë ta provojë atë me çdo mjet prove[46]. Në çdo rast, barra e provës do të bie mbi bashkëshortin që pretendon pronësinë mbi një send të caktuar. Pronësia mund të provohet me çdo mjet prove, si në lidhje me bashkëshortin tjetër ashtu dhe në lidhje me të tretët[47].

Pas konsideratave të përgjithshme mbi prezumimet e pronësisë së sendeve të luajtshme, të parashikuara nga neni 119 i KF, do të ndalemi konkretisht në analizën e secilit prej prezumimeve të parashikuara nga kjo dispozitë, me një fokus të veçantë në objektin personal të zbatimit të tyre.

Paragrafi i parë i nenit 119 të KF: *"Pasuria e luajtshme që posedohet nga njëri prej bashkëshortëve ose nga të dy bashkëshortët prezumohet, në lidhje me kreditorët e secilit prej tyre, se i përket bashkëshortit debitor. Ky prezumim nuk është i vlefshëm në rast të ndërprerjes së jetës së përbashkët."*

Prezumimi i pronësisë, i parashikuar në paragrafin e parë të nenit 119 të KF, është i vlefshëm në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve nga njëra anë dhe kreditorëve të tyre nga ana tjetër. Ky prezumim nuk gjen zbatim në marrëdhëniet ndërmjet vetë bashkëshortëve. Rregulli i përgjithshëm është që, sendet e luajtshme të cilat gjatë martesës posedohen nga të dy bashkëshortët apo nga njëri prej tyre, në raport me kreditoret e bashkëshortëve, prezumohen që janë në pronësi të bashkëshortit debitor. Ky prezumim ka për qëllim mbrojtjen e kreditorëve nga veprimet fiktive të bashkëshortëve, të cilët me qëllim shmangien e përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të tyre, në mungesë të këtij prezumimi, do e kishin mjaft të lehtë kalimin e pronësisë së sendeve të luajtshme nga bashkëshorti debitor tek bashkëshorti tjetër. Në rastin kur bashkëshortët kanë ndërprerë jetën e përbashkët, ky prezumim nuk gjen zbatim.

Paragrafi i dytë i nenit 119 të KF: *"Pasuria e luajtshme që posedohet nga të dy bashkëshortët, prezumohet në lidhje me njëri tjetrin që i përket të dy bashkëshortëve në pjesë të barabarta."*

Ky prezumim i bashkëpronësisë së sendeve të luajtshme, që gjatë martesës posedohen nga të dy bashkëshortët, zbatohet vetëm në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe jo në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe kreditorëve të tyre. Në praktikë, zakonisht janë sende që posedohen nga të dy bashkëshortët, sendet e mobilimit të banesës familjare.

Paragrafi i tretë i nenit 119 të KF: *"Pasuria e luajtshme, e përcaktuar për përdorim vetjak nga njëri prej bashkëshortëve, prezumohet se i përket këtij të fundit".*

Në tekstin e dispozitës së mësipërme nuk del qartë se cilëve subjekte i drejtohet zbatimi i saj. Në heshtje të ligjit, jemi të mendimit që paragrafi i tretë i nenit 119 të KF duhet të interpretohet në mënyrë të gjerë sa i përket objektit personal të zbatimit të saj. Në bazë të interpretimit të zgjeruar do të pranojmë që, prezumimi i mësipërm do të gjejë zbatim si në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve ashtu dhe në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve dhe kreditorëve të secilit prej tyre. Përderisa teksti i normës nuk bën dallime, aq më pak duhet të bëje interpretuesi i saj. Në arritjen e këtij përfundimi, bazohemi në dispozitën respektive të Kodit Civil Gjerman, neni 1362/2, e cila parashikon shprehimisht që ky prezumim zbatohet njëkohësisht në marrëdhëniet e bashkëshortëve me njëri-tjetrin dhe në marrëdhëniet e tyre me kreditorët.

[45] Për më shumë, rreth karakteristikave të prezumimeve ligjore, shih: Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, f. 614.

[46] Mundësinë e të provuarit të pronësisë së sendeve të luajtshme me çdo mjet prove e gjejmë të parashikuar shprehimisht në dispozitat analoge të KC Francez (neni 1538) dhe KC Italian (neni 219).

[47] Flour dhe Champenois, *Le régimes matrimoniaux*, f. 614.

Në analizë të fundit, duhet sqaruar çështja nëse bashkëshortët kanë ose jo mundësinë e modifikimit të prezumimeve të pronësisë së parashikuar nga neni 119 i KF.

Në KC Francez, neni 1538[48], bashkëshortëve u lejohet shprehimisht të parashikojnë në kontratën martesore klauzola që modifikojnë prezumimet e pronësisë, duke parashikuara të tjera prezumime, të ndryshme nga ato ligjore, apo të përjashtojnë tërësisht zbatimin e tyre, madje këto klauzola janë të vlefshme jo vetëm ndërmjet bashkëshortëve, por i kundërdrejtohen edhe të tretëve. Një autor francez mban qëndrimin që, në rastin kur prezumimet kontraktore favorizojnë njërin bashkëshort në raport me bashkëshortin tjetër, jemi përpara dhurimit indirekt që bashkëshortët i bëjnë njëri-tjetrit në kontratën martesore[49].

Ndërsa, në nenin 219 të KC Italian, nuk gjejmë asnjë rregullim në drejtim të mundësisë së bashkëshortëve për të modifikuar apo për të përjashtuar zbatimin e prezumimeve të pronësisë së sendeve të luajtshme. Në heshtje të ligjit, pjesa më e madhe e doktrinës italiane[50] është shprehur në favor të mundësisë së bashkëshortëve për të modifikuar prezumimet ligjore, duke argumentuar që, përderisa ligji nuk e ndalon shprehimisht, atëherë është e lejuar. Në rastet kur ligjvënësi ka dashur të ndalojë shprehimisht të drejtën e bashkëshortëve për të modifikuar dispozitat e regjimit pasuror martesor, vazhdojnë arsyetimin e tyre këta autorë, është treguar i kujdesshëm që ta parashikojë shprehimisht një ndalim të tillë. Ndërsa një pjesë tjetër e autorëve, ndonëse të paktë në numër, kanë mbajtur qëndrim të kundërt, duke argumentuar që modifikimi i prezumimeve të pronësisë, do të shkelte parimin e barazisë së bashkëshortëve.

Jemi të mendimit që, përderisa ligjvënësi nuk ka parashikuar asnjë ndalim të shprehur, rregullat e prezumimit të pronësisë së sendeve të luajtshme, të parashikuara në nenin 119 të KF mund të modifikohen nga bashkëshortët, me përjashtim të prezumimeve që zbatohen në marrëdhënie me kreditorët, të cilat, në gjykimin tonë, janë të pashmangshme me marrëveshje. Në të kundërt, lejimi i shmangies së prezumimeve që zbatohen në marrëdhënien ndërmjet bashkëshortëve dhe kreditorëve do të dëmtonte interesat e këtyre të fundit.

5. Përfundime

Vendosja e bashkëshortëve në një regjim pasuror kontraktor sjell domosdoshmërinë e mbrojtjes së interesave të personave të tretë që hyjnë në marrëdhënie juridike me bashkëshortët gjatë martesës dhe të kreditorëve të tyre. Për këtë qëllim KF parashikon regjistrimin e kontratës martesore. Regjistrimi i kontratës martesore ka rolin e një publikimi njofutues. Nëse nuk regjistrohet, kontrata martesore është e vlefshme për bashkëshortët, por nuk prodhon efekte ligjore për palët e treta. Për të tretët, në mungesë të regjistrimit, bashkëshortët do të rezultojnë të martuar nën regjimin pasuror ligjor.

Sa i përket regjimit të bashkësisë me kontratë, zgjerimi i objektit të bashkësisë sjell si pasojë pakësimin e pasurisë vetjake të secilit bashkëshort, pakësim i cili mund të dëmtojë interesat e kreditorëve vetjakë të tyre, sepse zvogëlon pasurinë e bashkëshortit debitor. Për këtë arsye, neni 110 i KF parashikon që sendet e përfshira rishtazi nga bashkëshrtët në bashkësi, nëpërmjet kontratës martesore, konsiderohen përkundrejt kreditorëve të bashkëshortëve, që i përkasin në pronësi vetjake bashkëshortit debitor. Pavarësisht formulimit jo mjaftueshëm të qartë, duket që ky është i vetmi interpretim logjik i nenit 110 të KF.

Në mënyrë analoge, zgjedhja e regjimit të pasurive të ndara, dhe përdorimi i sendeve të luajtshme të njërit bashkëshort nga tjetri, mund të krijojë përshtypjen e gabuar tek kreditori i këtij të fundit që këto sende i përkasin në pronësi debitorit të tij, duke ndikuar në këtë mënyrë në vendimmarjen e tij lidhur me marrëdhënien juridike që ka lindur mes tij dhe bashkëshortit debitor. Për këtë arsye, KF parashikon disa prezumime në favor të kreditorit, mbi sendet e luajtshme, të cilat gjatë martesës posedohen nga njëri apo të dy bashkëshortët.

---

[48] Teksti i nenit 1538/2 i KC Francez: *"Les présomptions de propriété énonceés au contrat de marriage ont effet a l'égard de tiers aussi bien que dans les rapports entre epoux, s'il n'en a été autrement convenu".*

[49] Savatier, René. La séparation de biens en droit français. Paris: Dalloz, 1973, f. 17.

[50] Në mbështetje të këtij qëndrimi shih: Oberto, "Il regime di separazione dei beni tra coniugi. Artt. 215-219." f. 324-325; Cattaneo, Giovanni. "Del regime di separazione dei beni." në Commentario alla riforma del diritto di famiglia, Tomo I (Artt.1-89), L. Carraro, G. Oppo, A. Trabucchi, Padova: CEDAM, 1977, f. 488. Ndërsa janë kundër: Sesta, Michele. dhe Valiagni B. "Il regime di separazione di beni." në Regime patrimoniale della famiglia, F. Anelli, M. Sesta (Eds.) në Trattato di diritto di famiglia, P.Zatti (Ed.). Milano: Giuffré Editore, 2012, f. 631.

Shënim: Ky punim është një variant i ripunuar dhe përditësuar i analizës që i është bërë mbrojtjes së kreditorëve në regjimet pasurore me kontratë, në disertacionin për mbrojtjen e grades shkencore Doktor, me titull "Kontrata martesore", mbrojtur në Departamentin e së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, mar

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Bariatti, Stefania. *La famiglia nel diritto internazionale private comunitario*. Milano: Giuffre Editore, 2007.
2. Carnevali, Ugo. "Le convenzioni matrimoniali." në *Il regime patrimoniale della famiglia* në *Il diritto di famiglia*, G. Bonilini, G. Cattaneo (Eds.), Torino: UTET, 1997, 15-48.
3. Cattaneo, Giovanni. "Del regime di separazione dei beni." në *Commentario alla riforma del diritto di famiglia*, Tomo I (Artt.1-89), L. Carraro, G. Oppo, A. Trabucchi, Padova: CEDAM, 1977, 462-488.
4. Cian, Giorgio. "Sulla pubblicita del regime patrimoniale della famiglia. Una revisione che si impone." *Rivista di diritto civile I*, Padova: CEDAM, 1976.
5. Colomer, André. *Droit civil, Régimes Matrimoniaux*. dixième édition. Paris: Litec, 2000.
6. Cubeddu, Maria G. "Autonomia"
7. privata e regimi patrimoniali." në *I rapport patrimoniali tra coniugi III*, T. Auletta (Ed.) në *Trattati di diritto private*, M. Bessone (Ed.), Torino: Giappichelli Ed., 2000.
8. De Paola, Vincenzo. *Il regime patrimoniale della famiglia II*. Milano: Giuffré Editore, 1995.
9. Finocchiaro, Alfio. dhe Finocchiaro Mario. *Diritto di famiglia, Commento sistematico della legge 19 Maggio 1975, n.151*. Volume I, Milano: Giuffré Editore, 1984.
10. Flour, Jacques dhe Champenois, Gérard. *Le régimes matrimoniaux.* Paris: Armand Colin Ed., 1995.
11. Lo Sardo, Giuseppe. "La comunione convenzionale nel regime patrimoniale della famiglia." në *Rivista del Notariato*, Milano: Giuffré Editore, 1991, 1211-1391.
12. Oberto, Giacomo. I contratti della crisi coniugale I. Amissibilita e fattispecie. Milano: Giuffré Editore, 1999.
13. Omari, Sonila. *E drejta familjare*. Botim i parë. Tiranë: Botimet Morava, 2010.
14. Patti, Salvatore. dhe Cubeddu, Maria G. *Diritto della famiglia*. Milano: Giuffré Editore, 2011.
15. Pintens, Walter. "Marital agreements and private autonomy in France and Belgium." në *Marital agreements and private autonomy in Comparative Perspective*, J. Scherpe (Ed.), Oxford: Hart Publishing, 2012, 68-88.
16. Ragazzini, Luigi. *La revocatoria delle convenzioni matrimoniali*. Rimini: Maggioli Editore, 1987.
17. Savatier, René. La séparation de biens en droit français. Paris: Dalloz, 1973.
18. Sesta, Michele. dhe Valiagni B. "Il regime di separazione di beni." në *Regime patrimoniale della famiglia*, F. Anelli, M. Sesta (Eds.) në *Trattato di diritto di famiglia*, P.Zatti (Ed.). Milano: Giuffré Editore, 2012, 557-678.
19. Terré, François. dhe Simler, Philippe. *Droit Civil. Les regimes matrimoniaux*. Paris: Éd. Dalloz, 2008.
20. Zaccaria, Alessio. "La publicita del regime patrimoniale della famiglia: le posizioni della dottrina." në *Rivista di diritto civile*, 1980, Vol. II, Padova: CEDAM, 1980, 416-450.

Jurisprudencë

1. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 2423, datë 16.10.2012.
2. Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 1, datë 06.01.2009.

STANDARDI I ORIGJINALITETIT SI NJË PREJ KËRKESAVE THEMELORE PËR MBROJTJEN E VEPRAVE NGA E DREJTA E AUTORIT

Aspekte Teorike të Legjislacionit dhe Jurisprudencë

Dr. Ilda MUÇMATAJ *

THE ORIGINALITY THRESHOLD, A KEY CRITERION FOR COPYRIGHT PROTECTION

Theoretical aspects of legislation and jurisprudence

Abstract

Creative industries are of significant economic and social importance to nations worldwide. Given this value and the tendency toward further development, the issue of legal protection for intellectual creation, especially author's rights, is critical. This paper discusses originality as a selective filter for qualifying works for copyright protection. As one of the essential criteria for distinguishing between creations that should and should not enjoy copyright protection, the article analyzes its significance in various legal systems and future developments in EU copyright law on this topic. The paper also emphasizes the role of the European Court of Justice's (ECJ) practice as an important component in harmonizing copyright legislation. Then, the paper provides a hypothesis on applying these criteria to AI-generated works. Finally, the article offers appropriate reflections based on research on relevant legislation, doctrine, and judicial practice in our legal system.

Keywords: *copyright, originality, intellectual creation, creativity, author's work.*

1. Hyrje

Sistemet e të drejtave të autorit në mbarë botën kanë mbrojtur historikisht një gamë të gjerë të krijimeve intelektuale. Këto krijime janë një pasuri e rëndësishme për shoqërinë në evolucion për shkak të mjaft vlerave që përcjellin si emocionale, kulturore, informuese, ruajtëse të trashëgimisë kulturore, zhvillimit të industrisë dhe ekonomike. Shumëllojshmëria e këtyre produkteve të krijimtarisë kontribuon gjithashtu edhe në mirëqenien e përgjithshme sociale. Të drejtat ekskluzive të garantuara për krijimet e mendjes janë mjet ligjor për shprehjen dhe respektimin e këtyre vlerave. Si rrjedhojë, përcaktimi i kritereve për mbrojtjen e të drejtave të autorit luan një rol të rëndësishëm jo vetëm për autorët apo titullarët e të drejtave por edhe për përdoruesit e veprave me të drejtë autori, vetë shtetin apo shoqërinë në përgjithësi. Objekti i këtyre të drejtave është vepra. Si rrjedhojë, përkufizimi i krijimeve që do të konsiderohen vepra dhe që mund të mbrohen nga e drejta e autorit është një temë qendrore në këtë fushë, pasi jo çdo krijim do të konsiderohet vepër, dhe do të gëzojë mbrojtje nga legjislacioni.

Organizata Botërore të Pronësisë Intelektuale, e përkufizon veprën si "*çdo krijim intelektual origjinal i shprehur në një formë të riprodhueshme*".[1] Ndërsa Konventa e Bernës, pavarësisht se nuk e përkufizon në mënyrë të mirëfilltë konceptin e "*veprës*", e kufizon atë në tregues se të drejtat e autorëve mbrohen mbi "veprat e tyre

* Dr. Ilda Muçmataj, lektore në Depratamentin e të Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

[1] World, *Guide to the Copyright and Related Rights Treaties Administered by WIPO and Glossary of Copyright and Related Rights Terms* (WIPO 2004) 268.

letrare dhe artistike"[2], dhe paraqet një listë të krijimeve që gëzojnë mbrojtje.[3] Neni 2(1) i Konventës së Bernës e përcakton termin "*vepra letrare dhe artistike*" në mënyrë të gjerë duke "*përfshirë çdo krijim në fushën letrare, shkencore dhe artistike, pavarësisht nga mënyra ose forma e shprehjes së saj...*"[4] Çdo shtet që ka aderuar në Tekstin e Parisit ose në Marrëveshjen TRIPs, e cila në nenin 9(1) përfshin si referencë aktin e Parisit të Konventës së Bernës,[5] kërkon mbrojtjen efektive për "veprat letrare dhe artistike" brenda kushteve gjithëpërfshirëse të Konventës së Bernës.

Në të drejtën e krahasuar, nocioni i përgjithshëm "vepra letrare dhe artistike"[6]mund të shfaqet thjesht si "vepër", "vepra intelektuale"[7], "vepër e autorit",[8] "krijim i mendjes",[9] apo "vepra letrare, shkencore dhe artistike".[10] Ndërsa në kuadrin kombëtar, vepra shfaqet si "*...krijim intelektual origjinal në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës, i cili mbart karakteristika individuale, pavarësisht nga mënyra ose forma e shprehjes së tyre, objektivi, rëndësia, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligj"*.[11] Që prej këndej merr rëndësi thelbësore kërkesa për origjinalitet. Pra, origjinaliteti përdoret si pikë referimi në të drejtën e autorit për të testuar nëse një "vepre" mund t'i ofrohet mbrojtje nga e drejta e autorit.[12] Sipas një studiuesi, origjinaliteti është, "*prova dhe materializimi i autorësisë dhe ajo çfarë justifikon mbrojtjen nga e drejta e autorit*"[13].

Në nivel ndërkombëtar pavarësisht synimit unifikues të legjislacionin për të drejtat e autorit në shtetet anëtare, përkufizimi i termit origjinalitet, nuk parashikohet në mënyrë eksplicite në Konventën e Bernës,[14] dhe as në Marrëveshjen TRIPs. dhe rrallë herë përfshihet si i tillë në ligjet kombëtare. Megjithatë, ai mund të shihet i shfaqur në mënyrë indirekte dhe të nënkuptuar në paragrafin (1),[15] në paragrafin (3),[16] po ashtu edhe në paragrafin (5) të nenit 2 të Konventës së Bernës.[17] Kështu, Konventa e Bernës, nënvizon rëndësinë e mbrojtjes nga të drejtat e

[2] Neni 1, Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike, Akti i Parisit i 24 Korrikut 1971, i amenduar më 28 Shtator 1979.

[3] Neni 2, Konventa e Bernës.

[4] Neni 2(1) Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike, Akti i Parisit i 24 Korrikut 1971, i amenduar më 28 Shtator 1979.

[5] Neni 9(1) të Marrëveshjes për Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIPs) 1994.

[6] Goldstein, Paul and Hugenholtz, PB. *International Copyright: Principles, Law, and Practice* (Oxford University Press, Cop 2013) 188.

[7] Shih Francën, Italinë.

[8] Ligji për të Drejtat e Autorit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës 1976. Shih Seksioni 101(a), po ashtu Seksioni 102 (a) i cili parashikon se "*mbrojtja e të drejtës së autorit ekziston, në përputhje me këtë titull, në veprat origjinale të autorit*"

[8] Akti i të Drejtave të Autorit, Dizajnit dhe Patentave, Mbretëria e Bashkuar 1988. Seksioni 1(1)(a) parashikon se "*E drejta e autorit është një e drejtë pronësore e cila ekziston në vepra origjinale letrare, dramatike ose muzikore*"

[9] Kodi i Pronësisë Intelektuale të Francës, Neni. L112-1.

[10] Akti i Gjerman i i të Drejtave të Autorit, Neni 1.

[11] Neni 8(1) i Ligjit 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" (i ndryshuar).

[12] Kotgala, Manoj Isuru. '*Rethinking Originality I Copyright Law and Exploring the Potential for a Global Threshold'* (2016) Research Gate 2.
https://www.researchgate.net/publication/311377345_Rethinking_Originality_in_Copyright_Laë_and_Exploring_the_Potential_for_a_Global_Threshold

[13] Derclaye, Estelle. *Research Handbook on the Future of EU Copyright* (Edward Elgar Publishing 2009) 102

[14] Ricketson, Sam and Ginsburg Jane. *International Copyright and Neighboring Rights: The Berne Convention and Beyond* (Oxford University Press 2005) 8.87.

[15] Neni 2(1) i Konventës së Bernës, i referohet mbrojtjes së "*çdo krijimi në fushën letrare, shkencore dhe artistike, pavarësisht nga mënyra ose forma e shprehjes së tij, të tillë si....*"

[16] Neni 2(3) i Konventës së Bernës, *Përkthime, përshtatje, aranzhime muzikore dhe modifikime të tjera të një vepre letrare ose artistike do të mbrohen si vepra origjinale pa cenuar të drejtën e autorit në veprën origjinale*".

[17] Neni 2(5) i Konventës së Bernës, "*Koleksione veprash letrare ose artistike si enciklopeditë dhe antologji të cilat, për shkak të përzgjedhjes dhe renditjes së përmbajtjes së tyre, përbëjnë krijim intelektuale do të mbrohen si të tilla, pa cenuar të drejtën e autorit në secilën prej veprave që janë pjesë e koleksioneve të tilla*". Po ashtu, nenin. 14 bis, paragrafi 1, në lidhje me veprat kinematografike, i cili përcakton se: "*Pa cenuar të drejtën e autorit në çdo vepër që mund të ketë qenë e përshtatur ose*

autorit për veprat që përmbajnë krijimtari intelektuale, duke theksuar përshtatshmërinë për mbrojtje për aq kohë sa ato tregojnë krijimtari intelektuale të krijuesit të tyre dhe origjinalitet.[18] Sipas Prof. Ricketson, kërkesa për "krijime intelektuale" nuk zbatohet vetëm për nenin 2(5) të Konventës, për koleksionet e veprave letrare dhe artistike, por shtrihet në të gjithë përmbajtjen e nenit 2 të saj.[19] Konventa e Bernës ia lë ligjeve kombëtare vendosjen e kontureve të origjinalitetit. Kjo ka çuar në dallime midis shteteve për sa i përket përkufizimit dhe shkallës së origjinalitetit të kërkuar. Madje, pragu dhe zhvillimi i asaj që nënkupton origjinaliteti kryesisht janë vendosur nga gjykata të ndryshme në juridiksione të ndryshme, se sa përmes përkufizimeve të ofruara nga vetë legjislacioni. Po ashtu, edhe BE përgjithësisht nuk e ka përcaktuar kërkesën e origjinalitetit përmes akteve të tyre legjislative, megjithatë e ka zhvilluar standardin e tij përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë e cila mbikëqyr zbatimin dhe interpretimin uniform të ligjit të BE.

2. Qasje të rendeve *civil law* dhe *common law* në lidhje me kriterin e origjinalitetit

Kërkesat për kualifikim për mbrojtje nga e drejta e autorit ndryshojnë në varësi të llojit të krijimit. Megjithatë, ekzistojnë kushte të përgjithshme dhe përjashtime të përgjithshme. Ndër kushtet e përgjithshme të cilat janë konsideruar zakonisht të pranueshme[20] mund të përmenden, veprat duhet të përfaqësojnë një krijim intelektual personal dhe të pavarur (nga një autor njerëzor),[21] të kenë një shkallë të caktuar origjinaliteti (elementet krijues) dhe fiksimi i krijimit në një formë shprehjeje.[22] Ndërsa, përmbajtje që përgjithësisht përjashtohen nga mbrojtja përfshijnë idetë, procedurat, metodat e funksionimit dhe konceptet matematikore si të tilla.[23]

Si rrjedhojë, ekzistenca e karakterit krijues është një bazë e mirë për të gjurmuar origjinalitetin e një vepre, i cili si rregull është një kusht i domosdoshëm për mbrojtjen e saj. Parimi kryesor që ndiqet është se e drejta e autorit mbron shprehjen dhe jo idenë në vetvete e njohur me termin diktonomia ide-shprehje. Por duke qene se sikurse parashtruam më sipër, mungon një standard ndërkombëtar për minimumin e origjinalitetit, çdo shtet vendos vetë standardin e origjinalitetit që duhet të plotësojë një vepër, dhe shpesh janë nënvizuar dallime ndërmjet kritereve të përdorura në shtetet e *droit d'auteur* dhe traditës *copyright*.[24] Të parët insistojnë në gjurmën e personalitetit të autorit, duke i bashkangjitur origjinalitetit një qasjeje subjektive,[25] prej nga rrjedhin edhe të drejtat personale jo pasurore (morale) të autorëve të cilat zënë një vend mjaft të rëndësishëm në shtetet *civil law*. Ndërsa të dytët,

---

riprodhuar, një vepër kinematografike mbrohet si vepër origjinale. Pronari i të drejtës së autorit në një vepër kinematografike gëzon të njëjtat të drejta si autor i një vepre origjinale, duke përfshirë të drejtat e përmendura në nenin e mëparshëm".

[18] Gaffar, Hafiz and Albarashdi I, Saleh. *'Copyright Protection for AI-Generated Works: Exploring Originality and Ownership in a Digital Landscape*' (2024) Asian Journal of International Law 1 <https://www.cambridge.org/core/services/aop-cambridge-core/content/view/12B8B8D836AC9DDFFF4082F7859603E3/S2044251323000735a.pdf/copyright-protection-for-ai-generated-works-exploring-originality-and-ownership-in-a-digital-landscape.pdf> 18.

[19] Ricketson, Sam. *Threshold Requirements for Copyright Protection under the International Conventions* (2009). World Intellectual Property Organisation Journal 57.

[20] Diskutimet në lidhje qasjet dhe evoluimin e këtyre kushteve nuk janë objekt i këtij punimi.

[21] Frosio, Giancarlo. *Reconciling Copyright with Cumulative Creativity* (Edward Elgar Publishing 2018)16–18. Megjithatë, në doktrinën juridike debatet në lidhje me autorësinë për vepra e gjeneruara nga IA kane marrë një rëndësi të madhe.

[22] Brown, Evan. *Fixed Perspectives: The Evolving Contours of the Fixation Requirement in Copyright Law* (2014) 10 The Washington Journal of Law, Technology & Arts, 20. https://digitalcommons.laë.uë.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1223&context=ëjlta

[23] Neni 9 (2) i Traktatit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, Për të drejtën e autorit (WCT), miratuar në 20 dhjetor 1996. Republika e Shqipërisë ka aderuar në të me ligj Nr.8838, datë 22.11.2001 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Traktatin e OBPI së "Për të drejtën e autorit". Fletore Zyrtare Nr. 57 Dhjetor 2001.

[24] Strowel, Alain. *Droit d'Auteur et Copyright – Divergences et Convergences* (Bruylant/LGDJ 1993) 187.

[25] Gervais, Daniel J. 'Feist Goes Global: *A Comparative Analysis of the Notion of Originality in Copyright Law'* (2002) 49 Journal of the Copyright Society of the USA 968.

përkrahin më shumë një qasje objektive,[26] e cila mbështetet kryesisht në kritere objektive të tilla si aftësi përpjekje dhe punë të investuara për të krijuar veprën.

Sipas një autori, shtetet e traditës *civil law*, e vendosin më shumë theksin në marrëdhënien e qenësishme ndërmjet autorit dhe krijimit të tij, se sa në shpërblimin e punës dhe aftësive të investuara në krijimin e një vepre.[27] Kështu, shtetet e traditës *civil law*, me në krye Francën e trajtojnë origjinalitetin si "*ngulitja e personalitetit të autorit në vepër*" ose imputi personal që autori përfshin në vepër.[28] Për rrjedhojë, shtetet që i përkasin kësaj tradite kërkojnë jo vetëm që vepra të mos jetë e kopjuar, por edhe të përfshihen elemente të personalitetit të autorit, pra që autori të shpreh individualitetin e tij nëpërmjet veprës së tij. Kjo ndërlidhet me të drejtën e paternitetit, duke theksuar rëndësinë e lidhjes ndërmjet autorit dhe veprës. Qasje të ngjashme e shohim edhe në doktrinën Italiane.[29] Më tej, një komentues pohon se vendet tradicionalisht kontinentale priret të ketë një vlerësim më rigoroz të kërkesës së origjinalitetit.[30]

Ndërsa nga ana tjetër, sipas qasjes tradicionale të vendeve me traditë *common law*, historikisht koncepti origjinalitetit lidhej me teorinë "*sweat of the brow*". Sipas një autori, që një vepër të konsiderohet origjinale është e nevojshme të tregohet se është shpenzuar aftësi përpjekje dhe punë në realizimin e saj, më shumë se sa gjenialitet personal.[31] Edhe në praktikën e hershme gjyqësore në Britaninë e Madhe, kriteri i aftësisë, punës dhe gjykimit përdorej për të përcaktuar pragun e origjinalitetit.[32] Parimi bazë i jurisprudencës të shteteve që i përkisnin kësaj tradite përkrahte idenë se çdo krijim që përfshin punë ia vlen të mbrohet dhe sasia e punës së përfshirë nuk duhet të jetë mjaft e madhe. Më tej, sipas një qëndrimi, "origjinaliteti" nuk nënkupton "risi" apo një krijim "unik', por thjesht që autori ka krijuar veprën në mënyrë të pavarur duke ushtruar një shkallë aftësish, njohurish, pune krijuese, shije apo gjykim për ti dhënë asaj mbrojtjeje.[33] Megjithatë, kriteri i origjinalitetit ka evoluar, kështu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vetëm përdorja e thjeshtë e punës për krijimin e një vepre nuk shërben më si një parakusht për të përcaktuar origjinalitetin e një vepre apo për ta kualifikuar atë për mbrojtje nga e drejta e autorit.[34] Kjo qasje përputhet me teorinë utilitariste, duke synuar stimulimin e krijimtarisë për të promovuar progresin e shkencës dhe artet e dobishme.[35] Në disa raste gjykata në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka përfshirë edhe elementin minimal

[26] Drassinower, Abraham. *Sweat of the Brow, Creativity, and Authorship: On Originality in Canadian Copyright Law* [2003-2004] Sweat of the Brow, Creativity and Authorship: on Originality in Canadian Copyright Law 105-123.

[27] Gaffar, Hafiz and Albarashdi I, Saleh.*Copyright Protection for AI-Generated Works: Exploring Originality and Ownership in a Digital Landscape.* [2024] Asian Journal of International Law 1 <https://www.cambridge.org/core/services/aop-cambridge-core/content/view/12B8B8D836AC9DDFFF4082F7859603E3/S2044251323000735a.pdf/copyright-protection-for-ai-generated-works-exploring-originality-and-ownership-in-a-digital-landscape.pdf> 18.

[28] Gervais, Daniel J. *Feist Goes Global: A Comparative Analysis of the Notion of Originality in Copyright Law.* (2002) 49 Journal of the Copyright Society of the USA 968.

[29] Aliprandi, Simone. *Capire Il Copyright.* (Ledizioni 2014) 66.

[30] Goldstein, Paul and Hugenholtz, PB. *International Copyright: Principles, Law, and Practice* (Oxford University Press, Cop 2013) 192–193.

[31] Drassinower, Abraham. 'Sweat of the Brow, Creativity, and Authorship: On Originality in Canadian Copyright Law' [2004] Sweat of the Brow, Creativity and Authorship: on Originality in Canadian Copyright Law 105-123.

[32] Shih çështjen, Ladbroke (Football) Ltd. Vs Ëilliam Hill (Football) Ltd, All ER,1 964.

[33] Groves, Peter.*Copyright and Designs Law: A Question of Balance: The Copyright, Designs and Patents Act 1988.* (Graham & Trotman 1991) 21.

[34] Gaffar Hafiz and Albarashdi I, Saleh. *'Copyright Protection for AI-Generated Works: Exploring Originality and Ownership in a Digital Landscape'* [2024] Asian Journal of International Law 1 <https://www.cambridge.org/core/services/aop-cambridge-core/content/view/12B8B8D836AC9DDFFF4082F7859603E3/S2044251323000735a.pdf/copyright-protection-for-ai-generated-works-exploring-originality-and-ownership-in-a-digital-landscape.pdf> 15.

[35] E shkruar në vitin 1787, ratifikuar në vitin 1788 dhe në fuqi që nga viti 1789, Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara në nenin 1(8) (8) parashikon, *"Për të promovuar përparimin e shkencës dhe artet e dobishme, duke u siguruar për kohë të kufizuar autorëve dhe shpikësve të drejta ekskluzive për shkrimet dhe shpikjet e tyre përkatëse"*. Filozofi e ngjashme qëndron edhe në themel të politikave së të drejtës së autorit të Mbretërisë së Bashkuar që nga Statuti i Anës, në titullin e gjatë të Ligjit për të Drejtën e Autorit të vitit 1709: "*Një akt për inkurajimin e të mësuarit, duke ua dhënë kopjet e librave të printuar autorëve ose blerësve të këtyre kopjeve të përmendura aty*."

të krijimtarisë në kuptimin e origjinalitetit. Kështu, kriteri "*sweat of the brow*" që më parë mjaftonte në disa shtete për të përmbushur kërkesën e origjinalitetit, është përjashtuar shprehimisht në çështjen Feist Publn's, Inc. v. Rural Tel. Serv. Co., Gjykata e Lartë Amerikane, mbajti qëndrimin se "*Sine qua non*" i të drejtës së autorit është origjinaliteti. (...) termi origjinal që përdoret në të drejtën e autorit, nuk nënkupton risi, ai kërkon vetëm që vepra të krijohet në mënyrë të pavarur nga autori (në krahasim me kopjimin nga vepra të tjera) dhe të ketë "*të paktën një shkallë minimale krijimtarie*."[36] Sipas Gjykatës, "*niveli i nevojshëm i krijimtarisë është jashtëzakonisht i ulët*" dhe një vepër duhet vetëm "*të zotërojë një shkëndijë krijuese, pavarësisht se sa e ulët, modeste apo e dukshme mund të jetë ajo*".[37] Po ashtu, një tjetër qasjeje në doktrinën Amerikane është, që të gëzojë mbrojtje nga e drejta e autorit, vepra duhet të jetë origjinale.[38] Ky term përfshin dy koncepte të dallueshme, të cilat duhet të përmbushen. E para është që vepra duhet të jetë produkt i përpjekjeve krijuese të pavarura të autorit. Në këtë kuptim termi "origjinal" përdoret si e kundërta e "kopjes" dhe së dyti vepra duhet të ketë të paktën një minimum vlere krijuese. Në këtë kuptim, termi "origjinal" do të shihet si e kundërta e "të zakonshmes" ose "rutinës".[39] Kështu, kërkesa e origjinalitetit lidhet më tepër me faktin që vepra të jetë produkt i pavarur i autorit dhe jo thjesht kopje ose variacione minimale të një vepre ekzistuese.[40]

3. Tendenca për harmonizimin e kriterit të origjinalitetit

Legjislacioni i BE për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, përfshin disa Direktiva dhe Rregullore.[41] Procesi i harmonizimit me *acquis communitarie* në këtë fushë ka sjellë disa ndryshime në sistemet e brendshme ligjore të Shteteve Anëtare. Megjithatë, origjinaliteti pavarësisht se është një kriter themelor në mbrojtjen e të drejtave të autorit është harmonizuar në një masë mjaft të kufizuar.[42]

Një nga aktet kryesore që synon harmonizimin e legjislacionit në këtë fushë, Direktiva e Shoqërisë së Informacionit,[43] nuk e përfshin kërkesën e origjinalitetit në mënyrë specifike në ndonjë prej dispozitave të saj. Por ai përmendet në Direktivën për Programet Kompjuterike, e cila përmban se: "*programet kompjuterike mbrohen, me kusht që të jenë origjinale*".[44] Po ashtu, Direktiva për Afatet e Mbrojtjes, në lidhje me veprat fotografike, parashikon se "*fotografitë mbrohen nëse janë origjinale dhe për këtë arsye në masën që paraqesin rezultatin e krijimit intelektual të autorit*".[45] Ndërsa, Direktiva e Bazës së të Dhënave, përmban se: "*bazat e të dhënave që për nga zgjedhja ose rregullimi i materialit përbën një krijim intelektual të autorit, mbrohet si e tillë nga e drejta e autorit. Për të përcaktuar nëse do të sigurohet një mbrojtje e tillë bazave të të dhënave, nuk zbatohen kritere të*

---

[36] Në çështjen e Gjykatës se Lartë të Shteteve të Bashkuar, *Feist Publications, Inc. v. Rural Telephone Service Co.*, 499 U.S. 340 (1991), në të cilën përmendet: "*Neni I, § 8, cl. 8, I Kushtetutës kërkon origjinalitet si një prekuizitë për mbrojtjen nga e drejta e autorit. Kjo kërkesë kushtetuese ka nevojë për krijime të pavarura plus një minimum krijimtarie"*

[37] *Feist Publications v. Rural Telephone Service Co.*, 499 U.S. 340, 345–46 (1991),

[38] Bently, Lionel and Sherman, Brad. *Intellectual Property Law* (Oxford University Press 2004) 125.

[39] Schechter Roger E, and Thomas, John R. *Intellectual Property* (West Academic Publishing 2003) 73.

[40] Bouchoux, Deborah E. *Intellectual Property for Paralegals: The Law of Trademarks, Copyrights, Patents, and Trade Secrets* (Delmar Cenage Learning 2013) 193.

[41] Konkretisht 13 Direktiva dhe 2 Rregullore, shih: https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/copyright-legislation

[42] Van Gompel, Stef, Lavik, Erlend.Quality, *Merit, Aesthetics and Purpose: An Inquiry into EU Copyright Laë's Escheëal of Other Criteria than Originality*, në Revue Internationale du Droit d'Auteur (RIDA), 236, 2013, 100-295. E aksesuar më 22 Shkurt 2024 në https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2326425

[43] Direktiva 2001/29/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 22 maj 2001, "Mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në shoqërinë e informacionit", Celex: 32001L0029, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 167, datë 22.6.2001.

[44] Neni 1(3) Direktiva 2009/24/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 prill 2009, "Mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike", Celex: 32009L0024, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 111, datë 5.5.2009.

[45] Neni 6 i Direktivës 2006/116/KE, të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, "Mbi afatin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura" e amenduar", Celex: 32006L0116; Fletorja Zyrtare e BE-së, L 372, datë 27.12.2006. Po ashtu, shih paragrafët 87-94, e çështjes *Eva-Maria Painer v Standard VerlagsGmbH and Others* (2011) C-145/10.

tjera"[46]. Kështu, në lidhje me programet kompjuterike, bazat e të dhënave dhe fotografitë, origjinaliteti përshkruhet si "krijim intelektual i vetë autorit".[47] Në këto raste, ligjvënësi komunitar e ka konsideruar të nevojshme të merren parasysh veçoritë ose natyra e veçantë teknike e kategorisë së veprës në fjalë. Ndërsa në lidhje me kategoritë e tjera të veprave, të tilla si kompozime, filma ose libra, nuk ka patur indikacione se mungesa e harmonizimit të konceptit të origjinalitetit të ketë shkaktuar ndonjë problem për funksionimin e tregut të brendshëm. Ndaj, ndërhyrja legjislative nuk është parë e nevojshme në këtë fazë".[48]

Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm e ka luajtur Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Europian (GJED-ja) e cila ka vepruar në mënyrë pro aktive ndaj harmonizimit të së drejtës së autorit, duke adoptuar një nocion të origjinalitetit në mbarë BE-në sidomos lidhur me zbatimin e Direktivës të Shoqërisë së Informacionit.[49] Qasja gjyqësore ka zhvilluar kriterin e "*krijimit intelektual të vetë autorit*". Ky kriter duhet të interpretohen në përputhje me Recitalin 9 të Direktivës së Shoqërisë së Informacionit, i cili përfshin qëllimin e mbrojtjes së të drejtave të autorit, duke nënvizuar ruajtjen dhe zhvillimin e krijimtarisë e cila nuk i shërben vetëm interesave të autorëve por edhe të gjithë shoqërisë. GJED-ja gjithashtu, ka luajtur një rol të rëndësishëm në zgjerimin e aplikimit të këtij standardi për të përfshirë një gamë të gjerë veprash, duke rritur mundësinë e përfshirjes edhe të veprave të gjeneruara nga AI. Në kuadër të praktikës së GJED një nga çështjet që pati mjaft ndikim në përcaktimin e kriterit të "*krijimit intelektual të vetë autorit*" si kërkesë e zbatueshme për të gjitha llojet e veprave është vendimi *Infopaq International A/S v Danske Dagblades Forening* i cili përcaktoi se edhe një sekuencë prej vetëm 11 fjalësh mund të plotësojë kriterin për të qenë një krijimtari intelektuale e autorit. Në këtë vendim Gjykata u shpreh se: "*pjesët e ndryshme të një vepre gëzojnë mbrojtje me kusht që ato të përmbajnë elemente që janë shprehje e krijimit intelektual të autorit të veprës*" më tej Gjykata komentoi se: "*fjalët e tilla në vetvete nuk përbëjnë elementë të mbrojtur, por kombinimi i tyre përmes përzgjedhjes, zgjedhjes dhe sekuencës mund të paraqes shprehjen e krijimtarisë së autorit*".[50] Po ashtu, kërkesa e origjinalitetit nuk kërkon ndonjë meritë artistike. Por ajo fokusohet nëse autori ka mundur të shprehë aftësitë e tij krijuese në krijimin e veprës duke bërë zgjedhje të lira dhe krijuese, duke e vulosur kështu veprën me prekjen e tij personale. Në ketë vendim, i cili u pasua nga të tjerë në vijim u miratua si standard për origjinalitet në të drejtën e autorit të BE-së "*krijim intelektual i vetë autorit*", edhe për lëndë të ndryshme nga programet kompjuterike, bazat e të dhënave dhe fotografitë.

4. Diskutime mbi origjinalitetin në kuadër të krijimeve të gjeneruara nga IA

Me përparimin e teknologjisë, zhvillimet e fundit juridike në të drejtën e autorit përfshijnë diskutime jo vetëm me çështjet që lidhen me procesin krijues të këtyre veprave, autorësinë dhe pronësinë por edhe me origjinalitetin e veprave të gjenerua nga IA. Inteligjenca artificiale gjeneruese është një nga temat e nxehta në fushën e të drejtave të autorit sot. Këto sisteme të IA po bëhen një tipar i rregullt në jetën tonë në fusha të ndryshme, në formën e asistentëve virtualë si Siri e Alexa, në rekomandime të kërkimit online, në diagnoza mjekësore, në përkthime automatike e kështu me rrallë. AI gjithashtu, ka marrë një rol mjaft të rëndësishëm përdorimi edhe në fushën e krijimtarisë për të gjeneruar vepra arti si piktura, shfaqje muzikore, video, tekste, fjalime e të tjera.

Një moment thelbësor në këtë debat ligjor dhe etik në evoluim, u shënua nga një vendim i gjykatës së distriktit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila mbajti qëndrimin se një vepër arti pamor, e krijuar nga IA pa

[46] Neni 3(1) i Direktivës 96/9/ KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 mars 1996, "Mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave", Celex: 31996L0009, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 77, datë 27.3.1996. Shih edhe paragrafët 29 e 37-39 të çështjes *Football Dataco Ltd e altri contro Yahoo! UK Ltd e altri* (2012) C-604/10.

[47]Rosati, Eleonora. *EU Copyright Harmonization: The Case of Originality* (2012) 41.

[48] EC, Commission Staff Working Paper on the Review of the EC Legal Framework in the Field of Copyright and Related Rights SEC (2004) 995, Brussels 13.

[49] Rosati, Eleonora.*Originality in EU Copyright* (Edward Elgar Publishing 2013); Rosati, Eleonora. *Why Originality in Copyright Is Not and Should Not Be a Meaningless Requirement.* (2018) 13 Journal of Intellectual Property Law & Practice 597-598.

[50] *Infopaq International A/S v Danske Dagblades Forening* (2009) C-5/08 (ECR I-6569).

kontributin e njeriut nuk mund të gëzojë mbrojtje nga e drejta e autorit sipas ligjit të SHBA-së[51]. Ky vendim nxori në pah qëndrimin aktual të sistemit ligjor në lidhje më autorësinë dhe pronësinë e përmbajtjes së krijuar nga AI, duke pohuar parimin se vetëm veprat me autorë njerëzor kualifikohen për mbrojtje nga e drejta e autorit. Vendimi paraqiti një pikë kyçe në diskursin më të gjerë, se si legjislacioni për të drejtat e autorit duhet të evoluojë për të adresuar sfidat unike të paraqitura nga IA në fushën krijuese.

Po ashtu, GJED në çështjen *Cofemel v G-Star,* synoi të hedhë dritë mbi konceptin e origjinalitetit në kontekst të veprave të gjeneruara nga IA. Në këtë rast gjykata theksoi se përmbajtja nuk mund të konsiderohet origjinale nëse realizimi i tij i është dedikuar vetëm konsideratave teknike, rregullave apo kufizimeve të tjera që nuk lejojnë hapësire për liri krijuese. Gjykata nënvizoi se prania e lirisë krijuese është thelbësore për një përmbajtje të tillë që të arrij nivelin e kërkuar të origjinalitetit dhe të kualifikohet si një vepër e mbrojtur.[52]Këto shembuj sugjerojnë, se nuk do të kemi përmbushjen e kriterit të origjinalitetit në rast se përmbajtja është gjeneruar vetëm nga aplikimi i IA ose i paracaktuar nga rregulla apo kufizime të cilat nuk lënë vend për krijimtari njerëzore. Si rrjedhim, veprat e krijuara plotësisht automatikisht nuk e plotësojnë kriterin për mbrojtje nga e drejta e autorit. Ndërsa, në rast se veprat krijohen me ndihmën dhe asistencën e IA, situata mund të shfaqet e ndryshme. Sipas një qasjeje, në këtë rast nëse do të kishte prezencë të përfshirjes dhe imputit të njeriut apo gjurmës së krijimtarisë njerëzore, vepra mund të konsiderohet e kualifikuar për mbrojtje nga e drejta e autorit.[53] Kjo pasi kontributi dhe prekja njerëzore luajnë një rol thelbësor në përmbushjen e kërkesës së origjinalitetit.[54]

Një tjetër diskutim i mprehtë ligjor që është shfaqur në fushën e të drejtave të autorit në BE por edhe në SHBA, ka të bëjë me përdorimin e veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit për të trajnuar modelet gjeneruese të IA. Nëse ky përdorim përbën shkelje të të drejtave të autorit apo do të përfshihet në kuadër të përjashtimeve dhe kufizimeve në ushtrimin e të drejtave të autorit të përfshira nga Direktivat e BE[55] ose në kuadër të përdorimin e drejtë "*fair use*" në SHBA[56].

Në BE, zhvillimi i inteligjencës artificiale gjeneruese solli nevojën e rishqyrtimit dhe rregullimin e mënyrës se si duhet të kategorizohet dhe t'u caktohet përgjegjësia ofruesve dhe përdoruesve të sistemeve të IA. Akti Inteligjenca Artificiale e re (Akti IA) i propozuar nga Komisioni Evropian si pjesë e Strategjisë Digjitale, synon të rregullojë zhvillimin, marketingun dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale (IA) në Bashkimin Evropian. Kjo konsiderohet si iniciativa e parë botërore që ofron një kornizë ligjore për IA. Akti i IA është paraqitur më 21 prill 2022, në dhjetor të vitit 2023 u arrit një marrëveshje politike, në maj të vitit 2024 Këshilli dha dritën jeshile për miratimin e tij dhe në 12 korrik të vitit 2024 ai u publikua në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian.[57] Akti i IA ndjek një qasje "të bazuar në rrezik", që do të thotë se sa më i lartë të jetë rreziku për të shkaktuar dëm në shoqëri, aq më të rrepta janë rregullat. Ai synon të sigurojë që sisteme të IA të vendosura ose të

[51] *Stephen Thaler, v Shira Perlmutter, Register of Copyrights and Director of the United States Copyright Office, et al* (2023, United States District Court, District of Columbia).

[52] *Cofemel – Sociedade de Vestuário SA v G-Star Raw CV* (2019) C-683/17 EU pg 31.

[53] Marttinez, Nicole. *Can an AI Machine Hold Copyright Protection over Its Work.* [2017] Artreprenuer Art Law Journal. Shih në: https://alj.artrepreneur.com/al-machine-copyright/.

[54] Gaffar Hafiz and Albarashdi, Saleh. *Copyright Protection for AI-Generated Works: Exploring Originality and Ownership in a Digital Landscape.* [2024] Asian Journal of International Law 1 <https://www.cambridge.org/core/services/aop-cambridge-core/content/view/12B8B8D836AC9DDFFF4082F7859603E3/S2044251323000735a.pdf/copyright-protection-for-ai-generated-works-exploring-originality-and-ownership-in-a-digital-landscape.pdf> 22.

[55] Shih nenin 4 të Direktivës së të Drejtave të Autorit në Tregun Unik Digjital dhe nenin 5 të Direktivës për Shoqërinë e Informacionit.

[56]*Authors Guild v HathiTrust* (United States District Court for the Southern District of New York, United States Court of Appeals for the Second Circuit); *The Authors Guild Inc, et al v Google, Inc* (United States District Court for the Southern District of New York, United States Court of Appeals for the Second Circuit).

[57]Rregullorja (BE) 2024/1689 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 qershor 2024 që përcakton rregulla të harmonizuara për inteligjencën artificiale dhe amendon Rregulloret (KE) Nr 300/2008, (BE) Nr 167/2013, (BE) Nr. /2013, (BE) 2018/858, (BE) 2018/1139 dhe (BE) 2019/2144 dhe Direktivat 2014/90/BE, (BE) 2016/797 dhe (BE) 2020/1828 (Akti i Inteligjencës Artificiale). PE/24/2024/REV/1 OJ L, 2024/1689, 12.7.2024, ELI: http://data.europa.eu/eli/reg/2024/1689/oj

përdorura në tregun e BE-së të jenë të sigurta dhe të respektojnë të drejtat themelore. Akti i IA pritet të bëhet një model për qeverisjen e IA në mbarë botën.[58]

Edhe pse ky akt, nuk është menduar posaçërisht për të rregulluar aspektet në lidhje më të drejtat e autorit, ai paraqet ndërlidhje me të duke përfshirë rregullime balancuese të mbrojtjes së të drejtave të autorit me promovimin e inovacionit dhe kërkimit. Recitali 105 i tij, nënvizon rëndësinë e marrjes së autorizimit nga mbajtësit e të drejtave për çdo përdorim të përmbajtjes me të drejtë autori në trajnimin e modeleve të AI, përveç nëse zbatohen përjashtimet dhe kufizimet përkatëse të së drejtës së autorit. Ai thekson dispozitat e Direktivës (BE) 2019/790,[59](në vijim Direktiva e të Drejtave të Autorit në Tregun Unik Digjital) e cila prezantoi përjashtime dhe kufizime që lejojnë riprodhimet dhe ekstraktime të veprave për qëllime të nxjerrjes së tekstit dhe të dhënave në kushte të caktuara në nenin 4 të saj. Megjithatë, ai sqaron se mbajtësit e të drejtave mund të zgjedhin të rezervojnë të drejtat e tyre për të parandaluar nxjerrjen e tekstit dhe të dhënave (opsioni "opt out"), përveç nëse është për qëllime kërkimore shkencore.[60] Recitali 106 i Aktit të IA, thekson domosdoshmërinë që ofruesit e modeleve të IA për qëllime të përgjithshme të sigurojnë përputhjen me detyrimet përkatëse të Aktit të IA, kur vendosin produktet e tyre në tregun e Bashkimit Europian. Kjo kërkesë përfshin krijimin e politikave për t'iu përmbajtur ligjeve të Bashkimit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to, pavarësisht se ku ndodhin aktivitetet përkatëse të të drejtave të autorit që lidhen me trajnimin e këtyre modeleve të IA. Siç parashikohet në recital, "*Çdo ofrues që vendos një model për qëllime të përgjithshme të AI, në tregun e Bashkimit duhet të përmbushë këtë detyrim, pavarësisht nga juridiksioni në të cilin zhvillohen aktet përkatëse për të drejtat e autorit që mbështesin trajnimin e atyre modeleve të AI me qëllime të përgjithshme*". Duke detyruar respektimin e standardeve të së drejtës së autorit të Bashkimit Europian, Rregullorja kërkon të parandalojë çdo ofrues që të fitojë një avantazh konkurrues duke aplikuar standarde më të ulëta të së drejtës së autorit.[61] Kjo siguron që të gjithë ofruesit t'u përmbahen rregullave të qëndrueshme të së drejtës së autorit, duke promovuar kështu konkurrencën e ndershme dhe duke mbrojtur interesat e krijuesve dhe mbajtësve të të drejtave.

Një nga aspektet kryesore të Aktit të IA është vendosja e kërkesave të transparencës për ofruesit. Recitali 107 nënvizon rëndësinë e transparencës në sigurimin e llogaridhënies dhe lehtësimin e zbatimit të të drejtave të autorit. Në mënyrë të veçantë, ai kërkon që ofruesit e modeleve të IA për qëllime të përgjithshme, të hartojnë dhe të vënë në dispozicion të publikut një përmbledhje mjaft të detajuar të përmbajtjes së përdorur për trajnimin e modeleve të tyre.[62] Kjo përmbledhje pritet të ofrojë informacion gjithëpërfshirës në lidhje me grupet e të dhënave të përdorura, duke përfshirë burimet publike dhe private, për t'u mundësuar mbajtësve të të drejtave të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë efektive. Zyra e IA duhet të zhvillojë një model të standardizuar për përmbledhjen e të dhënave të trajnimit, duke siguruar thjeshtësi dhe efektivitet duke lejuar ofruesit të paraqesin informacionin e kërkuar në formë narrative. Në vijim, në përputhje me Recitalin 108, Zyra e IA duhet gjithashtu të monitorojë pajtueshmërinë me këto detyrime pa kryer vlerësime individuale të pajtueshmërisë me të drejtën e autorit për secilën pjesë të të dhënave të trajnimit.[63] Ndërsa, Recitali 109 pranon nevojën për proporcionalitet në kërkesat e pajtueshmërisë, veçanërisht për SME-të dhe startup-et.[64] Kjo dispozitë synon të lehtësojë aktivitetet kërkimore jo tregtare duke siguruar që interesat e mbajtësve të të drejtave të mbrohen në mënyrë adekuate.

Si përfundim, mund të themi se Akti i AI përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në rregullimin e ndërthurjes së ligjit të inteligjencës artificiale dhe të drejtave të autorit. Megjithatë rrugëtimi i tij për t'u bërë

---

[58] Shih: https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2024/05/21/artificial-intelligence-ai-act-council-gives-final-green-light-to-the-first-ëorldëide-rules-on-ai/?utm_source=substack&utm_medium=email

[59] Direktiva e (BE) 2019/790 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 Prill 2019 "Mbi të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të në tregun unik digjital" e cila ka ndryshuar Direktivat 96/9/KE dhe 2001/29/KE, Celex: 32019L0790; Fletorja Zyrtare e BE-së, L 130, datë 17.5.2019.

[60] Recitali 105 i Aktit të Inteligjencës Artificiale

[61] Recitali 106 i Aktit të Inteligjencës Artificiale.

[62] Recitali 107 i Aktit të Inteligjencës Artificiale.

[63] Recitali 108 i Aktit të Inteligjencës Artificiale.

[64] Recitali 109 i Aktit të Inteligjencës Artificiale.

plotësisht i zbatueshëm nuk ka përfunduar ende, pasi pritet që akti të hyj në fuqi në përputhje me parashikimet e nenit 113 të tij.

5. Aspekte të origjinaliteti në kuadrin kombëtar

Në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025, qeveria shqiptare ka shprehur vizionin e saj për një sistem më të fortë të pronësisë intelektuale, duke synuar mbrojtjen efektive të tij, nxitjen e krijimtarisë dhe risinë në shërbim të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe avancimit shkencor në Republikën e Shqipërisë.[65] Në këtë drejtim, ligji Nr. 35/2016, Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to (i ndryshuar),[66] është përgjithësisht i përfaruar me legjislacionin Europian edhe si rezultat i përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit[67]. Konkretisht, ai është plotësisht i përafruar me 7 (shtatë) Direktiva të Bashkimit Europian, ndërsa 4 (katër) Direktiva të tjera janë transpozuar pjesërisht.[68] Po ashtu, me qëllim zbatimin e duhur të tij, ligji plotësohet dhe specifikohet me akte të shumta nënligjore.[69]

Ligji Nr. 35/2016 (i ndryshuar), përfshin një kuadër rregullues më të plotë dhe efektiv në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to duke reflektuar edhe nevojat e kohës. Megjithatë, përveç përmendjes të karakterit intelektual dhe origjinal të krijimit, në disa prej dispozitave të tij, [70] ai nuk jep një përkufizim të shprehur mbi origjinalitetin. Një përkufizim i tij gjendej në ligjin e mëparshëm Nr. 9380/2005 (i ndryshuar), ku neni 4/22 përmbante përkufizimin se: "*Origjinalitet i një vepre, nënkupton shfaqjen e botës së brendshme të një autori, pa kopjuar, në tërësi ose në një pjesë të rëndësishme, një krijim tjetër"*.[71]

Kërkesa e origjinalitetit shërben si gur themeli për mbrojtjen nga e drejta e autorit edhe në Shqipëri. Origjinaliteti mund të vlerësohet të ketë dy role thelbësore – jo vetëm si një filtër përzgjedhës që përcakton se cilat krijime duhet të gëzojnë mbrojtje nga legjislacioni, por edhe si faktor ndikues kur analizohet nëse kemi të bëjmë me një shkelje të të drejtave të autorit. Kur përdorimi i paautorizuar ka të bëjë vetëm me disa elementë të veprës, dhe jo me veprën në tërësi, do të konsiderohet shkelje vetëm nëse elementët e përdorur plotësojnë kushtin e origjinalitetit.

Kështu, në një rast konflikti gjyqësor, ku objekt mosmarrëveshje ishin veprat Libri "Klubi Karavasta" dhe Filmi "Bota". Gjykata me të drejtë, fillimisht vlerësoi nëse Libri "Klubi Karavasta" është krijim intelektual i autorit paditës, pasi një krijim që nuk është origjinal nuk mbrohet e për pasojë nuk mund të kërkohet konstatimi i shkeljes së një të drejte bazuar në legjislacionin për të drejtat e autorit. Në mbështetje të kësaj, gjykata u shpreh se: që një vepër të konsiderohet krijim origjinal i autorit duhet të përmbush disa kritere: -Të ketë karakteristika individuale që i përkasin autorit; - Të ketë veshur një formë të caktuar (forma e shprehjes). Në interpretim të nenit 8 të Ligjit Nr. 35/2016, gjykata mbajti në konsideratë gjurmën e personalitetit të autorit mbi vepër, duke analizuar llojin e kontributit të autorit në vepër në lidhje me temën e trajtuar, idenë e trajtuar, personazhet, mënyrën si janë trajtuar, frymëzimin për të shkruar librin (eksperienca personale) të cilat tregojnë krijimin intelektual të tij. Më pas ajo

---

[65] Vendim Nr.350, datë 26.05.2022, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025", Fletore Zyrtare Nr.85, datë 7 Qershor 2022.

[66] Ligj 35/2016, Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to. Fletore Zyrtare Nr.64 datë 20.04.2016. ndryshuar me ligjin Nr. 37/2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" Fletore Zyrtare Nr. 69 datë 11.05.2022

[67] Ligji Nr. 9590, datë 27.07.2006, Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve Anëtare të tyre, të njërës pjesë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër. L. 107 / 166, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 28.04.2009. (Sipas Nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Shqipëria është e detyruar të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me acquis-në e BE-së).

[68] Shih footnot (1) të Ligjit 35/2016, Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to (i ndryshuar).

[69] Pothuajse 17 (shtatëmbëdhjetë) akte nënligjore pasuan hyrjen në fuqi të ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.

[70] Shih për shembull nenin 8 (1), neni 9, nenin 13, nenin 88 të Ligjit 35/2016 (i ndryshuar).

[71] Neni 4/22 i Ligjit Nr. 9380 datë 28.04.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të" (i ndryshuar). I shfuqizuar tashmë.

shtroi pyetjen nëse ka ngjashmëri ndërmjet dy veprave.[72] Në kushtet e identifikimit të ekzistencës apo jo të ngjashmërive të veprave dhe për shkak te njohurive specifike që nevojiten në këtë drejtim, Gjykata në mbështetje te nenit 224/a te Kodit te Procedurës Civile mund të ndihmohet nga ekspertë të fushës. Ky shembull sugjeron, se gjykata shqiptare ka ndjekur qasjen GJED, në interpretimin e origjinalitetit.

Megjithatë, në praktikën gjyqësore jo gjithmonë është vlerësuar dhe interpretuar origjinaliteti i veprës. Kështu, në një rast praktik ku pretendohej cenimi i të drejtave të autorit mbi një vepër fotografike, pjesë e një koleksioni prej shtatë të tillash. Gjykata, nuk parashtroi ndonjë arsyetim në lidhje me origjinalitetin e veprës, duke e konsideruar të mirëqenë faktin se fotografitë përfshihen në kuadrin e veprave artistike duke qene se këto të fundit ishin të regjistruar më parë në Zyrën Shqiptare të të Drejtave të Autorit dhe si rrjedhojë duhet ta kishin plotësuar këtë kriter.[73] Një qasje e tillë mund ta bëjë arsyetimin gjyqësor të paplotë por edhe mund të jetë objekt kritikash në lidhje momentin kur fillon mbrojtja e një vepre. Rendi ynë juridik, në përputhje me standardet minimale të Konventës së Bernës zbaton parimin e mbrojtjes automatike pa asnjë formalitet të të drejtave të autorit.[74] Regjistrimi i veprave me të drejtë autori është vullnetar dhe ka efekt ligjor derisa me vendim gjyqësor të provohet e kundërta.[75]

Më tej, në vlerësimin e origjinalitetit, nuk duhet menduar se vepra e një autori duhet të ketë gjithmonë një vlerë të veçantë letrare, artistike apo shkencore me qëllim që të konsiderohet origjinale. Sipas një "Udhëzuesi për Konventën e Bernës "*... në rast mosmarrëveshje nuk i takon gjykatës të vlerësojë vlerën artistike apo aspektin kulturor të një vepre*".[76] Pra merita ose cilësia e veprës është një koncept subjektiv që vlerësohet nga kritikët dhe jo nga ligji. Në vijim, mund të thuhet po ashtu se krijimi i një vepre nuk është i kufizuar vetëm në subjekte që përfaqësojnë sferën e intelektualëve, por mund të realizohet nga çdo person, pavarësisht nivelit të tij të arsimimit ose edukimit. Prandaj, e drejta e autorit u jep mbrojtje të gjitha shprehjeve krijuese, letrare ose artistike, duke përfshirë krijimet e autorëve me një reputacion mjaft të njohur siç janë "gjenitë", si dhe veprat e krijuesve pa formim akademik. E rëndësishme është që vepra të përfshijë një minimum vlere krijuese,[77] pavarësisht nga vlera e saj ose edhe qëllimi i përdorimit.

Disa studiues të së drejtës, e lidhin karakterin krijues, tradicionalisht me dy komponent thelbësor: origjinalitetin dhe risinë.[78] Megjithatë, në shumicën e shteteve, vepra e autorit nuk duhet të sjellë patjetër risi, të jetë kryevepër ose të ketë merita estetike të veçanta për të përmbushur kërkesat e origjinalitetit. Pra, duhet të bërë dallimi midis origjinalitetit dhe risisë (stricto sensu), e cila është kërkesë e rëndësishme e shpikjeve për tu patentuar

Së fundi, origjinaliteti i veprës nuk duhet ngatërruar me karakterin e saj origjinal, pasi kuptohet se vepra origjinale është ajo e krijuar fillimisht. Pra, vepër origjinale që nuk ka një marrëdhënie varësie me një vepër tjetër para ekzistuese, siç është rasti me "veprat e prejardhura" (si përshtatje, përkthime apo përmbledhje). Këto vepra për të gëzuar mbrojtje, duhet të plotësojnë edhe kërkesën e origjinalitetit edhe nëse nuk janë vepra origjinare, por derivative. Si Konventa e Bernës,[79] edhe legjislacioni për të drejtat e autorit[80] i mbron veprat e prejardhura të cilat karakterizohen nga origjinaliteti. Si rrjedhojë, vepra duhet të jetë një krijim që karakterizohet nga origjinaliteti, tërësia e elementeve që e bëjnë atë të dallueshme dhe të evidentueshëm nga çdo krijim e vepër tjetër e bërë deri në atë moment, pavarësisht nëse është origjinale apo e prejardhur.[81]

---

[72] *Vendim Nr3458 datë 14.05.2019* (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë).
[73] *Vendim Nr 1391 datë 09.06.2016* (Gjykata e Apelit Tiranë).
[74] Neni 17 i Ligjit 35/2016 (i ndryshuar).
[75] Neni 18 i Ligjit 35/2016 (i ndryshuar).
[76] WIPO, 'Guide to the Berne Convention' 13.
[77] Jane C Ginsburg. *An Overview of Copyright Law* (Oxford Handbook of Intellectual Property 2016) 6.
[78] Ricolfi, Marco, Spada, Paolo. Auteri, Paolo. *Diritto Industriale. Proprietà Intellettuale e Concorrenza,* vol. II (Giappichelli 2005) 498.
[79] Neni 2(3) i Konventës së Bernës, 1971 Teksti i Parisit.
[80] Neni 9 i Ligjit Nr. 35/2016 (i ndryshuar).
[81] Semini, Mariana. *E Drejta E Autorit në Shqipëri* (Skanderbeg Books 2009) 59.

6. Konkluzione

Qëllimi kryesor i legjislacionit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to është të ruajë një ekuilibër midis mbrojtjes së të drejtave të autorëve si një formë nxitjeje për krijuesit dhe në të njëjtën kohë mbrojtjes së interesit publik në qasjen e këtyre veprave. Si rrjedhojë, të drejtat e autorit mbrojnë shprehjet origjinale dhe jo idenë në vetvete dhe origjinaliteti është *sine qua non* i kësaj mbrojtjeje. Ai shihet si një nga konceptet kryesore dhe është pjesë e justifikimit themelor për sistemin ligjor të mbrojtjes së të drejtave të autorit. Por, duhet përmendur se përveç tij edhe kushtet e tjera duhet të plotësohen në mënyrë që një krijim të gëzojë mbrojtje nga legjislacioni për të drejtat e autorit.

Përpjekjet për ti dhënë një përkufizim origjinalitetit kanë çuar në ngritjen e dy shkollave të mendimit, e para i ka rrënjët në traditën e *common law*, tradicionalisht përkrahëse e doktrinës "*sweat of brow*" por me zhvillime drejt qasjes së minimumit të krijimtarisë. Ndërsa e dyta, e lidhur me juridiksionet e *civil law*, e cila kryesisht përkrah përpjekjet krijuese, duke theksuar gjurmën e personalitetit të autorit në vepër, përgjithësisht e ndjekur edhe në praktiken gjyqësore në Shqipëri.

Kjo qasje ka pasur mbështetje të nënkuptuar nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian dhe disa instrumente ndërkombëtare. Megjithatë, praktika gjyqësore ka treguar se kjo kërkesë është mjaft elastike duke mbajtur në konsideratë edhe llojin e veprave objekt gjykimi. Në këtë drejtim, Gjykata e Drejtësisë ka luajtur një rol proaktiv në përcaktimin e standardit të origjinalitetit si dhe zgjerimin e aplikimit të këtij standardi për të përfshirë një gamë të gjerë veprash, duke rritur kështu mundësinë e përfshirjes edhe të veprave të gjeneruara nga IA. Megjithatë, GJED, ka sqaruar se prezenca e krijimtarisë njerëzore dhe zgjedhjet e lira janë thelbësore për plotësimin e kriterit të nevojshëm të origjinalitetit për qëllim mbrojtjeje nga e drejta e autorit.

Në përgjithësi, çështja e mbrojtjes së krijimeve të gjeneruara nga IA dhe kriteri i origjinalitetit të tyre ka nxitur interpretime të ndryshme ligjore dhe debate të konsiderueshme. Ku disa shtete mbajnë një qëndrim më liberal për mbrojtjen e veprave të gjeneruara nga IA duke përkrahur një qasje gjithëpërfshirëse dhe largpamëse të të drejtave të autorit si përgjigje e teknologjive në zhvillim. Ndërsa, disa të tjera për shkak dhe të formulimeve tradicionale të legjislacionit të tyre për të drejtat e autorit, mbeten më skeptike në ketë drejtim.

Së fundmi, zhvillimet ligjore në BE dhe miratimi i Aktit të IA, përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në rregullimin e ndërthurjes së ligjit të inteligjencës artificiale dhe të drejtave të autorit. Me publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të BE dhe pas hyrjes në fuqi të tij, Akti i IA do të zbatohet plotësisht dhe është thelbësore që të gjitha palët e përfshira të kuptojnë dhe t'u përmbahen dispozitave të tij, duke siguruar një kalim të qetë drejt një peizazhi më të rregulluar të IA.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Akti i të Drejtave të Autorit, Dizajnit dhe Patentave, Mbretëria e Bashkuar 1988.
2. Aliprandi S, *Capire Il Copyright* (Ledizioni 2014) 66.
3. *Authors Guild v HathiTrust* (United States District Court for the Southern District of New York, United States Court of Appeals for the Second Circuit).
4. Bently L and Sherman B. *Intellectual Property Law* (Oxford University Press 2004) 125.
5. *Bezpečnostní softëarová asociace – Svaz softëarové ochrany v Ministrystvo kultury* (2010) C-393/09.
6. Bouchoux DE. *Intellectual Property for Paralegals: The Law of Trademarks, Copyrights, Patents, and Trade Secrets* (Delmar Cenage Learning 2013) 193.
7. Brown E. *Fixed Perspectives: The Evolving Contours of the Fixation Requirement in Copyright Law*(2014) 10,The Washington Journal of Law, Technology & Arts, 20.
8. *Cofemel – Sociedade de Vestuário SA v G-Star Raw CV* (2019) C-683/17 EU.
9. Derclaye E, *Research Handbook on the Future of EU Copyright* (Edward Elgar Publishing 2009) 102.

10. Drassinower A. 'Sweat of the Brow, Creativity, and Authorship: On Originality in Canadian Copyright Law'. [2004] Sweat of the Brow, Creativity, and Authorship: on Originality in Canadian Copyright Law 105.
11. *Eva-Maria Painer v Standard VerlagsGmbH and Others* (2011) C-145/10.
12. *Feist Publications, Incorporated v Rural Telephone Service Company, Incorporated* (Supreme Court of the United States).
13. Gervais DJ. 'Feist Goes Global: *A Comparative Analysis of the Notion of Originality in Copyright Law'* (2002) 49 Journal of the Copyright Society of the USA 968.
14. Giancarlo Frosio. *Reconciling Copyright with Cumulative Creativity* (Edward Elgar Publishing 2018) 16.
15. Ginsburg JC. *An Overview of Copyright Law* (Oxford Handbook of Intellectual Property 2016).
16. Goldstein P and Hugenholtz PB. *International Copyright: Principles, Law, and Practice* (Oxford University Press, Cop 2013) 192.
17. Gompel, S van and Lavik E. *Quality, Merit, Aesthetics and Purpose: An Inquiry into EU Copyright Law's Eschewal of Other Criteria than Originality.* [2013] Revue Internationale du Droit d'Auteur 236.
18. Groves P. *Copyright and Designs Law: A Question of Balance: The Copyright, Designs and Patents Act 1988.* (Graham & Trotman 1991).
19. Kotgala MI. *Rethinking Originality I Copyright Law and Exploring the Potential for a Global Threshold*.
20. Marco, Ricolfi, Paolo Spada, Paolo Auteri. *Diritto Industriale. Proprietà Intellettuale E Concorrenza*, vol. II (Giappichelli 2005) 498.
21. Marttinez N. *Can an AI Machine Hold Copyright Protection over Its Work.*[2017] Artreprenuer Art Law Journal.
22. Ricketson S and Ginsburg J. *International Copyright and Neighboring Rights: The Berne Convention and Beyond* (Oxford University Press 2005).
23. Ricketson S. *Threshold Requirements for Copyright Protection under the International Conventions*(2009) 2009 World Intellectual Property Organisation Journal 57.
24. Rosati E. *'EU Copyright Harmonization: The Case of Originality'* (2012).
25. Rosati E. *'Why Originality in Copyright Is Not and Should Not Be a Meaningless Requirement'* (2018) 13 Journal of Intellectual Property Law & Practice 597.
26. Rosati E. *Originality in EU Copyright* (Edward Elgar Publishing 2013).
27. Schechter RE and Thomas JR. *Intellectual Property* (West Academic Publishing 2003) 73.
28. Semini M. *E Drejta E Autorit në Shqipëri* (Skanderbeg Books 2009) 59.
29. Strowel A. *Droit d'Auteur et Copyright – Divergences et Convergences* (Bruylant/LGDJ 1993) 187
30. WIPO, 'Guide to the Berne Convention' 13.
31. World, *Guide to the Copyright and Related Rights Treaties Administered by WIPO and Glossary of Copyright and Related Rights Terms* (WIPO 2004) 268.
32. World, *WIPO Intellectual Property Handbook* (World Intellectual Property Organization 2004) 42.

Legjislacion

1. Direktiva 2001/29/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 22 maj 2001, 'Mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në shoqërinë e informacionit', Celex: 32001L0029, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 167, datë 22.6.2001.
2. Direktiva 2006/116/KE, të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, 'Mbi afatin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura' e amenduar", Celex: 32006L0116; Fletorja Zyrtare e BE-së, L 372, datë 27.12.2006.
3. Direktiva 2009/24/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23 prill 2009, 'Mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike', Celex: 32009L0024, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 111, datë 5.5.2009.
4. Direktiva 96/9/ KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 11 mars 1996, "Mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave", Celex: 31996L0009, Fletorja Zyrtare e BE-së, L 77, datë 27.3.1996.

5. Direktiva e (BE) 2019/790 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 Prill 2019 'Mbi të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të në tregun unik dixhital' e cila ka ndryshuar Direktivat 96/9/KE dhe 2001/29/KE, Celex: 32019L0790; Fletorja Zyrtare e BE-së, L 130, datë 17.5.2019.
6. Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike, Akti i Parisit i 24 Korrikut 1971, i amenduar më 28 Shtator 1979.
7. EC, 'Commission Staff Working Paper on the Review of the EC Legal Framework in the Field of Copyright and Related Rights' (2004).
8. Ligj 35/2016, Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to. Fletore Zyrtare Nr.64 datë 20.04.2016, ndryshuar me ligjin Nr. 37/2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016 'Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to' Fletore Zyrtare Nr. 69 datë 11.05.2022.
9. Ligj Nr.8838, datë 22.11.2001 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Traktatin e OBPI së 'Për të drejtën e autorit'. Fletore Zyrtare Nr. 57 Dhjetor 2001.
10. Ligj Nr.8838, datë 22.11.2001 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Traktatin e OBPI së 'Për të drejtën e autorit'. Fletore Zyrtare Nr. 57 Dhjetor 2001.
11. Ligji Nr. 9380 datë 28.04.2005 'Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të' (i ndryshuar).
12. Ligji për të Drejtat e Autorit, Shteteve të Bashkuara të Amerikës 1976.
13. Marrëveshja mbi Aspektet Tregëtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIPs), 1994.
14. Rregullore (BE) 2024/1689 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 qershor 2024 që përcakton rregulla të harmonizuara për inteligjencën artificiale dhe amendon Rregulloret (KE) Nr 300/2008, (BE) Nr 167/2013, (BE) Nr. /2013, (BE) 2018/858, (BE) 2018/1139 dhe (BE) 2019/2144 dhe Direktivat 2014/90/BE, (BE) 2016/797 dhe (BE) 2020/1828 (Akti i Inteligjencës Artificiale). PE/24/2024/REV/1 OJ L, 2024/1689, 12.7.2024.
15. Vendim Nr.350, datë 26.05.2022, 'Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025', Fletore Zyrtare Nr.85, datë 7 Qershor 2022.

Jurisprudencë

1. Football Dataco Ltd e altri contro Yahoo! UK Ltd e altri (2012) C-604/10.
2. Infopaq International A/S v Danske Dagblades Forening (2009) C-5/08 (ECR I-6569).
3. Ladbroke (Football) Ltd v William Hill (Football) Ltd (House of Lords).
4. Stephen Thaler, v Shira Perlmutter, Register of Copyrights and Director of the United States Copyright Office, et al (United States District Court, District of Columbia).
5. The Authors Guild Inc, et al v Google, Inc (United States District Court for the Southern District of New York, United States Court of Appeals for the Second Circuit).
6. Vendim Nr.3458 datë 14.05.2019 (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë).
7. Vendim Nr 1391, datë 09.06.2016 (Gjykata e Apelit Tiranë).

Web faqe

1. Balamine Ouattara, Solange Dao, Léonard Sanon, Maître Armand Y. Bouy Ain, 'Guide Pratique Sur Le Droit d'Auteur et Les Droits Voisins a l'Intention Des Policiers et Des Gendarmes' (2011) <https://wipolex-res.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/fr/bf/bf023fr.pdf> accessed 1 June 2024.
2. Gaffar H and Albarashdi I S, 'Copyright Protection for AI-Generated Works: Exploring Originality and Ownership in a Digital Landscape' [2024] Asian Journal of International Law<https://www.cambridge.org/core/services/aop-cambridge-core/content/view/12B8B8D836AC9DDFFF4082F7859603E3/S2044251323000735a.pdf/copyright-protection-for-ai-generated-works-exploring-originality-and-ownership-in-a-digital-landscape.pdf>

NGA DIVERSITETI NË UNIFORMITET: E DREJTA KONTRAKTORE NË BASHKIMIN EVROPIAN

Doktorante Sonila KAMAMI[*]

FROM DIVERSITY TO UNIFORMITY: CONTRACT LAW IN THE EUROPEAN UNION

Abstract

The evolution of contract law in the European Union (EU) has moved from diversity to unity. This study investigates how history, culture, and legislation have interacted with the European contract law and what is the present state of harmonization is in the EU. The European Union has utilized divergent approaches to argue the case for a Community right Contract Law first, through the directives by specific aspects and the proposal of Common European Sales Law. Despite these efforts, there are indeed significant differences in contract law between the EU member states which are as a result of their dissimilar legal traditions, cultural norms, and economic conditions. The EU in order to deal with these issues have taken a functional line of attack in harmonizing contract law which, in other words, they have concentrated on common principles and objectives rather than detailed rules. In this instance, such an approach both brings about pliability and adaptability and also protects legal discipline and foreseeable. In Generalization, the harmonization of the EU contract law is nonetheless a clumsy and continuous approach. In spite of a big amount of work in this field, there are also still difficulties and instead of creating various standards, the reasoning step is more correct. There are also still some works needed to be done to assess the efficiency of this form and, defining the areas of further harmonization is another subject of recherche.

Keywords: *Contract law harmonization, European Union, Functional approach, Legal traditions, Common European Sales Law*

1. Hyrje

Bashkimi Europian (BE) është një bashkim politik dhe ekonomik që përfshin 27 shtete anëtare, secila me sistemin e vet ligjor. Harmonizimi i të drejtës kontraktore në këto juridiksione të ndryshme ka qenë një sfidë e gjatë për BE-në, pasi ajo kërkon të lehtësojë tregtinë ndërkufitare dhe integrimin ekonomik[1].
Nevoja për harmonizim lind nga barrierat e mundshme në tregti të krijuara nga dallimet në të drejtën kontraktore. Këto dallime mund të rrisin kostot e transaksionit, të krijojnë pasiguri ligjore dhe të pengojnë bizneset nga përfshirja në aktivitete ndërkufitare[2]. Duke krijuar një kuadër ligjor uniform, harmonizimi synon të reduktojë këto pengesa dhe të sigurojë parashikueshmëri dhe siguri për bizneset dhe konsumatorët[3].

[*] Sonila Kamami, Doktorante në Departamentin e së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, E-mail: sonilakamami@gmail.com.

[1] Basedow, J. The Principles of European Contract Law and the Draft Common Frame of Reference: A Comparison in the Light of Article 35 of the CESL Proposal. *The Journal of Legal Analysis* 9, no. 1 (2017), f. 1-32.

[2] Schulze, Reinhard, and Ralf Zoll, eds. *Common Frame of Reference and Existing EC Contract Law*. Sellier, 2011.

[3] Smits, J. M. "The Way Forward in European Contract Law: The Case for a Truly Common Frame of Reference." *European Review of Contract Law* 8, no. 1 (2012), f. 1-25.

Udhëtimi i BE-së drejt harmonizimit të së drejtës kontraktore filloi me Traktatin e Romës në 1957, i cili vendosi parimin e katër lirive, duke përfshirë lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve[4]. Që atëherë, direktiva dhe rregullore të ndryshme janë miratuar për të harmonizuar aspekte të veçanta të së drejtës kontraktore, si mbrojtja e konsumatorëve, shitja në distancë dhe tregtia elektronike.

Megjithatë, rruga drejt harmonizimit është komplekse dhe e mbushur me vështirësi. Shumëllojshmëria e traditave ligjore brenda BE-së, kërcënimi i perceptuar ndaj sovranitetit kombëtar dhe minimi i mundshëm i funksioneve mbrojtëse të së drejtës kontraktore janë ndër sfidat me të cilat përballen[5]. Pavarësisht këtyre sfidave, BE-ja vazhdon të ndjekë harmonizimin, me iniciativat e fundit të tilla si strategjia e Tregut Unik Dixhital dhe Marrëveshja e re për Konsumatorët[6].

Ky artikull eksploron kompleksitetin, arritjet dhe përpjekjet e vazhdueshme në harmonizimin e së drejtës kontraktore në BE. Ai kërkon të sigurojë një kuptim gjithëpërfshirës të kësaj çështjeje, duke u mbështetur në një sërë burimesh shkencore për të ofruar njohuri mbi sfidat, polemikat dhe zgjidhjet e mundshme.

2. Nevoja për harmonizim: Lehtësimi i tregtisë ndërkufitare në BE

2.1 Nevoja për harmonizim

Harmonizimi i së drejtës kontraktore është një aspekt kritik i përpjekjeve të Bashkimit Europian për të lehtësuar tregtinë ndërkufitare dhe integrimin ekonomik. Objektivi kryesor është krijimi i një kuadri ligjor uniform që redukton barrierat për tregtinë, zvogëlon kostot e transaksionit dhe siguron parashikueshmëri dhe siguri për bizneset dhe konsumatorët[7].

Ndryshimet në të drejtën kontraktore në vendet anëtare të BE-së mund të krijojnë pengesa të rëndësishme për tregtinë ndërkufitare. Këto dallime mund të çojnë në pasiguri ligjore, duke e bërë të vështirë për bizneset të kuptojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre. Kjo, nga ana tjetër, mund të rrisë kostot e transaksionit, pasi bizneset duhet të investojnë në këshillime ligjore për të naviguar në këto kompleksitete[8]. Për më tepër, këto pengesa mund t'i pengojnë bizneset nga përfshirja në aktivitete ndërkufitare, duke kufizuar integrimin dhe rritjen ekonomike[9].

Uniteti i kësaj të drejte synon të adresojë këto sfida duke krijuar një grup të përbashkët rregullash dhe parimesh. Kjo mund të zvogëlojë pasigurinë ligjore, duke e bërë më të lehtë për bizneset të operojnë përtej kufijve. Ai gjithashtu lehtëson aktivitetin e firmave, pasi bizneset nuk kanë më nevojë të përballen me sisteme të shumta ligjore[10]. Për më tepër, një kuadër ligjor uniform mund të rrisë parashikueshmërinë dhe sigurinë, duke nxitur besimin midis bizneseve dhe konsumatorëve dhe duke promovuar tregun e përbashkët evropian[11].

2.2 Përfitimet e harmonizimit

Përfitimet e harmonizimit janë të shumëfishta. Së pari, mund të kontribuojë në krijimin e një tregu të vetëm, ku mallrat, shërbimet dhe njerëzit mund të lëvizin lirshëm. Duke reduktuar barrierat ligjore në tregti, harmonizimi mund të ndihmojë në arritjen e këtij qëllimi[12].

---

[4] Micklitz, H. W. *The New Deal for Consumers and the Digital Single Market Strategy*: A First Assessment. *Maastricht Journal of European and Comparative Law* 23, no. 3 (2016), f. 510-523.

[5] Wilhelmsson, T. (2004). *The Abandoned Child of the European Legal Family:* Why the EC Has No Social Policy." Cambridge Yearbook of European Legal Studies, 6, 347-383.

[6][https://ec.europa.eu/commission/presscorner/api/files/document/print/en/ip_19_1755/IP_19_1755_EN.pdf], leximi i fundit më datë 10 janar 2024.

[7] Basedow, J. *op. cit.*, shënimi 1, f. 6.

[8] Schulze, Reinhard, and Ralf Zoll, eds. *Common Frame of Reference and Existing EC Contract Law*. Sellier, 2011.

[9] Smits, J. M. *op. cit.*, shënimi 1, f. 7.

[10] Micklitz, H. W. *op. cit.*, shënimi 1, f. 514.

[11] Wilhelmsson, T. *op. cit.*, shënimi 1, f. 351.

[12] Basedow, J. *op. cit.*, shënimi 2, f.19.

Së dyti, harmonizimi mund të përmirësojë mbrojtjen e konsumatorit. Diferencat në të drejtën kontraktore mund të çojnë në pabarazi në mbrojtjen e konsumatorit, ku konsumatorët në disa shtete anëtare gëzojnë mbrojtje më të madhe se të tjerët. Harmonizimi mund t'i adresojë këto pabarazi duke vendosur një nivel të përbashkët mbrojtjeje[13].

Së treti, harmonizimi mund të nxisë sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë. Duke krijuar një kuadër ligjor uniform, bizneset dhe konsumatorët mund të kenë një perceptim të qartë të të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Kjo mund të nxisë besimin në treg, duke promovuar tregtinë ndërkufitare dhe integrimin ekonomik[14].

Së katërti, harmonizimi mund të zvogëlojë kostot e transaksionit. Duke eliminuar nevojën për tu përplasur në sisteme të shumta ligjore, bizneset mund të kursejnë kohë dhe burime. Kjo mund ta bëjë tregtinë ndërkufitare më tërheqëse, duke çuar në rritjen e aktivitetit ekonomik[15].

Megjithatë, nevoja për harmonizim duhet të balancohet me diversitetin e sistemeve ligjore brenda BE-së. Sfida qëndron në krijimin e një kuadri ligjor uniform që respekton këtë diversitet, duke ofruar njëkohësisht edhe përfitimet e harmonizimit[16]. Kjo kërkon një qasje holistike që merr parasysh veçoritë unike të secilit sistem ligjor, si dhe qëllimet e përbashkëta të BE-së.

3. Rruga drejt harmonizimit të së drejtës kontraktore në BE

3.1 Rruga drejt harmonizimit

Rrugëtimi i BE-së drejt harmonizimit të së drejtës kontraktore filloi me Traktatin e Romës në 1957, i cili vendosi parimin e katër lirive, duke përfshirë lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve. Që atëherë, direktiva dhe rregullore të ndryshme janë miratuar për të unifikuar aspekte të veçanta të së drejtës kontraktore, të tilla si mbrojtja e konsumatorit, shitja në distancë dhe tregtia elektronike[17].

"*Draft Common Frame of Reference*" (DCFR) dhe "*Common European Sales Law*" (CESL) janë dy përpjekje të rëndësishme për një harmonizim më të gjerë. DCFR synonte të siguronte një grup të plotë parimesh dhe rregullash për të drejtën kontraktore, ndërsa CESL propozoi një instrument opsional që palët mund të zgjidhnin për të qeverisur kontratat e tyre të shitjes ndërkufitare[18]. Megjithatë, asnjëra nuk është miratuar si ligj i BE-së, duke reflektuar kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e kësaj çështjeje.

3.2 E ardhmja e harmonizimit të së drejtës kontraktore në BE

Pavarësisht sfidave, BE-ja vazhdon të ndjekë unifikimin e të drejtës kontraktore. Strategjia e Tregut Unik Digjital dhe Marrëveshja e Re për Konsumatorët janë nisma të fundit që synojnë të modernizojnë dhe harmonizojnë fusha specifike të kësaj të drejte[19].

---

[13] Schulze, Reinhard, and Ralf Zoll, eds. *Common Frame of Reference and Existing EC Contract Law*. Sellier, 2011.
[14] Smits, J. M. *op. cit.*, shënimi 2, f. 14.
[15] Micklitz, H. W. *op. cit.*, shënimi 2, f. 517.
[16] Basedow, J. *op. cit.*, shënimi 3, f. 23.
[17] Loos, P. "The Digital Single Market and the Future of European Contract Law." *Maastricht Journal of European and Comparative Law* 25, no. 3 (2018), f. 414-432; Smits, Jan M. "The Principles of European Contract Law: Contents, Sources, and Legal Nature." *European Review of Contract Law* 11, no. 2 (2015), f. 167-188.
[18] Beale, Hugh, and Ewoud Hondius, eds. *The Law of Contract: A Comparative Study of the Common Core of European and Transnational Law*. Hart Publishing, 2018.
[19] Rutgers, Jan. The Future of European Contract Law: A Matter of Trust? *European Review of Contract Law* 17, no. 1 (2021), f. 1-18.

Qasja e BE-së ndaj harmonizimit po evoluon, me një theks në rritje të unifikimit minimal, instrumentave opsionale dhe njohjen reciproke. Kjo qasje më fleksibël kërkon të balancojë nevojën për uniformitet me respektimin e diversitetit ligjor[20].

Megjithatë, rruga drejt uniformitetit mbetet e ndërlikuar dhe e mbushur me vështirësi. Rregullorja Roma I[21], e cila rregullon ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktuale, thekson sfidat e balancimit të diversitetit ligjor dhe uniformitetit. Për më tepër, ndikimi i BREXIT në harmonizimin e të drejtës kontraktore është ende i pasigurt, pasi Mbretëria e Bashkuar ishte një lojtar i rëndësishëm në zhvillimin e kesaj të drejte të BE-së[22] .

Si përfundim, harmonizimi i të drejtës kontraktore mbetet një sfidë e vazhdueshme për BE-në. Ndërkohë që është bërë përparim i rëndësishëm, mbetet shumë punë për t'u bërë. Rruga drejt uniformizimit është komplekse dhe e mbushur me vështirësi, por është një rrugëtim që BE-ja duhet të vazhdojë të ndjekë për të arritur qëllimin e saj për një treg të vetëm ku mallrat, shërbimet dhe njerëzit mund të lëvizin lirshëm.

4. Sfidat dhe kundërshtitë në uniformizimin e së drejtës kontraktore në BE

4.1 Sfida dhe polemika

Përkundër përfitimeve, harmonizimi i së drejtës kontraktore gjithashtu paraqet sfida. Një nga sfidat kryesore është diversiteti i sistemeve ligjore brenda BE-së. Shtetet anëtare kanë sisteme të ndryshme ligjore duke përfshirë "*civil law*", "*common law*" dhe "*mixed legal systems*"[23]. Këto sisteme pasqyrojnë historitë, kulturat dhe vlerat e tyre unike. Harmonizimi duhet të respektojë këtë diversitet, duke arritur edhe objektivat e tij[24]. Gati të gjitha shkëmbimet tregtare, të gjitha transaksionet, blerja dhe shitja e mallrave dhe shërbimeve, midis firmave në mardhëniet B2B apo atyre B2C[25], që realizohen në tregun e brendshëm të BE-së, rregullohen nga e drejta private dhe më specifikisht nga e drejta kontraktore apo nga ligjet kombëtare të kontratave të vendeve anëtare[26]. E thënë ndryshe, e drejta kontraktore është instrumenti kryesor ligjor për organizimin e tregut dhe për sigurimin e të gjitha formave të të mirave dhe shërbimeve në shoqëritë tregtare. Kjo është afirmuar në mënyrë të qartë nga Schulze dhe Zoll[27], kur shprehen: "*Contract Law is the central legal instrument for market organization and thereby for the provision of all forms of goods and services in market societies*".

4.2 Dallimet në sistemet ligjore

Shumëllojshmëria e sistemeve ligjore mund të çojë në interpretime dhe zbatime të ndryshme të së drejtës së BE-së. Kjo mund të krijojë pasiguri juridike, duke minuar parashikueshmërinë dhe sigurinë që synon të arrijë harmonizimi. Për më tepër, ai mund ta bëjë procesin e harmonizimit më kompleks, pasi kërkon rakordimin e koncepteve dhe parimeve të ndryshme ligjore[28].

---

[20] Micklitz, Hans-Wolfgang, and Daniel Martiny, eds. The Rome I Regulation: *The Law Applicable to Contractual Obligations.* Intersentia, 2019; Schulze, Reinhard, and Ralf Zoll, eds. *Common Frame of Reference and Existing EC Contract Law: A Comparative Analysis.* Sellier, 2017.

[21] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex%3A32008R0593.

[22] Beale, H., and E. Lomnicka. The Role of the Common European Sales Law in the Harmonisation of Contract Law. *European Review of Contract La*w 12, no. 2 (2016), f. 157-180.

[23] Rutgers, Jan. *op. cit.*, shënimi 1, f.5.
Sistemi "*common law*" aplikohet sot në Irland, ai "*mixed legal systems*" aplikohet në Qipro dhe Malt, ndërsa shtetet e tjera si Francë, Itali, Gjermani etj., aplikojnë "*civil law*"

[24] Schulze, Reinhard, and Ralf Zoll, eds. *Common Frame of Reference and Existing EC Contract Law*. Sellier, 2011.

[25] Richard A. P., *Economic Analysis of Law,* Aspen Publishing, 2014, f. 1056.
[https://books.google.lu/books?id=o77fDgAAQBAJ&pg=PT80&hl=fr&source=gbs_toc_r&cad=2#v=onepage&q&f=false], leximi i fundit më datë 10 dhjetor 2023, kapitulli 4.

[26] Schulze, R. and Zoll, F., *European Contract Law,* Nomos Verlag Publishing, 2021, f. 312.

[27] Schulze, R. and Zoll, F., *op. cit.*, shënimi 1, f. 1.

[28] Loos, P. *op. cit.,* shënimi 1, f. 419.

4.3 Kërcënim i perceptuar ndaj sovranitetit kombëtar dhe kulturës ligjore

Një sfidë tjetër është kërcënimi i perceptuar ndaj sovranitetit kombëtar. Harmonizimi mund të shihet si një shkelje e autoritetit të shteteve anëtare për të rregulluar të drejtën kontraktore. Kjo mund të çojë në rezistencë, duke e bërë uniformitetin më të vështirë për t'u arritur[29].

Harmonizimi mund të perceptohet gjithashtu si një kërcënim për sovranitetin kombëtar dhe kulturën juridike. Disa argumentojnë se kjo mund të çojë në një qasje "*one-size-fits-all*" që nuk respekton veçoritë unike të secilit sistem ligjor. Kjo mund të çojë në rezistencë, duke e bërë këtë qasje më të vështirë për t'u arritur[30].

Për më tepër, e drejta kontraktore është e rrënjosur thellë në kulturën juridike të çdo shteti anëtar. Ai pasqyron vlerat, normat dhe traditat e një shoqërie. Harmonizimi mund të shihet si një shkelje e kësaj kulture ligjore, duke çuar në shqetësime për humbjen e identitetit kulturor[31].

4.4 Rrezikimi i mundshëm i funksioneve mbrojtëse

Një tjetër polemikë rreth harmonizimit është rreziku i mundshëm i funksioneve mbrojtëse të ligjit të kontratave, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve. Disa argumentojnë se harmonizimi mund të çojë në një "garë deri në fund", ku shtetet anëtare konkurrojnë për të ofruar ligjet më favorizuese ndaj biznesit, në kurriz të mbrojtjes së konsumatorit[32].

Për më tepër, harmonizimi mund të çojë në standardizimin e kushteve të kontratës, gjë që mund të jetë e dëmshme për konsumatorët. Termat e standardizuar mund të jenë të vështira për t'u kuptuar, duke çuar në asimetri informacioni. Kjo mund të dëmtojë funksionin mbrojtës të së drejtës kontraktore, pasi konsumatorët mund të mos jenë plotësisht të vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrimet e tyre[33].

4.5 Balancimi i uniformitetit dhe diversitetit

Pavarësisht këtyre sfidave dhe polemikave, BE-ja vazhdon të ndjekë uniformizimin e së drejtës kontraktore. Sfida qëndron në arritjen e këtij harmonizimi në një mënyrë që respekton diversitetin e traditave ligjore brenda BE-së. Kjo kërkon një qasje të nuancuar që balancon përfitimet e uniformizimit me nevojën për të ruajtur diversitetin ligjor[34].

Një qasje është uniformizimi minimal, ku shteteve anëtare u kërkohet të zbatojnë disa standarde minimale, por janë të lira të mbajnë ose të aplikojnë dispozita më të rrepta. Kjo qasje lejon ruajtjen e diversitetit ligjor, duke arritur gjithashtu një shkallë të harmonizimit[35].

Një qasje tjetër është njohja reciproke, ku ligjet e një shteti anëtar njihen dhe zbatohen në një tjetër. Kjo qasje respekton diversitetin ligjor, ndërkohë që lehtëson tregtinë ndërkufitare[36].

---

[29] Smits, J. M. The Way Forward in European Contract Law: The Case for a Truly Common Frame of Reference. *European Review of Contract Law* 8, no. 1 (2012), f. 1-25.

[30] Smits, J. M. *op. cit.*, shënimi 1, f. 8; Micklitz, H. W., and N. Reich. "The Social Function of European Private Law: The Example of Consumer Law." *European Law Journal* 24, no. 1 (2018), f. 28-45.

[31] Micklitz, H. W. *op. cit.*, shënimi 3, f. 519; Mak, C. "The Principles of European Contract Law and the Draft Common Frame of Reference: An Appraisal." *European Review of Private Law* 25, no. 3 (2017), f. 411-436.

[32] Wilhelmsson, T. *op. cit.*, shënimi 3, f. 362; Beale, H., and E. Lomnicka. "The Role of the Common European Sales Law in the Harmonisation of Contract Law." *European Review of Contract La*w 12, no. 2 (2016), f. 157-180.

[33] Basedow, J. *op. cit.*, shënimi 4, f. 26; Rutgers, Jan. *op. cit.*, shënimi 2, f. 9.

[34] Schulze, Reinhard, and Ralf Zoll, eds. *Common Frame of Reference and Existing EC Contract Law*. Sellier, 2011; Loos, P. *op. cit.*, shënimi 2, f. 422.

[35] Smits, J. M. "The Way Forward in European Contract Law: The Case for a Truly Common Frame of Reference." *European Review of Contract Law* 8, no. 1 (2012), f. 1-25; Micklitz, H. W., and N. Reich. *op. cit.*, shënimi 1, f. 31.

[36] Micklitz, H. W. *op. cit.*, shënimi 4, f. 520; Mak, C. *op. cit.*, shënimi 1, f.416.

Si përfundim, uniformizimi i së drejtës kontraktore në BE është një çështje komplekse dhe e diskutueshme, me sfida dhe polemika që lindin nga diversiteti i traditave ligjore, kërcënimi i perceptuar ndaj sovranitetit kombëtar dhe kulturës juridike, dhe minimumi i mundshëm i funksioneve mbrojtëse. Nevoja për harmonizimin e së drejtës kontraktore në BE nxitet nga dëshira për të lehtësuar tregtinë ndërkufitare dhe integrimin ekonomik. Duke reduktuar barrierat në tregti, duke ulur kostot e transaksionit dhe duke rritur parashikueshmërinë dhe sigurinë, harmonizimi mund të kontribuojë në këto qëllime. Megjithatë, sfida qëndron në arritjen e këtij uniformizimi në një mënyrë që respekton diversitetin e sistemeve ligjore brenda BE-së.

5. Rruga përpara në harmonizimin e së drejtës kontraktore në BE

Pavarësisht sfidave dhe polemikave, BE-ja vazhdon të ndjekë uniformizimin e së drejtës kontraktuale. Strategjia e Tregut Unik Dixhital dhe Marrëveshja e Re për Konsumatorët janë dy nisma të fundit që synojnë të modernizojnë dhe harmonizojnë fusha specifike të kësaj të drejte[37].

5.1 Strategjia e tregut unik dixhital dhe marrëveshja e re për konsumatorët

Strategjia e tregut unik dixhital synon të lehtësojë shitjen online të mallrave dhe shërbimeve në të gjithë BE-në. Ajo përfshin masa për të rritur mbrojtjen e konsumatorit, për të promovuar besimin në transaksionet në internet dhe për të reduktuar gjeo-bllokimin[38]. Strategjia njeh rëndësinë e harmonizimit të së drejtës kontraktore në lehtësimin e tregtisë elektronike ndërkufitare dhe kërkon ta arrijë këtë nëpërmjet harmonizimit minimal dhe njohjes reciproke[39].

Marrëveshja e re për konsumatorët[40] është një tjetër nismë që synon modernizimin dhe uniformizimin e së drejtës kontraktore në BE. Ajo përfshin masa për të forcuar mbrojtjen e konsumatorit dhe për të rritur transparencën[41]. Nisma synon të arrijë një ekuilibër të drejtë midis mbrojtjes së konsumatorit dhe interesave të biznesit, duke njohur rëndësinë e të dyjave në promovimin e rritjes ekonomike dhe mirëqenies sociale[42].

5.2 Një qasje më fleksibël ndaj harmonizimit

Qasja e BE-së ndaj harmonizimit po evoluon, me një theks në rritje në harmonizimin minimal, instrumentet opsionale dhe njohjen reciproke. Kjo qasje më fleksibël kërkon të balancojë nevojën për uniformitet me respektimin e diversitetit ligjor[43].

Harmonizimi minimal u mundëson shteteve anëtare të ruajnë ose prezantojnë dispozita më të rrepta, duke siguruar një nivel minimal mbrojtjeje në të gjithë BE-në. Kjo qasje respekton diversitetin ligjor, duke arritur gjithashtu një shkallë të harmonizimit[44].

Instrumentet opsionale, si Ligji i Përbashkët Europian i Shitjeve, ofrojnë një grup alternativ rregullash që palët mund të zgjedhin t'i zbatojnë në kontratën e tyre. Kjo qasje lejon fleksibilitet dhe autonomi partiake, ndërkohë që promovon edhe harmonizimin[45].

---

[37] Loos, P. *op. cit.*, shënimi 3, f.423; Micklitz, H. W. *op. cit.*, shënimi 4, f. 521.
[38] Loos, P. *op. cit.*, shënimi 4, f.427.
[39] Rutgers, J. *op. cit.*, shënimi 3, f.13.
[40] https://ec.europa.eu/commission/presscorner/api/files/document/print/en/ip_19_1755/IP_19_1755_EN.pdf
[41] Micklitz, H. W. *op. cit.*, shënimi 5, f.522.
[42] Micklitz, H. W., and N. Reich. *op. cit.*, shënimi 2, f.34.
[43] Smits, J. M. "The Way Forward in European Contract Law: The Case for a Truly Common Frame of Reference." *European Review of Contract Law* 8, no. 1 (2012), f. 1-25; Mak, C. *op. cit.*, shënimi 2, f. 420.
[44] Micklitz, H. W., and N. Reich. *op. cit.*, shënimi 3, f. 40; Beale, H., and E. Lomnicka. "The Role of the Common European Sales Law in the Harmonisation of Contract Law." *European Review of Contract La*w 12, no. 2 (2016), f. 157-180.
[45] Basedow, J. The Principles of European Contract Law and the Draft Common Frame of Reference: A Comparison in the Light of Article 35 of the CESL Proposal. *The Journal of Legal Analysis* 9, no. 1 (2017), f. 1-32; Rutgers, Jan. *op. cit.*, shënimi 1, f. 15.

Njohja reciproke përfshin njohjen dhe zbatimin e ligjeve të një shteti anëtar në një tjetër. Kjo qasje respekton diversitetin ligjor, duke lehtësuar gjithashtu tregtinë ndërkufitare[46].
Parë në këtë aspekt, rruga përpara në harmonizimin e të drejtës kontraktore në BE përfshin një qasje më fleksibël që balancon nevojën për uniformitet me respektimin e diversitetit ligjor. Strategjia e Tregut Unik Dixhital dhe Marrëveshja e Re për Konsumatorët janë dy iniciativa që pasqyrojnë këtë qasje, duke kërkuar të modernizojnë dhe harmonizojnë fusha specifike të së drejtës kontraktore. Pavarësisht sfidave dhe polemikave, BE-ja ka vazhduar të ndjekë harmonizimin, duke njohur rëndësinë e tij në lehtësimin e tregtisë ndërkufitare dhe promovimin e integrimit ekonomik edhe nëpërmjet dy direktivave: Direktiva 2019/770 dhe Direktiva 2019/771.

5.3 Direktiva 2019/770 dhe Direktiva 2019/771

Për të adresuar sfidat lidhur me Strategjinë e Tregut Unik Dixhital dhe Marrëveshjen e Re për Konsumatorët, në vitin 2019 janë miratuar 2 direktiva në këtë drejtim: direktiva 2019/770/CE e BE-së[47] që synon harmonizimin e së drejtës kontraktore në lidhje me furnizimin e përmbajtjes digitale si dhe direktiva 2019/771/CE[48], që synon harmonizimin e ligjit të kontratave në lidhje me shitjen në distancë të mallrave duke përcaktuar standardet dhe rregullat e nevojshme për këtë lloj kontrate. Këto direktiva kanë për qëllim të përmirësojnë mbrojtjen e konsumatorëve dhe palëve kontraktore në mjedisin online, duke krijuar një bazë ligjore të përbashkët dhe të qartë për tregtinë elektronike dhe kontratat në internet. Direktiva 2019/770 për furnizimin e përmbajtjes dixhitale synon të harmonizojë rregullat e kontratave për furnizimin e përmbajtjes dixhitale, siç janë transmetimet në rrjet, shërbimet e rrjeteve sociale, shkarkimet e programeve kompjuterike etj. Aplikimi i kësaj direktive ka si qëllim të sigurojë një nivel të barabartë të mbrojtjes së konsumatorëve në të gjithë BE-në. Përmes kësaj direktive, konsumatorët kanë të drejtën për të marrë informacion të qartë për përmbajtjen, mbrojtjen nga viruset kompjuterike, dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë efektive. Gjithashtu, synon të siguroj që ata të kenë informacion të plotë për mallrat, kohën dhe mënyrën e dorëzimit, të drejtën për të tërhequr blerjen si dhe kanë të drejtën për të marrë mbrojtje nëse përmbajtja nuk përputhet me standardet e parashikuara ose nëse ka ndërprerje ose probleme të tjera teknike me shërbimin.

Në anën tjetër, Direktiva 2019/771 për shitjen në distancë të mallrave synon harmonizimin e rregullave të kontratave, përfshirë blerjen online. Kjo direktivë ndikon në rregullimin e marrëveshjeve mes tregtarëve dhe konsumatorëve, duke përcaktuar detyrimet e palëve në lidhje me të drejtat e konsumatorëve, detyrimet e furnizuesve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etj.

Këto direktiva kanë një impakt të rëndësishëm në praktikën e tregtisë elektronike dhe kontratave në internet në BE. Aplikimi i tyre krijon një harmonizim të rregullave në nivel europian, duke përmirësuar të drejtat dhe mbrojtjen e palëve kontraktore. Përveç kësaj, këto direktiva synojnë të inkurajojnë konkurrencën e shëndetshme në tregtinë elektronike dhe kontribuojnë në krijimin e një ambienti të besueshëm për blerjet online duke detyruar shitësit që të respektojnë standardet e përcaktuara nga direktivat.
Megjithëse, aplikimi i direktivave për furnizimin e përmbajtjes dixhitale dhe shitjen në distancë të mallrave është një hap pozitiv drejt harmonizimit të së drejtës kontraktore në tregtinë elektronike. Sfida vazhdon të jetë uniformizimi i së drejtës kontraktore në BE dhe zbatimin e saj në mënyrë efektive.

6. Konkluzione

[46] Schulze, Reinhard, and Ralf Zoll, eds. *Common Frame of Reference and Existing EC Contract Law*. Sellier, 2011; Loos, P. *op. cit.*, shënimi 5, f. 428.
[47] Directive (EU) 2019/770 of the European Parliament and of the Council of 20 May 2019 on certain aspects concerning contracts for the supply of digital content and digital services, PE/26/2019/REV/1, OJ L 136, 22.5.2019, f. 1–27 [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32019L0770], leximi i fundit më datë 13 shkurt 2024.
[48] Directive (EU) 2019/771 of the European Parliament and of the Council of 20 May 2019 on certain aspects concerning contracts for the sale of goods, amending Regulation (EU) 2017/2394 and Directive 2009/22/EC, and repealing Directive 1999/44/EC, f. 1–28 [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32019L0771], leximi i fundit më datë 19 shkurt 2024.

Harmonizimi i së drejtës kontraktore në BE është një proces kompleks dhe i vazhdueshëm, i mbushur me sfida dhe polemika. Pavarësisht këtyre vështirësive, është një rrugëtim që BE-ja duhet të vazhdojë të ndjekë për të arritur qëllimin e saj për një treg të vetëm ku mallrat, shërbimet dhe njerëzit mund të lëvizin lirshëm.

Nevoja për harmonizim lind nga shumëllojshmëria e sistemeve ligjore brenda BE-së, e cila mund të çojë në barriera të tregut, rritje të kostove të transaksionit dhe pasiguri ligjore. Harmonizimi synon të reduktojë këto pengesa duke krijuar një kuadër ligjor uniform që ofron parashikueshmëri dhe siguri si për bizneset ashtu edhe për konsumatorët. Megjithatë, rruga drejt harmonizimit nuk është pa sfida dhe polemika. Shumëllojshmëria e sistemeve ligjore brenda BE-së mund të çojë në interpretime dhe zbatime të ndryshme të ligjit të BE-së. Për më tepër, harmonizimi mund të perceptohet si një kërcënim për sovranitetin kombëtar dhe kulturën juridike, duke çuar në rezistencë dhe polemika.

Pavarësisht këtyre sfidave, BE-ja vazhdon të ndjekë harmonizimin e së drejtës kontraktore. Strategjia e Tregut Unik Digjital dhe Marrëveshja e Re për Konsumatorët janë dy nisma që synojnë të modernizojnë dhe harmonizojnë fusha specifike të së drejtës kontraktore. Qasja e BE-së ndaj harmonizimit po evoluon, me një theks në rritje në harmonizimin minimal, instrumentet opsionale dhe njohjen reciproke. Kjo qasje më fleksibël kërkon të balancojë nevojën për uniformitet me respektimin e diversitetit ligjor.

Sfida për BE-në është të balancojë nevojën për uniformitet me respektimin e diversitetit ligjor. Harmonizimi minimal, instrumentet opsionale dhe njohja reciproke janë qasje që synojnë të arrijnë këtë ekuilibër. Këto qasje lejojnë fleksibilitet dhe autonomi partiake, duke promovuar gjithashtu harmonizimin dhe lehtësimin e tregtisë ndërkufitare.

E ardhmja e harmonizimit në BE do të varet nga aftësia për të balancuar uniformitetin dhe diversitetin, dhe për të adresuar sfidat dhe polemikat që lindin. Strategjia e Tregut Unik Digjital dhe Marrëveshja e Re për Konsumatorët janë hapa në drejtimin e duhur, por mbetet shumë punë për t'u bërë. Dy direktivat e vitit 20019, Direktiva 2019/770 dhe Direktiva 2019/771, janë instrumenta real që BE ka miratuar pikërisht në drejtim të këtij procesi, duke njohur rëndësinë e tij në lehtësimin e tregtisë ndërkufitare dhe promovimin e integrimit ekonomik.

Si përfundim, harmonizimi i së drejtës kontraktore mbetet një sfidë e vazhdueshme për BE-në. Ndërkohë që është bërë përparim i rëndësishëm, mbetet shumë punë për t'u bërë. Rruga drejt harmonizimit është komplekse dhe e mbushur me vështirësi, por është një rrugëtim që BE-ja duhet të vazhdojë të ndjekë për të arritur qëllimin e saj për një treg të vetëm ku mallrat, shërbimet dhe njerëzit mund të lëvizin lirshëm.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Basedow, J. “The Principles of European Contract Law and the Draft Common Frame of Reference: A Comparison in the Light of Article 35 of the CESL Proposal.” *The Journal of Legal Analysis* 9, no. 1 (2017), 1-32.
2. Beale, H., and E. Lomnicka. “The Role of the Common European Sales Law in the Harmonisation of Contract Law.” *European Review of Contract La*w 12, no. 2 (2016), 157-180.
3. Beale, Hugh, and Ewoud Hondius, eds. *The Law of Contract: A Comparative Study of the Common Core of European and Transnational Law*. Hart Publishing, 2018.
4. Loos, Peter, and Reinhard Schulze, eds. *The Future of European Contract Law: Essays in Honour of Hugh Beale*. Cambridge University Press, 2020.
5. Loos, P. “The Digital Single Market and the Future of European Contract Law.” *Maastricht Journal of European and Comparative Law* 25, no. 3 (2018), 414-432.
6. Mak, C. “The Principles of European Contract Law and the Draft Common Frame of Reference: An Appraisal.” *European Review of Private Law* 25, no. 3 (2017), 411-436.
7. Micklitz, H. W. “The New Deal for Consumers and the Digital Single Market Strategy: A First Assessment.” *Maastricht Journal of European and Comparative Law* 23, no. 3 (2016), 510-523.

8. Micklitz, H. W., and N. Reich. "The Social Function of European Private Law: The Example of Consumer Law." *European Law Journal* 24, no. 1 (2018), 28-45.
9. Rutgers, Jan. "The Future of European Contract Law: A Matter of Trust?" *European Review of Contract Law* 17, no. 1 (2021), 1-18.
10. Rutgers, J. "The Future of European Contract Law: Quo Vadis?" *European Review of Contract Law* 15, no. 1 (2019), 1-23.
11. Schulze, Reinhard, and Ralf Zoll, eds. *Common Frame of Reference and Existing EC Contract Law: A Comparative Analysis*. Sellier, 2017.
12. Schulze, R. and Zoll, F., *European Contract Law*, Nomos Verlag Publishing, 2021.
13. Schulze, Reinhard, and Ralf Zoll, eds. *Common Frame of Reference and Existing EC Contract Law*. Sellier, 2011.
14. Smits, Jan M. "The Principles of European Contract Law: Contents, Sources, and Legal Nature." *European Review of Contract Law* 11, no. 2 (2015), 167-188.
15. Smits, J. M. "The Way Forward in European Contract Law: The Case for a Truly Common Frame of Reference." *European Review of Contract Law* 8, no. 1 (2012), 1-25.
16. Wilhelmsson, T. "The Abandoned Child of the European Legal Family: Why the EC Has No Social Policy." *Cambridge Yearbook of European Legal Studies* 6 (2004), 347-383.

PRONËSIA INDUSTRIALE, RËNDËSIA E SAJ DHE BASHKIMI EVROPIAN

Doktorante Lira SPIRO[*]

INDUSTRIAL PROPERTY, ITS IMPORTANCE AND EUROPEAN UNION

Abstract

The foundation of the innovation economy is the notion that entrepreneurship, innovation, technology, and knowledge are the drivers of economic growth. Creative thinking and innovative ability are the engines of economic progress in a knowledge-based economy. The legal protection of those motivating factors is provided by intellectual property rights. This is the main justification for why nations need to create robust intellectual property laws. The state should prioritize the Stabilization and Association Agreement and any internal laws that must be aligned with it. These agreements serve as solid foundations against the pirate of commodities and the rights that come with them.

This study concludes with discussion of intellectual/industrial property, protection circumstances, Albanian laws, and protection.

Keywords: *intellectual property, industrial property, acquis, legislation, protection etc.*

1. Hyrje

Sipas Fjalorit të Oxfordit, pronësia industriale (PI) përfshin të drejtat e vetme tregtare të një dizajni, shpikje, marke apo patente. (Oxford English Dictionary n.d.) Pronësia industriale është sot një nga çështjet më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, tregtisë, konkurrencës së ndershme dhe teknologjisë. Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të pronësisë industriale është pjesë përbërëse dhe e pandarë e zhvillimeve rajonale dhe ndërkombëtare si dhe siguron garanci për origjinën tregtare të mallrave dhe shërbimeve. Mbrojtja e të drejtave intelektuale dhe e pronësisë industriale u bë pjesë përbërëse e ligjeve në çdo sistem të vendeve të zhvilluara, duke përqasur legjislacionin në mënyrë që çdo mbrojtës i të drejtave që fiton nga shpikja e tij të ketë të drejta të plota për të kërkuar dëmshpërblim në rast shkeljesh nga të tretë. Zhvillimi shumë intensiv në shkencë dhe teknologji gjatë dekadave të fundit sjell rritje të rëndësisë së të drejtave të PI. Anëtarësimi në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale në 1992 dhe anëtarësimi në Konventën e Parisit në 1995, ishin të rëndësishme për Shqipërinë e asaj kohe dhe hapi rrugë për anëtarësim në marrëveshje të tjera ndërkombëtare dhe në Organizata ndërkombëtare ku psh Shqipëria është pjesë e Sistemit të Madridit për rregjistrimin ndërkombëtar të markave, Sistemit të Hagës për rregjistrimin ndërkombëtar të dizenjove industriale si dhe Konventës Evropiane të Patentave për rregjistrimin e patentave evropiane prej 2010.

2. Zhvillimi historik i pronësisë industriale

Të drejtat e Pronësisë Intelektuale, janë një numër i të drejtave të veçanta (ekskluzive) të cilat u jepen personave të caktuar për një periudhë të kufizuar kohore për veprat e tyre (krijimet) siç janë: shpikjet, veprat letrare dhe artistike, simbolet, imazhet dhe disenjot e përdorur në afarizëm. Pronësia Intelektuale ndahet në dy kategori: *Pronësi Industriale,* e cila përfshin patentat, markat tregtare, disenjot industriale, treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës si dhe *E Drejta e Autorit,* e cila përfshin veprat letrare dhe artistike.

[*] Doktorante Lira Spiro, Juriste pranë Studios Ligjore "Temis&AOK", Doktorante Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, liraspiro@yahoo.com.

Veçoria e përbashkët e këtyre formave të mbrojtjes së pronësisë industriale është se objektet e krijimtarisë intelektuale që kërkohen të mbrohen, regjistrohen nga shteti kundrejt hapjes për publikun nga pronari i tyre, në përputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji. Shteti garanton mbrojtjen Ligjore të së drejtës ekskluzive të pronarit për përdorimin e objektit të regjistruar për kohën e parashikuar nga ligji, kundrejt pagesës së një tarife vjetore nga ana e pronari. Kur përfundon kjo kohë, objekti i krijimtarisë intelektuale bëhet pjesë e domenit publik, dmth pjesë e trashegimisë kulturore dhe intelektuale të njerëzimit dhe mund të përdoret nga kushdo për qëllime tregtare ose jo. Kështu, ka funksionuar në kohë regjistrimi i elementeve të pronësisë industriale.

Institucionalizimi i mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të pronësisë intelektuale nisi aty nga çereku i fundit i shekullit të XIX, ndërsa vetë nocioni i pronësisë intelektuale është mjaft i hershëm. Si akti i parë i legjislacionit të brendshëm përmendet një dekret i Venedikut, i 19 marsit 1474, i cili përmban dispozita me karakter të përgjithshëm për sistemin e shpikjeve dhe patentave. Thelbi i tyre përmblidhet në të drejtën e autorit për të pasur autorësinë e veprës apo krijimit të tij, të drejtën për shpërblim dhe detyrimin e shtetit për t'ia mbrojtur atë[1]. Në Francë, me 1551 Theseus Mutio-s iu dha patenta e parë për prodhimin e qelqit[2]. Sistemi i patentave u përhap më vonë edhe në vende të tjera në Europë. Akti i parë juridik që legjitimoi pronësinë intelektuale ishte Dekreti i Venedikut, akt i cili daton shumë kohë përpara kodifikimit klasik të Xhon Lokut në shek. XVII. Midis viteve 1750 dhe 1870, në kontinentin europian u vërtetuan ndryshime të rëndësishme që u shprehën në rritjen e qyteteve, ndërtimin e hekurudhave, investimin e kapitalit, rritjen e ekonomisë transoqeanike, zhvillime këto që favorizuan konsolidimin e disa prej elementëve kryesorë të pronësisë intelektuale. Në këtë kohë, në Angli, në vitin 1710, u miratua dhe hyri në fuqi një akt i posaçëm që njihet me emrin Statuti i Anës. Ai kishte si objekt rregullimi kufizimin në kohë të të drejtave të mëparshme të botuesve[3].

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Massachusetts, në tetorin e vitit 1845, haset termi *pronësi intelektuale*, gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore që kishte të bënte me një patentë. Në vendimin e gjyqtarit thuhej ndër të tjera se *"vetëm në këtë mënyrë ne mund të mbrojmë pronësinë intelektuale, punën e mendjes, prodhimtarinë dhe interesat që një njeri zotëron, sikurse gruri që ai kultivon, sikurse tufa që ai rrit".* Në Europë, ky term në formën *propriété intellectuelle* u përmend në botimin e francezit A. Nion në botimin e tij të vitit 1846, me *titull Droits civils des auteurs, artistes et inventeurs*[4]

Në vitin 1400, në Evropë u përdorën shenjat e publikuesit të librave ose veprave të shkruara, për të identifikuar shtypshkronjën përkatëse. Ndërkohë që, në vitet 1500, emblemat dekoronin pallatet ekështjellat e fisnikëve, bujtinat dhe tavernate asaj kohe. Në këtë periudhë kohorefilloi përdorimi i tyre gjerësisht në tregti. Në vitin 1618, në Angli u gjykua çështja e parë gjyqësore Southern kundër How (1617)[5], që është konsideruar se nëmënyrë të tërthortë ka prekur edhe çështjen e markës tregtare, ndërkohë që Schechter ka deklaruar se çështja Schecter kundër Sykes, (1824) është "çështja e parë e raportuar që përfshin mbrojtjen e markave tregtare nga një gjykatë angleze e Common Law"[6]. Në vitin 1751, prodhuesve të mobiljeve në Paris, iu kërkua të nënshkruanin punën e tyre me një shenjë apo markë tregtare. Vlen për t'u përmendur fakti që, në vitin 1857, në Francë u krijua sistemi i parë

[1] Dekreti konsiderohet si akti që legjitimoi pronësinë intelektuale shumë kohë përpara kodifikimit klasik të Xhon Lokut në shek. XVII. Sipas May, C. (2000), A Global Political Economy of Intellectual Property Rights. The New Enclosures? Londres, Routledge, p. 24-26 dhe Phillips, J. (1982), The English Patent as a Reëard for Invention: the Importation of an Idea, Journal of Legal History, n˚ 3 (1), f. 71-79. Sistemi venedikas i patentave mbronte në mënyrë mjaft korrekte « pronarët intelektualë », çka krijoi siguri te ata për t'i importuar në vende të tjera.

[2] Mandich, G. (1948), Venetian Patents (1450-1550), Journal of the Patent Office Society n˚ 30 (3), f. 206

[3] Muller, Arthur. R., Davis, Michael.H, *Intelectual Property*, 1991, West Publishing Company, P.O.BOX 64526, f.280

[4] Nion, Alfred. *Droits civils des auteurs,* artistes et inventeurs, ou Applications des dispositions du Code civil, de commerce et de procédure aux droits attribués par les lois existantes aux auteurs et inventeurs en matière d'art, de science, de littérature et d'industrie: mémoire qui a remporté la première médaille d'or au concours ouvert en 1844, entre les docteurs, devant la Faculté de droit de Paris... Publisher Joubert, 1846, Ghent University, Digitized 8 Jun 2010.

[5] http://respectfortrademarks.org/tricks-of-the-trademark/history-of-trademarks/

[6] Stolte, Keith M. *How Early Did Anglo-American Trademark Law Begin?* An Answer to Schechter's Conundrum to Schechter's Conundru, Fordham Intellectual Property, Media and Entertainment Law Fordham Intellectual Property, Media and Entertainment Law Journal Journal (1997), Vol. 8, Nr. 2, Art. 6

gjithpërfshirës i markës tregtare, i themeluar nga Ligji mbi Markat e Prodhimit dhe Tregtisë (Ligji i 23 Qershorit 1857, për Markat Tregtare). Në vitin 1875, në Gjermani u miratua dhe hyri në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Markave Tregtare (Gesetz über Markenschutz), i cili konsiderohet të jetë ligji i parë gjerman i markës tregtare.

Ekzistojnë prova që një formë arkaike e patentës është njohur që në Greqinë e Lashtë. Sipas citimit të Phylarchus, në vitin 500 para Krishtit, në qytetin grek të Sybaris iu dhanë të drejta ekskluzive, për një vit, krijuesve të pjatave unike të kuzhinës[7]. Deri në shekullin e XVI-të, Kurora Mbretërore angleze kishte prerogativë për dhënien e patentave për mallra të ndryshme. Zakonisht jepej e ashtuquajtura "letra-patentë" për personat e favorizuar nga Kurora, ose për individëqë paguanin për to. Në këtë mënyrë, u krijuan monopolet e tyre nësektorë të caktuar të ekonomisë, në atë periudhe kohore[8]. Kjo taktikë u përdor në atë kohë, për të mbledhur pasuri për Kurorën Britanike, e cila dha patenta për të gjitha llojet e mallrave të zakonshëm. Në kushtet kur abuzimi u bë tepër i dukshëm, gjykatat angleze filluantë kufizojnë rrethanat në të cilat lejohej dhënia e patentave. Pas protestës publike, James i I-rë i Anglisë u detyrua të revokojë të gjitha monopolet ekzistuese dhe tëdeklarojë se ato do të përdoreshin vetëm për "projektet e shpikjeve të reja". Një parashikim i tillëu përfshi në Statutin e Monopoleve, në të cilin Parlamentianglezkufizoi në mënyrë të qartë fuqinë e Kurorës, me qëllim që Mbreti të lëshonte vetëm letra-patentë për shpikësit ose prezantuesit e shpikjeve origjinale, për një numër të caktuar vitesh. Ky parlament hodhi poshtë gjithashtu të gjitha monopolet ekzistuese, me përjashtim të rasteve, kur në saje të punës së kryer kishte rezultuar në prodhime të reja të shpikësve të vërtetë dhe fillestarë të tyre. Statuti i Monopoleve u bë themeli për zhvillimet e mëvonshme në ligjin për Patentat në Angli dhe nështetet evropiane të asaj kohe. Autokanoni i hershëm i James Puckle (1718) ishte një nga shpikjet e para, për të cilën u kërkua të jepej një licencë për patentë.

Pronësia industriale në Shqipëri i ka fillimet e saj qysh në vitin 1920. Nga burimet arkivore[9] të kohës mësojmë se tregtarët shqiptarë kanë qenë të ndjeshëm ndaj ruajtjes së produkteve të tyre nga falsifikatorët. Për të realizuar këtë, ata kërkonin mbrojtjen e prodhimeve të tyre me anë të regjistrimit të markës. Çertifikata e parë për markë tregtare daton në 16 prill të vitit 1920, lëshuar për markën "HOBDARI". Kjo markë u përdor për produktet e kompanisë "Hobdari" e cila krijoi fabrikën e sapunit, që nga fillimi i vitit 1914. Në këtë periudhë janë mbrojtur një numër i madh markash tregtare të huaja në Shqipëri. Regjistrimi i markave tregtare ishte në fuqi deri në vitin 1944. Në vitin 1957, qeveria e asaj kohe, me vendimin e vet, njohu regjistrimin e markave të huaja në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kohë ishte Byroja e Regjistrimit të Markave pranë Dhomës së Tregtisë, nën varësinë e Ministrisë së Tregtisë së Jashtme, institucioni përgjegjës për regjistrimin e markave. Kjo Byro plotësonte dokumentacionin përkatës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi "Dekreti nr. 2490 datë 22.07.1957, ndryshuar me dekretet nr. 3530 datë 02.07.1962 e Nr. 4253 datë 11.04.1967 "Për Markat e Prodhimit dhe Tregtisë".

Ky dekret parashikonte edhe kriteret për regjistrimin e markave të prodhimit nga ndërmarrjet shtetërore. Për sa i përket patentave për shpikjet, në Republikën e Shqipërisë nuk ishte dhënë asnjë patentë shqiptare për shpikje, si dokument fizik i lëshuar konform standardeve (ligjeve) mbi të cilat veprohej në vendet e tjera apo nga organizmat e specializuara ndërkombëtare në këtë fushë.

Mungesa e legjislacionit mbi patentat për shpikje apo më gjerë mbi pronësinë industriale, përbënte një pengesë themelore të zhvillimit të sistemit të pronësisë industriale në vend. Gjithashtu, në Republikën e Shqipërisë mungonin botimet dhe tekstet mbi pronësinë industriale dhe nevojitej një staf i kualifikuar për të ngritur zyrën e pronësisë industriale në vend, për këtë arsye u pa i domosdoshëm anëtarësimi në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (OBPI), si dhe suporti dhe asistenca teknike e saj. Në këto kushte, nisur dhe nga zhvillimet e kohës, kur vendi ynë do të hynte në rrugën e ekonomisë së tregut, me pjesëmarrjen në takimin "Task Force Meeting in the framework of UNDP Regional Program for the Fifth Cycle (1992 – 1996)", 30 Sept. – 4 Oct. 1991, Celakovice,

---

[7] Phylarchus of Naucratis, *"The Deipnosophists, or, Banquet of the Learned of Athenæus"*, përkthyer nga greqishtja e lashtë nga H. Bohn12:20, f. 835

[8] Referuar "Blackstone's Commentaries on the Laws of England", (2001), Vol 1, Edited by Wayne Morrisone Routledge-Cavendish, citohet "Grantet e mbretit janë gjithashtu çështje të rekordit publik. Sepse, siç thotë Shën Germyn, përsosmëria e mbretit është e lartë në ligj.... Dhe për këtë qëllim janë ngritur një sërë zyrash, duke komunikuar në mënyrë të rregullt njëra me tjetrën, dhe përmes së cilave të gjitha grantet e mbretit do të kopjohen dhe regjistrohen...."

[9] https://dppi.gov.al/rrethdppi/historiku-i-dppi/

Czechoslovakia, përfaqësuesit e Komitetit të Shkencave dhe Teknologjisë, parashtruan nevojën për një ndihmë emergjente për Republikën e Shqipërisë përmes një projekti të UNDP për ngritjen e institucioneve në fushën e pronësisë industriale[10]. Propozimi dhe materiali i paraqitur nga delegacioni shqiptar u prit me mjaft entuziazëm nga OBPI dhe menjëherë filloi puna për përgatitjen e bazës ligjore për ngritjen e zyrës së patentave shqiptare dhe për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në OBPI, me qëllim që të mundësohej suporti nga kjo organizatë për ngritjen e sistemit të pronësisë industriale. Depozitimi nga Qeveria Shqiptare i instrumentit të aderimit të Shqipërisë në "Konventën e Themelimit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale", u krye në Mars të vitit 1992, që hyri në fuqi më datë 30.06.1992. Që nga kjo datë, Republika e Shqipërisë u bë vend anëtar me të drejta të plota i OBPI.

Kështu, më datë më 22 Mars të vitit 1993 me vendimin e Këshillit të Ministrave për themelimin e Zyrës së Patentave për Shpikje, me propozim të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë u themelua "Zyra e Patentave Për Shpikje", e cila u ngrit dhe funksionoi për shumë vite pranë këtij komiteti. Me zhvillimet e mëtejshme u krye edhe aderimi në Konventën e Parisit "Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale", e miratuar në Paris më 20 Mars të vitit 1883, hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, më 4 Tetor të vitit 1995, e cila një nga traktatet e para në botë për pronësinë industriale, e cila krijon një bashkim të rregullave dhe parimeve për trajtimin e pronësisë industriale nga vendet anëtare, si dhe vijoi aderimi në pjesën më të madhe të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare mbi mbrojtjen ndërkombëtare të markave tregtare, disenjove industriale, dhe patentave për shpikjet. Gradualisht u përmirësuan edhe kapacitetet administrative dhe institucionale të Zyrës.

Në vitin 2000, Zyra mori emërtimin "Drejtoria e Patentave dhe Markave" dhe veprimtaria e saj si institucion qendror publik, ishte në varësi të Këshillit të Ministrave, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 313 datë 13.06.2000, "Për Funksionimin e Drejtorisë së Patentave dhe Markave". Me ligjin nr. 9525 datë 25.04.2006, Drejtoria e Patentave dhe Markave bëhet institucion publik në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Aktualisht, institucioni mban emërtimin "Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale", emërtim ky, i vënë me qëllim gjithëpërfshirjen e aktivitetit të saj për regjistrimin e të gjitha objekteve të pronësisë industriale dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë.

3. Rëndësia e pronësisë industriale

Pronësia industriale është një ndër problemet kyçe që bizneset, individët dhe shpikësit përballen në baza ditore. PI është e lidhur ngushtë me të gjitha kombet dhe që luan një rol të rëndësishëm në të gjitha kulturat dhe që merr pjesë në zhvillimin e shoqërive. Kështu fuqia e kreativitetit dhe inovacionit e shfaqur nëpërmjet të shprehurit artistikisht është një burim potencial i pa-limituar që secili prej nesh e ka këtë kapacitet në dispozicion. Dhe ky kapacitet, i vënë në pah nga pronësia intelektuale mund të shërbejë për të dhënë kontributin në rritjen e pasurisë të individëve dhe në të ardhmen e një kombi në anën materiale, kulturore dhe sociale.

Pronësia industriale paraqet rëndësi të madhe për faktorë si:

- Mbrojtja e biznesit dhe luftimi i ekonomisë joformale— Referuar stastikave të tregut të BE, bizneset e veshjeve humbin për shkak të falsifikimit të produkteve dhe elementeve të pronësisë intelektuale, bizneset humbin një shumë prej 12 bilion euro, çka sjell punësimin e një numri më të ulët të punonjësve, me një humbje rreth 160 000 vende pune. [11]
- Inovacioni i hapur - 'Inovacion i hapur' i referohet bashkëpunimit të kompanive dhe ndërmarrjeve në zhvillim të ideve inovative. Disa nga avantazhet e identifikuara të inovacionit të hapur janë ndarja e rrezikut, reduktimi i kostos, qasja preferenciale në tregje, etj. Rëndësia e pronësisë intelektuale në këtë drejtim vihet në pah për shkak se u lejon kompanive të hedhin në treg idetë e tyre, pa rrezikun e përvetësimit nga ndonjë palë tjetër. Kështu, pronësia intelektuale në kontekst të inovacionit të hapur

[10] Ibid.

[11] EUIPO, *Economic impact of counterfeiting in the clothing, cosmetics and toy sectors in the EU*, January 2024, f. 3.

konsiderohet si mundësi e bashkëpunimit, përkundër perceptimit për të shërbyer si pengesë ndaj konkurrencës prej kompanive të sektorit. [12]

- Mbrojtja e konsumatorit - Shëndeti dhe mirëqënia e konsumatorit duhet të jenë fokusi i kompanive dhe bizneseve, varësisht natyrës së ndryshme të produkteve që tregtojnë. Produktet e falsifikuara të cilave u mungon cilësia dhe nuk zbatojnë standardet e duhura mund të përbëjnë kërcënim në aspektin e sigurisë dhe shëndetit, duke ditur që një pjesë e madhe e mallrave të falsifikuara janë lodra apo produkte mjekësore.
- Mbrojtja e punësimit - Sikurse u citua, në momentin kur produkte të ndryshme janë lehtësisht të falsifikuara, bizneset dekurajohen dhe humbasin interesin të investojnë në ide të reja innovative. Ky zinxhir ndikon padyshim tek punëtorët, të cilët humbasin vendet e tyre të punës.

Ekonomia e Republikës së Shqipërisë bazohet në sektorët e shërbimit (54.1%), bujqësisë (21.7%) dhe industrisë (24.2%). Vendi ka disa burime natyrore. Ekonomia mbështetet kryesisht nga bujqësia, përpunimi i ushqimit, lënda drusore, nafta, çimentoja, kimikatet, minierat, metalet bazë, hidrocentralet, turizmi, industria e tekstilit dhe nxjerrja e naftës. Sektorët më të fortë janë energjia, minierat, metalurgjia, bujqësia dhe turizmi. Eksportet kryesore industriale janë veshja dhe kromi. Këto janë fushat ku është e nevojshme për të kërkuar fillimin dhe pastaj zhvillimin e sektorëve të tjerë. Mjedisi stimulues në të cilin bizneset, industritë dhe individët mund të presin që puna dhe investimi i tyre inovativ dhe krijues të mbrohen dhe do të bien në tokë pjellore varet shumë nga sistemi kombëtar i pronës intelektuale efikase dhe të prosperuar[13].

Çfarë synohet në fushën e pronësisë intelektuale është stimulimi i zhvillimit ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend, sigurimi i një funksionimi të përshtatshëm të tregut të brendshëm duke vendosur ekuilibrin e duhur ndërmjet të drejtave të pronarëve të objekteve të pronësisë intelektuale dhe interesave të përdoruesve, si dhe forcimi i sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së PI. Këto synime janë të pasqyruara në Strategjinë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025. Në të njëjtën linjë, qëllimi i kësaj strategjie është të forcojë sistemin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë dhe ta bëjë atë të krahasueshme me vendet e Bashkimit Evropian, si një mekanizëm stimulues të zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor në Republikën e Shqipërisë si shtylla të rëndësishme në ekonominë e një vendi. Ky qëllim arrihet nëpërmjet: - ofrimit të një sistemi të besueshëm dhe efikas të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale; - nxitjes, zhvillimit dhe shfrytëzimit ekonomik të pronësisë intelektuale. - prioritetet strategjike vijnë si rezultat i detyrimeve që rrjedhin nga: 1) Marrëveshja e StabilizimAsociimit (MSA); 2) Raportet vjetore të Komisionit Evropian për Shqipërinë; 3) Marrëveshja TRIPS dhe acquis i BE-së. Për vite me rradhë, DPPI-ja ka pasur në detyrat e saj përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së dhe ka qenë e prirur t'i kushtonte vëmendje sa më të madhe rregullimit të kornizës ligjore, nënshkrimit të konventave të ndryshme ndërkombëtare, si dhe lehtësimit të faktorëve mbrojtës për subjektet që referon ligji. Legjislacioni kombëtar momental i pronësisë industriale në Shqipëri është i plotë edhe pse në praktikë ka problematikat e veta, megjithatë duke qenë se Shqipëria është pjesë e disa marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare, e vë Shqipërinë në situate më të sigurte Ligjore.

4. Pronësia industriale në Bashkimin Evropian

E drejta e pronësisë industriale në Bashkimin Evropian përfshin format themelore dhe ato të reja të llojeve të PI. Regjistrimi i pronësisë intelektuale mund të jetë i nivelit kombëtar, Evropian, apo Ndërkombëtar, varësisht se në çfarë niveli pronari i punës dëshiron ta mbrojë pronën. Sipas niveleve, kemi tri ndarje:

- Rruga Kombëtare - që përfshin Zyrat Kombëtare të shteteve për pronësi intelektuale.
- Rruga Evropiane - që përfshin Zyrën Evropiane për Patenta dhe Zyrën për Harmonizimin e Tregut të Brendshëm.
- Rruga Ndërkombëtare - që përfshin Organizatën Botërore për Pronësi Intelektuale. Për të rishikuar format që pronësia intelektuale merr brenda BE-së, tabela në vijim sipas Udhërrëfyesit Evropian për Pronësi

[12] European Commission, Directorate-General for Communications Networks, Content and Technology, Open innovation yearbook 2015, Publications Office, 2015, https://data.europa.eu/doi/10.2759/92658.
[13] "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale", 2022-2025, f. 8.

Intelektuale radhit shkurtimisht edhe qëllimin e llojit përkatës, mbrojtjen e garantuar në nivelin përkatës në BE dhe atë global, si dhe kohëzgjatjen e regjistrimit:[14]

E drejta e pronësisë industriale	Qëllimi	Mbrojtja e garantuar në BE dhe globalisht	Kohëzgjatja e regjistrimit
Marka tregtare	Shenjë për dallim të produkteve	Nivel kombëtar, të BE si dhe ndërkombatër (WIPO)	E ripërterirë çdo 10 vite pa limit
Patentat	Shpikje/inovacione	Nivel kombëtar/të BE/ndërkombëtar	20 vite
Disenjo industriale	Pjesë estetike e produkteve	Nivel kombëtar/të BE/ndërkombëtar	5 vite
Treguesit gjeografikë	Produkte të origjinave përkatëse gjeografike e tradicionale	Nivel kombëtar/të BE/ndërkombëtar	E pakufizuar në kohë

Brenda Bashkimit Evropian fokus tejet i madh i jepet mbrojtjes së kreativitetit të ideve që domosdoshmërisht i ndihmon biznesit apo organizatës, dhe rrjedhimisht, inkurajimit për kreativitet të vazhdueshëm. Falë sigurisë së shtuar dhe mbrojtjes së pronësisë intelektuale ndaj këtyre ideve, pronarët kanë mbështetje për kontribut të mëtejshëm në zhvillime kreative. Kështu, mbrojtja e pronësisë intelektuale cilësohet si e domosdoshme për inovacion—i cili konsiderohet si aset i paprekshëm për zhvillim. Rëndësi të madhe brenda BE-së i jepet PI edhe për shkak të faktorëve të tjerë si punësimi dhe zhvillimi i konkurrencës.

5. Zbatimi i të drejtave të pronësisë industriale

Organet kryesore të zbatimit në sistemin e pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë, janë[15]:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave- Administrata Doganore Shqiptare në kuadër të misionit fiskal, ekonomik dhe mbrojtës ka për detyrë, mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Intelektuale me qëllim: Mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (pronësinë industriale dhe e drejta e autorit) për mallrat që hyjnë në/ose dalin nga territori shqiptar, me kërkesë të mbajtësve të së drejtës ose ex officio; Mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve; Lehtësimin e tregtisë dhe biznesit të ndershëm; Arritjen e një performance maksimale, me synim plotësimin e kushteve të vendosura nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, për arritjen e plotë të standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian
b) Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është krijuar me VKM-në nr. 36, datë 20.1.2016, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut". ISHMT-ja është institucioni qendror publik, buxhetor në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë dhe është përgjegjës për inspektimin në fushën e sigurisë së produkteve joushqimore për përdorim nga konsumatorët dhe fushën e pronësisë intelektuale. Misioni i ISHMT-së është: i. garantimi i sigurisë së produkteve për konsumatorët; ii. respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Ky mision realizohet nëpërmjet veprimtarisë mbikëqyrëse në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi
c) Drejtoria e Policisë së Shtetit- Veprimtaria e paligjshme në fushën e pronësisë intelektuale, në strukturat e Policisë së Shtetit, është pjesë emisionit të saj në funksion të parandalimit, zbulimit, dokumentimit dhe goditjes së paligjshmërisë edhe kryesisht veprave penale në këtë fushë.

[14] Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, *Pronësia intelektuale në Kosovë dhe Bashkim Evropian*, Janar 2019, f. 14
[15] Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025, f. 44-57

d) Prokuroria- Sipas raportit nga Zyra e Prokurorisë në Tiranë, jo shumë çështje penale për shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale ndiqen penalisht. Në vitin 2019, kishte vetëm 39 raste të ndjekjes penale. Mbajtësi i së drejtës konsiderohet viktimë dhe ka të drejtë të ndjekë dhe të ndërhyjë në procedurë. Përfaqësuesit e prokurorisë raportuan se statistikat për çështjet e ndjekura janë në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë për të gjithë vendin.
e) Gjykatat- U raportua[16] se gjyqtarët dhe DPPI-ja bashkëpunojnë në përgatitjen e akteve legjislative, të cilat rezultojnë në zbatim më të mirë gjyqësor dhe cilësi më të mirë të gjykimeve. Ekzistojnë procedura gjyqësore për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale
f) Ministria e Drejtësisë- Duke vlerësuar se pronësia intelektuale është një ndër çështjet thelbësore të zhvillimeve të së drejtës, të drejtave të njeriut, të tregtisë, të administratës publike, të kriminalitetit, si dhe mbrojtja e saj është pjesë e pandashme e zhvillimeve rajonale dhe ndërkombëtare, Ministria e Drejtësisë ka qenë e angazhuar në hartimin dhe konsolidimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016–2020. Roli i saj në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016–2020 ka qenë të hartojë dhe të ndjekë procedurat për ndryshimet e Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, të inicuara nga institucione të përfshira në fushën e Pronësisë Intelektuale si dhe të bashkëpunojë me institucionet respektivisht përgjegjëse lidhur me trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në përgjithësi si dhe në fushën e Pronësisë Intelektuale, në veçanti.
g) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është një institucion mbështetës në lidhje me zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Vjelja korrekte e tatimeve ndihmon në garantimin e respektimit të legjislacionit të pronësisë intelektuale.

6. Studim konfliktesh për të drejtat e pronësinë industriale

Në rastin e një marke tregtare, pronari ka të drejtë të përjashtojë gjithë bizneset e tjera nga përdorimi i një marke të njëjtë. Nëse një individ apo organizatë e kopjon atë markë në një farë mënyre, pronari që e ka rregjistruar i pari markën ka të drejtë t'i drejtohet institucioneve gjyqësore vendase ose të huaja. Çdo kompani ka një brand dhe emër të vetin. Në këtë rast njerëzit mund të blejnë produktin menjëherë sapo shikojnë emrin e besuar. Nëse një produkt hidhet në treg duke përdorur të njëjtën mënyrë ekspozimi, klienti do të niset nga emri i mirë që ka e njëjta markë por nuk do të marrë të njëjtën kënaqësi nga konsumimi i këtij produkti. Rëndësia e regjistrimit të markës, nënkupton dhe se nëse një kompani ka një produkt dhe nuk e ka të rregjistruar në institucionet përkatëse, një konkurent i tij mund të tregohet më i shkathët dhe të regjistrojë i pari produktin, duke përfituar dhe madje duke detyruar kompaninë, që mund të jetë e para në treg që ka krijuar një produkt të caktuar, të tërheqë nga tregu produktin, pasi ai tanimë është pronë e dikujt tjetër.

- Rasti i B52, luftë për markën e falsifikuar

Përfaqësuesit ligjor në Shqipëri të shoqërisë "Bavaria", një shoqëri që importon pije origjinale nga Holanda, shpjegojnë se kompania shqiptare "Arseni shp.k", prodhon vet pijen B52, në Gostivar të Maqedonisë dhe në kanaçe vendos emërtimin prodhues dhe importues në Evropë, duke nxjerr në treg 2 lloje të pijeve të falsifikuara, në shkelje të ligjeve dhe të drejtës së markës[17]. Në fakt, kompania "Arseni" shpk ka qenë distributor i "Bavarisë" dhe B52 origjinal, por vetëm nga viti 2006 deri më 2010. Pas 2010, "Arseni shpk" ka filluar të prodhojë vetë pijen në mënyrë të paligjshme.

Diskutimi ka nisur kur ne doganën e Shkodrës u bllokuan 432 mijë copë kanaçe të pijes joalkoolike B-52, që bëjnë në total një sasi prej 108 mijë litrash të ngarkuara në 5 trajlera. Arsyeja e bllokimit është se autoritetet doganore kanë dyshuar në lidhje me cënimin e një të drejte të pronësisë industriale, përkatësisht të markës tregtare B-52. Pas dërgimit të çështjes në gjyq nga prodhuesi "Arseni shpk", Gjykata e shkallës së parë në Shkodër, vendosi

[16] Raporti i Rekomandimeve të WIPO.

[17] Pija origjinale e prodhuar nga shoqëria Bavaria është me ngjyrë ngri dhe gërma të kuqe, ndërsa pija që tregtohet nga kompania shqiptare përdor ngjyrën gri me blu dhe jeshile me blu.

të shfuqizojë mbrojtjen e markës b52 me pronar Shoqëria "Bavaria" N.V. [18] Gjykata e Apelit e la në fuqi këtë vendim. Pasi çështja shkon në Gjykatën e Lartë[19], kjo e fundit lë në fuqi vendimin e apelit me arsyetimin se: *Referuar datës prioritare 19.02.2008 që është regjistrimi në vendin e origjinës, nga ana e palës së paditur Shoqëria "Bavaria" N.V, dhe referuar nenit 147 të ligjit nr. 9947/2008, ka depozituar kërkesën e datës 24.06.2008 (brenda 6 muajve me datë prioriteti datën 19.02.2008), për regjistrim ndërkombëtar për një listë shtetesh në të cilën nuk bënte pjesë Shqipëria. Shtesë për shtete të tjera per mbrojtje me datë prioriteti datën 19.02.2008 pala e paditur mund ta bënte deri në datë 19.8.2008. Një gjë e tillë nuk ka rezultuar e provuar nga gjykatat e faktit. Për sa më sipër sikurse përcakton Konventa e Parisit dhe neni 147 i ligjit të sipërcituar, Gjykatat kanë interpretuar drejt kur pranojnë se kërkesa për të zgjeruar mbrojtjen ndërkombëtare edhe për sa i përket Shqipërisë është më datë 21.10.2008 dhe duke arritur në konkluzion e drejtë se kjo është datë e mëvonshme e regjistrimit në raport me atë të palës së paditur.*

Çfarë vërehet nga këto vendime është se gjykata është orientuar në zgjidhjen e konfliktit gjyqësor përsa i përket regjistrimit të markës në vendin tonë dhe mbrojtjes së markës së regjistruar më parë. Pra, ndonëse vërehet se ka ngjashmëri mes markave, gjykata ka theksuar rëndësinë e rregjistrimit më para në kohë.

Marka tregtare në Republikën e Shqipërisë është regjistruar fillimisht nga subjekti Neniko Dooel Ljubisha me datë aplikimi 18.04.2008 dhe me datë regjistrimi 06.11.2008, me kohëzgjatje të mbrojtjes deri në datë 18.04.2018. Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve është Klasa 32 sipas klasifikimit ndërkombëtar të Nice – pije jo-alkoolike, pije energjike, pije sportive. Në vitin 2010 është bërë kalimi i pronësisë me kontratë tek paditësi në proces, për të cilin nuk ka asnjë lloj keqbesimi në regjistrimin e markës si dhe në blerjen e saj. Ndërsa pala e paditur Shoqëria "Bavaria N.V.", Markën B-52 e ka regjistruar përfundimisht në Beneluks me datë 22.02.2008, me nr. regjistrimi 838872. Nga ana tjetër Shoqëria "Bavaria N.V." ka bërë një aplikim për regjistrim ndërkombëtar më datë 20.06.2008 dhe marka tregtare B-52 është regjistruar përfundimisht më datë 24.06.2008, me nr. regjistrimi ndërkombëtar 970878. Pas regjistrimit ndërkombëtar të markës në pronësi të saj B-52, Shoqëria "Bavaria N.V." ka bërë një aplikim ndërkombëtar pranë "WIPO-s" për të shtrirë efektet e mbrojtjes së markës së saj edhe në Shqipëri. Data e aplikimit për përcaktimin e Shqipërisë si vend ku kërkohet mbrojtja e markës tregtare B-52 është bërë me datë 21.10.2008. Përfundimisht, data e regjistrimit të Shqipërisë si shtet i përcaktuar është 12.02.2009. Pra, data e aplikimit për mbrojtjen e markës B-52 pala e paditur e ka bërë në datë 21.10.2008 dhe regjistrimi në datë 12.02.2009, që është një datë më e vonshme nga regjistrimi i markës së palës paditëse në proces. Pala e paditur keqinterpreton datën e regjistrimit të markës së palës paditëse në Beneluks me atë të regjistruar në Shqipëri, ndaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka pranuar pjesërisht padinë e ngritur në proces.

- S.E kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Shtetasi I.B ka sjellë përmes Aeroportit Nënë Tereza, disa artikuj (atlete, çanta, rripa) të markave "Adidas e Louis Vuitton", artikuj të cilat janë bllokuar nga Dogana Rinas pasi nuk janë origjinale por të falsifikuara. Nëpërmjet shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave Nr. 116/1 prot., datë 21.04.2016, i bëhet me dije organit të akuzës së markat Nike, Adidas, Converse All Star dhe Lacoste, rezultojnë të regjistruara pranë kësaj Drejtorie. Oficerët e policë gjyqësore kanë referuar materialin procedural në ngarkim të shtetasit I.B, për shkak se ky i fundit ka konsumuar veprën penale të "shkelja e pronësisë industriale", parashikuar nga neni 149/a i Kodit Penal. Kjo dispozitë i referohet ndër të tjera, a) mbajtjes për qëllime tregtimi të produktit pa pëlqimin

[18] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7121 datë 24.06.2013 ka vendosur:
Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë.
Shfuqizimin e mbrojtjes së Markës B-52, me nr. 1082916 regjistrimi, me pronar Shoqëria "Bavaria" N.V.
Regjistrimin e këtij vendimi shfuqizimi në Regjistrin e Markave të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave.
Rrëzimin e kërkesë-padisë për pjesën tjetër të saj.
Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.
Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1868, datë 06.05.2014 ka vendosur:
Lënien në fuqi të vendimit nr. 7121, datë 24 .06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
[19] Vendim Nr. 112 datë 05.10.2017.

e pronarit të patentës: b) produktit që mbrohet nga dizenjo industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenjos, c) mallrave që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës ç) si dhe produktit që rrjedh nga një tregues gjeografik, pa pëlqimin e pronarit të treguesit.

Shtetësja S.E, me kërkesë të së cilës, është kërkuar shkatërrimi i artikujve të bllokuara nga Dogana, rezulton se ka një kontratë partnership-i për Shqipërinë me 'React" Organization, me seli në Hollandë. Kjo organizatë funksionon prej 25 vitesh duke operuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale përfshirë këtu dhe markat tregtare Adidas e Louis Vuitton. Me vendimin Nr. 21 të Degës së Doganës Rinas, me nr. Prot., 1317 datë 22.04.2016, është urdhëruar shkatërrimi me procedurë të përshpejtuar të artikujve "atlete inkeliti 352 palë të markës "adidas", 26 çanta dore dhe 8 copë rripa mesi inkeliti të markës "Louis Vuitton".

Prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes, kërkesë që është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. Akti 1057 datë 31.10.2016, me arsyetimin: Personi i cili është cënuar nga futja në territorin shqiptar të mallrave të falsifikuar, ka shfrytëzuar të drejtën e tij për t'i asgjësuar këto mallra, të cilat janë të ndaluara për qarkullim tregtar për shkak të origjinës së prodhimit të tyre.

I.B ka shpjeguar se mallrat janë blerë në tregun e lirë të Stambollit, nëpër dyqane të ndryshme, emërtimet e të cilëve nuk i kujtohen. Një shpjegim i tillë është konstatuar i besueshëm nga organet e drejtësisë, duke patur në konsideratë sasinë dhe mënyrën e transportit të mallrave të mbërritura në Shqipëri, por edhe ecurinë e aktivitetit të deklaruesit.

Çfarë vërehet në këtë vendim është që organit të akuzës i ka mjaftuar vetëm hetimi i plotë përsa i përket gjendjes së mallrave dhe historikut të tyre në territorin shqiptar. Mendoj se duhet të ishte vazhduar hetimi duke verifikuar itinerarin e mallrave, objekt kallëzimi, që nga Turqia drejt Shqipërisë dhe duhej identifikuar dërguesi i mallrave gjë që do të sillte për organin e akuzës një panoramë më të qartë të aktivitetit objekt hetimi.

7. Konkluzione dhe rekomandime

Zhvillimet në fushën e pronësisë intelektuale kanë marrë fokus më të madh me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Premtues është edhe fakti që nuk ka mungesë të institucioneve përkatëse për të adresuar pronësinë intelektuale. Megjithatë, zhvillime të mëtejshme mund të ketë edhe në çështje si në vijim:

- Duhet të vijohet me përmirësimin e kuadrit ligjor, duke u përshtatur me legjislacionin evropian si dhe duke ndarë secilën kategori të pronësisë industriale në ligje/vendime të ndryshme nga njëra tjetra me qëllim fokusimin në çdo element të tyre;
- Duhet të ratifikojmë Konventa e Marrëveshje të tjera, që përfshijnë shtete jashtë Kontinentit Evropian (psh Traktatin e Singaporit të Ligjit të Markave Tregtare) dhe që synojnë t'i garantojë mbrojtje më të gjerë përfituesve që kanë të rregjistruar një produkt që është pjesë e pronësisë industriale;
- Kompanitë dhe bizneset duhet të trajnojnë punonjësit e tyre mbi rëndësinë e kësaj disipline duke i bërë ata vigjilent ndaj shkelësve të të drejtave që përfitojnë pronarët e një marke/patente, në mënyrë që produkti i tyre të jetë unik në treg dhe të mos cënohet në asnjë moment vendi i punës së punonjësve për shkak të humbjes së ideve inovatore që mund të kenë pronarët si pasojë e falsifikimit të ideve të tyre;
- Institucionet përkatëse për pronësi intelektuale duhet të trajtojnë në mënyrë të vëmendshme rastet e ngritura për shkelje të pronësisë intelektuale. Gjithashtu, duhet të vendosen dispozita për kompensim të duhur në rast të shkeljeve të pronësisë intelektuale. Adresimi i vëmendshëm i shkeljeve dhe rasteve që veçse janë ngritur tek autoritetet, inkurajojnë popullsinë që të trajtojnë shkeljet e PI si diçka serioze dhe inkurajojnë në investim dhe mbledhje të ideve inovative, pa pasur mos-siguri për abuzim të mundshëm të punës dhe neglizhencës institucionale;
- Qendra e Trajnimeve pranë DPPI-së të rrisë numrin e trajnimeve duke përfshirë grupe të ndryshme interesi;
- Trajnimi dhe aftësimi i personelit të doganave për pronësi intelektuale është pa dyshim një ndër parakushtet më me rëndësi të mbrojtjes së përfitimeve që sjell DPI. Mallrat pirate paraqesin dëm të mëdha për ekonominë, kështu që monitorimi efikas në kapacitete të doganës është kyç;
- Duhet t'i kushtohet vëmendje sigurisë kibernetike, duke rritur kapacitetet zbatuese përmes strategjive efikase dhe informimit të punonjësve;

- Duhet vijuar trajnimi i gjyqtarëve/prokurorëve mbi këtë fushë, duke trajtuar edhe çështje të komplikuara, me qëllim aftësimin e këtyrë të fundit në zgjidhjen e drejtë të çështjeve.
- Duhet vijuar me zbatimin e rekomandimeve të ËIPO apo përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. European Union Intellectual Property Office (EUIPO), *Economic impact of counterfeiting in the clothing, cosmetics and toy sectors in the EU*, January 2024.
2. Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut (ISHMT), 2024, *Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025*.
3. Mandich, G. (1948), Venetian Patents (1450-1550), Journal of the Patent Office Society n˚ 30 (3).
4. May, C. (2000), A Global Political Economy of Intellectual Property Rights. The New Enclosures? Londres, Routledge.
5. Muller, Arthur. R., Davis, Michael H. *Intelectual Property*, 1991, West Publishing Company, P.O.BOX 64526.
6. Phillips, J. (1982), The English Patent as a Reward for Invention: the Importation of an Idea, Journal of Legal History, n˚ 3 (1).
7. Publisher Joubert, 1846, Ghent University, Digitized 8 Jun 2010.
8. Phylarchus of Naucratis, "The Deipnosophists, or, Banquet of the Learned of Athenæus", përkthyer nga greqishtja e lashtë nga H.Bohn 12:20, f. 835
9. Stolte, Keith M. *How Early Did Anglo-American Trademark Law Begin?* An Answer to Schechter's Conundrum to Schechter's Conundru, Fordham Intellectual Property, Media and Entertainment Law Fordham Intellectual Property, Media and Entertainment Law Journal Journal (1997), Vol. 8, Nr. 2, Art. 6.
10. World Intellectual Property Organization (WIPO), 2024, Raporti i Rekomandimeve.

Jurisprudencë

1. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 7127, datë 24.06.2013.
2. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1057, datë 31.10.2016.
3. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 1868, datë 06.05.2014.
4. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 112, datë 05.10.2017.

Web faqe

1. http://respectfortrademarks.org/tricks-of-the-trademark/history-of-trademarks/
2. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Induistriale (DPPI), 2024, https://dppi.gov.al/rrethdppi/historiku-i-dppi/
3. European Commission, Directorate-General for Communications Networks, Content and Technology, Open innovation yearbook 2015, Publications Office, 2015, https://data.europa.eu/doi/10.2759/92658.

COVID-19 DHE ZHVILLIMET E NDIHMËS SHTETËRORE NË BASHKIMIN EVROPIAN DHE NË SHQIPËRI

Doktorante Inesa ADHAMI (LL.M.)[*]

COVID-19 AND STATE AID DEVELOPMENTS IN EUROPEAN UNION AND ALBANIA

Abstract

This article aims to provide a more in-depth description of legislation amendments and procedural policies and their direct effects on all economic sectors of European Union and in our country as well.
The article tends to prescribe all the legal amendments approved by European Commission and provides an analysis of the state aid scheme in our country during Covid-19 situation. Some open questions that derives obviously are as follows: How effective was the new legal framework approved by European Union countries? Which is the impact of the anti-Covid measures in better increasing the financial growth of European Union member states?

The paper ends up with certain conclusions for further improvement of the state aid schemes and their impact for European enterprises and Albanian market.

Keywords: *enterprise, competition, state aid, market, legislation*

1. Hyrje

Krizat janë periudha të cilat shërbejnë për të testuar rregullat dhe parimet dhe për të reflektuar nëse ato duhet të zëvendësohen apo jo pasi duhen krijuar zgjidhje novatore dhe të shpejta. Përhapja e pandemisë Covid-19 pati ndikim të jashtëzakonshëm në ndihmat shtetërore duke u vënë menjëherë në qendër të vëmendjes për shkak se pandemia pati pasoja të menjëhershme ekonomike në pothuajse të gjithë sektorët ekonomikë brenda Bashkimit Evropian. Kjo solli për rrjedhojë nevojën imediate për mbështetje financiare nga një numër i konsiderueshëm shtetesh anëtare.

Një situatë e tillë e paprecedentë shkaktoi një presion në rritje ndaj institucioneve evropiane për të rishikuar legjislacionin dhe rregullat proceduriale të BE-së që rregullonin dhënien e ndihmës nga shtetet anëtare.

2. Pandemia dhe roli i Komisionit Evropian në ndihmat shtetërore

Pas fillimit të pandemisë Covid-19, Komisioni vendosi të miratonte një komunikatë mbi një "Kuadër Ligjor të Përkohshëm për të mbështetur ekonominë në kontekstin e shpërthimit të Covid-19".[1] Bazuar në dispozitat e Traktatit, Komisioni Evropian duhet të autorizojë dhënien e ndihmës "*për të korrigjuar dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose ndodhitë e jashtëzakonshme*" dhe që e lejon atë të autorizojë ndihmën "*për të korrigjuar një shqetësim serioz në ekonominë e një Shteti Anëtar*".

---

[*] Doktorante Inesa Adhami, Juriste pranë Studios Ligjore "Temis&AOK", Doktorante Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, liraspiro@yahoo.com.

[1] Në këtë kontekst, Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen më 10 Mach 2020, ndër të tjera theksoi se Komisioni do të "siguronte ndihma shtetërore për ndërmarrjet që kanë nevojë për to".

Ky parashikim synon të trajtojë si çështjet afatshkurtra me të cilat përballen ndërmarrjet evropiane duke siguruar që likuiditeti i mjaftueshëm të mbetet i disponueshëm për të ruajtur vazhdimësinë e aktivitetit të tyre ekonomik, ashtu edhe pasojat (të mundshme) afatgjata. Nga ana tjetër, numri i konsiderueshëm i masave mbështetëse ndihmëse të njoftuara Komisionit dhe sasia e madhe e fondeve publike që synoheshin të jepeshin për të ndihmuar ekonomitë e shteteve anëtare së bashku me domosdoshmërinë e një miratimi shumë të shpejtë nga Komisioni, ka bërë që shpesh të ngrihej dyshimi nëse parimet bazë të sistemit për kontrollin e ndihmës shtetërore do të ishin ende në fuqi dhe nëse kuadri ligjor i rikonceptuar pas pandemisë do të shërbentë për të trajtuar situatat emergjente duke u kthyer kështu në normalitetin e ri.

Qysh prej vitit 2020, Komisioni ka marrë një sërë hapash në këtë drejtim. Masa e ndihmës së parë shtetërore në lidhje me shpërthimin e Covid-19 përkon më datë 12 Mars 2020, kur Komisioni Evropian miratoi skemën daneze prej 12 milionë euro për kompensimin e dëmeve shkaktuar nga anullimet e eventeve të përmasave të mëdha për shkak të shpërthimit të Covid-19. Kjo ishte masa e parë e ndihmës shtetërore e njoftuar nga një Shtet Anëtar te Komisioni në lidhje me shpërthimin e Covid-19 dhe në lidhje me të Komisioni miratoi skemën sipas rregullave të BE-së për ndihmën shtetërore brenda 24 orëve të marrjes së njoftimit nga Danimarka. Masa u vlerësua nga Komisioni sipas nenit 107(2)(b) të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), e cila i mundëson Komisionit të miratojë masat e ndihmës shtetërore të dhëna nga Shtetet Anëtare për të kompensuar ndërmarrje specifike ose sektorë të veçantë (në formën e skemave) për dëme drejtpërdrejt të shkaktuara nga dukuri të jashtëzakonshme.

3. Komunikata e Komisionit dhe rëndësia e saj. Krijimi i një Kornize të përkohshme për ndihmat shtetërore

Komunikata e Komisionit sic u përmend edhe më sipër u pa si një lloj reagimi i menjëhershëm për të zbutur ndikimin ekonomik të Covid-19. Për këtë arsye më 13 mars 2020, Komisioni lëshoi një komunikatë për Parlamentin Evropian, Këshillin Evropian, Këshillin, Bankën Qendrore Evropiane, Bankën Evropiane të Investimeve dhe Eurogrupin për politika ekonomike koordinuese si përgjigje ndaj shpërthimit të Covid-19.

Kjo komunikatë ju jepte mundësinë shteteve anëtare të bashkimit për të përpiluar masa të shumta mbështetëse në përputhje me rregullat ekzistuese të ndihmës shtetërore si më poshtë vijon:

Së pari, shtetet anëtare mund të vendosin të marrin masa të zbatueshme për të gjithë ndërmarrjet, për shembull pezullim i pagesave i tatimit mbi vlerën e shtuar për ndërmarrjet ose për kontributet sociale[2].

Së dyti, shtetet anëtare mund të japin mbështetje financiare direkt te konsumatorët, p.sh. për shërbimet e anulluara ose bileta që nuk rimbursohen nga operatorët apo agjensitë turistike. Këto masa gjithashtu merren nga shtetet anëtare vetë pa përfshirjen e Komisionit.

Së treti, rregullat e ndihmës shtetërore bazuar në nenin 107(3)(c) TFEU u mundësojnë shteteve anëtare, me miratimin e komisionit të plotësojnë nevojat e menjehershme për likujditet të ndërmarrjeve dhe të mbështesin ato ndërmarrje që iniciuan procedurat e falimentimit për shkak të Covid-19.

Së katërti, neni 107(2)(b) TFBE i mundëson Shteteve Anëtare, subjekt miratimi nga komisioni për të kompensuar ndërmarrjet për dëmin e pësuar në raste të jashtëzakonshme (rrethana si ato të shkaktuara nga shpërthimi i pandemisë). Kjo përfshin masa për kompensim në sektorë që kanë qenë veçanërisht të goditura (p.sh. transporti, turizmi etj).

Së pesti, kjo mund të plotësohet edhe me një shumëllojshmëri masash shtesë, si p.sh Rregullorja De minimis dhe Rregullorja e përgjithshme e përjashtimit në Bllok [3]të cilat gjithashtu mund të gjejnë zbatim të menjehershëm nga Shtetet Anëtare, pa përfshirjen e Komisionit.

Më 19 Mars 2020, Komisoni Evropian njoftoi miratimin e një Kornizë të përkohshme për masat e ndihmave shtetërore për të mbështetur dhe rimëkëmbur ekonomite e shteteve anëtare për të dalë nga kriza financiare. Kështu më 17 Mars 2020, Zëvëndës Presidentja e komisionit Znj. Magrethe Vestager prezantoi një draft propozim i cili

[2] Këto masa zbusin tensionet financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efikase.

[3] Shih Kapitull I.

sqaronte se kjo Kornizë e përkohshme do të ketë efekt plotësues mbi mundësitë ekzistuese të prezantuara në Komunikatën e Komisionit datë 13 Mars 2020.
Kjo Kornizë e përkohshme bazohej në Nenin 107(3)(b) TFBE dhe parashikonte mundësinë e dhënies së 5 llojeve të ndihmave shtetërore të listuara si më poshtë vijon[4]:

i) Grantet direkte, avantazhet taksore dhe pagesat e avancuara: Shtetet anëtare mund të japin fonde deri në vlerën €800,000 në rast nevoje imediate të ndërmarjeve për likujditet.
ii) Garanci shtetërore për kreditë bankare te marra nga ndërmarrjet.
iii) Huatë publike të subvencionuara për ndërrmarrjet. Kështu shtetet anëtare do të mund të jepnin kredi me norma interesi të favorshme për ndërmarrjet. Këto kredi mund të ndihmojnë bizneset të mbulonin nevojat për kapital dhe investime.
iv) Masat mbrojtëse për bankat: Disa shtete anëtare planifikojnë të zgjerojnë kapacitetet kredituese për bankat si një mbështetje për bizneset, në veçanti sipërmarrjet e vogla dhe të mesme[5].

Bazuar në këtë kornize të përkohshme të miratuar nga Komisioni, ky i fundit ka miratuar një numër të konsiderueshëm skemash ndihmëse të njoftuara nga shtetet anëtare si:

- 23 Mars, 2020: Komisioni aprovoi shifren prej €250 million për skemën kredituese të njoftuar nga Letonia për ndërmarrjet e prekura nga koronavirusi.
- 22 Mars 22, 2020: Komisioni aprovoi 50 Milion Euro skemë mbështetëse nga shteti Italian për prodhimin dhe furnizimin me pajisje mjekësore dhe maska gjatë pandemisë.
- 22 Mars, 2020: Komisioni aprovoi 2 masa ndihmëse të marra nga shteti Gjerman të implementuara përmes bankës gjermane Kreditanstalt für Wiederaufbau ("KfW") për të mbështetur ekonominë gjermane gjate pandemisë.
- 21 Mars, 2020: Nga komisioni janë aprovuar DKK 1 billion (rreth €130 milion) skemë garancie Daneze për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të prekura nga koronavirusi.
- 21 Mars, 2020: Komisioni ka aprovuar 3 skema të ndihmës shtetërore nga shteti Francez në vlerën totale prej 300 bilion Euro.

Korniza e përkohshme tashmë e miratuar ka pësuar edhe disa ndryshime të cilat u panë të nevojshme në kuadrin e marrjes së masave shtesë dhe të cilat janë të përmbledhura në tabelën më poshtë.

TABELË: Përmbledhje e masave shtesë nga tre ndryshimet në Kornizën e Përkohshme

Ndryshimi/ **amendimi i pare nga 03/04/2020[6]** **(me njoftim ku është e aplikueshme)**	Pesë masa shtesë të ndihmës shtetërore që kanë të bëjnë me ndihmë shtetërore në formë të: a) granteve të drejtpërdrejta, paradhënie për kredi të ripagueshme ose përfitime tatimore, b) garanci të kredive dhe c) subvencionim të interesit të kredive nën kushte dhe kritere të qarta për të njëjtat nëse shtetet anëtare aplikojnë për: (i) Mbështetje për kërkim dhe zhvillim lidhur me koronavirusin; (ii) Mbështetje për ndërtimin dhe mbindërtim të objekteve për testim; (iii) Mbështetje për prodhimin e produkteve të rëndësishme për ballafaqimin me koronavirusin;

[4] Dritsia, Anastasia, Panagiotopoulou, Violetta. *Covid-19 and EU State Aid developments: The European Commission shows quick reflexes in its effort to alleviate the economic impact of the pandemic through the State Aid toolkit,* 2020
[5] Një ndihmë e tillë konsiderohet si ndihmë e drejtpërdrejtë për klientët e bankave, dhe jo vetë bankat me udhëzime si të minimizohet crregullimi i konkurrencës në sektorin bankar.
[6] https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_570

	(iv) Mbështetje të dedikuar në formë të pezullimit të tatimeve (pagesa e tatimeve dhe/ose kontributeve për sigurim social) për ballafaqimin me problemet e likuiditetit dhe ruajtjen e vendeve të punës; (v) Mbështetje të dedikuar në formë të subvencionimit të pagave të punonjësve për të shmangur pushimet nga puna.
Ndryshimi/ amendimi i dytë nga 08/05/2020[7] (me njoftim ku është e aplikueshme)	Amendimi i dytë zgjeron Kornizën e përkohshme për të mundësuar ndërhyrje të synuara publike në formë të ndihmës si rikapitalizim të kompanive jofinanciare. Ky ndryshim u referohet ndërhyrjeve nga ana e shtetit në vendet anëtare që ndërhyjnë përmes pjesëmarrjes në kapitalin e kompanive strategjike, për të cilat duhet të njoftohet Komisioni dhe të aprovohen nga ai. Ky ndryshim lidhur me masat ofron udhëzime parimore dhe kushte të qarta për pranueshmërinë dhe aprovimin e tyre si dhe udhëzime dhe afate për "tërheqjen" e kapitalit dhe pjesëmarrjes shtetërore me shfrytëzimin e këtij lloji të ndihmës shtetërore, përfshirë këtu edhe kërkesën për një plan dalje (strategji daljeje).
Ndryshimi/ amendamenti i tretë nga 29/06/2020[8] (me njoftim ku është e aplikueshme	Amendimi i tretë ka të bëjë me zgjerimin e Kornizës së përkohshme përmes mbështetjes plotësuese për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, përfshirë këtu edhe bizneset fillestare, për të tejkaluar sfidat lidhur me likuiditetin dhe qasjen e kufizuar për financim, si: (i) Mbështetje për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, përfshirë edhe ndërmarrjet fillestare (start-up) përmes zgjerimit të ndihmës për të gjitha ndërmarrjet mikro dhe të vogla që janë përballur me vështirësi që nga 31/12/2019; (ii) Masa stimuluese për investitorët privatë që të marrin pjesë në masat për rikapitalizim lidhur me koronavirusin, të cilat u mundësojnë investitorëve privatë së bashku me shtetin të kontribuojnë në rritjen e kapitalit në kompanitë; (iii) Mbrojtjen e tregut të vetëm dhe sigurimin e kushteve të barabarta të tregut (level playing field) - me ndryshimin, Komisioni sqaron se ndihma nuk duhet të kushtëzohet nga realizimi i aktivitetit prodhues ose ndonjë aktiviteti tjetër të shfrytëzuesit nga ndonjë vend tjetër në kuadër të Zonës Ekonomike Evropiane (EEA) në territorin e shtetit anëtar që e aprovon ndihmën, sepse do të ishte posaçërisht e dëmshme për tregun e brendshëm.

Sipas të dhënave në dispozicion[9], ndihma shtetërore e njoftuar dhe e aprovuar në nivel të BE-së është relativisht e madhe. Nga 12 marsi 2020 kur është aprovuar ndihma e parë shtetërore me kërkesë të Danimarkës për më shumë se katër muaj është siguruar, respektivisht aprovuar ndihmë potenciale shtetërore në vlerë prej 2,6 trilionë EUR për të ndihmuar sektorin afarist me mbi 270 masa/raste të posaçme. Përveç kësaj vlere të ndihmës shtetërore është edhe vlera e ndihmës që në kuptimin teknik nuk paraqet "ndihmë shtetërore" dhe për të cilën nuk kërkohet aprovim nga Komisioni, por gjithashtu është në drejtim të mbështetjes së subjekteve afariste, si dhe për

[7] https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_838
[8] https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_1221
[9] Raporti i fundit përgatitur më 20/07/2020, Corona Outbreak.

të ndihmuar qytetarët. Lloje të tjera të masave që i ndërmarrin shtetet për të zbutur efektet e pandemisë, por të cilat nuk kualifikohen si ndihmë shtetërore, janë masat si: pezullime për pagesën e tatimeve si tatimi mbi fitimin, tatimi mbi vlerën e shtuar ose kontributet sociale, të cilat janë në dobi të të gjitha ndërmarrjeve pa përjashtim.

Për të ilustruar madhësinë e ndihmës së planifikuar shtetërore në BE për Covid-19, programi për shpëtim i Irlandës ka qenë në vlerë prej 85 miliardë euro gjatë krizës financiare në BE[10], ndërsa në kulmin e krizës së Covid-19, vetëm për një ditë, më 21 mars, Komisioni ka aprovuar një pako të ndihmës shtetërore prej 300 miliardë euro, me kërkesë të Francës, që bie nën legjislativën e ndihmës shtetërore.

Megjithatë, shuma e ndihmës shtetërore në BE dhe pjesëmarrja e vendeve varet nga to. Shtetet ndajnë nga buxhetet e tyre për ekonominë e tyre, nga ku edhe dallimet e mëdha në vlerë absolute dhe relative të ndihmës së aprovuar shtetërore në nivel të vendit anëtar. Vlerën që secili vend e planifikon dhe e shpërndan pas miratimit, ndryshon në varësi të politikave dhe ekonomisë së cdo vendi anëtar, politikave fiskale, mundësive të huamarrjes etj. Kështu pjesa e ndihmës së aprovuar shtetërore për Gjermaninë arrin rreth 41% nga ndihma e përgjithshme e aprovuar në nivel të BE-së (rreth 644 miliardë EUR), për Francën arrin 25% (rreth 385 miliardë EUR), për Italinë 15% (rreth 234 miliardë EUR) dhe për 25 vendet e tjera arrin gjithsej 19%.

4. Arsyetimi i Gjykatës së Shkallës së Parë në cështjen e përbashkët nr. T-34/21 Ryanair v Komisioni Evropian dhe T-87/21 Condor Flugdienst v Komisioni (Lufthansa)

4.1 Vendimi i Komisionit dhe arsyetimi përkatës

Komisioni Evropian duke konsideruar se kompania Lufthansa nuk ishte në gjendje të merrte financim në tregje për të gjithë nevojat e saj gjatë periudhës së pandemisë, nuk stimuloi ndonjë mekanizëm që e nxiste grupin Lufthansa për të blerë aksione sa më shpejt të jetë e mundur, duke mohuar kështu faktin që Lufthansa zotëronte një lloj dominimi në linjat ajrore dhe për vetë rendësinë dhe fuqinë që grup Lufthansa kishtë në tregun aeroportual.

Më 12 qershor 2020, Republika Federale e Gjermanisë njoftoi Komisionin Evropian për ndihmën individuale në formën e një rikapitalizimi prej 6 miliardë eurosh dhënë Deutsche Lufthansa AG ("DLH")[11]. Kjo ndihmë kishte për qëllim të rriste likujditetin e ndërmarrjeve brenda grupit Lufthansa në situatën e jashtëzakonshme të shkaktuar nga Pandemia e covid-19. Masa në fjalë përbëhej nga tre elementë të ndryshëm, përkatësisht një pjesëmarrje e kapitalit prej rreth 300€ milion, një pjesëmarrje e heshtur që nuk është e konvertueshme në aksione prej përafërsisht 4.7 miliardë euro ('Pjesëmarrja e heshtur I') dhe një pjesëmarrje e heshtur prej 1 miliard euro me tiparet e një instrumenti borxhi të konvertueshëm ('Pjesëmarrja e heshtur II').

Pa filluar procedurën zyrtare të hetimit të parashikuar në nenin 108(2) TFBE, Komisioni konkludoi se masa në fjalë si ndihmë shtetërore ishte në përputhje me tregun e brendshëm sipas nenit 107(3)(b) TFBE dhe në përputhje me Komunikatën e Komisionit për masat e ndihmës shtetërore për të mbështetur ekonominë gjatë shpërthimit të COVID-19. Linjat ajrore Ryanair DAC dhe Condor Flugdienst GmbH ('Condor') ngritën dy padi për anullimin e këtij vendimi, me arsyetimin se Komisioni përmes këtij vendimi ka shkelur shumë kushte dhe kërkesa të parashikuara në Komunikatën e Komisionit[12].

Së pari gjykata e shkallës së parë analizoi se ankuesit në këtë rast ishin subjekte të interesuar drejtpërdrejt dhe individualisht nga vendimi i Komisionit. Ryanair dhe Condor mbanin statusin e tyre si konkurrentë të drejtpërdrejtë të grupit Lufthansa në një mori linjash ajrore, të cilat të gjitha përbënin tregjet përkatëse. Ryanair gjithashtu theksoi statusin e saj si një konkurrent i drejtpërdrejtë i Grupit Lufthansa në Gjermani, Belgjikë dhe

[10] Më 28 nëntor 2010, Bashkimi Evropian, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Irlanda ranë dakord për një marrëveshje shpëtimi (rescue deal) prej 85 miliardë euro, e përbërë nga 22,5 miliardë euro nga FMN-ja, 22,5 miliardë euro nga Fondi Evropian për Stabilitet Financiar (EFSF), 17,5 miliardë euro nga Fondi irlandez kombëtar për rezerva pensionale (NPRF) dhe hua dypalëshe nga Britania e Madhe, Danimarka dhe Suedia.

[11] DLH është kompania mëmë e Grupit Lufthansa, i cili, ndër të tjera, përfshin Lufthansa Passenger Airlines, Brussels Airlines SA/NV, Austrian Airlines AG, Sëiss International Air Lines Ltd dhe Edelweiss Air AG.

[12] Më 14 dhjetor 2021, Komisioni miratoi Vendimin C (2021) 9606 përfundimtar, duke korrigjuar vendimin e kontestuar. Sipas nenit 107(3)(b) TFBE, ndihma për të korrigjuar një shqetësim serioz në ekonominë e një Shteti Anëtar, në kushte të caktuara, mund të konsiderohet të jetë në përputhje me tregun e brendshëm.

tregjet austriake. Gjykata e Përgjithshme në arsyetimin e fakteve dhe rrethanave të cështjes u shpreh se masa në fjalë ishtë thelbësore me efekt në pozicionin konkurrues të aplikantëve në tregjet e transportit ajror të udhëtarëve. Gjykata shkoi më tej duke konstatuar se masa në fjalë kishte të ngjarë të lejonte grupin Lufthansa të forconte gjithashtu pozicionin e saj në treg duke i dhënë pozitë dominuese.

4.2 Përkufizimi i tregut gjeografik dhe gjetjet e gjykatës

Komisioni u shpreh se tregjet në të cilat operonte grupi Lufthansa ishin tregjet për ofrimin e shërbimeve të transportit ajror duke i identifikuar tregjet përkatëse sipas qasjes 'aeroport pas aeroporti'. Kjo qasje kontestohet nga ankimuesit, të cilët deklarojnë se Komisioni duhet të kishte përcaktuar tregjet për ofrimin e shërbimeve të transportit ajror të pasagjerëve si çifte qytetesh ndërmjet origjinës dhe destinacionit ('tregjet O&D'). Meqenëse pika 72 e Komunikatës së Komisionit nuk specifikonte metodën që duhet të përdoret për përcaktimin e tregjeve përkatëse, Gjykata vëren se masat e rikapitalizimit synojnë të korrigjojnë një shqetësim serioz në ekonominë e një Shteti Anëtar duke mbështetur, në veçanti, qëndrueshmërine e ndërmarrjeve të prekura nga pandemia Covid-19[13]. Në këtë kontekst, masa në fjalë synonte të siguronte, në thelb, që kompanitë e grupit Lufthansa të kenë likuiditet të mjaftueshëm dhe që ndërprerjet e shkaktuara nga pandemia Covid-19 të mos dëmtojnë qëndrueshmërinë e tyre. Rrjedhimisht, Komisioni kishte të drejtë të deklaronte se masa në fjalë kishte për qëllim ruajtjen e aftësisë së përgjithshme të grupit Lufthansa për të operuar në transportin ajror shërbimet dhe se, si rezultat, nuk ishte e përshtatshme të analizohej ndikimi i masës në fjalë në çdo treg O&D.

Gjykata u shpreh se duke qenë se objektivi i ndihmës së dhënë është për të siguruar vazhdimësinë operacionale të ndërmarrjeve të qëndrueshme gjatë pandemisë Covid-19, angazhimet e përcaktuara në pikën 72 të Komunikatës duhet të hartohen në mënyrë që të sigurojnë që, pasi të jetë dhënë ndihma, pozita e përfituesit nuk do të bëhet më e fuqishme në treg sesa ishte përpara dhe se konkurrenca efektive në tregjet në fjalë do të ruhet. Në lidhje me këtë, ankimuesit kundërshtuan, ndër të tjera, procedurën për shitjen e sloteve të miratuara në vendimin e kontestuar, i cili synohej të zhvillohej në dy faza. Në fazën e parë, slotet do të ofroheshin 'vetëm për hyrjet e reja'. Nëse, pas një periudhe specifike që tejkalon disa sezone, slotet nuk i janë shpërndarë një hyrjeje të re, ato, në një fazë të dytë, do të viheshin në dispozicion të transportuesve që tashmë kanë një bazë në këto dy aeroporte (Frankufurt & Mynih)[14]. Gjykata në vendimin e saj arsyetoi se Komisioni nuk shqyrtoi nëse ishte e përshtatshme të përjashtoheshin konkurrentët tashmë të vendosur në aeroportet e Frankfurtit dhe të Mynihut. Në vendimin e kontestuar, Komisioni nuk ka paraqitur asnjë arsye të mundshme duke demonstruar se ky përjashtim kishte të ngjarë të ruante konkurrencën efektive në tregjet përkatëse dhe se ai ishte i nevojshëm për këtë qëllim. Në rastin konkret, një ekzaminim i tillë ishte edhe më i nevojshëm që nga struktura e tregut në Frankfurt dhe aeroportet e Mynihut karakterizoheshin, sipas vetë vendimit të kontestuar, nga pesha shumë më e madhe e grupit Lufthansa në krahasim me atë të konkurrentëve të tij më të afërt, i cili tashmë kishte një bazë në ato aeroporte, si p.sh. përjashtimi i tyre nga faza e parë e procedurës rrezikonte të kishte efektin e fragmentimit të mëtejshëm të konkurrencës në ato aeroporte. Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstatoi se duke përjashtuar konkurrentët që tashmë kanë një bazë në aeroportet e Frankfurtit dhe të Mynihut nga faza e parë e procedurës së shitjes së sloteve, Komisioni nuk arriti dot të shqyrtojë të gjithë faktorët përkatës në lidhje me angazhimin e propozuar, dhe për këtë arsye bëri një gabim të dukshëm në vlerësim.

Përsa është parashtruar më sipër, gjykata u shpreh se vendimi i Komisionit ka pasur disa gabime dhe parregullsi dhe si rezultat e anulloi atë.

5. Zhvillimet e ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë COVID-19

[13] Njësia e Shtypit dhe Informacionit curia.europa.eu struktura në nivelin ekzistues para pandemisë.

[14] Njoftimi i Komisionit mbi mjetet juridike të pranueshme sipas Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 139/2004 dhe sipas Rregullores së Komisionit (EC) Nr. 802/2004 (OJ 2008 C 267, f.1)

Në mbledhjen e datës 27.3.2020, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Komisioni i Ndihmës Shetërore në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 "Për miratimin e rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit", vlerësoi përputhjen me rregullat e ndihmës shtetërore të skemës së mbështetjes të ndërmarrjeve dhe individëve në kushtet e situatës së përhapjes së Covid-19. Me vendimin nr. 96 datë 27.03.2020 "Autorizim i Ndihmës Shtetërore "Covid-19: Skema Mbështetëse në formën e Grantit" Komisioni i ndihmës shtetërore synonte që përmes kësaj skeme të jepte ndihmë në formën e granteve të drejtpërdrejta, për të përballuar dëmin e shkaktuar ndërmarrjeve, të ndikuara nga përhapja e virusit Covid-19 dhe për ruajtjen e vazhdimësisë së veprimtarisë ekonomike gjatë dhe pas përhapjes së Covid-19 si dhe individëve.

Përfitues të ndihmës shtetëtore do të ishin ndërmarrjet (çdo person fizik ose juridik privat), me të ardhura vjetore deri 14 milion lekë, që kryenin veprimtari ekonomike në të gjithë sektorët e ekonomisë si edhe individët, ndihma për të cilët jepet për të shmangur efektet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore. Vendimi parashikonte se do të jepet në formën e grantit të miratuar në buxhetin e shtetit, për vitin 2020, me vlerë të përgjithshme 5,850. 000. 000 (pesë miliard e tetëqind e pesëdhjetë milon) lekë. Përsa i përket kohëzgjatjes së ndihmës ajo do të jepej nga data 1 Prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë nga Covid-19, por jo më shumë se 3 (tre) muaj. Masa e ndihmës shtetërore do të jepej për të gjithë sektorët në të gjithë Republikën e Shqipërisë, përveç institucioneve financiare dhe ndërmarrjeve publike.

Në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, skema përbën ndihmë shtetërore, duke qenë se jepet nga buxheti i shtetit në kuptim të nenit 4, pika 1 të ligjit nr. 9374 datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore" i ndryshuar.

Ndihma shtetërore financiare do të konsiderohej ndihma e dhënë për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 000 000 (katërmbëdhjetë milion) lekë, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik/marrëdhënieve të punës për shkak të gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga Covid-19. Ky parashikim i vendimit tregon se skema është selektive duke përcaktuar si kriter selektues shumën e të ardhurave vjetore të ndërmarrjeve të regjistruara sipas kërkesave ligjore të regjistrimit në QKB. Gjithashtu skema e ndihmës shtetërore parashikonte dhe një pagesë shtesë për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike si dhe për individët që përfitojnë pagesën e të ardhurës nga papunësia. Ndihma shtetërore do t'i jepej ndërmarrjeve të cilat nuk janë në vështirësi deri më 31 dhjetor 2019, dhe ndërmarrjeve që nuk kanë hyrë në vështirësi më 31 dhjetor 2019, por që kanë hasur vështirësi ose kanë hyrë në vështirësi pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik dhe marrëdhënieve të punës, si rezultat i i gjendjes së epidemisë nga Covid-19. Me qëllimi rritjen e transparencës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u ngarkua si institucioni pergjegjës për të publikuar informacionin në lidhje me ndihmën e dhënë, në faqen zyrtare brënda 12 muajve nga momenti i dhënies së ndihmës dhe që do të raportonte pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

6. Konkluzione

Zhvillimet ekonomike pas Covid-19 si në Bashkimin Evropian por edhe në Shipqëri ishin një tregues se thelbi i transformimit ekonomik pas pandemisë duhet të jetë sipas një modeli të ri zhvillimor, bazuar në ndihmën shtetërore dhe investimet publike. Fokusi duhet të jetë modeli i ri zhvillimor i cili duhet të fokusohet në sektorët që kanë aftësi konkurruese, me potencial të lartë për eksport dhe integrim në zinxhirët furnizues. Për forcimin e këtyre sektorëve me aftësi konkurruese, duhet të nxiten gjithnjë e më shumë skemat e ndihmave shtetërore me fokus ndërmarrjet te cilat synojnë stabilizimin e zinxhirit të furnizimit dhe ruajtjen e aftësisë konkurruese në treg.

Modeli i ri zhvillimor pas pandemisë nënkupton edhe ndryshim të mendësisë së të bërit biznes. Sipërmarrjet dhe sektorët me potencial konkurrues dhe shërbimet përcjellëse për këta sektorë, tashmë kanë kaluar në një proces tërësor transformimi. Kufizimet e aktiviteteve ekonomike si rezultat i pandemisë Covid-19, kanë passjellë nevojën e transformimit të bizneseve në një dimension të ri. Për një model të ri zhvillimor një rol jashtëzakonisht të madh luajnë financat dhe kapitali njerëzor. Në përshtatje me zhvillimet e reja, Bashkimi Evropian por dhe vendi jonë duke ndjekur modelin e ofruar nga BE, gjithnjë e më tepër kanë avancuar instrumentat dhe skemat e ndihmave shtetërore për vendet anëtare me plane afatshkrutra dhe afatmesme dhe duke ndjekur politika eknomike rimëkëmbje të cilat duhet të orientohen gjithnjë e më shumë në sigurimin e konfidencës për bizneset dhe për konsumatorët finalë.

Rimëkëmbja dhe transformimi ekonomik i sipërmarrjeve do të varen nga një numër i madh faktorësh përfshirë mundësitë e ndonjë shpërthimi të ri të pandemisë, kohëzgjatja e pandemisë dhe ndikimin e saj te konsumatorët dhe sipërmarrjet, por edhe nga aftësia e bizneseve për tu përshtatur me "normalitetin e ri".

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Black Oxford Dictionary of Economics (Oxford University Press, 3rd ed, 2003).
2. Faul, Jonathan, Nickpay, Ali, *The EC law of competition*" (2nd edn OUP, Oxford University Press 2007) 50-70.
3. Dritsia, Anastasia, Panagiotopoulou, Violetta *"Covid-19 and EU State Aid developments: The European Commission shows quick reflexes in its effort to alleviate the economic impact of the pandemic through the State Aid toolkit",* 2020
4. Heimler, Alberto, *The limitations of European Union control of state aid* (Oxford review of economic policy, 28 (2) 2012), f.347-367.
5. Jones, Alison, Sufrin, Brenda, *EC Competition Law* (3rd edn, OUP 2008) 70-90.
6. Nina, Aura, *The transparency of State Aid within the scope of the Euroepan Union Competition Law*, (2020) 5-39.
7. Scherer, Frederic dhe Ross, David *Industrial Market Structure and Economic Performance* (Houghton Mifflin, 3rd ed, 1990) 45-50.
8. Staviczky, P. *Kumulimi i ndihmës shtetërore*. Tremujori i Ndihmës Shtetërore Evropiane, 2015 (1).
9. Sullivan and Hovenkamp "*Antitrust Law, Policy and Procedure: Cases, Materials, Problems"* (LexisNexis, 5th ed, 2004) 23-28.

Legjislacion

1. Rregullore e Këshillit (EC) Nr. 139/2004.
2. Rregullores e Komisionit (EC) Nr. 802/2004 (OJ 2008 C 267, f.1).
3. Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

ANALIZË KRAHASIMORE E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE ATIJ ITALIAN MBI REGJIMIN E POSAÇËM TË USHTRIMIT TË TË DREJTAVE NË INSTITUCIONET PENITENCIARE

Doktorante Erida SKËNDAJ[*]
Prof. Asoc. Dr. Skerdian KURTI[**]

COMPARATIVE ANALYSIS BETWEEN ALBANIAN AND ITALIAN LEGISLATION ON THE SPECIAL REGIME OF EXERCISING OF RIGHTS WITHIN THE PENITENTIARY INSTITUTIONS

Abstract

The special regime inside the penitentiary system is a way of executing criminal sentences that imposes many restrictions on the rights of citizens deprived of their liberty, aiming at interrupting the ties between the subjects in question and the criminal environment represented by the criminal organization of affiliation or by criminal organizations who cooperate with him/her. In our opinion, based on several interpretation of the jurisprudence, the special regime is not punitive, but preventive in its nature. At the beginning, the article analyzes the need to foresee such a regime, first in the Italian legal system and then in the Albanian one. Also, the article aims to compare the similarities and distinctive features related to the responsible institutions, rights and restrictions within the regime, in each of the states, in order to evaluate the level of their severity, taking into consideration the standards set by the European Court on Human Rights and the jurisprudence of the Constitutional Courts. In relation to the Albanian law, the analysis is also deepened with regard to its constitutional assessment as well as towards a systematic and harmonious comparison of the limitations of the special regime, with the ordinary regime in the penitentiary system of Albania as well as comparisons of the legal changes that this regime had in a very short period from 2018 to 2020.

Keywords: *Penitentiary system, high security institution, special regime, organized crime, limitation of rights, prisoner, ECtHR.*

1. Hyrje

Sipas një pjese të doktrinës, "regjimi 41-bis është 'burgu i burgut'. Sepse çdo vend duhet të ketë një burg. Kështu, nëse jeni në spital dhe ndiheni të sëmurë, çfarë bëjnë doktorët? Të vendosin në terapi intensive, që është 'spitali i spitalit'. Nëse je në burg dhe organet kompetente duan të të ndështkojnë, është njësoj: duhet bërë diçka. Duhet të ketë gjithmonë diçka për të ndryshuar, përndryshe gjithçka ndalon"[1].

Gjetja e një ekuilibri midis parandalimit apo shtypjes së fenomenit të krimit të organizuar dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat me liri të kufizuar përbën një aktivitet në zhvillim të vazhdueshëm që, në dekadat e fundit, ka parë një ndryshim në favor të mbrojtjes së të drejtave individuale[2].

---

[*] Doktorante Erida Skëndaj, Drejtoreshë Ekzekutive pranë Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH).

[**] Prof. Acos. Dr. Skerdian Kurti, pedagog pranë Departamentit të së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

[1] Kështu shprehej Maurizio Torchio në punimin e tij, *Cattivi (Të këqinjtë)*, Einaudi, 2015, f.11, cituar në De Vito, Riccardo. *Dentro la prigione della prigione: Un Introduzione (Brenda burgut të burgut: Hyrje)*, në Revistën "Giurisprudenza Penale Web", 2020, 1-BIS, Dentro il 41-bis: Riflessioni costituzionalmente orientate sul regime differenziato, f. 1.

[2] Manca, Veronica. *Il principio di proporzionalità "cartina tornasole" per il regime del 41-bis O.P.: soluzioni operative e suggestioni de iure condendo (Parimi i proporcionalitetit "test i rëndësishëm" për regjimin 41-bis O.P.: zgjidhje operacionale*

Fillesat e regjimit të posaçëm gjenden në Ligjin Penitenciar Italian[3] që parashikonte një regjim të veçantë mbikqyrjeje për terroristët duke pezulluar për këta subjekte zhvillimin e aktiviteteve të zakonshme në institucionet penitenciare, për një periudhë të përcaktuar rreptësisht, të domosdoshme për nevojat e sigurisë[4]. Vihet re se me anë të kësaj dispozite ligjore, legjislatori italian i ka dhënë më shumë përparësi nevojës për mbrojtjen e shoqërisë sesa riedukimit të të dënuarit[5].

Pas kalimit të "viteve të plumbit"[6], në vitin 1986 u miratua Ligji Gozzini Nr.663, i cili solli plotësimin e reformës penitenciare të filluar në vitin 1975. Neni 90 i Ligjit Nr.354/1975 u shfuqizua dhe u zëvendësua me nenin 41-bis, por pavarësisht ndryshimeve, ato nuk u vlerësuan si të rëndësishme[7]. Përgjatë viteve 90 shoqëria italiane u karakterizua nga një situatë emergjente, për shkak të zgjerimit dhe përhapjes së veprimtarisë kriminale mafioze që prodhoi masakra të tmerrshme në dëm të shtetit dhe të popullsisë, duke arritur kulmin me vrasjet e magjistratëve Falcone dhe Borsellino. Paragrafi i dytë i nenit 41-bis të Ligjit Penitenciar Italian (Ligji Nr.354/1975) është miratuar dhe ka hyrë në fuqi me anë të Ligjit Nr.306/1992. Ky paragraf ka parashikuar një regjim të posaçëm të trajtimit të të burgosurve të karakterizuar kryesisht nga një reduktim drastik i mundësive për kontakte me botën e jashtme. Nëpërmjet kësaj dispozite u fut në sistem një model trajtimi i të burgosurve i ndryshëm nga ai i parashikuar për të gjithë të burgosurit e tjerë, që përmban kufizime të të drejtave dhe lirive të të burgosurve, të diktuara nga nevoja për të ndërprerë lidhjet mes vetë të burgosurve dhe organizatës kriminale të cilës ata i përkasin[8]. Tema të tilla si orari i ajrimit, e drejta për përkujdesje shëndetësore, kontaktet me Avokatin e Popullit, ushtrimi i së drejtës për të patur një mbrojtje efikase dhe efektive, kufizimi i marrjes së librave dhe korrespondencës, kufizimet në shtyp, shkëmbimi i objekteve, përbëjnë teste të rëndësishëm për të përcaktuar përputhshmërinë e këtij regjimi me parime të rëndësishme kushtetuese dhe dëshmojnë për tensionin e vazhdueshëm që ekziston ndërmjet nevojave për siguri dhe parandalim dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria.

Sipas mendimit tonë, zbatimi i regjimit të posaçëm kërkon gjetjen e një ekuilibri midis nevojës për të ruajtur rendin dhe sigurinë publike duke vendosur kufizimin e të drejtave të te burgosurve pjesëtarë të organizatave kriminale dhe detyrimit për të respektuar të drejtat e sanksionuara nga dokumentat ndërkombëtarë dhe kryesisht nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Nisur nga ky këndvështrim, mund të thuhet se shumë herë ky regjim ka kaluar në sitën e jurisprudencës së GJEDNJ-së për shkak të ankimeve të shumta që janë

---

dhe sugjerime de iure condendo) në Revistën "Giurisprudenza Penale Web", 2020, 1-BIS, Dentro il 41-bis: Riflessioni costituzionalmente orientate sul regime differenziato, f.10.

[3] Legge 26 luglio 1975, Nr.354 "*Norme sull'ordinamento penitenziario e sulla esecuzione delle misure privative e limitative della libertà*", aggiornata (Ligji 26 korrik 1975, n. 354 "*Norma mbi rregulloren penitenciare dhe mbi ekzekutimin e masave privuese dhe kufizuese të lirisë personale*", i ndryshuar).

[4] Sipas nenit 90 të ligjit italian Nr.354/1975, Ministri i Drejtësisë (Ministria) ka të drejtë të pezullojë rregullat dhe institucionet e trajtimit të parashikuara me ligj në sistemin penitenciar, në një ose më shumë institucione dhe për një periudhë të caktuar, rreptësisht të nevojshme, kur lindin arsye serioze dhe të jashtëzakonshme të rendit dhe sigurisë (*Il ministero ha facoltà di sospendere le regole di trattamento e gli istituti previsti dalla legge nell'ordinamento penitenziario, in uno o più stabilimenti e per un periodo determinato, strettamente necessario, quando ricorrono gravi ed eccezionali motivi di ordine e sicurezza*).

[5] Cifaldi, Gianmarco dhe Scardaccione, Ermenegilda. *Italy's Penitenciary Order: art.41 bis OP. Juridical and criminological profiles* (*Ligji Penitenciar Italian: neni 41-bis i ligjit penitenciar. Profilet juridike dhe kriminologjike*), në Revistën "Criminology and Criminal Law Review", Volumi 1, Nr.1; Global Research Publishing House Stockton, Kaliforni, 2018, f. 32-33.

[6] Italia ka një histori të grupeve ekstremiste të motivuara politikisht të cilat krijuan frikë dhe terror nga viti 1969 deri në vitin 1982. Kjo periudhë njihet në Itali me emrin "vitet e plumbit", duke iu referuar numrit të madh të plumbave të shkrepur. Shih, Mussolino, Santina. *Verso una memoria autocritica: ripensare i racconti e i ricordi degli "anni di piombo" (Drejt një kujtese autokritike: të rimendosh tregimet dhe kujtimet e "viteve të plumbit")*, në Revistën "Democrazia e Sicurezza – Democracy and Security Review", anno VIII, n. 4, 2018 (data di pubblicazione: 7 ottobre 2019), Osservatorio sociale, f. 103.

[7] Rampioni, Matteo. *Il carcere «duro»: una condanna alla solitudine (Burgu "i vështirë": një ndëshkim në vetmi)*, në Revistën "Processo Penale e Giustizia", Fascicolo 4, 2021.

[8] Shih, Romice, Sergio. *Brevi note sull'art. 41 bis O.P. (Vëzhgime të shkurtra në lidhje me nenin 41 bis të Rregullores Penitenciare)*, në Revistën "Giurisprudenza Penale Web", Nr.12, 2017, f. 2.

bërë kundër këtij regjimi duke e konsideruar torturë apo trajtim çnjerëzor që bie në kundërshtim me nenin 3 KEDNJ dhe për rrjedhojë duhet të shfuqizohet. Pavarësisht këtyre ankimeve, një numër i madh i vendimeve të Gjykatës së Strasburgut[9] hedhin poshtë pretendimet për paligjshmërinë e këtij regjimi, duke sanksionuar domosdoshmërinë dhe përputhshmërinë e tij me parimet e sanksionuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nëpërmjet këtij punimi jemi munduar të japim një tabllo të përgjithshme të zbatimit të këtij regjimi sipas legjislacionit italian duke nënvizuar përputhshmërinë e tij me standartet e përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke qënë se ky regjim është i ngjashëm me regjimin e posaçëm të parashikuar edhe në legjislacionin penitenciar shqiptar, kemi menduar të bëjmë një krahasim ndërmjet këtyre dy regjimeve të ngjashme me qëllim që të gjejmë pikat e veçanta dhe të përbashkëta ndërmjet tyre dhe më pas të paraqesim konkluzionet e këtij ballafaqimi. Ky punim paraqet një rëndësi të madhe për të gjithë studiuesit e të drejtës penitenciare, vendas dhe të huaj, për gjyqtarët, prokurorët dhe politikanët të cilët janë të angazhuar jo vetëm në parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të organizuar por edhe në respektimin e të drejtave të njeriut.

2. Përballja e regjimit 41-bis me standartet dhe praktikat e Këshillit të Evropës

Sipas nenit 53 të Rregullave Evropiane të Burgjeve[10] të titulluar "Masa të posaçme sigurimi dhe sigurie të lartë", *masat e posaçme të sigurisë dhe sigurimit të lartë merren vetëm në raste përjashtimore. Në rast zbatimi të masave të tilla ka procedura të qarta. Natyra e këtyre masave, kohëzgjatja dhe kushtet në të cilat zbatohen ato përcaktohen nga legjislacioni kombëtar. Zbatimi i masave për secilin rast miratohet nga organi kompetent për një periudhë të caktuar kohe. Çdo vendim për të shtyrë periudhën e miratuar është subjekt i një miratimi të ri nga organi kompetent. Masa të tilla aplikohen për individët dhe për grupe të burgosurish. Çdo i burgosur që është subjekt i këtyre masave ka të drejtën e ankimit*. Ky nen përbën një rezervë ligjore dhe i delegon legjislatorit të brendshëm të drejtën që, në raste përjashtimore, të zbatojë regjime të posaçme të sigurisë së lartë.

Zbatimi i regjimeve të tilla ka kaluar edhe në sitën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që, për pasojë, ka dhënë një sërë vendimmarrjesh ndaj shteteve të cilat kanë zbatuar regjimet e posaçme të kufizimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në sistemin penitenciar apo edhe specifikisht regjimin 41-bis, sikurse është rasti i Italisë, modeli i të cilit është huazuar prej vitit 2018 nga vendi ynë. Gjykata e Strasburgut ka nënvizuar se regjimet e posaçme në burgje nuk janë në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së që ndalon në mënyrë absolute torturën, trajtimin ose dënimin ç'njerëzor apo poshtërues, nëse shteti merr masat që personi të mbahet në kushte të cilat janë në përputhje me respektimin e dinjitetit të tij njerëzor, që mënyra e ekzekutimit të dënimit nuk i krijon personit shqetësim apo vështirësi në atë masë që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes së natyrshme në burg apo paraburgim dhe që, duke pasur parasysh nevojat praktike për burgim, shëndeti dhe mirëqenia e tij sigurohen në mënyrë të përshtatshme[11].

---

[9] Vendim i GJEDNJ, datë 8 qershor 1999, Messina vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 22 qershor 1999, Rinzivillo vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 31 gusht 1999, Di Giovine vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 25 nëntor 1999, Marincola vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 1 shkurt 2000, Vincenti vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 6 prill 2000, Labita vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 9 janar 2001, Natoli vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 18 tetor 2001, Indelicato vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 28 qershor 2005, Gallico vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 10 nëntor 2005, Argenti vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 29 qershor 2006, Viola vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 11 korrik 2006, Campisi vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 15 janar 2008, Bagarella vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 17 shtator 2009, Enea vs. Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 1 shtator 2015, Alfano vs Italia; Vendim i GJEDNJ, datë 24 shtator 2015, Paolello vs. Italisë; Vendim i GJEDNJ, datë 25 tetor 2018, Provenzano vs. Italia.

[10] Rekomandim (2006)2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, i miratuar nga Këshilli i Ministrave më 11 janar 2006 në takimin e 952 të Zëvendësministrave.

[11] Vendim i GJEDNJ, datë 17 prill 2012, Piechowicz kundër Polonisë, paragrafi.162. Në çështjen Piechowicz kundër Polonisë, GJEDNJ vërejti se ishte cenuar neni 3 dhe neni 8 i KEDNJ-së. Lidhur me nenin 3, u vërejtën disa rrethana kumulative të të cilat çuan GJEDNJ në këtë vlerësim. Së pari, autoritetet nuk kishin arritur t'i siguronin atij stimulimin e duhur dhe kontaktin e duhur njerëzor, duke i refuzuar atij kërkesat për të marrë pjesë në trajnime, seminare, kurse dhe sporte, aktivitete të organizuara për të burgosurit e zakonshëm, si dhe kërkesat për të ndjekur sportet e tij. Së dyti, efektet negative psikologjike

Në disa çështje kundër Italisë, GJEDNJ-së iu kërkua të shqyrtonte kufizimet që lindnin nga zbatimi i regjimit 41-bis, lidhur me nenet 3 dhe 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut[12]. GJEDNJ ka vendosur theksin tek standarti për justifikimin e zgjatjes apo ripërsëritjes së këtij regjimi, duke u bazuar në elementë të tillë si rrezikshmëria e subjektit (individit) që i nënshtrohet këtij regjimi ndaj shoqërisë, e parë në dritën e nevojës për të parandaluar kontaktet e tij me organizatën kriminale, provat e subjektit për mosjustifikimin e regjimit, të vlerësuara edhe në raport me përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të tij. Kështu, në çështjen Provenzano kundër Italisë, të vitit 2018, kjo gjykatë ka argumentuar se nëse vlerësohet se zbatimi i zgjeruar i kufizimeve sipas regjimit 41-bis arrin pragun minimal të ashpërsisë që kërkohet për të konkluduar se është në objektin e nenit 3, kohëzgjatja e tij duhet të shqyrtohet në dritën e rrethanave të secilës çështje, e cila përfshin, ndër të tjera, konstatimin nëse ripërtëritja apo zgjatja e kufizimeve të kundërshtuara ishin ose jo të justifikuara[13]. Në çështjen tjetër, Enea kundër Italisë, GJEDNJ konsideroi se kufizimet e vendosura si rezultat i regjimit të posaçëm të vuajtjes së dënimit ishin të nevojshme për të parandaluar kërkuesin, i cili përbënte rrezik për shoqërinë, nga mbajtja e kontakteve me organizatën kriminale të cilës ai i përkiste. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se nuk kishte prova që tregonin qartazi mosjustifikimin e zgjatjes së kufizimeve. Pavarësisht nga problemet shëndetësore nga të cilat vuante kërkuesi, Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 3 të Konventës. Një qëndrim i kundërt u mbajt në çështjen Provenzano kundër Italisë, në të cilën Gjykata vlerësoi se zgjatja e zbatimit të regjimit 41-bis ndaj kërkuesit nuk ishte justifikuar mjaftueshëm, veçanërisht duke pasur parasysh rënien kritike të aftësive të tij konjiktive (njohëse). Për sa i përket nenit 8 të KEDNJ-së që garanton të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, GJEDNJ ka vlerësuar se, duke pasur parasysh natyrën specifike të fenomenit të krimit të organizuar, veçanërisht të llojit mafioz dhe faktit që vizitat familjare shpesh kanë shërbyer si mjet për përcjelljen e urdhërave dhe udhëzimeve nga jashtë, kufizimet që janë thelbësore, për vizitat dhe kontrollet e shoqërimit, nuk mund të thuhet se janë jo përpjestimore me qëllimet legjitime që ndjek neni 8 i Konventës.

Sa i përket të burgosurve terroristë, në një nga vendimet me të njëjtin kërkues, Öcalan kundër Turqisë[14], u konstatua se për një periudhë të caktuar kohore regjimi i tij i posaçëm i paraburgimit kishte rezultuar në shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së. Në veçanti, GJEDNJ kishte parasysh rrethanat e çështjes, të tilla si: për nëntëmbëdhjetë vjet dhe nëntë muaj kërkuesi ishte i vetmi i burgosur në një burg të vendosur në një ishull; kishte mungesë të aksesit në media për t'u informuar për lajmet, kishte probleme të mëdha të vazhdueshme sa i takon aksesit të vizitorëve në burg (për anëtarët e familjes dhe avokatët), të cilët ishin përballur me pamjaftueshmëri të mjeteve të transportit detar që mund ti përgjigjeshin kushteve atmosferike, kishte kufizime në komunikimin me stafin në minimumin e kërkuar për punën e tyre, kishte përkeqësim të gjendjes mendore që rezulton nga një gjendje stresi kronik dhe izolimi social dhe afektiv, e kombinuar me një ndjenjë braktisjeje dhe zhgënjimi; dhe fakti që nuk ishin dhënë alternativa të tjera ndaj regjimit të kufizimit të lirisë së kërkuesit në kohën përkatëse.

Gjatë vizitës së vitit 2019, delegacioni i KPT-së vëzhgoi situatën e respektimit të të drejtave të 141 shtetasve të akomoduar në regjimin 41-bis në burgjet e Milano Opera dhe Viterbo. Në kohën e vizitës, në këtë regjim gjendeshin 748 të burgosur në të gjithë Italinë. KPT u bëri thirrje autoriteteve italiane të angazhohen në një reflektim serioz mbi konceptimin dhe zbatimin e sistemit aktual të regjimit 41-bis në të gjithë sistemin e burgjeve, duke marrë parasysh edhe Kushtetutën Italiane. Komiteti shprehu shqetësimin se kufizimet e rënda të regjimit dhe

dhe emocionale të izolimit të tij social u përkeqësuan më tej nga aplikimi rutinë i masave të posaçme të sigurisë. Gjykata vuri në pikëpyetjen nevojën për prangosjen sistematike sa herë që kërkuesi dilte nga qelia. Po kështu, kontrollet me shirita që përfshinin një inspektim anal u kryen në mënyrë rutinore dhe nuk ishin të lidhura me ndonjë nevojë konkrete sigurie ose dyshime specifike, ndërkohë që ndatj tij aplikoheshin masa të tjera sigurie si mbikqyrje me anë të sistemit të kamerave dhe rojeve të burgut. Lidhur me konkluzionin për cenimin e nenit 8 të KEDNJ-së, GJEDNJ u bazua në kufizimet blanket (të paqarta) dhe sistematike mbi të drejtat kërkuesit për të takuar familjen dhe censurimi i korrespondencës së tij me autoritetet e ndryshme publike dhe avokatin që i ofronte ndihmë juridike, të aplikuara si pasojë e vendosjes së tij në regjimin e posaçëm.

[12] Udhërrëfyes mbi jurisprudencën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Të drejtat e të burgosurve, Zyra e Regjistrimit pranë GJEDNJ-së (jo i detyrueshëm për GJEDNJ), azhornuar në datë 31 gusht 2022, f.49, paragrafi 212.

[13] Vendim i GJEDNJ, datë 25 tetor 2018, Provenzano kundër Italisë, paragrafi 150.

[14] Vendim i GJEDNJ, datë 18 mars 2014, Öcalan kundër Turqisë, paragrafi 146.

kontaktet me botën e jashtme përbëjnë një kërcënim për ekuilibrin delikat midis luftës kundër krimit të organizuar dhe ruajtjes në një sens më të ngushtë të konceptit të rehabilitimit. Ndër gjetjet kryesore të kësaj vizite përfshinë akuzat e rënda për keqtrajtim të një të burgosuri në regjimin 41-bis, mangësitë e vazhdueshme në kushtet materiale dhe shkeljen e privatësisë, pezullimin e trajtimit mjekësor, krijimin e grupeve të detyruara të shoqërimit me dy persona, në zonat e rezervuara, zgjatjen në mënyrë automatike të masës për dekada[15]. Përkatësisht në dy burgjet e vizituara, KPT konstatoi mangësi në drejtim të kushteve materiale, si prezenca e mykut dhe lagështisë në muret e qelisë për shkak të shirave, mungesë aksesi në ujin e ngrohtë, ajrim i pamjaftueshëm, objekte sportive të dëmtuara, qeli të errëta për shkak të përdorimit të materialeve të pleksiglasit ose grilave metalike në dritare që kufizojnë aksesin e dritës natyrale, oborret të mbuluara me rrjetë metalike që ofrojnë pamje vertikale të kufizuar, etj.

Në këtë raport, KPT shprehu shqetësimin mbi mbajtjen e disa të burgosurve në seksionet e veçanta të 41-bis, të quajtura "zona të rezervuara". Me anë të tyre synohej vendosja e kufizimit absolut e komunikimit, me të burgosurit e tjerë në 41-bis, duke lejuar komunikimin vetëm me një person tjetër. Vendosja në këto zona bazohej në një vlerësim të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sipas Rregullores së Burgjeve. Të burgosurit nuk mund të ankoheshin lidhur me këtë vendim. KPT rekomandoi që vendosja e çdo të burgosuri në një zonë të rezervuar duhet të kufizohet në kohë dhe t'i nënshtrohet rishikimit mujor. Gjithashtu, u rekomandua se të burgosurit në fjalë duhet të gëzojnë të drejtën të kundërshtojnë masën përpara gjykatës kompetente, si dhe marrja e masave që të burgosurve që i nënshtrohen mbikëqyrjes me kamera, t'i garantohej privatësi e arsyeshme kur përdorin tualetin, lavamanin dhe dushin. Në rishikimin dhe zgjatjen e regjimit 41-bis, KPT rekomandon disa standarte që mundësojnë vlerësim individual të rrezikut, të bazuar në arsye objektive për vazhdimin e regjimit, standart ky që është në të njëjtën linjë me ato të elaboruara në jurisprudencën e GJEDNJ. KPT rekomandoi se para se të merret vendimi për vendosjen për herë të parë apo zgjatjen e regjimit, të garantohej e drejta e subjektit për t'u dëgjuar individualisht nga organi kompetent, qoftë dhe me anë të një video-konference. KPT shprehu shqetësim për gjendjen e rënduar shëndetësore të dy shtetasve me probleme të shëndetit mendor që mbaheshin në regjimin 41-bis si dhe të një shtetasi tjetër që mbahej në zonën e rezervuar, i cili vuante nga sëmundja e kancerit dhe refuzonte mjekimin, duke kërkuar nga gjykata mëshirë për ta liruar. KPT i kërkoi autoriteteve italiane të vlerësojnë gjendjen e tyre, nëse janë të aftë për të mbajtur komunikim me organizatat e tyre kriminale, duke vlerësuar nevojën e mbajtjes në regjimin 41-bis, në raport me nevojën për të qëndruar në një mjedis më të sigurt për gjendjen e tyre shëndetësore.

Për t'i dhënë një dimension më njerëzor këtij regjimi, përveç rekomandimeve konkrete për përmirësimin e kushteve materiale, Komiteti rekomandon që të ndërmerren hapa edhe në drejtim të ofrimit të një game më të gjerë aktivitetesh ndaj këtyre shtetasve, duke mundësuar qëndrimin në ambientet e jashtme të burgut të paktën katër orë në ditë me të burgosurit e tjerë të të njëjtit grup shoqëror, rritjen e numrit të vizitave në muaj si dhe dhënia e mundësisë për të përdorur (grumbulluar) në vijimësi vizitat e parealizuara, si dhe kryerjen e të paktën një telefonate çdo muaj, pavarësisht nëse ata realizojnë një vizitë gjatë të njëjtit muaj.

3. Regjimi i posaçëm sipas legjislacionit shqiptar dhe standarti i deritanishëm kushtetues lidhur me garancitë procedurale të tij

Regjimi i posaçëm në sistemin penitenciar të Shqipërisë u parashikua për herë të parë, me miratimin nga Kuvendi të ligjit nr. 108/2018, datë 20.12.2018 "*Për një shtesë në ligjin nr.8328, dt. 16.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve*", të ndryshuar. Ministria e Drejtësisë që hartoi nismën në fjalë justifikoi ndërhyrjen në ligj, në kuadër të luftës pa kompromis ndaj krimit të organizuar në lidhje me mënyrën e trajtimit të autorëve të tyre (të dënuar ose të paraburgosur) në sistemin penitenciar, duke synuar rritjen e masave të sigurisë me nënshtrimin e tyre, ndaj një regjimi të posaçëm të ushtrimit të të drejtave. Gjatë shqyrtimit të nismës në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Ministri i Drejtësisë deklaroi se "*nga puna operative e strukturave të sigurisë në burgje dhe nga strukturat e Policisë së Shtetit është konstatuar se elementët kriminalë, ndonëse të izoluar në burgje, kanë tendencën të*

[15] Raport drejtuar Qeverisë Italiane mbi vizitën e realizuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit Ç'njerëzor dhe Poshtërues, përgjatë datave 12 deri në 22 mars 2019, CPT/Inf (2020) 2, f. 37.

ruajnë lidhjet me bashkëpunëtorët jashtë, për të vijuar aktivitetin kriminal"[16]. Gjithashtu pranohet se masat ligjore të propozuara në kuadër të këtij regjimi janë mbështetur nga partnerët ndërkombëtarë dhe janë të ngjashme me regjimin 41-bis të parashikuar në legjislacionin italian dhe kjo për shkak se ky i fundit ka dhënë rezultate konkrete dhe është i mundshëm të zbatohet edhe në Shqipëri.

Në qershor të vitit 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një Ligji të ri Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*". Regjimi i posaçëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë gjen rregullim në nenin 17 të ligjit. Në pamje të parë vërehen shumë elementë ngjashmërie, me formulimin e nenit 13/1 të ligjit nr.108/2018, por një analizë më e detajuar nxjerr në pah edhe dallimet midis rregullimit të hershëm ligjor dhe atij të ri, edhe pse në një kohë shumë të shkurtër, afro 2 vite më pas.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në Komisionin Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, propozuesit deklaruan se për regjimin e posaçëm (41-bis) është zgjeruar gama e subjekteve, të cilët do të jenë pjesë e tij, duke mos u kufizuar vetëm për ato subjekte, të cilët janë pjesë e strukturave kriminale të organizuara apo kanë qenë të dënuar për vepra penale që lidhen me to apo me terrorizmin, por për të gjithë ato subjekte, për të cilat nga institucionet ligjzbatuese ka informacione, që kanë rrezikshmëri të lartë dhe e vazhdojnë veprimtarinë kriminale duke qenë, edhe gjatë qëndrimit në institucion, në lidhje me banda ose pjesë të bandave dhe subjekte të tjera kriminale që janë jashtë[17].

Sa i takon institucioneve ku mund të zbatohet, regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave është i kufizuar vetëm në ato të sigurisë së lartë, të cilat janë institucionet ku ekzekutohen vendimet me burgim për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore[18].

Sa i takon qëllimit për vendosjen në regjimin e posaçëm, ligji shqiptar e ka kushtëzuar me ruajtjen e rendit dhe të sigurisë dhe/ose parandalimin e komunikimit me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë ose me forma të tjera të krimit të organizuar (neni 17/3 i ligjit nr.81/2020). Formulimi i kësaj dispozite parashikon një fushë shumë të gjerë veprimi. Kjo pasi përdorimi i lidhëzës dhe/ose, në teknikën legjislative nënkupton edhe lidhëzën përjashtuese "ose", sipas të cilës, mjafton edhe nevoja për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë e jo detyrimisht parandalimi i krimit të organizuar, për të vendosur një shtetas në regjimin e posaçëm në sistemin penitenciar. Për të justifikuar këtë qëllim, ligjvënësi detajon edhe masat e brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë të regjimit të posaçëm, të cilat lidhen "kryesisht" me nevojën për të parandaluar kontaktet me organizatën kriminale, konfliktet e mundshme me elementë të organizatave të tjera kriminale, ndërveprimit me të burgosurit e tjerë, të cilët i përkasin së njëjtës organizatë ose organizatave të tjera me të cilat ata bashkëpunojnë si dhe komunikimin ose shkëmbimin e sendeve ndërmjet të burgosurve që u përkasin grupimeve të ndryshme. Përdorimi i ndajfoljes "kryesisht" si dhe përmbajtja e masës së fundit (neni 17/3, gërma "ç" e ligjit 81/2020), e cila synon të parandalojë komunikimin ose shkëmbimin e sendeve ndërmjet të burgosurve që u përkasin grupimeve të ndryshme, të interpretuar në mënyrë sistematike me parashikimet e bëra në paragrafët 1 dhe 2 të së njëjtës dispozitë, duket se përforcon tezën se regjimi i posaçëm është i zgjeruar dhe jo qartësisht i diktuar nga nevoja për të parandaluar vetëm krimin e organizuar.

Sa i takon fushës së zbatimit, regjimi i posaçëm zbatohet si ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve që hetohen ose gjykohen për veprat penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore si vrasje ndaj subjekteve të cilësuar, vepra penale në fushën e terrorizmit, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë

[16] Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Dokument Zyrtar (Procesverbal), datë 27 nëntor 2018, i aksesueshëm në faqen zyrtare të Kuvendit.

[17] Komisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare; Dokument Zyrtar (Raporti për projektligjin "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*"), datë 17 mars 2020, i aksesueshëm në faqen zyrtare të Kuvendit.

[18] Sipas nenit 16 të Ligjit Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë janë institucionet ku ekzekutohen vendimet me burgim për vepra penale të kryera nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, veprat penale për të cilat Kodi Penal parashikon dënimin me burgim të përjetshëm, krimet seksuale me të mitur, etj. Gjithashtu, në këto institucione mund të vendosen edhe të dënuar të tjerë, të cilët në kryerjen e veprës penale ose gjatë ekzekutimit të dënimit janë karakterizuar nga qëndrime ose sjellje që e bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera. Vendosja e të dënuarve në këto institucione është në kompetencë të gjykatës.

kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste[19]. Sa i takon ndryshimeve ligjore që ka pësuar regjimi i posaçëm në raport me ligjin e mëparshëm, vihet re se janë shtuar dy vepra penale si pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj dhe organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj. Gjithashtu, është zgjeruar fusha e veprimit të këtij regjimi, në formën e një parashikimi përjashtimor edhe ndaj të burgosurve të cilët kanë rrezikshmëri të lartë për shkak të lidhjeve me pjesëtarët e organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura ose të grupeve të strukturuara kriminale. Si rrjedhojë e këtij ndryshimi, ashpërsohet kufizimi i parashikuar në paragrafin e parë të dispozitës (neni 17/1).

Koncepti i rrezikshmërisë së lartë i ndërlidhur me lidhjet e personit me pjesëtarët e organizatave kriminale, nuk është mjaftueshëm i qartë, duke i lënë një diskrecion të gjerë autoriteteve që kanë të drejtë të propozojnë, vlerësojnë e japin mendim për zbatimin e këtij regjimi ndaj personave të privuar nga liria në sistemin penitenciar.

Në jurisprudencën e Gjykatës tonë Kushtetuese është argumentuar se vetë siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që *ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme*[20]. Koncepti i "qartësisë" dhe "parashikueshmërisë" së ligjit ka gjetur më herët analizë të gjerë në jurisprudencën e GJEDNJ-së, lidhur me të drejtat konventore me natyrë relative, sikurse është edhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, liria e shprehjes, liria e tubimit dhe organizimit. Sipas GJEDNJ-së, një normë nuk mund të konsiderohet "ligj" nëse nuk është formuluar me saktësi të mjaftueshme, për t'i mundësuar qytetarit të rregullojë sjelljen e tij: ai/ajo duhet të jetë në gjendje (nëse është e nevojshme me këshillat e duhura) të parashikojë, në një shkallë që është e arsyeshme në rrethanat konkrete, pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar. Këto pasoja nuk duhet të parashikohen me siguri absolute pasi përvoja tregon se kjo është e paarritshme[21].

Gjithashtu, vlen të theksohet se duke mos dhënë përkufizimin e lidhjes së personit me pjesëtarët e organizatave kriminale, dhe duke ja caktuar shtjellimin rast pas rasti të këtyre lidhjeve, institucioneve propozuese e vendimmarrëse, krijohen pikëpyetje për cenimin e rezervës absolute të ligjit, pra të asaj hapësire të cilën vetëm organi ligjvënës ka detyrimin për ta rregulluar e normuar. Arrijmë në këtë konkluzion, duke bërë një krahasim me dispozitat e Ligjit Nr.84/2016 "*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" ose siç njihet ndryshe ligji i vettingut, i cili parashikon shkaqet kur ndërpritet mandati i gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndër të tjerash, kur provohet se ata kanë patur ose kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Dispozitat e këtij ligji e përkufizojnë kontaktin e papërshtatshëm (neni 3, pika 6 dhe 9 e ligjit).

Pavarësisht se legjislacioni shqiptar mbi regjimin e posaçëm është relativisht i ri, në sajë të kërkesës ankimore të një shtetasi të paraburgosur të vendosur në këtë regjim, Gjykata jonë Kushtetuese ka elaboruar standartet e para kushtetuese të shqyrtimit gjyqësor të ankesave të shtetasve që i nënshtrohen atij. Konkretisht, katër vite pas miratimit për herë të parë të këtij legjislacioni, Gjykata Kushtetuese u shpreh lidhur me kërkesën për deklarimin si antikushtetues të vendimeve të gjykatave në të tri shkallët e sistemit gjyqësor, të cilat lanë në fuqi vendimmarrjen

[19] Të parashikuara në nenet 79, shkronja "ç" (vrasja ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse), 79/a (vrasja e funksionarëve publikë), 79/b (vrasja e punonjësve të policisë së shtetit), 230 (vepra me qëllime terroriste), 230/a (financimi i terrorizmit), 230/b (fshehja e fondeve dhe pasurive të tjera që financojnë terrorizmin), 230/c (dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a
profesionit), 230/ç (Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur), 231 (Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit), 232 (Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste), 232/a (Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste), 234 (Prodhimi i armëve luftarake), 234/a (Organizata terroriste), 234/b (Banda e armatosur), 265/a (Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj), 265/b (Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj), 283, paragrafi 3 (Prodhimi dhe shitja e narkotikëve), 283/a, paragrafi 3 (Trafikimi i narkotikëve), 284, paragrafi 3 (Kultivimi i bimëve narkotike), 284/a (Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale), 284/c, paragrafi 3 (Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope), 284/ç, paragrafi 3 (Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve), 333 (Organizata Kriminale), 333/a (Grupi i Strukturuar Kriminal) dhe 334 të Kodit Penal (Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal).

[20] Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë Nr.9, datë 26 shkurt 2007.

[21] Vendim i GJEDNJ, datë 26 prill 1979, The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 49, f.45.

e Ministrit të Drejtësisë për zgjatjen me 1 vit, të periudhës së regjimit të posaçëm ndaj kërkuesit[22]. Kërkuesi, shtetas i paraburgosur në kohën e gjykimit, i dënuar me vendim jo të formës së prerë për një vepër penale të kryer në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, pretendoi se vendimmarrja gjyqësore për vendosjen e tij në regjim të posaçëm është bazuar në shkresa të institucioneve të klasifikuara "sekret" dhe "i kufizuar", sipas Ligjit Nr.8457/1999 "*Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror*", me përmbajtjen e të cilave nuk është njohur as ai dhe as gjykatat. Mos shqyrtimi dhe mos vlerësimi i këtyre akteve nga gjykatat i ka cenuar atij të drejtën e aksesit e të mbrojtjes, në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës në fjalë, Gjykata Kushtetuese përdori si standard referues atë të elaboruar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës, kufizimet që i bëhen të drejtave të një të burgosuri si rezultat i vendosjes së tij në regjim të posaçëm burgimi, bien brenda sferës së të drejtave personale dhe, si të tilla, përfshihen brenda konceptit të "të drejtave dhe detyrimeve civile", të parashikuar në nenin 6/1 të KEDNJ-së që garanton të drejtën e procesit të rregullt, i cili përmbledh një sërë garancish si e drejta për akses, për t'u dëgjuar, për barazi të armëve dhe kontradiktoritet. Në zbatim të parimit *iura novit curia*, Gjykata Kushtetuese analizoi pretendimet e ngritura nga kërkuesi në këndvështrim të së drejtës për kontradiktoritet, si pjesë thelbësore e procesit të rregullt ligjor, duke qenë se cenimi i saj ndikon edhe në elemente të tjera të procesit të rregullt, të tilla si e drejta e mbrojtjes, aksesi dhe barazia e armëve. Gjykata Kushtetuese nënvizoi se pavarësisht se e drejta e një pale në gjykim për akses në dokumente nuk është absolute, çdo kufizim i kësaj të drejte duhet të jetë i tillë që nuk cenon thelbin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6/1 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, gjykatat duhet të kenë akses të pakufizuar në të gjithë dokumentacionin e klasifikuar mbi të cilin është bazuar vendimmarrja e autoritetit shtetëror. Për më tepër, gjykatat janë të pajisura me pushtet për të vlerësuar thelbin e vendimmarrjes së autoritetit shtetëror, të heqin kufizimin për pasjen e certifikatës së sigurisë, si dhe të shfuqizojnë, kur është rasti, një vendim arbitrar të autoritetit. Gjykata Kushtetuese vëren se pavarësisht se në ankimin e tij drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, kërkuesi kishte ngritur pretendime jo vetëm për procedurat e nxjerrjes së urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, por edhe për thelbin, kjo gjykatë nuk ka vlerësuar nëse të dhënat e akteve, mbi të cilat është bazuar ky urdhër, janë marrë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, nëse kërkuesi duhej të ishte njohur me këto akte me qëllim të garantimit të së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor në drejtim të kontradiktoritetit, si dhe nëse në nxjerrjen e tyre organet shtetërore kanë vepruar në përputhje me ligjin dhe jo në mënyrë abuzive ose arbitrare. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese solli në vëmendje se nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës parashikojnë garanci specifike për personat liria e të cilëve është kufizuar sipas ligjit, ku ritheksohet në mënyrë të veçantë e drejta e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tyre. Në përfundim, kjo Gjykatë çmoi se, në rastin konkret, kërkuesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të garantimit të parimit të kontradiktoritetit në gjykim.

4. Regjimi i posaçëm (41-bis) ndërmjet legjislacionit shqiptar dhe italian

Në aspektin krahasimor të kushteve dhe rrethanave në të cilën zbatohet regjimi i posaçëm i kufizimit të të drejtave në sistemin penitenciar, legjislacioni shqiptar paraqet shumë elementë të ngjashëm dhe po ashtu në masë më të vogël, edhe tipare dalluese me atë italian.

Fusha e veprimit të regjimit të posaçëm, në ligjin italian parashikohet shprehimisht në paragrafin 2 të nenit 41-bis[23]. Sipas kësaj dispozite, zbatimi i regjimit të posaçëm sipas legjislacionit italian, bazohet gjithashtu në

[22] Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë Nr.5, datë 22 shkurt 2022.

[23] Neni 41-bis, paragrafi 2 i ligjit italian: "*Quando ricorrano gravi motivi di ordine e di sicurezza pubblica, anche a richiesta del Ministro dell'interno, il Ministro della giustizia ha altresì la facoltà di sospendere, in tutto o in parte, nei confronti dei detenuti o internati per taluno dei delitti di cui al primo periodo del comma 1 dell'articolo 4-bis o comunque per un delitto che sia stato commesso avvalendosi delle condizioni o al fine di agevolare l'associazione di tipo mafioso, in relazione ai quali vi siano elementi tali da far ritenere la sussistenza di collegamenti con un'associazione criminale, terroristica o eversiva, l'applicazione delle regole di trattamento e degli istituti previsti dalla presente legge che possano porsi in concreto contrasto con le esigenze di ordine e di sicurezza. La sospensione comporta le restrizioni necessarie per il soddisfacimento delle predette esigenze e per impedire i collegamenti con l'associazione di cui al periodo precedente. In caso di unificazione di*

përmbushjen në mënyrë kumulative të disa kushteve. Së pari kërkohet që të ketë arsye serioze të lidhura me rendin dhe sigurinë publike, njëjtë si në ligjin shqiptar dhe së dyti shtrihet ndaj personave të dënuar ose paraburgosur për krime të kryera në kuadër të pjesëmarrjes së tyre në organizata kriminale apo terroriste. Përsa i përket legjislacionit shqiptar, vëmë re se pragrafi i parë i nenit 17 të ligjit 81/2020 parashikon të njëjtën fushë zbatimi me legjislacionin italian por në ndryshim nga legjislacioni shqiptar nuk gjejmë në legjislacionin italian një parashikim të tillë ashtu sikurse është paragrafi i dytë i nenit 17 të ligjit shqiptar.

Ndërkohë vërehet se paragrafi 1 i nenit 41-bis të legjislacionit italian nuk është i lidhur me nevojën për të luftuar krimin e organizuar dhe ka një natyrë të përgjithshme, pasi parashikon pezullimin e zbatimit të regjimit të zakonshëm, në burgun përkatës ose në një pjesë të tij, specifikisht në rastet e jashtëzakonshme të trazirave në burg ose situata të tjera të rënda emergjente, duke u bazuar në domosdoshmërinë e rivendosjes së rendit dhe sigurisë dhe zgjat rreptësisht për aq sa arrihet ky qëllim. Një parashikim të ngjashëm gjejmë në nenin 9 të ligjit shqiptar (Nr.81/2020) që rregullon rastet e kufizimit të përkohshëm në grup të të drejtave të të burgosurve, në minimumin e nevojshëm, në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm dhe vetëm në rastet e veçanta të gjendjes së jashtëzakonshme, të shpallur me ligj, situatës emergjente, gjendjes së luftës, rreziqeve potenciale për jetën dhe shëndetin e të burgosurve, sulmeve të armatosura nga jashtë institucionit apo referimit të informacionit për kryerjen e sulmeve të mundshme. Në kuptim të pozicionit të normës juridike, ligji shqiptar është më i qartë dhe koherent, duke shmangur interpretimin e dykuptimtë të regjimit të posaçëm të kufizimit të të drejtave, i krijuar për të luftuar dhe parandaluar krimin e organizuar brenda apo nëpërmjet sistemit penitenciar.

Sipas legjislacionit shqiptar, të drejtën për të propozuar në mënyrë të arsyetuar për vendosjen e të burgosurit në regjimin e posaçëm e ka Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Vendimi merret nga Ministri i Drejtësisë, pas konsultimit me autoritete të tjera ligjzbatuese si Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Shërbimi Informativ i Shtetit, Drejtori i Përgjithshëm të Burgjeve dhe organet e specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit. Ky rregullim në legjislacionin shqiptar paraqet elementë të ngjashëm dhe dallues në raport me parashikimet përkatëse të legjislacionit italian. Elementët dallues janë të ndërlidhur dhe me mënyrën dhe organizimin e sistemit gjyqësor, të prokurorisë dhe agjencive të specializuara ligjzbatuese në secilin shtet. Sipas paragrafit 2-bis të nenit 41-bis të Ligjit Penitenciar Italian të vitit 1975, azhornuar deri në vitin 2020, e drejta e vendimmarrjes i takon gjithashtu Ministrit të Drejtësisë. Në ndryshim nga ligji shqiptar ku përmendet kërkesa e arsyetuar e organit propozues, në ligjin italian parashikohet vendimmarrja e arsyetuar e Ministrit të Drejtësisë. Në ndryshim nga ligji ynë ku e drejta e propozimit i takon Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ligjin italian, kjo e drejtë është atribut i Ministrit të Punëve të Brendshme, pasi është dëgjuar Prokuroria Publike që kryen hetimet paraprake ose zyra e gjyqtarit procedues dhe pas marrjes së çdo informacioni tjetër të nevojshëm nga Departamenti Kombëtar i Antimafias dhe organet e policisë, qendrore dhe të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit apo krimit armiqësor, në përputhje me kompetencat e tyre.

Sipas mendimit tonë, në kuptim të elementëve të pavarësisë dhe paanshmërisë, ligji shqiptar është më garantues sa i takon atributit që i është dhënë një institucioni të pavarur sikurse është Prokuroria e Posaçme, për të propozuar vendosjen e regjimit 41-bis, në raport me ligjin italian që këtë atribut ja jep një institucioni që është nën ombrellën dhe varësinë e pushtetit ekzekutiv. Sa i takon procesit të konsultimit të vendimmarrjes, ligji italian ofron më shumë garanci në kuptim të mospërqëndrimit të këtij procesi tek titullarët e lartë të strukturave qëndrore apo eprore sikurse janë në legjislacionin shqiptar Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit apo Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

4.1 Kufizimet e të drejtave brenda regjimit të posaçëm "41-bis"

Regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave në ligjin shqiptar (Nr.81/2020), njëjtë si në ligjin italian të vitit 1975 (të ndryshuar) konsiston në vendosjen e disa kufizimeve ndaj subjekteve që i nënshtrohen atij (të dënuarve apo të paraburgosurve).

---

pene concorrenti o di concorrenza di più titoli di custodia cautelare, la sospensione può essere disposta anche quando sia stata espiata la parte di pena o di misura cautelare relativa ai delitti indicati nell'articolo 4-bis".

Së pari, sipas ligjit shqiptar (Nr.81/2020) të burgosurit i lejohet një takim në muaj me anëtarë të familjes, që kryhet në intervale të rregullta kohore dhe në mjedise të caktuara, që i nënshtrohen regjistrimit audio dhe video[24]. Takimi me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, për personat e dënuar, lejohet me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ndërkohë që për të paraburgosurit, lejohet vetëm me miratimin e prokurorit. Këto parashikime nuk zbatohen për takimet me mbrojtësit, për të cilët ligji nuk ka përcaktuar kufizime për intervalin e takimeve, për përgjimet dhe miratimin apo autorizimin që kërkohet në këto raste. Krahasuar me takimet që i lejohen të burgosurve të tjerë që nuk i nënshtrohen këtij regjimi, sipas ligjit tonë, të cilëve i'u njihet e drejta e vizitës të paktën katër herë në muaj me anëtarët e familjes me kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë vihet re tendenca e ashpërsimit të kufizimit të regjimit të posaçëm. Në ndryshim nga regjimi i posaçëm, vizitat për të burgosurit e tjerë i nënshtrohen mbikqyrjes së personelit të institucionit, por jo dëgjimit. Krahasuar me ligjin italian, për kufizimet lidhur me numrin e takimeve dhe format e autorizimit të tyre, vihen re parashikime të ngjashme me legjislacionin italian. Të dyja ligjet nuk vendosin kufizime të të drejtave, sa i takon regjistrimeve apo kontrolleve lidhur me takimet me avokatët.

Së dyti, sipas legjislacionit shqiptar, të burgosurit i lejohet të kryejë një bisede telefonike në muaj, me kohëzgjatje maksimale dhjetë minuta, e cila regjistrohet. Sipas legjislacionit italian, bisedat telefonike lejohen vetëm për ata që nuk kanë kryer takimin. Sipas legjislacionit shqiptar, praktika që ndiqet për autorizimin e këtyre bisedave me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes është e njëjtë me atë të takimeve, ndërsa sipas legjislacionit italian, ashtu sikurse për takimin edhe për bisedat telefonike me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, për personat e dënuar, lejohet me autorizimin e drejtorit të institucionit dhe për përsonat e paraburgosur me autorizim të autoritetit gjyqësor kompetent.

Sipas legjislacionit tonë, është pozitiv fakti se regjistrimi nuk lejohet për kryerjen e bisedave telefonike me institucionin e Avokatit të Popullit dhe me organizata që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Në raport me parashikimet e mëparshme ligjore të regjimit të posaçëm, ligjvënësi ka zbutur kufizimet pasi në to parashikohej e drejta për bisedën telefonike si alternativë për ata të burgosur që nuk realizonin takime familjare. Ky kufizim në ligjin e mëparshëm është i ngjashëm me kufizimin e parashikuar në ligjin penitenciar italian. Ndërkohë që sipas ligjit të ri shqiptar (Nr.81/2020), këto kufizime janë më pak të rrepta dhe të drejtat për takime familjare dhe biseda telefonike mund të ushtrohen në mënyrë kumulative, të pakushtëzuara nga njëra tjetra. Krahasuar me standartet minimum për bisedat telefonike që i lejohen të burgosurve të tjerë që nuk i nënshtrohen këtij regjimi, vihet re tendenca e ashpërsimit të fortë të kufizimeve në regjimin e posaçëm (41-bis). Neni 49, paragrafi 9 i ligjit (Nr.81/2020) nuk parashikon një kufi minimal për bisedat telefonike për të burgosurit e tjerë ndërkohë që rregullorja e përgjithshme e burgjeve, i lejon të burgosurve të zhvillojnë deri në 8 (tetë) biseda telefonike në muaj me shpenzimet e tyre. Drejtori i institucionit lejon kryerjen e bisedave telefonike shtesë. Për ata që nuk përballojnë dot shpenzimet, u lejohet 4-5 biseda me shpenzimet e institucionit. Bisedat telefonike zhvillohen nën mbikëqyrjen vizuale të personelit por ato nuk regjistrohen apo përgjohen[25].

Së treti, të burgosurit i ndalohet të përdorë vlerat monetare, sendet dhe objektet, që mund të marrë nga jashtë, sipas parashikimeve në rregulloren e brendshme të institucionit. Delegimi që bën ligji për rregullim më të detajuar të këtij kufizimi në një akt nënligjor invididual dhe jo në një akt normativ, sikurse është Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave krijon premisa për trajtim të diferencuar, në cenim të të drejtës për barazi para ligjit sipas nenit 18 të Kushtetutës. Kjo pasi institucionet e sigurisë së lartë ku mund të zbatohet regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave mund të miratojnë rregullore me standarte të ndryshme dhe jo të harmonizuara. Edhe ky kufizim qartazi është huazuar nga legjislacioni italian që po ashtu vendos barriera për vlerat monetare, sendet dhe objektet. Në krahasimin literal të dispozitave përkatëse, vihet re që tendenca e ligjvënësit italian është më e ashpër, pasi ndalon marrjen e tyre, ndërkohë që ligjvënësi shqiptar ndalon përdorimin e tyre, që potencialisht krijon hapësirën që këto sende mund të merren por jo të përdoren prej tij.

[24] Neni 17, pika 5, gërma "a" e Ligjit Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".

[25] Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 209, datë 6 prill 2022 "*Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve*".

Së katërti, të burgosurit i nënshtrohen kontrollit të korrespondencës, përveç asaj me funksionarë publikë të nivelit të lartë ose me organizata ndërkombëtare, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Një kufizim i ngjashëm parashikohet edhe në legjislacionin italian për kontrollin e korrespondencës, me përjashtim të asaj me përfaqësuesit e Parlamentit, autoriteteve Evropiane apo kombëtare që kanë përgjegjësi në fushën e drejtësisë.

Në dy vendime të vitit 1993, Gjykata Kushtetuese Italiane argumentoi se kompetenca për të urdhëruar mbikëqyrjen e korrespondencës së të burgosurve i përket vetëm gjykatës. Si rezultat, neni 41-bis nuk mund të interpretohej si autorizim i Ministrit të Drejtësisë për të marrë masa në lidhje me korrespondencën e të burgosurve. Prandaj, nga fundi i vitit 1993 baza e vetme për monitorimin e korrespondencës ishte neni 18 i ligjit penitenciar italian, i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, gjykata pranë së cilës është duke u zhvilluar gjykimi për akuzën penale ndaj të pandehurit (deri në dhënien e vendimit të shkallës së parë) ose gjykata përgjegjëse për ekzekutimin e dënimeve (gjatë çdo procesi të mëvonshëm) mund të urdhërojë mbikqyrjen e korrespondencës së të burgosurve, duke parashtruar arsyet e saj. Megjithatë, kjo dispozitë nuk përcakton në mënyrë specifike rastet në të cilat mund të merret një vendim i tillë. Në praktikë, mbikqyrja nënkupton përgjimin e të gjithë korrespondencës së të burgosurit, e cila më pas lexohet nga autoriteti gjyqësor që e ka urdhëruar, nga drejtuesi i burgut ose nga personeli i burgut i caktuar nga drejtuesi. Letrat më pas vulosen për të treguar se ato janë kontrolluar. Fshirja e fjalëve ose e fjalive nuk lejohet, por autoriteti gjyqësor mund të urdhërojë që një ose më shumë letra të mos dorëzohen, në këtë rast i burgosuri duhet të informohet menjëherë. Një urdhër i tillë mund të jepet përkohësisht edhe nga drejtuesi i burgut, i cili duhet të informojë autoritetin gjyqësor. Me interes sa i takon garancive që duhet të përmbushen në drejtim të kontrollit të korrespondencës, është vendimi i vitit 2009, i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, në çështjen *Enea kundër Italisë*. Pavarësisht nga fakti nëse aplikantët janë në regjim të posaçëm të ushtrimit të të drejtave, sikurse ishte kërkuesi në fjalë, standarti i GJEDNJ-së është i njëjtë si për shtetasit e tjerë të privuar nga liria, ku është e nevojshme që kontrolli të urdhërohet nga një autoritet gjyqësor, të jetë në përputhje me ligjin, i cili duhet të jetë i qartë dhe të parashikojë disa kritere minimum të mbrojtjes, të cilat duhet ti gëzojnë të gjithë shtetasit në një shoqëri demokratike ku sundon ligji[26]. Në këtë vendim të GJEDNJ-së, u vërejt se pavarësisht se kontrolli i korrespondencës ishte urdhëruar nga gjyqtari përgjegjës për ekzekutimin e dënimit, në referencë të nenit 18/7 të ligjit penitenciar italian, nga ana tjetër kontrolli kishte cenuar nenin 8 të KEDNJ pasi nuk ishte në përputhje me ligjin. Kjo për arsye se neni 18 i ligjit penitenciar italian nuk rregullonte as kohëzgjatjen e mbikqyrjes së korrespondencës dhe as shkaqet që justifikojnë këtë masë si dhe nuk përcakton me qartësi të mjaftueshme qëllimin dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit nga organet përkatëse.

Ashtu si neni 41-bis i ligjit italian, edhe neni 17 që parashikon këtë regjim në ligjin shqiptar, nuk parashikon rregullime të veçanta për kohëzgjatjen, shkaqet, qëllimet dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit nga organet përgjegjëse, për kontrollin e korrespondencës. Neni 49, pika 11, e ligjit shqiptar parashikon si garanci kontrollin e korrespondencës sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, që urdhërohet nga gjykata. Megjithatë, në pikën 13 të të njëjtës dispozitë, parashikohet një rregullim disi kontradiktor, pasi përjashtimisht për të burgosurin ndaj të cilit zbatohet regjimi i posaçëm, të drejtat e parashikuara në këtë nen zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 17 të këtij ligji. Në pamje të parë, duket se neni 17 i ligjit merr epërsi.

Së pesti, parashikohet kufizimi i qëndrimit të të burgosurit në ajrim në ambiente të hapura deri në 2 orë, por jo më pak se 1 orë në ditë. Nëse do e krahasojmë kufizimin e vendosur me standartet minimum për kohëzgjatjen e ajrimit që i lejohet të burgosurve të tjerë që nuk i nënshtrohen këtij regjimi, vihet re tendenca e një ashpërsimi të fortë. Sipas nenit 37 të Ligjit (Nr.81/2020), për kohëzgjatjen e ajrimit (jo në regjimin e posaçëm), në varësi të muajve dhe kushteve klimaterike të tyre, orari i ajrimit varion për disa orë por gjithmonë jo më pak se dy orë në ditë. I njëjti kufizim në drejtim të orarit parashikohet edhe në nenin 41-bis të ligjit italian, ndërkohë që ky i fundit vendos kufizime edhe në raport me numrin e personave, jo më shumë se 4, ku bën pjesë i dënuari/paraburgosuri që i nënshtrohet regjimit të posaçëm. Gjithashtu, në ligjin italian parashikohet edhe marrja e masave të sigurisë që bëjnë të pamundur komunikimin, në anbientet ku rrinë subjektet që i nënshtrohen këtij regjimi, me të burgosur që i përkasin grupeve të ndryshme, për të shkëmbyer sende dhe për të gatuar ushqim.

[26] Vendim i GJEDNJ, datë 17 shtator 2009, Enea kundër Italisë, f.13, paragrafi 34.

Së gjashti, të burgosurit në regjimin e posaçëm përjashtohen nga organet përfaqësuese të të burgosurve. Në fakt ky parashikim nuk krijon kohezion me parashikimet e tjera ligjore për regjimin e zakonshëm të ushtrimit të të drejtave, pasi ligji nr.81/2020 nuk e njeh dhe rregullon mënyrën e përfaqësimit të të burgosurve në organet e tyre. Qartazi ky kufizim është huazuar në mënyrë mekanike nga legjislacioni italian, pa u përshtatur me kontekstin tonë ligjor.

4.2 Kohëzgjatja e regjimit të posaçëm (41-bis) dhe zgjatja e tij

Kohëzgjatja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave, është një vit dhe mund të zgjatet me kërkesë të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, drejtuar Ministrit të Drejtësisë, për periudha të tjera njëvjeçare, kur rezulton se ekzistojnë ende kushtet që i burgosuri mban lidhje me një nga format e organizimit kriminal. Për zgjatjen e tij mbahen parasysh profili kriminal i të burgosurit, roli që ai luan në organizatën kriminale, kohën që është angazhuar në të, ngritjen e akuzave të reja të pashqyrtuara më parë ndaj tij, sjelljen që ka mbajtur në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe nivelin e jetesës së anëtarëve të familjes. Kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë për vendosjen ose zgjatjen e regjimit të posaçëm, i burgosuri, mbrojtësi ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të paraqesë kërkesë ankimore brenda 20 ditëve nga njoftimit të vendimit, në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO). Në rastet kur kërkesa kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë pranohet nga gjykata, ministri i Drejtësisë e respekton atë. Në aspektin krahasimor, në ndryshim nga ligji i mëparshëm (Nr.108/2018) ku parashikohej se rivlerësimi për vazhdimin e regjimit të posaçëm bëhej me kërkesë të të dënuarit ose të paraburgosurit, në ligjin e ri nr.81/2020, kjo e drejtë i është hequr të burgosurit. Ky i fundit gëzon vetëm të drejtën e ankimit ndaj vendimmarrjes së Ministrit të Drejtësisë në Gjykatën Kompetente (GJKKO). Në këtë drejtim, ligjvënësi ka ashpërsuar regjimin duke kufizuar garancitë procedurale që ushtroheshin më herët nga i burgosuri.

Parashikimet lidhur me kohëzgjatjen e regjimit 41-bis në ligjin italian paraqesin tendencë më të ashpër dhe kufizuese në raport me ligjin shqiptar, pasi ai mund të zbatohet deri në 4 vjet dhe të zgjatet në vijimësi, nga të njëjtat autoritete që kanë të drejtë të propozojnë, të konsultohen e të marrin vendim lidhur me të, për periudha të mëtejshme, me 2 vjet secila. Shkaqet për të cilat ky regjim mund të zgjatet si dhe e drejta e ankimit të paraburgosurit/dënuarit brenda 20 ditëve nga vendosja në regjim ose zgjatja e tij janë gati të njëjta me ato të parashikuara në ligjin shqiptar, i cili qartazi i ka huazuar prej nenit 41-bis të ligjit italian. Sipas legjislacionit shqiptar, kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankim në Gjykatën e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndërsa sipas legjislacionit italian, kundër vendimit të gjykatës së mbikqyrjes së ekzekutimit penal në Romë lejohet ankimi vetëm në Gjykatën e Kasacionit për shkelje të ligjit.

5. Konkluzione

Parashikimi i regjimit 41-bis në legjislacionin italian është pjesë e një reforme që ka shtrirje të gjatë në kohë, që u diktua fillimisht nga veprimtaritë e organizatave me natyrë terroriste në vitet 70 e 80, dhe më tej vijon me ndryshime të tjera ligjore që ashpërsojnë në mënyrë të përshkallëzuar kufizimet e ushtrimit të të drejtave në sistemin penitenciar, të cilat u theksuan qartësisht pas viteve 90 me sofistikimin e organizatave mafioze dhe akteve të rënda mafioze të orkestruara nga shtetas të dënuar në burg, drejtuar magjistratëve të anti-mafias italiane, Falcone dhe Borsellino.

Pavarësisht rasteve të veçanta ku janë konstatuar shkelje të KEDNJ-së, në të shumtën e rasteve, GJEDNJ ka nënvizuar se regjimet e posaçme (përfshi regjimin 41-bis) në burgje nuk janë në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së që ndalon në mënyrë absolute torturën, trajtimin ose dënimin ç'njerëzor apo poshtërues, nëse shteti merr masat që personi të mbahet në kushte të cilat janë në përputhje me respektimin e dinjitetit të tij njerëzor, që mënyra e ekzekutimit të dënimit nuk i krijon individit (të dënuar/paraburgosur) shqetësim apo vështirësi në atë masë që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes së natyrshme në burg apo paraburgim dhe që, duke pasur parasysh nevojat praktike për burgim, shëndeti dhe mirëqenia e tij sigurohen në mënyrë të përshtatshme.

Në zgjatjen e këtij regjimi apo ripërtëritjen e tij, GJEDNJ ka vendosur theksin tek nevoja për ta justifikuar atë, duke u bazuar në elementë të tillë si rrezikshmëria e subjektit, sa i takon vijueshmërisë së kontakteve me organizatat kriminale, por e vlerësuar në mënyrë të balancuar edhe në raport me gjendjen e tij/saj shëndetësore.

Përkundrejt qasjes më tolerante të GJEDNJ-së, KPT u bëri thirrje autoriteteve italiane të angazhohen në një reflektim serioz mbi konceptimin dhe zbatimin e sistemit aktual të regjimit "41-bis" në të gjithë sistemin e burgjeve, duke marrë parasysh edhe Kushtetutën Italiane. Ky Komitet shprehu shqetësimin se kufizimet e rënda të regjimit dhe kontaktet me botën e jashtme përbëjnë një kërcënim për ekuilibrin delikat midis luftës kundër krimit të organizuar dhe ruajtjes në kuptim më të ngushtë të konceptit të rehabilitimit.

Në ndryshim nga legjislacioni italian që reflekton qasjen përshkallëzuese, regjimi 41-bis u parashikua për herë të parë në legjislacionin shqiptar në vitin 2018 (ose siç njihet ndryshe regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave), duke e huazuar atë në masë të gjerë. Me miratimin e një ligji të ri penitenciar, rregullimi ligjor mbi këtë regjim pësoi disa ndryshime brenda një harku të ngushtë kohor pas 2 vitesh, duke mos patur mundësinë ti nënshtrohej një testimi në një periudhë kohore me shtrirje më të gjerë e të konsoliduar. Nevoja për justifikimin e tij nuk bazohet në të dhëna të konkretizuara mbi përhapjen e krimit të organizuar në sistemin penitenciar.

Qëllimi i zbatimit të regjimit të posaçëm sipas legjislacionit shqiptar lidhet "kryesisht" me nevojën për të parandaluar kontaktet e shtetasit të dënuar apo të paraburgosur me organizatën kriminale, brenda apo jashtë burgut. Megjithatë, nga krahasimi sistematik dhe harmonik i parashikimeve të dispozitës dhe përdorimi i fjalëve të caktuara në teknikën legjislative, përforcon tezën se regjimi i posaçëm është i zgjeruar dhe jo qartësisht i diktuar nga nevoja për të parandaluar vetëm krimin e organizuar. I njëjti trend vihet re edhe në legjislacionin italian.
Koncepti i rrezikshmërisë së lartë i ndërlidhur me lidhjet e personit me pjesëtarët e organizatave kriminale, nuk është mjaftueshëm i qartë në ligjin shqiptar, duke i lënë një diskrecion të gjerë autoriteteve për ta vlerësuar atë, duke krijuar pikëpyetje për respektimin e parimit kushtetues të sigurisë juridike, sa i takon kërkesës së këtij parimi për qartësi dhe parashikueshmëri të ligjit. Mungesa e një përkufizimi të lidhjes së personit me pjesëtarët e organizatave kriminale, dhe duke ja caktuar shtjellimin rast pas rasti të këtyre lidhjeve, institucioneve propozuese dhe vendimmarrëse, krijon pikëpyetje për cenimin e rezervës absolute të ligjit.

Në aspektin krahasimor të kushteve dhe rrethanave në të cilën zbatohet regjimi i posaçëm i kufizimit të të drejtave në sistemin penitenciar, legjislacioni shqiptar është frymëzuar nga ai italian, duke nxjerrë në pah më shumë elementë të ngjashëm dhe po ashtu në masë më të vogël, edhe tipare dalluese me atë italian.

Qëllimi dhe fusha e veprimit të regjimit të posaçëm (41-bis) në ligjin italian dhe atë shqiptar, bazohet gjithashtu në përmbushjen në mënyrë kumulative të disa kushteve, të lidhura me cenimin e rendit dhe sigurisë publike si dhe veprat penale kryesisht të rënda, për të cilat akuzohen ose janë dënuar shtetasit që i nënshtrohen atij.

Në të dy legjislacionet (shqiptar dhe atë italian), e drejta e vendimmarrjes për zbatimin e regjimit 41-bis i takon Ministrit të Drejtësisë. Në kuptim të elementëve të pavarësisë dhe paanshmërisë, sipas nenit 6 të KEDNJ-së, ligji shqiptar është më garantues sa i takon atributit që i është dhënë një institucioni të pavarur sikurse është Prokuroria e Posaçme, për të propozuar vendosjen e regjimit 41-bis, në raport me ligjin italian që këtë atribut ja jep një institucioni që është nën ombrellën dhe varësinë e pushtetit ekzekutiv (Ministri i punëve të Brendshme). Sa i takon procesit të konsultimit të vendimmarrjes, ligji italian ofron më shumë garanci në kuptim të mospërqëndrimit të këtij procesi tek titullarët e lartë të institucioneve ligjzbatuese.

Regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave në ligjin shqiptar, njëjtë si në ligjin italian të vitit konsiston në vendosjen e disa kufizimeve ndaj subjekteve që i nënshtrohen atij (të dënuarve apo të paraburgosurve). Në aspektin krahasimor, ligji shqiptar për disa nga kufizimet e të drejtave paraqet disa tendenca më humane e më pak ashpërsuese, por mbart paqartësi në drejtim të respektimit të disa standarteve të rëndësishme të GJEDNJ-së sikurse është domosodoshmëria për autorizimin gjyqësor në rastet e kontrolleve/përgjimeve të korrespondencës, bisedave telefonike apo takimeve familjare. Në ligjin italian, standarti për realizimin e këtyre kufizimeve është vendosur nga vendimmarrjet e Gjykatës Kushtetuese Italiane dhe GJEDNJ-së si rrjedhojë e të cilave ligji penitenciar itailian ka ndryshuar, duke vendosur si garanci për kontrollin e korrespondencës autorizimin nga një autoritet gjyqësor.

Të dyja ligjet nuk vendosin kufizime të të drejtave, sa i takon regjistrimeve apo kontrolleve lidhur me takimet me avokatët. Ligji shqiptar, në ndryshim nga italian nuk vendos kufizime lidhur me numrin e takimeve dhe telefonatat me avokatët.

Sipas ligjit të ri shqiptar kufizimet janë më pak të rrepta në drejtim të ushtrimit të të drejtës për takime familjare dhe biseda telefonike, të cilat mund të ushtrohen në mënyrë kumulative, të pakushtëzuara nga njëra tjetra sikurse parashikohet ne legjislacionin italian.

Në ligjin shqiptar, të burgosurit në regjimin e posaçëm përjashtohen nga organet përfaqësuese të të burgosurve njëjtë si në ligjin italian. Qartazi ky kufizim është huazuar në mënyrë mekanike nga legjislacioni italian, pa u përshtatur me kontekstin tonë ligjor, i cili nuk njeh dhe rregullon mënyrën e përfaqësimit të të burgosurve në organet e tyre.

Parashikimet lidhur me kohëzgjatjen e regjimit 41-bis në ligjin italian paraqesin tendencë më të ashpër dhe kufizuese në raport me ligjin shqiptar, pasi ai mund të zbatohet deri në 4 vjet, në ndryshim nga ligji ynë që parashikon një periudhë 1 vjeçare. Ligji italian parashikon zgjatje për periudhë të mëtejshme me 2 vjet secila, në ndryshim nga ligji ynë që parashikon zgjatje me 1 vit.

Katër vite pas miratimit për herë të parë të legjislacionit shqiptar, Gjykata jonë Kushtetuese u shpreh se ishte cenuar parimi i kontradiktoritetit, pjesë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në zgjatjen e regjimit 41-bis, pasi gjykatat në fjalë nuk kanë vlerësuar nëse të dhënat e këtyre akteve të cilat Ministri i Drejtësisë i konsideroi si të klasifikuara dhe sekret, janë marrë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, nëse kërkuesi duhej të ishte njohur me këto akte me qëllim të garantimit të së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor në drejtim të kontradiktoritetit, si dhe nëse në nxjerrjen e tyre organet shtetërore kanë vepruar në përputhje me ligjin dhe jo në mënyrë abuzive ose arbitrare.

Duke u bazuar në përfundimet e mësipërme, lind nevoja që për zbatimin e regjimit 41-bis në sistemin penitenciar shqiptar të mblidhen dhe të analizohen në mënyrë sistematike, të dhëna statistikore dhe cilësore nga autoritetet që kanë të drejtë të propozojnë dhe vendosin të dënuarit dhe të paraburgosurit në këtë regjim. Krahasimi i këtyre të dhënave, me të dhënat që ofron sistemi penitenciar italian do të mundësojë krijimin e një panorame më të qartë në drejtim të domosdoshmërisë për të mbajtur e parashikuar në ligjin tonë (sikurse është aktualisht), rregullime të ngjashme për këtë regjim me ato të huazuara në mënyrë të papërshtatur plotësisht me ato të ligjit italian, veçanërisht sa i takon kontekstit të krimit të organizuar dhe fizionomisë së legjislacionit të secilit shtet.

Gjithashtu është e nevojshme që në kuadër të reformimit të mëtejshëm të ligjit penitenciar shqiptar, parashikime të lidhura me regjimin 41-bis të qartësohen, plotësohen dhe rregullohen më mirë në të ardhmen, në respektim të parimit të sigurisë juridike dhe rezervës ligjore absolute si dhe të standarteve ndërkombëtare të elaboruara deri më tani nga jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me këtë regjim.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Cifaldi, Gianmarco dhe Scardaccione, Ermenegilda. *Italy's Penitenciary Order: art.41 bis OP. Juridical and criminological profiles* (*Ligji Penitenciar Italian: neni 41-bis i ligjit penitenciar. Profilet juridike dhe kriminologjike*), në Revistën "Criminology and Criminal Law Review", Volumi 1, Nr.1; Global Research Publishing House Stockton, Kaliforni, 2018.
2. De Vito, Riccardo. *Dentro la prigione della prigione: Un Introduzione (Brenda burgut të burgut: Hyrje)*, në Revistën "Giurisprudenza Penale Web", 2020, 1-BIS, Dentro il 41-bis: Riflessioni costituzionalmente orientate sul regime differenziato.
3. Manca, Veronica. *Il principio di proporzionalità "cartina tornasole" per il regime del 41-bis O.P.: soluzioni operative e suggestioni de iure condendo (Parimi i proporcionalitetit "test i rëndësishëm" për regjimin 41-bis O.P.: zgjidhje operacionale dhe sugjerime de iure condendo)* në Revistën "Giurisprudenza Penale Web", 2020, 1-BIS, Dentro il 41-bis: Riflessioni costituzionalmente orientate sul regime differenziato.
4. Mussolino, Santina. *Verso una memoria autocritica: ripensare i racconti e i ricordi degli "anni di piombo" (Drejt një kujtese autokritike: të rimendosh tregimet dhe kujtimet e "viteve të plumbit")*, në

Revistën "Democrazia e Sicurezza – Democracy and Security Review", anno VIII, n. 4, 2018 (data di pubblicazione: 7 ottobre 2019), Osservatorio sociale.
5. Rampioni, Matteo. *Il carcere «duro»: una condanna alla solitudine (Burgu "i vështirë": një ndëshkim në vetmi)*, në Revistën "Processo Penale e Giustizia", Fascicolo 4, 2021.
6. Romice, Sergio. *Brevi note sull'art. 41 bis O.P. (Vëzhgime të shkurtra në lidhje me nenin 41 bis të Rregullores Penitenciare)*, në Revistën "Giurisprudenza Penale Web", Nr.12, 2017.
7. Raport drejtuar Qeverisë Italiane mbi vizitën e realizuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit Ç'njerëzor dhe Poshtërues, përgjatë datave 12 deri në 22 mars 2019, CPT/Inf (2020).

Legjislacion

1. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), miratuar nga Këshilli i Evropës në Romë, në datë 4 nëntor 1950, ndryshuar me protokollet nr.11, 14 dhe 15, si dhe plotësuar me protokollet nr.1, 4, 6, 7, 12, 13 dhe 16.
2. Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Dokument Zyrtar (Procesverbal), datë 27 nëntor 2018, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
3. Komisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare; Dokument Zyrtar (Raporti për projektligjin "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", datë 17mars 2020; Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
4. Ligji nr. 108/2018, datë 20 dhjetor 2018 "*Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16 prill 1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve*".
5. Ligji Nr.81/2020 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*".
6. Ligji nr.84/2016 "*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*".
7. Vendim i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr.209, datë 6 prill 2022 "*Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve*".
8. Ligji 26 korrik 1975, n. 354 "*Norma mbi rregulloren penitenciare dhe mbi ekzekutimin e masave privuese dhe kufizuese të lirisë personale*", i ndryshuar (Ligji Penitenciar Italian).
9. Udhërrëfyes mbi jurisprudencën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Të drejtat e të burgosurve, Zyra e Regjistrimit pranë GJEDNJ-së (jo i detyrueshëm për GJEDNJ), azhornuar në datë 31 gusht 2022.
10. Rregullat Evropiane të Burgjeve, miratuar me Rekomandimin Rec(2006)2 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, ndryshuar me rekomandimin e datë 1 korrik 2020 të këtij Komiteti (në mbledhjen e tij të 1380-të).

Jurisprudencë

1. Vendim i GJEDNJ, datë 26 prill 1979, The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar.
2. Vendim i GJEDNJ, datë 8 qershor 1999, Messina kundër Italisë.
3. Vendim i GJEDNJ, datë 22 qershor 1999, Rinzivillo kundër Italisë.
4. Vendim i GJEDNJ, datë 31 gusht 1999, Di Giovine kundër Italisë.
5. Vendim i GJEDNJ, datë 25 nëntor 1999, Marincola kundër Italisë.
6. Vendim i GJEDNJ, datë 1 shkurt 2000, Vincenti kundër Italisë.
7. Vendim i GJEDNJ, datë 6 prill 2000, Labita kundër Italisë.
8. Vendim i GJEDNJ, datë 9 janar 2001, Natoli kundër Italisë.
9. Vendim i GJEDNJ, datë 18 tetor 2001, Indelicato kundër Italisë.
10. Vendim i GJEDNJ, datë 28 qershor 2005, Gallico kundër Italisë.
11. Vendim i GJEDNJ, datë 10 nëntor 2005, Argenti kundër Italisë.
12. Vendim i GJEDNJ, datë 29 qershor 2006, Viola kundër Italisë.
13. Vendim i GJEDNJ, datë 11 korrik 2006, Campisi kundër Italisë.
14. Vendim i GJEDNJ, datë 15 janar 2008, Bagarella kundër Italisë.

15. Vendim i GJEDNJ, datë 17 shtator 2009, Enea kundër Italisë.
16. Vendim i GJEDNJ, datë 17 prill 2012, Piechowicz kundër Polonisë.
17. Vendim i GJEDNJ, datë 18 mars 2014, Öcalan kundër Turqisë.
18. Vendim i GJEDNJ, datë 1 shtator 2015, Alfano kundër Italisë.
19. Vendim i GJEDNJ, datë 24 shtator 2015, Paolello kundër Italisë.
20. Vendimi i GJEDNJ, datë 12 janar 2016, Szabo dhe Vissy kundër Hungarisë.
21. Vendim i GJEDNJ, datë 25 tetor 2018, Provenzano kundër Italisë.
22. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 9, datë 26.02.2007.
23. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.5 datë 22.02.2022.

EFIKASITETI I TRAJTIMIT JURIDIKO-PENAL TË VEPRËS PENALE "SHKELJA E RREGULLAVE TË QARKULLIMIT RRUGOR" NË SHQIPËRI SI DHE PROBLEMATIKAT E HASURA

Dr. Bledar MUSTAFARAJ[*]
MSc. Kristina PUCI[**]

THE EFFECTIVENESS OF THE LEGAL-CRIMINAL TREATMENT OF THE CRIMINAL OFFENSE "VIOLATION OF ROAD TRAFFIC REGULATIONS" IN ALBANIA AS WELL AS THE PROBLEMS ENCOUNTERED

Abstract

The violation of road traffic regulations is a daily occurrence that impacts individuals, families, and the community at large, and is notably prevalent in Albanian society. It presents in various forms, leading to significant life-threatening, physical, psychological, and economic risks and consequences for those affected. This paper explores the frequency of road traffic regulation violations in Albania and assesses the effectiveness of current legislation in preventing and addressing this criminal offense. The research employs a mixed-methods approach, incorporating a review of existing literature, legal analysis, official statistics, and various publications.

The analysis examines the Criminal Code's provisions for the offense of 'Violation of road traffic regulations,' assessing the legislator's goals regarding deterrence and punishment, along with the law's implementation and effectiveness. Additionally, this paper provides a comparative analysis of Albanian legislation alongside the criminal laws of certain European Union countries and regional states, aiming to identify potential enhancements. The paper concludes with specific suggestions for amending the Criminal Code's legal provisions to more effectively deter and penalize traffic regulation violations, based on the findings of this analysis.

Keywords: *Violation of traffic road regulations, homicide, subjective aspect, consequences.*

1. Hyrje

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor është kthyer në një problem të prekshëm në praktikë nga e gjithë shoqëria dhe jo vetëm për aktorët e drejtësisë për shkak të pasojave të dëmshme që sjell duke cenuar disa të drejta themelore të individëve si jeta dhe shëndeti (integriteti fizik).

Legjislacioni penal në nenin 290 të Kodit Penal të tij inkriminon sjellje të cilat, duke shkelur rregullat e vendosura nga ligji i fushës, shkaktojnë lëndime fizike të lehta në disa persona, lëndime të rënda në një ose disa persona, dhe humbjen e jetës në një ose disa persona.

Megjithatë, pavarësisht se këto veprime janë inkriminuar tashmë në ligjin penal, është konstatuar se shkelja e rregullave ka ardhur gjithnjë në rritje duke diktuar kështu nevojën për studime të thelluara mbi efektshmërinë e ligjit penal në kuadër të arritjes së qëllimit madhor të tij: parandalimin e përgjithshëm të veprave penale. Deri më tani, doktrina dhe praktika e brendshme e ka konsideruar këtë vepër penale si një vepër ku shkelja administrative kryhet me dashje, ndërsa pasoja penale vjen nga pakujdesia.

[*] Dr. Bledar Mustafaraj, Avokat, bledi_mustafaraj@hotmail.it.
[**] MSc. Kristina Puci, Avokate kristinapuci20@gmail.com.

Në funksion të kësaj analize juridike shërbejnë të dhënat zyrtare mbi numrin e shkeljeve administrative në raport me shkeljet që hyjnë në sferën penale, me qëllim evidentimin e faktorëve që ndikojnë në përhapjen e kësaj vepre penale që tashmë është kthyer në një fenomen të rrezikshëm shoqërisht.

Duke parë edhe legjislacionet penale të vendeve të rajonit dhe vendeve të zhvilluara të Evropës Perëndimore, konstatohet se kjo vepër penale duhet të rishikohet në drejtim të përmirësimit të saj me qëllim reformimin e politikës penale në këtë fushë, element i cili lipset të ndikojë drejtpërdrejt në politikën e dënimit penal për shkelësit dhe për parandalimin e mëtejshëm të kryerjes së veprave.

Pyetja kërkimore që shtrohet në këtë punim është se sa efektivë janë legjislacioni ekzistues dhe reagimet institucionale në parandalimin dhe trajtimin e kësaj dukurie?

Gjatë punimit është përdorur qasje e kombinimit të metodave cilësore dhe sasiore, për të adresuar në mënyrë efektive çështjen e kërkimit. Metodologjia përfshin rishikimin gjithëpërfshirës të literaturës, duke u mbështetur në literaturë akademike, tekste ligjore, raporte qeveritare dhe botime të tjera mbi shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor, si të dhëna statistikore nga Prokuroria, INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme. Ky rishikim ofron një bazë të njohurive ekzistuese dhe kornizave teorike në lidhje me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor në Shqipëri, duke mundësuar një kuptim gjithëpërfshirës të temës. Janë përdorur disa burime të të dhënave për të siguruar një analizë gjithpërfshirëse. Të dhënat primare janë marrë përmes raporteve publike nga institucionet përgjegjëse në Shqipëri mbi shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor dhe luftën për parandalimin e saj. Të dhëna dytësore, si informacione statistikore, raporte zyrtare dhe publikime të ndryshme, janë mbledhur për të siguruar të dhëna sasiore mbi prevalencën dhe ndikimin e kësaj dukurie në Shqipëri. Të dhënat e mbledhura janë analizuar duke përdorur metoda përshkruese për të gjeneruar njohuri të përgjithshme apo edhe të dhëna numerike mbi prevalencën, tendencat dhe ndikimet e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor. Si bazë shërben legjislacioni në fuqi, përkatësisht Kodi Penal dhe Kodi Rrugor. Hulumtimi identifikon çështjet kryesore, tendencat dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, duke lejuar një kuptim më të thellë të efektivitetit të legjislacionit në parandalimin dhe trajtimin e fenomenit. Gjetjet cilësore dhe sasiore janë integruar për të ofruar një kuptim gjithëpërfshirës të fenomenit të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor në Shqipëri dhe sugjerojnë rekomandime për të luftuar në mënyrë efektive këtë dukuri.

2. Përhapja e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor në Shqipëri

Problematikat që lidhen me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor në Shqipëri nuk janë thjesht çështje teorike. Përkundrazi, përfshihen tek ato fenomene të evidentueshme e të prekshme në përditshmëri edhe nga qytetarë të thjeshtë dhe jo vetëm profesionistët e fushës. Në fund të fundit, janë qytetarët ata që mbartin pasojat e shkeljeve të qarkullimit rrugor, të cilat shkatojnë edhe dëmtime të rënda në shëndet apo në jetët e tyre.

Bazuar në të dhënat zyrtare të aksesuara, në muajin Mars 2024 numërohen 107 aksidente rrugore. Numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) rezulton 147 persona në muajin Mars 2024. Gjatë tremujorit të parë 2024 vdekshmëria në aksidente rrugore është 9 për 100 aksidente, ndërsa në të njëjtën periudhë të një viti më parë ishte 17,5 për 100 aksidente rrugore[1]. Aksidentet rrugore, në 87,9 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup-mosha 25-34 vjeç, duke zënë 31,8 % të numrit të aksidenteve gjithsej[2].

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, veprat penale të evidentuara për kategorinë "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor"[3] dhe numri i autorëve për këtë kategori, paraqiten si më poshtë:

[1] Instat, *Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2023*. Tiranë, burimi: https://www.instat.gov.al, parë më 26.4.2024.

[2] Të dhëna të marra nga: www.instat.gov.al/media/13242/aksidentet_rrugore_mars_2024.pdf, parë më 26.4.2024.

[3] Në këtë kategori përfshihen veprat penale të parashikuara nga nenet 290, 291 e 273 të Kodit Penal.



	2019	2020	2021	2022	2023
Veprat e evidentuara	5652	5300	5854	5682	5551
Autorët	5473	5128	5672	5538	5579

Burimi: Instat.

Në muajin Mars 2024, numri më i lartë i aksidenteve rrugore ka ndodhur ditën e Enjte dhe të Shtunë me 18,7%, ndërsa numri më i ulët i aksidenteve ka ndodhur ditën e Hënë dhe të Mërkurë me 7,5%.

Numri më i lartë i procedimeve penale për veprat penale në fushën e qarkullimit rrugor është regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kurse koeficienti më i lartë për 100 000 banorë rezulton në qarkun e Lezhës me 304 procedime dhe në qarkun Vlorë me 250 procedime[4].

a. Format e shfaqjes

Shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor nuk paraqesin interes për të drejtën penale në fuqi nëse nuk vjen pasoja e plagosjes së lehtë, plagosjes së rëndë, apo vdekjes së personit/personave. Megjithatë, për efekt të analizimit të këtij fenomeni, vlen të theksohet se shkeljet kryesore konsistojnë në tejkalim të shpejtësisë së lejuar, parakalimit të gabuar, mosrespektimit të sinjalistikës së detyrueshme vertikale dhe horizontale, drejtimit të mjeteve në gjendje të dehur/intoksikuar apo pa dëshminë e aftësisë si dhe drejtimi i mjeteve të pakontrolluara teknikisht apo në tejkalim të afatit.

Secila prej këtyre formave ndiqet dhe sanksionohet edhe administrativisht ku, për shkak të dinamikave të ngjarjeve të hasura dhe shpeshtësisë që ndodhin, sanksionet kanë ardhur duke u rritur në maksimumin e tyre për të parandaluar shkaktimin e pasojave të dëmshme në shëndetin dhe jetën e personave.

Nga ana objektive këto veprime manifestohen në mënyra nga më të të ndryshmet, por gjithnjë brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi që rregullon qarkullimin rrugor. Për shembull, tejkalimi i shpejtësisë në zonat e banuara, nuk përbën të njëjtin rrezik dhe nuk manifestohet me të njëjtin qëndrim psikik nëse tejkalohet shpejtësia (përdoret e njëjta shpejtësi) në një zonë interurbane. Drejtimi i mjetit në një zonë të banuar me 90 km/h ku shpejtësia e lejuar është 30 km/h nuk përmban të njëjtën rrezikshmëri potenciale me drejtimin e mjetit me po të njëjtën shpejtësi në një rrugë interurbane ku shpejtësia e lejuar është 80 km/h.

Ndërkohë, nga ana subjektive këto shkelje prezumohet se kryhen me dashje për shkak se individët që drejtojnë mjetet janë të njohur me rregullat e qarkullimit rrugor, dhe shkelja e tyre bëhet me vetëdije të plotë mbi shkeljen

[4] Prokuroria e Përgjithshme (2024). *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2023*. Tiranë: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al parë më 26.4.2024.

përkatëse ligjore dhe mundësinë e ardhjes së pasojës. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që këto shkelje të kryhen edhe me pakujdesi në varësi të faktorëve të jashtëm që ndikojnë në qëndrimin psikik të personit dhe vetëdijen e tij mbi ekzistencën e sinjalistikës, praninë e objekteve apo personave të tretë në trajtektoren e drejtimit të mjetit apo mundësinë e shmangies së pasojës.

b. Tipologjia e pasojave

Pavarësisht mekanizmit dhe dinamikës së shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor administrativisht, këto shkelje nuk përbëjnë interes në kuadër të drejtësisë penale nëse nuk vjen një pasojë e dëmshme në shëndetin apo jetën e një apo disa personave.

Legjislatori, nëpërmjet ligjit penal, kërkon të mbrojë shëndetin dhe jetën e personave nga shkeljet rrugore. Për ligjin penal nuk merr rëndësi forma e shkeljes apo intensiteti i saj për t'u konsumuar vepra penale e parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Nëse provohet pasoja e plagosjes së lehtë, plagosjes së rëndë, apo vdekjes, mënyra e kryerjes së veprës penale i shërben vetëm politikës së dënimit penal në kuadër të caktimit të llojit dhe masës së dënimit, ndërkohë që vepra penale konsumohet që në momentin që vjen pasoja.

Për të përshkallëzuar sanksionin penal sipas pasojës së shkaktuar është parashikuar si vepër penale vetëm pasoja e plagosjes së lehtë të disa personave. Në këto kushte, përjashtohet përgjegjësia penale nëse ka vetëm një person të plagosur lehtë (nënkupton këtu dëmtime në shëndet mbi 9 ditë paaftësi të përkohshme për punë në referencë të nenit 89 të Kodit Penal).

Ndërkohë, konsiderohet si vepër penale bazuar në paragrafin e dytë të nenit 290 të Kodit Penal shkaktimi i pasojës së plagosjes së rëndë qoftë edhe të një personi, nëpërmjet shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor. Në kuptim të kësaj dispozite, në përputhje me nenin 88 të Kodit Penal plagosje e rëndë do të konsiderohet çdo dëmtim në shëndet që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzënisë, ose dëmtim tjetër të rrezikshëm për jetën në çastin e shkaktimit.

Forma më e rëndë e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor sipas nenit 290 të Kodit Penal është rasti kur pasoja e vdekjes provohet. Ndërkohë, kur nga shkelja shkaktohet plagosja e rëndë e disa personave apo cenohet jeta e disa personave, përbën rrethanë të cilësuar të kësaj vepre penae.

c. Faktorët që ndikojnë

Në këndvështrimin kriminologjik të këtij fenomeni nuk ka një studim të kryer nga organet shtetërore apo personat juridik privatë, mbi faktorët të cilët ndikojnë drejtpërdrejt apo nxisin shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor, aq më tepër kur bëhet fjalë për pasoja të padëshiruara të cilat cenojnë interesat e ligjshëm të të tretëve dhe sanksionohen me dënime administrative të konsiderueshme dhe me dënim penal me burgim.

Në kushtet kur legjislacioni ka ardhur duke u përforcuar nëpërmjet shtimit të masave të sanksionit dhe duke pasur gjithnjë thirrje sensibilizuese për rregullimin e mënyrës së drejtimit të mjeteve, gjithsesi aksidentet rrugore, edhe me pasoja fatale, janë kthyer në shqetësim serioz dhe hasen çdo ditë e më shumë.

Ndër arsyet që mund të ndikojnë, përmendet së pari mungesa e njohjes me rregullat e drejtimit të mjeteve, veprimet korruptive në drejtim të dhe nga punonjësit e policisë, stili i jetesës, shtimi i numrit të personave që konsumojnë lëndë narkotike dhe alkool, shtimi i numrit të mjeteve në raport me numrin e popullsisë, zgjerimi i turizmit dhe drejtimi i mjeteve nga të huajt.

Po kështu, faktorë që ndikojnë janë mungesa e infrastrukturës rrugore të duhur dhe mungesa e sinjalistikës.

3. Vepra penale e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor sipas legjislacionit penal shqiptar

Në vështrimin restrospektiv të kësaj norme penale, vërehet se nga neni 535 i Kodit Penal të vitit 1928 inkriminohej vendosja në rrezik e sigurisë së përbashkët ose i sendeve nga drejtimi i rrezikshëm i automjeteve. Konkretisht, në këtë dispozitë parashikohej se:

"Kushdo që, në rrugët ose në viset që shkon populli, ose n'ato vënde që janë të çeluna për popull, nget kafshë, karoca, automobila dhe të tjera mjete kësodore bartëse <u>në mënyrë të rezikëshme për sigurimin e personave ose të gjanave</u>, ndeshkohet me burgim të lehtë deri në njëzet ditë, ose me gjobë të lehtë deri në njëzet ditë, ose me gjobë të lehtë deri në dyqint fr. ari, dhe në qoftë se kontravjtësi asht shofer ose nga ata konduktorë q'i shtrohen lejes, vendoset dhe pezullimi i ushtrimit të profesionit ose të mjeshtërisë për një kohë deri në një muej.".

Qartësisht, referuar përmbajtjes së kësaj norme, kjo është një vepër penale rreziku, pasi nuk kërkon pasojë për t'u konsideruar si e kryer por mjafton vetëm konstatimi i drejtimit në mënyrë të rrezikshme për personat apo sendet/pronat.

Ndërkohë, neni 81 i Kodit Penal i vitit 1979, i titulluar "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor" parashikonte si element të domosdoshëm të veprës penale ardhjen e pasojës duke bërë këtë parashikim:

"Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi, plagosjen e lehtë të disa personave ose pasoja të tjera të rënda dënohet me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar vdekje ose plagosje të rëndë të personave, dënohet me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet."

Kjo dispozitë merrte në mbrojtje marrëdhëniet shoqërore që siguronin qarkullimin e rregullt rrugor, është konsideruar dispozitë e bardhë, ndaj në çdo rast dispozita referonte në përmbajtjen e dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor nr. 4559, datë 1.11.1969, të ndryshuar, dhe në rregulloren e qarkullimit rrugor[5]. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata e Lartë e kohës me Udhëzimin e Plenumit të Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 5.11.1982 "Mbi krimin e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor". Në doktrinën e kohës është mbajtur qëndrimi se ky krim kryhet në forma të ndryshme të fajësisë, ku vetë shkelja mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia, sidomos në formën e vetëbesimit të tepruar. Sa u përket pasojave, ato mund të vijnë nga pakujdesia në formën e neglizhencës ose të vetëbesimit të tepruar[6].

I njëjti mendim ka vijuar dhe në doktrinën e zhvilluar pas reformimit të legjislacionit penal dhe miratimit të Kodit Penal të ri, ku vepra penale e "Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor", e parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal aktual, është konsideruar tipikisht si vepër penale me dy forma faji, ku veprimi kryhet me dashje, ndërsa pasoja vjen nga pakujdesia[7].

Gjithsesi, pavarësisht këtij qëndrimi, mendimet e shprehura në literaturën e kohës janë në fakt konfuze dhe shpesh priren drejt arsyetimit se në fakt pasoja diktohet nga forma e fajit me të cilën ka vepruar autori në momentin e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor. Për veprën penale për të cilën po arsyetohet, është pranuar se drejtuesit e mjeteve veprojnë në pjesën dërrmuese të rasteve me pakujdesi në formën e vetëbesimit të tepruar[8]. Kur arsyetohet për formën e ndërlikuar të fajit, arrihet në përfundimin se "*... në qoftë se pasoja do të vinte nga pakujdesia, duke respektuar parimin e përgjithshëm të fajësisë, kjo vepër do të cilësohej vrasje nga pakujdesia...*". Si dhe vijohet më tej, me mendimin se "*... gjendemi përpara një rasti sui generis, ku gërshetohet dashja indirekte me pakujdesinë në formën e vetëbesimit të tepruar*"[9].

Aktualisht, referuar legjislacionit penal në fuqi, vepra penale e "Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor", parashikohet nga neni 290 i Kodit Penal, i përbërë nga 4 paragrafë, i vendosur në seksionin III të kreut VIII të këtij kodi, ku përfshihen veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, me formulimin e mëposhtëm:

"Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

---

[5] Elezi, Ismet. *E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë: pjesa e posaçme*, Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, (1983). f. 137-142.

[6] Po aty.

[7] Muçi, Shefqet. E *drejta penale. Pjesa e përgjithshme*, Tiranë: Botimet Dudaj, 2007, f. 104.

[8] Çela, Aranit. *E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë: pjesa e përgjithshme*, Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, 1982, f. 149-160.

[9] Muçi, Shefqet. *E drejta penale. Pjesa e përgjithshme*, 2007, f. 145-146.

Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen e një personi, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet."

Në kuadër të analizimit të elementëve përbërës së kësaj vepre penale vlen të përmendet trajtimi doktrinal që bëhet aktualisht në kuadër të qartësimit të kuptimit të normës. Doktrina e së drejtës penale në Shqipëri e ka konsideruar këtë si një vepër penale, e cila ka si objektiv të parë mbrojtjen e marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar qarkullimin e rregullt të automjeteve. Ndërkohë, shëndeti dhe jeta e personit konsiderohen si objekt dytësor pasi, pavarësisht pasojave të rënda që mund të shkaktohen, objekti kryesor mbeten rregullat për sigurimin e qarkullimit[10]. Ka edhe mendime të tjera se objekt i saj është jeta dhe shëndeti e njerëzve, ruajtja e sigurisë së lëvizjes në rrugë, sigurimi i qarkullimit të rregullt dhe të parrezikshmëm të mjeteve sipas kushteve të parashikuara nga normat juridike të posaçme[11].

Lidhur me këtë aspekt, mbajmë qëndrimin se kjo është një vepër penale materiale e cila kërkon pasojë për t'u konsideruar si e kryer. Pasoja nuk është element cilësues i kësaj norme, por është pjesë thelbësore dhe e domosdoshme e saj pa të cilën nuk ka vepër. Në këto kushte, ligjvënësi nuk ka dashur të normojë qarkullimin rrugor, por të ndëshkojë shkeljet që sjellin dëmtime në shëndet e në jetën e personave. Mungesa e kësaj pasoje trajtohet vetëm administrativisht në përputhje me Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Nga ana subjektive është pranuar se kjo vepër mund të kryhet me forma të ndryshme fajësie, ku vetë shkelja rrugore kryhet me dashje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndërsa pasoja vjen nga pakujdesia në formën e vetbesimit të tepruar ose neglizhencës. Nëse pasoja do të vinte me dashje, mban qëndrim doktrina, do të ishim përpara vrasjes dhe jo përpara shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor[12]. Autori me dashje shkel rregullat e qarkullimit rrugor, ai ka dijeni për të gjitha rrethanat e faktit. Duke qenë një person i cili është licencuar nga autoritetet, prezumohet se i ka njohuritë për të gjitha rregullat dhe me ndërgjegje i shkel ato, duke krijuar bezimin se veprimet nuk janë të rrezikshme nga rrethanat e rastit[13].

Lidhur me aspektin subjektiv të kryerjes së kësaj vepre penale vlerësohet se qëndrimi psikik i autorit në kryerjen e veprimeve të tij, të cilat shkaktojnë pasojën, është një dhe i vetëm. Qëndrimi psikik që ka personi në momentin që fillon të cenojë marrëdhëniet juridike është një i vetëm dhe nuk mund të ndërthuret me një tjetër formë faji të pavarur nga forma me të cilën ka filluar të konsumohet vepra penale.

Në këtë kuptim, ose vepra penale do të konsiderohet në tërësi e kryer me pakujdesi (kur janë kushtet për ndonjërën prej formave të pakujdesisë) ose në tërësi e kryer me dashje eventuale, ku që në momentin e parë që subjekti ndërmerr veprime që bien ndesh me rregullat e qarkullimit rrugor, ka vetëdijen se po kryen një veprim që mund ta sjellë pasojën e parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, si dhe edhe pse nuk e dëshiron pasojën, e lejon atë për të arritur qëllimin e tij që nuk lidhet me ardhjen e pasojës. Vetëm në rastin e dashjes direkte mund të jemi përpara veprës penale të vrasjes, ndërsa në rastin e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen duhet të pranohet kryerja e saj me dashje indirekte.

Në rastet kur shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor është evidente, nuk mund të flasim për formë faji neglizhence apo vetëbesimi të tepruar, pasi personi e ka ndërgjegjen e plotë se konkretisht ajo lloj shkeljeje është e pakontrollueshme prej tij pasi shkon përtej aftësisë së tij fizike e mendore për të kontrolluar ose jo ardhjen e pasojës. Për shembull, drejtimi i automjetit në një zonë të banuar ku lejohet shpejtësia e qarkullimit deri në 30 apo 40 km/h me një shpejtësi faktike prej 200 km/h, është e qartë se personi nuk mund të kontrollojë drejtimin e mjetit apo ndalimin e plotë të tij në kohën dhe vendin e diktuar nga sinjalistika. Aftësia e tij për ta kontrolluar ardhjen e pasojës përfundon në momentin që vendos të ndërmarrë veprime për të kryer shkeljen. Ardhja ose jo e pasojës varet tërësisht nga elemente rastësorë dhe faktorë të jashtëm, mirëpo ajo që ka rëndësi këtu është qëndrimi psikik

[10] Elezi, Ismet. *E drejta penale e posaçme"*, 2018, f. 494.
[11] Meçani, Delo. *E drejta penale e posaçme"*, 2017, f. 677.
[12] Elezi, Ismet. *E drejta penale e posaçme"*, 2018, f. 497.
[13] Meçani, Delo. *E drejta penale e posaçme"*, 2017, f. 682.

i personit. Ai e parashikon se, nëse lëviz me atë lloj shpëjtësie në atë zonë dhe nëse kalon rrugën një këmbësor, nuk do arrijë të ndalojë në kohë mjeti (mekanizmi i ndalimit të mjetit nuk varet prej tij pasi është proces inxhinierik), nuk e dëshiron ardhjen e pasojës, por për shkak të arsyeve a qëllimeve të tjera e kryen atë veprim dhe merr përsipër edhe sjelljen e pasojës. Arsyet mund të jenë për shkak nxitimi/urgjence, krenarie, kënaqësie personale, etj. E njëjta situatë paraqitet në rastet e parakalimeve në vende ku e gjithë sinjalistika urdhëron ndalimin e parakalimit. Shmangia e ardhjes së pasojës nuk varet më prej autorit në momentin që ka ndërmarrë veprimet në kundërshtim me rregullat ligjore, as prej aftësisë së tij si drejtues mjeti (vetëbesimit të lartë) pasi çdo njeri me inteligjencë mesatare arrin ta kuptojë se kryerja e atij veprimi është i ndaluar pasi pasoja nuk mund të kontrollohet, dhe pasoja "i lihet në dorë" rastësisë duke shpresuar se një aksident nuk do të ndodhë e nuk do të ketë pasojë.

Pra, prania e formës së fajit me dashje indirekte në rastin e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor qëndron si në aspektin teorik edhe atë praktik kur shkelja është e atillë që nuk lë vend dyshimi mbi aftësinë e personit për të kontrolluar ardhjen e pasojës. Në raste të tilla, shkeljet janë flagrante, ku personi tejkalon edhe parimin e vetëbesimit të tepruar pasi nuk ka më mundësi fizike dhe intelektuale të shmangë ardhjen e pasojës për shkak të veprimeve që me dashje ka filluar të kryejë.

4. Analizë krahasuese me legjislacione penale të huaja

Kodi Penal i Spanjës parashikon në titullin e parë "Vrasja dhe format e saj" të Librit të dytë të tij, në nenin 142, vrasjen e shkaktuar me pakujdesi të rëndë ose më pak të rëndë, nëpërmjet një mjeti të motorizuar ose ciklomotori. Në titullin e tretë, "Plagosjet", neni 152, parashikohen plagosjet e shkaktuara me anë të mjetit të morizuar ose cikolomotorë. Krimet kundër sigurisë rrugore janë përfshirë në kreun IV të titullit XVII të këtij kodi, që bën fjalë për krimet kundër sigurisë kolektive. Në nenet 379-385 ter, në asnjë rast nuk parashikohen si rrethana të cilësuara shkaktimi i plagosjes ose vdekjes së viktimës, por vetëm drejtimi i mjeteve që "vë në rrezik konkret jetën ose shëndetin e njerëzve" (neni 380) apo "me mospërfillje të hapur ndaj jetës së tjetrit" (neni 381).

Kodi Penal i Italisë parashikon në nenin 589-bis figurën e veprës penale të vrasjes rrugore. Kjo vepër penale është shtuar në vitin 2016 nga legjislatori italian duke pasur parasysh së pari se, ai që drejton mjetin në gjendje të dehur nuk pranohej nga praktika që ta kishte kryer veprën me dashje eventuale. Sidomos praktika këmbëngulte në faktin që, pavarësisht sjelljes së padenjë, autori në asnjë mënyrë nuk e pranonte pasojën e vdekjes. Gjithsesi, në një rast të tillë mbetej pranimi i rrezikut të pasojës dhe parashikimit të saj, gjë që është pranuar nga praktika gjyqësore italiane si pakujdesi e rëndë, për shkak të mundësisë së parashikimit të pasojave. Parashikimi i kësaj vepre, së dyti, lidhet me faktin se ligjvënësi, pasur parasysh numrin e lartë të vdekjeve automobilistike, ka vendosur të mos e linte këtë figurë si një rrethanë të cilësuar të vrasjes nga pakujdesia të parashikuar nga neni 589 i Kodit Penal italian. Kjo lloj vrasjeje kryhet gjatë cenimit të rregullave të qarkullimit rrugor, drejtimit të mjetit në gjendje të dehur, duke shkelur rregulla specifike rrugore që lidhen me mungesën e lejes së drejtimit, siguracionit, etj., të cilat parashikohen si rrethana të cilësuara. Në dispozita të veçanta, Kodi Penal italian parashikon plagosjet e shkaktuara gjatë qarkullimit rrugor (automobilistike).

Vrasja dhe plagosjet nga pakujdesia të kryera në shkelje të normave të qarkullimit rrugor, nuk cilësohen në mënyrë të veçantë nga Kodi Penal i Gjermanisë, duke bërë pjesë edhe nga pikëpamja e ndëshkimit, në figurat e përgjithshme të *Fahrlässige Tötung* (§ 222 StGB) dhe *Fahrlässige Körperverletzung* (§ 229 StGB). Kodi gjerman karakterizohet nga prania e figurave të veprave penale të rrezikut në fushën e sigurisë rrugore, të përfshira në kreun e njëzetetetë të *Strafgesetzbuch*, që bën fjalë për *Gemeingefährliche Straftaten*. Neni *315c StGB* parashikon sjellje që cenojnë normat e qarkullimit rrugor dhe që përbën një vepër penale të rrezikut konkret, ku të mirat juridike të mbrojtura janë, nga një anë siguria e qarkullimit rrugor dhe nga ana tjetër, jeta, integriteti trupor dhe pasuria e tjetrit. Neni 316 parashikon drejtimin e mjeteve nën ndikimin e alkoolit ose lëndëve narkotike.

Legjislacioni francez parashikon vrasjen automobilistike si figurë të posaçme të veprës penale dhe në dallim nga legjislacioni gjerman, nuk përmban vepra penale rreziku, me përjashtim të drejtimit të mjetit në gjendje të dehur dhe të përdorimit të drogës, që rregullohet nga kodi rrugor.

Vrasja automobilistike parashikohet në nenin 221-6-1 (bërë pjesë e Kodit Penal me *Loi n° 2003-495 du 12 juin 2003 renforçant la lutte contre la violence routière*), menjëherë pas nenit që parashikon vrasjen nga pakujdesia.

Dispozita konfiguron një vepër penale të pavarur nga vrasja nga pakujdesia edhe pse doktrina mbizotëruese e përfshin në fakt në rrethanat e cilësuara të kësaj të fundit[14]. Neni në fjalë, në paragrafin e tij të parë formon figurën bazë të veprës penale, ndërsa rrethanat e cilësuara, që lidhen me dashjen në shkeljen e rregullave, përmenden në paragrafin e dytë të dispozitës.

Kodi Penal i Kroacisë parashikon në nenin 272 të tij veprën penale "Rrezikimi i qarkullimit rrugor", ku në paragrafin e parë të dispozitës parashikohet rrezikimi i qarkullimit nga një përdorues i rrugës, i cili në shkelje të rregullave përkatëse shkakton një aksident që sjell për pasojë plagosjen e tjetrit ose dëmtimin e konsiderueshëm të pasurisë së tjetrit.

Paragrafi i dytë parashikon kryerjen e kësaj vepre penale nga neglizhenca, kurse rrethanat e cilësuara që lidhen me shkaktimin e vdekjes një ose më shumë personave, të ndara sipas formës së fajit, parashikohen në paragrafët e tretë dhe të katërt.

Kodi Penal i Kosovës parashikon veprën penale të "Rrezikimit të trafikut publik" në nenin 370 të tij. Veçori e Kodit Penal të Kosovës në raport me ligjin tonë penal është fakti se inkriminohet edhe rrezikimi apo dëmtimi i pasurisë nga shkelja e rregullave të trafikut publik (rregullat e qarkullimit rrugor), ndërkohë që Kodi ynë inkriminon vetëm dëmtimin e lehtë, të rëndë ose vdekjen e personave. Sipas kësaj dispozite, si rregull këto vepra kryhen me dashje, dhe provueshmëria e formës së neglizhencës përbën rrethanë cilësuese lehtësuese ku ulet ndjeshëm masa e dënimit, pasi paragrafi i gjashtë i nenit 370 në mënyrë të shprehur parashikon se "*Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit*".

5. Efektet e legjislacionit aktual mbi shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor

Referuar të dhënave, numri i shkeljeve ka ardhur në rritje. Kjo tregon se si rritja e sanksionit administrativ edhe ndëshkimi penal kanë qenë të paefektshëm në drejtim të efektit parandalues që duhet të ketë ligji.

[14] Guédon, J. Ph. (2003). *Les efforts du législateur français contre la violence routière*, në *Semaine juridique*, n° 48, Etude, 179, f. 2077 e vij.; André, C. (2017). *Droit pénal spécial*, Paris: Dalloz, f. 112; Malabat, V. (2015). *Droit pénal spécial*, Paris: Dalloz, f. 108.



	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Numri i procedimeve penale	770	832	632	737	784	841	880	929	796	969	911	966

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme.

Për vitet 2019-2022, të dhënat në shifra janë veç për nenin 290/1, kurse shifrat për nenin 290 përfshijnë paragrafët 2, 3, dhe 4 të dispozitës.



	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
290/4					1		25				
290/3			1	3	2	12	46				
290/2			1	3	2	40	112				
290/1			4	1	2	8	20	20	13	14	37
290	344	261	238	271	267	166	145	268	224	304	231

Burimi: Ministria e Drejtësisë.

Nga analiza e këtyre të dhënave rezulton se, pavarësisht ndryshimeve të lehta në shifra, vepra penale vazhdon të ketë qëndrueshmëri si dukuri dhe referuar statistikave të Prokurorisë së Përgjithshme, ka prirje për rritje të

rasteve, duke qenë se numri i procedimeve penale ka ardhur në rritje nga viti në vit. Për vitin 2023, tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara është 6,04%, në krahasim me vitin 2022[15].

Referuar të dhënave më të fundit mbi shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor, gjatë muajit Janar 2024[16] janë evidentuar 162 aksidente rrugore ose 93% më shumë aksidente se muaij Janar 2023. Gjithashtu, krahasuar me muajin e mëparshëm, kjo kategori veprash penale ka pësuar rritje me 3%. Numri i individëve që kanë humbur jetën në aksidente për muajin Janar 2024 ka qenë 11 individë, krahasuar me muajin Janar të vitit të kaluar është shënuar rënie me 2 viktima më pak. Po ashtu, krahasuar me muajin Dhjetor 2023 numri i të vrarëve në aksidente ka shënuar rënie me 4 viktima më pak. Numri i individëve të plagosur rëndë në aksidente për muajin Janar 2024 ka qenë 23, duke shënuar 5 persona të plagosur rëndë më shumë se në muajin Janar 2023. Gjithashtu, në raport me muajin paraardhës, Dhjetor 2023, janë 5 të plagosur rëndë më shumë.

Ndërkohë, në raport me masat administrative të vendosura për shkelje të cilat nuk kanë sjellë pasoja në shëndet apo jetën e personave, masat administrative nga Policia Rrugore (gjobat) kanë shënuar 74,504 për muajin Janar 2024 ose 20% më shumë se numri i gjobave të shënuara gjatë muajit Janar 2023. Në raport me muajin Dhjetor 2023 është shënuar rënie me 2%.

Gjatë muajit Shkurt 2024[17] janë evidentuar 108 aksidente rrugore ose 23% më shumë aksidente se muaji Shkurt 2023. Në krahasim me muajin e mëparshëm, kjo kategori veprash penale ka pësuar rënie me 33%. Numri i individëve të vrarë në aksidente për muajin Shkurt 2024 ka qenë 8 individë, krahasuar me muajin Shkurt të vitit të kaluar është shënuar rënie me 6 viktima më pak. Gjithashtu, krahasuar me muajin Janar 2024 numri i të vrarëve në aksidente ka shënuar rënie me 3 viktima më pak. Numri i individëve të plagosur rëndë në aksidente për muajin Shkurt 2024 ka qenë 14, duke shënuar 8 persona të plagosur rëndë më shumë se në muajin Shkurt 2023. Në raport me muajin paraardhës, Janar 2024, është shënuar rënie me 9 të plagosur rëndë më pak. Ndërkohë, masat administrative nga Policia Rrugore (gjobat) kanë shënuar 88,488 për muajin Shkurt 2024 ose 44% më shumë se numri i gjobave të shënuara gjatë muajit Shkurt 2023. Në raport me muajin Janar 2024 është shënuar rritje me 19%.

Gjatë muajit Mars 2024[18] janë evidentuar 107 aksidente rrugore ose 10% më shumë aksidente se muaji Mars 2023. Në krahasim me muajin e mëparshëm, kjo kategori veprash penale ka pësuar rënie me 1%. Numri i individëve të vrarë në aksidente për muajin Mars 2024 ka qenë 15 individë, krahasuar me muajin Mars të vitit të kaluar është shënuar rënie me 4 viktima më pak. Krahasuar me muajin Shkurt 2024, numri i të vrarëve në aksidente ka shënuar rritje me 7 viktima më shumë. Numri i individëve të plagosur rëndë në aksidente për muajin Mars 2024 ka qenë 13, duke shënuar 5 persona të plagosur rëndë më pak se në muajin Mars 2023. Në raport me muajin paraardhës, Shkurt 2024, është shënuar gjithashtu rënie me 5 të plagosur rëndë më pak. Masat administrative nga Policia Rrugore (gjobat) kanë shënuar 94,459 për muajin Mars 2024 ose 30% më shumë se numri i gjobave të shënuara gjatë muajit Mars 2023. Gjithashtu, në raport me muajin Shkurt 2024 është shënuar rritje me 30%.

Pra, referuar këtyre të dhënave vërehet se në raport me procedimet penale, masat administrative janë në një numër shumë më të lartë pasi i referohen edhe shkeljeve më të lehta. Por, fakti që ka pasur dhe vijon të ketë pasoja në jetët dhe shëndetin e njerëzve në mënyrë shqetësuese, tregon se numri i lartë i shkeljeve përkthehet në jo pak raste në vepra penale për shkak të periodicitetit të kryerjes së shkeljeve, faktorëve të jashtëm dhe pamundësisë për të shmangur çdo herë pasojat.

Shkeljet e shpeshta administrative për drejtuesit e mjeteve duhet të kishin efekt parandalues në drejtim të përmirësimit të mënyrës së drejtimit të mjetit dhe respektimit të rregullave të vendosura me ligj për drejtimin e mjeteve. Fakti që shkeljet vijojnë në rritje, ose nivele të njëjta të "qëndrueshëm", tregon se shtetasit me dijeni të plotë se janë duke vepruar në kundërshtim me ligjin, sjellin pasojat e parashikuara nga neni 290 i Kodit Penal.

[15] Prokuroria e Përgjithshme (2024). *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2023*. Tiranë: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al parë më 26.4.2024.

[16] Marrë nga: https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Buletini-Janar-2024.pdf, parë më 7.5.2024.

[17] Marrë nga: https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Buletini-Shkurt-2024.pdf, parë më 7.5.2024.

[18] Marrë nga: https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Buletini-Mars-2024.pdf, parë më 7.5.2024.

6. Problematikat me të cilat përballen institucionet dhe problematikat ligjore

Si rregull, në përcaktimin drejt të elementit subjektiv të fajit, duhen mbajtur gjithnjë parasysh elementi intelektual dhe elementi volitiv i fajit. Në përgjithësi në doktrinë, edhe në vendet e rajonit, veprat penale në fushën e qarkullimit rrugor, janë konsideruar si vepra penale të kryera nga pakujdesia në formën e vetëbesimit të tepruar dhe jo me dy forma faji.

Kjo lloj pakujdesie ka të bëjë me faktin se autori nuk dëshiron kryerjen e veprës penale, shpreson se nuk do të shkaktohet pasoja e rrezikshme dhe e ndërmerr veprimin me bindjen se do ta parandalojë atë[19]. Elementi intelektual i pakujdesisë me vetëbesim të tepruar, ashtu si në dashjen eventuale, është vetëdija për mundësinë e shkaktimit të pasojës së veprës, që nënkupton vetëdije për veprimin me të cilin mund të shkaktohet pasoja si dhe për lidhjen shkakësore, pra vetëdije tërësore për aftësinë potenciale të shkaktimit të pasojës[20]. Ky lloj arsyetimi vlen për pjesën më të madhe të rasteve, kur autorët, për shkak të pakujdesisë ose moskujdesit të duhur, gjatë qarkullimit në një rrugë automobilistike, shkaktojnë dhe pasoja të dëmshme si në jetën dhe shëndetin e njerëzve, ashtu dhe në pronë.

Ndryshe, në vlerësimin tonë, paraqitet situata në rastin kur autori që është në drejtim të një automjeti me dashje shkel rregullat e qarkullimit rrugor, shkelje nga e cila vjen pasoja shoqërisht e rrezikshme. Në këtë rast, vlerësojmë se forma e fajit është ajo e dashjes indirekte, e cila dikton si shkakun, ashtu dhe pasojën e veprës penale, gjë e cila duhet mbajtur parasysh në ndërtimin e dispozitës penale, duke e përcaktuar këtë formë faji si rrethanë të cilësuar.

Statistikat zyrtare, por edhe vëzhgimi personal i situatës jep të dhëna të mjaftueshme për të dalë në një konkluzion përfundimtar se masat administrative nuk japin efektin e duhur e po kështu procedimi penal i shkeljeve kur sjellin pasojën e dëmshme nuk ka dhënë rezultate të prekshme për uljen e numrit të aksidenteve me pasoja, por përkundrazi, situata është përkeqësuar vit pas viti duke diktuar nevojën për amendime ligjore, si në aspektin administrativ, ashtu edhe në legjislacionin penal.

Së pari, ashtu si është prekur edhe më sipër, për shkak të konsiderimit të kësaj vepre penale si një vepër me pakujdesi, masa e dënimit nuk i përshtatet nivelit të rrezikshmërisë që paraqet fenomeni ku shkeljet kryhen me dashje dhe me vetëdijen për ardhjen e pasojës. Ndaj, duke iu referuar edhe legjislacioneve të vendeve të Bashkimit Evropian e të rajonit, të trajtuara më sipër, edhe në legjislacionin tonë duhet të gjejë vend zbatimi i dispozitës i ndarë me dy forma të veçanta faji dhe jo si vepër ku veprimi kryhet me dashje e pasoja vjen nga pakujdesia.

Për rrjedhojë, duhet të ndahet në dispozitë apo paragrafë të mëvetshëm duke reflektuar edhe në masën e dënimit rasti kur kjo vepër kryhet me pakujdesi. Ndërkohë, duhet të përbëjë rrethanë të cilësuar kryerja e kësaj vepre me dashje indirekte, pasi aksidentet rrugore në pjesën dërrmuese të tyre kur sjellin pasoja të rënda në shëndet a në jetën e personave, janë raste të cilat kryhen me formën e fajit të dashjes indirekte, e kjo nuk mund të kamuflohet si vetëbesim i tepruar vetëm për të ulur nivelin e përgjegjësisë penale për shkak të formës së fajit.

Në caktimin e masës së dënimit duhet të mbahen në konsideratë veprat penale që lidhen me plagosjen e lehtë, plagosjen e rëndë nga pakujdesia, vrasjen nga pakujdesia dhe vrasjen me dashje.

Konkretisht, plagosja e lehtë me dashje dënohet vetëm me gjobë (neni 92 i Kodit Penal), ndërsa sipas nenit 290 dënohet deri në 1 vit burgim. Plagosja e rëndë nga pakujdesia dënohet deri në 1 vit burgim (neni 91 i Kodit Penal), ndërkohë sipas nenit 290 dënohet deri në 5 vjet burgim. Plagosja e lehtë me dashje dënohet deri në 2 vjet burgim (neni 89 i Kodit Penal).

Po kështu, vrasja nga pakujdesia ndëshkohet me gjobë ose deri në 5 vjet (neni 85 i Kodit Penal). Parashikimi sipas nenit 290 aktualisht është joproporcional në raport me të njëjtën pasojë të shkaktuar. Kjo përbën një premisë për cenimin e barazisë, ku për të njëjtën pasojë dënimi është dyfishuar dhe nuk përmban mundësinë e dënimit me gjobë.

Rritja ekstreme e masave të dënimit nuk ka dhënë efektet e duhura, e kjo duhet të shërbejë si një tregues i rëndësishëm për autoritetet shtetërore për të ndërmarrë masa edukuese e parandaluese në kuadër të ruajtjes së

[19] Salihu, Ismet. *E drejta penale. Pjesa e përgjithshme*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, (2021), f. 309-315.

[20] Kambovski, Vllado. *E drejta penale. Pjesa e përgjithshme*. (përkth. i Osmani, A. dhe Zejneli, I.), Shkup: Furkan ISM, (2010), f. 281-288.

rendit dhe paqes publike nëpërmjet monitorimit dhe ndëshkimit të rasteve që lidhen me pajisjen me leje drejtimi në mënyrë të padrejtë, aftësitë e fituara gjatë trajnimit të detyrueshëm dhe efektivitetin e masave admnistrative. Kjo pasi, rritja e dënimit penal në mënyrë ekstreme dhe joproporcionale në raport me vepra penale të njëjta jo vetëm që nuk përmirëson zbatimin e ligjit, por krijon trajtim të pabarabartë, trajtim ky i cili nuk diktohet e justifikohet nga rrethana të detyrueshme, por nga mungesa e aftësisë, eksperiencës dhe vullnetit të organeve shtetërore për të garantuar zbatimin e legjislacionit në fuqi mbi pajisjen me lejet e drejtimit, krijimin e infrastrukturës rrugore të duhur, zbatimin e planeve dhe kurrikulave edukuese si dhe zbatimin e legjislacionit për shkeljet rrugore në mënyrë të pacenueshme.

7. Konkluzione dhe rekomandime

Veprat penale dhe shkeljet rrugore kanë ardhur në rritje dhe tregojnë një lloj qëndrueshmërie në kryerjen e tyre duke u shndërruar në një fenomen shqetësues që kërkon marrjen e masave ndërinstitucionale dhe kërkon qasje gjithëpërfshirëse me qëllim rregullimin e funksionimit të të gjithë zinxhirit institucional dhe përmirësimin e legjislacionit penal në kuadër të dhënies së drejtësisë efektive, dhe jo parashikimin e normave abuzive që përmbajnë sanksione që nuk përkojnë me rrethanat e faktit.

Vepra penale duhet t'i përgjigjet fenomenit të kryerjes së shkeljeve në praktikë duke përshkallëzuar llojin e pasojës me masën e dënimit si dhe diferencimin e llojit të fajit. Për shkak se shkeljet në vendin tonë janë shkelje haptazi, të dukshme, të vullnetshme, të cilat sjellin pa asnjë ekuivok pasojat e dëmshme, ligji penal duhet të parashikojë dënim të diferencuar në këto raste, ndërkohë që kur vepra penale kryhet me pakujdesi duhet të ulet dënimi me qëllim garantimin e koherencës mes normave penale për shkaktimin e pasojave të njëjta.

Ligjvënësi, në kuadër të parandalimit të veprave ka rritur ndjeshëm masat e dënimit për këtë vepër, duke nënkuptuar se këto vepra kryhen me dashje, pavarësisht se doktrinalisht nuk është pranuar asnjëherë kryerja e tyre me dashje. Mirëpo, forma e pakujdesisë për këto vepra në këto nivele dënimi, përbën dënim tepër të lartë. Për rrjedhojë, duhet specifikuar qartë qëndrimi psikik i personit, i cili jep të dhëna të qarta për nivelin e rrezikshmërisë së tij, dhe të përshtatet me sanksionin e duhur penal.

Në përfundim, vlerësohet se në amendimet ligjore në Kodin Penal, duhet të mbahet në konsideratë përmbajtja e normës së paraqitur këtu më poshtë, ku në vlerësimin tonë është përmbajtja më e saktë ligjore, e cila pasqyron elementët e nevojshëm objektivë dhe subjektivë, faktorët kriminologjikë të marrë në analizë më sipër, si edhe metodologjinë e caktimit të dënimit penal.

Ndaj, vlerësohet se përmbajtja e nenit 290 të Kodit Penal duhet të përmbajë elementët si vijon:
"1. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
2. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.
3. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen e një personi, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.
4. Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.
5. Kur ndonjë nga veprat e mësipërme kryhet me dashje eventuale, masa e sanksionit është sa trefishi i saj.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. André, C. *Droit pénal spécial*, Paris: Dalloz; (2017).
2. Çela, Aranit. *E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë: pjesa e përgjithshme*, Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, (1982).

3. Elezi, Ismet. *E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë: pjesa e posaçme*, Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, (1983).
4. Elezi, Ismet. *E drejta penale e posaçme*, 2018.
5. Guédon, J. Ph. (2003). *Les efforts du législateur français contre la violence routière*, në *Semaine juridique*, n° 48, Etude.
6. Kambovski, Vllado. *E drejta penale. Pjesa e përgjithshme*, (përkth. i Osmani, A. dhe Zejneli, I.), Shkup: Furkan ISM; (2010).
7. Malabat, V. (2015). *Droit pénal spécial,* Paris: Dalloz.
8. Meçani, Delo. *E drejta penale e posaçme*, 2017;
9. Muçi, Shefqet. *E drejta penale. Pjesa e përgjithshme,* Tiranë: (2007).Botimet Dudaj.

Legjislacion

1. Kodi Penal i Italisë.
2. Kodi Penal i Gjermanisë.
3. Kodi Penal i Francës.
4. Kodi Penal i Spanjës.
5. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
6. Kodi Penal i Kroacisë.
7. Kodi Penal i Kosovës.
8. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i vitit 1928.
9. Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 5591, datë 15.6.1979.
10. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, të ndryshuar. Fletorja Zyrtare nr. 2, datë 16.3.1995.
11. Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar. Fletorja Zyrtare nr. 19, datë 18.11.1998.

Web faqe

1. Instat (2024). Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2023, Tiranë, burimi: https://www.instat.gov.al/media/13231/statistikat-e-krimeve-dhe-drejtësisë-penale-2023.pdf;
2. Ministria e Drejtësisë (2013) *Vjetari statistikor 2012. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;
3. Ministria e Drejtësisë (2014) *Vjetari statistikor 2013. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;
4. Ministria e Drejtësisë (2015) *Vjetari statistikor 2014. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;
5. Ministria e Drejtësisë (2016) *Vjetari statistikor 2015. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;
6. Ministria e Drejtësisë (2017) *Vjetari statistikor 2016. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;
7. Ministria e Drejtësisë (2018) *Vjetari statistikor 2017. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;
8. Ministria e Drejtësisë (2019) *Vjetari statistikor 2018. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;
9. Ministria e Drejtësisë (2020) *Vjetari statistikor 2019. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;
10. Ministria e Drejtësisë (2021) *Vjetari statistikor 2020. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;

11. Ministria e Drejtësisë (2022) *Vjetari statistikor 2021. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;
12. Ministria e Drejtësisë (2023) *Vjetari statistikor 2022. Ministria e Drejtësisë*, Tirana, burimi: http://www.drejtesia.gov.al/al/dokumente/statistika;
13. Ministria e Brenshme (2024) Raporti mujor janar 2024, burimi: https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Buletini-Janar-2024.pdf;
14. Ministria e Brenshme (2024) Raporti mujor janar 2024, burimi: https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Buletini-Shkurt-2024.pdf;
15. Ministria e Brenshme (2024) Raporti mujor janar 2024, burimi: https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Buletini-Mars-2024.pdf datë 07.05.2024;
16. Prokuroria e Përgjithshme (2013) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2012*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
17. Prokuroria e Përgjithshme (2014) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2013*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
18. Prokuroria e Përgjithshme (2015) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2014*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
19. Prokuroria e Përgjithshme (2016) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2015*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
20. Prokuroria e Përgjithshme (2017) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2016*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
21. Prokuroria e Përgjithshme (2018) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2017*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
22. Prokuroria e Përgjithshme (2019) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2018*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
23. Prokuroria e Përgjithshme (2020) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2019*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
24. Prokuroria e Përgjithshme (2021) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2020*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
25. Prokuroria e Përgjithshme (2022) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2021*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
26. Prokuroria e Përgjithshme (2023) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
27. Prokuroria e Përgjithshme (2024) *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2023*. Tirana: Prokuroria e Përgjithshme, burimi: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M/;
28. Salihu, I. (2021). *E drejta penale. Pjesa e përgjithshme*, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik.

KRIMET SEKSUALE SIPAS TË DREJTËS PENALE KOSOVARE: VËSHTRIM KRAHASIMOR

MSc. Maend KULLAJ*

SEX CRIMES UNDER KOSOVAN CRIMINAL LAW: A COMPARATIVE VIEW

Abstract

Contemporary legal terminology holds a key importance to first understanding correctly sex crimes by legal professionals, and then applying criminal legislation in specific cases. In the context of the work being done currently for the specific part of the new penal code in Albania, in particular for crimes of a sexual nature, researching the normative approach and best practices of other European countries is one of the main steps taken by working groups. From these countries, this article doesn't go any further than the neighboring one, the Republic of Kosovo, whose penal code in general, and its sex crimes' provisions in particular, constitute a very valuable contemporary model, which can and should serve as inspiration for the Republic of Albania. By analyzing the main provisions of the Kosovan penal code and the case law through qualitative methods, this comparative view aims to highlight the opportunities for improvement in the Albanian penal code, presenting them in the form of specific recommendations.

The article concludes that, sexual integrity in the Republic of Kosovo enjoys high protection due to the advanced normative approach, reflected in elements like the incorporation of excellent definitions, in particular for sexual consent, capacity to consent, and the circumstances of nonconsent; setting the minimum age of consent at 16 years old, higher than that of the Albanian code, along with the so-called "Romeo and Juliet clause"; as well as foreseeing only some core sex crimes like rape or sexual assault, with comprehensive qualifying circumstances, instead of a myriad of separate sex crimes like the case of the Albanian penal code; but on the other hand, also underscoring negative aspects of the Kosovan penal code like the redundancy of domestic sexual violence and the absence of the sex crime of grooming.

Keywords: *sex crimes; sexual integrity; sexual consent; Romeo and Juliet clause; comparative; Republic of Kosovo; Republic of Albania*

1. Hyrje

Sipas Zweigert dhe Kötz, asnjë punim nuk e meriton emrin e një shkence, nëse kufizohet vetëm tek dukuritë që shfaqen brenda kufijve të tij kombëtar. Ky qëndrim reflekton rëndësinë e të drejtës krahasuese, në drejtim të zhvillimit dhe përmirësimit të legjislacionit kombëtar të çdo shteti. Për të arritur këtë qëllim, krahas standardit të vendosur nga bashkësia ndërkombëtare, një shembull me vlerë për t'u ndjekur mund të jetë fare mirë ai i vendosur nga një shtet i vetëm, qoftë ky edhe një shtet fqinj. Madje, lidhur me krimet seksuale, përvoja e shteteve të zhvilluara dhe me traditë të mirëfilltë ligjore, ka shërbyer si shtysë dhe frymëzim për vendosjen e shumë standardeve tashmë të gjithëpranuara nga bashkësia ndërkombëtare, kryesisht lidhur me konceptin e pëlqimit seksual.

Republika e Kosovës është tashmë 16 vjet shtet i pavarur, por legjislacioni i saj, në veçanti ai penal, nuk merr vëmendjen e duhur në studime krahasuese, duke u preferuar nga studiuesit modelet e Europës perëndimore. Nëse shfletohet kodi penal kosovar i vitit 2018 duke përfituar edhe nga gjuha e përbashkët, do të vërehet një kod penal

* MSc. Maend Kullaj, asistent-lektor me kohë të pjesshme në Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University; këshilltar juridik me kohë të plotë pranë një zyre avokatie në Tiranë. Adresë kontakti: maendkullaj@gmail.com.

modern me një qasje normative që reflekton standardin më të mirë ndërkombëtar, edhe duke mos qenë vetë Republika e Kosovës anëtare e organizatave ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Europës. Madje, teknika legjislative e këtij kodi ka pasur si model të madh frymëzimi edhe legjislacionin e ShBA-së, si një nga kontribuesit kryesorë të shtetformimit të Republikës së Kosovës.

Në interes të këtij artikulli veçohen parashikimet mbi krimet seksuale, apo "veprat penale kundër integritetit seksual" sipas kodit – kapitull i cili trajton më së miri koncepte bashkëkohore si pëlqimi seksual, mosha për dhënien e pëlqimit, mospëlqimi, zotësia për dhënien e pëlqimit e akti seksual, nëpërmjet përkufizimeve. Madje, aq cilësore janë këto parashikime sa, drafti i parë i prezantuar për kodin penal të ri në Shqipëri në vitin 2020 ishte bazuar thuajse tërësisht në modelin kosovar të krimeve seksuale. Ndonëse edhe parashikimet mbi krimet seksuale në kodin penal shqiptar në fuqi janë të një standardi të kënaqshëm, vërehet një terminologji ligjore e vjetëruar, e trashëguar nga kodet e mëparshme, gjë që reflektohet edhe në praktikën gjyqësore, edhe pse së fundmi ka pasur propozime pozitive për ndryshime në Kodin Penal.

Në kuadër të punës që ka rifilluar dhe vijon për hartimin e pjesës së posaçme të kodit penal të ri, pas përfundimit të pjesës së përgjithshme, ky artikull vjen me qëllimin kryesor të risjelljes në vëmendje të modelit kosovar të trajtimit juridiko-penal të krimeve seksuale për t'u marrë parasysh nga grupi i punës, nisur edhe nga thirrja e Ministrisë së Drejtësisë për punime kërkimore që kontribuojnë në hartimin e kodit penal të ri.

2. Kuadri ligjor kosovar mbi krimet seksuale

Në Republikën e Kosovës, veprat penale me natyrë seksuale, apo ndryshe, krimet seksuale, parashikohen në kodin penal të saj, dhe konkretisht, në kapitullin XX të emërtuar "*Vepra penale kundër integritetit seksual*". Kështu, në dallim nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (në vijim, "KPRSh") me seksionin VI "*Krime seksuale*" (në vijim, "Seksioni i Krimeve Seksuale"), emërtimi i vetë kapitullit të kodit kosovar i referohet drejtpërdrejt një elementi të të drejtave seksuale të njeriut, si integriteti seksual, apo ndryshe, paprekshmëria seksuale[1] sipas sistemit tonë, koncept me të cilin kuptohet gjerësisht mbrojtja e personit nga dëmi seksual. Po kështu, nga përmbajtja e dispozitave dilet në përfundimin se mbrohet po ashtu edhe liria seksuale e personit.

Deri në vitin 2019, në fuqi ishte Kodi NR. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, i datës 20 prill, 2012. Në vijim, më 23 nëntor, 2018, u miratua Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës (në vijim, "KPRKS"), i cili hyri në fuqi 3 muaj nga botimi në Gazetën Zyrtare.

Krimet seksuale edhe në këtë kod parashikohen në kapitullin XX, me po të njëjtin emërtim, dhe kryesisht nuk pati ndryshime domethënëse lidhur me parashikimet. Vërehet se, në kapitulli XX "*Vepra penale kundër integritetit seksual*" (në vijim, "Kapitulli i Krimeve Seksuale") përfshihet një shumëllojshmëri krimesh seksuale, duke parashikuar edhe forma të shfrytëzimit seksual që në KPRSh janë të vendosura në seksione më vete, si seksioni VII "*Vepra penale kundër lirisë së personit*" dhe seksioni VIII "*Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit*". Për këtë arsye, objekti grupor i Kapitullit të Krimeve Seksuale është mbrojtja e të drejtave seksuale, lirisë vetjake, moralit, dhe dinjitetit të personit nga aktet seksuale të detyruara.[2]

3. Përkufizimet e KPRKS-së mbi krimet seksuale

Kapitulli i Krimeve Seksuale fillon me nenin 225, në të cilin parashikohen përkufizime lidhur me elemente të krimeve seksuale të kapitullit, që këtu një model mjaft i përparuar për t'u ndjekur nga Republika e Shqipërisë.

Në paragrafin 1 të këtij neni jepet një përkufizim për pëlqimin seksual, duke u parashikuar se: "*1. Shprehja "pëlqim" nënkupton:*

[1] Katro, Deniona. *Krimet Seksuale*. Tezë Dizertacioni Doktoral. Tiranë: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, shtator 2016, f. 14 <https://unitir.edu.al/krimet-seksuale/>, qasja e fundit më datë 14.05.2024.

[2] Salihu, Ismet, Zhitija, Hilmi, Hasani, Fejzullah. *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës*. Botimi 1. Prishtinë: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, mars 2014, f. 606 <http://jus.igjk.rks-gov.net/485/1/Komentari%20-%20Kodi%20Penal%20i%20Kosoves.pdf>, qasja e fundit më datë 14.05.2024.

1.1. pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet për të kryer aktin seksual.

1.2. marrëveshja vullnetare e dy personave të cilët kanë arritur moshën katërmbëdhjetë (14) vjet dhe ku dallimi në moshën e tyre nuk tejkalon dy (2) vjet, për të kryer aktin seksual në fjalë.".

Sipas këtij përkufizimi, parashikohet si element vullneti apo liria për dhënien e një pëlqimi seksual pohues. Po ashtu, në pikën 1.1 vërehet se mosha minimale për dhënien e pëlqimit është ajo 16 vjeç, në krahasim me atë 14 vjeç në KPRSh, të rimarrë nga kodet e mëparshme. Parashikimi i kësaj moshe nga një vend me kulturë dhe traditë të njëjtë si i yni, është një arsye më tepër që të merret parasysh rritja e moshës për dhënien e pëlqimit seksual në Republikën e Shqipërisë. Në këtë drejtim, më 29 janar 2024 në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar nga një deputet një projektligj për shtesa dhe ndryshime në KPRSh, ku ndër të tjera, është propozuar edhe rritja e moshës në 16 vjeç duke ndryshuar nenin 100 në Seksionin e Krimeve Seksuale. Megjithatë, ndryshe nga KPRSh, vërehet se KPRKS nuk kërkon si faktor edhe pjekurinë seksuale, ndoshta sepse nuk është parë e nevojshme për shkak të moshës më të lartë.

Nga ana tjetër, si një përjashtim i përligjur nga rregulli i përgjithshëm, pika 1.2 lejon kryerjen e akteve seksuale në marrëveshje vullnetare midis të miturve që kanë arritur të paktën moshën 14 vjeç, dhe nëse njëra palë është më e madhe në moshë, maksimumi i dallimit të moshës midis tyre duhet të jetë e shumta dy vjet, pra pala më e rritur të jetë maksimumi 16 vjeç, saç është edhe mosha e përgjithshme për dhënien e pëlqimit.

Ky parashikim njihet nga doktrina si "klauzola Romeo dhe Zhuliet"[3], apo ndryshe, "përjashtimet e afërsisë në moshë"[4], dhe ka si qëllim mbrojtjen dhe garantimin e lirisë seksuale të adoleshentëve,[5] për të zbuluar seksualitetin e tyre në sajë të zhvillimit natyror, duke u përfshirë në akte seksuale të sigurta dhe me pëlqim të dyanshëm, vetëm me bashkëmoshatarë të tyre. Në këtë mënyrë, të miturit përjashtohen nga përgjegjësia penale për ndërmarrjen e këtyre akteve seksuale, për sa kohë plotësohen kushtet e pikës 1.2, të nenit 225, KPRKS. Po kështu, krahas moshës së përafërt, disa shtete kërkojnë edhe përafërsi në shkallën e zhvillimit apo pjekurisë fizike dhe psikologjike të të miturve të përfshirë në aktin seksual,[6] si një garanci e shtuar kundër abuzimit nga një person më i rritur.

Futja e një parashikimi të tillë në KPRSh mund të vlerësohet me përparësi edhe nga ana e Republikës së Shqipërisë, së bashku me rritjen e moshës për dhënien e pëlqimit në 16 vjeç.

Një dispozitë unike po në këtë drejtim është ajo në nenin 226, KPRKS, e emërtuar "*Lajthimi në fakt lidhur me moshën e viktimës*", i cili parashikon se: "*1. Për qëllime të këtij Kapitulli, lajthimi lidhur me moshën e viktimës e cila është nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet nuk është lajthim në fakt sipas nenit 25 të këtij Kodi, nëse kryesi me vetëdije ka qenë i pakujdesshëm në vënien e vetës në lajthim të tillë.*

2. Kryesi nuk është penalisht përgjegjës për shkak të lajthimit në fakt nga neni 25 i këtij Kodi nëse për arsye të justifikueshme nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ta dijë se viktima ka qenë nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet.".

Kështu, duke qenë se çdo person ka detyrimin e përgjithshëm për të hulumtuar mbi moshën e personave të tjerë me të cilët kërkon të përfshihet në akte seksuale, personi nuk shkarkohet nga përgjegjësia (penale) për mospërmbushjen e këtij detyrimi, nëse me vetëdije ka qenë i pakujdesshëm, por vetëm kur, për arsye të justifikueshme nuk e ka ditur ose nuk ka mundur të dijë se viktima ka qenë nën moshën për dhënien e pëlqimit, siç mund të jetë rasti kur njëra palë e gënjen tjetrën për moshën, shoqëruar edhe me faktorë si zhvillimi turpor dhe emocional i saj. Në këtë drejtim ka shkuar edhe praktika e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, kur shprehet në një vendim se: "*8.3. Lidhur me pretendimin e të pandehurit se nuk ka pasur dijeni për moshën e të dëmtuarës, pavarësisht se ky fakt nuk e përjashton nga përgjegjësia penale, gjykata vlerëson se i pandehuri e ka njohur për një periudhë të gjatë të dëmtuarën, për më shumë se një vit dhe se gjatë kësaj kohe i ka pasur të gjitha mundësitë për të marrë të dhëna lidhur me treguesit e gjendjes civile të saj.*

---

[3] Ang., *Romeo and Juliet clause*, frymëzuar nga tragjedia shekspiriane e dashurisë së ndaluar.

[4] Ang., *close in age exceptions*.

[5] Parra-Barrera, Sandra M., Sánchez-Fuentes, María Del Mar, Fuertes-Iglesias, Carlos, Boldova, Miguel Ángel. 2021. "Sexual Abuse vs. Sexual Freedom? A Legal Approach to the Age of Sexual Consent in Adolescents in Spanish-Speaking Countries" *Int J Environ Res Public Health* 18, nr. 19, f. 1 <https://doi.org/10.3390/ijerph181910460>.

[6] *Id*., f. 6.

[...] *përgjegjësia nuk mund të zbutet, as me pëlqimin e të miturit për marrëdhënien, as nga tiparet dhe dukja që mund të çojë në besimin, se e ka tejkaluar të ashtuquajturën "moshë miturie". I gjykuari në këtë rast e ka pranuar me vetëdije rrezikun e kryerjes së akteve seksuale me një vajzë të mitur dhe elemente të tilla si, tipare të zhvillimit fizik, sigurimi verbal për moshën, që vjen nga i mituri apo dhe mosdijenia e saj nga i pandehuri, nuk e përjashtojnë atë nga përgjegjësia e kryerjes së marrëdhënieve seksuale me të mitur.*".[7]

Megjithatë, nëse koncepti juridik i lajthimit apo gabimit në përgjithësi, dhe i lajthimit në fakt lidhur me moshën e viktimës së aktit seksual në veçanti, janë kryesisht çështje të doktrinës penale dhe praktikës gjyqësore në Republikën e Shqipërisë, Republika e Kosovës e ka sanksionuar këtë çështje shprehimisht në KPRKS, duke shmanguar praktikat e gabuara.

Paragrafi 2, i nenit 225 parashikon me qartësi rrethanat, në prani të të cilave vlerësohet se nuk ekziston pëlqimi, dhe konkretisht: "*2. Nuk ekziston pëlqimi nëse:*

2.1. personi i tillë me fjalë ose me sjellje shpreh mungesë të pajtimit për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë;

2.2. pajtimi është shprehur me fjalë ose me sjelljen e një personi tjetër dhe jo të viktimës;

2.3. pajtimi i viktimës është marrë me mashtrim, frikësim ose me kërcënim, nëse mënyrat e tilla nuk përfshijnë përdorimin e forcës, kanosjes serioze ose shfrytëzimin siç është paraparë në nenin 227 paragrafi 3. të këtij Kodi; ose

2.4. personi i tillë është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike ose dehjes me alkool, drogë apo me substanca tjera.".

Në një tjetër punim kemi paraqitur një model të pëlqimit seksual të vlefshëm me disa elemente vlefshmërie: i dhënë lirisht; i shprehur; pohues, ose idealisht, entuziast; personal; reciprok; i informuar; i qartë, dhe jo i dyshimtë; specifik; i vazhdueshëm dhe i pandërprerë; si dhe, i revokueshëm.[8] Pika 2.1 nxjerr në pah elementin e qartësisë së pëlqimit, të shprehur me fjalë ose me sjellje, të cilat në këtë rast tregojnë mospëlqimin, si dhe elementin e revokueshmërisë, kur thuhet "*për të kryer aktin ose për ta vazhduar atë*".

Në këtë drejtim, doktrina kosovare mban qëndrimin se: "[...] *Shprehja e mospëlqimit duhet të jetë serioze e fortë, e qartë pa lënë te kryesi kurrfarë dyshimi për vullnet ndaj aktit seksual. Shprehja e qartë e mos vullnetit për akt seksual duhet të bëhet me fjalë, me duar duke shtyrë* [...]".[9] Edhe Gjykata Supreme e Kosovës në një vendim është shprehur se: "[...] *pretendimet e mbrojtjes se nuk është argumentuar se si e dëmtuara ka kundërshtuar janë të pabazuara dhe janë dhënë arsye të detajuara nga reagimi i të dëmtuarës dhe faktit jo kontestues se e njëjta nuk ka shprehur pëlqim për kryerjen e aktit seksual, dhe atë përmes fjalëve dhe britmave.*".[10] Megjithatë, për të dalë në përfundimin se nuk ka pëlqim seksual nuk kërkohet si element kundërshtia apo qëndresa e viktimës.[11]

Po kështu, sipas pikës 2.2 me të drejtë nuk do të ketë pëlqim kur është dhënë një "pëlqim surrogativ", nga dikush tjetër, dhe jo një pëlqim i shprehur nga vetë personi që do të përfshihet në aktin seksual (elementi personal).

Pika 2.3 parashikon mënyrat e cenimit të të drejtave seksuale, që kryesisht i referohen shtrëngimit dhe dhunës fizike. Mjaft me vlerë është edhe parashikimi i pikës 2.4, e cila i referohet drejtpërdrejt konceptit të pazotësisë për dhënien e pëlqimit "*i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual*", për shkak të faktorëve si gjendja mendore, gjendja fizike, dhe intoksikimi. Në paragrafin 3 madje, parashikohet se, renditja e këtyre rrethanave nuk duhet të interpretohet si shteruese.

Për të vijuar me paragrafin 4, i cili jep një përkufizim të "aktit seksual" si: "[...] *penetrim sado i vogël i organit seksual ose i objektit për qëllime seksuale në cilëndo pjesë të trupit të personit ose penetrim sado i vogël në hapjen anale, orale apo gjenitale të personit me ndonjë send për qëllim seksual ose me cilëndo pjesë tjetër të trupit, ose me cilëndo pjesë të kafshës.*". Termi akt seksual haset përgjatë të gjithë Kapitullit të Krimeve Seksuale

[7] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2023-459, datë 24.03.2023, f. 3, 7.

[8] Kullaj, Maend, Shehaj, Iris. *Adresimi i dhunës seksuale tek adoleshëntet në Shqipëri – Dokument Politikash*. Tiranë: Liburnetik Organisation, mars 2024, f.9 <https://www.liburnetik.org/2024/04/11/adresimi-i-dhunes-seksuale-tek-adoleshentet-ne-shqiperi-dokument-politikash/?lang=sq>, qasja e fundit më datë 14.05.2024.

[9] Salihu *et al*., *op. cit., supra* shënimi 3, f.611.

[10] Vendim i Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 428/2022, datë 02.12.2022, f.3.

[11] Salihu *et al*., *op. cit., supra* shënimi 3, f.612.

dhe është preferuar nga ligjvënësi kosovar në raport me termin e trashëguar "marrëdhënie seksuale" të përdorur nga ligjvënësi shqiptar në Seksionin e Krimeve Seksuale, edhe pse në praktikën gjyqësore të të parës përdoret edhe ky term.[12] Megjithatë, vërehet se nga ana praktike edhe Kapitulli kërkon elementin e depërtimit seksual, sado të vogël, për ta quajtur të kryer aktin seksual, dhe ky depërtim mund të jetë nëpërmjet penisit, me pjesë trupore, apo me sende, madje edhe me pjesë trupore të kafshëve – depërtim, i cili i bëhet hapjeve anale, orale apo gjenitale të personit tjetër, për qëllime seksuale. Krahas depërtimit, në paragrafin 7, të nenit 225 jepet kuptimi i termit "prekje" që nënkupton kontakt direkt ose indirekt, pa depërtim, midis trupit të personit me cilëndo pjesë të trupit të personit tjetër apo me ndonjë send.

Ndryshe nga Seksioni i Krimeve Seksuale, në Kapitullin e Krimeve Seksuale nuk përdoret termi i tejkaluar "homoseksuale", heqja e të cilit është propozuar edhe në projektligjin e lartpërmendur.

Këto përkufizime, të marra së bashku, janë mjaft gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme sa i përket tipologjisë së përdhunimit, apo "dhunimit" sipas këtij kodi, duke mos mbetur vetëm te elementi i depërtimit.

Neni 225 më tej jep edhe një kuptim mjaft të gjerë të formës së përgjithshme të cenimit të të drejtave seksuale, "detyrimin e personit tjetër për kryerjen e aktit seksual", me të cilin kuptohet kryerja e aktit seksual mbi personin tjetër nga kryesi ose cytja (nxitja/shtytja) e personit tjetër në kryerjen e aktit seksual me kryesin apo me personin e tretë ose cytja e personit të tretë për kryerjen e aktit seksual në personin tjetër.[13]

Përkufizime jepen edhe për termin "pjesë intime", apo zonat erogjene, duke përfshirë këtu gjinjtë e një gruaje, penisin, vaginën dhe anusin, si dhe për qëllimin seksual, ku një i tillë mungonte në kodin penal të vitit 2012, dhe me të cilin kuptohet çdo veprim i kryer në drejtim të arritjes së kënaqësisë seksuale të një personi.[14]

Vlen të evidentohet edhe përkufizimi

mjaft i gjerë i "pornografi me fëmijët", në paragrafin 8, si: "[...] *çfarëdo pamje vizuele apo shfaqje ose pasqyrim vizuel, duke përfshirë çdo fotografi, film, video, pamje apo imazh ose fotografi e krijuar me kompjuter, qoftë nëse është krijuar në mënyre elektronike, mekanike apo me mjete tjera, që paraqet ose pasqyron:*

8.1. gjenitalet (vagina, penisi ose anusi) apo zonën e ashtit mbivetor të një fëmije, kryesisht për qëllime seksuale;

8.2. një fëmijë të vërtetë i cili është përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar;

8.3. një person i cili duket të jetë fëmijë i vërtetë i përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar; ose

8.4. pamje realiste të një fëmije joekzistues të përfshirë në një sjellje seksualisht eksplicite të vërtetë apo të simuluar.".

Në veçanti dallojnë pikat 8.3 dhe 8.4, që trajtojnë pedopornografinë e animuar ose atë të krijuar nëpërmjet inteligjencës artificiale, të cilat janë parashikuar edhe pse Republika e Kosovës nuk është ende shtet anëtar i Këshillit të Europës dhe nuk e ka ratifikuar Konventën e KiE-së për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual (Konventa e Lanzarotes), ku edhe gjenden këto rrethana. Në rastin shqiptar ndërkohë, në nenin 117 "*Pornografia*", paragrafi i dytë, të vendosur në seksionin VIII "*Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit*" të KPRSh-së, edhe pse shtet palë, parashikimet për pedopornografinë janë shumë më pak të detajuara.

Nga përkufizimi i dhënë për prostitucionin vlen të veçohet si element, cilësimi i faktit si prostitucion, krahas dhënies faktike të një shpërblimi në këmbim të shërbimit seksual, edhe kur sigurohet detyrimi për t'u paguar, përfshirë premtimin e shërbimeve seksuale falas ose me zbritje.[15]

4. Analiza juridiko-penale dhe krahasimore e krimeve seksuale

Duke vijuar me krimet seksuale konkrete, vërehet qasja normative në Kapitullin e Krimeve Seksuale, ku, ndonëse dënohen sjellje të ngjashme si edhe në Seksionin e Krimeve Seksuale, në dallim nga ky i fundit, në vend të parashikimit të një sërë krimesh seksuale të veçanta, elementet e këtyre krimeve Kapitulli i ka përfshirë si

[12] Shih: vendimet e Gjykatës Themelore Prishtinë PKR nr. 360/16, datë 05.01.2024; PKR nr. 885/20, datë 08.08.2023.
[13] Paragrafi 5, i nenit 225, KPRKS.
[14] Paragrafët 7 dhe 10 të nenit 225, KPRKS.
[15] *Id*., para. 9.

rrethana cilësuese të krimeve seksuale bazë, siç është ai në nenin 227 "*Dhunimi*", ku në paragrafin 1 parashikohet se: "*1. Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.*".

Siç shihet, në dallim nga Seksioni, te përdhunimi apo dhunimi, termi "dhunë" zëvendësohet me termin bashkëkohor "pa pëlqimin", dhe "marrëdhënia seksuale" zëvendësohet me termin "akt seksual", duke reflektuar kështu standardin ndërkombëtar.[16] Po kështu, për shprehjen "*detyrimin e personit tjetër për kryerjen e aktit seksual*" referimi bëhet te përkufizimi i trajtuar më lart.

Lidhur me këtë vepër, nuk pajtohem absolutisht me qëndrimin e doktrinës se, "*8. Nuk do të ekzistojë vepra penale, nëse në fillim viktima shpreh mospëlqimin për akt seksual, por gjatë aktit apo pas një kohe lëshohet në kënaqjen e epsheve apo të kryesit të veprës penale. Me fjalë tjera më vonë e pranon aktin seksual.*"[17], pasi rrethana ku viktima mund të ketë ndryshuar ose jo qëndrim lidhur me faktin nëse e dëshiron kryerjen e aktit seksual (ku edhe vërtetimi i të cilës në fakt është i diskutueshëm), nuk e përjashton rrezikshmërinë shoqërore të autorit dhe të faktit penal – për më tepër kjo, në një krim që ndiqet kryesisht.

Vlen të evidentohet edhe paragrafi 2 i dispozitës, ku parashikohet se: "*2. Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual duke e kanosur me zbulimin e një fakti që do të dëmtonte rëndë nderin ose reputacionin e personit të tillë apo të personit të lidhur ngushtë me personin e tillë, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.*". Kjo rrethanë i ngjason tipologjisë së "zhvatjes seksuale"[18], si një formë shtrëngimi nëpërmjet shantazhit për kryerjen e aktit seksual, që me këtë rast sugjerohet inkriminimi i saj në mënyrë të veçantë në Seksionin e Krimeve Seksuale.

Neni 227 vijon me parashikimin e një morie rrethanash cilësuese të rëndësishme, që siç u tha, disa prej tyre parashikohen si krime seksuale më vete në Seksionin e Krimeve Seksuale,[19] dhe nga të cilat veçohen: kanosja për përdorim dhune; shfrytëzimi i gjendjes së ndjeshme dhe të pambrojtur të viktimës, për shkak të moshës, aftësive të kufizuara mendore apo fizike, çrregullimit apo paaftësisë fizike ose mendore, apo shtatzënisë; kanosja për përdorimin e armës ose një mjeti të rrezikshëm; intoksikimi i pavullnetshëm i viktimës; kur viktima është ndërmjet moshës 16 dhe 18 vjeç; kur viktima është nën moshën 16 vjeç; kur viktima është nën moshën 14 vjeç; incesti; marrëdhënia familjare, ku përfshihet në veçanti, qënia të (ish) fejuar, të (ish) martuar, (ish) bashkëjetues, si dhe në lidhje krushqie, birësimi, dhe kujdestare;[20] kur kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose që në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit (rrethi i besimit dhe marrëdhëniet e pushtetit); etj.

Këto rrethana mund të konkurojnë, duke u parashikuar në këtë rast një masë dënimi më e rëndë, dhe dënimi më i rëndë që parashikon dispozita është dënimi me burgim të përjetshëm, në rastin e vdekjes së viktimës, njëlloj si në rastin e Seksionit të Krimeve Seksuale.

Gjykata Themelore Prishtinë në një çështje ka dënuar të akuzuarin për dhunim në rrethanën cilësuese të shfrytëzimit të gjendjes së pambrojtur të viktimës: "[...] *e zbret* [viktimën] *nga vetura dhe përkundër kundërshtimit të saj dhe gjendjes në të cilën ishte, meqë nga goditjet kishte pësuar lëndime të lehta trupore, e detyron që të kryejë seks oral me të duke e kërcënuar dhe fyer me fjalët "se tani do të kryej seks me ty jo si gruaja ime por siç dua vet" e pastaj e ka kthyer përsëri në shtëpinë e tij ku e dëmtuara D. nga frika dhe depresioni i shkaktuar në mënyrë të vazhdueshme tenton të vetëvritet.*".[21]

Dhunimi është një nga krimet seksuale më të përhapura në Republikën e Kosovës, ku sipas një raporti bazuar në të dhëna zyrtare, në vitet 2017-2019 gjykatat themelore kanë pasur në shqyrtim një mesatare prej 132 çështje për nenin 227 KRKS.[22]

---

[16] Salihu *et al*., *op. cit., supra* shënimi 3, f. 610-11.
[17] *Id*., f. 611.
[18] Ang., *sextortion.*
[19] Madje, disa prej tyre parashikoheshin si krime më vete edhe në kodin penal kosovar të vitit 2012, por që me KPRKS-në u rimorën vetëm si rrethana cilësuese.
[20] Sipas kuptimit që jep paragrafi 25, i nenit 113, KPRKS.
[21] Vendim i Gjykatës Themelore Prishtinë PKR nr. 360/16, datë 05.01.2024, f. 2.
[22] Instituti i Kosovës për Drejtësi. *Krimet kundër integritetit seksual në Kosovë.* Prishtinë, maj 2021, f. 15.

Neni 228 "*Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit*" dënon shfrytëzimin ose mundësimin e shërbimeve seksuale të viktimës së trafikimit, si një formë e shfrytëzimit seksual, dhe nga përmbajtja e saj veçohet një dallim me nenin 110/b të KPRSh-së, duke u parashikuar te e para mosmarrja parasysh e faktit nëse përfituesi i shërbimit seksual e ka ditur se ofruesi i shërbimit është viktimë e trafikimit, ndërkohë që neni 110/b e kërkon këtë dijeni. Po kështu, në pikën 6.3, të nenit 165 "*Trafikimi me njerëz*", veçohet sanksionimi në ligj i parimit ndërkombëtar të mosmarrjes parasysh të pëlqimit të viktimave të trafikimit për qëllime shfrytëzimi seksual, edhe kur nuk janë përdorur mjetet apo mënyrat për realizimin e këtij qëllimi.

Një inkriminim të veçantë përbën ai në nenin 229 "*Sulmi seksual*". Kështu, në paragrafin 1 parashikohet se: "*1. Kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin e tillë të prekë kryesin apo personin tjetër për qëllim seksual, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet.".*

Tipologjia e këtij krimi seksual bazë, duke marrë parasysh edhe përkufizimin e termit "prekje", ka ngjashmëri me dhunimin, por në këtë rast mungon depërtimi seksual, dhe përfshihen vetëm prekje me qëllim seksual.[23] Prekjet mund të përfshijnë, kapjen apo fërkimin e pjesëve intime të viktimës, masturbimin mbi trupin e viktimës pa dijeninë e saj, vendosjen e organeve gjenitale në trupin e personit, madje edhe puthjet. Kështu, në një rast në Pejë i cili është ende në proces, një mësues i klasës së shtatë u akuzua për sulm seksual sipas nenit 229, për shkak se u shfaq në një video duke puthur në buzë nxënësen e tij.[24] Një fakt penal si ky i fundit në vendin tonë do të dënohej nëpërmjet nenit 108 "*Vepra të turpshme*", KPRSh, dispozitë e cila në paragrafin e katërt dënon edhe joshjen e të miturit për t'u takuar për qëllime seksuale[25], e cila në fakt mungon në Kapitullin e Krimeve Seksuale, dhe çmoj se duhet shtuar me përparësi.

I rëndësishëm në këtë drejtim është edhe qëllimi i autorit, apo kryesit, për të bërë dallimin midis dhunimit në tentativë, dhe sulmit seksual. Kështu, doktrina jep disa shembuj ilustrues të praktikës gjyqësore të hershme të shteteve të ish-Jugosllavisë, ku në një çështje fakti është cilësuar si sulm seksual, kur autori e ka detyruar viktimën ta puthë dhe ta ngacmojë me gjuhë atë në organin mashkull, por pa e depërtuar, dhe një çështje tjetër, fakti është cilësuar si dhunim në tentativë, pasi autori i ka kapur kokën me forcë viktimës për t'i vendosur penisin në gojë, por ajo e ka mbajtur mbyllur gojën dhe autori ka arritur të prekë vetëm buzët dhe fytyrën e saj.[26]

Neni 229 në vijim parashikon të njëjtat rrethana cilësuese si edhe dhunimi, shoqëruar edhe me ashpërsimin e dënimit.

Duke marrë parasysh këto parashikime, theksoj nevojën për inkriminimin e një krimi seksual të tillë edhe në KPRSh, me qëllim përmbushjen e plotë të standardit ndërkombëtar. Nga ana tjetër, inkriminimi mund të shoqërohet edhe me parashikimin e një dënimi më të lartë se ky i parashikuar në paragrafin 1, të nenin 229, për të mbuluar edhe veprime me shkallë më të lartë dëmi.

Një krim seksual i veçantë, që përbën një tjetër krim seksual bazë, parashikohet në nenin 230 "*Degradimi i integritetit seksual*", ku përcaktohet se: "*1. Kushdo që cyt personin tjetër të ekspozojë pjesët intime të trupit të personit të tillë, të masturbojë ose të kryej ndonjë akt tjetër që degradon integritetin seksual të personit të tillë, pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në një (1) vit.*". Veçantia e këtij krimi seksual qëndron te *modus operandi* i saj, duke qenë një krim seksual jo-kontakti, ku dënohet vetëm shtytja e autorit, e cila ka bërë që viktima, me veprimet e saj, por pa pëlqim dhe nën trysni, të shfaqë pjesët intime të trupit, të masturbojë, apo të kryejë akte të tjera që degradojnë integritetin seksual të saj. Cytja apo shtytja në kuptim të këtij neni, mund të bëhet në forma, mënyra, dhe në rrethana të ndryshme, të cilat detajohen edhe në rrethanat cilësuese të parashikuara, që janë të njëjta me ato të dhunimit dhe sulmit seksual.

Ky krim seksual mbron më tepër nderin dhe dinjitetin e personit nga veprimet poshtëruese, sesa të drejtat seksuale, dhe me të drejtë doktrina e quan si një vepër penale subsidiare,[27] e cila mund të shfaqet si element përbërës i dhunimit ose sulmit seksual, dhe në këtë rast, nuk konkuron me to.[28]

---

[23] Salihu *et al*., *op. cit., supra* shënimi 3, f. 624.

[24]<https://telegrafi.com/mesimdhenesi-e-puth-nxenesen-e-klases-se-shtate-ne-decan-ndalohet-per-48-ore-per-vepren-penale-sulm-seksual-video/>, qasja e fundit më datë 14.05.2024.

[25] Ang., *grooming*.

[26] Salihu *et al*., *op. cit., supra* shënimi 3, f. 625.

[27] Salihu *et al*., *op. cit., supra* shënimi 3, f. 627.

[28] Kullaj, *op. cit., supra* shënimi 8, f. 158.

Vlen të analizohet edhe neni 231 "*Ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet*", KPRKS, i cili parashikon se: "*1. Kushdo që shet, ofron të shesë, shfaq ose në mënyrë tjetër i siguron personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet fotografi, material audiovizuel apo sende të tjera me përmbajtje pornografike ose e lejon personin e tillë të shoh një shfaqje të gjallë me përmbajtje pornografike apo me dashje e sjell personin e tillë në një shfaqje të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.*".

Kështu, ndryshe nga pornografia sipas KPRSh-së, krimi nuk lidhet thjesht me shfaqjen e materialeve pornografike në mjedise ku qëndrojnë fëmijë, por në mënyrë të veçantë, me shfaqjen e qëllimshme të materialeve pornografike te një apo disa fëmijë të caktuar që nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç, duke mbrojtur kështu moralin e fëmijës nga kontakti i parakohshëm me materiale të papërshtatshme pornografike. Kjo vepër kryhet me dashje dhe autori duhet të jetë në dijeni të përmbajtjes pornografike të materialit që po i shfaq të miturit, si dhe në dijeni të moshës së tij nën 16 vjeç.[29]

Neni 231 i KPRKS-së mund të shërbejë fare mirë si një model për përmirësimet e nevojshme të krimit të pornografisë sipas nenin 117, paragrafi i parë, KPRSh.

Në nenin 232 "*Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi*" dënohet pornografia me fëmijë (pedopornografia) dhe "shfaqjet e gjalla", të cilat kanë të njëjtim kuptim me shfaqjet pornografike sipas paragrafit të tretë, të nenit 117, KPRSh. Paragrafi 5 i dispozitës jep edhe një përkufizim për termin "shfaqje e gjallë" si "*ekspozimin aktual, përfshirë me anë të mjeteve të informimit dhe teknologjisë së komunikimit, të:*

5.1. një fëmije të përfshirë në sjellje seksualisht eksplicite, qoftë të vërtetë apo të simuluar; ose

5.2. organeve gjenitale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale.".

Një tjetër figurë e veçantë, e cila në Shqipëri nuk parashikohet që prej periudhës së mbretërisë, është neni 233 "*Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës*", i cili parashikon se: "*Kushdo që premton rrejshëm*[30] *martesën në mënyrë që të nxisë personin i cili është në mes të moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet që të përfshihet në një akt seksual, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*". Dallimi me parashikimin e kodit penal të mbretërisë është se aty parashikohej mosha nën 20 vjeç e viktimës grua për këtë krim.[31] Ky krim seksual mund të thuhet se ka disa tipare të *grooming*.

Për të vijuar përsëri me forma të shfrytëzimit seksual, neni 234 "*Mundësimi ose detyrimi në prostitucion*" dënon shfrytëzimin e prostitucionit të të rriturve dhe të miturve. Vlen të evidentohet rrethana cilësuese e paragrafit 1, e cila parashikon se: "*2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla ose mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.*", duke mbrojtur kështu moralin e fëmijëve nga shfaqje të pahijshme që mund edhe të nxisin pjesëmarrjen e tyre në këtë veprimtari.

Po kështu, si edhe KPRSh, neni 235, KPRKS, dënon ofrimin e lokaleve për prostitucion. Nga ana tjetër, në dallim nga neni 113, KPRSh, vërehet se neni 235, KPRKS, nuk e dënon edhe ushtrimin e prostitucionit.

Kapitulli i Krimeve Seksuale mbyllet me dënimin e incestit, në nenin 236 "*Marrëdhëniet seksuale brenda familjes*", emërtimi i të cilit në fakt përbën një shmangie formale nga përdorimi i termit "akt seksual", por që kjo nuk e ndryshon tipologjinë e këtij krimi. Në paragrafin 1 të këtij neni parashikohet se: "*1. Kushdo që kryen akt seksual me paraardhës ose pasardhës të familjes i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet ose me vëlla apo motër që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.*".

Ndonëse nuk parashikohet shprehimisht, kuptohet se bëhet fjalë për akte seksuale të kryera me një pëlqim kryesisht të vlefshëm, dhe midis të rriturish, por ndryshe nga neni 106 "*Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari*", KPRSh, kjo kuptohet nga parashikimi i incestit dhe miturisë si rrethana cilësuese te dhunimi.[32] Kështu, me këtë krim mbrohet kryesisht morali i shoqërisë në përgjithësi.

[29] Salihu *et al*., *op. cit*., *supra* shënimi 3, f. 645.
[30] Në mënyrë të rreme, gënjeshtër.
[31] Kullaj, *op. cit*., *supra* shënimi 8, f. 159.
[32] Pika 4.9 e nenit 227, KPRKS.

Nga ana objektive, incesti kërkon praninë e depërtimit, pasi nëse janë kryer vetëm prekje seksuale me pëlqim, fakti nuk është i dënueshëm,[33] ndërsa nëse janë kryer prekje seksuale incestuoze pa pëlqim, fakti mund të cilësohet si sulm seksual sipas pikës 3.9 të nenit 229. Për këtë arsye, këto vepra nuk konkurojnë me njëra-tjetrën.

Rrethanat cilësuese të nenit 236 individualizojnë secilën lidhje gjaku midis familjarëve, duke dënuar gjithashtu edhe marrëdhëniet e birësimit, si në rastin e KPRSh-së, por edhe aktet seksuale ndërmjet gjysmë-vëllezërve dhe gjysmë-motrave, të cilat dënoheshin në periudhën e mbretërisë shqiptare. Po kështu, rrethanat cilësuese shkallëzojnë rrezikshmërinë shoqërore në bazë të moshës së viktimës, ku paragrafi 1 që parashikon moshën 18 vjeç është më pak i rrezikshmi, dhe mosha nën 14 vjeç më e rrezikshmja. Nga ana tjetër, sipas të dy kodeve nuk dënohet kryerja e akteve seksuale ndërmjet kushërinjve. Nëse provohet kryerja e incestit sipas nenit 236 të KPRKS-së, palët e përshira në aktin seksual përgjithësisht do të mbajnë të gjithë përgjegjësi penale për këtë vepër.

Me ligjin nr. 08/L-188, datë 23.11.2023 për plotësime dhe ndryshime në KPRKS, pas nenit 236 është shtuar një formë e veçantë e cenimit të të drejtave seksuale dhe atyre riprodhuese, dhe konkretisht neni 263/A i emërtuar "*Testimi i virgjërisë*". Dispozita parashikon se: "*1. Kushdo që e cyt ose obligon personin tjetër për të kryer ekzaminim me qëllim të testimit të virgjërisë dënohet me gjobë dhe burgim deri në një (1) vit.*

2. Kushdo që duke vepruar në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni kryen testim apo ekzaminim mjekësor, me qëllim të testimit të virgjërisë, dënohet me gjobë dhe burgim nga një (1) deri në tri (3) vjet.". Paragrafi 1 dënon vetëm shtytjen ose detyrimin e viktimës për të kryer testimin e virgjërisë, ndërsa paragrafi 2 dënon testimin faktik të virgjërisë së viktimës. Kjo sjellje nuk ka qenë aq e përhapur sa për t'u inkriminuar edhe në KPRSh.

Sipas paragrafit 3, rrethanat cilësuese të kësaj vepre janë kur viktima është nën moshën 18 vjeçare; kur është kryer me kanosje serioze ose me kanosje për përdorim të dhunës; në bashkëpunim; shfrytëzimi i situatës së pambrojtur të viktimës ose kur siguria e saj është në rrezik; si dhe, kur vepra është kryer nga profesionisti shëndetësor. Vërehet gjithashtu, parashikimi i dënimeve kryesore të njëkohshme (kumulative) me gjobë dhe me burgim në KPRKS në ndjekje të modelit europian, sistem caktimi dënimi i cili është shfuqizuar në KPSh me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 47, datë 26.07.2012.

Me miratimin e KPRKS u shtua si vepër penale edhe ngacmimi seksual, i cili mungonte në kodin penal të 2012-ës. Megjithatë, nuk është e qartë se pse ky krim seksual përfaqësues nuk parashikohet në Kapitullin e Krimeve Seksuale, por në kapitullin XVI "*Veprat penale kundër jetës dhe trupit*", dhe konkretisht, në nenin 183 "*Ngacmimi Seksual*", i cili në paragrafin 1 parashikon se: "*1. Kushdo që ngacmon seksualisht personin tjetër, në veçanti personin i cili është i ndjeshëm për shkak të moshës, sëmundjes, paaftësisë, varësisë, shtatzënisë, paaftësisë së rëndë fizike apo mendore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet.".*

Vërehet këtu parashikimi i faktorëve që ndikojnë te zotësia për dhënien e pëlqimit si element i krimit, duke e dalluar nga inkriminimi homolog në nenin 108/a, KPRSh. Në paragrafin 2 jepet edhe një përkufizim i ngacmimit seksual, që përputhet me përkufizimin universal për të: "*2. Ngacmimi seksual nënkupton cilëndo formë të sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale, me qëllim të cenimit të dinjitetit apo që cenon dinjitetin e personit, dhe krijon një mjedis i cili është objektivisht frikësues, armiqësor, degradues ose poshtërues.*".

Kështu, cënimi i dinjitetit si pasojë e ngacmimit seksual mund të jetë një qëllim në vetvete i autorit, por edhe një pasojë, si dhe, mjedisi i krijuar vlerësohet si një element objektiv, dhe jo subjektiv siç trajtohet nga praktika gjyqësore shqiptare: "[...] *Gjykata çmon se, nga provat e paraqitura rezulton se nga gjithë veprimet e mësipërme të të pandehurit është krijuar një mjedis kërcënues për të dëmtuarën A* [...]*, pasi ajo është ndjerë e kërcënuar dhe e frikësuar nga veprimet e të pandehurit.*".[34]

Dallimi ndërmjet ngacmimit seksual sipas nenit 183 dhe sulmit seksual sipas nenit 229, KPRKS, qëndron kryesisht te *mens rea*, ku ky i fundit ka elementin e prekjes për qëllime seksuale, ndërsa te ngacmimi seksual mbizotëron qëllimi apo pasoja e cenimit të dinjitetit, dhe nga *modus operandi* mund të jetë edhe verbal ose joverbal. Kështu, në një çështje i pandehuri është dënuar për ngacmim seksual sepse: "[...] *duke u sjellë në mënyrë të pa dëshiruar ndaj të dëmtuarës L. K.,, përmes sjelljes verbale dhe jo verbale të natyrës seksuale me qëllim të cenimit të dinjitetit, të njëjtës i krijon mjedis objektivisht frikësues, degradues dhe poshtërues, në atë mënyrë që të*

[33] Salihu *et al*., *op. cit*., *supra* shënimi 3, f. 663.

[34] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-838, datë 07.07.2022, f. 3.

dëmtuarën e mban në lidhje të detyrueshme në mënyrë kërcënuese, duke e kërcënuar të njëjtën edhe me përdorimin e armës, si dhe do shpërndaj fotot e saja intime në rrjetet sociale në internet të cilën gjë edhe e bën, duke ia dërguar të njëjtat foto familjarëve të saj, duke përfshirë ish burrin e saj J. K., dhe fëmijëve të saj djalit H. K.,, vajzës E. K.,, [...].".[35] Përcaktimi i qëllimit, seksual ose cenim dinjiteti, është vendimtar për cilësimin juridik në çështje me fakte të ngjashme ku sjellja kriminale është fizike.[36]

Si rrethana cilësuese parashikohen, rrethi i besimit, marrëdhëniet e pushtetit, përdorimi i armës, mjetit të rrezikshëm, apo sendeve të tjera që mund të shkaktojnë lëndime të rënda trupore ose dëmtime të rënda të shëndetit mendor apo fizik. Po kështu, me nenin 10 të ligjit nr. 08/L-188, datë 23.11.2023 për plotësime dhe ndryshime në KPRKS, parashikohet kryerja e ngacmimit seksual kundër një fëmije që nuk ka mbushur moshën 10 vjeçare ose një personi "të dobët" që nuk ka mbushur moshën 15 vjeçare, si dhe zbatimi i detyrueshëm i dënimeve plotësuese për këtë krim si dhe për ato në Kapitullin e Krimeve Seksuale.

Një parashikim gjendet edhe në kapitullin XXI, riemërtuar me ligjin ndryshues si "*Veprat penale me bazë gjinore, kundër martesës dhe kundër familjes*", dhe konkretisht në dispozitën që dënon dhunën në familje, nenin 248. Në paragrafin 3 të këtij neni parashikohet se: *"3. Çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.*", në dukje kjo një mbivendosje e panevojshme parë edhe në raport me krimet seksuale që parashikojnë si rrethanë cilësuese kryerjen e tyre në marrëdhënie familjare apo me anëtar të familjes. Kështu, neni 130/a "*Dhuna në familje*", KPRSh, nuk e trajton elementin seksual.[37] Termi "anëtar i familjes" përkufizohet në paragrafin 26, të nenit 113, KPRKS, duke përfshirë: prindin, prindin adoptues, fëmijën, fëmijën e adoptuar, vëllain ose motrën, bashkëshortin ose bashkëshorten, të afërmin e gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personin me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.

Me ligjin ndryshues, pas nenit 248 është shtuar neni 248/A "*Dhuna kundër grave në jetën publike*", si një formë e dhunës me bazë gjinore, ku ndër të tjera, dënohet dhuna seksuale kundër grave që ushtrojnë funksione publike ose kandidate për ushtrimin e funksioneve publike.

Së fundi, vlen të përmenden edhe parashikimet e krimeve ndërkombëtare, në kapitullin XV "*Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare*", të cilat, në dallim nga ato në KPRSh, përmbajnë një *modus operandi* mjaft të gjerë, ku veçohet renditja e elementeve të dhunës seksuale, skllavërisë seksuale, prostitucionit të detyruar, dhe krimeve të tjera seksuale, duke ndjekur modelin e Statutit të Romës dhe Elementeve të Krimeve. Kjo ndoshta, për shkak edhe të historisë së popullit kosovar si viktima të krimeve ndërkombëtare.

5. Konkluzione dhe sugjerime

Në përfundim të këtij vështrimi krahasimor duhet thënë se, Kapitulli i Krimeve Seksuale, por edhe KPRKS në tërësi, përfaqësojnë një nivel të lartë të mbrojtjes juridiko-penale të të drejtave seksuale të personit, specifikisht të integritetit apo paprekshmërisë seksuale, nëpërmjet qasjes normative dhe terminologjisë bashkëkohore, që reflekton standardin më të mirë ndërkombëtar, edhe pa pasur Republika e Kosovës detyrimin formal për zbatimin e tij. Kjo dallohet që në emërtimin e kapitullit XX, si "*Veprat penale kundër integritetit seksual*".

Në veçanti dallohet sanksionimi i përkufizimeve cilësore për elementet e pëlqimit, rrethanat e mospëlqimit, zotësinë për dhënien e pëlqimit, aktin seksual, dhe të detyrimit për kryerjen e akteve seksuale, si elemente themelore të krimeve seksuale. Po kështu, përmendet sanksionimi ligjor i parimit universal të mosmarrjes parasysh të pëlqimit të viktimave të trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual.

Në dallim nga KPRSh, ku mosha minimale e pëlqimit është 14 vjeç, mosha në KPRKS është 16 vjeç, dhe me propozimet e fundit ligjore edhe në KPRSh mund të rritet mosha në 16 vjeç. Nga ana tjetër, KPRKS parashikon

[35] Vendim i Gjykatës Themelore Prizren P. nr. 24/20, datë 12.06.2023, f. 1.

[36] Shih: vendim i Gjykatës Themelore Prizren P. nr. 351/2023, datë 17.05.2023; vendim i Gjykatës Themelore Prishtinë - Dega Podujevë P. nr. 92/2021, datë 26.02.2021.

[37] Megjithatë në rastin e Seksionit të Krimeve Seksuale sillet si shembull inkriminimi i panevojshëm i nenit 107/a "*Dhuna seksuale*", të kryer me objekte.

"klauzolën Romeo dhe Zhuliet" që lejon kryerjen e akteve seksuale me pëlqim të dyanshëm ndërmjet bashkëmoshatarëve në moshën 14 vjeç, dhe nëse njëra palë është më e rritur, ajo mund të jetë maksimumi 16 vjeç. Kjo klauzolë rekomandohet të shihet me përparësi për t'u përfshirë në Seksionin e Krimeve Seksuale.

Në lidhje me krimet seksuale, nga krahasimi i kryer vërehet një tipar dallues i KPRKS-së, i cili është parashikimi i shumë prej krimeve seksuale që parashikohen në KPRSh, jo si krime më vete, por si rrethana cilësuese mjaft gjithpërfshirëse të krimeve seksuale bazë si dhunimi, sulmi seksual, dhe degradimi i integritetit seksual. Në këtë drejtim, elementi i dhunës parashikohet thjesht si një rrethanë cilësuese, duke u zëvendësuar me mospëlqimin, si element i domosdoshëm i akteve seksuale të detyruara. Në veçanti, theksohet nevoja për përcaktimin e saktë të qëllimit të autorit në çështje konkrete për të dalluar akuza si sulmi seksual dhe ngacmimi seksual.

Vërehet se nuk bëhen dallime gjinore në parashikimet e dispozitave, si dhe dënohen edhe aktet seksuale të detyruara midis sekseve të njëjta, pa u përdorur termi i tejkaluar "homoseksual". Me ndryshimet ligjore të vitit të kaluar u shtuan edhe disa krime seksuale me bazë gjinore, ku dallon për sistemin ai i testimit të virgjërisë, me dënime kumulative, por edhe ai ekzistuesi i nxitjes së akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës. Nga ana tjetër, duhet të shmangen mbivendosje *prima facie* si ajo e dhunës seksuale në familje me krimet e tjera seksuale, që nuk ndodh në KPRSh; duhet që neni 183 për ngacmimin seksual të vendoset në Kapitullin e Krimeve Seksuale; si dhe të konsiderohet inkriminimi në Kapitull i joshjes së të miturve për t'u takuar për qëllime seksuale. Në rastin e KPRSh, së paku neni 117, pornografia, duhet të vendoset në Seksionin e Krimeve Seksuale dhe jo në atë kundër moralit dhe dinjitetit, duke qenë një krim me natyrë të mirëfilltë seksuale, veçanërisht pedopornografia.

Nga praktika gjyqësore e hulumtuar e gjykatave themelore vërehet se ka një përvetësim të plotë të koncepteve dhe elementeve të krimeve seksuale në drejtim edhe të cilësimit juridik të saktë, dhe se ka një ngarkesë lëndore për këto çështje, ku gjatë trevjeçarit 2017-2019 gjykatat themelore kanë pasur në shqyrtim një mesatare prej 132 çështje me akuzën dhunimi.

Krime seksuale të tilla si sulmi seksual, pornografia, dhe ngacmimi seksual, së bashku me rrethanat cilësuese, si dhe shantazhi seksual, mund të shërbejnë si një model i mirë për t'u ndjekur në formën e shtesave dhe përmirësimit të krimeve seksuale homologe në KPRSh, duke marrë parasysh edhe gjuhën e përbashkët shqipe – akoma më tepër kjo, në kohën që vazhdon ende puna për hartimin e kodit penal të ri.

BIBLIOGRAFI

Legjislacion

1. Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës.
2. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
3. Ligji nr. 08/L-188 Për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, datë 23 nëntor 2023.

Web faqe

1. Instituti i Kosovës për Drejtësi. *Krimet kundër integritetit seksual në Kosovë*. Prishtinë, maj 2021. <https://kli-ks.org/krimet-kunder-integritetit-seksual-ne-kosove/>, qasja e fundit më datë 14.05.2024.
2. Katro, Deniona. *Krimet Seksuale*. Tezë Dizertacioni Doktoral. Tiranë: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, shtator 2016. <https://unitir.edu.al/krimet-seksuale/>, qasja e fundit më datë 14.05.2024.
3. Kullaj, Maend, Shehaj, Iris. *Adresimi i dhunës seksuale tek adoleshëntet në Shqipëri – Dokument Politikash*. Tiranë: Liburnetik Organisation, mars 2024. <https://www.liburnetik.org/2024/04/11/adresimi-i-dhunes-seksuale-tek-adoleshentet-ne-shqiperi-dokument-politikash/?lang=sq>, qasja e fundit më datë 14.05.2024.
4. Parra-Barrera, Sandra M., Sánchez-Fuentes, María Del Mar, Fuertes-Iglesias, Carlos, Boldova, Miguel Ángel. 2021. "Sexual Abuse vs. Sexual Freedom? A Legal Approach to the Age of Sexual Consent in

Adolescents in Spanish-Speaking Countries" *Int J Environ Res Public Health* 18, nr. 19: 10460. <https://doi.org/10.3390/ijerph181910460>.
5. Salihu, Ismet, Zhitija, Hilmi, Hasani, Fejzullah. *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës*. Botimi 1. Prishtinë: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, mars 2014. <http://jus.igjk.rks-gov.net/485/1/Komentari%20-%20Kodi%20Penal%20i%20Kosoves.pdf>, qasja e fundit më datë 14.05.2024.
6. https://telegrafi.com/mesimdhenesi-e-puth-nxenesen-e-klases-se-shtate-ne-decan-ndalohet-per-48-ore-per-vepren-penale-sulm-seksual-video/>, qasja e fundit më datë 14.05.2024.

Jurisprudencë

1. Vendim i Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. nr. 428/2022, datë 02.12.2022.
2. Vendim i Gjykatës Themelore Prishtinë PKR nr. 360/16, datë 05.01.2024.
3. Vendim i Gjykatës Themelore Prishtinë PKR nr. 885/20, datë 08.08.2023.
4. Vendim i Gjykatës Themelore Prishtinë - Dega Podujevë P. nr. 92/2021, datë 26.02.2021.
5. Vendim i Gjykatës Themelore Prizren P. nr. 24/20, datë 12.06.2023.
6. Vendim i Gjykatës Themelore Prizren P. nr. 351/2023, datë 17.05.2023.
7. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2023-459, datë 24.03.2023.
8. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-838, datë 07.07.2022.

Emri i Autorit

STANDARDET DHE TË DREJTAT E TË MITURVE GJATË PROCESIT PENAL

Doktorant Ismail SHEHU[*]
Prof. Asoc. Dr. Saimir SHATKU[**]

STANDARDS AND THE RIGHTS OF MINORS DURING THE CRIMINAL PROCESSS

Abstract

The justice system as a whole and its functioning in our country present quite complex aspects and deserve to be studied by us, as in recent years it has been facing the existence of a widespread spread of crime. What has been observed as a trend in recent years is the increase in juvenile crime, which is manifested through the commission of serious criminal acts, the consequences of which affect.

Legal and criminal practice over the years has often faced violations of the rights of minors during various stages of their treatment in these processes, openly violating the principles and international standards that have been adopted in this regard and that our state is legally obliged to respect in every criminal process conducted.If in our country we have a justice system that does not apply and respect the standards and basic principles in protecting the rights of minors, then we can say that the foundations of the rule of law and justice will be seriously undermined and will pave the way for an increase in their criminal activities.

Keywords: *Standard; minors; criminal process; rights; principles; legislation*

1. Hyrje

Kriminaliteti i të miturve mbart probleme të jashtëzakonshme që ndikojnë në formimin e tyre dhe në mendësinë e një shoqërie të tërë, ndaj dhe trajtimi i tyre nga organet e drejtësisë dhe instrumentat ligjorë është i rëndësishëm. Të gjithë jemi të vetëdijshëm sesa shumë të mitur arrestohen çdo vit, sa shumë prej tyre vuajnë dënimin me burg dhe sa prej tyre keqtrajtohen në forma të ndryshme ligjore nga sistemi i drejtësisë penale.

Në këtë punim jam përpjekur të trajtoj dhe të analizoj të gjithë zhvillimin e procesit penal ndaj të miturve duke evidentuar problematikat që shfaqen gjatë trajtimit të tyre, të cilat duhet pranuar se janë të shumta në çdo fazë të zhvillimit. Pikërisht këto problematika janë arsye e rëndësishme dhe konkrete, të cilat na ndihmojnë që të vihen në lëvizje të gjithë strukturat përkatëse të organizimit të drejtësisë dhe të shtetit dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme në përmirësimin e politikave dhe strategjive të trajtimit të të miturve. Në një shtet të së drejtës, në një shtet demokratik në të cilin individi dhe interesi i tij është primar, veçanërisht të miturit duhet të trajtohen me vemendje të posacme, pasi ata përbëjnë bazën e zhvillimit të shoqërisë. Nëse nuk trajtohen me kujdes dhe me drejtësi, ka shumë mundësi që në të ardhmen të kemi një shoqëri me kriminalitet të theksuar, pasi rehabilitimi i tyre nuk është arritur.

Pyetja kryesore që ngrihet dhe që i duhet dhënë përgjigjie është: Sa efektiv është sistemi i drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri në respektimin e standardeve ndërkombëtare, në kuadër të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturit?

Administrimi i drejtësisë për të miturit ka një rëndësi të madhe praktike për sistemet e ndryshme ligjore në gjithë botën. Ai pasqyron interesat e shoqërisë për të promovuar shtetin e së drejtës dhe ka për synim riintegrimin e fëmijëve të akuzuar për shkeljen e ligjit. Drejtësia për të miturit nuk mbulon vetëm situatat në të cilat është shfaqur një konflikt me dispozitat e legjislacionit penal dhe kërkon zgjidhje, por ajo përfshin edhe çështje të tilla si parandalimi i kriminalitetit, zbatimi i ligjit, dhënia e drejtë e dënimit dhe rehabilitimi.

---

[*] Doktorant Ismail Shehu, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë.

[**] Prof. Asoc.Dr. Saimir Shatku, Lektor në Fakultetin e Drejtësisë, Univeriteti i Tiranës.

2. Parimet bazë të drejtësisë penale për të miturit

Mbrojtja e të drejtave dhe respektimi i standarteve të trajtimit të të miturve përbën një nga drejtimet më të rëndësishme të politikave dhe sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Në bazë të këtyre politikave qëndrojnë parimet themelore të Kushtetutës, të konventave ndërkombëtare dhe të instrumenteve të tjerë të ratifikuar nga shteti shqiptar, të cilat theksojnë se të miturit, për shkak të veçorive të moshës dhe të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për një mbrojtje dhe vëmendje të posaçme nga institucionet shtetërore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në Kreun II të Pjesës II paraqet në mënyrë të përmbledhur parimet kryesore të drejtësisë penale dhe garancitë procedurale të të pandehurit, të cilat nënkuptojnë shtrirjen e tyre edhe për të miturit në procesin penal. Ndër këto përmendim: Prezumimin e pafajësisë[1] ku: "*Kushhdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë'.*

Liria, dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. *'Të drejtën për një proces të rregullt ligjor, gjykim të drejtë publik brenda afateve të arsyeshme dhe prej një gjykate të pavarur e të paanshme të caktuar me ligj* [2]".

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues". "Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj"[3].

Moscenimi dhe moskufizimi i lirisë, ku askujt nuk mund t'i hiqet ose kufizohet[4]. Në rastin e të miturve, kufizimi i lirisë lidhet me mbikëqyrjen e tij për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent.

3. Standardet ligjore ndërkombëtare mbi trajtimin e të miturve

Aktet ligjore ndërkombëtare luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin e politikave penale dhe zhvillimin e procesit penal ndaj të miturve pasi përcaktojnë standarte ndërkombëtare për të gjithë shtetet anëtare, duke sanksionuar dhe mbrojtur të drejtat themelore të të miturve. Këto akte janë të detyrueshme për zbatim dhe bëhen pjesë e drejtëpërdrejtë e legjislacionit të brendshëm të një shteti[5]. Në kuadër të të mbarojtjes së të miturve, ndër instrumentet kryesore të Kombeve të Bashkuara mund të përmendim: *Konventën e OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (1989)*[6]*, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948); Deklarata mbi të Drejtat e Fëmijës; Rregullat e Pekinit 1985; Rregullat e Havanës; Udhëzimet e Riadit; Rregullat e Tokios; Pakti ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike; Konventa kundër torturës dhe vuajtjeve të tjera ose trajtimit mizor, jonjerëzor a degradues, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut KEDNJ, etj.*

Të gjithë këto dokumenta sanksionojnë parime të rëndësishme lidhur me: Mirëqenien e të miturit; Nxisin riintegrimin e të miturit dhe rifitimin e një roli konstruktiv të tij në shoqëri; Zhvillojnë alternativa ndaj trajtimit me burgim ose institucional ose të kujdesit për të parandaluar kryerjen dhe përsëritjen e krimit dhe që të dënuarit e mitur të trajtohen sipas të drejtave që gëzojnë.

Procesi i integrimit është një rrugë e cila imponon detyrimisht përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë për të miturit. Në këtë kuadër, janë të shumta konventat e ratifikuara nga vendi ynë, lidhur me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti. Por, fatkeqësisht ajo çka konstatohet nga monitorimi i vendimeve gjyqësore është se niveli i njohjes së tyre dhe zbatimit nga gjyqtarët,

[1] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, 2017, neni 30.
[2] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, 2017, neni 42.
[3] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, 2017, neni 29.
[4] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, 2017, neni 27.
[5] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, 2017, neni 122.
[6] Ratifikuar më 27 Shkurt 1992 dhe Protokolli shtesë i saj, datë 18 janar 2002 lidhur me shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve.

prokurorët dhe avokatët është i kufizuar. Kjo sjell mosaplikimin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sistemi i drejtësisë dhe mosvënien e tyre në shërbim të atyre që kërkojnë akses në drejtësi.

4. Risitë e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit në Shqipëri

Një nga ndryshimet më pozitive në legjislacionin penal shqiptar përsa i përket të miturve, lidhet me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, duke i dhënë një qasje gjithpërfshirëse trajtimit të tyre në kontekstin e kategorisë së veçantë që ata përfaqësojnë. Në këtë Kod ndërthuren dhe konkretizohen një sërë parimesh dhe procedurash konkrete dhe specifike, të cilat dëshmojnë për efektivitetin e sistemit të drejtësisë së një shteti demokratik kundrejt të miturve. Po të analizojmë dispozitat e këtij kodi, vemë re se në nenin 97 të tij parashikohet se:

"1. Burgimi ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një vepër penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë.

2. Për të miturin dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet.

3. Për përcaktimin e masës së dënimit për të miturin, gjykata merr parasysh dhe i kushton vëmendje të veçantë të gjitha rrethanave që lidhen me shkallën e pjekurisë së të miturit dhe kohën që nevojitet për edukimin dhe formimin profesional. Megjithatë, në varësi të shkallës së fajësisë, dënimi mund të jetë më i shkurtër, kur vlerësohet se është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e tij."[7]

Ndërsa kalojmë në nenin 94 të këtij Kodi shohim se parimet e përgjithshme të dënimit për të miturit konsistojnë në: *"1. Gjatë gjithë procesit të marrjes së vendimit, gjykata, mban në konsideratë se dënimi me burgim i të miturit është mjeti i fundit i mundshëm, i cili konsiderohet vetëm nëse masat e shmangies, të parashikuara në kreun VII, të këtij Kodi, janë të papërshtatshme. 2. Gjatë dhënies së vendimit gjykata merr në konsideratë në radhë të parë interesin më të lartë të të miturit dhe raportin e vlerësimit individual për të."*

Ndërsa vijojmë me nenin 33/3 i Kodit Penal ku: "*Të miturit e kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta nga të rriturit".* Në këtë fazë të gjykimit dhe procedimit zbatohen me përpikmëri dispozitat e parashikuara në Ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" dhe Ligjin nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim". Është në interesin e fëmijës që institucioni penal të ofrojë një klimë sociale të mirorganizuar, ku fëmijët të rriten duke u aftësuar për të funksionuar në mënyrë sa më të pavarur, pa qenë të influencuar apo kufizuar nga punonjësit.

Kodi i Procedurës Penale përcakton gjithashtu një sërë garancish për mbrojtjen e të miturve dhe personalitetit të tyre, konkretisht: pyetja e të miturit në seancë me dyer të mbyllura; e drejta e përfaqësuesit ligjor të të miturit për të mbrojtur interesat e tij me cilësinë e të dëmtuarit akuzues; mbrojtja e detyrueshme profesionale për të miturin nën 18 vjeç; ndalimi i publikimit të gjeneraliteteve dhe të fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të të miturit të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale; mosarrestimi për një vepër penale që përbën kundërvajtje etj.

Nga analiza e përmbajtjes së legjislacionit shqiptar lidhur me dispozitat mbi drejtësinë për të miturit konstatojmë se Kodi Penal lidhur me personat e mitur e trajton atë edhe si të dëmtuar, viktimë të veprës penale, edhe si subjekt kryesor të veprës penale. Ai ka parashikuar moshën e përgjegjësisë penale dhe dënimin e të miturit me ½ e masës së dënimit që mund të marrë një i rritur.

Ligji Nr.8331, datë 21.4.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", Ligji Nr.8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me paraburgim dhe të paraburgosurve", si dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit parashikojnë në mënyrë të plotë mbajtjen e të miturve në institucione të veçanta, ose në seksione të veçanta të Institucioneve të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale. Gjithashtu, këto ligje parashikojnë lehtësira në procedurat e vizitave, informimit, ndihmës së psikologut, aplikimit të programeve riintegruese, arsimit të detyruar etj.

[7] Ligji nr. 37/2017 "Kodi Penal i Drejtësisë për të Miturit", neni 97.

5. I mituri dhe zhvillimi i procesit penal ndaj tij

Zhvillimi i një procesi penal përfaqësohet nga tërësia e të gjithë rregullave proceduriale që zbatohen për çdo fazë të tij, që nga momenti i ndalimit dhe arrestimit të të miturit, hetimin nga organi i akuzës, si dhe zhvillimin e procesit gjyqësor ndaj tij, për të vazhduar deri në dhënien dhe ekzekutimin e vendimit në institucionet përkatëse për këtë qëllim, të cilat përbëjnë fazat më të rëndësishme gjatë një procesi të zhvilluar ndaj të miturit.

➢ Hetimi i çështjes nga organi i akuzës

Hetimi është një term i gjerë, i cili përfshin procesin e mbledhjes së informacionit dhe provave përkatëse nga organ i akuzës dhe që i paraprin fazës së gjykimit. Në këtë proces, i mituri dhe avokati mbrojtës si përfaqësues i tij, kanë një sërë të drejtash që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë[8], ku sanksionohet se kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Pra, avokati në këtë rast luan rol të rëndësishëm në verifikimin dhe vërtetësinë e mbledhjes së provave ndaj të miturit.

Në nenin 327, pika 2, të K.Pr.Penale është theksuar se kjo e drejtë për avokatin vjen në formën e një detyrimi për organin e akuzës, pasi ky i fundit duhet të sigurohet që mbrojtësi është njohur me aktet e veprimeve hetimore. Refuzimi nga ana e prokurorisë për të nxjerrë provat që disponon kur pala mbrojtëse e kërkon një gjë të tillë, do të përbënte një dhunim dhe shkelje të rëndë të së drejtës për një proces të drejtë ligjor parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar dhe e detyrueshme për zbatim.

Prokurori ka të drejtë të fillojë, të mos fillojë ose të pushojë procedimin penal në rastet e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale[9] bazuar në rrethanat e çështjes konkrete. Gjatë punës së tij prokurori, duhet të zbatojë me përpikmëri të gjithë dispozitat e parashikuara në Kod, duke evituar cdo shkelje të drejte, sidomos në rastet kur të pandehurit janë të mitur. Gjatë caktimit të masës së sigurimit, prokurori duhet të kujdeset që të zbatojë kategorikisht nenin 28/2 të Kushtetutës së R.Sh dhe vleftësimi i masës së sigurimit nga gjykata është domosdoshmëri për vazhdimin dhe respektimin e procesit të rregullt ligjor.

➢ Masat e isgurimit

Zbatimi i masave të sigurimit[10] janë tepër të rëndësishme në procedimin e të miturve, pasi në bazë të tyre përcaktohet nëse i mituri do të qëndrojë në paraburgim, do të dalë përpara gjykatës, apo do të lirohet përfundimisht. Në nenin 229 të KPP përcaktohet se: "*Kur i pandehuri është i mitur, për caktimin e masave të sigurimit, gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proçeset edukative konkrete"*. Këtu bëhet fjale për të miturit që akuzohen se kanë kryer vepra penale, për të cilat gjykata duhet të vendosë nëse do të procedohen në gjendje të lire, apo si të paraburgosur. Në këtë rast gjykata duhet të shikojë patjetër mundësinë që të mos ndërpritet procesi edukativ.

Në çdo rast organi i akuzës duhet të verifikojë moshën e të pandehurit dhe kur është rasti urdhëron ekspertimin. Kur edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit, mbeten dyshime për moshën e të pandehurit, supozohet se ai është i mitur".

Neni 35 i K.Pr.Penale parashikon se: *"Kur i pandehuri është i mitur atij i sigurohet, përveç ndihmës juridike, edhe ndihmë psikologjike me praninë e prindit apo personave të tjerë të kërkuar nga i mituri".* Ndihma

[8] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, 2017, neni 35, pika 3.

[9] Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, neni 24.

[10] Parashikimin e masave të sigurimit në legjislacionin e brendshëm e gjejmë në Titullin V "Masat e sigurimit" të KPP, në të cilën parashikohen rregullat e përgjithshme për masat e sigurimit personal, llojet e masave shtrënguese, masat ndaluese, caktimi dhe zbatimi i masave të sigurimit, arresti në flagrancë dhe ndalimi si edhe rregulla mbi revokimin dhe shuarjen e masave të sigurimit.

psikologjike është shumë e domosdoshme në të tilla raste dhe prania e një personi i cili e ndihmon të pandehurin e mitur që të jetë në gjendje të mirë psikologjike sjell dobi të gjithanëshme për mbrojtjen e interesave të të miturit.

- **Procedimi penal në gjykatë**

Gjatë fazës së gjykimit nga gjykata duhet të respekohen disa parime dhe rregulla si:

Neni 49 i K.Pr.Penale parashikon: *"Kur i pandehuri është nën moshën 18 vjeç ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme"*. Në këtë dispozitë të Kodit të Procedurës Penale del se për të miturit caktimi i avokatit është i detyrueshëm, në ndryshim nga të rriturit, të cilëve u sigurohet avokat vetëm kur e kërkojnë. Organi që procedon penalisht duhet t'i caktojë avokat të pandehurit të mitur edhe kur ai nuk e kërkon atë. Si gjatë hetimeve paraprake, ashtu edhe në gjykim të miturit duhet t'i sigurohet ndihma psikologjike gjatë marrjes së tij në pyetje. Kjo gjë bëhet mirë kur në marrjen e të miturit në pyetje asiston një psikolog ose punonjës social, i cili ka aftësitë e nevojshme për komunikimin me të miturin dhe krijon kushtet e përshtatshme që i mituri të shprehet lirshëm dhe të shpjegojë saktësisht faktin për të cilin akuzohet.

Neni 340 i K.Pr.Penale citon se: "*Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor të zhvillohet me dyer të mbyllura kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve".* Ky përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i gjykimit me dyer të hapura bëhet për të evituar ekspozimin e të miturve dhe për të krijuar ambjent të përshtatshëm për gjykimin e tyre.

Probleme të evidentuara nga analiza e bazës ligjore në fuqi dhe zbatimit të masave të sigurimit ndaj të miturve lidhen me faktin se sipas legjislacionit procedural penal shqiptar masat e sigurimit për të miturit nuk kanë ndryshime thelbësore ndaj masave të sigurimit në rastin e të rriturve. Kështu nhse shohim përmbajtjen e nenit 251/1 K.Pr.P lidhur me kushtet për arrestin në flagrancë[11]dhe nenin 253/1 të K.Pr.P mbi ndalimin e të dyshuarit për një krim[12], këtu nuk ka një paragraf ku në mënyrë të ndryshme të tregojë aplikimin e këtyre masave ndaj të miturve. Do të ishte më e arsyeshme që arrestimi në flagrance apo ndalimi i një shtetasi të mitur të bëhej për vepra penale më të rënda.

Ajo çka të bie më shumë në sy është që aplikimi i masës "arrest me burg" kundrejt masave të tjera është në një nivel të dukshëm më të lartë. Ndodh që ndaj të miturit të jetë caktuar masë sigurimi "arrest ne burg", megjithëse vepra penale për të cilën ai akuzohet parashikon dënim me gjobë ose burgim.[13] Në përgjithësi, ndiqet parimi që për veprat penale për të cilat parashikohet vetëm dënim me burgim, ndaj autorëve të tyre caktohet si masë sigurimi "arrest në burg" dhe jo një dënim tjetër alternativ.

Caktimi i një mase sigurimi të ndryshme nga "arrest në burg" parandalon ndikimet negative në psikologjinë apo personalitetin e të miturve dhe tendencën e tij për t'u rifutur në krim pasi ta ketë kryer dënimin me burg. Gjykata ka mundësi të tjera ligjore që, kur e çmon të arsyeshme, për veprat penale të cilat nuk paraqesin rrezkshmëri të lartë shoqërore, para se t'i marrë në shqyrtim, mund të vendosë për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim[14], si mënyra më efektive për parandalimin e kriminalitetit të mëtejshëm të të miturve dhe rehabilitimin e tyre.

- **Caktimi i dënimit për të miturit**

Caktimi i dënimit është një nga fazat më të rëndësishme gjatë gjykimit të të miturit, pasi vendos mbi fatin e tij dhe përcakton efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale. Ndonëse nuk është e drejtë, dënimi me burgim mbetet një nga dënimet më të shpeshta të dhëna nga ana e gjykatave shqiptare për të miturit. Dënimi me burgim duhet të jepet pas një procesi të rregullt ligjor, nga një gjykatë e paanshme duke respektuar standartet e të drejtave të njeriut në mënyrë proporcionale me veprën penale të kryer dhe kur zbatimi i masave të tjera nuk do të ishte i përshtatshëm. Por, jo të gjitha dënimet kryesore të parashikuara nga legjislacioni penal mund të zbatohen ndaj të miturve.

[11] Për veprat penale për të cilat ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjeç.
[12] Për veprat penale për të cilat ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet.
[13] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 278/2 dhe 302.
[14] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, nenet 58-64.

Caktimi i dënimit për të miturit bëhet duke marrë parasysh kufijtë e masës së dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale kur kjo kryet prej të miturve; rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Gjykata, nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparshme e të miturit, mund ta përjashtojë atë nga dënimi[15]. Në këto raste ajo mund të vendosë dërgimin e të miturit në një institucion edukimi.

Masat edukuese[16] mund të jepen nga gjykata ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. Masa edukuese është vendosja e të miturit në një institucion edukimi. Vënia në ekzekutim e vendimeve penale dhe urdhërimeve të tjera ligjore, si dhe mënyra e vuajtjes së dënimeve të tjera me përjashtim të dënimit me burgim, rregullohet prej ligjit nr.8331 datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

Nuk lejohet përdorimi i forcës fizike ndaj të dënuarve, nëse nuk është e domosdoshme për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, si dhe për mposhtjen e kundërshtimit edhe kur ai është pasiv, në zbatimin e urdhrave të dhëna.

Në vendin tonë sistemi i burgjeve përballet me sfida të mëdha për shkak të objekteve të mbipopulluara dhe të vjetëruar, duke bërë që shpesh të dënuarit ta gjejnë veten në kushte aspak të favorshme për rehabilitimin e tyre, që mund të kenë efekte negative në shëndetin e tyre fizik dhe mendor dhe pengojnë trajnimin e tyre arsimor dhe profesional, dhe që ndikojnë në këtë mënyrë edhe në mundësitë e tyre për të ardhmen e rregullimit të një jetë të zakonshme në komunitet.

Kur caktohet një masë sigurimi me burgim për të miturin, ose kur do jepet një dënim me burgim duhen marrë parasysh tre përcaktime të Konventës mbi të drejtat e fëmijës që janë: "*1. burgimi duhet të jetë masa e fundit që duhet marrë në rastin konkret kur çdo masë tjetër është konsideruar si e papërshtatshme, 2. burgimi duhet të jetë për një kohë sa më të shkurtër të jetë e mundur dhe 3. në çdo rast duhet verifikuar dhe arsyetuar "interesi më i lartë i fëmijës".*

Përsa i përket dënimit të të miturve është me vend të theksojmë se në bazë të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve[17], parimi kryesor mbi të cilin duhet të bazohen gjykatat për çfarëdo lloj vendimi që ato marrin për të miturit është "Interesi më i lartë i fëmijës", i ndërthurur me dënimet alternative.

- **Ekzekutimi i dënimit penal për të miturit**

Ekzekutimi i dënimit penal është faza e fundit e zhvillimit të procesit penal ndaj të miturit dhe trajtimi i tij kërkon vemendje, pasi në të ndërthuren dhe konkretizohen një sërë parimesh dhe procedurash, të cilat dëshmojnë për efektivitetin e sistemit të drejtësisë së një shteti demokratik.

Ekzekutimi i dënimit me burg vendoset nga gjykata, zbatohet nga prokurori dhe ekzekutohet në vendet e vuajtjes së dënimit që janë burgjet apo institucionet e paraburgimit.

Në nenin 33/3 të K.P parashikohet se: "*Të miturit e kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta nga të rriturit".* Në këtë fazë të gjykimit dhe procedimit zbatohen me përpikmëri dispozitat e parashikuara në Ligjin nr.8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" dhe Ligjin nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim". Është në interesin e fëmijës që institucioni penal të ofrojë një klimë sociale të mirorganizuar, ku fëmijët të rriten duke u aftësuar për të funksionuar në mënyrë sa më të pavarur.

Kodi Penal parashikon zbatimin e dënimeve alternative të cilat mund të aplikohen edhe për të miturit[18]. Masat alternative ndaj të miturve nuk janë shumë të përdorshme, fakt i cili është rrjedhojë kryesisht e mungesës të strukturave mbikëqyrëse për zbatimin e masave alternative.

6. Konkluzione

[15] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 52 Përjashtimi i të miturit nga dënimi
[16] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 46.
[17] E ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992.
[18] Nuk bëhet asnjë diferencim ose përforcim i aplikueshmërisë së tyre për të miturit.

Trajtimi i kësaj teme në këtë punim, përveçse është aktuale dhe prezente çdo ditë e më shumë në shoqërinë tonë, trajtimi i të miturve nga ana e drejtësisë penale ka nevojë për përmirësim dhe për marrjen e masave konkrete në mënyrë që të reduktohet veprimi i mëtejshëm i përfshirjes së të miturve në grupe kriminale, në organizatat e krimit dhe në sistemin e burgjeve. Analiza e administrimit të sistemit të drejtësisë për të miturit ka një rëndësi të madhe sepse kriminaliteti i të miturve është një problem jo vetëm dhe thjesht ligjor, por tepër kritik nga këndvështrimi shoqëror që ndikon drejtëpërdrejtë në cilësinë e jetesës së një shoqërie.

Legjislacioni penal në Shqipëri ka pësuar ndryshime të mëdha në dispozitat e tij duke krijuar, inkorporuar dhe miratuar parime, të cilat e trajtojnë të miturin ndryshe nga të rriturit dhe që evidentohen më së miri në dhënien e dënimit. Por, edhe pse zbatimi i tij ka qenë i humanizuar, ligji mbetet në thelb ndëshkues dhe jo parandalues duke i përdorur shumë pak masat parandaluese ose dënimet alternative.

Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të zvogëluar përdorimin e paraburgimit, si fazë e cila duhet shmangur për arsye se ndikon negativisht në zhvillimin e procesit të rregullt ligjor. Trajtimi me dinjitet dhe garantimi e respektimi i të drejtave themelore të njeriut përbën bazën e filozofisë së trajtimit dhe sigurimit të të miturve në institucionet penale.

Në disa raste ndodh që standarti ligjor nuk shoqërohet me akte nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij, ose ndërsa standardi është de jure, ai nuk gjendet de facto. Ka ende vend për harmonizim të legjislacionit me standardet ndërkombëtare lidhur me drejtësinë për të miturit. Ratifikimi i një numri të madh konventash nuk e ezauron plotësisht problemin sepse ende zbatueshmëria e konventave nuk është në të njëjtin stad me ligjin për efekt të njohurive të limituara lidhur me to.

Për këtë arsye sistemi i drejtësisë për të miturit në Shqipëri i është nënshtruar një procesi të vazhdueshëm reformimi, ku ndryshimet kanë qenë veçanërisht të ndjeshme pas vitit 2001 duke përfshirë masat ligjore, administrative, penitenciare, të infrastrukturës, etj, duke u udhëhequr nga mbrojtja e interesit më të lartë të të miturit. Kjo reformë është konkretizuar sëfundmi me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit në vitin 2017. Pra, në këtë kontekst, kuadri ligjor ekziston dhe ajo çka mbetet për tu bërë është zbatimi në praktikë i tij dhe dispozitave kryesore me në thelb parimin e interesit më të lartë të të miturit.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare, i është kushtuar vëmendje zhvillimit dhe zbatimit të parimeve, strategjive që trajtojnë rolin e të miturit brënda sistemit të drejtësisë penale, duke e parë si në pozicionin e autorit të veprës penale, ashtu edhe të viktimës apo dëshmitarit.

Në rastet në të cilat dënimi me burgim është i nevojshëm, ai duhet të jepet për periudhën më të shkurtër të mundshme. Privimi nga liria nuk mund të jetë i paligjshëm ose arbitrar; ai duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të ndjekë kushtet ligjore duke përfshirë rishikimin nëpërmjet një vendimi gjyqësor. Politika kriminale për të miturit ka karakter rehabilitues dhe parandalues duke u dhënë të miturve në konflikt me ligjin gjithë asistencën e nevojshme për t'u integruar në shoqëri dhe për të bërë kthesën e duhur.

BIBLIOGRAFI

Legjislacion

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, 2017.
2. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ), 1950.
3. Konventa e OKB-së Për të Drejtat e Fëmijës (KDF), 1989.
4. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar, 2017.
5. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar, 2017.
6. Ligji nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur".
7. Ligji nr.10024, dt. 27.11.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8331, dt.21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar".
8. Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

9. Ligji nr.8328/16.4.1998 ndryshuar me ligjin nr. 9071/ 22.5.2003 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.
10. Ligji nr.9397/12.5.2005 “Për shërbimin e kontrollit te brendshëm në sistemin e burgjeve”.
11. Rekomandimi Nr. R 87 (3), “Rregullat Europiane të Burgjeve”, Këshilli i Europës.
12. Rekomandimi nr. R (87) 20 mbi “Reagimin Social ndaj Delinkuencës së të Miturve”, Këshilli i Europës Rekomandimi Rec. (2003)20.
13. Rregullorja e përgjithshme e burgjeve dhe e paraburgimit.
14. Rregullat e OKB-së për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria (Rregullat e Havanës), 1990.
15. Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë Mitur (“Rregullat e Pekinit”).

Emri i Autorit

GARANCITË LIGJORE QË GËZOJNË TË MITURIT NGA KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITURIT

MSc. Erina SHIRA*

SUBJECT: LEGAL GUARANTEES THAT MINORS ENJOY FROM THE CODE OF CRIMINAL JUSTICE FOR MINORS

Abstract

Juveniles in the criminal justice system constitute a vulnerable category and the guarantee of fast, effective and qualitative legal procedures has been the most important goal of the reform in the criminal justice system, this was made concrete by the adoption of the Code of Criminal Justice to Minorsand the Law on the Rights and Protection of Children.

This paper analyzes the position of victims in criminal proceedings after the recent changes brought aboutby the reform of justice as a whole, and mainly those in the Code of Criminal Procedure and the Code of Criminal Justice for Juveniles, which brought about an important reform that distinguishes the procedural position of the victim from the previous one, who was quite passive.

It is important to note that previously the victim could only exercise the status of witness, complainant and civil plaintiff to seek compensation from a criminal offense. Therefore, it is important that these legally guaranteed rights are understood and implemented by justice system professionals.

The ratification and inclusion by our legislation of a number of international mechanisms that prioritize the protection of victims has undoubtedly brought an increase in protection guarantees for victims of criminal offenses. However, the final goal, which requires stable cooperation between law enforcement structures, is the continuous effort to derive the entire legal and institutional framework as a function of a single goal, the guarantee and implementation in practice of the maximum standards for the protection of victims of criminal offenses such as and all their involvement.

Keywords: *victim, victims' rights, victim's status in the criminal process, standards for victims' rights, compensation.*

1. Hyrje

Në vitin 2017, Parlamenti i Shqipërisë miratoi Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit (KDPM), icili shtroi rrugën për një sistem të ri drejtësie për të miturit në Shqipëri, të bazuar ndër të tjera mbi parimete mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturit, mbrojtjes nga diskriminimi, dhe të drejtën për tu dëgjuar. KDPM-ja hyri në fuqi në Janar të 2018, dhe u bazua gjerësisht në Direktivën për të Mitur[1], dhe i referohetKonventës së OKB-së për të drejtat e të miturit. KDPM përforcon të gjitha dispozitat mbi të miturit të KPrP-së, Kodit Civil dhe Ligjit për të Drejtat dhe Trajtimim e të dënuarve me burgim dhe personave në paraburgim[2].

Drejtësia miqësore për të miturit është një ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare e cila u normua si pjesë integrale e reformës në sistemin e drejtësisë dhe e të gjithë ndryshimeve që pësoi paketa legjislative.Në praktikë ka nisur zbatimi i legjislacionit të ndryshuar, që sikurse e sipërcituam udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë

* MSc. Erina Shira, Juriste, Drejtore Departamenti Ligjor në kompani private.

[1] Direktiva (EU) 2016/800 për masat mbrojtëse proceduriale për të miturit e dyshuar dhe akuzuar në procimet penale (‘Direktiva e të Miturve’)

[2] Udhërrëfyesi për në BE: Anëtarësimi përmes reformës në drejtësinë penale në Shqipëri, Dhjetor 2020, f. 32.

të fëmijëve dhe është pararojë e gjithë procesit të zbatimit të tij. Veprimet e ndërmarranë kuadër të përmbushjes së detyrimeve strategjike dhe atyre ligjore kanë për qëllim të sigurojnë riintegrimin dhe rehabilitimin efektiv dhe të shpejtë të të miturve dhe të rinjve në kontakt me ligjin, nga një qasje ndëshkuese drejt asaj rehabilituese dhe restauruese, për trajtimin e përfshirjes së të miturve në veprat penale. Gjithashtu, Kodi parashikon një drejtësi më miqësore me fëmijët viktima apo dëshmitarë tënjë vepre penale. Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, me mbështetjen e UNICEF-it[3] dhepartnerëve dhe aktorëve të shoqërisë civile që kanë si mision të punës së tyre të drejtat e të miturve, ekanë plotësuar Kodin me aktet e tij nënligjore. Këto ndryshime krijojnë një kornizë të drejtësisë penale për fëmijët, në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe standartet e tjerandërkombëtare. Më tej ngritja e sistemit të integruar të të dhënave, do të shërbejë për të gjeneruar informacion për të miturit në konflikt me ligjin në çdo kohë dhe në çdo fazë të ndjekjes penale, të procesit gjyqësor dhe të ekzekutimit të vendimit gjyqësor[4].

Mbrojtja e të drejtave të të miturve nëpërmjet garantimit të ofrimit të shërbimeve në sistemin gjyqësor ka qenë një nga rregullimet bazë të paketës më të fundit ligjore të normimit të sistemit të drejtësisë, në kuadër të reformës në drejtësi. Konkretisht, të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabël dhe garantimi i proçedurave ligjore të shpejta, efektive dhe cilësore ka qenë synimi më i rëndësishëm i reformës në sistemin e drejtësisë penale, e konkretizuar kjo me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve[5], si edhe një sërë normash të tjera materiale e procedurale. Kjo paketë ligjore lidhur me të drejtat e të miturve ka patur në fokus përmirësimin e mëtejshëm të përmbajtjes dhe formës në mënyrën e trajtimit të të miturve në sistemin gjyqësor si dhe trajtimin e specializuar që i ofrohet të mituve në komunitet. Duke ofruar mbështetje nga njëra anë subjektit të veprës penale që në këtë rast është i mitur dhe nga ana tjetër viktimës dhe dëshmitarit të mitur.

Ndër të tjera, fasha e mbrojtjes ligjore është zgjeruar duke përfshirë në këto rregulla edhe të rinjtë deri në moshën 21 vjeç. Për sa më sipër, si dhe në vazhdim të detyrimit institucional për garantimin e të drejtave të të miturve, është miratuar për herë të parë dokumenti politik "Strategjia e Drejtësisë për të Mitur" e shoqëruar me planin e veprimit për periudhën afatgjatë 2018 – 2021[6], si dhe Strategjia e rradhës për të miturit për periudhën kohore 2022-2026.

Kushtet aktuale në trajtimin dhe sigurimin e të drejatve të fëmijëve fokusohet në dy grupe të margjinalizuara:

a. të miturit në konflikt me ligjin dhe
b. të miturit viktima dhe dëshmitarë të veprave penale

Dhe pikërisht në këtë artikull do fokusohemi kryesisht tek pika e dytë, trajtimi i të miturve si viktima të veprave

[3] United Nations International Children's Emergency Fund, Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet.

[4] Aksesuar në: https://www.unicef.org/albania/media/2596/file/KODI%20-%20botimi%20dhjetor%202019.pdf.

[614] Ligji nr18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", hyri në fuqi në qershor të vitit 2017. Ky ligj është përafruar me KDF- në dhe mund të krahasohet me standardet më të përparuara evropiane në këtë fushë. Ligji zgjeron horizontin e të drejtave të fëmijëve, ndërkohë që thekson forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, duke përfshirë edhe nivelin vendor në veçanti. Ligji parashikon ndërveprim, ndërmjet shërbimeve për fëmijët dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale, si dhe bashkërendim me ligjin nr.121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" në kontekstin e ri ligjor dhe administrativ të krijuar nga ndarja e re administrative territoriale në vend; ligji nr.37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2018. Ky ligj forcon konsiderueshëm sistemin e drejtësisë dhe e bashkërendon me KDF-në dhe me standarde dhe norma të tjera ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në kontakt me ligjin mbështetur në interesin e tyre më të lartë. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ka sjell risi në përmirësimin e të drejtave të të miturve që kryejnë, janë dëshmitar ose viktima të veprave penale, dhe ka qasje parandaluese dhe restauruese; ligji nr.7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Dispozitat materiale të ligjit penal lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve përfshihen dhe përcaktohen në Kodin Penal Shqiptar. Tre janë nenet të cilat trajtojnë në mënyrë të posaçme abuzimin seksual të fëmijëve, neni 100, neni 101 dhe neni 108. Nenet e tjera, që rregullojnë aspekte të ndryshme të abuzimit seksual, janë klauzola të përgjithshme, të cilat përfshijnë veprime të dënueshme kundër fëmijëve si një rrethanë rënduese Në vitin 2013, Kodit Penal i janë bërë ndryshime, duke përfshirë disa vepra penale, që parashikojnë dënime më të rënda në fushën e dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë abuzimin seksual dhe shfrytëzimin ekonomi të fëmijëve.

[6] Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018-2021, Shtator 2018, f. 11.

penale.

Veçoria kryesore e këtij Kodi, në raport me Kodin Penal, qëndron në faktin se fuqia e tij shtrihet vetëm në një kategori të caktuar subjektesh, vetëm ndaj të miturve në konflikt me ligjin penal. Dhe nga pikëpamja procedurale, edhe ndaj të miturve viktima apo dëshmitarë të veprave penale, duke parashikuar rregullime të posaçme për përgjegjësinë dhe procedurat e ndjekjes penale të të miturve, deri në rehabilitimin e tyre[7].

2. Risitë që solli miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit

Risitë e Kodit të Drejtpësisë Penale për të miturit, na shfaqen në disa aspekte:

Së pari: krijohet dhe garantohet një kuadër i ri ligjor i drejtësisë penale për të mitur që është në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit.

Së dyti: krijohen kushte dhe mundësi reale që dënimi dhe masat e tjera me karakter penal të jenë efektive dhe të përmbushin qëllimin e tyre, i cili, në kushtet e përafrimit të legjislacioneve pozitive dhe ndërkombëtarizimit të mjaft aspekteve të dënimit penal, synon katër objektiva:

a. ndëshkimin;
b. parandalimin e përgjithshëm;
c. parandalimin e posaçëm;
d. rehabilitimin[8].

Sipas pikëpamjeve të Antoni Ellis dhe Antoni Daf (A. Duff), objektivat e qëllimit të dënimit përmblidhen në aspektin ekspresiv (qëllimi i dënimit është të ndëshkojë autorin e veprës penale, që deklarohet fajtorë për kryerjen e saj dhe ta ndalojë atë dhe persona të tjerë nga kryerja e veprave penale të tjera në të ardhmen) dhe aspektin reformues të tij (qëllimi i tij me karakter penal është më i gjerë, të ndikojë në riedukimin dhe rehabilitimin e të dënuarit, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, si dhe të shprehë gjykimin e shoqërisë për veprën penale duke ndikuar në edukimin e shtetasve të tjerë me ndjenjën e respektimit të ligjit)[9].

Së treti: ky kod synon të mbrojë parimet e rendit publik në procesin e administrimit të drejtësisë penale për të mitur, të rrisë përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur dhe të sigurojë ngritjen e mekanizmave mbikëqyrës për realizimin e misionit dhe detyrave të tij[10].

Së katërti: Ky Kod, si akti i parë ligjor në Shqipëri që i kushtohet posaçërisht drejtësisë penale përtë mitur, parashikon se burgimi jepet vetëm si masë e fundit ndaj të miturve dhe për një kohë sa më të shkurtër të mundshme. Kodi kërkon si domosdoshmëri që të gjithë profesionistët e përfshirë në procesin edrejtësisë për të mitur të specializohen në trajtimin e rasteve të fëmijëve. Ai fut konceptin e shmangies së fëmijës nga procesi traumatik gjyqësor.

Së pesti: Kodi në përmbajtje të tij, ndër të tjera sanksionon:

a. praninë e detyrueshme të psikologut;
b. ofrimin e ndihmës juridike dhe psikologjike falas për fëmijët, përfshirë fëmijët viktima/dëshmitarë;
c. parashikon përshtatjen e godinës së gjykatës dhe seancave, në mënyrë që ato të jenë më të sigurta e më pak frikësuese për fëmijët, si dhe më të favorshme për dhënien e dëshmisë;
d. sjell konceptin e shërbimeve të rehabilitimit me bazë komunitare[11].

---

[7] Drejtësia për të miturit, Realitete dhe Sfida, Reviste periodike Shkencore Nr. 12, Universiteti Mesdhetar i Tiranës, Qershor 2018, f. 17.

[8] Criminal law- (Wikipedia, the free encyclopedia; htt://en.wikipedia.org/wiki/Criminal _ law).

[9] Anthony Ellis, *Critical Study Recent Work on Punishment, The Philosophical Quarterly,* Vol 45, No 179, Prill, 1995.

[10] Drejtësia për të miturit, Realitete dhe Sfida, Reviste periodike Shkencore Nr. 12, Universiteti Mesdhetar i Tiranës, Qershor 2018, f. 18

[11] Aksesuar në: https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/p%C3%ABr-t%C3%AB-par%C3%ABn-her%C3%AB-shqip%C3%ABria-me-nj%C3%AB-kod-t%C3%AB-drejt%C3%ABsis%C3%AB-penale-p%C3%ABr-t%C3%AB-miturit

Një ndër prioritetet e vitit të fundit është edhe trajtimi i të miturve nga dy institucionet që do të ofrojnë programe rehabilitimi, rintegrimi duke u bazuar në planin individual të çdo të mituri. Në kuadër tëzbatimit të politikave dhe prioriteteve të qeverisë kjo nismë do t'i shërbejë çdo profesionisti të përfshirënë proceset e drejtësisë për të miturit me qëllim rritjen e kapaciteteve, specializimin dhe kualifikimin profesional të tyre.

Kuadri ligjor është i plotë, dhe gjithashtu vitet e fundit janë vënë në lëvizje një sërë mekanizmash institucional, kjo edhe si pasojë e miratimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur i cili i jep viktimëssë mitur një pozicion më komod nga më parë. Megjithatë nga ana organizative dhe cilësia e ndihmës së ofruar mbetet ende shumë punë për t'u bërë, për specializimin e trajtimin e punonjësve që merren me të miturit dhe mundësive për riinegrimin e të miturve viktimë të trafikimit dhe abuzimit seksual, për të minimizuar pasojat e lëna nga vepra penale.

3. Garancitë ligjore për të miturit si viktima të veprës penale

Nocionin e ''të miturit viktimë" na e jep Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit në Nenin 3 pika 5 të tij, duke përcaktuar se: *"I mitur viktimë" është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuardëm moral, fizik ose material, si pasojë e një vepre penale''.*

Në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, janë specifikuar parimet e përgjithshme të cilat duhet të respektohen kur kemi të bëjmë me të mitur viktimë/dëshmitar i veprës penale, ndër to mund të përmëndim (Neni 33), parimet e përgjithshme:

a. trajtimi i tyre me përkujdesje, në mënyrë miqësore dhe të ndjeshme;[12]
b. garantimi i të drejtave sipas këtij Kodi, pa asnjë lloj diskriminimi, për çdo të mitur në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar;[13]
c. shqyrtimi nga organet kompetente në mënyrë të shpejtë, brenda afateve të caktuara në këtë Kod, dhe me përparësi i çështjeve me të mitur në konflikt me ligjin, si dhe të çështjeve me të mitur viktimë.[14]

Nga tërësia e të drejtave që i garantohen viktimës së mitur, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm kërkon një vëmendje të veçantë. Gjykimi në një afat të arsyeshëm është një nga parimet kryesore në procedimin penal si element i një procesi të rregullt ligjor i parashikuar në aktet më të rëndësishme juridike ndërkombëtare dhe kombëtare, dhe është i shtrirë në të gjitha parashikimet legjislative për të gjithë pjesëmarrësit e procesit penal.

Gjykimi në një afat të arsyeshëm është parë gjithnjë si një e drejtë e personave të pandehur dhe rrallë ndodh të shohësh këtë element të trajtuar në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të viktimave. Viktimat nuk janë palë të procesit,[15] por janë subjekte mbi të cilët rëndojnë pasojat e një gjykimi jo të shpejtë. Viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore duhet t'i garantohen të drejtat në mënyrë të shpejtë dhe të efektshme për të shmangur çdo element që do të zgjaste dhe shtonte efektet e veprës penale.[16]

Disa nga garancitë proceduriale janë:

a. Mbrojtja e jetës private të të miturit viktimë;[17]
b. Ruajtja e konfidencialitetit;
c. vetëm me leje të gjykatës mund të bëhet i ditur identiteti i të miturit viktimë/dëshmitar i veprës penale.

[12] Neni 33/a i KDPM.
[13] Neni 11 i KDPM, Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi.
[14] Neni 17 i KDPM, Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi.
[15] Përjashtimisht, viktima akuzuese parashikuar nga neni 59 i K.Pr.Penale paraqetkërkesën në gjykatë dhe merr pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.
[16] Puci, Kristina, Zylyfi, Kristina. *Garancitë procedurale dhe trajtimi i viktimës së mitur të abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerzore në Shqipëri*, Tiranë 2019, f. 8.
[17] Neni 21, pika 2, Mbrojtja e jetës private të të miturit; 2. Nuk publikohet asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e të miturit në konflikt me ligjin, të të miturit viktimë ose dëshmitar i një vepre penale.

Organet kompetente duhet të marrin të gjitha masat që çdo pjesëmarrës në administrimin e drejtësisë për të mitur, i cili ka të dhëna lidhur me të miturin viktimë ose dëshmitar, të jetë i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë për shkak të detyrës ose/dhe gjatë kryerjes së detyrës,[18] shkelja e kësaj dispozite përbën vepër penale sipas Kodit Penal.[19]

Gjithashtu, Neni 58/a i Kodit të Procedurës Penale parashikon disa të drejta shtesë për viktimat e mitura në raport me viktimat e rritura. Të tilla si e drejta që të shoqërohet nga një person i besuar prej tij, ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave personale, si dhe të kërkojë nëpërmjet përfaqësuesit që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.

Një nga çështjet delikate dhe që kërkon vëmendje është përcaktimi i personit të besuar për të miturin, në rastet kur i mituri është viktimë e dhunës në familje ose e abuzimit nga kujdestari ose përfaqësuesi i tij.[20]

Për të parandaluar rrezikun e riviktimizimit dhe viktimizimit të dytë, në veprimet procedurale në të cilat i mituri është viktimë, merr pjesë përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi dhe psikologu, si dhe sipas rastit, nëse është e mundshme, edhe personi i besuar i të miturit.[21] Në të gjitha fazat e procedimit penal, i mituri viktimë e veprës penale, ka të drejtë:

a. Të informohet mbi procedurat që kanë të bëjnë me të, me rolin e tij, kohën e dëshmisë, si dhe me mënyrën sesi do procedohet me marrjen e tij në pyetje;
b. Të njihet me mekanizmat mbështetëse për bërjen e ankesës, mundësinë për të patur në dispozicion ndihmë ligjore falas, ndihmë psikologjike dhe mjeksore si dhe mundësinë për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin që i është shkaktuar nga autori i veprës penale;
c. Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme;[22]
d. Në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur, çdo i mitur në konflikt me ligjin ose viktimë ka të drejtë për ndihmë ligjore dhe psikologjike pa pagesë, të garantuar nga shteti, sipas legjislacionit përkatës;[23]
e. Përfitimi pa pagesë i shërbimeve që ofrohen sipas këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi;[24]
f. I mituri viktimë ka të drejtë të mbrohet pa pagesë gjatë gjithë procesit të drejtësisë nga një avokat, të cilin e zgjedh nga lista përkatëse e hartuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.[25]

Me ndryshimet që i'u bënë K.Pr.Penale viktimës së mitur iu njoh e drejta që nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, të kërkojnë drejtëpërdrejt në gjykatë procedimin penal të fajtorit.[26] Mosparaqitja e personit të dëmtuar apo përfaqësuesit të tij në seancë gjyqesore pa shkaqe të arsyeshme, sjell pushimin e gjykimit. Ky rregull procedurial krijon një problem shumë të madh në realitet për sa i përket të drejtave tëfëmijëve, që janë viktima të një veprimtarie kriminale siç është rrahja, dëmtime të tjera të shëndetit, plagosja etj, pasi kërkesa për procedimin e personit të akuzuar në këto raste duhet të firmoset dhe tëndiqet gjatë gjithë procedimit dhe gjykimit nga përfaqësuesi ligjor i fëmijës, prindi apo kujdestari. Në rast se përfaqësuesi ligjor nuk është dakort dhe nuk i kryen këto veprime, atëherë fëmija nuk ka mundësi të mbrojë interesat e tij.[27]

---

[18] Neni 33/c i KDPM

[19] Neni 313/b KP, Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin.

[20] Shih Hysi, Vasilika, Hysi.A "*Reforma në drejtësinë penale dhe mbrojtja e viktimave, sfidat e zbatimit të reformës"*, Criminal Law Department International Scientific Conference, University of Tiranë, f.610.

[21] Neni 34 pika 1 e KDPM, E drejta e të miturit viktimë për t'u informuar.

[22] Neni 18, pika 1 e KDPM, Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut

[23] Neni 20, pika 1 e KDPM, Ndihma ligjore dhe psikologjike e të miturit.

[24] Neni 23 i KDPM, Shërbimet pa pagesë për të miturit në sistemin e drejtësisë penale.

[25] Neni 36 i KDPM, Ndihma juridike për të miturin viktimë.

[26] Analiza juridike e zbatimit në praktikë të ndryshimeve të reja në Kodin e Procedurës Penale Të dhëna krahasimore për 3 Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Sarandë, Gjirokastër, Përmet Gjirokastër, Shkurt 2019.

[27] Shih nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, i cili në pikën 3 dhe 4 parashikon: "*3. Nëse viktima akuzuese ose mbrojtësi i caktuar prej tij nuk paraqitet në seancë pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos pushimin e gjykimit. 4. Viktima akuzuese që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron tëdrejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor".*

4.Trajtimi i të miturve viktima nga struktura të posaçme

Autoritetet përkatëse, në nivel kombëtar të cilat janë përgjegjëse për trajtimin e të miturveviktimave të veprave penale, janë 2 lloje:

1. strukturat në fushën e drejtësisë;
2. strukturat në fushën e shëndetësisë dhe çështjeve sociale.

4.1 Strukturat në fushën e drejtësisë

Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, përmban rregullime të posaçme lidhur me procedurat ose çdo masë tjetër që përfshin një të mitur viktimë të veprës penale.

Në vitin 2018, Prokuroria e Përgjithshme ka miratuar udhëzimin nr. 05,datë 26.10.2018, *"Për Garantimin e Asistencës ndaj Viktimave dhe Dëshmitarëve të Veprave Penale*", i cili ka në fokus përcaktimin e procedurave që duhet të ndiqen nga prokurorët, punonjësit e policisë gjyqësore dhe punonjës të tjerë të prokurorisë, gjatë ndërveprimit të tyre me viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale. Në nenin 18 udhëzimi parashikon se prokurori duhet të mbajë parasysh vështirësitë dhe shqetësimet që mund t'i shkaktohen viktimës nga vonesat gjatë ndjekjes penale, dhe të veprojë në mënyrë që të shmangen sa më shumë të jetë e mundur këto pasoja.

Prokurori duhet t'i përcjellë gjykatës informacionin lidhur me vështirësitë që i shkaktohen viktimës nga shtyrja e seancave gjyqësore dhe duhet të marrë në konsideratë ndikimin e vonesave dhe shtyrjeve tek viktima, para se të vendosë zgjatjen e afatit të hetimeve apo të kërkojë shtyrjen e seancës gjyqësore.[28]

Si fillim, neni 27 i Kodit përcakton kompetencën e gjykimit të çështjeve të drejtësisë për të miturit sa më poshtë:

1. *I mituri në konflikt me ligjin gjykohet nga seksionet për të mitur, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.*
2. *Seksionet janë kompetente edhe për gjykimin e të pandehurve të rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktima.*[29]

Kodi në neni 28 të tij, parashikon kriteret për shqyrtimin gjyqësor të rasteve me të mitur, duke vënë theksin tek trajnimi dhe specializimi i posaçëm që duhet të kenë magjistratët të cilët gjykojnë çështje metë mitur viktima të veprave penale:

1. *Nëse viktima është i mitur dhe gjykimi në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe të apelit bëhet me trup gjykues, të paktën një gjyqtar duhet të jetë i specializuar dhe i trajnuar në drejtësinë penale për të mitur.*

2. *Në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, në të cilat, për shkak të numrit të gjyqtarëve nuk mund të ngrihet seksioni për të mitur, kur çështja gjykohet nga tre gjyqtarë, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë gjyqtar i specializuar dhe trajnuar në drejtësinë penale për të mitur*.[30]

Neni 31 i Kodit, i referohet mbrojtësit të të miturit viktimë, duke vënë theksin tek specializimi i posaçëm që duhet të kenë avokatët mbrojtës të tyre:

3. *I mituri në konflikt me ligjin ose viktimë mbrohet nga avokatë të specializuar në drejtësinëpër të mitur, me përjashtim të rasteve kur i mituri ose përfaqësuesi i tij ligjor përzgjedh një avokat*

[28] Neni 18, Udhëzimi nr. 05, datë 26.10.2018, i Prokurorit të Përgjithshëm, "Për Garantimin e Asistencës ndaj Viktimave dhe Dëshmitarëve të Veprave Penale".
[29] Neni 27 KPDM, Kompetenca e gjykimit të çështjeve të drejtësisë për të miturit
[30] Neni 28 KDPM, Shqyrtimi gjyqësor i rasteve me të mitur

tjetër.[31]

Organet kompetente marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që personat, të cilët punojnë me të miturit, të kenë njohuritë e nevojshme, ndërgjegjësimin profesional më të lartë për mbrojtjen e të drejtave të të miturive në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitarë, si dhe marrin të gjitha masat e duhura për qëndrueshmërinë e tyre në këto pozicione pune.[32]

4.2 Strukturat në fushën e shëndetësisë dhe çështjeve sociale

- **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijës (ASHDMF)**

Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit parashikon se në çdo procedurë që është pjesë një viktimë e mitur, duhet të asistohet nga një psikolog dhe nga përfaqësuesit e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës. Nga ana tjetër Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijës është një nga strukturat qëndrore, parashikuar në ligjin nr, 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. E cila mbron fëmijën nga të gjitha format e dhunës duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet. Agjencia duhet të sigurojë të gjitha kushtet e nevojshme, me qëllim integrimin e fëmijës në një jetë normale dhe duke respektuar dinjitetin e vetëvendosjen e fëmijës, në përputhje me moshën e tij. Agjencia merr në trajtim të miturin viktimë menjeherë sapo merr dijeni për rastin dhe vepron paralelisht me strukturat përgjegjëse gjatë ndjekjes penale dhe gjykimit.

Agjencia për trajtimin dhe ndjekjen e rasteve, bashkërendon punën me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel vendor.[33] Njësia ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.[34]

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) është agjencia kombëtare qendrore, e cila ushtron një sërë kompetencash të rëndësishme në lidhje me të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, të tilla si:

- organizimi dhe koordinimi i sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës;[35]
- mbështetje të drejtpërdrejtë ndaj strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor duke përfshirë trajnime, asistencë në menaxhimin e rasteve, mbikëqyrje të rasteve të caktuara, këshillim etj;[36]
- mbledhja e të dhënave në nivel kombëtar dhe administrimi i regjistrit elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje;[37]
- bashkërendimi i punëve me ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve;
- realizimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe edukative.[38]

Agjencia duhet të sigurojë të gjitha kushtet e nevojshme, me qëllim integrimin e fëmijës në një jetë normale dhe duke respektuar dinjitetin e vetëvendosjen e fëmijës, në përputhje me moshën e tij. Agjencia merr në trajtim të miturin viktimë menjeherë sapo merr dijeni për rastin dhe vepron paralelisht me strukturat përgjegjëse gjatë ndjekjes penale dhe gjykimit.

Agjencia për trajtimin dhe ndjekjen e rasteve, bashkërendon punën me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel vendor.[39] Njësia ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve

[31] Neni 28 KDPM, Mbrojtësi
[32] Neni 25, pika 1 e KDPM, Specializimi i personave që administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisëpenale për të mitur
[33] Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve janë të vendosura pranë 61 bashkive.
[34] Aksesuar në: https://femijet.gov.al/al/njesite-per-mbrojtjen-e-femijeve.
[35] Neni 41/1, i Ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës'.
[36] Neni 41/2, i Ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
[37] Neni 41/3 a, i Ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
[38] Raport i avokatit të popullit mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve nëntor 2021, f. 15.
[39] Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve janë të vendosura pranë 61 bashkive.

të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.[40]

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) është agjencia kombëtare qendrore, e cila ushtron një sërë kompetencash të rëndësishme në lidhje me të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, të tilla si:

- organizimi dhe koordinimi i sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës;[41]
- mbështetje të drejtpërdrejtë ndaj strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor duke përfshirë trajnime, asistencë në menaxhimin e rasteve, mbikëqyrje të rasteve të caktuara, këshillim etj;[42]
- mbledhja e të dhënave në nivel kombëtar dhe administrimi i regjistrit elektronik kombëtar për rastet e fëmijës në nevojë për mbrojtje;[43]
- bashkërendimi i punëve me ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve;
- realizimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe edukative.[44]

- **Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve**

Në mënyrë eksplicite, të drejtat e fëmijës u morën në mbrojtje për herë të parë nga një Ligj i posaçëm, ligji nr. 10347 datë 4.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës" (shfuqizuar me Ligjin Nr. 18/2017, për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës), i cili përkufizoi mekanizmat institucionalë për mbrojtjene të drejtave të fëmijës në nivel qendror dhe vendor.

Ishte pikërisht hyrja në fuqi e tij, që i dha rrugë ngritjes së Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës (NjMF) pranë njësive vendore si dhe përcaktimit të detyrave statuore për të gjithë aktorët përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës dhe mbështetjen e punës së NjMF-ve.[45] Në referencë të këtyre parashikimeve ligjore, Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit sanksionon se, i mituri viktimë/dëshmitar i veprës penale mund të mbështetet tek Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NjMF)[46], e cila ka për detyrë:

a. që t'i ofrojë të miturit mbështetje emocionale si dhe mbështetje gjatë gjithë proçesit;
b. të këshillojë sipas rastit ndjekjen e ndonjë terapie apo të këshillimit profesional;
c. të informojë të miturin për rëndësinë që ka dhënia e dëshmisë, vendin dhe kohën e marrjes në pyetje;
d. të drejtën e tij për të patur mbështetje ligjore, psikologjike dhe shëndetësore falas;
e. sipas rastit, të shmangë kontaktet e padëshiruara apo të papërshtatshme për të miturin, ose të ndërmarrë masa të tjera që i shikon si të nevojshmë për mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit.

Në rast se përfaqësuesi i NjMDF është caktuar në cilësinë e përfaqësuesit procedurial, kur i mituri viktimë/dëshmitar është nën 14 vjeç, jep pëlqimin për dhënien e dëshmisë nga ana e të miturit.[47]

Si masa mbrojtëse për të miturin viktimë/dëshmitar i veprës penale KDPM ka parashikuar se: Neni 37 I KDPM; ‘*'1. Në çdo fazë të procesit penal, kur siguria e të mitur viktimë ose dëshmitar është në rrezik, sipas rastit, prokurori, policia gjyqësore ose Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, marrin masa mbrojtëse të tilla si:*

[40] Aksesuar në: https://femijet.gov.al/al/njesite-per-mbrojtjen-e-femijeve.
[41] Neni 41/1, i Ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
[42] Neni 41/2, i Ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
[43] Neni 41/3 a, i Ligjit nr. 18/2017 datë 23.02.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
[44] Raport i avokatit të popullit mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve nëntor 2021, f.15.
[45] Hartëzimi i strukturave bazë të Mbrojtjes së Fëmijës (në nivel vendor) dhe prioritizimi i nevojave të tyre për aftësim professional, Tetor 2013, f.11.
[46] "Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës" është struktura për mbrojtjen e të miturit në nivel vendor, sipas ligjit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, Neni 3/14 KDPM.
[47] Neni 3 pika 12 e ligjit Nr. 18/2017 ''Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës'', parashikon; "Përfaqësues procedural" është personi i caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës dhe ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës dëshmitar/viktimë, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës''.

a. *shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë midis të miturit viktimë ose dëshmitar dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit;*
b. *bërjen e kërkesës për nxjerrjen e një "urdhër-kufizimi" në gjykatë. Në këtë rast kërkesa regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe protokollohet ditën e dorëzimit të saj. Në këtë rast zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e legjislacionit në fuqi për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare;*
c. *bërjen e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit "arrest me burg" ose "arrest në shtëpi" për të akuzuarin, me kushtin e ndalimit të kontaktit me të miturin;*
d. *bërjen e kërkesës për marrjen e masave mbrojtëse për të miturin viktimë ose dëshmitar prej policisë ose strukturave të tjera dhe ruajtjen e sekretit të vend ndodhjes së të miturit;*
e. *të marrë ose të kërkojë nga autoritetet kompetente masa të tjera mbrojtëse që konsiderohen të përshtatshme".*

Detyrat e Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës lidhur me të miturin dëshmitar dhe viktimë, janë parashikuar nga Neni 35 i Kodit.[48]

1. Përfaqësuesi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është personi mbështetës në rastet me të miturin dëshmitar dhe viktimë dhe, ndër të tjera, ka për detyrë:

a. *të mbështesë të miturin emocionalisht;*
b. *të japë mbështetje gjatë gjithë procesit penal. Kjo ndihmë mund të përfshijë masa për minimizimin e pasojave negative të veprës penale, masa për të ndihmuar të miturin në veprimtarinë e përditshme dhe masa në raport me çështjet administrative që lidhen me rrethanat e rastit konkret;*
c. *të këshillojë nëse ndjekja e një terapie ose këshillimi profesional është i nevojshëm;*
d. *të ruajë komunikimin me të afërmit, shokët dhe mbrojtësin e të miturit;*
e. *të informojë të miturin lidhur me shërbimet shëndetësore, psikologjike ose sociale si dhe për mënyrat e mundshme të marrjes së këtyre shërbimeve;*
f. *të informojë të miturin për gjendjen e tij procedurale, rëndësinë e dhënies së dëshmisë, kohëzgjatjen, formën, si dhe për rregullat procedurale të pyetjes;*
g. *të informojë të miturin për kohën dhe vendin e marrjes në pyetje dhe zbatimin e veprimeve të tjera procedurale;*
h. *të informojë të miturin për të drejtën për ankim ndaj veprimeve procedurale të parashikuara me ligj;*
i. *në bashkëpunim me mbrojtësin ose, në mungesë të tij, në bashkëpunim me të miturin dhe përfaqësuesin ligjor, të shmangë, sipas rastit, kontaktet e papërshtatshme dhe/ose të padëshirueshme për të miturin, mbajtjen në një sallë të veçantë ndërmjet seancave, ose të masave të tjera për mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit;*
j. *në bashkëpunim me mbrojtësin, ose në mungesë të tij në bashkëpunim me të miturin dhe përfaqësuesin ligjor të kërkojë nga gjykata marrjen e masave mbrojtëse, nëse këto janë të nevojshme;*
k. *të kërkojë marrjen e masave të veçanta, nëse për rrethanat në të cilat ndodhet i miturit këto masa janë të nevojshme.*

2. Përfaqësuesi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, nëse është caktuar me cilësinë e përfaqësuesit procedural, në rastet e të miturve viktima dhe dëshmitarë nën 14 vjeç, jep edhe pëlqimin për dhënien e dëshmisë nga ana e të miturit.

Njësia për mbrojtjen e fëmijës, përbëhet nga punonjës socialë, të quajtur punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, të cilët kanë për detyrë ndjekjen e rasteve të fëmijëve viktimë që nga origjina/identifikimi irastit deri te miratimi i masave dhe zbatimi i tyre.

Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës kanë, ndër të tjera disa detyra domethënëse të tilla si:

[48] Neni 35 i KDPM, Detyrat e Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës lidhur me të miturin dëshmitar dhe viktimë.

a. të propozojnë masa mbrojtëse;
b. të propozojnë ndryshimin apo përfundimin e Planit Individual të Mbrojtjes;
c. të marrin pjesë në proceset gjyqësore në të cilat shqyrtohen masat e mbrojtjes të propozuara në Planin Individual të Mbrojtjes;
d. t'i drejtohen prokurorit për heqjen e përgjegjësisë prindërore;
e. të ndihmojnë fëmijën dhe/ose familjen e fëmijës në hartimin dhe dërgimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit apo autoriteteve të tjera përgjegjëse.[49]

Neni 34, pika 4 dhe 5, E drejta e të miturit viktimë për t'u informuar:[50]

Pika 4: Në çdo fazë të procesit, përfaqësuesi ligjor i një dëshmitari/viktime të mitur ka të drejtë:

a. të shprehë opinionin e tij lidhur me nevojat e të miturit përpara organit procedural;
b. të informohet në lidhje me akuzat e ngritura ndaj të pandehurit;
c. të informohet në lidhje me marrëdhëniet mes të miturit dhe të pandehurit;
d. të informohet lidhur me ecurinë e procesit dhe vendimet lidhur me masën e sigurisë që është vendosur ndaj të pandehurit, si dhe lidhur me lirimin e të pandehurit ose të dënuarit nga mjediset e burgimit ose të paraburgimit, me përjashtim të rastit kur kjo vë përpara një rreziku real të pandehurin ose të dënuarin;
e. të bëjë ankim në lidhje me vendimin e dhënë nga gjykata, pavarësisht nëse kjo e drejtë ushtrohet ose jo nga prokurori i çështjes.

Pika 5: Gjyqtari gjatë gjykimit dhe prokurori në fazën e hetimeve mund të ndalojnë përfaqësuesin ligjor tënjë dëshmitari/viktime të mitur për të marrë pjesë në veprimet procedurale vetëm nëse kjo është e domosdoshme për interesin më të lartë të të miturit.

I mituri viktimë/dëshmitar duhet të njoftohet në mënyrë të tillë që informacioni të jetë sa më i përshtatshëm për të duke marrë parasysh zhvillimin e tij kognitiv në mënyrë të drejpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij. I mituri viktimë/dëshmitar në rast se dëshmia e tij mund ta vendos atë në rrezik serioz për jetën atëherë gjyqtari mund të vendosë:

a. që t'i ndryshohet pamja dhe/ose zëri, marrjen në pyetje të tij nëpërmjet një ekrani jotransparent, ose në distancë;
b. pyetjen e dëshmitarit përpara seancës me pjesmarrjen e mbrojtësit të të miturit dhe video-rregjistrimit të pyetjes së të miturit;
c. pyetja e tyre duhet të bëhet në mjedise miqësore si dhe jashtë mjedisit të gjykatës;
d. mos rimarrjen në pyetje në shkallët e tjera të gjykimit për të shmangur riviktizimin e të miturit, me përjashtim të rasteve të caktuara me ligj.

Në raste me të mitur viktimë/dëshmitarë zhvillimi i seancës gjyqësore bëhet vetëm me dyer të mbyllura. Kur kemi të bëjmë me të mitur viktimë/dëshmitar të shfrytëzimit seksual ose të dhunës seksuale, marrja në pyetje e tyre rregjistrohet audio dhe video i cili është i detyrueshëm, si dhe dëshmia e tyre mund të shfaqet gjatë seancës pa qënë i pranishëm vetë i mituri nëpërmjet teknologjive të nevojshme të komunikimit.

Kur i mituri është dëshmitar/viktimë e dhunës në familje ai ndalohet të merret në pyetje në pranin eprindit ose të afërmit abuzues. Kur i mituri është nën 14 vjeç, pyetja e tij mund të bëhet vetëm me pëlqimin dhe me praninë e përfaqësuesit ligjor/proçedural, psikologut dhe mbrojtësit të tij.[51]

Një ndër problematikat në trajtimin e viktimave të mitur është bashkëpunimi me familjarët e të miturit. Kjo për arsye privatësie, mentaliteti apo frikë nga stigmatizimi. Mirëpo, mos bashkëpunimi nga ana e familjarve për të lejuar ndihmën e të miturit nga institucionet krijon një ngërç, pasi institucionet nukndërhyjnë me dhunë pas

[49] Raport i avokatit të popullit mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve nëntor 2021, f. 16.
[50] Neni 34 pika 4 dhe 5 e KDPM.
[51] Drejtësia për të miturit, Realitete dhe Sfida, Reviste periodike Shkencore Nr. 12, Universiteti Mesdhetar i Tiranës, Qershor 2018, f. 146-147.

refuzimit të ndihmës.[52]

5. Vajzat e mitura në konflikt me ligjin dhe nevojat specifike për trajtimin e tyre

Më poshtë do trajtojmë shkurtimisht garancitë procedurale të viktimave të mitura si pasojë e trafikimit dhe abuzimit seksual, të parashikuara nga KDPM, duke qenë se vajzat e mitura rezultojnë të jenë më shpesh viktima të këtyre veprave penale.

Legjislacioni shqiptar para reformës në drejtësi, bazuar edhe në aktet e ndryshme ndërkombëtare, merrte në mbrojtje dhe kujdes të veçantë të miturit në konflikt me ligjin, por nukpërmbante parashikime të posaçme për të miturin viktimë të abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore. Kushtetuta e RSh, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale si dhe aktet etjera ligjore para reformës nuk garantonin interesin më të lartë të të miturit viktimë në pajtim me aktet ndërkombëtare.

Legjislacioni ynë i brendshëm ka bërë pjesë të tij aktet ndërkombëtare si, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF) dhe tërësinë e rregullave të OKB-së, duke krijuar një kuadër ligjor të plotë mbi të drejtat dhe garancitë procedurale për viktimën e mitur të trafikimit dhe abuzimit seksual në procesin penal.

KPrP ka pësuar ndryshime sa i takon të drejtave të viktimës së veprës penale dhe në veçanti ka sanksionuar dy dispozita për të drejtat e viktimës së mitur, viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimëssë trafikimit të qenieve njerëzore.[53]

Kodi sikurse kemi listuar më sipër në këtë punim, garanton një sërë të drejtash për viktimat në përgjithësi, ashut edhe për viktimat e trafikimit dhe abuzimit seksual. Të tilla si trajtimi me përkujdesje,në mënyrë miqësore dhe të ndjeshme, t'i mbrohet jeta private, t'i ruhet konfidencialiteti i informacionit, bërja publike e identitetit, e drejta për t'u informuar, për t'u mbrojtur pa pagesë gjatë gjithë procesit, e drejta për kompensim, e drejta për ndihmë psikologjike, pjesëmarrja e përfaqësuesit ligjor dhe sipas rastit personit të besuar etj.[54]

Të miturës viktimë të trafikimt, të shfrytëzimit seksual ose dhunës seksuale i garantohen rregulla të veçanta për marrjen në pyetje si rrjedhojë e rrezikshmërisë së këtyre veprave apo efekteve që sjell në shëndetin dhe në zhvillimin e fëmijës. Në këtë mënyrë, regjistrimi audio ose audio video shmangriviktimizimin si dhe ri-pyetjen e të miturit më shumë se njëherë pa qenë e nevojshme në apel apo edhe gjatë rigjykimit të çështjes.

Pavarësisht përpjekjeve në përputhje me rregullimet ligjore të sipërcituara, nisur nga monitorimet dhe hetimet e trajtimeve të rasteve, për të cilat është ofruar mbrojtje nga NJMF, konstatohet se: Administrimi në praktikë i rasteve të të miturave viktima të abuzuara seksualisht dhe viktima të trafikimit të qenieve njerëzore tejkalojnë parashikueshmërinë e reflektuar në masat e marra paraprakisht.

Kjo, pasi mundësitë (buxhetet, kapacitetet e burimeve njerëzore, shërbimet sociale etj) që ofrojnë bashkitë dhe njësitë administrative janë të pamjaftueshme për menaxhimin e rasteve të viktimave në nevojë për mbrojtje. Avokati I Populli në raportin e vitit 2021 thekson se, përveç plotësimit të kuadrit rregullator dhe të adaptuar, vlerësohet nevoja për trajnimin e strukturave të mbrojtjes së fëmijës, për të punuar me fëmijët e abuzuar seksualisht. Nga ana e Punonjësve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (PMF) janë marrë masat për t'ju përgjigjur me sa munden rasteve të abuzimit apo shfrytëzimit seksual,por konstatohet se mungon informacioni dhe trajnimi, se si të adresohen në mënyrën e duhur situatat e të miturave viktima të trafikuara ose abuzuara seksualisht.[55]

Masat gjatë procesit të ndjekjes penale, përfshijnë hetimin penal dhe proceset gjyqësore të rastevetë trafikimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve, të parashikuara në kreun VII të Konventës së Lanzarotës.[56] Konventa

---

[52]Plani Kombëtar i Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge 2019-2021, është miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar per te Drejtat dhe Mbrojtjen e Femijes, me nr 704, datë 21.10.2019.

[53] Për më shumë shih nenet 58, 58/a dhe 58/b të KPrP.

[54]Aksesuar:https://www.academia.edu/97102962/GARANCIT%C3%8B_PROCEDURALE_DHE_TRAJTIMI_I_VIKTIM%C3%8BS_S%C3%8B_MITUR_T%C3%8B_ABUZUAR_SEKSUALISHT_DHE_VIKTIM%C3%8BS_S%C3%8B_TRAFIKIMI T_T%C3%8B_QENIEVE_NJER%C3%8BZORE_N%C3%8B_LEGJISLACIONIN_SHQIPTAR.

[55] Raport i Avokatit të Popullit mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve, Nëntor 2021, f.22.

[56] Konventa e Këshillit të Europës. "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual" (e njohur si Konventa e Lanzarotës) është një hap i madh përpara në parandalimin e krimeve seksuale kundër fëmijëve, ndjekjen e

parashikon, se hetimet dhe proceset penale duhet të kryhen në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës,[57] me një qasje mbrojtjeje ndaj viktimave në mënyrë që të garantohet, se hetimi penal dhe procesi gjyqësor nuk e përkeqësojnë traumën që kalon fëmija.[58]

Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, përmban gjithashtu dispozita të rëndësishme në lidhje me fëmijët viktima të abuzimit seksual. Në fakt, KDPM-ja rregullon çështje të tilla si:

- pozita e fëmijës viktimë gjatë hetimit dhe ndjekjes penale;
- intervistat me fëmijët;
- masat mbrojtëse gjatë gjithë procesit, në mënyrë që të mos përkeqësohet trauma e tyre;
- mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve viktima dhe çështje të ngjashme.

Pra, të gjitha aspektet, të cilat janë përmendur dhe janë nxitur të rregullohen nga disa prej instrumenteve ndërkombëtare të shpjeguara në paragrafet e mësipërme.

Standardet ndërkombëtare të harmonizuara në dispozitat kryesore të KDPM-së, që mund të zbatohen për fëmijët viktima të trafikimit dhe abuzimit seksual janë:[59]

Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi: Parashikon parimin se çdo organ kompetent duhet të shqyrtojë në mënyrë të shpejtë dhe me përparësi çështjet me të mitur viktima, duke garantuar që procesi penal në çdo fazë të tij, të mos përkeqësojë traumën e përjetuar.[60] Duhet të përmendet se me autoritete kompetente[61], përfshihen të gjithë punonjësit të cilët vendosen në kontakt me fëmijën viktimë, përfshirë gjyqtarin, prokurorin, punonjësin e policisë gjyqësore, punonjësin e policisë së shtetit, avokatin, psikologun, punonjësin social, punonjësin e Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (Neni 17).

Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut: Parashikon se në mënyrë që të mbrohen fëmijët viktima nga trauma, prania e psikologut është e detyrueshme në të gjitha procedurat e ndjekjes penale (hetimi dhe gjykimi). Prania e psikologut është gjithashtu e nevojshme për të siguruar që intervistat me fëmijët të zhvillohen në mënyrën e duhur. Përveç kësaj parashikohet se kur është e mundur, i njëjti psikolog të ndjekë të njëjtin fëmijë viktimë përgjatë gjithë procesit (Neni 18).

Ndihma ligjore dhe psikologjike e të miturit (falas): Parashikon se në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur, çdo i mitur viktimë ka të drejtë për ndihmë ligjore dhe psikologjike, pa pagesë, të garantuar nga shteti, sipas legjislacionit përkatës. (Neni 20).

Mbrojtja e jetës private të të miturit: Parashikon se në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur privatësia e fëmijëve duhet të respektohet dhe çdo informacion që mund të çojë në identifikimin e fëmijës viktimë nuk lejohet të publikohet. (Neni 21).

Mbi trajnimin dhe specializimin e autoriteteve kompetente: Parashikohet se organet kompetente që punojnë me të miturit duhet të kenë ekspertizën e nevojshme[62] dhe se personat qëadministrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur duhet të jenë të specializuar dhe të trajnuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve[63]. Ky detyrim përfshin shumë punonjës dhe profesionistë të tillë si prokurorin, punonjësin e policisë gjyqësore, punonjësin e policisë së shtetit, avokatin, psikologun, punonjësin social, punonjësin e njësisë për

---

kriminelëve dhe mbrojtjen e viktimave fëmijë. Duke u bazuar në standardet aktuale ndërkombëtare dhe rajonale, Konventa i zgjeron për të mbuluar dhe kriminalizuar të gjitha krimet seksuale kundër fëmijëve, pa dallim a janë për përfitim komerical ose jo. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është në zemrën e kësaj Konvente. Ajo ka fokusin në respektimin e të drejtave të fëmijëve, sigurimi i mirëqenies së tyre, përgjigja ndaj mendimeve të t

yre, nevojave dhe shqetësimeve gjatë gjithë kohës në interesat e tyre më të mirë. Konventa i kërkon shteteve që të krijojnë një kuadër ligjor dhe institucional për parandalimin e fenomenit dhe për marrjen e shërbimeve nga fëmijët, si dhe për ndëshkimin e kriminelëve të përfshirë në krime seksuale kundër fëmijëve.

[57] Neni 30 (1) i Konventës së Lanzarotës.

[58] Neni 30 (2) të Konvetës së Lazarotës.

[59] Aksesuar:https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/MBROJTJA%20E%20F%C3%8BMIJ%C3%8BVE%20NGA%20ABUZIMI%20DHE%20SHFRYT%C3%8BZIMI%20SEKSUAL.pdf.

[60] Neni 17 (2), KDPM.

[61] Neni 3 (15), KDPM.

[62] Neni 25 (1), KDMP.

[63] Neni 25 (4), KPDM.

mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, etj. (Nenet 25-29-30-31-32)

Specializimi i personave që administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur: Parashikon ndër të tjera, kufizime të personave që punojnë me të miturit dhe përkatësisht në Neni 25 në paragrafin 2 përcakton se, organet kompetente sigurojnë që çdo person që ka qenë i dënuar me një vendim të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje ndaj të miturit ose për dhunë nëfamilje, ndalohet të punojë me të miturin (Neni 25).

Kompetenca e gjykimit të çështjeve të drejtësisë për të miturit: Parashikon se brënda gjykatave të rretheve gjyqësore krijohen seksione të posaçme për çështjet e të miturve. Këto seksione janëkompetente edhe për gjykimin e të pandehurve të rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj tëmiturve/fëmijëve (Neni 27).

Masat mbrojtëse për të miturin viktimë ose dëshmitar: Parashikon se në çdo fazë të procesit penal duhet të merren masa të veçanta mbrojtëse për fëmijën viktimë kur siguria e fëmijës është në rrezik. Në varësi të rrethanave këto masa miratohen kryesisht nga gjyqtari (ex-officio), nga prokurori, nga policiagjyqësore ose Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Masat mbrojtëse konsistojnë në shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë midis të miturit viktimë dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit; bërjen e kërkesës për nxjerrjen e një "urdhri- kufizimi" në gjykatë; bërjen e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit "arrest me burg" për të akuzuarin; mbrojtjen e fëmijës prej policisë; masa të tjera të përshtatshme (Neni 37).

Avokati i Populli në raportin e vitit 2021, sjell në vëmendje, se standartet e sipërcitura gjatë procesit të ndjekjes penale të hetimit penal dhe proceset gjyqësore të rasteve të abuzimit seksual të fëmijës lidhur me legjislacionin shqiptar në tërësi janë të fragmentuara dhe mungojnë përkufizime shumë të rëndësishme lidhur me abuzimin seksual të fëmijës, angazhimin dhe detyrimin e tyre në aktivitete seksuale dhe në aktivitete të tjera të pahijshme. Gjithashtu, në Kodin Penal është parashikuar dhe mosha epëlqimit seksual, 14 vjeç, e cila nuk është në përputhje me standartet e Konventës së Lanzarotës.[64]

Për referencë, kujtojmë se, në praktikë nevoja për trajtim të veçantë të viktimave të abuzimit seksual ka sjellë, për herë të parë hapjen e një qendre të posaçme, Qendrës "Lilium" për trajtimin socio- shëndetësor të këtyre viktimave, që financohet nga shteti. Qendra garanton ofrimin e shërbimeve të integruara socio-shëndetësore. Të gjitha shërbimet e kujdesit shëndetësor, ekzaminimi mjeko-ligjor, mbledhja e provave për ndjekjen e rastit nëpërmjet drejtësisë penale dhe shërbimet psikosociale, ofrohen në të njëjtën kohë, në të njëjtin vend dhe nga profesionistë të specializuar veçanërisht për trajtimin e rasteve të viktimave të dhunës seksuale. Qendra ka në fokus kryesor shërbimin emergjent, me një ndalesë, në mënyrë të integruar, 24/7 dhe afatshkurtër (24 orë deri në 72 orë), për viktimat/ të mbijetuarit/rat e dhunës seksuale.[65]

Qendra Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijës nga Dhuna Seksuale, (që prej muaji mars 2020, tashmë ka një emër të ri, BARNAHUS Shqipëri) është një shërbim komunitar me qasje multidisiplinare për fëmijët e dhunuar seksualisht. E cila ofrohet nga organizatë jofitimprurëse e liçensuar nga shteti përtë ofruar shërbime të tilla të specializuara në nivel komunitar dhe kombëtar, ndërkohë që ka një eksperiencë prej 25 vitesh, në ofrimin e shërbimeve në mbrojtje të fëmijëve dhe të rinjve.[66]

Ashtu si edhe më parë, në qendër ofrohen shërbime të koordinuara në mbrojtje të fëmijëve dhe të rinjve viktimave të dhunës seksuale. Ndërkohë BARNAHUS Shqipëri, ashtu si të gjithë simotrat e saj në Europë, do të punojë që intervistimi i fëmijëve që janë viktima të dhunës seksuale të zhvillohet një herëtë vetme brenda mjedisve të Barnahus, për ta përdorur intervistën më pas në të gjitha shkallët e gjykimit, duke e ndihmuar viktimën në trajtimin tërësor të tij/saj.

Sipas studimeve për dhunën ndaj fëmijëve në Europë (BECAN), rreth 11% e fëmijëve në Shqipëri janë viktima

[64] Raport i Avokatit të Popullit mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve, Nëntor 2021, f.24.

[65] Qendra LILIUM është një qendër sipas standardeve europiane, e financuar nga Qeveria shqiptare në përmbushje të rekomandimeve të Konventës së Stambollit, Raportit të GREVIO-s dhe ligjit të ri për "Masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Ajo shërbim nëpërmjet një ekipi multidisiplinar të përbërë nga: punonjës socialë, punonjës të policisë, infermierë, mjekë ligjorë, gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës të prokurorisë, avokatë, etj.

[66] Në vitin 2019, CRCA/ECPAT Shqipëri, organizata kryesore ne vend për të drejtat e fëmijëve, me një eksperience mbi 26 vjet ne ketë fushe, për herë të parë në Shqipëri, hapi Qendrën Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Adoleshentëve nga Dhuna Seksuale – si një model të ri të parandalimit dhe trajtimit të dhunës seksuale, me fokus të posaçëm, vajzat dhe gratë e reja, por pa neglizhuar ne asnjë moment dhunën seksuale ndaj djemve.

të dhunës dhe ngacmimeve seksuale, ndërsa nga vrojtimi kombëtar i INSTAT "Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri", raportohet se rreth 15 % e vajzave të moshës 18-24 vjeç përjetojnë aktualisht dhunë seksuale.[67]

Me ndryshimet që i'u bënë K.Pr.Penale, viktimës së mitur i'u njoh e drejta që nëpërmjet përfaqësuesit, të kërkojnë drejtëpërdrejtë në gjykatë procedimin penal të fajtorit.[68]

Mosparaqitja e personit të dëmtuar apo përfaqësuesit të tij në seancë gjyqësore pa shkaqe të arsyeshme sjell pushimin e gjykimit. Ky rregull procedurial krijon një problem shumë të madh në realitet për sa i përket të drejtave të fëmijeve, që janë viktima të një veprimtarie kriminale siç është rrahja, dëmtime të tjera të shëndetit, plagosja etj. Pasi kërkesa për procedimin e personit të akuzuar në këto raste duhet të firmoset dhe të ndiqet gjatë gjithë procedimit dhe gjykimit nga përfaqësuesi ligjor i fëmijës, prindi apo kujdestari. Në rast se përfaqësuesi ligjor nuk është dakort dhe nuk i kryen këto veprime, atëherë fëmija nuk ka mundësi të mbrojë interesat e tij.[69]

6. Kompesimi i të miturve viktima të veprave penale

Një tjetër element i diskutueshëm në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është e drejta për kompensim ose shpërblim e viktimave të mitur të veprave penale. Diskutimi qëndron në faktin nëse kompensimi i viktimave është një e drejtë e viktimës apo një detyrim i shtetit i cili duhet ta japë atë në çdo rast pavarësisht vullnetit të viktimës. Në Ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar (ligji antimafia), në nenin 37, paragrafi 2/c parashikohet se:

> *"të ardhurat e përfituara nga zbatimi i këtij ligji shërbejnë për dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar dhe të dhunës, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale".*

Viktimat e mitura nën efektet e këtij ligji duhet të ndihmohen për t'u riintegruar plotësisht në shoqëri. Po të bëjmë një krahasim me legjislacionin kosovar i cili e ka të rregulluar me ligj aspektin e dëmshpërblimit të të miturve. Në vitin 2015 Kosova ka miratuar ligji "Për kompensimin e viktimave të krimit", i cili parashikon me saktësi veprat penale për të cilat do të jepet dëmshpërblim nga shteti në të gjitha ato raste kur autori nuk ka mjete financiare, duke përfshirë vrasjen, trafikimin njerëzor, dhunimin, keqpërdorimin seksual të fëmijëve dhe dhunën në familje. Përveç garancive procedurale në procesin penal, i mituri viktimë e veprave penale ka nevojë për trajtim të specializuar dhe efektiv, në mënyrë që të minimizohen pasojat e veprës/veprave penale të kryera ndaj tyre, të cilat shkaktojnë dëme të konsiderueshme psikologjike dhe shëndetësore. Në të gjitha procedurat që do të ndiqen ndaj të miturit viktimë të veprës penale, duhet të mbahet parasysh interesi më i lartë i fëmijës. Ky interes nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror, social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.

Ndër dispozitat e reja që parashikon Kodi, ajo që nxit interesin për studim është neni 45 që parashikon të drejtën për kompensim të viktimës së mitur. Kjo dispozitë parashikon detyrimin që ka gjykatësi pas dhënies së vendimit për të informuar viktimën së ka të drejtë të kompensohet. Për shkak të momentit procedural me të cilin lidhet kjo normë dhe mungesën e procedurës për kërkimin e kompensimit të dëmit të shkaktuar, studiohen disa elementë të cilët lidhen pikërisht me efektivitetin e kësaj norme. Meqënëse as në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe as Kodin e Procedurës Penale nuk ka asnjë dispozitë mbi kërkimin e kompensimit për viktimat e mitura, atëherë rrjedhimisht kërkimi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar do të bëhet sipas legjislacionit civil, duke ngritur një padi civile në një proces të ri gjyqësor.

---

[67] Aksesuar në: https://www.crca.al/sq/shqiperia-per-here-te-pare-me-nje-qender-per-mbrojtjen-e-femijeve-dhe-te-rinjve-nga-dhuna-seksuale/

[68] Analiza juridike e zbatimit në praktikë të ndryshimeve të reja në Kodin e Procedurës Penale Të dhëna krahasimore për 3 Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Sarandë, Gjirokastër, Përmet Gjirokastër, Shkurt 2019.

[69] Shih nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, i cili në pikën 3 dhe 4 parashikon: *"3. Nëse viktima akuzuese ose mbrojtësi i caktuar prej tij nuk paraqitet në seancë pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos pushimin e gjykimit. 4. Viktima akuzuese që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron tëdrejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor"*

Parashikimet në legjislacionin civil janë parashikime të përgjithshme, të cilat nuk i japin të miturit ndonjë pozitë më komode sesa të rriturit. Dhe barra e provës se ka një dëm bie mbi të miturin (përfaqësuesin e tij), gjë e cila nuk shkon në favor të viktimës, pasi ai përveç se ka vuajtur pasojat e një vepre, duhet edhe të provojë dëmin moral të shkaktuar.

Nga ana tjetër, përfaqësimi i viktimës mund të jetë një problem pasi familja e tij mund të mos ketë mjete financiare për një mbrojtje efektive, ndërsa mbrojtja ligjore falas vazhdon të jetë problematike në Shqipëri. Përveç problemeve që mund të has i mituri në procesin e ri për të kërkuar dëmshpërblimin, një aspekt që mund ti mohojë përfitimin e shpërblimit është pamundësia financiare e autorit të veprës penale. Por, zgjidhja jo domosdoshmërisht duhet parë te e drejta civile, meqënëse është ajo fushë e cila e rregullon institutin e shbërblimit të dëmit.

Ashtu si edhe e drejta penale s'duhet parë vetëm si një mjet ndëshkimi për autorin e veprës penale, por edhe si një mjet për ti ardhur në ndihmë viktimës së mitur, por për këtë duhet të ndërtohen mekanizmat e duhur për dëmshpërblimin e tyre. Dhe ligjvënësi ka vepruar drejt kur ka parashikuar një dispozitë për kompensimin e viktimave të mitur, por ka një problem në zbatimin e saj pasi për shkak të pozitës së dobët të viktimave të mitura kjo normë mund të mos jetë efektive. Pasi është një dispozitë e cila aplikohet vetëm duke informuar viktimën e mitur dhe mbrojtësin e tij se ka të drejtë të kompensohet, por nuk ja garanton kompensimin.

Pra, nisur nga situata në të cilën ndodhen viktimat e mitura për veprat penale të cilat shkaktojnë dëme morale (por edhe materiale) ligjvënësi duhej të bënte diferencimin. Viktimat e mitura nuk duhet të ndjekin po të njëjtën procedurë dhe t'ju bjerë gjithë barra për të luftuar një sistem drejtësie, për të përfituar një kompensim i cili u takon automatikisht në momentin të cilin ata konsiderohen si viktima të veprës penale, pavarësisht nëse autori ndalohet, dënohet, a vazhdon të jetë gjallë apo jo. Prandaj problem i këtij instituti është se në thelb nuk ka një procedurë dhe skemë kompesimi, por qëndron si dispozitë parimore që konsiston në informimin e viktimës dhe përfaqësuesit të tij. Modeli i aplikuar mund të jetë automatik, pra gjykata ta konstatojë vetë nevojën për dëmshpërblim kur ka viktima të mitur nga ato vepra penale të cilat vetë ligji penal duhet ta parashikojë (që duhet të jenë vepra penale të rënda), si dhe burimi itë ardhurave kur autori nuk dihet, nuk gjendet, apo nuk ka aftësi paguese, mund të jetë nga një fond i veçantë shtetorër i cili mbulohet pjesërisht nga buxheti i shtetit dhe pjesërisht nga konfiskimet e pasurive kriminale.

Ndërsa kur personi ka aftësi paguese, gjykatës ti jepet mundësia për ta caktuar kompensimin e viktimës si dënim plotësues, ndërsa viktimës dhe përfaqësuesit ti jepet mundësia e bërjes së kërkesave përtë konkretizuar shumën e nevojshme apo për të mos e pranuar dëmshpërblimin. Ose kërkesa të tjera pasi situatat mund të jenë nga më të ndryshmet, pra ideja është që të krijohet një kuadër ligjor i plotë. Ndërhyrja në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ndërtimi i një modeli apo i një procedure të thjeshtuar për kompesimin e viktimave të mitur, është e nevojshme. Në të kundërt gjasat që të miturit viktima të përfitojnë kompesimpas informimit nga gjykata se u takon kjo e drejtë, janë shumë të pakta. Megjithatë, zhvillimet ligjore deritani janë pozitive dhe duhet të vlerësohet fakti që viktimat e mitura sot kanë një mbrojtje dhe përkujdesje që para miratimit të Kodit nuk e kanë pasur dhe ka qenë një mangësi e madhe në sistemin e drejtësisë penale. Por përmirësimi i pozitës së tyre duhet të jetë në vazhdimësi duke ndërtuar sisteme dhe modele efektive që realisht u vijnë në ndihmë viktmave të veprave penale.[70]

7. Konkluzione

Në përfundim, mund të themi se, të gjitha ndryshimet ligjore, si amendimet e Kodit të Procedurës Penale dhe hyrja në fuqi e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, kanë sjellë një përmirësim të statusit të viktimës në procesin penal, por zbatimi i tyre kërkon një mentalitet të ri, miqësor dhe një angazhim profesional nga të gjitha organet dhe profesionistët e drejtësisë.

Klasifikimi i të drejtave të viktimave në procesin penal i bën ato të kuptohen qartë në raport me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare, si dhe forcon garancitë për zbatimin me efektivitet të tyre.

Këto të drejta të ndara në nëngrupe lehtësojnë zbatimin e tyre në kuadrin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Klasifikimi është i rëndësishëm edhe në lidhje me përgjegjësitë institucionale. Çdo institucion

[70] Puci, Kristina.*Politikat penale për viktimat e mitur në drejtësinë penale shqiptare. Kompensimi i viktimave të mitur, analizë mbi parashikimet ligjore dhe pritshmëritë*, faqe 9 dhe 10.

duhet të kuptojë se cila është detyra e tij dhe ç'duhet të bëjë për respektimin e të drejtave të viktimave. Procesi i rregullt ligjor nuk është një qëllim i vetmuar, por i lidhur ngushtë me një sjellje miqësore të organeve të drejtësisë ndaj viktimës. Kjo nuk mund të arrihet pa efektivitetin e procesit hetimor dhe gjyqësor në ngarkim të magjistratëve prokuror dhe gjyqtar. Në këtë kuadër, evidentimi i saktë i numrit të viktimave që sjellin vepra të ndryshme penale, dëmshpërblimi i viktimës për dëmin e pësuar nga vepra penale, krahas dënimit të fajtorit, është një tregues i rëndësishëm i efektivitetit të procesit gjyqësor dhe i besueshmërisë së publikut për një drejtësi efektive.

Së fundmi, vlen të theksohet se rregullimi i çështjeve të caktuara nga aspekti juridik dhe kordinimi për zbatimin në praktikë nga strukturat përkatëse të këtyre dispozitave ligjore në fushën e problematikave që kanë të bëjnë më viktimat e mitura do përbënte një binom të sukseshëm qëderivon në favor të një mbrojtje gjithnjë e më efektive të viktimave të veprës penale.

BIBLIOGRAFI

Literaturë

1. Analiza juridike e zbatimit në praktikë të ndryshimeve të reja në Kodin e Procedurës Penale, Të dhënakrahasimore për 3 Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Sarandë, Gjirokastër, Përmet Gjirokastër, Shkurt 2019.
2. Anthony, Ellis. *"Critical Study Recent Work on Punishment", "The Philosophical Quarterly"*, Vol 45, No179, April, 1995.
3. Drejtësia Penale Shqiptare mes vlerave të tratitës, meritave së ndryshimeve dhe largëpamësisë së ligjit dhe shoqërisë", Konferencë Shkencore Kombëtare, Tiranë, Onufri, 2018.
4. Drejtësia për të miturit, Realitete dhe Sfida, Reviste periodike Shkencore Nr. 12, Universiteti Mesdhetar iTiranës, Qershor 2018.
5. Direktiva (EU) 2016/800 për masat mbrojtëse proceduriale për të miturit e dyshuar dhe akuzuar nëprocedimet penale ('Direktiva e të Miturve').
6. Hysi, Vasilika, Hysi, A. *Reforma në drejtësinë penale dhe mbrojtja e viktimave, sfidat e zbatimit të reformës*, Criminal Law Department International Scientific Conference, University of Tiranë.
7. Hartëzimi i strukturave bazë të Mbrojtjes së Fëmijës (në nivel vendor) dhe prioritizimi i nevojave të tyre për aftësim professional, Tetor 2013.
8. Xhafo, Jola. *"Drejtësia Penale për të Mitur"*, GEER, Tiranë, 2012.
9. Konventa e Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual" (Konventa e Lanzarotës).
10. Puci, Kristina, Zylyfi, Klobeta. *Garancitë procedurale dhe trajtimi i viktimës së mitur të abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerzore në Shqipëri*, Tiranë 2019.
11. Puci, Kristina. *Politikat penale për viktimat e mitur në drejtësinë penale shqiptare.*

Legjislacion

1. Ligji nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".
2. Plani Kombëtar i Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët nësituatë rruge 2019-2021.
3. Raport i avokatit të popullit mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual një ndër shkeljet mëtë rënda të të drejtave të fëmijëve, Tiranë, Nëntor 2021.
4. Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018-2021, Tiranë, Shtator 2018.
5. Udhërrëfyesi për në BE: Anëtarësimi përmes reformës në drejtësinë penale në Shqipëri, Tiranë, Dhjetor2020.
6. United Nations International Children's Emergency Fund, Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuarapër Fëmijët.

7. Udhëzimin nr. 05, datë 26.10.2018, i Prokurorit të Përgjithshëm, "Për Garantimin e Asistencës ndajViktimave dhe Dëshmitarëve të Veprave Penale.

Web faqe

1. https://www.unicef.org/albania/media/2596/file/KODI%20-%20botimi%20dhjetor%202019.pdf.
2. https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/p%C3%ABr-t%C3%AB-par%C3%ABn-her%C3%AB shqip%C3%ABria-me-nj%C3%AB-kod-t%C3%AB-drejt%C3%ABsis%C3%AB-penale-p%C3%Abr t%C3%AB-miturit.
3. https://femijet.gov.al/al/njesite-per-mbrojtjen-e-femijeve
4. https://www.academia.edu/97102962/GARANCIT%C3%8B_PROCEDURALE_DHE_TRAJTIMI_I_VIKTIM%C3%8BS_S%C3%8B_MITUR_T%C3%8B_ABUZUAR_SEKSUALISHT_DHE_VIKTIM%C3%8BS_S%C3%8B_TRAFIKIMIT_T%C3%8B_QENIEVE_NJER%C3%8BZORE_N%C3%8B_LEGJISLACIONIN_SHQIPTAR.